RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKO FINANCIARE TË DREJTORISË RAJONALE TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT, QARKU TIRANË"

AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE

Tiranë, Shtator 2021

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-8**
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-7
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.	**HYRJA**	**8-15**
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**16-268**
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-17
III.2.	**Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**	17-268
III.2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.	17-20
III.2.2	Auditim mbi hartimin dhe zbatimin buxhetit.	20-22
III.2.3	Mbi administrimin e ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.	22-27
III.2.4	Mbi funksionin e inspektimit të Sektorit të Inspektimit të Produkteve me Origjinë Shtazore.	27-140
III.2.5	Mbi funksionin e inspektimit të Sektorit të Inspektimit të Produkteve me Origjinë jo Shtazore.	140-191
III.2.6	Mbi funksionin e inspektimit të Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve.	191-203
III.2.7	Mbi funksionin e inspektimit jashtë planit vjetor të miratuar, të iniciuara nga ankesat, indiciet, rastet urgjente, apo edhe me urdhëra të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së.	203-218
III.2.8	Mbi veprimtarinë e sektorit të laboratorit.	218-255
III.2.9	Mbi praktikat e inspektimit të kryera me institucione të tjera, si Krimi Ekonomik, etj.	255-256
III.2.10	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	256-266
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**266-283**
V.	**ANEKSE**	**284-295**
V.1.	Observacione	**295-301**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU), Qarku Tiranë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit, vlerësimin procedurës së planifikimit dhe kryerjes së inspektimit, masat administrative të vendosura nga inspektorët, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, bashkëpunimet e DRAKU Tiranë me institucione të tjera për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta si dhe vlerësimin e aktivitetit të komisionit të shqyrtimit të ankesave (organi epror) mbi vendimmarrjen e tij, për masat administrative të vendosura nga DRAKU Tiranë.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 05.01.2021 deri më datë 05.03.2021, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020 për vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, të DRAKU Tiranë, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, administrimin e vlerave monetare e materiale, planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet me origjinë shtazore, joshtazore, bimët, vendosjen e masave administrative dhe arkëtimin e tyre, veprimtarinë e sektorit të laboratorit, probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 13 akt-konstatimeve dhe 1 akt-verifikimi. Në përfundim të punës audituese në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e DRAKU Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të auditimit rezultoi:

▪ Në **2 raste** për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare, nga momenti i vendosjes së gjobave, nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin dhe arkëtimin, duke sjellë parashkrimin e tyre, dhe heqjen e të drejtës për arkëtimin nga AKU, *me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë.*

▪ Në 21 raste në vlerën 31,550,000 lekë, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, në mungesë të kompetencës ligjore, arsyetimit ligjor dhe jashtë afatit;

▪ Në 3 raste, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i kanë lënë në fuqi, duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë;

▪ Në **56 raste** nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbaruesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likujdim vullnetar, kërkimi nga përmbaruesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve) dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën **29,958,000 lekë**, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë **23 gjoba**, përkatësisht në vlerën **18,334,000 lekë** gjithsej, për të cilat është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.

▪ Në **59 raste,** procedura e asgjesimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 69 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, pasi në këto praktika nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjesimit, si procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të

mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill.

▪ Në **35 raste** nuk dokumentohet me shenjat dalluese bllokimi i produkteve ushqimore dhe më pas administrimi i tyre për produktet, konkretisht për:

-27,890 kg mish, i ndryshëm;
-20,000 kg djath për praninë e vajit të palmës, për të cilin ka patur ankesë nga konsumator;
-20,525 kg yndyrë vegjetale, e shitur në treg si gjalp, për të cilën është lënë detyrë e tërheqjes nga tregu, por që nuk administrohet informacion se çfarë është bërë me këtë sasi;
-9,132 kg produkte të ndryshme (mocarela, briosh, djathra, etj);
-4,242 litra vaj të cilat janë shitur, ndërkohë që analizat laboratorike të këtij vaji, të kryera më pas, kanë dalë jashtë standardit, dhe ky vaj nuk u tërhoq nga tregu;
-587 kg yndyrë vegjetale e cila ishte shitur në treg si gjalp;
-516 cop pasta C;
-3 raste të bllokimit të aktivitetit/linjës së prodhimit.

▪ Në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre.

▪ Në **12 raste** është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat kanë qenë në shkelje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambjentet e subjekteve private, si B.Z.F sh.p.k., K sh.p.k., në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë.

▪ DRAKU Tiranë nuk ka dorëzuar pranë rezervave shtetërore për ankand, pajisjet dhe sendet sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë.

▪ Në **11 raste** janë konstatuar mangësi dhe moszbatim i kuadrit ligjor në fushën e licencimit, si vijon:

-Në 4 raste është bërë refuzimi i aplikimit të subjektit për licencim, për mosplotësim të kushteve teknike, por nuk është bërë edhe ndalimi i ushtrimit të aktivitetit, si dhe përcaktimi i afatit konkret për rregullimin dhe plotësimin e kushteve për licencim;
-Në 6 raste nuk dokumentohen veprimet e inspektorëve përgjatë verifikimit të kushteve teknologjike, higjenike si dhe të dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
-Në 1 rast është miratuar aplikimi për licencim, ndërkohë që dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, ka patur mangësi në formë dhe përmbajtje, dhe për rrjedhojë aplikimi nuk duhej miratuar.

▪ Në **20 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është dokumentuar plotësisht dhe saktësisht procedura e marrjes së mostrës në subjekt, ose nuk është nuk është marrë mostër me pretendimin se ISUV pranon mostra për analizë deri në orën 13:00, si dhe vendimi i inspektimit është marrë në të njëjtën ditë kur është marrë edhe mostra, pa pritur rezultatin e saj.

▪ Në **3 raste** është konstatuar se nga inspektorët e pikës kufitare Qafë Thanë dhe Durrës, është lejuar hyrja e produkteve ushqimore në Shqipëri (42 ton yndyrë vegjetale dhe 20 ton djath), ku dokumentet e praktikës së importit kanë patur mangësi në formë dhe përmbajtje, kryesisht (invoice, packing-list, certifikata veterinare, certifikata e analizave laboratorike), janë fotokopje, pa vulën e laboratorit përkatës dhe jo në gjuhën shqipe, mungesa e akt-kontrollit të inspektorëve, si dhe **në 1 rast,** janë zhbllokuar produkte importi të subjekti C, në mungesë të dokumentacioni të origjinës (analiza e cilësisë), sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në **21 raste** në vlerën **31,550,000 lekë**, nga ky Komision janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, nga të cilat në: **-14 raste** në vlerën **21,350,000 lekë** gjithsej, janë shfuqizuar gjobat në mungesë të kompetencës ligjore dhe jashtë afatit, 2 raste prej tyre. **-5 raste** në vlerën **8,650,000 lekë** në mungesë të arsyetimit ligjor nga Komisioni përkatës pranë DPAKU. **-2 raste** në vlerën **1,550,000 lekë**, janë shfuqizuar gjobat, ndërkohë që ato kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, pra Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat nuk ka patur ende vendim përfundimtar.	Faqe 256-266	E lartë	DRAKU Tiranë dhe DPAKU në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjobat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përjashtuar 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjykimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme. DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, **për 2 gjobat,** të cilat kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e ecurisë së procesit në Gjykatën Administrative të Apelit.
2	Nga auditimi i praktikave të ekzekutimit të gjobave, është konstatuar se në 2 raste **për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare**, nga momenti i vendosjes së gjobave, **nuk është marrë asnjë masë** për ekzekutimin dhe arkëtimin, **duke sjellë parashkrimin e tyre**, sipas nenit 46 të Ligjit nr.10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", dhe heqjen e të drejtës për arkëtimin nga AKU, *me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë.*	Faqe 27-140	E lartë	DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën *350,000 lekë*, përkatësisht nga personat përgjegjës, pasqyruar në tabelën nr.31, në Kap., Anekse, aneksi nr.7.
3	Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në 3 raste janë shfuqizuar gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i kanë lënë në fuqi, *duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë*.	Faqe 256-266	E lartë	DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të përcjellin pranë zyrave të përmbarimit, vendimet e mësipërme të Gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim dhe arkëtimin e gjobave në vlerën *3,150,000 lekë*.
4	DR AKU Tiranë nuk ka përllogaritur dhe ndalur tatimin mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë *(1,842,171 x 15 %)* ndaj E.S, pagë e përfituar sipas urdhër shpenzimit nr.82 datë 13.05.2020 mbi bazën e Vendimit Gjykatës së Apelit nr.3320 datë 20.12.2019.	Faqe 22-27	E lartë	DRAKU Tiranë të marrë masa për arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë ndaj E.S, pasi nuk është ndalur nga paga e përfituar, sipas urdhër shpenzimit nr.82, datë 13.05.2020 dhe Vendimit Gjykatës Apelit nr. 3320 datë 20.12.2019.
5	-Në **56 raste** nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbaruesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likujdim vullnetar, kërkimi nga përmbaruesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve) dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 29,958,000 lekë, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë 23 gjoba, përkatësisht në vlerën 18,334,000 lekë gjithsej, për të cilat është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.	Faqe 27-140	E lartë	DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proçes shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor privat, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme), për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa). Për çdo rast, kur nga përmbaruesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, DPAKU t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbaruesve. Në këtë mënyrë, kjo praktikë do të shërbejë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit të AKU me zyrat e përmbarimit. -Për dy rastet, në të cilat nuk është kërkuar për arkëtim kamat-vonesa, të njoftohet shërbimi i përmbarimit për arkëtimin e tyre, duke shmangur dëmin ekonomik që mund të shkaktohet ndaj buxhetit të shtetit, në të ardhmen.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
				-Gjithashtu 23 gjobat në vlerën 18,334,000 lekë, t'i përcillen për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit të DPAKU-së ose Komisionit të posaçëm në MBZHR, sipas kompetencës ligjore.
6	Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, ku theksojmë se në këto praktika janë konstatuar edhe raste të trajtimit me dy standard.	Faqe 27-191	E lartë	DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre, si dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit.
7	DRAKU Tiranë nuk ka dorëzuar pranë rezervave shtetërore për ankand, pajisjet dhe sendet sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, por ato qëndrojnë prej 3 vitesh në magazinën e AKU, në dëm të biznesit dhe administrimit tyre. DRAKU Tiranë pajisjet e konfiskuara ndaj 18 subjekteve në vitin 2018 i ka dorëzuar pa vlerë duke i pasqyruar vetëm në sasi.	Faqe 22-27	E lartë	DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marrë masa për kalimin në pranë rezervave shtetërore të pajisjeve dhe sendeve sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, sipas flet hyrjes nr.2 datë 07.05.2018 të AKU.
8	Nga auditimi i praktikave të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore, në **12 raste** është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat kanë qenë në shkelje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambjentet e subjekteve private, si B.Z.F sh.p.k., K. sh.p.k., në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë. Theksojmë se ky veprim është kryer në tejkalim të kompetencave ligjore, pasi për kryerjen e tij, (pra mishin e konfiskuar ta dërgosh në ambjentet e një tjetër subjekti privat), nuk ka patur minimalisht as edhe një kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike, ndërmjet AKU dhe këtyre subjekteve, që të lejonte kryerjen e këtij veprimi.	Faqe 27-140	E lartë	DRAKU dhe DPAKU të marrin masat e nevojshme, duke analizuar dhe vlerësuar mundësitë e investimit në blerjen e dhomave frigoriferike ose marrjes me qira të tyre, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen, të ruhen në këto ambjente. Nëse ky proces finalizohet, të sigurohen mimalisht 4 dhoma frigoriferike, pra 1 dhomë në dispozicion të 3 Qarqeve, më konkretisht dhoma frigoriferike për DRAKU Tiranë, të shërbejë edhe për DRAKU Elbasan dhe DRAKU Durrës, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në subjektet e inspektuara, t'u tarifohet atyre, deri në momentin e asgjesimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet sipas përcaktimeve të Ligjit të ushqimit, nuk do t'i lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit ta futet përsëri në treg.
9	Nga auditimi i praktikave të asgjesimit të produkteve, të cilave u ka kaluar afati i përdorimit ose kanë qenë të dëmtuara dhe nuk mund të konsumohen, është konstatuar se në **59 raste,** nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjesimit, si procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill.	Faqe 27-191	E lartë	DRAKU Tiranë, të marri masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe: Procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.
10	Nga auditimi i praktikave të inspektimit (kryesisht atyre me ankesë/indicie), në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve ushqimore të ndryshme dhe linjës së prodhimit, është konstatuar se **në 35 raste** nuk dokumentohet me shenjat dalluese dhe më pas administrimi i tyre për produktet, konkretisht për: -27,890 kg mish, i ndryshëm; -20,000 kg djath për praninë e vajit të palmës, për të cilin ka patur ankesë nga konsumator; -20,525 kg yndyrë vegjetale, e shitur në treg si gjalp, për të	Faqe 27-191	E lartë	DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat e nevojshme, që të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe për bllokimin e aktivitetit/linjës së prodhimit, këtu mund ti referoheni praktikës që ndjekin autoritetet doganore/Inspektorati Shtetor Teknik Industrial), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shënjat dalluese dhe përdorimi i tyre të përcaktohet si detyrim ligjor në rregulloren e brendshme të institucionit.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	cilën është lënë detyrë e tërheqjes nga tregu, por që nuk administrohet informacion se çfarë është bërë me këtë sasi; -9,132 kg produkte të ndryshme (mocarela, briosh, djathra, etj); -4,242 litra vaj të cilat janë shitur, ndërkohë që analizat laboratorike të këtij vaji, të kryera më pas, kanë dalë jashtë standardit, dhe ky vaj nuk u tërhoq nga tregu; -587 kg yndyrë vegjetale e cila ishte shitur në treg si gjalp; -516 cop pasta Cannelloni; -3 raste të bllokimit të aktivitetit/linjës së prodhimit.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinion i kundërt[1]

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së DRAKU Tiranë për periudhën 01.01.2018-31.12.2020, nëse kjo veprimtari është kryer duke respektuar dhe zbatuar ligjet, rregulloret në fuqi, marrëveshjet, duke përfshirë këtu shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, kryerjen e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen e penaliteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DRAKU Tiranë, ku rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), si pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale të institucioneve të auditimit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DRAKU Tiranë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave mbështesin dhënien e një ***opinioni të kundërt****.*[2]

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentua se, *aktiviteti i kryer nga DRAKU Tiranë për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, administrimin e vlerave monetare e materiale, planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet me origjinë shtazore, joshtazore dhe bimët, vendosjen e masave administrative, shqyrtimin dhe arkëtimin e tyre, veprimtarinë e sektorit të laboratorit përgjatë periudhës* 01.01.2018-31.12.2020*, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke mos përmbushur detyrat funksionale të institucionit*, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale dhe të përhapura.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë"*. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave, me qëllim marrjen e

[1] *Sipas* ***Manualit të Auditimit Përputhshmërisë*** *të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 2306.2020, grupi II pika 7.3.3, Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjes janë materiale dhe të përhapura.*

[2] *Neni 4, pika 2, shkronja b, paragrafi i tretë "Opinion i kundërt, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura", në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.*

evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Konkretisht në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

-Në 56 raste nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbaruesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likujdim vullnetar, kërkimi nga përmbaruesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve) dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 29,958,000 lekë, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë 23 gjoba, përkatësisht në vlerën 18,334,000 lekë gjithsej, për të cilat është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.

-Në 21 raste në vlerën 31,550,000 lekë, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, në mungesë të kompetencës ligjore, arsyetimit ligjor dhe jashtë afatit;

-Në 3 raste, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i kanë lënë në fuqi, duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë;

-Në 2 raste për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare, nga momenti i vendosjes së gjobave, nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin dhe arkëtimin, duke sjellë parashkrimin e tyre dhe heqjen e të drejtës për arkëtim, me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë;

-Në 59 raste, procedura e asgjesimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 69 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, pasi në këto praktika nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjesimit, si procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill.

-Në 35 raste nuk dokumentohet me shenja dalluese bllokimi i produkteve ushqimore dhe më pas administrimi i tyre.

-Në 18 raste është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre.

-Në 12 raste është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat kanë qenë në shkelje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambjentet e subjekteve private, në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DRAKU Tiranë:

Drejtimi DRAKU Tiranë, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DRAKU Tiranë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH,

gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikuam me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikuam çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kundërt.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.1153/1, datë 05.01.2021, i ndryshuar me shkresën nr.1153/2, datë 06.01.2021 dhe me shkresën nr.1153/3, datë 03.02.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.01.2021 deri në datë 05.03.2021, në subjektin "Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë" (*në vijim DRAKU*) për periudhën nga 01.01.2018 deri 30.12.2020 u krye auditimi "Mbi funksionimin dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare" nga Grupi i Auditimit me përbërje:
1.K.K, Përgjegjës Grupi
2.H.M, Auditues
3.B.B, Auditues
4.F.Ç, Auditues
5.E.G, Auditues

II.1. Objektivi i auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimin e përputhshmërisë mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, të DRAKU Tiranë, ku objektivi i auditimit ishte: "Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, në:
-Zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të lëna nga KLSH;
-Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
-Administrimin e vlerave monetare e materiale;
-Planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet me origjinë shtazore, joshtazore, bimët, vendosjen e masave administrative dhe arkëtimin e tyre;
-Veprimtarinë e sektorit të laboratorit;
-Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

II.2. Qëllimi i auditimit.

Dhënia e opinionit dhe lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në të ardhmen.

II.3. Identifikimi i çështjes.

DRAKU Tiranë, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, duke patur në fokus kryesor, garantimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor. Auditimi u fokusua në fushat e aktivitetit të DRAKU Tiranë, sipas vlerësimit dhe kategorizimit të riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët), pasqyruar në tabelën nr.1, Kapitulli "Anekset".

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

DRAKU Tiranë si dhe niveli drejtues i saj (Drejtori i Përgjithshëm, Kryeinspektor i Drejtorisë Rajonale të AKU-së, si dhe niveli i mesëm drejtues) kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbyen si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore
Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC; Ligji nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; -Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015 i ndryshuar; Rregullore "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
Ligje:	Ligji nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligji nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën ë Shqipërisë"; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative"; Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar; Ligji 87/2012 për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr.4, datë 16.08.2012, të këshillit të ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre"; Ligji nr.87/2013 "Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit";

	Ligji nr.105/2016 dt. 27.10.2016 "Për mbrojtjen e bimëve" Ligji nr.10416 dt.07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar; Ligji nr.17/2020 "Për produktet plehëruese"; Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr.10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"; Ligji nr.10465, datë29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare";
Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)	VKM nr.1081 datë 21.10.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e AKU-së", i ndryshuar; VKM nr.696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi"; VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar"; VKM nr.235, datë 21.3.2017 "Për miratimin e rregullores për karakteristikat e cilesisë dhe kriteret e natyrshmerise së vajit të ullirit dhe vajit të bersisë së ullirit"; VKM nr.760, datë 16.9.2015 "Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor"; VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore"; VKM nr.434, datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit"; VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar; VKM nr.532, datë 11.9.2018 "Për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve"; VKM nr.530, datë 13.6.2013 "Për përcaktimin e kritereve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç fares"; VKM nr.260, datë 27.3.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave"; VKM nr.452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar; VKM nr.417, datë 27.5.2020 Për procedurat e organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin"; VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"; VKM nr.1188 datë 20.08.2008 "Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve", i ndryshuar;

	VKM nr.1555 datë 12.11.2008, "Për përcaktimin e e rregullave të regjistrimit dhe të kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", i ndryshuar;
Akte të tjera nën ligjore:	Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 10.8.2018 "Për miratimin e rregullores, "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"; Urdhëri nr.58, datë 21.08.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në RSH", i ndryshuar; Urdhëri i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.25, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve"; Urdhëri nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line"; Urdhëri nr.108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit"; Urdhëri nr.4635, datë 16.10.2006 "Për inspektimin fitosanitar në PIK"; Urdhëri nr.72, datë 15.03.2011 "Për miratimin e akt-kontrollit mbi inspektimin e produkteve me origjinë jo-shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për çdoganimin e tyre dhe akt-marrje mostre", i ndryshuar; Urdhëri nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit"; Urdhëri nr.4277, datë 01.12.2015 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim"; Urdhëri nr.1586, datë 28.04.2016 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për ndjekjen e procedurave ligjore në gjykatat administrative, për vjeljen e gjobave të vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm gjykatë rrethi"; Urdhëri nr.3352, datë 05.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm "Për inspektimin e subjektit Globex"; Urdhëri nr.4549, datë 27.10.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, Për marrjen e mostrave të farave dhe produkteve plehëruese për analizim të treguesve cilësor të farës dhe elementëve përbërës të plehut"; Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.2363 datë 30.03.2018 "Për dorëzimin e materialeve të sekuestruara gjatë inspektimeve"; Urdhëri i Ministrit të Bujqësisë nr.374 datë 31.08.2007 ndryshuar me nr.72 datë 15.03.2011 "Mbi inspektimin e produkteve me origjine jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe veprimet e zhdoganimit"; Udhëzimi nr.4, datë 20.04.2018, Udhëzimi nr.2, datë 26.02.2019 Udhëzimin nr.2, datë 24.02.2020, të Ministrit përgjegjës për bujqësinë "Për miratimin e planeve vjetore të inspektimit dhe marrjes së mostrave"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; Udhëzimi nr.1, datë 05.02.2016 "Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore"; Udhëzimi nr.5, datë 04.05.2018 "Për përjashtimin nga zbatimi i sistemit

	të vetëkontrollit për operatorë të veçantë të biznesit ushqimor"; Udhëzimi nr.7 datë 14.12.2015 "Për aromatizuesit, dhe përbërësit të caktuar ushqimor me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore"; Udhëzimi nr.4, datë 21.03.2011 "Për përbërjen dhe etiketimin e produkteve ushqimore të përshtatshme për personat intolerant ndaj glutenit"; Udhëzimi nr.16, datë 22.12.2014 "Për përcaktimin e kriterit të pastërtisë së ngjyruesve të përdorur në produktet ushqimore"; Udhëzimi nr.207, datë 31.03.2015 "Për përcaktimin të treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuara për tu shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore"; Udhëzimi nr.3, datë 27.02.2006 "Për etiketimin e produkteve ushqimore të importuara"; Udhëzimi nr.8, datë 08.05.2007 "Për tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucinet varësë te MBUMK"; Udhëzimi nr.20, datë 25.11.2010 "Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore"; Udhëzimi nr.22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor"; Udhëzimi nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", i ndryshuar; Udhëzimi nr.207, datë 31.03.2015 "Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për tu shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore"; Udhëzimi nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; Udhëzimi nr.8, datë 8.05.2007 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë"; Udhëzimin nr.1 datë 09.01.1996 "Per procedurat e punes se sistemit te thesarit dhe marrëdhëniet me institucionet buxhetore", i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.7.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Udhëzimi nr.107, datë 02.12.2002 "Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor"; Udhëzimi i Agjencisë Prokurimit Publik nr.2, datë 28.3.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla"; UMF nr.33, datë 11.07.2013 dhe nr.57 datë 12.06.2014 "Për gjurmët standarde auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte"; Rregullore e brendshme e AKU-së;

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Ekzaminimi i dosjeve të inspektimit;
2. Verifikimi i transaksioneve;
3. Rillogaritja/kontrolli aritmektik i veprimeve financiare;
4. Kryqëzimi i të dhënave;
5. Shqyrtimi i praktikave të laboratorit;
6. Kombinim i dy metodave, procedurave thelbësore analitike dhe testimi i praktikave të inspektimit;
7. Vlerësimi i auditimit të brendshëm

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 13 gjithsej, dhe 1 akt-verifikimi, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili shërbeu si materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Vlerësimi i materialitetit mbi shpenzimet e institucionit, pasqyruar në tabelën nr.2, Kap. "Anekset"[3]

- **Niveli i materialitetit:** 2% * 57,592,102 lekë = 1,151,842 lekë
- **Gabimi i lejuar:** 1,152,842 lekë * 10% = 115,184 lekë
- **Saktësia:** 1,151,842 lekë – 115,184 lekë = 1,036,658 lekë
- **Preçizioni i materialitetit** ose gabimet e mundshme për gjithë popullatën (vlerën totale të shpenzimeve të institucionit) 1,036,658 lekë * 90% = 932,992 lekë
- Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për totalin e popullatës: (57,592,102 lekë * 0.7 faktorin e riskut) : 1,036,658 lekë = **38 çështje**
- Numri i çështjeve për tu shqyrtuar për një nga llogaritë ekonomike që ka risk më të lartë se të tjerat, në gjykimin e grupit të auditimit, mallra dhe shërbime, (7,784,257 lekë * 0.7)/1,036,658 lekë = **5 çështje**

Gjatë planifikimit dhe ushtrimit të auditimeve të përputhshmërisë, Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse. Shkeljet apo gabimet, janë materiale (në kuptimin e rëndësisë) nëse ato, të shkëputura ose të mbledhura me gabime të tjera, ndikojnë në konkluzionet kryesore të auditimit.

Përcaktimi i materialitetit sipas **sasisë** përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret, etj.

Materialiteti vlerësohet në nivelin 2%.

Për më tepër, në disa raste shmangiet nga përputhshmëria, mund të mos jenë materiale nga ana sasiore, - për shkak të natyrës së tyre ose për shkak të kontekstit në të cilin ato lindin – janë materiale nga ana **cilësore** dhe në këtë mënyrë kanë ndikim në zbulimet dhe konkluzionet e auditimit.

[3] Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 3.4 "Materialiteti"

Vlerësimi i **riskut**, në auditimet e përputhshmërisë, është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke patur parasysh tre komponentët e riskut të auditimit:
Risku i brendshëm, i shmangies nga përputhshmëria apo gabimeve, vlerësohet të jetë i mesëm për shkak të:
- Kompleksitetit të kuadrit rregullator dhe kohës në të cilën është miratuar kjo bazë ligjore.
- Ndryshimet e shpeshta të strukturës organizative.

Risku i kontrollit është risku që një shmangie materiale (e rëndësishme) mund të ndodhë dhe që nuk parandalohet, zbulohet dhe korrigjohet në kohën e duhur, nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Risku i kontrollit vlerësohet i mesëm duke qenë se ekzistojnë procedura të kontrollit me anë të konfirmimeve nga palë të treta gjatë zhvillimit të procedurës.
Risku i moszbulimit është risku që auditimi të mos zbulojë shmangie materiale të ndodhura dhe që nuk janë parandaluar apo zbuluar dhe korrigjuar në kohën e duhur nga sistemi i kontrollit të brendshëm të njësisë, entit, departamentit, agjencisë, organizatës, institucionit, etj. Risku i moszbulimit do të jetë i ulët duke marrë parasysh nivelin e pranuar të riskut dhe riskun e vlerësuar të brendshëm dhe atë të kontrollit.[4]

-Nisur nga sa më sipër, nga vlerësimi i riskut të brendshëm (RB), riskut të kontrollit të brendshëm (RKB) dhe riskut të zbulimit (RZ), ku dy risqet RB dhe RKB, ndikojnë në aktivitetet e institucionit, kemi bërë kategorizimin e riskut të aktiviteteve dhe përzgjedhjen e kampionit të auditimit, të cilat gjykojmë të auditojmë, pasqyruar në tabelën nr.3, Kap. "Anekset".

<u>Kampionimi (Përzgjedhja e kampionëve të veçantë dhe testimi i tyre):</u>[5]
Për përzgjedhjen e kampionit, që u auditua sipas fushave, kryesisht të inspektimeve dhe laboratorit, pasi për shpenzimet sipas llogarive ekonomike, e kemi përcaktuar nëpërmjet vlerësimit të materialitetit, jemi mbështetur në disa kritere, shtresëzim dhe nënshtresëzim, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga subjekti që u auditua, përgjatë fazës së planifikimit.
Konkretisht, për funksionin e inspektimit nga sektori i produkteve me origjinë shtazore, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut në nivel të lartë, kriteret për përzgjedhjen e kampionit ishin si më poshtë vijon:
1. U përzgjodhën subjektet private, të cilat konsiderohen me risk të lart dhe të mesëm, kryesisht inspektimet e produkteve të bulmetit dhe të mishit, që kanë edhe konsumin më të lartë, si dhe të shtrira në Qarkun Tiranë;
2. U përzgjodhën muajt, të cilët kanë numrin më të lartë të inspektimeve, me qëllim që kampioni të ishte sa më gjithëpërfshirës;
3. Brenda këtyre muajve u përzgjodhën inspektimet, në të cilat janë vendosur masa administrative, gjoba, bllokim produkti, sekuestrim, asgjesim;
4. Përsëri brenda këtyre muajve u përzgjodhën inspektimet në të cilat janë marrë mostra për analizë, me përgjigje negative dhe pozitive të rezultatit;
5. Gjithashtu përgjatë gjithë vitit, u përzgjodhën praktika inspektimi, të cilat janë autorizuar, bazuar në indicie, ankesa, dhe inspektimet alert, si dhe inspektime në të cilat është vendosur vetëm masa administrative "Paralajmërim" dhe zbatim detyrash brenda afatit të caktuar nga

[4] Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 4.3.2 - Për të ruajtur nivelin e riskut të auditimit (deri 5 %) të përcaktuar në politikat audituese të KLSH-së, sa më i lartë të vlerësohet nga audituesit niveli i riskut të brendshëm dhe/ose të kontrollit, aq më i ulët duhet të jetë risku i mos zbulimit.
[5] Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 5.7 - Përzgjedhja e disa artikujve të veçantë bëhet në rastet kur audituesi zgjedh brenda popullatës vetëm artikuj me karakteristika të veçanta. Këto përgjithësisht i korrespondojnë artikujve me risk të lartë ose me vlerë të lartë brenda popullatës së përzgjedhur.

inspektorët, ku kryesisht kemi zgjedhur ato inspektime të cilat janë me indicie dhe masa e vendosur është paralajmërim;
6. Sa më sipër për ilustrim për vitin 2018, kemi përzgjedhur muajt Janar, Korrik, Tetor dhe Dhjetor, dhe shtrirje në të gjithë vitin, për praktikat me indicie, ankesa, alert, ilustruar në tabelën nr.4, Kap. "Anesket", për muajin Janar;
-Për vitin 2019, u përzgjodhën muajt Maj, Qershor, Gusht, Tetor, Dhjetor.
-Për vitin 2020, u përzgjodhën sipas rastit praktika inspektimi, në të cilat nuk ishte fokusi, verifikimi i zbatimit të masave kundër Covid 19.
-Kjo metodikë është ndjekur edhe për sektorin e inspektimit të produkteve me origjinë jo-shtazore dhe të inspektimit të bimëve.

- Përsa i përket sektorit të laboratorit, kemi audituar analizat e mostrave të sjella vetë nga subjektet private, duke i kushtuar më tepër rëndësi aplikimit të tarifave për çdo tregues të analizuar për produkt, të miratuar me Udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 08.05.2007.

-Sa më sipër, si vit me më tepër risk, për të përzgjdhur kampionin, u përzgjodhë viti 2018, ku është numri më i lartë i analizave si dhe të ardhurat e realizuara nga ky shërbim janë më të larta rreth 2,470,585 lekë në krahasim me vitin 2019 me rreth 826,805 lekë.

Struktura e kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet.
Siç e kemi cituar edhe më sipër, riskun e kontrollit të brendshëm e kemi vlerësuar të mesëm, për arsye se ekzistojnë disa proçedura të kontrollit të brendshëm, por dobësia vihet re në zbatimin e tyre.

Theksojmë se periudha që u auditua përfshin vitin buxhetor 2018, 2019 si vite të plota aktiviteti, dhe vitin 2020, për efekt raportimi të auditimit të buxhetit, pasi aktiviteti i inspektimit për këtë vit, ka qenë i kufizuar, referuar këtu Urdhrit nr.128, datë 11.03.2020 i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për përcaktimin e ditëve të pushimit dhe masave të tjera mbrojtëse në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga COVID-19"; Urdhrit nr.1345, datë 12.03.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së "Për miratimin e masave në lidhje me zhvillimin e procesit të inspektimit, në kuadër të parandalimit të përhapjes së Virusit COVID-19", ku është përcaktuar që të pezullohen të gjitha procedurat e inspektimit zyrtar të planifikuara në planin vjetor, si dhe inspektimet rastësore të kryera kryesisht në furrat e bukës, janë bërë mbi përdorimin e masave mbrojtëse, dorezave, distanca, dizifektantët, eleminimi i prerjes së bukës; Udhëzimit nr.6, datë 17.03.2020 të Ministrit të Bujqësisë; Urdhrit të Prefektit të Qarkut Tiranë, për ngritjen e grupeve të përbashkëta të monitorimit (AKU, Policia, Drejtoria e Tatimeve, Inspektorati i Shëndetësisë) të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19; Urdhrit nr.28, datë 21.10.2020 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadërt të Task-Forcës anti COVID-19", me qëllim zbatimin e masave të sigurisë dhe senzibilizimin e qytetarëve për mbajtjen e maskave.
Sa më sipër, pavarsisht faktit se DRAKU Tiranë është një strukturë varësie, vlerësojmë se, ky institucion konsiderohet me risk të lartë, përsa i përket natyrës së aktivitetit që kryen, ndjeshmërisë së lartë sociale që ka, ndërgjegjësimin e biznesit, në garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit për konsum njerëzor dhe për kafshët.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

1. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, ka si mision garantimin e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar, trajtimit, përpunimit, dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë. Gjithashtu kjo

Drejtori ka si objektiv, kryerjen e inspektimeve, marrjen dhe analizimin e mostrave, nga ushqimet me origjinë shtazore dhe ushqimet me origjinë jo-shtazore, si dhe bimët, produktet plehëruese.
2. DRAKU Tiranë, deri më datën 14.09.2020 është organizuar dhe ka funksionuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr.1081, datë 21.10.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombetar të Ushqimit", e ndryshuar, dhe pas datës 14.09.2020 e në vijim, është e organizuar dhe funksionon sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr.708, datë 09.09.2020. DRAKU Tiranë, e shtrin juridiksionin e vet në Qarkun Tiranë, duke përfshirë Bashkinë Tiranë, Kavajë dhe Rrogozhinë.
Struktura e DRAKU Tiranë është miratuar me Urdhrin nr.119, datë 10.03.2014 të Kryeministrit, dhe është e organizuar në nivel Drejtorie dhe Sektori. Niveli i drejtorisë përfaqësohet nga Kryeinspektori i DRAKU (1 punonjës), i cili drejton Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit (20 inspektor); Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit (16 inspektor); Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore (5 inspektor); Sektorin e Shërbimeve Laboratorike Fiziko-Kimiku dhe Mikrobiologjiku (1 përgjegjës dhe specialist); Sektori i Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, PIK (6 inspektor, nga të cilët 2 inspektor për produktet me origjinë jo-shtazore, 2 inspektor për produktet me origjinë shtazore dhe 2 inspektorë për produktet e mbrojtjes së bimëve) dhe Sektorin e Shërbimeve të Brendshme (1 përgjegjës, 2 specialist dhe 1 sanitar), pra në total në organikën e DRAKU Tiranë janë 58 punonjës.

DRAKU Tiranë ka si funksion:
a) kontrollin paraprak për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjienosanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatoreve të biznesit ushqimor, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve;
b) kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve në territorin e qarkut përkatës;
c) kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve në njësitë e inspektimit kufitar;
d) Ndalon, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të atij të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi a ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
dh) analizimi laboratorik për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe bimëve.

▪ Procedura e inspektimit iniciohet me lëshimin e autorizimit nga Kryeinspektori i DRAUK Tiranë, në të cilin përcaktohet subjekti, kohëzgjatja, çfarë do të inspektohet, si dhe grupi i inspektorëve.
Nga grupi i inspektorëve, gjatë inspektimit në terren, pranë subjektit, plotësohet listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit, në të cilin pasqyrohen veprimet, shkeljet, lihet detyrë për dorëzim dokumentacioni, marrje mostrash për analizë laboratorike, si dhe vendimi përfundimtar i inspektimit i cili merret nga grupi i inspektimit.
Çdo sektor i inspektimit ka planin vjetor të inspektimit, i cili përgatitet nga Drejtoria Rajonale, më pas dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme, e cila bënë konsolidimin e tij me planet e Drejtorive të tjera rajonale, dhe ky plan i konsoliduar i dërgohet Inspektoratit Qendror për mendim. Pas dhënies së mendimit nga Inspektorati Qendror, plani vjetor i inspektimit miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në rolin e institucionit epror të AKU.

-Gjithashtu çdo sektor i inspektimit ka planin për marrjen e mostrave në terren, nga subjekte të ndryshme.

▪ Procedura e analizës së mostrës, ka dy burime, mostrat që vijnë nga inspektorët e DRAKU-së, dhe mostrat që sjellin vetë subjektet private për analizë, prej nga gjenerohen të ardhura, si rrjedhojë e tarifimit të shërbimit të analizës së mostrave të sjella nga vetë subjektet. Këto të ardhura thjesht, kontabilizohen për efekt pasqyrimi dhe raportimi në bilancin e DRAKU Tiranë, por kalojnë automatikisht në buxhetin e shtetit. Gjithashtu theksojmë se në rastet kur mostra e sjellë nga inspektorët, ka përgjigje pozitive (pra jashtë normave) shërbimi laboratorik i kryer tarifohet, dhe paguhet nga subjekti prej të cilit është marrë mostra.

Aktualisht laboratori kryen analiza të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore, për bimët nuk kryen, pasi nuk ka kapacitete të mjaftueshme për kryerjen e tyre. Analizat për mostrat e bimëve, produkteve të mbrojtjes së bimëve, kryhen në laboratorin e ISUV, Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanave, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Çdo mostër që vjen në laborator nga inspektorët, është e koduar, me qëllim që marrësi në dorëzim (përgjegjësi i laboratorit), mos të dijë se cilit subjekt i përket mostra, për të shmangur diskriminimin, konfliktin e interesit.

Mostrat që vijnë në laborator shoqërohen me fletën e shoqërimit, e cila është e nënshkruar nga grupi i inspektorëve që ka marrë mostrën, si dhe nga përgjegjësja e laboratorit, që merrë mostrën në dorëzim, dhe më pas e shpërndan tek specialistët për analizimin e saj.

Përgjigja e rezultatit të mostrës, nga momenti i pranimit deri në daljen e saj, varion nga 3-7 ditë, në raste të caktuara edhe më shumë.

Mostrat që sillen në laborator për analizë, përgjigjet e tyre, treguesit e analizuar, mbahen në një regjistër, të laboratorit.

Theksojmë se regjistrat që mbajnë sektorët e mësipërm, nuk kanë ndonjë format të miratuar me Urdhër/Udhëzim, por janë regjistra, forma e të cilëve është e trashëguar nga periudha të mëparshme.

▪ Inspektorët e DRAKU Tiranë, në rastin e konstatimit të shkeljeve ligjore nga subjektet, përgjigjes pozitive (jashtë standardit) nga analiza laboratorike, kanë të drejtë të bllokojnë mallin, sekuestrojnë, dhe të marrin masat për asgjesimin e tij, me shpenzimet e subjektit, duke qenë të pranishëm gjatë procesit të asgjesimit të produktit, dhe dokumentimit të këtij procesi.

-Gjithashtu inspektorët kanë detyrimin e vendosjes së gjobave, ndalimin përkohësisht të aktivitetit ose mbylljen e plotë të tij, në varësi të llojit të shkeljes dhe rëndësisë së saj.

-DRAKU Tiranë gjeneron të ardhura nga gjobat, shërbimet laboratorike, shërbimet e inspektorëve në pikën kufitare (kontrollin e dokumentacionit, të produkteve/kafshëve import- eksport), si dhe nga tarifa e certefikatës veterinare që lëshohet nga DRAKU, për produktet me origjinë shtazore që të cilat eksportohen. Këto të ardhura kalojnë në buxhetin e shtetit.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

<u>2.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm:</u>

Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, rezultoi se me shkresën nr.557/10, datë 22.09.2015, nga KLSH, janë përcjellë rekomandimet e lënë në auditimin e mëparshëm, për zbatimin e të cilave u mbajt akt-verifikimi dhe ku rezultoi se:

1. DRAKU Tiranë nuk ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

2. DRAKU Tiranë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në DRAKU Tiranë:
Nga ana e KLSH janë lënë **17** rekomandime gjithsej, nga këto:

- 6 masa për përmirësim ligjor, 5 masa organizative, dhe 6 masa disiplinore.

-Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 masa për përmirësim ligjor, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht 4 prej tyre dhe 2 pa zbatuar, 5 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar pjesërisht 2 dhe pa zbatuar 3 prej tyre. Nga masat disiplinore nuk është zbatuar asnjë. Këto janë pasqyruar në pasqyrën nr.1, në Kap. "Anesket".

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR:

Rekomandim 1: Në zbatim të ligjit të ushqimit nga AKU dhe MBZHRAU të hartohet dhe t'i propozohet Këshillit të Ministrave projekt-vendimi mbi mënyrën e vjeljes së gjobave dhe shpërndarjes së tyre.
1.1 AKU në zbatim të ligjit për ushqimin, të propozojë aktet nënligjore pranë Ministrit të MBZHRAU.
1.2 Modeli i procesverbalit të përmbajë dhe plotësojë të dhënat si nr. i llogarisë për derdhjen e detyrimit, adresën e institucionit.
1.3 AKU të hartojë rregulloren e re të brendshme të institucionit.

Deri më 31.12.2015

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se rekomandimi nr.1 nuk është zbatuar dhe **nuk mund të kërkohet për zbatim pasi Ligji** për ushqimin me ndryshimet e fundit, e ka hequr detyrimin e miratimit të VKM për mënyrën e administrimit të gjobave të vendosura. Lidhur me rekomandimin 1.2, rezulton se është zbatuar, pasi aktet nënligjore që parashikon Ligji i ushqimit, janë miratuar. Lidhur me rekomandimin 1.3, është zbatuar pasi rregullorja e institucionit është miratuar me Urdhërin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë.
Zbatimi: *3 r*ekomandime **janë zbatuar dhe 1 i pa zbatuar, i cili nuk mund të kërkohet për zbatim.**
Rekomandim 2: MBZHRAU dhe DPAKU të marrin masa për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti dhe tarifave të tyre, referuar Udhëzimit nr.8, datë 08.05.2007 "Për përcaktimin e tarifave të të ardhurave dytësore".

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.
Zbatimi: Rekomandimi nuk **është zbatuar për të cilin do të rikërkohet zbatimi**.

Rekomandim 3: DRAKU të marri masat për hartimin e rregullores për procedurën e asgjesimit të produkteve të sekuestruara nga inspektorët.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se ky rekomandim është zbatuar, pasi në nenin 69 të Ligjit të ushqimit, përcaktohet se mënyra e asgjesimit të produkteve të bllokuara në treg, bëhet sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit.
Zbatimi: Rekomandimi **është zbatuar**.

B. MASA ORGANIZATIVE:

Rekomandim 1: DPAKU të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos apelimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, në dy raste të pagesave të punonjësve të larguar nga puna.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

Zbatimi: Rekomandimi nuk **është zbatuar**.

Rekomandim 2: DRAKU Tiranë për gjobat e vendosura në vlerën 19,831 mijë lekë, të marri masat për hedhjen e tyre në sistemin AKU net, të bëjë kontabilizimin dhe arkëtimin e tyre.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi gjobat janë hedhur në sistem dhe janë kontabilizuar (pasqyruar në PF), por nuk janë arkëtuar, pasi janë parashkruar dhe nuk mund të rikërkohet arkëtimi i tyre.

Zbatimi: Rekomandimi **është zbatuar pjesërisht**.

Rekomandim 3: DRAKU Tiranë të marri masat për certefikimin e laboratorit.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

Zbatimi: Rekomandimi **nuk është zbatuar dhe do të rikërkohet zbatimi i tij**.

Rekomandim 4: DRAKU Tiranë të marri masat që procesverbalet e inspektimit, të plotësohen në çdo rubrikë nga inspektorët, përgjatë inspektimeve që kryejnë.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Zbatimi: Rekomandimi **është zbatuar pjesërisht**.

Rekomandim 5: DRAKU Tiranë të përgatitë dokumentacionin ligjor të pronësisë për objektin që i është vënë në dispozicion nga MBZHRAU, si dhe të bëjë kontabilizimin e saj.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

Zbatimi: Rekomandimi **nuk është zbatuar dhe do të rikërkohet zbatimi i tij**.

C. MASA DISIPLINORE

Rekomandim: Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në nenin 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", germa "b" e "ç" dhe nenin 59 "Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore" të Ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr.115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", grupi i auditimit i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore **"Vërejtje"** për:

1. Për z. T.K, me detyrë ish Drejtor i DRAKU Tiranë;
2. Për znj. R.J, ish inspektore e DRAKU Tiranë;
3. Për znj. A.D, me detyrë ish inspektor i DRAKU Tiranë;
4. Për znj. V.K, me detyrë ish përgjegjëse e sektorit juridik në DPAKU.
5. Për znj. L.K, me detyrë ish specialiste e sektorit juridik në DPAKU.

6. Për znj. G.DH, me detyrë ish specialist i sektorit juridik në DPAKU.
Komenti i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se nuk është zbatuar.
Zbatimi: Rekomandimi nuk është zbatuar dhe nuk mund të zbatohet pasi punonjësit e mësipërm nuk janë në marrëdhënie pune me DRAKU Tiranë.

2.2. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin buxhetit.

Në zbatim të pikave të programit të auditimit nr. 1153/1, date 05.01.2021 u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:
1. Organika dhe struktura e DR AKU për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020,
2. Situacionet e shpenzimeve vjetore DR AKU për periudhën e vitit 2018-2019-2020.
3. Shkresat dhe evidenca te ndryshme lidhur me buxhetin për periudhën 2018-2019-2020.
4. Evidencat e shpenzimeve dhe dokumentacioni për karburantin e mjeteve transportit të DR AKU për 2018-2019-2020.
5. Dokumentacioni për vendimet gjyqësore për largimet nga puna për 2018-2019-2020.
6. Bilanci i vitit 2018 dhe 2019.
7. Dokumentacioni hyrje-daljeve për 2018-2019-2020.
8. Dokumentacioni i bankës për 2018-2019-2020.
9. Dokumente të tjera.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, sipas pikave të programit auditimit, konstatohet që:

Struktura dhe organika.

Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë për vitin 208-2019-2020 **funksionon me një strukture** dhe organike prej **58 punonjës**, e cila është e organizuar në 3 sektorë, përkatësisht:
-Sektori i inspektimit dhe ushqimit për kafshë me origjinë shtazore,
-Sektori i inspektimit dhe ushqimit për kafshë me origjinë jo shtazore,
-Sektori i mbrojtjes bimëve dhe imputove bujqësore,

Buxheti.

Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë për vitin 208-2019-2020 **ka hartuar dhe miratuar buxhetin për vitin 2018, 2019 dhe 2020,** në zbatim të kërkesave:
- të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH",
- të UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit",
- të Ligjit nr.109/2017 datë 30/11/2017, ligjit nr. 99/2018 datë 03/12/2018 dhe ligjit nr. 88/2019 datë 18/12/2019 "Për buxhetin e vitit 2018, 2019 dhe 2020",
- të shkresave të MBZHR nr.888/1 datë 24.01.2018, nr.1371/1 date 18.02.2019 dhe nr.312 datë 15.01.2020 "Dergohet detajimi i planit buxhetit per vitin 2018, 2019 dhe 2020, shpenzime korente".

Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar nga Drejtoria Përgjithshme me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2018,2019 dhe 2020 sipas artikujve paraqitet sipas situacionit të rekorduar me thesarin, pasqyruar në tabelat nr.4-6, në Kap. "Anekset".

Për vitin 2018, 2019 dhe 2020 nuk ka tejkalim shpenzimesh sipas artikujve, pasi këto kanë qenë edhe nën kontrollin e degës thesarit Tiranë.
Nga auditimi referuar situacioneve të shpenzimeve vjetore sipas artikujve për 3 vitet, rezulton se:

-Shpenzimet për paga me shpenzimet operative janë në raport të drejtë midis tyre, pasi pesha e shpenzimeve operative është 20 % ndaj shpenzimeve për paga**,** ça tregon efiçence dhe efektivitet të shpenzimeve sipas artikujve.
-Shpenzimet për investime nuk paraqiten, pasi ato mbulohen nga Drejtoria e përgjithshme AKU.
Për vitin 2018, 2019, 2020 shpenzimet operative pasqyruar në tabelat nr.7-9, në Kap. "Anekset".

-Për vitin 2018, 2019 dhe 2020 nuk ka tejkalim shpenzimesh.
Nga auditimi i shpenzimeve operative të DRAKU Tiranë nuk rezultuan probleme, përjashtuar shpenzimet e karburantit dhe shpenzimet gjyqësore, konkretisht:
Vendime gjyqësore.
Për vitet 2018-2019-2020, DRAKU Tiranë ka likuiduar **5 vendime gjyqësore për largime nga puna** për vlerën **3,531,426 lekë**, me ndikim negativ financiar në buxhetin e shtetit, si dhe nuk ka nxjerrë përgjegjësinë dhe nuk ka marrë masa administrative ndaj personave përgjegjës, që kanë shkaktuar vlerën 890,544 lekë për vitin 2018 dhe 2,640,882 lekë për vitin 2020, dëmshpërblim me vendim Gjykate të Apelit, nën pretekstin se nuk mund të gjykojmë personat e larguar në vitin 2012 nga institucioni, në kundërshtim me pikën 62 e UMF nr.2 datë 6.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* ku thuhet se: "*...Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative....".* konkretisht:
1. Shpenzime për vendimet gjyqësore për vitin 2018, paraqiten për largime nga puna me vlerën 890,544 lekë, pasqyruar në tabelën nr.10, Kap. "Anekset".

Theksojmë se: DRAKU Tiranë nëpërmjet zyrës juridike ka apeluar vendimin e shkallës së parë. Likuidimi i vlerës 890,544 leke është kryer sipas urdhër shpenzimit nr.46 datë 13.03.2018 dhe nr.177 datë 03.10.2018, si dhe nr.215 datë 21.11.2018 *(Nënpunës autorizues **F.S dhe M.M**).*
2. Shpenzime për vendimet gjyqësore për vitin 2020, paraqiten për largime nga puna me vlerën 2,640,882 lekë, likuiduar sipas urdhër shpenzimit nr.82 datë 13.05.2020 dhe nr.186 datë 11.11.2020 *(A.N dhe M.N në rolin e Nënpunësit Autorizues dhe N.C në rolin e Nënpunësit Zbatues të DRAKU Tiranë),* pasqyruar në tabelën nr.11, Kap. "Anekset".
Nga auditimi rezulton se: *Nga Titullari i Ministrisë së Bujqësisë, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë dhe nuk janë marrë masa administrative ndaj* z.F.S dhe z.A.I, që kanë shkaktuar ndikim negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 2,640,882 lekë, si pasojë e dublimit të ***pagës*** për të njëjtin vend pune (*për inspektorin zëvendësues dhe për inspektorin e larguar, i cili e ka fituar dëmshpërblimin me vendim gjykatës Apelit),* në kundërshtim me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr.442 date 04.03.2020 dhe me pikën 62 e UMF 2 datë 6.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit buxhetit"* ku thuhet: "*...Titullarët e njësive qeverisjes përgjithshme analizojnë vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative....".*

DRAKU Tiranë, në kundërshtim UMF nr.5 datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, nuk ka ndalur dhe përllogaritur tatimin mbi të ardhurat në vlerën ***276,325 lekë*** *(1,842,171 x 15 %)* ndaj E.S, *e cila përfaqëson të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit,* sipas urdhër shpenzimit nr.82 datë 13.05.2020 dhe vendimit nr.3320 datë 20.12.2019 të Apelit, ku thuhet: *të paguhet paga nga data e ndërprerjes deri në rikthimin në detyrë.* DR AKU nëpërmjet zyrës juridike ka apeluar vendimin e shkallës parë.
3. *Nga Titullari i Ministrisë së Bujqësisë në bashkëpunim me z.M.N nuk janë nxjerrë përgjegjësitë dhe nuk janë marrë masa administrative ndaj* ndaj personave përgjegjës *(për largimet nga puna në vitin 2013),* që si pasojë e veprimeve të tyre është krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 704,402 lekë ***dëmshpërblim*** për të larguarin zj.M.F, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr. 995 date 15.06.2020 dhe me pikën 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* ku thuhet se: "*...Titullarët e njësive të qeverisjes së*

përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative....". DR AKU Tiranë nëpërmjet zyrës juridike ka apeluar vendimin e shkallës së parë.
Likuidimi i vlerës 704,402 lekë është kryer sipas urdhër shpenzimit nr.130 datë 04.08.2020 *(M.N në rolin e Nënpunësit Autorizues dhe N.C në rolin e Nënpunësit Zbatues të DRAKU Tiranë).*
Shpenzime karburanti.
-Shpenzimet për blerjen e karburantit për 3 vitet mbulohen nga Drejtoria Përgjithshme e AKU Tiranë, nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik, por nga grupi i auditimit, u auditua administrimi i dokumentacionit justifikues për përdorimin e tij nga DRAKU Tiranë, trajtuar në pikën 3 të Projekt-Raportit të Auditimit.

2.3. Auditim mbi administrimin e ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.
Për vitin 2018, 2019, 2020 mallrat dhe artikujt e blerë janë administruar nëpërmjet magazinës duke u bërë hyrje dhe dalje.
Nga auditimi u konstatuan disa mangësi dhe shkelje në veprimet me magazinën:
a. Karburanti
Blerja e karburantit është kryer nga AKU Qendër, ndërsa sipas planit dhe nevojave ai është shpërndarë në drejtoritë rajonale. Sipas të dhënave dhe akt-rakordimeve të karburantit të magazinieres P.R, rezulton se:
- në vitin 2018 institucioni ka 1 mjet Land Rover Defender me targa AA720NS, ku janë bërë hyrje 1,200 litra dhe janë bërë dalje 1,084 litra, diferenca gjendje 116 litra naftë, kaluar dhe përdorur në vitin 2019.
- në vitin 2019 institucioni ka në përdorim 7 automjete të reja dhe 1 furgon, ku janë bërë hyrje 2,660 litra naftë dhe janë berë dalje 2,630 litra, diferenca gjendje146 litra naftë, kaluar dhe përdorur në vitin 2020.
- në vitin 2020 institucioni ka në përdorim 8 automjete, ku janë bëre hyrje 4,170 litra naftë dhe janë bërë dalje 4,166 litra**,** diferenca gjendje 150 litra nafte**.**
DRAKU Tiranë ka hartuar dhe miratuar me komision normativat e konsumit të karburantit për automjetet e saj, sipas aktit teknik nr.3114/6 datë 11.03.2019.
Janë mbajtur procesverbale të shoqëruara me autorizimet e inspektimit për justifikimin e karburantit të përdorur sipas automjeteve dhe inspektorëve.
Nga auditimi i dokumentacionit të karburantit, u konstatua se:
* Në fletë-udhëtimet ose *përmbledhëses sipas muajve e datave përkatëse* pasqyrohen km e kryera në mënyrë të pasaktë, pasi shtohen km në distancat e linjave brenda qytetit Tiranë dhe jashtë saj, duke mos u mbështetur në tabelën e distancave të miratuara nga DPSHTRR, konkretisht:
- 414 km Tiranë-Tiranë për datën 02.09.2019 me makinën AA937VV K.J, ku për çdo ditë maksimumi kryhen 2 inspektime me nga gjysme dite.
-129 km Tiranë-Tiranë për datën 29.11.2019 me makinën AA872VV D.D, ku për çdo ditë maksimumi kryhen 2 inspektime me nga gjysme dite.
-141 km Tiranë-Kavajë-Tiranë, datë 05.11.2019, makina AA912VV, E.C, ku për çdo ditë maksimumi kryhen 2 inspektime me nga gjysme dite.
-133 km Tiranë-Kavajë-Tiranë, datë 19.11.2019, makina AA912VV, E.C, ku distanca Tiranë-Kavajë është 50 km (vajtje ardhje 100 km),
-102 km DRAKU-Njësia 2 dhe 5 Tiranë, datë 12.12.2019, makina AA912VV, E.C,
- 960 km Tirane-Tiranë, muaji korrik 2020, makina TR 3226L A.B,
Sa sipër, përveç specialistes së financës zj.P.R dhe përgjegjëses së sektorit të financës zj.N.C, ngarkohen me përgjegjësi edhe inspektorët K.J, E.C dhe A.B.

***** Fletëdaljet e naftës paraqiten në disa raste të parregullta, pasi nuk janë të lexueshme, kanë korrigjime dhe shtesa, mungesë nënshkrimi nga marrësi, mungesë urdhër-dalje nga titullari etj, konkretisht:
-fletë dalja nr.133 datë 28.06.2019 për 30 litra naftë nuk ka nënshkrimin e marrësit z.A.T.
-fletë dalja nr.188 datë 01.10.2019 për 297 litra naftë ka korrigjime ne sasi (*nga 197 bere 297 litra z.S.S)* dhe në vlerë.
- fletë dalja nr. 268 datë 20.12.2019 për 50 dhe 44 litra naftë ka korrigjime ne sasi (*nga 40 dhe 30 bere 50 dhe 44 litra A.H)*.
Sa sipër, evidentimi i lëvizjes, menaxhimit dhe konsumit të karburantit mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës të parregullt, të pa plotë dhe të paqartë si dhe të pambështetur në dokumente të tjera vërtetuese dhe plotësuese për harxhimin e karburantit si dhe mos argumentimi i rritjes së konsumit së karburantit është në kundërshtim me:
* ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 4, pika 26.
* UMF nr. 30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*"i ndryshuar, rubrika "*Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve*" pika 35, 40,52,53 dhe **pika 36**, ku thuhet:

dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime.

c. Pajisjet dhe sende të sekuestruara/konfiskuara.
DRAKU Tiranë pajisjet dhe sendet e sekuestruara/konfiskuara të 18 subjekteve për vitin 2018, nuk i ka administruar në magazinë, pra nuk i ka bërë hyrje e dalje, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë.
Njëkohësisht pajisjet dhe sendet e sekuestruara/konfiskuara i ka pasqyruar vetëm në copë (sasi) sipas inventarit saj dhe nuk i ka pasqyruar në vlerë, nuk bëhet fjalë për kapacitetin, volumin, vitin e prodhimit, kritere bazë këto për efekt rivlerësimit ose nxjerrjen jashtë përdorimit tyre.
Bazuar në urdhërin e Drejtorit Përgjithshëm nr.2363 datë 30.03.2018 të AKU-së, DRAKU Tiranë me procesverbal dorëzues datë 07.05.2018 këto pajisje dhe sende të sekuestruara, i ka dorëzuar pranë AKU Qendër, e cila ka prerë fletë hyrjen nr.2 datë 07.05.2018 nënshkruar nga dorëzuesi dhe marrësi.
Fletë hyrja nr.2 datë 07.05.2018 e AKU e nënshkruar nga përfaqësuesi i drejtorisë rajonale z.I.F dhe magazinieri i AKU N.S pasqyron pajisjet vetëm në sasi pa vlerë.
Gjithashtu në fletëhyrjen nr. 2 datë 07.05.2018, pasqyrohet mbishkrimi: 5 frigoriferët janë jashtë përdorimit, por që për këto pajisje nuk është ngritur një komision vlerësimi me specialistit fushës (inxhinier elektrik), me qëllim vlerësimin e tyre nëse janë në gjendje pune apo jo, si dhe në kushtet kur për frigoriferët nuk është pasqyruar vlera e tyre në momentin e administrimit në DRAKU, vlera e amortizimit të tyre, për të cilën nuk ka dokument justfikues, e bënë të pamundur vlerësimin e amortizimit vjetor të tyre dhe përcaktimin e vlerës së mbetur në momentin e dorëzimit në DPAKU.
Gjithashtu theksojmë se, në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e përcaktimit të vitit të prodhimit të frigoriferëve, vlerës së mbetur në momentin e sekuestrimit, shmang afatin e amortizimit dhe krijon hapësira për nxjerrje jashtë përdorimi të tyre para kohe dhe në gjendje pune. Për më tepër amortizimi si element i zbritshëm kostoje nuk sjell nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve, pasi mund të jenë funksionale edhe pas plotësimit të afatit të amortizimit nga riparimet e tyre, të cilat zgjatin afatin funksional.
Bazuar në urdhrin e drejtorit Përgjithshëm nr.2363 datë 30.03.2018, DRAKU Tiranë pajisjet dhe sendet e sekuestruara/konfiskuara do të kalojnë pranë rezervave shtetit, por nuk mund të kalojnë 5

frigoriferët që pretendohen se janë jashtë përdorimit, pasi ky veprim bie ndesh me pikën 4/c te UKM nr.1 datë 18.02.2015, ku thuhet:

.....Nëse duhet te nxirren përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine (skrap) apo asgjësimit përfundimtar,
Nëse, pas verifikimit, mallrat rezultojnë pa vlerë përdorimi dhe konkludohet për asgjësimin përfundimtar tyre, ato nuk merren në dorëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale Shtetit,

Sqarojmë se pranë Rezervave të Shtetit dorëzohen materiale, artikuj dhe mjete të emergjencës, ndihma nga donator, materiale të sekuestruara, konfiskuara për shkak kundravajtjeve administrative ose penale etj, të cilat janë në gjendje funksionale, dhe jo jashtë funksionit.
Përfundimisht, pajisjet dhe sendet e sekuestruara/konfiskuara të subjekteve qëndrojnë në magazinën e DPAKU (zyrat Tufinë) prej 3 vitesh, duke mos i kaluar pranë rezervave shtetërore për ankand ose për nxjerrje jashtë përdorimit në rast se janë, fakt për këtë është se në praktikën e mësipërme nuk administrohet fletëdalja për në rezervat e shtetit, procesverbali i asgjesimit të pajisjeve dhe sendeve sekuestruara/konfiskuara, fletëhyrja dhe fletëdalja për skrapin dhe pjesët e këmbimit, etj.
Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin*" dhe ngarkon me përgjegjësi dorëzuesin e materialeve të sekuestruara, i cili ka firmosur fletë-hyrjen e lëshuar nga magazinieri i DPAKU, inspektorët e DRAKU Tiranë, të cilët në procesverbalet e bllokimit, nuk kanë pasqyruar plotësisht të dhënat identifikuese të materialeve të sekuestruara, magazinierin e DRAKU Tiranë dhe përgjegjësin e sektorit të financës pranë DRAKU Tiranë, të cilët nuk kanë marrë në administrim dhe më tej për të bërë kontabilizimin e sendeve të sekuestruara/konfiskuara, ish Kryeinspektorin e DRAKU Tiranë z.F.S (në rolin e Nënpunësit autorizues të DRAKU Tiranë) dhe Drejtorin e Përgjithshëm të DPAKU për periudhën në të cilën është bërë dorëzimi i sendeve të sekuestruara z.A.I (në rolin e Nënpunësit autorizues të DRAKU Tiranë), që nuk ka marrë masat e nevojshme për dorëzimin e tyre pranë rezervave shtetërore.

Po kështu, është vepruar edhe me inspektimin e datës 23.10.2019 Kavajë (subjekti S.V), ku në procesverbalin e inspektimit pasqyrohet informacioni se janë sekuestruar cengela dhe mjete prerëse, si dhe 23 kg mish viçi, të cilat janë dorëzuar në ambjentet e DRAKU Tiranë me automjetin e institucionit me targa AA691XI. Nga auditimi i kësaj praktike, konstatohet se nuk pasqyrohet informacioni për numrin e çengelave dhe mjetet prerëse të bllokuara. Gjithashtu nuk administrohet fletë-hyrja e sendeve dhe e mishit të sekuestruar, pranë magazinës së DRAKU Tiranë, veprime në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit publik"* dhe me ligjin nr.25/2018 *"Për kontabilitetin*" dhe bën përgjegjës inspektorët Z.C, E.C, dhe ish Kryeinspektorin z.A.N (në rolin e Nënpunësit autorizues të DRAKU Tiranë).
Për problemet lidhur me administrimin e sendeve dhe produkteve ushqimore në magazinën e DRAKU Tiranë, ngarkohet me përgjegjësi magazinierja zj.P.R, si dhe zj.M.M dhe z.A.N.

Bilanci 2019.

Bilanci për vitin 2018 dhe 2019 është mbyllur brenda afatit ligjor, ndërsa bilanci i vitit 2020 është në proces mbyllje dhe brenda afatit ligjor. Bilanci për vitin 2019 është dërguar në thesar sipas shkresës nr.438, date 03.03.2020. Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin, pasqyrën e shpenzimeve, të ardhurave si dhe pasqyrat tjera shoqëruese hartuar nga sektori i shërbimeve mbështetëse dhe miratuar nga titullarët e DRAKU Tiranë, respektivisht sipas periudhave.
Nga auditimi i bilancit 2019 u konstatua se:

1. Nga DRAKU Tiranë nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2019, Godina-3-katëshe, në të cilën janë zyrat e institucionit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin*", me ligjin ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", *por është mjaftuar duke pasqyruar vlerën e rikonstruksionit prej 2,7 milion lekë.*
Godina-3-katëshe e DRAKU Tiranë është ndërtuar në vitin 2015 nga projektet e BE për vlerën 520,000 euro *(sipas një dokumenti ne gjuhe huaj)*, por nuk disponohet situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi, dokumentet bazë për regjistrimin e saj në zyrat e Kadastrës.
Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi Kryeinspektorët e DRAKU Tiranë, sipas periudhave përkatëse, z.F.S, zj.M.M, z.A.N, z.M.N (në rolin e Nënpunësit autorizues të DRAKU Tiranë) dhe zj.N.C, përgjegjëse e sektorit të financës (në rolin e Nënpunësit zbatues të DRAKU Tiranë).

Inventarizimi i pasurisë
Në bazë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit, në fund të çdo viti.
Për vitet 2018, 2019 dhe 2020 titullarët e institucionit DRAKU Tiranë (M.M, A.N dhe M.N) kanë ngritur komisionin e inventarizimit fizik, dhe nga shqyrtimi i praktikave përkatëse, rezulton se është hartuar dhe miratuar raporti i inventarizimit, informacioni për titullarin, si dhe nga procesi i inventarizimit, nuk kanë rezultuar diferenca (-/+) me fletë-hyrjet dhe fletë-daljet e materialeve si dhe gjendjen në magazinën e institucionit.

Banka 2018, 2019 dhe 2020 si dhe shpenzime me procedurë prokurimi me vlerë të vogël.
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të bankës në DR AKU Tiranë për vitin 2018, 2019 dhe 2020 u konstatuan disa **mangësi dhe shkelje**, konkretisht:

Shpenzime gjyqësore.
Për vitin 2019 DRAKU Tiranë ka likuiduar 3 gjoba (të arkëtuara më parë nga subjektet) për vlerën 840,300 lekë me vendim gjykate formës prerë, pasi janë shfuqizuar, përkatësisht:
1. sipas urdhër shpenzimit nr.126, datë 09.08.2019 DR AKU Tiranë ka likuiduar subjektin A F.S shpk për vlerën 377,400 lekë, në zbatim të vendimit gjykatës administrative të shkalles parë i formës prerë nr.1162 datë 08.04.2019 (gjobë),
2. sipas urdhër shpenzimit nr.108, datë 03.07.2019 DR AKU Tiranë ka likuiduar subjektin A.M për vlerën 303,300 lekë gjobe e arkëtuar me pare nga subjekti.
3. sipas urdhër shpenzimit nr.146, datë 12.09.2019 DR AKU Tiranë ka likuiduar subjektin A.M për vlerën 159,600 lekë gjobe, në zbatim të vendimit gjykatës administrative të shkalles parë i formës prerë nr.1542 datë 02.05.2019 (gjobë).
4. sipas urdhër shpenzimeve nr.29,30,31,32, 33, 34 datë 70.02.2020 dhe nr.76 datë 13.05.2020 DR AKU Tiranë ka likuiduar DRSHTRR Tiranë vlerën 7,000 lekë gjoba për tejkalim afati për

kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve, në vend të personave përgjegjës që drejtojnë dhe përdorin automjetet, dhe për këtë mbajnë përgjegjësi z.A.N ish Kreyinspektor i DRAKU Tiranë në periudhën kur janë kryer pagesat si dhe zj.N.C, përgjegjëse e sektorit të financës.

5. sipas urdhër shpenzimit nr.117 datë 24.07.2019 DRAKU Tiranë ka likuiduar me procedurë prokurimi me vlera vogla subjektin R.C shpk vlerën 72,000 lekë, shpenzime transporti për 4 rrugë, për materiale reagentëve 510 kg, 1 raft, ambalazhe, bombola gazi, perde, abazhurë e tjera, në linjën Siri Kodra deri tek DRAKU Tiranë, rruga Hamdi Pepa, rezulton se:

a. thuhet se materialet u transportuan me 4 rrugë, por nuk citohet lloji i automjetit dhe targa e tij në asnjë dokument të kësaj praktike.

Fatura e subjektit nr. 60597242, date 03.07.2019 është e parregullt, pasi: nuk ka të plotë përshkrimin e mallit, nuk është pasqyruar sasia dhe çmimi pa TVSH, mungon nënshkrimi i transportuesit dhe linja e përshkruar, mungon pasqyrimi i lloji të automjetit dhe targa e tij, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36, ku thuhet:

> dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime.

a. nuk ka arsyetim ligjor pagesa 72,000 lekë dhe kryerja e shërbimit të transportit në mënyrë të ndarë (4 rrugë dhe jo vetëm 1, me qëllim uljen e kostos së shërbimit të transportit dhe respektuar parimin e ekonomicitetit) me nga 18,000 leke/rruga, pasi nuk e justifikon ngarkesa prej 510 kg e cila është e mangët edhe për një rrugë si dhe nuk justifikohet me këtë distance te shkurtër të rrugës nga rruga *Siri Kodra* deri tek rruga *Hamdi Pepa*.

b. shpenzimi për qiramarrje mjeti transporti prej 72,000 lekë ka qene jo efektiv, jo i argumentuar dhe i pa nevojshëm, pasi DRAKU Tiranë disponon 10 automjetet e saj, çka do të thotë se janë shpenzuar 72,000 lekë, ndërkohë që ky shpenzim mund të ishte shmangur nga DRAKU Tiranë, duke e kryer transportin me mjetet e veta.

c. dokumentacioni i kësaj praktike pagese paraqet mangësi, pasi procesverbali datë 03.07.2019 i komisionit (krijuar sipas urdhrit drejtorit S.S date 03.07.2019) F.V, H.H dhe F.G nuk përcakton llojin dhe targën e automjetit si dhe km e përshkuara.

Përfundimisht, nuk ka pasur konkurrencë ky shpenzim transporti dhe nuk është realizuar qëllimi i prokurimit, sepse ka fituar subjekti me vlerën e barabartë me fondin limit, madje dhe i paargumentuar ky fond limit. Veprime në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik", me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 "Për gjurmët standarde auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte".

6. sipas urdhër shpenzimit nr.39 datë 10.02.2020, ku DRAKU Tiranë ka likuiduar me procedurë prokurimi me vlera vogla subjektin I SHA për vlerën 291,620 lekë, shpenzime siguracioni për 7 automjetet e saj TPL dhe Kasko. Kështu konkurrimi ka qene formal me diferenca të papërfillshme midis Operatorit Ekonomik fitues me 8 mijë lekë diferencë nga fondi limit (300,000 lekë), madje janë pranuar oferta barazi dhe mbi fondin limit, konkretisht: "S" 300,600 lekë, "A" 300,000 lekë, "I" 299,400 lekë dhe fituesi "I SHA" 291,620 lekë (TPL 17,697-19,000 lekë dhe Kasko 23,800-27,300 leke). Ngarkohen me përgjegjësi komisioni blerjeve vogla D.D, D.K dhe E.V, krijuar sipas urdhrit drejtorit nr.333/1 date 09.06.2020. Theksojmë se siguracioni TPL dhe Kasko për automjetin AA691XI është kryer më vonë sipas urdhër shpenzimit nr.103 datë 25.06.2020 për vlerën 74,600 lekë (TPL=28,600 dhe Kasko 46,000). Gjithashtu 8 automjetet janë prodhim i vitit 2019.

Këto veprime bien në kundërshtim me udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.3.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik", me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 "Për gjurmët standarde te auditit për prokurimet me vlere vogël dhe larte".

2.4. Auditim mbi funksionin e inspektimit të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore.

Në mënyrë të përmbledhur mbi nivelin e arkëtimit të gjobave të vendosura brenda vitit ushtrimor në nivel institutucioni, si më poshtë vijon:

-Për vitin 2018 janë vendosur **380 gjoba** në vlerën **91,100,000 lekë**, nga të cilat janë shfuqizuar 800,000 lekë, pra detyrimi është **90,300,000 lekë** si dhe nga këto janë arkëtuar vetëm **51 gjoba** në vlerën **6,934,000 lekë**, ose rreth 8% të totalit.

-Për vitin 2019 janë vendosur **193 gjoba** në vlerën **131,920,000 lekë**, nga të cilat është shfuqizuar 1 gjobë në vlerën 1,000,000 lekë, pra detyrimi është **130,920,000 lekë** si dhe nga këto janë arkëtuar vetëm **12 gjoba** në vlerën **1,840,000 lekë**, ose 1.3%.

-Për vitin 2020 janë vendosur **76 gjoba** në vlerën 13,280,000 **lekë, nga të cilat janë shfuqizuar 1,700,000 lekë**, pra detyrimi është **11,580,000 lekë** si dhe nga këto janë arkëtuar vetëm **12 gjoba** në vlerën **1,170,000 lekë**, ose 10% e totalit të arkëtueshëm.

-Pra sa më sipër, rezulton se niveli i arkëtimit të gjobave të vendosura brenda vitit ushtrimor, është shumë i ulët, çka tregon për mungesë efektiviteti të DRAKU Tiranë si dhe të DPAKU, në marrjen e masave për ekzekutimin e gjobave të vendosura.

Aktiviteti i inspektimit në formë tabelare është pasqyruar në tabelën nr.12, Kap. "Anekset".

Respektimi i përcaktimeve ligjore mbi planifikimin e inspektimeve

-DRAKU Tiranë e kryen aktivitetin e saj të inspektimit në Qarkun Tiranë, në bazë të planit vjetor të inspektimeve dhe inspektimeve jashtë planit.

-Planifikimi i inspektimeve bëhet në bazë të metodologjisë së miratuar në DPAKU, e cila nuk administrohet në DRAKU Tiranë.

-Sipas kësaj metodike, subjektet që inspektohen nga DRAKU Tiranë ndahen në subjekte me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët. DRAKU në kryerjen e aktivitetit të saj inspektues, zbaton Skenarin C të metodologjisë për përllogaritjen e numrit të inspektimeve, që do të thotë se një subjekt me risk të lartë inspektohet 4 herë në vit, një subjekt me risk të mesëm 1-2 herë në vit dhe një subjekt me risk të ulët 0-1 herë në vit.

-Për vitin 2018 plani i inspektimeve është miratuar me Udhëzimin nr.4, datë 20.04.2018 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë, për vitin 2019 me Udhëzimin nr.2, datë 26.02.2019 dhe për vitin 2020 me Udhëzimin nr.2, datë 24.02.2020.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2018 janë planifikuar për tu inspektuar nga sektori i inspektimit të produkteve me origjinë shtazore 1891 subjekte dhe në total 3367 inspektime, nga të cilat 321 subjekte me risk të lartë ku është planifikuar të kryhen 1287, 1541 subjekte me risk të mesëm ku është planifikuar të kryhen 3327 inspektime dhe 23 subjekte me risk të ulët ku janë planifikuar për tu kryer 23 inspektime.

-Risku i subjektit përcaktohet në bazë të llojit të aktivitetit që ai kryhen, pra subjektet që prodhojnë, përpunojnë, paketojnë produkte me origjinë shtazore klasifikohen me risk të lartë, subjekte që përpunojnë yndyra, kolagjen, xhelatin, subjekte të shitjes më shumicë/pakicë (bulmet dhe mish) etj, klasifikohen me risk të mesëm. Pra vetëm ky indikator përdoret nga AKU në klasifikimin e riskut të subjektit, dhe jo edhe historiku i tij, pra një subjekt që nuk është konstatuar në shkelje në vitet e fundit, nuk ka përse të kategorizohet në vitin pasardhës me risk të lartë.

-Pra nëse mbledhim numrin e inspektimeve të planifikuara për tu kryer sipas subjekteve, rezulton se nga DRAKU Tiranë për vitin 2018 do të kryhen 4891 inspektime gjithsej dhe jo 3367 inspektime. Kjo vlerë rezulton për arsye se subjekte të caktuara me risk të lartë dhe të mesëm

planifikohen për tu inspektuar më tepër ose më pak se frekuenca vjetore, pasqyruar në tabelën nr.13, Kap. "Anekset".
-Në total DRAKU Tiranë për vitin 2018 ka kryer 1741 inspektime + 20 inspektime për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna = 1761 inspektime
-Sqarojmë se nga numri total i inspektimeve të kryera përgjatë vitit 2018, kemi hequr indiciet, ankesat, urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm, asgjesimet, kërkesat e subjektit për zhbllokim aktiviteti/produkti.
-Sipas tabelës nr.14, pasqyruar në Kap. "Anekset", rezulton se inspektimet e planifikuara realizohen mesatarisht 51%.
-Sipas tabelës nr.15, pasqyruar në Kap. "Anekset", rezulton se kampionimet e kryera realizohen mesatarisht 51%
-Inspektimet jashtë planit vjetor të miratuar janë realizuar 1091 gjithsej, ose 32 %, pra brenda parashikimit të bërë në programin vjetor të aktivitetit.

<u>Për vitin 2019</u>
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2019 janë planifikuar për tu inspektuar 1820 subjekte ose 71 subjekte më pak se në vitin 2018, dhe në total 3249 inspektime, nga të cilat 310 subjekte me risk të lartë ku është planifikuar të kryhen 1245 inspektime, 1466 subjekte me risk të mesëm ku është planifikuar të kryhen 3180 inspektime dhe 44 subjekte me risk të ulët ku janë planifikuar për tu kryer 53 inspektime.
-Pra nëse do të mbledhim vlerat e mësipërme rezulton se DRAK Tiranë për vitin 2019 duhet të kryejë 4478 inspektime dhe jo 3249 inspektime. Kjo vlerë rezulton për arsye se subjekte të caktuara me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët planifikohen për tu inspektuar më tepër ose më pak se frekuenca vjetore, pasqyruar në tabelën nr.16, në Kap. "Anekset".
-Në total DRAKU Tiranë për vitin 2019 ka kryer 2016 inspektime + 60 inspektime për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna = 2076 inspektime
Sqarojmë se nga numri total i inspektimeve të kryera përgjatë vitit 2019, kemi hequr indiciet, ankesat, urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm, asgjesimet, kërkesat e subjektit për zhbllokim aktiviteti/produkti.
-Sipas tabelës nr.17, pasqyruar në Kap. "Anekset", rezulton se inspektimet e planifikuara e planifikuara realizohen mesatarisht 65%.
-Sipas tabelës nr.18, pasqyruar në Kap. "Anekset", rezulton se kampionimet e kryera realizohen mesatarisht 53%
-Inspektimet jashtë planit vjetor të miratuar janë realizuar 1479 gjithsej, ose 46%, pra 10% mbi përcaktimin e bërë në programin vjetor të aktivitetit.

<u>Për vitin 2020</u>
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2020 janë planifikuar për tu kryer 2343 inspektime.
-Sipas tabelës nr.19, pasqyruar në Kap. "Anekset", rezulton se inspektimet e planifikuara realizohen mesatarisht 73%.
-Inspektimet jashtë planit vjetor të miratuar janë realizuar 1287 gjithsej, ose 43%, pra 7% mbi përcaktimin e bërë në programin vjetor të aktivitetit.

Gjithashtu në nivel institucional konstatohet se:
-Plani vjetor nuk është hartuar sipas standardeve të kërkuara nga Inspektorati Qendror me tematikë inspektimi dhe parashikimin e numrit të përgjithshëm të inspektimeve që do të kryhen;
-Programet mujore nuk hartohen dhe miratohen si dhe të dërgohen për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.696, datë 16.08.2013 dhe Urdhrit nr.6, datë 19.02.2015;

-Nga DPAKU nuk është respektuar përcaktimi ligjor në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ku është detyrim kur në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, të miratohet metodika për përcaktimin e vlerës së gjobës.
-Inspektimet on-line nuk kanë filluar në përputhje me afatin e vendosur në Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Drejtorët e Përgjithshëm të AKU-së, z.A.I, z.A.H, z.R.L, z.B.S si dhe ish Kryeinspektorët e DRAKU Tiranë z.F.S (Kryeinspektor i DRAKU Tiranë Janar – Maj 2018, për periudhën që është audituar nga KLSH) për planifikim të inspektimeve jo sipas frekuencës dhe nivelit të riskut të disa subjekteve në vitin 2018, për mos realizim të planit të inspektimeve për 4 muajt e parë të vitit 2018;
zj.M.M (Kryeinspektor i DRAKU Tiranë Maj 2018 – Maj 2019, për periudhën që është audituar nga KLSH), për mosrealizim të inspektimeve të planifikuara në vitin 2018 (Maj-Dhjetor 2018) dhe inspektimeve të planifikuara (Janar – Maj 2019), për planifikim të inspektimeve jo sipas frekuencës dhe nivelit të riskut të disa subjekteve në vitin 2019;
z.S.S, Kryeinspektor i DRAKU Tiranë (Maj 2019 – Tetor 2019, për periudhën që është audituar nga KLSH) për planifikim të inspektimeve jo sipas frekuencës dhe nivelit të riskut të disa subjekteve në vitin 2020, si dhe për mosrealizim të inspektimeve të planifikuara për muajt Maj – Tetor 2019;
z.A.N, Kryeinspektor i DRAKU Tiranë (Tetor 2019 – Maj 2020, për periudhën që është audituar nga KLSH) për mosrealizim të inspektimeve të planifikuara në muajt Tetor – Dhjetor 2019 dhe muajt Janar, Shkurt 2020[6];
z.M.N, Kryeinspektor i DRAKU Tiranë (Korrik – Dhjetor 2020, për periudhën që është audituar nga KLSH), për mosrealizim të inspektimeve të planifikuara në muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020[7].

Respektimi i përcaktimeve ligjore në kryerjen e inspektimeve në terren, sekuestrimin dhe administrimin, si dhe njoftimin, ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura:

1. Inspektimi i kryer pranë subjektit A, me vendndodhje Tiranë, Rruga Fortuzi, në datën 15.01.2018, nga inspektorët S.L dhe G.H.
-Procesverbali i inspektimit me nr.43673, datë 15.01.2018, ku pasqyrohet se subjekti ka një të punësuar pa librezë shëndetësore, disponon planin DDD por i kaluar afati kohor, si dhe disa produkte janë pa etiketim në gjuhën shqipe. Gjithashtu subjekti nuk ka respektuar detyrat e lëna nga inspektimi i kryer në datën 20.12.2017. Ndaj subjektit janë vendosur dy gjoba, me nga 50 mijë lekë secila, një për mosrespektimin e kërkesave të etiketimit dhe tjetra për mos korrigjimin e detyrave të lëna në inspektimin e mëparshëm.
Në këtë praktikë inspektimi konstatohet se:
-Inspektorët nuk kanë pasqyruar me vërtetësi dhe plotësi respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit. Kjo për arsye se:

---

[6]Për muajin Mars e në vazhdim marrim në konsideratë faktin e karantimit të vendit, si dhe Urdhërave/Udhëzimeve të ndryshme Urdhrit nr.128, datë 11.03.2020 i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për përcaktimin e ditëve të pushimit dhe masave të tjera mbrojtëse në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga COVID-19"; Urdhrit nr.1345, datë 12.03.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së "Për miratimin e masave në lidhje me zhvillimin e procesit të inspektimit, në kuadër të parandalimit të përhapjes së Virusit COVID-19" Udhëzimit nr.6, datë 17.03.2020 të Ministrit të Bujqësisë; Urdhrit të Prefektit të Qarkut Tiranë, për ngritjen e grupeve të përbashkëta të monitorimit (AKU, Policia, Drejtoria e Tatimeve, Inspektorati i Shëndetësisë) të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19; Urdhrit nr.28, datë 21.10.2020 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadërt të Task-Forcës anti COVID-19".
[7] Këtu marrim në konsideratë që stafi i DRAKU Tiranë (30 inspektor) kanë qenë të angazhuar me grupet e përbashkëta të monitorimit të të zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Urdhrit të Prefektit të Qarkut Tiranë, për ngritjen e grupeve të përbashkëta të monitorimit (AKU, Policia, Drejtoria e Tatimeve, Inspektorati i Shëndetësisë) të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19; Urdhrit nr.28, datë 21.10.2020 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadërt të Task-Forcës anti COVID-19".

-Në datën që është kryer inspektimi, subjekti A me vendndodhje Tiranë, Rruga Fortuzi, nuk ka qenë i pajisur me licencën përkatëse, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore;
-Ky konstatim është nxjerrë pas verifikimit të kryer nga grupi i auditimit, në regjistrin e lejeve/licencave në faqen zyrtare të QKB-së, të licencave që disponon subjekti A, dhe ka rezultuar se ky subjekt për tu pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendndodhje, pra në Rrugën Fortuzi, ka aplikuar me kërkesën me numër LC-6274-01-2018, datë 17.01.2018 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
-Kjo kërkesë është miratuar nga DRAKU Tiranë, pas inspektimit të kryer pranë ambjekteve të këtij subjekti më datë 30.01.2018 (pra 15 ditë më pas, nga inspektimi i datës 15.01.2018), nga inspektorët Y dhe V, ku me procesverbalin e inspektimit nr.0040928, datë 30.01.2018, është pasqyruar se subjekti plotëson kushtet për t'u licencuar, konfirmuar edhe nga DRAKU Tiranë nëpërmjet shkresës nr.295/1 prot., datë 01.02.2018, dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, e cila nëpërmjet shkresës nr.538/2 prot., datë 07.02.2018, dërguar Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka konfirmuar kërkesën e bërë nga subjekti A, për pajisjen me licencë, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore.
-Pas këtyre veprimeve ndaj subjektit është miratuar licenca me nr. LN-4484-02-2018, datë 07.02.2018.
-Pra sa më sipër, subjekti A, me vendndodhje Tiranë, Rruga Fortuzi është pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit më datë 07.02.2018, dhe në datën 15.01.2018, ky subjekt ka ushtruar aktivitet pa licencë, fakt që nuk është pasqyuar nga inspektorët.

2. Inspektimi tjetër i kryer pranë subjektit B, me vendndodhje Tiranë, Rruga Tom Plezha, në datën 15.01.2018, nga inspektorët Z.C dhe A.N.
-Procesverbali i inspektimit me nr. 43525, datë 15.01.2018, ku pasqyrohet se subjekti duhet të mbajë të sistemuar ambjentin e magazinës, të pajiset me frigorifer të vogël për produktet e skaduara dhe të dëmtuara, kryesisht atyre shtazore, të pajiset me rregjister për monitorimin e temperaturave të ambjentit, të rinovoje një pjesë të flet analizave të produkteve kryesisht atyre me origjinë shtazore. Ndaj subjektit është vendosur vetëm masa paralajmërim dhe korrigjimi i shkeljeve deri më datë 25.01.2018
Në këtë praktikë inspektimi konstatohet se:
-Inspektorët nuk kanë pasqyruar me vërtetësi dhe plotësi respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit. Kjo për arsye se:
-Në datën që është kryer inspektimi, subjekti B me vendndodhje Tiranë, Rruga Tom Plezha, nuk ka qenë i pajisur me licencën përkatëse, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore;
-Ky konstatim është nxjerrë pas verifikimit të kryer nga grupi i auditimit, në regjistrin e lejeve/licencave në faqen zyrtare të QKB-së, të licencave që disponon subjekti B, dhe ka rezultuar se ky subjekt për tu pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendndodhje, pra në Rrugën Tom Plezha, Yzberisht, ka aplikuar me kërkesën me numër LC-6275-01-2018, datë 17.01.2018, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
-Kjo kërkesë është miratuar nga DRAKU Tiranë, pas inspektimit të kryer pranë ambjekteve të këtij subjekti më datë 31.01.2018 (pra 16 ditë më pas, nga inspektimi i datës 15.01.2018), nga inspektorët E.C dhe V.S, ku me procesverbalin e inspektimit nr.43644, datë 31.01.2018, është pasqyruar se subjekti plotëson kushtet për tu licencuar, konfirmuar edhe nga DRAKU Tiranë nëpërmjet shkresës nr.234/1 prot., datë 02.02.2018, dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, e cila nëpërmjet shkresës nr.697/2 prot., datë 08.02.2018, dërguar Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka konfirmuar kërkesën e bërë nga subjekti B, për pajisjen me licencë, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore, në rrugën Tom Plezha.
-Pas këtyre veprimeve ndaj subjektit është miratuar licenca me nr. LN-4493-02-2018, datë

08.02.2018.
-Pra sa më sipër, subjekti B, me vendndodhje Tiranë, Rruga Tom Plezha, është pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit më datë 08.02.2018, dhe në datën 15.01.2018, ky subjekt ka ushtruar aktivitet pa licencë, dhe nga inspektorët ky fakt nuk është pasqyruar.

3. Inspektimi tjetër i kryer pranë subjektit B, me vendndodhje Tiranë, Rruga Him Koli, në datën 16.01.2018, nga inspektorët Y.A dhe V.Zh.
Procesverbali i inspektimit me nr. 0040920, datë 16.01.2018, ku pasqyrohet se subjekti duhet të lyejë muret në ambjentin ku tregtohen produktet shtazore, si dhe të pajisi punonjësit me garderobë. Ndaj subjektit u vendos vetëm masa paralajmërim dhe korrigjimi i shkeljeve brenda afatit 10-ditor.
Në këtë praktikë inspektimi konstatohet se:
-Inspektorët **nuk kanë pasqyruar me vërtetësi dhe plotësi** respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit. Kjo për arsye se:
-**Në datën që është kryer inspektimi**, subjekti B me vendndodhje Tiranë, Rruga Him Koli, **nuk ka qenë i pajisur me licencën përkatëse**, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore;
-Ky konstatim është nxjerrë **pas verifikimit të kryer nga grupi i auditimit**, në regjistrin e **lejeve/licencave në faqen zyrtare të QKB-së**, të licencave që disponon subjekti B, dhe ka rezultuar se ky subjekt për tu pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendndodhje, pra në Rrugën Him Koli, **ka aplikuar me kërkesën me numër LC-6277-01-2018, datë 17.01.2018,** pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
-Kjo kërkesë është miratuar nga DRAKU Tiranë, pas inspektimit të kryer pranë ambjekteve të këtij subjekti më datë 29.01.2018 (pra 13 ditë më pas, nga inspektimi i datës 16.01.2018), nga inspektorët E.C dhe V.S, ku me procesverbalin e inspektimit nr.43639, datë 29.01.2018, është pasqyruar se subjekti plotëson kushtet për tu licencuar, konfirmuar edhe nga DRAKU Tiranë nëpërmjet shkresës nr.171/1 prot., datë 31.01.2018, dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, e cila nëpërmjet shkresës nr.540/2 prot., datë 07.02.2018, dërguar Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka konfirmuar kërkesën e bërë nga subjekti B, për pajisjen me licencë, për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të ushqimeve me origjinë shtazore, në rrugën Him Koli.
-Pas këtyre veprimeve ndaj subjektit është miratuar licenca me nr. LN-4482-02-2018, datë 07.02.2018.
-Pra sa më sipër, subjekti B, me vendndodhje Tiranë, Rruga Him Koli, është pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit më datë 07.02.2018, dhe në datën 16.01.2018, ky subjekt ka ushtruar aktivitet pa licencë, fakt që nuk është pasqyruar nga inspektorët, dhe për këtë arsye ndaj këtij subjekti në 3 rastet e mësipërme, në mbështetje të nenit 68, pika1, shkronja "e" të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, duhet të aplikohej masë administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë – 2,000,000 lekë, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 1, shkronja "dh" të Ligjit nr.87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre", duhej të bëhej ndalimi i ushtrimit të aktivitetit, masa të cilat nga ana e inspektorëve nuk janë ndërmarrë.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi zj.*S.L dhe* z.*G.H,* z.*Z.C dhe* z.*A.N,* zj.*Y.A dhe* zj.*V.Zh.*

4.Autorizimi për inspektim nr.115, datë 27.01.2018, **në subjektin Supermarket Ushqimor, C**, me grup inspektimi:E.M, A.N, Z.C, V.Ll.
Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0040607, datë 27.01.2018. Nga grupi i inspektimit është vendosur gjobë 150 mijë lekë për shkelje të kërkesave ligjore, mbi etiketimin dhe gjurmueshmërinë e produktit.

Në këtë praktikë konstatohet se:
-Nuk është përcaktuar afati nga grupi i inspektimit, për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara;
-Nuk dokumentohen kontrollet e kryera nga grupi i inspektimit (për planimetrin, kushtet e ruajtjes së produkteve, temperaturën e frigoriferit, temperaturën e ruajtjes së ushqimit, etj);
-Në proceverbalin përkatës, nuk jepet informacion për subjektin e inspektimit, për afatin e ankimit, institucionin ku do të drejtohet për ankim;
-Nga subjekti privat është bërë ankim me shkresën nr.897, datë 05.02.2018, pranë Drejtorisë së Përgjithshme, e cila nuk është shqyrtuar nga komisioni i posaçëm në DPAKU;
-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, nga subjekti nuk është kryer pagesa e gjobës, si dhe nga DRAKU Tiranë nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen dhe arkëtimin e saj, duke sjellë edhe parashkrimin e kësaj gjobe në muajin Mars 2020;
-***Si pasojë e këtyre mosveprimeve janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt dëm ekonomik në vlerën 150 mijë lekë në total.***
Për sa më sipër, për mangësitë në procedurën e inspektimit, mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi z.E.M, z.A.N, z.Z.C, zj.V.Ll, si dhe për procedurën e ekzekutimit të gjobës, duke sjellë edhe parashkrimin e saj në muajin Shkurt 2020, z.A.I, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.A.H ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.R.L ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.F.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Janar-Maj 2018, znj.M.C, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019, z.A.N ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020, si dhe zj.H.P Juristi i DRAKU Tiranë.

5. Ky subjekt është inspektuar **për herë të dytë**, brenda vitit 2018, me autorizimin nr.AKU-TR-2018-004712-1, datë 06.12.2018, me grupin e inspektimit: G.H, A.N dhe L.B.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-004712-1, datë 06.12.2018, është konstatuar se nuk është rinovuar plani D.D.D, nuk kryhet në mënyrë sistematike rregjistrimi i temperaturave frigoriferike, nuk janë të sistemuar produktet sipas natyrës.
-Procesbali i inspektimit me nr. AKU-TR-2018-004712-2, datë 06.12.2018, ku pasqyrohen gjetjet e mësipërme, si dhe masa administrative paralajmërim.
-Vendimi përfundimtar me nr.AKU-TR-2018-004712-5, datë 06.12.2018, jepet masa administrative paralajmërim, si dhe korrigjimi i shkeljeve të konstatuara.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Nuk është përcaktuar afati nga grupi i inspektimit, për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, veprim i cili është përsëritur për herë të dytë;
-Nuk pasqyrohet asnjë informacion, **nëse subjekti i ka korrigjuar shkeljet** e konstatuara në inspektimin e mëparshëm, të kryer me autorizimin nr.115, datë 27.01.2018, për dokumentimin e etiketimit të produkteve, për kërkesat për gjurmueshmërinë;
-Nuk dokumentohen kontrollet e kryera nga grupi i inspektimit për kryesisht për PMH, librezat shëndetësore të cilat ishin të parinovuara, konstatuar në inspektimin e parë, analizat laboratorike të ujit, të cilat duhet të rinovoheshin nga subjekti;
-Ndodhur në këto kushte, kur subjektit i gjenden shkelje për herë të dytë, të cilat janë pasqyruar vetë nga inspektorët, për më tepër brenda vitit, nga grupi i inspektimit **duhet të ishte vendosur gjobë** për mos regjistrim të temperaturës frigoriferike, në mbështetje të pikës 1 të nenit 68 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, e cila është pjesë kushteve higjenike përcaktuar në Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010, si dhe korrigjimi i shkeljeve brenda një afati konkret.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi z.G.H, z.A.N dhe z.L.B.

6.Autorizimi për inspektim nr.112, datë 26.01.2018, **në subjektin M.D**, me grup inspektimi:A.N, Z.C, M.K, me qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi, marrje mostra.

-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0043542, datë 26.01.2018. Në vendimin e inspektimit pasqyrohet marrja e mostrave: tremiks derri në masën 5*250 gr; kofshë derri me kockë në masën 5*250 gr dhe shpatull derri pa kockë në masën 5*250 gr. Sasia prej 25.489 kg kofshë derri me kockë, 400 kg shpatull derri pa kockë dhe 360 kg tremiks derri do të qendrojë e bllokuar, deri sa të dali rezultati i analizave. Gjithashtu është lënë afati **29.01.2018, për korrigjimin e shkeljeve** dhe që subjekti të paraqesë dokumentacionin përkatës për sistemin e gjurmueshmërisë, sistemin HACPP dhe planin D.D.D.

Në këtë praktikë konstatohet se:

-Nuk administrohet dokumentacion mbështetës (foto) për bllokimin e produkteve të ushqimit të mësipërme;

-Nuk administrohet procesverbali i bllokimit të produkteve;

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi z.*A.N*, z.*Z.C, dhe* zj.*M.K.*

7.Në vijim të inspektimit të mësipërm, pranë këtij subjekti është kryer **inspektim tjetër,** me autorizim inspektimi nr.120/10, datë 29.01.2018, me grup inspektimi: A.N, Z.C, M.K, për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, **nga i njëjti grup.**

-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0043542, datë 29.01.2018, pasqyrohet se subjekti ka përgatitur dokumentacionin HACCP, planin D.D.D, por jo sistemin e gjurmueshmërisë. Bazuar në këtë shkelje, ndaj subjektit është vendosur gjobë në vlerën 200 mijë lekë, si dhe brenda afatit 1-javor të korrigjohen mangësitë dhe të njoftohet DRAKU Tiranë.

Në këtë praktikë konstatohet se:

-Nuk dokumentohen kontrollet e kryera nga grupi i inspektimit (për planimetrin, kushtet e ruajtjes së produkteve, temperaturën e frigoriferit, temperaturën e ruajtjes së ushqimit, etj);

-Në proceverbalin përkatës, nuk jepet informacion për subjektin e inspektimit, për afatin e ankimit, institucionin ku do të drejtohet për ankim, për masën administrative të vendosur;

-Nuk dokumentohet përgatitja e sistemit HACCP dhe plani D.D.D, nga subjekti i inspektimit;

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se subjekti **nuk ka njoftuar DRAKU për korrigjimin e shkeljeve brenda datës 29.01.2018**, dhe si rrjedhojë ndaj këtij subjekti duhet të ishte vendosur gjobë për moskorrigjim të shkeljeve brenda afatit të përcaktuar, përcaktuar në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë")*;*

-Gjithashtu konstatohet **se për një periudhë rreth 2.5 vjeçare**, nga momenti i vendosjes së gjobës, **nuk është marrë asnjë masë**, për ekzekutimin dhe arkëtimin e kësaj gjobe, **duke sjellë parashkrimin e saj**, sipas nenit 46 të Ligjit nr.10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", dhe heqjen e të drejtës për arkëtimin nga AKU, konstatim i cili **mbështetet edhe nga vendimi nr.571** (31134-02497-80-2020), datë 06.07.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, i cili ka rrëzuar kërkesën e AKU-së për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për arsye se kjo kërkesë është bërë jashtë afatit ligjor; Kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në Gjykatën Administritative të Shkallës së Parë, është paraqitur përsëri nga DRAKU Tiranë, më datë 30.07.2020 me nr.,1375, kërkesë e cila është rrëzuar përsëri me Vendimin nr.764 (31134-02497-80-2020), datë 16.09.2020, me të njëjtin arsyetim si në vendimin e mëparshëm;

-DRAKU ka bërë ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, për ndryshimin e vendimit nr.764, datë 16.09.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe pranimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të gjobës. Kjo kërkesë e bërë nga DRAKU Tiranë, nuk është e plotë, për arsye se veç kërkesës së rrëzimit të vendimit nr.764, datë 16.09.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, duhej të bëhej edhe kërkesa për rrëzimin e vendimit nr.571 (31134-02497-80-2020), datë 06.07.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, i cili trajton të njëjtin problem dhe ka të njëjtën përmbajtje me vendimin nr.764, datë 16.09.2020.

-deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, nga subjekti nuk është kryer pagesa e gjobës, *si dhe nga DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen dhe arkëtimin e saj, duke sjellë edhe parashkrimin e kësaj gjobe në muajin Mars 2020;*
-Si pasojë e këtyre mosveprimeve janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt dëm ekonomik në vlerën 200 mijë lekë në total;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi z.A.N, z.Z.C, zj.M.K, si dhe për procedurën e ekzekutimit të gjobës, duke sjellë edhe parashkrimin e saj në muajin Shkurt 2020, z.A.I, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.A.H ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.R.L ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU, z.F.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Janar-Maj 2018, znj.M.C, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019, z.A.N ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020, si dhe zj.H.P Juristi i DRAKU Tiranë.

- Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 1-javor**, sipas inspektimit të kryer më datë 29.01.2018, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti M.P.I në DRAKU Tiranë, pas afatit 1-javor, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", *dhe për këtë mbanë përgjegjësi z.F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për periudhën Janar-Maj 2018.*

8.Në vijim të inspektimit të kryer më datë 26.01.2018, ku u morrën mostrat: tremiks derri në masën 5*250 gr; kofshë derri me kockë në masën 5*250 gr dhe shpatull derri pa kockë në masën 5*250 gr, si dhe pas daljes së rezultatit të analizës, nëpërmjet raport-provës nr.454, datë 05.02.2018, ku produkti tremiks derri, ka dalë me përmbajtje salmonelë, pranë këtij subjekti është kryer përsëri inspektim nëpërmjet autorizimit me nr.161/1 datë 06.02.2018, me inspektorë: N.H dhe A.N.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit me nr.0041462, datë 06.02.2018, është vendosur gjobë në vlerën 300 mijë lekë për tregtimin e produktit të pasigurt, **tërheqjen nga tregu të sasisë së shitur nga ky produkt deri më datë 09.02.2018**, si dhe është lënë detyrë që të korrigjohet shkelja, **duke bërë asgjesimin e sasisë 360 kg, por pa një afat të caktuar**.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Në gjykimin e grupit të auditimit, në kushtet kur produkti tremiks derri në sasinë 360 kg është bllokuar, si dhe mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, ku AKU kontrollin zyrtar e kryhen në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", **dhe në kushtet kur Ligji për ushqimin, nuk parashikon mënyrën se si duhet të veprohet me mallin e bllokuar (pra ti lihet subjektit në ruajtje apo ti merret)**, atëherë duhet të veprohet sipas përcaktimit ligjor të bërë në shkronjën ç, pika 2 të nenit 43, të Ligjit të inspektimit, ku parashikohet bllokimi dhe marrja në administrim e kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve, dhe në këtë rast, produkti i bllokuar duhej të merrej në administrim nga grupi i inspektimit, dhe më tej të veprohej sipas përcaktimit të bërë në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", dhe asgjesimi/shkatërrimi i tyre të bëhej me shpenzimet e subjektit, në prani të inspektorëve përkatës, **veprim i cili nuk është bërë, por është lënë në ruajte të subjektit, gjë e cila nuk parashikohet në asnjë akt ligjor apo nënligjor.**
-Nuk është përcaktuar afat konkret për asgjesimin e produktit;
-Nuk dokumentohet me foto (produkti i bllokuar, me shenjat dalluese);
-Në vendimin përfundimtar, **nuk vendoset edhe detyrimi për likujdimin e shpenzimeve të analizës laboratorike**, për produktin tremiks derri, sipas pikës 5 të nenit 38, të Ligjit nr.10433,

datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke hequr mundësinë e arkëtimit të saj, *me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën 4,500 lekë* (vlera e analizës).
-Gjoba në vlerën 300 mijë lekë është paguar nga subjekti në datën 08.10.2020;
-**Ndaj këtij subjekti nuk është arkëtuar kamat-vonesa 2% në muaj të masës së gjobës**, ku sipas llogaritjeve të grupit të auditimit është (0.02 * 300 mijë lekë * 29 muaj) = 174 mijë lekë, dhe për pasojë do të konsiderohet dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, për të cilën mbanë përgjegjësi përmbaruesi gjyqësor privat z.R.A, i cili nuk ka marrë masat për ekzekutimin e plotë të detyrimit monetar të debitorit[8] sipas Vendimit nr.488, datë 15.06.2020;
-Në total dëmi ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si pasojë e mosvprimeve të mësipërme është (174 mijë lekë + 4,5 mijë lekë) 178.5 mijë lekë.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi z.A.N dhe z.N.H për konstatimet në praktikën e inspektimit.

- Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda datës 09.02.2018 (ku më kryesorja është, lënia detyrë subjektit të asgjesimit të produktit tremiks derri në sasinë 360 kg)**, sipas inspektimit të kryer më datë 06.02.2018, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti M në DRAKU Tiranë, për respektimin e detyrimit të lënë nga grupi i inspektimit.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore z.F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për periudhën Janar-Maj 2018.

9.Pranë **subjektit M** është kryer **përsëri** inspektim me autorizimin me nr. 482/8 datë 15.05.018, me grup inspektimi: N.H dhe G.H, për marrje mostrash.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit me nr.0041462, datë 15.05.2018, ku pasqyrohet se u morrë mostra nga produkti gjoks pule të ngrirë pa kockë në masën 5 kampione*250 gr, për analizë zyrtare.
-Në vijim të praktikës së mësipërme, si dhe përgjigjes së analizës së produktit, gjoks pule i ngrirë pa kocka, nëpërmjet raport-provës nr.2515, datë 23.05.2018, ku është konstatuar prezencë e Salmonellës dhe e Typhimurium, pranë këtij subjekti, në datë 24.05.2020, është kryer inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2018-001246-1, datë 24.05.2018, me inspektorët L.Z dhe N.H.
-Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-001246-2, datë 24.05.2018, pasqyrohet rezultati i analizës, bllokimi i sasisë prej 27510 kg të produktit gjoks pule i ngrirë pa kocka (sasi e cila është bllokuar në Doganën Durrës, nga inspektorët e pikës kufitare Durrës), dhe i lihet detyrë që brenda 60-ditëve, subjekti të marri masat për kthimin në origjinë ose asgjesimin e produktit.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-001246-5, datë 24.05.2018, jepet masa paralajmërim dhe kthimi/asgjesimi i produktit.
Në praktikën e inspektimit konstatohet se:
-Nuk është përfshirë në vendimin përfundimtar të inspektimit, **detyrimi që subjekti të paguajë tarifën e analizës së mostrës** e cila kishte prezencë e Salmonellës dhe Typhimurium, *në vlerën 4,500 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.* Ky mosveprim bien në kundërshtim me pikën 5 të nenit 38 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
-Nuk administrohet procesverbali i bllokimit të produktit;
Për këtë mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.*L.Z dhe* z.*N.H.*

10.Në vijim pranë këtij subjekti është kryer **inspektim tjetër**, me autorizimin nr.AKU-TR-2018-001427-1, datë 06.06.2018, me inspektorët Sh.K dhe E.C.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-001427-1, datë 07.06.2018

[8] Shkronjat a, b, c dhe g të nenit 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".

-Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-001427-2, datë 07.06.2018, pasqyrohet se janë marrë mostra në masën 5 kampione me 25 gr secila, nga produkti kima pule, si dhe bllokohet sasia prej 6144 kg, e këtij produkti, deri në daljen e përgjigjes së analizës.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Inspektimi **është kryer jashtë afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit,** ku është përcaktuar data 06.06.2018 dhe jo 07.06.2018 (verifikuar nga listë verifikimi i inspektimit me datën 07.06.2018), si dhe në kushtet e mungesës së autorizimit të Drejtorit të DRAKU Tiranë për shtyrje të afatit të inspektimit, **atëherë ky inspektim është i pavlefshëm** dhe bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
-Nuk administrohet fletë-shoqërimi i marrjes së mostrës, ç'ka nuk vërteton veprimin e kryer nga inspektorët[9];
-Nuk administrohet procesverbali i bllokimit të produktit;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.*Sh.K dhe* z.*E.C.*

11. Pranë këtij subjekti me autorizimin nr.AKU-TR-2018-002500-1, datë 24.07.2018 është autorizuar të kryhet inspektim tjetër me inspektorët E.V dhe N.H, me qëllim **verifikimin e korrigjimit të shkeljes të asgjesimit/kthimit të 27510 kg** të produktit gjoks pule i ngrirë pa kocka.
Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-002500-2, datë 24.07.2018, pasqyrohet se subjekti edhe pas kalimit të këtij afati, **nuk e ka realizuar detyrën e lënë**, por sasia është gjendur përsëri e bllokuar dhe jo e asgjesuar/kthyer. Si arsye për moskorrigjimin e shkeljes, është pasqyruar se subjekti është në pritje të përgjigjes së analizës nga një laborator në Shtetin e Hollandës.
Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-002500-2, datë 24.07.2018, nuk jepet asnjë masë.
Në këtë praktikë konstatohet:
-**Nuk është vendosur gjobë për moskorrigjimin e shkeljes brenda afatit të përcaktuar**, sipas përcaktimit të bërë në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.*E.V dhe* z.*N.H.*

12.Përsëri subjekti M është inspektuar në muajin Nëntor të vitit 2018, me autorizimin nr.AKU-TR-2018-004305-1, datë 13.11.2018 me inspektorët E.C, V.V dhe N.H, me objekt zbatimin e legjislacionit në fuqi.
Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-004305-1, datë 14.11.2018.
Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-004305-2, datë 14.07.2018, pasqyrohet se frigoriferi është i mbingarkuar, duhen të sistemohen produktet, dhe të krijohen hapësirat e nevojshme për kontrollin e produktit në çdo moment.
Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-004305-5, datë 14.11.2018, nuk jepet asnjë masë.
Në këtë praktikë konstatohet:
-Inspektimi **është kryer jashtë afatit të përcaktuar në autorizimin** e inspektimit, ku është përcaktuar data 13.11.2018 dhe jo 14.11.2018 (verifikuar nga listë verifikimi i inspektimit me datën 14.11.2018), si dhe në kushtet e mungesës së autorizimit të Drejtorit të DRAKU Tiranë për shtyrje të afatit të inspektimit, **atëherë ky inspektim është i pavlefshëm** dhe bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".;

[9] Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit".

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.*E.C*, zj.*V.V dhe* z.*N.H.*

Në përfundim të auditimit të praktikave të inspektimit pranë subjektit M, përgjatë vitit 2018, **konstatohet se nuk administrohet asnjë informacion/dokument** lidhur me: -asgjesimin e 360 kg të produktit tremiks derri dhe tërheqjen e tij nga tregu; -kthimin në origjinë të sasisë prej 27.510 kg të produktit gjoks pule i ngrirë pa kocka.

13. Inspektimi me autorizimin nr.678/4, datë 08.07.2018, pranë **personit fizik H.Xh**, me vendndodhje në Tregun Industrial, Bashkia Kavajë, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.

-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041739, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se personi fizik, tregton mish në ambjent të hapur dhe jashtë kushteve të higjienës. Mishi ishte i pavulosur dhe i pa çertefikuar. Ndaj personit fizik, u vendosë masa administrative gjobë në vlerën 250,000 lekë për tregtimin e mishit jashtë kushteve ligjore dhe gjobë në vlerën 150,000 lekë për therjen e mishit në vende të hapura, bllokimi i mishit në sasinë 10 kg, *1 hanxhar, 1 thikë dhe 1 peshore*.

-Procesverbali i bllokimit me nr.0115, i mbajtur në datë 08.07.2018, ku pasqyrohen mallrat e bllokuara.

Në këtë praktikë konstatohet se:

-Inspektorët duhet të konfiskonin mallrat që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes administrative, dhe jo të bllokonin, pasi ky veprim nuk parashikohet në Ligjin nr. 87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre";

-Ka mospërputhje të të dhënave midis proceverbalit të inspektimit dhe procesverbalit të bllokimit, konkretisht në proceverbalin e inspektimit bllokohen 10 kg mish, ndërkohë në procesverbalin e bllokimit pasqyrohen 9 kg mish, në procesverbalin e inspektimit bllokohet 1 thikë, 1 hanxhar dhe 1 peshore, ndërkohë në procesverbalin e bllokimit pasqyrohet 1 thikë dhe 1 hanxhar;

-Subjekti ka marrë masë administrative gjobë, edhe për therjen e mishit, veprim i cili në gjykimin e grupit të auditimit, nuk qendron, pasi në asnjë rast nuk pasqyrohet se personi fizik ushtron aktivitet si thertore, i cili veç tregtimit të mishit, kryen edhe procesin e therjes, që në këtë rast personi fizik duhet të ketë kafshë të gjalla, që më pas t'i therë ato;

-Nuk dokumentohen me foto, si dhe nuk pasqyrohen në procesverbalin e bllokimit, të dhënat e identifikimit për mallrat e bllokuara, për peshoren, thikën, hanxharin;

-Nuk administrohet dokumenti i cili pasqyron dhe vërteton se ku janë dorëzuar mallrat e bllokuara;

-Nuk është bërë asgjesimi i mishit të bllokuar;

-Nuk është marrë masë me gjobë ndaj veterinerit zyrtar, *në vlerën 50,000 lekë* (vlera minimale e gjobës), i cili nuk ka përmbushur detyrat ligjore të përcaktuara (kryerjen e kontrollit veterinar të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënprodukte te kafshëve në mjediset e thertoreve) në nenin 131 të Ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Nuk administrohet njoftimi i Ministrisë së Brendshme, për moszbatim nga strukturat e pushtetit vendor, të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr.87/2012*;*

-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, gjobat e vendosura ndaj personit fizik nuk janë arkëtuar, dhe DRAKU është mjaftuar vetëm duke i nisur përmbaruesit gjyqësor urdhrin e ekzekutimit, por në vazhdim ndaj përmbaruesit nuk ka kërkuar informacion ose marrjen e veprimeve të tjera prej tij (sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës), mosvperime të cilat në gjykimin e grupit të auditimit, kanë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit me efekt negativ financiar, në vlerën 400 mijë lekë + (0.02 kamat-vonesa * 28 muaj * 400 mijë lekë) = 624 mijë lekë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.*N.H*, z.*E.V*, z.*G.H dhe* z.*D.K, si dhe z.R.A*

përmbarues gjyqësor privat i zyrës së përmbarimit R.B.S[10]*, si dhe për mozbatimin e Vendimit nr.21, datë 07.01.2019.*

14. Inspektimi me autorizimin nr.678/5, datë 08.07.2018, pranë **personit fizik V.Xh**, me vendndodhje në Tregun Industrial, Bashkia Kavajë, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041740, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se personi fizik, tregton mish në ambjent të hapur dhe jashtë kushteve të higjienës. Mishi ishte i pavulosur dhe i pa çertefikuar. Ndaj personit fizik, u vendosë masa administrative gjobë në vlerën 250 mijë lekë për tregtimin e mishit jashtë kushteve ligjore, gjobë në vlerën 150 mijë lekë për therjen e mishit në vende të hapura, bllokimi i mishit në sasinë 10 kg, *1 hanxhar, 1 thikë dhe 1 peshore*.
-Procesverbali i bllokimit me nr.0200, i mbajtur në datë 08.07.2018, ku pasqyrohen mallrat e bllokuara.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Inspektorët duhet të konfiskonin mallrat që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes administrative, dhe jo të bllokonin, pasi ky veprim nuk parashikohet në Ligjin nr. 87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre";
-Subjekti ka marrë masë administrative gjobë, edhe për therjen e mishit, veprim i cili në gjykimin e grupit të auditimit, nuk qendron, pasi në asnjë rast nuk pasqyrohet se personi fizik ushtron aktivitet si thertore, i cili veç tregtimit të mishit, kryen edhe procesin e therjes, që në këtë rast personi fizik duhet të ketë kafshë të gjalla, që më pas i therë ato;
-Nuk dokumentohen me foto, si dhe nuk pasqyrohen në procesverbalin e bllokimit, të dhënat e identifikimit për mallrat e bllokuara, për peshoren, thikën, hanxharin;
-Nuk administrohet dokumenti i cili pasqyron dhe vërteton se ku janë dorëzuar mallrat e bllokuara;
-Nuk administrohet dokumenti i hyrjes (fletë-hyrja) në magazinën e institucionit i cili ka konstatuar kundërvajtjen administrative dhe ka bllokuar mallrat;
-Nuk është bërë asgjesimi i mishit të bllokuar;
-Nuk është marrë masë me gjobë ndaj veterinerit zyrtar, në vlerën 50,000 lekë (vlera minimale e gjobës), i cili nuk ka përmbushur detyrat ligjore të përcaktuara (kryerjen e kontrollit veterinar të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënprodukte te kafshëve në mjediset e thertoreve), në nenin 131 të Ligjit nr.10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Nuk administrohet njoftimi i Ministrisë së Brendshme, për moszbatim nga strukturat e pushtetit vendor, të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr.87/2012;
-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, gjobat e vendosura ndaj personit fizik nuk janë arkëtuar, dhe DRAKU është mjaftuar duke i nisur përmbaruesit gjyqësor vetëm urdhrin e ekzekutimit, por në vazhdim ndaj përmbaruesit nuk ka kërkuar informacion ose marrjen e veprimeve prej tij (sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës), mosvperime të cilat në gjykimin e grupit të auditimit kanë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit me efekt negativ financiar, në vlerën 400 mijë lekë + (0.02 * 28 muaj * 400 mijë lekë) = 624 mijë lekë.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.*N.H,* z.*E.V,* z.*G.H dhe* z.*D.K, si dhe*

[10] Neni 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".
Nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

përmbaruesi gjyqësor privat z.A.S, për moszbatimin e kuadrit[11] *ligjor si dhe të Vendimit nr.21, datë 15.01.2019.*

15. Inspektimi me autorizimin nr.678/6, datë 08.07.2018, pranë **personit fizik I.K** (tregtim mishi), me vendndodhje në tregun Kavajë, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041735, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se personi fizik, tregton mish të pa certefikuar dhe vulosur.
-Ndaj subjektit, u vendosë masa administrative gjobë në vlerën 200 mijë lekë për therjen e mishit, jo sipas kërkesave ligjore dhe konfiskimi i sasisë prej 30.5 kg, **dhe mishi u dërgua në thertoren e subjektit privat "K".**
-Procesverbali i bllokimit me nr.0197, i mbajtur në datë 08.07.2018, ku pasqyrohen mallrat e konfiskuara dhe dërgimi i tyre në subjektin privat (me aktivitet thertore) K.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Inspektorët duhet të konfiskonin edhe mallrat që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes administrative, siç kanë vepruar në rastin e inspektimit të personit fizik V.Xh dhe H.Xh, në tregun e Kavajës;
-Subjekti ka marrë masë administrative gjobë, edhe për therjen e mishit, veprim i cili në gjykimin e grupit të auditimit, nuk qendron, pasi në asnjë rast nuk pasqyrohet se personi fizik ushtron aktivitet si thertore, i cili veç tregtimit të mishit, kryen edhe procesin e therjes, që në këtë rast personi fizik duhet të ketë kafshë të gjalla, që më pas i therë ato;
-Nuk dokumentohen veprimet e inspektimit nëpërmjet dokumenteve vërtetues dhe justifikues (foto, procesverbali i dorëzimit dhe ai i marrjes në dorëzim nga subjekti K);
-Nuk është bërë asgjesimi i mishit të konfiskuar;
-Nuk është marrë masë me gjobë ndaj veterinerit zyrtar, *në vlerën 50,000 lekë* (vlera minimale e gjobës), i cili nuk ka përmbushur detyrat ligjore të përcaktuara (kryerjen e kontrollit veterinar të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënprodukte te kafshëve në mjediset e thertoreve), në nenin 131 të Ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Nga inspektorët është vepruar me **dy standarde**, pasi për të njëjtat shkelje të konstatuara në këtë inspektim si dhe në ato të kryera tek personi fizik V.Xh dhe H.Xh, të cilët kanë të njëjtin aktivitet (tregtim i mishit në tregun e Bashkisë Kavajë), **janë vendosur masa gjobe të ndryshme.**
Konkretisht: "Ndaj personit fizik V.Xh është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 250 mijë lekë për tregtimin e mishit jashtë kushteve ligjore, gjobë në vlerën 150 mijë lekë për therjen e mishit në vende të hapura dhe bllokimi i mishit në sasinë 10 kg, 1 hanxhar, 1 thikë dhe 1 peshore, po kështu edhe ndaj personit fizik H.Xh;
Ndërkohë në inspektimin e personit fizik I.K, është vendosur gjobë në vlerën 200 mijë lekë nga 400 mijë lekë të vendosur në secilat prej praktikave të inspektimit më sipër, ose **200 mijë lekë më pak** se në dy praktikat e inspektimit më sipër;
Pra në të tre praktikat, janë inspektuar 3 persona fizik, që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit të mishit në të njëjtin treg (vënd i hapur) në Bashkinë Kavajë;
Në të tre praktikat konstatohet se mishi është pa vulë dhe certefikatë veterinare;
Në praktikën e inspektimit të personit fizik V.Xh, për vendosjen e gjobave në vlerën 400 mijë lekë gjithsej, përdoret si **referencë ligjore** (neni 16, pika 1, shkronja ë, të Ligjit nr.87/2012 - Tregtimi i mishit në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo ambient tjetër të hapur për publikun dënohet me gjobë në masën 150,000 – 250,000 lekë) **dhe** (neni 16, pika 1, shkronja c, të Ligjit nr.87/2012 - Therja e kafshëve në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo

[11] Neni 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".
Nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

ambient tjetër të hapur për publikun dënohet me gjobë në masën 150,000 – 250,000 lekë), po kështu edhe ndaj personit fizik H.Xh;
Ndërkohë në praktikën e inspektimit të personit fizik I.K, për vendosjen e gjobës në vlerën 200 mijë lekë (pra 200 mijë lekë më pak se në rastet e mësipërme), është përdorur si **referencë ligjore** (neni 16, pika 1, shkronja ç, të Ligjit nr.87/2012 - Therja e kafshëve në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 7 të këtij akti normativ, dënohet me gjobë në masën 100 000 – **200 000 lekë**)
Sa më sipër nga inspektorët duhet të ishin kryer të njëjtat veprime proceduriale dhe masa e gjobës duhet të ishte e njëjtë.

-Mishi i konfiskuar **është dërguar pranë subjektit privat K, i cili është vetë objekt inspektimi nga AKU**, **veprim i cili nuk ka asnjë bazë ligjore që lejon kryerjen e tij**, por është kryer në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Referuar këtij veprimi të kryer nga ana e inspektorëve, arrihet në konkluzionin se ky veprim është kryer në **tejkalim të kompetencave ligjore**, në kushtet e mungesës së minimalisht të një akti ligjor (kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike) midis institucionit dhe subjektit, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar, duke cenuar sigurinë ushqimore, pasi në çdo moment subjekti, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar (ku theksojmë se në këtë praktikë nuk administrohet as dokumenti i pranimit nga subjekti, të mallit të konfiskuar), mund ta nxjerrë në treg atë, mund ta trajtojë, përpunoj dhe ta përdori për një qëllim tjetër, si dhe ndikon negativisht në konkurrencën në treg;
-Nuk administrohet njoftimi i Ministrisë së Brendshme, për moszbatim nga strukturat e pushtetit vendor, të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr.87/2012.
-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, gjoba e vendosur ndaj personit fizik nuk është arkëtuar, për arsye se me vendimin nr.1586, datë 07.09.2018 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës nr. 2134 prot., datë 30.08.2018, së bërë nga DRAKU për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe në vijim nga DRAKU me shkresën nr.2589 prot., datë 25.09.2018 i jemi drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për ankim ndaj vendimit të GJSHP, dhe nuk ka një vendim përfundimtar.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.*N.H*, z.*E.V*, z.*G.H dhe* z.*D.K dhe zj.M.M për mosnjoftimin e Ministrisë së Brendshme.*

16. Inspektimi me autorizimin nr.678/8, datë 08.07.2018, pranë **personit fizik V.B** (tregtim mishi), me vendndodhje në tregun Kavajë, Synej, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041737, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se personi fizik, tregton mish të pa certefikuar dhe vulosur.
-Ndaj subjektit, është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 100 mijë lekë për therjen e mishit, jo sipas kërkesave ligjore dhe konfiskimi i sasisë prej 23.5 kg, **dhe mishi u dërgua në thertoren e subjektit privat "K".**
-Procesverbali i bllokimit me nr.0199, i mbajtur në datë 08.07.2018, ku pasqyrohen mallrat e konfiskuara dhe dërgimi i tyre në subjektin privat (me aktivitet thertore) K.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Inspektorët duhet të konfiskonin edhe mallrat që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes administrative, siç kanë vepruar në rastin e inspektimit të personit fizik V.Xh dhe H.Xh, në tregun e Kavajës;
-Subjekti ka marrë masë administrative gjobë, edhe për therjen e mishit, veprim i cili në gjykimin e grupit të auditimit, nuk qendron, pasi në asnjë rast nuk pasqyrohet se personi fizik ushtron aktivitet si thertore, i cili veç tregtimit të mishit, kryen edhe procesin e therjes, që në këtë rast personi fizik duhet të ketë kafshë të gjalla, që më pas i therë ato;
-Nuk dokumentohen veprimet e inspektimit nëpërmjet dokumenteve vërtetues dhe justifikues (foto, procesverbali i dorëzimit dhe ai i marrjes në dorëzim nga subjekti **K**);

-Nuk është bërë asgjesimi i mishit të konfiskuar;
-Nuk është marrë masë me gjobë ndaj veterinerit zyrtar, në vlerën 50,000 lekë (vlera minimale e gjobës), i cili nuk ka përmbushur detyrat ligjore të përcaktuara (kryerjen e kontrollit veterinar të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënprodukte te kafshëve në mjediset e thertoreve), në nenin 131 të Ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Nga inspektorët **përsëri** është vepruar me **dy standarde**, ku veç veprimit në mënyra të ndryshme, krahasuar me inspektimet në personat fizik V.Xh dhe H.X, edhe në këtë rast, pra në inspektimin e personit fizik V.B, ku është përdorur si referencë ligjore (neni 16, pika 1, shkronja ç, të Ligjit nr.87/2012 - Therja e kafshëve në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 7 të këtij akti normativ, dënohet me gjobë në masën 100 000 – 200 000 lekë) për vendosjen e gjobës në vlerën 100 mijë lekë, e njëjta referencë e përdorur edhe në inspektimin e personit fizik I.K, gjoba që vendoset është 100 mijë lekë më pak.
Pra në inspektimin e personit I.K, konstatohet mishi pa vulë dhe certefikatë, dhe në mbështetje të **nenit 16, pika 1, shkronja ç**, të Ligjit nr.87/2012, vihet gjobë **200 mijë lekë**;
Në inspektimin e personit fizik V.B, konstatohet mishi pa vulë dhe certefikatë, dhe në mbështetje të **nenit 16, pika 1, shkronja ç**, të Ligjit nr.87/2012, vihet gjobë **100 mijë lekë**.
Sa më sipër nga inspektorët duhet të ishin kryer të njëjtat veprime proceduriale dhe masa e gjobës duhet të ishte e njëjtë, për të katër rastet e inspektimit të personave fizik V.XH, H.XH, I.K dhe V.B.

-Mishi i konfiskuar është dërguar **përsëri** pranë subjektit privat **K**, i cili është vetë objekt inspektimi nga AKU, veprim i cili nuk ka asnjë bazë ligjore lejon kryerjen e tij, por është kryer në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Referuar këtij veprimi të kryer nga ana e inspektorëve, arrihet në konkluzionin se **ky veprim është kryer në tejkalim të kompetencave ligjore**, në kushtet e mungesës së minimalisht të një akti ligjor (kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike) midis institucionit dhe subjektit, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar, duke cenuar sigurinë ushqimore, pasi në çdo moment subjekti, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar (ku theksojmë se në këtë praktikë nuk administrohet as dokumenti i pranimit nga subjekti, të mallit të konfiskuar), mund ta nxjerrë në treg atë, mund ta trajtojë, përpunoj dhe ta përdori për një qëllim tjetër, si dhe ndikon negativisht në konkurrencën në treg;
-Nuk administrohet njoftimi i Ministrisë së Brendshme, për moszbatim nga strukturat e pushtetit vendor, të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit nr.87/2012.
-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, gjoba e vendosur ndaj personit fizik nuk është arkëtuar, dhe DRAKU është mjaftuar duke i nisur përmbaruesit gjyqësor vetëm urdhrin e ekzekutimit, por në vazhdim ndaj përmbaruesit nuk ka kërkuar informacion ose marrjen e veprimeve prej tij (sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës) mosvperime të cilat në gjykimin e grupit të auditimit kanë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit me efekt negativ financiar, në vlerën 100 mijë lekë + (0.02 * 28 muaj * 100 mijë lekë) = 156 mijë lekë.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.N.H, z.E.V, z.G.H dhe D.K, si dhe përmbaruesi gjyqësor z.A.V, i ngarkuar me ekzekutimin e detyrimit, për mos zbatimin e kuadrit ligjor[12], si dhe të Vendimit nr.1676, datë 16.09.2019.

17. Inspektimi me autorizimin nr.678/7, datë 08.07.2018, **pranë subjektit A.A** (tregtim mishi), me

[12] Neni 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".
Nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

vendndodhje Golem, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041736, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se, subjekti tregton mish të pa certefikuar dhe vulosur.
-Ndaj subjektit, u vendosë masa administrative gjobë në vlerën 200,000 lekë për therjen e mishit, jo sipas kërkesave ligjore dhe konfiskimi i sasisë prej 10 kg, dhe mishi u dërgua në thertoren e subjektit privat "**K**".
-Procesverbali i bllokimit me nr.0198, i mbajtur në datë 08.07.2018, ku pasqyrohen mallrat e konfiskuara.
Në këtë praktikë konstatohet se:
-Subjekti ka marrë masë administrative gjobë, për therjen e mishit, veprim i cili në gjykimin e grupit të auditimit, nuk qendron, për arsye se pas verifikimit të në rregjistrin e QKB-së, ky subjekt tregon mish dhe nënprodukte të tij, dhe nuk ushtron edhe aktivitetin e thertores.
-Nuk dokumentohen veprimet e inspektimit nëpërmjet dokumenteve vërtetues dhe justifikues (foto, procesverbali i dorëzimit dhe ai i marrjes në dorëzim nga subjekti Kazazi);
-Inspektimi **nuk është kryer i plotë**, për arsye se ky subjekt, referuar verifikimit të bërë nga grupi i auditimit, në rregjistrin e subjekteve të regjistruara në QKB, veç tregtimit të mishit, tregton edhe nënproduktet e tij, dhe për këtë arsye ndaj këtij subjekti duhet të ishin verifikuar të gjitha kushtet e higjienës, sistemi i gjurmueshmërisë;
-Gjithashtu veç mishit, ndaj këtij subjekti duhet të ishin konfiskuar edhe mjetet e punës, veprim i cili nuk ka ndodhur nga grupi i inspektorëve;
-Nuk është bërë asgjesimi i mishit të bllokuar;
-Nuk është marrë masë me gjobë ndaj veterinerit zyrtar, në vlerën 50,000 lekë (vlera minimale e gjobës), i cili nuk ka përmbushur detyrat ligjore të përcaktuara, në nenin 131 të Ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Konstatohet **se nuk janë ndjekur procedurat ligjore**, për njoftimin e Ministrit përgjegjës për bujqësinë si dhe Prefektit të Bashkisë Kavajë, për tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore, në kundërshtim me kërkesat ligjore;
-Mishi i konfiskuar është dërguar **përsëri** pranë subjektit privat **K**, i cili është vetë objekt inspektimi nga AKU, veprim i cili nuk ka asnjë bazë ligjore lejon kryerjen e tij, por është kryer në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Referuar këtij veprimi të kryer nga ana e inspektorëve, arrihet në konkluzionin se **ky veprim është kryer në tejkalim të kompetencave ligjore**, në kushtet e mungesës së minimalisht të një akti ligjor (kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike) midis institucionit dhe subjektit, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar, duke cenuar sigurinë ushqimore, pasi në çdo moment subjekti, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar (ku theksojmë se në këtë praktikë nuk administrohet as dokumenti i pranimit nga subjekti, të mallit të konfiskuar), mund ta nxjerrë në treg atë, mund ta trajtojë, përpunoj dhe ta përdori për një qëllim tjetër, si dhe ndikon negativisht në konkurrencën në treg;
-Ndaj subjektit nuk është pezulluar licenca, për mosrespektim të kërkesave veterinare;
-Deri në momentin e konstatimit nga grupi i auditimit, gjoba e vendosur ndaj personit fizik nuk është arkëtuar, dhe DRAKU është mjaftuar duke i nisur përmbaruesit gjyqësor vetëm urdhrin e ekzekutimit, por në vazhdim ndaj përmbaruesit nuk ka kërkuar informacion ose marrjen e veprimeve prej tij (sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës), mosvperime të cilat në gjykimin e grupit të auditimit kanë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit me efekt negativ financiar, në vlerën 200 mijë lekë + (0.02 * 28 muaj * 200 mijë lekë) = 312 mijë lekë.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.N.H, z.E.V, z.G.H dhe z.D.K, si dhe z.R.A përmbarues i zyrës së përmbarimit R.B.S, për mozbatimin e kuadrit ligjor [13], si dhe të Vendimit

[13] Neni 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".

nr.1539, datë 11.09.2019.

18. Inspektimi me autorizimin nr.678/5, datë 08.07.2018, pranë **subjektit B.K**, veprimtaria treg, kryer nga inspektorët N.H, E.V, G.H dhe D.K.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0041738, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se në treg shiten produkte shtazore (mish, peshk, bulmet) jashtë çdo kushti minimal të higjienës. **Produktet shiten në prezencë pluhuri, insektesh**. Për këtë u morrë masa e **konfiskimit dhe gjobë për disa subjekte**. Gjithashtu **ndaj B.K është vendosur gjobë** në vlerën 500 mijë lekë.
Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-Është **autorizuar inspektimi** i një subjekti, **që nuk përfshihet në fushën e zbatimit** të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 2 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, pikën 2 të nenit 2 të Ligjit nr.87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre", nenit 11 të Ligjit nr. Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", **pra në tejkalim të kopetencave ligjore** për kryerjen e funksioneve të këtij institucioni, **dhe si i till duhej të ishte refuzuar nga inspektorët**, mbështetur në pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", si punonjës që marrëdheniet e tyre të punësimit, për periudhën kur është kryer kontrolli, janë rregulluar nëpërmjet Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil";
-Ky veprim **nuk ka ndodhur**, por inspektorët **kanë kryer inspektimin**, duke vendosur gjobë ndaj një subjekti, **që nuk e kanë objekt inspektimi**, i cili **nuk ka asnjë autorizim, leje apo licencë për kryerjen e aktivitetit të tregtimit/therjes së mishit apo të produkteve të tjera me origjinë shtazore;**
-Gjithashtu konstatohet se në këtë praktikë, **nuk përmenden emrat e subjekteve të cilat janë gjobitur, si dhe nuk identifikohen mallrat e konfiskuar, nuk administrohet asnjë dokument (procesverbal bllokimi, foto)** që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve nga ana e inspektorëve, si dhe nuk ka asnjë faturë arkëtimi të lëshuar për subjektet që janë gjobitur, por vetëm fatura e arkëtimit të gjobës së vendosur ndaj B.K, në tejkalim të kopetencave ligjore, faturë e cila nuk është firmosur;
-Konstatohet se nuk janë ndjekur procedurat ligjore, për njoftimin e Ministrit përgjegjës për bujqësinë si dhe Prefektit të Bashkisë Kavajë, për tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore, në kundërshtim me kërkesat ligjore;
-Sa më sipër në këtë praktikë arrihet në konkluzionin se**:** "Veprimet e kryera nga ish Kryeinspektori në detyrë për periudhën kur është kryer inspektimi, nga inspektorët, **janë në tejkalim të kompetencave ligjore**, si dhe të dhënat në procesverbalin e inspektimit, konstatimit dhe vendimit janë plotësuar në mënyrë fiktive nga inspektorët e mësipërm".
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.*N.H,* z.*E.V,* z.*G.H dhe* z.*D.K, znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

19. Inspektimi me autorizimin nr.676, datë 06.07.2018, pranë **subjektit A.Q**, kryer nga inspektorët Z.C dhe L.Zh.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit i mbajtur me nr.0040893, datë 08.07.2018, ku është konstatuar se subjekt, tregton mish pa çertefikatën veterinare dhe vulën e veterinerit.
-Ndaj këtij subjekti u vendos gjobë në vlerën 100 mijë lekë, u konfiskua 11 kg mish që u gjet në subjekt, dhe kjo sasi mishi u **dërgua në frigoriferin e subjektit privat B**.
-Procesverbali i bllokimit me nr.118, pasqyron konfiskimin e mishit, dërgimin e tij pranë

Nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

frigoriferit të subjektit B.
Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-**Nuk dokumentohen veprimet** e inspektimit nëpërmjet dokumenteve vërtetues dhe justifikues (foto, procesverbali i dorëzimit dhe ai i marrjes në dorëzim nga subjekti B);
-Inspektimi **nuk është kryer i plotë**, për arsye se ky subjekt, referuar verifikimit të bërë nga grupi i auditimit, në rregjistrin e subjekteve të regjistruara në QKB, veç tregtimit të mishit, tregton edhe produkte bulmet, dhe për këtë arsye ndaj këtij subjekti duhet të ishin verifikuar të gjitha kushtet e higjienës, sistemi i gjurmueshmërisë;
-Gjoba është vendosur për therjen e kafshëve, ndërkohë që subjekti vetëm tregton dhe nuk ther kafshë, pra referimi ligjor i bërë nga inspektorët është i gabuar;
-Nga inspektorët nuk është marrë asnjë masë ndaj veterinerit zyrtar;
-Konstatimi i inspektorëve se ky mish është i papërshtatshëm për konsum njerëzor, **është i pa mbështetur ligjërisht dhe shkencërisht**, për arsye se që të vlerësohet nëse mishi i konfiskuar është i papërshtatshëm duhet të plotësohen të paktën një nga kërkesat ligjore të përcaktuara në pikën 2 të nenin 12 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, si vijon a) karakteristikat e tij ndryshohen për shkak të trajtimit fizik, kimik apo mikrobiologjik;
b) përmban substanca ose lëndë të para, të cilat nuk janë verifikuar dhe vlerësuar nga ana toksikologjike dhe nuk janë të sigurta për konsum publik;
c) përmban papastërti dhe përzierje, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njerëzve.
Pra në rastin e mësipërm, asnjë prej këtyre karakteristikave, nuk është cituar dhe faktuar nga inspektorët;
-Gjithashtu veç mishit, **ndaj këtij subjekti duhet të ishin konfiskuar edhe mjetet e punës**, veprim i cili nuk ka ndodhur nga grupi i inspektorëve;
-Mishi i konfiskuar **është dërguar pranë subjektit privat B**, i cili është **vetë objekt inspektimi nga AKU**, veprim i cili nuk ka asnjë bazë ligjore lejon kryerjen e tij, por është kryer në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Referuar këtij veprimi të kryer nga ana e inspektorëve, arrihet në konkluzionin se ky veprim është kryer në tejkalim të kopetencave ligjore, në kushtet e mungesës së minimalisht të një akti ligjor (kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike) midis institucionit dhe subjektit, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar, duke cenuar sigurinë ushqimore, pasi në çdo moment subjekti, në të cilin është dërguar malli i konfiskuar (ku theksojmë se në këtë praktikë nuk administrohet as dokumenti i pranimit nga subjekti të mallit të konfiskuar), mund ta nxjerrë në treg atë, mund ta trajtojë, përpunoj dhe ta përdori për një qëllim tjetër, si dhe ndikon negativisht në konkurrencën në treg;
-Deri në momentin e konstatimit të grupit të auditimit, nuk është arkëtuar gjoba e vendosur ndaj këtij subjekti, dhe DRAKU është mjaftuar duke i nisur përmbaruesit gjyqësor vetëm urdhrin e ekzekutimit, por në vazhdim ndaj përmbaruesit nuk ka kërkuar informacion ose marrjen e veprimeve prej tij (sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës) mosvperime të cilat në gjykimin e grupit të auditimit kanë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit me efekt negativ financiar, në vlerën 100 mijë lekë + (0.02 * 28 muaj * 100 mijë lekë) = 156 mijë lekë gjithsej.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.Z.C dhe zj.L.Zh, si dhe përmbaruesi gjyqësor zj.I.T, e ngarkuar për arkëtimin e detyrimit[14].

20.Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003799-1, datë 24.06.2019, të subjektit A, me aktivitet supermarket ushqimor. Inspektorët e autorizuar: G.H, M.B, D.D, E.M. Ky inspektim

[14]Neni 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".
Nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

është iniciuar mbi bazën e një ankese të ardhur me email në datë 24.06.2019, ku në supermarket tregëtohen disa produkte jashtë afatit të skadencës.
-Me shkresën nr.AKU-TR-2019-003799-9, datë 24.06.2019, është bërë kërkesë për shtyrje të afatit të inspektimit, nga data 24.06.2019 deri në datën 25.06.2019, me arsyetimin se personi përgjegjës nuk ka qenë i pranishëm në subjekt.
-Listë-verifikimi nr. AKU-TR-2019-003799-1, datë 25.06.2019.
-Procesverbali i inspektimit me nr. AKU-TR-2019-003799-2, datë 25.06.2019, ku është konstatuar se subjekti ushtron aktivitet pa licencën përkatëse me kodin II.1.B, në raftet e supermarketit u gjendën disa produkte jashtë afatit të përdorimit, pa etiketë në gjuhën shqipe, si dhe një produkt (mocarela) pa etiketë dhe dokumentacion shoqërues.
Për shkeljet e mësipërme ndaj subjektit u vendosën masat administrative:
-2,000,000 lekë për mungesën e licencës;
-300,000 lekë për nxjerrjen në treg të ushqimeve të pasigurta;
-100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë;
-50,000 lekë për etiketimin e produkteve në gjuhën shqipe;
Pra në total 2,450,000 lekë.
-Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente me nr.AKU-TR-2019-003799-4, datë 24.06.2019, ku është bërë bllokimi i produkteve ushqimore dhe i është lënë detyrë subjektit t'i asgjesojë ato dhe të njoftojë DRAKU Tiranë, **por pa afat të caktuar nga inspektorët.**
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003799-5, datë 25.06.2019, ku pasqyrohen gjobat e vendosura dhe detyra për asgjesimin e produkteve të bllokuara.
-Ndaj vendimit të inspektimit subjekti ka bërë ankim në DPAKU, me shkresën nr.4282 prot., datë 05.07.2019, dhe Komisioni i shqyrtimit të ankesave me Vendimin nr.35, datë 27.04.2020 ka shfuqizuar vendimit përfundimtar të inspektimit.
-Arsyetimi i Komisionit në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:
-"Lidhur me gjobën për mungesën e licencës për ushtrimin e aktivitetit, licenca është akt administrativ që i njeh të drejtën titullarit të fillojë të ushtrojë aktivitetin dhe është detyrim i çdo subjekti të pajiset me licencë. Subjekti A përfshihet në kategorinë e atyre subjekteve që duhet të pajisen me licencë. Komisioni vlerëson se masa administrative e vendosur për licencën është e përligjur sa i takon faktit se jemi para shkeljes së kërkesave ligjore. Pavarsisht vlerësojmë se masa administrative nuk është proporcionale duke marrë në konsideratë disa faktorë. Konkretisht ky subjekt ka disa vite që ka ushtruar aktivitet dhe nga inspektimet e mëparshme nuk janë marrë masa administrative për mungesën e licencës, dhe arrihet në konkluzionin se ky subjekt e ka ushtruar aktivitetin në mirëbesim. Nga grupi i inspektimit është pasqyruar se subjekti ushtron aktivitet në vendndodhje të përshtatshme, kushtet higjeno-sanitare janë të përshtatshme. Sa më lart evidentohet se subjekti plotëson kushtet për tu licencuar dhe se në këtë rast jemi përpara ushtrimit të aktivitetit, të cilit nuk do ti miratohej aplikimi për licencim. Në përfundim komisioni vlerëson se gjoba e vendosur nuk është proporcionale e për rrjedhojë jo e ligjshme.
-Lidhur me gjobën e vendosur për gjurmueshmërinë, për mungesën e dokumentacionit shoqërues të produktit mocarela prej 5 kg, që tregëtonte subjekti. Komisioni shprehet se etiketimi i produkteve nuk lidhet drejtëpërdrejtë me gjurmueshmërinë. Pvarsisht faktit se në mungesë të etiketimit nuk mundësohet gjurmimi i produktit, masa administrative e aplikuar nga inspektorët nuk gjenë mbështetje në ligj. Në lidhje me gjobën e vendosur për gjurmueshmërinë, komisioni vlerëson se ajo do të aplikohet në të gjitha rastet kur subjekti nuk disponon një sistem gjurmueshmërie për të gjitha produktet e tij ose në rastin kur ky sistem është i paplotë dhe nuk mundëson gjurmimin e produkteve në çdo kohë sipas datës së skadencës, numrit të lotit, etj. Duke vlerësuar edhe provat e paraqitura nga subjekti, rezulton se ai disponon një sistem gjurmueshmërie, në të cilin pasqyrohet i gjithë informacioni. Sa më sipër komisioni çmon se masa e marrë për gjurmueshmërinë nuk është e justifikuar si dhe nuk është proporcionale.
-Lidhur me gjobën e vendosur për mungesën e etiketave në gjuhën shqipe, theksojmë se produktet

që nuk kanë patur etiketë në gjuhën shqipe, nuk janë gjetur në rafte për tregëtim, dhe se gjoba e vendosur nuk i përgjigjet gjetjes së konstatuar. Në këto kushte grupi i inspektimit ka gabuar në marrjen e masës administrative për mungesën e etiketës.
-Lidhur me produktet jashtë afatit të skadencës, theksojmë se pala ankuese ka parashtruar faktin se ka marrë masa për nxjerrjen jashtë tregut të këtyre produkteve. Subjekti pretendon se ka njoftuar furnitorin për ti kthyer/zëvendësuar artikujt që ishin afër datës së skadencës, 30 ditë para se këtyre produkteve tu kalonte afati. Këtu i referohemi kontratës së subjektit me furnitorin, ku përcaktohet si detyrim se produktet që janë afër afatit të skadencës duhet ta njoftojë furnitorin 30 ditë përpara se ato të skadojnë. Nga sa më lart komisioni vlerëson se, ndërsa palët nuk kanë përcaktuar në kontratë mënyrën e njoftimit, atëherë njoftimi do të konsiderohet i kryer nga subjekti A. Në këto rrethana, komisioni vlerëson se subjekti i ka përmbushur detyrimet që ja ngarkojnë aktet ligjore në fuqi.
-Lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, theksojmë se nga grupi i inspektimit, nuk është zbatuar. Në vlerësimin e rrethanave të kryerjes së kundërvajtjes, komisioni vëren se produktet e konstatuara në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi nuk kanë cenuar sigurinë ushqimore.
Në përfundim komisioni vlerëson se akti administrativ i inspektimit, është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, nuk është proporcional dhe në përputhje me nevojën që e ka diktuar atë, dhe vlerësohet i paligjshëm".
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohen veprimet e inspektorëve, pra bllokimi i produkteve dhe vendosja e shenjave dalluese të bllokimit të tyre;
-Nuk është përcaktuar afati për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, si dhe për asgjesimin e produkteve të bllokuara;
-Nuk dokumentohet destinacioni i produkteve të bllokuara;
-Nuk është respektuar proporcionaliteti i vendosjes së gjobave;
-Ankesa e bërë nga subjekti ndaj gjobës së vendosur, nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor;
-Arsyetimi i bërë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë DPAKU-së, nuk ka mbështetje ligjore, është subjektiv dhe jo objektiv, për arsye se:
-Subjekti ushtron aktivitet që në vitin 2016 dhe është përgjegjësi e tij që të informohet për detyrimet ligjore që duhet të respektojë, kjo në rastin e pajisjes me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Në inspektimin e mësipërm, nuk jemi në rastin kur inspektorët kanë shkuar për të verifikuar kushtet në të cilat ushtron aktivitet subjekti, sipas konkluzionit të komisionit, i cili shprehet se subjekti plotëson kushtet për licencim dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte vendosur masë administrative.
-Lidhur me proporcionalitetin e gjobës së vendosur, **grupi i auditimit e gjykon të bazuar në ligj, arsyetimin e bërë nga komisioni,** i cili vlerëson se është vendosur masa maksimale dhe jo ajo minimale, ku sipas përcaktimit ligjor, gjoba për mungesën e licencës është 1,000,000 lekë – 2,000,000 lekë, por nuk e gjykon si të bazuar në ligj shfuqizimin e plotë të gjobës. Pra sipas arsyetimit të komisionit, në një rast të tillë, duhej bërë ndryshimi i masës së gjobës dhe jo shfuqizimi i saj, sepse në këtë mënyrë është pranuar ti falet shkelja subjektit.
-Sa i përket gjurmueshmërisë, inspektorët kanë konstatuar se produkti mocarela prej 5 kg nuk ka dokumentacion shoqërues (pra nuk respektohet gjurmueshmëria), dhe në këtë rast, sipas përcaktimeve ligjore ndaj subjektit duhet të vendoset masë administrative. Referuar arsyetimit të bërë nga komisioni, grupi i auditimit gjykon se ai është i gabuar, pasi gjurmueshmëria duhet të jetë për çdo produkt që tregëtohet nga subjekti. Gjithashtu theksojmë se, për produktin mocarela, grupi i inspektimit është shprehur për mungesën e dokumentacionit shoqërues dhe jo për etiketën, arsyetim të cilin e përdor komisioni për të shfuqizuar gjobën.
-Lidhur me mungesën e etiketës në gjuhën shqipe të disa produkteve, theksojmë se në procesverbalin e inspektimit, thuhet qartë se produktet, të cilat nuk kanë patur etiketë në gjuhën

shqipe, janë në raftet e supermarketit dhe jo në magazinën e tij, siç arsyeton komisioni, me qëllim shfuqizimin e gjobës. Edhe në rastin se këto produkte do të ishin në magazinën e tij, përsëri ato duhet të ishin të pajisura me etiketë në gjuhën shqipe, për arsye se kush e garanton komisionin, se nëse produktet janë në një ambjent tjetër dhe jo të reklamuara, ato nuk do të shiten nga subjekti?
-Lidhur me produktet që ishin të skaduara, grupi i inspektimit i ka gjetur ato në raftet e supermarketit, dhe arsyetimi i bërë nga komisioni, i cili duket sikur vlerëson kushtet kontraktuale të subjektit me furnitorët e tij, dhe jo respektimin e kërkesave ligjore të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, nuk është i mbështetur në ligj, për arsye se subjekti ka përgjegjësi ligjore për çdo produkt ushqimor që tregëton, për cilësinë dhe sigurinë e tij, ku një nga këta element është edhe tregëtimi i produkteve brenda afatit të përdorimit të tyre, dhe në këtë rast minimalisht këto produkte, që u ka kaluar afati i përdorimit, duhet të ishin hequr nga raftet, të paketoheshin dhe ruheshin në një ambjent të veçantë, dhe jo të pritet që furnitori i tij t'i tërheqi ato nga tregu dhe ti zëvendësojë me të tjera.
-Theksojmë se edhe konkluzioni i komisionit se produktet e gjetura jashtë afatit të përdorimit, nuk kanë cenuar sigurinë ushqimore, është plotësisht subjektiv, për arsye se që të dalësh në një konkluzion të till, minimalisht duhet të vlerësohen produktet nëpërmjet analizës laboratorike, dhe jo me fjalë.

- Sa më sipër grupi i auditimit gjykon dhe vlerëson se, **një praktikë e tillë e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve, nuk mbron interesat e konsumatorit për një ushqim cilësor dhe të sigurt,** por përkundrazi, si dhe në këtë mënyrë dëmtohet konkurrenca e ndershme në treg.
- Gjithashtu aplikimi i vlerës maksimale të gjobës nga inspektorët, **e rëndon pozitën financiare të subjektit, dhe mund të sjelli edhe pasoja të tjera sociale ose shëndetësore** ndaj personit që administron ose që e ka në pronësi aktivitetin.

Për sa më sipër (për praktikën e shqyrtimit të ankimit dhe faljen e gjobave të vendosura) mbajnë përgjegjësi ligjore z.R.L, Kryetar i komisionit, z.B.K, zj.A.K, zj.I.A dhe zj.A.H, si dhe inspektorët z.G.H, zj.M.B, z.D.D, z.E.M, për mangësitë e konstuara në praktikën e inspektimit.

21.Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-005595-1, datë 03.09.2019, të subjektit B, me aktivitet prodhim brumi, Rruga Shaban Gardhoshi. Inspektorët e autorizuar: M.H, M.C dhe J.K. Ky inspektim është iniciuar mbi bazën e një ankese të ardhur nëpërmjet email-it nga DPAKU, konkretisht: "Në vijim gjeni denoncimin në lidhje me vazhdimin e ushtrimit të aktivitetit "Prodhime brumi" nga subjekti R i pezulluar më herët nga ana juaj, por tashmë me një tjetër NIPT:L92014020Q (B) dhe adresë të re: Rruga Shaban Gardhoshi".

- Listë-verifikimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-005595-1, datë 03.09.2019, ku pasqyrohet informacioni:

-Subjekti s'ka licencën përkatëse për ushtrimin e aktivitetit;
-Mungon dokumentacioni vërtetues i kryerjes së dezinfektimit të ambjentit;
-Mungon regjistrimi i monitorimit të temperaturave;
-Mungon sistemi i vetëkontrollit HACCP;
-Mungon gjurmueshmëria;
-Mungojnë etiketat e produktit ushqimor;

- Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2019-005595-1, datë 03.09.2019, ku janë pasqyruar shkeljet e mësipërme dhe janë vendosur masat administrative, si vijon:

-2,000,000 lekë për mungesën e licencës;
-200,000 lekë për mungesën e HACCP;
-200,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë;
-200,000 lekë për mospërmbushjen e përgjegjësive të operatorit;
-100,000 lekë për etiketimin e produkteve në gjuhën shqipe;
Pra në total 2,700,000 lekë.

▪ Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente me nr.AKU-TR-2019-005595-2, datë 03.09.2019, ku është bërë bllokimi i linjës së prodhimit të produkteve të brumit deri në pajisjen me licencë. Gjithashtu bllokimi i produktit gjysëm të gatshëm briosh në sasinë 300 cope * 10 gr/cope = 3 kg.

▪ Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-005595-1, datë 03.09.2019, ku pasqyrohen gjobat e vendosura, dhe korrigjimi i shkeljeve: Pajisja me licencë, zbatimi i planit HACCP, përgatitja e sistemit të gjurmueshmërisë, etiketimin e produkteve, kryerja e analizës së ujit për ngarkesën mikrobiale dhe kryerjen e dezifenktimit.

▪ Ndaj vendimit të inspektimit subjekti ka bërë ankim në DPAKU, me shkresën nr.6584 prot., datë 16.09.2019, dhe Komisioni i shqyrtimit të ankesave me Vendimin nr.02, datë 06.02.2020 ka shfuqizuar vendimit përfundimtar të inspektimit.

▪ Arsyetimi i Komisionit në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

-"Lidhur me gjobën për mungesën e licencës për ushtrimin e aktivitetit, licenca është akt administrativ që i njeh të drejtën titullarit të fillojë të ushtrojë aktivitetin dhe është detyrim i çdo subjekti të pajiset me licencë. Në rastin e subjektit B, si një subjekt i ri, sipas ekstraktit të QKB, nuk ka detyrim për tu licencuar pa filluar ushtrimin e aktivitetit, pasi xhiroja e tij vjetore nuk mund të llogaritet paraprakisht. Një fakt i tillë e bën të pamundur evidentimin e detyrimit të subjektit për tu licencuar ose jo në zbatim të nenit 19 të VKM nr.538, datë 26.05.2009.

-Lidhur me gjobën e vendosur për planin HACCP. Komisioni shprehet se mosdisponimi i tij përbën shkelje të nenit 26 të Ligjit të ushqimit dhe Udhëzimit nr.20, datë 25.11.2010 të Ministrit të Bujqësisë. Fakti që B ka paraqitur pranë komisionit manualin e autokontrollit, nuk provon që ai e ka disponuar atë gjatë kryerjes së inspektimit.

-Lidhur me mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë, ku është konstatuar mungesa e regjistrave ku pasqyrohet informacioni mbi hyrjen e lëndës së parë, vlerësojmë se këto mangësi janë të bazuara në ligj dhe në prova.

-Lidhur me etiketimin, theksojmë se produkti kur ofrohet tek konsumatori i fundit i paambalazhuar, për shitje direkte, atëherë mënyra e etiketimit të tij do të rregullohet me një akt ligjor të posacëm, i cili ende nuk është miratuar. Në këto kushte nuk mund të vendoset gjobë për një shkelje të tillë.

-Lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, theksojmë se nga grupi i inspektimit, nuk është zbatuar. Në vlerësimin e rrethanave të kryerjes së kundërvajtjes, komisioni vëren se subjekti është inspektuar për herë të parë, si dhe produktet e konstatuara në kundërshtim me përcaktimet ligjore nuk kanë cenuar rëndë sigurinë, ç'ka në rast të kundërt do të legjitimonte marrjen e masës administrative, gjobë, në vlerën maksimale.

Në përfundim komisioni vlerëson se akti administrativ i inspektimit, është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, nuk është proporcional dhe në përputhje me nevojën që e ka diktuar atë, dhe vlerësohet i paligjshëm".

Në praktikën e mësipërme konstatohet se:

-Nuk dokumentohen veprimet e inspektorëve, pra bllokimi i linjës së prodhimit dhe i produkteve dhe vendosja e shenjave dalluese të bllokimit të tyre;

-Nuk është përcaktuar afati për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara;

-Ankesa e bërë nga subjekti ndaj gjobës së vendosur, nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor;

-Arsyetimi i bërë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë DPAKU-së, nuk ka mbështetje ligjore, është subjektiv dhe jo objektiv, për arsye se:

-Si fillim masat administrative në këtë rast janë marrë ndaj subjektit dhe jo ndaj individit, ç'ka do të thotë se ky subjekt ka ushtruar aktivitet, për një periudhe prej rreth 7 vite (konfirmuar nga DRAKU Tiranë dhe nga verifikimi i ekstraktit në QKB, të NIPT-it: L22002009H, në pronësi të shtetasit G.R, i cili më pas ia ka shitur shtetasit B), pra ky subjekt nuk është i ri në treg.

-Gjithashtu vlenë të theksojmë se për këtë subjekt ka patur edhe një ankesë të mëparshme, nga banorët e zonës përreth.

-Arsyetimi i bërë nga komisioni se ky subjekt është pagues i taksës vendore (veprim i cili nuk dokumentohet) dhe për këtë nuk duhet të pajiset me licencë si dhe nga inspektorët nuk është verifikuar xhiroja e subjektit, për të vlerësuar nëse duhet të ketë licencë apo jo, **nuk qendron.** Grupi i auditimit thekson se licenca jepet për llojin e aktivitetit dhe jo për xhiron e aktivitetit të tij, pra në momentin që ky subjekt ka si aktivitet prodhimin dhe tregëtimin e produkteve ushqimore, ai ka detyrimin që të pajiset me licencë, dhe këtu i referohemi Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Ligjit të ushqimit, të cilët e përcaktojnë qartë se ndaj një aktiviteti të tillë, duhet të bëhet verifikimi i kushteve higjenike, teknologjike (linja e prodhimit), drejtuesit teknik (certefikatës dhe njohurive të tij);
-Sa i përket gjurmueshmërisë, inspektorët kanë konstatuar se subjekti nuk ka regjistrin për lëndët e para që hyjnë në subjekt, fakt të cilin e ka cituar edhe vetë komisioni, që këto shkelje të subjektit janë të mbështetura në ligj dhe në prova, dhe ndërkohë komisioni i ka shfuqizuar.
-Lidhur me etiketimin e produkteve, theksojmë se këto produkte nuk janë shitur tek konsumatori final, por tek subjekte të tjera të cilat i tregëtojnë tek konsumatori final, dhe arsyetimi i bërë nga komisioni nuk qendron.
-Lidhur me proporcionalitetin e gjobës së vendosur, **grupi i auditimit gjykon se** në këtë rast komisionit i lind e drejta dhe detyrimi që të ndryshonte vlerat e gjobave, por jo shfuqizimin plotësisht të tyre.
Theksojmë se edhe konkluzioni i komisionit se produktet e gjetura, nuk kanë cenuar rëndë sigurinë ushqimore, është plotësisht subjektiv dhe jo në përputhje me qëllimin e Ligjit të ushqimit, pasi sipas komisionit, duhet që të cenohet rëndë siguria e shëndetit që të vendosen masa administrative.
▪ Sa më sipër grupi i auditimit gjykon dhe vlerëson se një praktikë e tillë e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve, **nuk mbron interesat e konsumatorit për një ushqim cilësor dhe të sigurt**, por përkundrazi, si dhe në këtë mënyrë dëmtohet konkurrenca e ndershme në treg.
Për sa më sipër (për praktikën e shqyrtimit të ankimit dhe faljen e gjobave të vendosura) mbajnë përgjegjësi ligjore z.R.L, Kryetar i komisionit, z.B.K, zj.A.K, zj.I.A dhe zj.A.H, si dhe inspektorët zj.M.H, zj.M.C dhe z.J.K, për mangësitë e konstuara në praktikën e inspektimit.

22.Në inspektimin e subjektit K, , vendndodhje Fshati Domje, Rruga Frashnjet, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: G.H dhe D.D.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001222-1, datë 28.02.2019, firmosur nga M.M, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001222-1, datë 28.02.2019, ku nuk pasqyrohet informacioni mbi orën kur ka nisur dhe ka përfunduar inspektimi, por kohëzgjatja e inspektimit pasqyrohet në orën 00:00 – 00:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se asgjesimi nuk u krye për arsye se subjekti nuk kishte marrë masat përkatëse (mungonte mjeti i duhur për shkatërrimin fizik të produkteve dhe mungonin inspektorët e tatimeve).
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001222-1, datë 28.02.2019.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nga inspektorët nuk është kryer verifikimi fizik i produkteve që do të asgjesohen, me qëllim vlerësimin nëse ata përputhen me listën e produkteve të dërguara në kërkesën e subjektit për asgjesim;
-Arsyetimi se asgjesimi nuk u krye për shkak se mungonin inspektorët e tatimeve nuk qendron,

pasi në mbështetje të pikës 2/v të nenit 58 të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", personi mund ta kryejë procedurën e asgjesimit, nëse inspektorët e tatimeve nuk paraqiten brenda afatit të njoftimit;
-Arsyetimi se mungonte makina për shkatërrimin fizik të produkteve nuk qendron, sepse përderi sa subjekti e ka njoftuar vetë DRAKU Tiranë, për kryerjen e asgjesimit, llogjikisht i ka marrë masat për kryerjen e këtij procesi;
-Nga inspektorët nuk është përcaktuar një afat konkret, me qëllim detyrimin e subjektit për kryerjen e asgjesimit, pasi nuk mund të lihet në dëshirë të tij për të vendosur se kur duhet të kryejë procedurën, për arsye se janë produkte ushqimore, dhe në çdo kohë ekziston rreziku që t'i vendosi në treg.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.G.H dhe z.D.D.

23.Në inspektimin e subjektit K, , vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: G.H dhe D.D.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001379-1, datë 07.03.2019, firmosur nga M.M, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001379-1, datë 08.03.2019, ku nuk pasqyrohet informacioni mbi orën kur ka nisur dhe ka përfunduar inspektimi, por kohëzgjatja e inspektimit pasqyrohet në orën 00:00 – 00:00, si dhe jepet informacioni se inspektimi zgjati 6 orë. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar kërkesës së subjektit me nr.754 prot., datë 04.03.2019, për kryerjen e asgjesimit, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit. U krye verifikimi fizik i produkteve që do të asgjesoheshin dhe përputheshin me produktet e pasqyruara në listën e subjektit për asgjesimin e tyre, bashkangjitur kërkesës. Gjatë procedurës së asgjesimit ishin të pranishëm inspektorët e tatimeve si dhe të mjedisit. U krye shkatërrimi fizik i produkteve me mjetet me targa AA359TA dhe AA781VE, si dhe sperkatje me detergjent. Sasia e asgjesuar 52.18 ton me vlerë 16,835,993 lekë, u dërgua në landfillin e sharës.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001379-1, datë 07.03.2019.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit kërkesa e subjektit dhe lista me produktet që do të asgjesohen.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Sasia e deklaruar në listën bashkëlidhur kërkesës së subjektit për asgjesim nuk përputhet me sasinë e deklaruar nga inspektorët në procesverbalin e inspektimit, konkretisht sipas dokumentit të subjektit sasia është 2,529.13 kg ndërkohë sipas inspektorëve janë asgjesuar 52.18 ton ose 52,180 kg;
-Në praktikën e mësipërme nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sh), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Nuk administrohet kontrata e shërbimit ndërmjet subjektit Kosmote foods (gjeneruesi i mbetjeve) dhe subjektit, i cili do të kryejë procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve, në landfillin e Sh;

-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;
-Nuk dokumentohet me foto ngarkimi i produkteve në mjetet e mësipërme dhe dërgimi i tyre në landfillin e Sh;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.G.H dhe z.D.D.

24.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: M.H inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, M.C inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, Sh.K inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore, N.M inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore si dhe V.Ll inspektor në DPAKU.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002774-1, datë 15.05.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori S.S, nga ankesa e ardhur nga konsumatori, për produktin yndyrë vegjetale e cila tregëtohej si gjalp. Produkti është importuar nga K dhe është blerë në një supermarket, i cili është furnizuar nga K. Mbi bazën e kësaj ankese është inciuar inspektimi në K, me qëllim verifikimin e gjurmueshmërisë, importit, por edhe të kushteve të higjienës, etj.
-Kërkesë për shtyrje të afatit të autorizimit nr.AKU-TR-2019-002774-9, datë 16.05.2019, deri më datë 17.05.2019, për shkak të ngarkesës së inspektimit, miratuar nga ish Kryeinspektori S.S.
-Listë-verifikimi nuk administrohet në praktikën e inspektimit;
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002774-2, datë 17.05.2019, ku pasqyrohen shkeljet e kuadrit ligjor, për etiketimin, importin, përgjegjësitë e operatorit. Gjithashtu ndaj subjektit për shkeljen e kërkesave ligjore janë vendosur 3 gjoba në vlerën 2,300,000 lekë (2,000,000 lekë për importin + 100,000 lekë për etiketimin + 200,000 lekë për përgjegjësitë e operatorit). Procesverbali i firmosur nga grupi i inspektimit dhe jo edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i DPAKU zj.V.Ll.
-Vendimi i ndërmjetëm i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002774-4, datë 17.05.2019, ku është bërë bllokimi i sasisë 45 ton të produktit, i cili do të qendrojë i bllokuar në dhomat frigoriferike të subjektit deri në rietiketimin e tij.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002774-5, datë 17.05.2019, ku pasqyrohen masat administrative, tërheqja e produkteve të shitura si gjalp ndërkohë që është yndyrë vegjetale për rietiketimin e tyre, si dhe rietiketimin e sasisë 45 ton që u gjet gjendje në subjekt, brenda datës 24.05.2019 dhe të njoftoj DRAKU Tiranë, për korrigjimin e shkeljeve.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit, 2 praktika të importit dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, shitjet e bëra nga subjekti, ankesa.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Dokumentet e administruara për praktikat e importit dhe dokumentet shoqëruese të tyre (invoice, packing list, certifikata veterinare e lëshuar në Ukrainë, certifikata e analizave laboratorike), të cilat janë marrë nga grupi i inspektimit **janë fotokopje dhe pa nënshkrimin e përfaqësuesit dhe vulën e subjektit Kosmonte Foods.**
-Nuk janë mbajtur akt-kontrollet nga inspektorët e PIK-ut Qafë Thanë, por janë lëshuar dokumente veterinare, të cilat lëshohen në rastet kur produkti është me origjinë shtazore, dhe në këtë rast nuk është.
-Certifikatat e analizave laboratorike të dy praktikave të importit, **janë fotokopje,** pa emër dhe mbiemër të titullarit të laboratorit, **pa vulën e laboratorit,** por vula e vendosur në këto certifikata

është e kompanisë prodhuese të produktit, konkretisht A LTD, kompani e cila nuk ka laborator të akredituar për kryerjen e analizave për ushqime[15], ç'ka do të thotë se çertefikatat nuk janë të sakta në formë dhe përmbajtje, janë fiktive, duke krijuar dyshim mbi vërtetësinë e tyre. Gjithashtu dokumentet janë në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën Shqipe.

-Sa më sipër nuk duhej të lejohej hyrja në Shqipëri e produkteve të dy importeve të kryera sipas datave 14.01.2019 dhe 29.04.2019, por nga inspektorët e PIK-ut në Qafë Thanë janë lëshuar dokumentet veterinare për dy importet, përkatësisht dokumenti nr.33, datë 14.01.2019 për importin e kësaj date dhe dokumenti nr.508, datë 29.04.2019, për importin e dytë;

-Praktika e dytë e importit ka mangësi në dokumentacionin e saj, konkretisht në importin e datës 30.04.2019, nga K, është importuar nga shitësi D LTD 26, produkti yndyrë vegjetale (e prodhuar nga A LTD) në sasinë 21,000 kg neto (pra pa përfshirë peshën e paketimit). Produktet e importuara janë 3 grupe, si vijon:

1.B.V.C-yndyrë totale 82% përfshirë 25% yndyrë qumështi në paketime 5 kg/pako, në sasinë 2500 kg, prodhuar më datë 15.04.2019 – skadon më datë 15.04.2021;

2.B.V.Z-yndyrë totale 82% përfshirë 0.6% yndyrë qumështi, në paketime 5 kg/pako, në sasinë 4500 kg, prodhuar më datë 15.04.2019 – skadon më datë 15.04.2021;

3. B.V.Z-yndyrë totale 82% përfshirë 0.6% yndyrë qumështi, në paketime 25 kg/pako, në sasinë 560 kg, prodhuar më datë 15.04.2019 – skadon më datë 15.04.2021;

-Certefikata e analizës laboratorike nr.240419/1-1 për produktin e parë, nuk i përket atij, pasi të dhënat në certefikatë nuk përputhen me të dhënat e produktit, konkretisht produkti përban yndyrë totale 82% përfshirë 25% yndyrë qumështi, ndërkohë në certefikatë pasqyrohet yndyrë totale 82% përfshirë 0.6% yndyrë qumështi, pra për sasinë 2500 kg të produktit nuk është bërë kontrolli cilësor i saj;

-Nga grupi i inspektimit nuk është pasqyruar plotësisht gjurmueshmëria e produktit në subjekt, konkretisht sipas informacionit të pasqyruar: Në subjekt janë gjendur:

1.B.V 82% yndyrë totale përfshirë 3.6% yndyrë qumështi, me datë prodhimi 06.12.2018 – skadence 06.12.2020, për të cilin nuk pasqyrohet sasia e furnizuar dhe sasia e shitur. Gjithashtu nuk administrohet praktika e importit të këtij produkti.

3.B.V.C 82% yndyrë totale përfshirë 25% yndyrë qumështi, me datë prodhimi 15.11.2018 – skadence 15.11.2020, për të cilin nuk pasqyrohet sasia e furnizuar dhe sasia e shitur. Gjithashtu nuk administrohet praktika e importit të këtij produkti.

Të gjitha produktet e mësipërme, të cilat janë yndyrë vegjetale, janë shitur nga K si gjalp.

-Vendimmarrja e grupit të inspektimit nuk është e saktë konkretisht: Referenca ligjore shkronja ç e pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", përdorur për bllokimin e produktit yndyrë vegjetale, nuk është zbatuar siç duhet pasi sipas kësaj reference produkti bllokohet dhe administrohet në ambjentet e institucionit që ka konstatuar kundërvajtjen administrative, veprim i cili nuk është bërë, pasi produkti është bllokuar dhe është lënë në ambjentet e subjektit;

-Masa e lënë për rietiketimin e ushqimit nuk ka bazë ligjore, pra në asnjë përcaktim në Ligjin e ushqimit si dhe në VKM nr.1344, datë 10.10.2008[16], nuk thuhet se në rastet kur etiketa përmban informacion të gabuar, ajo duhet të rietiketohet. Nëse do të marrim në konsideratë intepretimin e bërë në pikën 1/b të nenit 11, ku një ushqim është i pasigurt, në rastin kur informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë (rasti i mësipërm) ose informacione të tjera, të vlefshme për të, për parandalimin e efekteve të dëmshme specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh, dhe në këtë rast sipas përcaktimit të bërë në

[15] Sipas verifikimit të bërë nga grupi i auditimit në listën e laboratorëve testues të akredituar në Ukrainë, publikuar në faqen zyrtare të institucionit National Accreditation Agency of Ukraine (Agjencia Kombëtare e Akreditimit, Ukrainë).
[16] VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "për etiketimin e produkteve ushqimore".

pikën 1 të nenit 24 dhe nenit 69 të Ligjit për ushqimin, ky produkt ushqimor duhet të hiqet nga tregu, të bllokohet dhe të asgjesohet, dhe jo të rietiketohet, ose inspektorët mund të kishin marrë mostër për analizë laboratorike, për të vlerësuar nga ana shkencore, cilësinë dhe sigurinë e produktit, por as ky veprim nuk është kryer.
-Në këtë rast produkti duhej të bllokohej, të merrej në administrim nga inspektorët dhe të ruhej në ambjentet e institucionit, si dhe të lihej detyrimi që ky produkt të asgjesohet brenda një afati të caktuar;
-Grupi i inspektimit duke lënë si detyrë për subjektin, që të tërheqë nga tregu sasinë e shitur dhe bashkë me ato të bëjë edhe rietiketimin e sasisë gjendje 45 ton, ka ligjëruar cilësinë e produktit **B.V.C-yndyrë totale 82% përfshirë 25%, në sasinë 2,500 kg,** i cili praktikisht nuk ka certifikatën e analizës laboratorike, pra edhe cilësia e tij nuk është e garantuar.
-Gjithashtu konstatohet se gjoba e vendosur nuk është arkëtuar akoma, si dhe ankimi i bërë nga subjekti më datë 25.06.2019, nuk është shqyrtuar nga komisioni i ngritur në Ministrinë e Bujqësisë, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 2,300,000 lekë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.Sh.K, zj.M.H, z.N.M dhe zj.M.C, si dhe z.A.H, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së deri në Tetor të vitit 2019, z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së Tetor 2019-Tetor 2020 si dhe z.B.S, Drejtori i Përgjithshëm në detyrë, i cili nuk i ka përcjellë komisionit në Ministri të Bujqësisë, ankesën e bërë nga subjekti. Gjithashtu mbajnë përgjegjësi inspektorët e PIK-ut në Qafë Thanë, z.F.M për importin e datës 29.04.2019 dhe z.R.M për importin e datës 14.01.2019.

25. Kjo praktikë e gabuar është ndjekur edhe në vazhdim nga DRAKU Tiranë, ku nëpërmjet inspektimit të këtij subjekti, me grup inspektimi Z.C dhe E.C, sipas autorizimit nr.AKU-TR-2019-006160-1, datë 27.09.2019, firmosur nga S.S, me kërkesë të subjektit, është bërë zhbllokimi i sasisë 40 ton, me argumentin se është bërë notifikimi i etiketës.
Për më tepër, që detyrimi i notifikimit të etiketës, nuk ishte lënë në inspektimin e mëparshëm. Theksojmë se ky është një produkt importi, dhe informacioni i tij jepet në gjuhën shqipe në etiketën origjinale ose në kundëretiketë[17], pra nuk duhet të bëhet notifikimi i etiketës, veprim të cilin VKM nr.1344, datë 10.10.2008, nuk e parashikon në asnjë përcaktim ligjor. Për më tepër, në zbatim të përcaktimit ligjor të bërë në pikën 1 të nenit 12 të VKM nr.1344, datë 10.10.2008, informacioni që deklarohet në etiketë, duhet që ta shoqërojë produktin ushqimor, të cilit i referohen ose të dërgohen paraprakisht apo njëkohësisht me dërgesën e tij, dhe kjo duhet të garantohet nga operatori i biznesit, gjë e cila nuk është bërë.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-006160-1, datë 27.09.2019.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006160-2, datë 27.09.2019. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se sipas kërkesës së subjektit me nr.3540 prot., datë 17.09.2019 për zhbllokim të produkteve të bllokuara në inspektimin e datës 17.05.2019, u krye verifikimi dhe në subjekt (dhomën frigoriferike) u gjend sasia prej 45 ton. Gjithashtu në subjekt u gjendën 40 kg nga produkti yndyrë vegjetale e cila është përdorur për kryerjen e analizave laboratorike (autokontroll, pra nga vetë subjekti) e cila është e papërdorshme, si dhe sasia prej 587.06 kg, e cila është kthyer nga subjektet, por është e papërdorshme, sepse është hapur nga klientët, dhe do të qëndrojë e bllokuar deri në marrjen e masave për asgjesimin e tyre. Sasia prej 45 ton e cila është notifikuar sipas shkresës nr.2614/2 prot., datë 26.07.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë, S.S, është zhbllokuar.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006160-5, datë 27.09.2019, ku nuk pasqyrohet asnjë masë.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:

[17] VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "për etiketimin e produkteve ushqimore".

-Si fillim nga inspektorët duhet të ishte bërë konstatimi i shkeljes së moskorrigjimit brenda afatit nga subjekti, të detyrave të lëna në ispektimin e mëparshëm, për tërheqjen e produktit nga tregu, dhe duhet të ishte marrë masë administrative, veprim i cili nuk është bërë;
-Në praktikën e inspektimit pasqyrohet informacioni se janë kthyer 587 kg nga produkti, por nuk ka asnjë faturë kthimi, nuk ka fletë-hyrje në magazinën e K, për produktet e kthyera;
-Nuk ka asnjë dokument mbi njoftimin e bërë nga K, subjekteve të tjera, të cilat i ka furnizuar me produktet e mësipërme (butter vegetable), me qëllim tërhqjen nga tregu.
-Inspektorët nuk kanë vendosur një afat të caktuar për kryerjen e asgjesimit të produkteve, por e kanë lënë në dëshirë të subjektit;
-Nuk janë vendosur shenjat dalluese të bllokimit të produkteve ç'ka e bënë të pa realizuar plotësisht masën administrative të inspektorëve, dhe nuk garantohet, nëse subjekti do të tregëtojë nga ky produkt apo jo;
-Masa e zhbllokimit e marrë nga inspektorët nuk ka bazë ligjore, përkundrazi çdo ushqim i bllokuar që nuk plotëson kërkesat e Ligjit për ushqimin duhet të asgjesohet dhe jo të zhbllokohet.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Kryeinspektori z.S.S, si dhe inspektorët z.Z.C dhe z.E.C.

26.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: L.B dhe E.V.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006040-1, datë 23.09.2019, firmosur nga S.S, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006040-2, datë 24.09.2019. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar kërkesës së subjektit me nr.3534 prot., datë 16.09.2019, për kryerjen e asgjesimit, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit. U krye verifikimi fizik i produkteve që do të asgjesoheshin dhe përputheshin me produktet e pasqyruara në listën e subjektit për asgjesimin e tyre, bashkangjitur kërkesës. Gjatë procedurës së asgjesimit ishin të pranishëm inspektorët e tatimeve si dhe të mjedisit. U krye shkatërrimi fizik i produkteve me mjetet me targa AA631PB, BR4814B dhe AA202OV, sipas kontratës së shërbimit. Sasia e asgjesuar 62.75 ton me vlerë 16,460,562 lekë, u dërgua në landfillin e B.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006040-5, datë 24.09.2019.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit kërkesa e subjektit, lista me produktet që do të asgjesohen dhe disa foto.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Në praktikën e mësipërme nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e B), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Subjekti në kohën që është kryer procedura e transferimit të mbetjeve, nuk ka qenë i licencuar për kryerjen e transportit të tyre në landfillin e B. Licencën për kryerjen e transportit ai e ka marrë më datë 22.10.2019, sipas akt-miratimit nr.9040 prot., të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;

-Nuk dokumentohet me foto dërgimi i produkteve në landfillin e B. Theksojmë se në fotot e administruara në praktikën e inspektimit, janë disa produkte të paketuara, vendosur mbi paleta druri si dhe në disa prej tyre ngarkimi në automjet, por që nuk identifikohen targat e tij;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit dhe dërgimi i tyre në landfillin e B.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.L.B dhe z.E.V.

27.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: D.D, E.M dhe E.V.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-008799-1, datë 30.12.2019, firmosur nga A.N, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-008799-2, datë 30.12.2019. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar kërkesës së subjektit me nr.4750 prot., datë 23.12.2019, për kryerjen e asgjesimit, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit. U krye verifikimi fizik i produkteve që do të asgjesoheshin dhe përputheshin me produktet e pasqyruara në listën e subjektit për asgjesimin e tyre, bashkangjitur kërkesës. Gjatë procedurës së asgjesimit ishin të pranishëm inspektorët e tatimeve si dhe të mjedisit. U krye shkatërrimi fizik i produkteve me mjetet me targa AA725YY dhe TR4734R, sipas kontratës së shërbimit me subjektin Eco Empire. Sasia e asgjesuar 3.5 ton me vlerë 13,874,133 lekë, u dërgua në landfillin e B.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-008799-5, datë 30.12.2019.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit kërkesa e subjektit, lista me produktet që do të asgjesohen dhe disa foto.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Në praktikën e mësipërme nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e B), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;
-Nuk dokumentohet me foto dërgimi i produkteve në landfillin e B. Theksojmë se në fotot e administruara në praktikën e inspektimit, janë disa produkte të paketuara, vendosur mbi paleta druri si dhe në disa prej tyre ngarkimi në automjet;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit dhe dërgimi i tyre në landfillin e B.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.D.D, z.E.M dhe z.E.V.

28.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: S.L dhe G.H.

-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001698-1, datë 07.04.2020, firmosur nga A.N, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001698-1, datë 07.04.2020. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar kërkesës së subjektit me nr.551 prot., datë 03.04.2020, për kryerjen e asgjesimit, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit. U krye verifikimi fizik i produkteve që do të asgjesoheshin dhe përputheshin me produktet e pasqyruara në listën e subjektit për asgjesimin e tyre, bashkangjitur kërkesës. Gjatë procedurës së asgjesimit ishin të pranishëm inspektorët e tatimeve si dhe të mjedisit. U krye shkatërrimi fizik i produkteve me mjetet me targa AA725YY dhe TR4734R. Sasia e asgjesuar 48.5 ton me vlerë 13,153,682 lekë, u dërgua në landfillin e B.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-008799-5, datë 30.12.2019.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit lista me produktet që do të asgjesohen.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;
-Nuk dokumentohet me foto ngarkimi i produkteve në mjetet e mësipërme dhe dërgimi i tyre në landfillin e B;
-Në praktikën e mësipërme nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e B), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit dhe dërgimi i tyre në landfillin e B.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.S.L dhe z.G.H.

29.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: E.Sh dhe E.C.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004067-1, datë 25.06.2020, firmosur nga M.N, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004067-2, datë 25.06.2020. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar kërkesës së subjektit me nr.1010 prot., datë 17.06.2020, për kryerjen e asgjesimit, trupa inspektuese u paraqit pranë subjektit. Sasia e asgjesuar 45.5 ton me vlerë 9,263,477 lekë.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004067-2, datë 25.06.2020.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit lista me produktet që do të asgjesohen.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk pasqyrohet informacioni se me cilat mjete u bë shkatërrimi i produkteve;
-Nuk pasqyrohet informacioni se në cilin landfill u dërguan mbetjet;
-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;
-Nuk dokumentohet me foto procesi i asgjesimit të produkteve;
-Nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në

procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e B), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit dhe dërgimi i tyre në landfillin e B.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.E.Sh dhe z.E.C.

30.Në inspektimin e subjektit K, vendndodhje si më sipër, me aktivitet: "Tregtia me shumicë dhe pakicë e pemëve dhe perimeve. Tregtia me shumicë dhe pakicë e mishit dhe e produkteve të mishit. Tregtia me shumicë dhe pakicë e luleve dhe bimëve; restorante; magazinimi i mallit; veprimtaria e agjensive te tjera te transportit. Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshem nga legjislacioni në fuqi. Import-eksport, veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet., etj".
-Grupi i inspektimi: E.Sh dhe D.K.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001698-1, datë 07.04.2020, firmosur nga Eljon Cuci, me kërkesë të subjektit për asgjesim të produkteve.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk administrohet procesverbali i inspektimit;
-Nuk administrohet vendimi përfundimtar i inspektimit;
-Nuk dokumentohet fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj, si dhe ndryshimi i llogarisë së inventarit në pasqyrën financiare të aktiveve;
-Nuk dokumentohet me foto procesi i asgjesimit;
-Nuk administrohet dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e B), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Për sa më sipër nuk vërtetohet procedura e asgjesimit.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.E.Sh dhe z.D.K.

31.Në inspektimin e subjektit G, , vendndodhje Blloku i magazinave frigoriferike në rrugën dytësore pranë urës së Limuthit, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj
-Grupi i inspektimi: N.H, M.K
-Autorizimi i inspektimit firmosur nga F.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë.
-Procesverbali i inspektimit dhe vendimit përfundimtar nr., serial 0041491, datë 23.02.2018, ku pasqyrohet se:
-Ka vendndodhje të përshtatshme;
-Kushtet higjeno-sanitare të përshtatshme;
-Personeli i pajisur me librezë shëndetësore;
-Subjekti përdor uji rrjeti dhe ka kryer analizën bakterologjike;
-Subjekti disponon planin HACCP;
-Sistemi i gjurmueshmërisë funksionon;
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet plani HACCP;

-Nuk dokumentohet temperatura e dhomave frigoriferike për 3 frigorifer, nga të cilët 2 freskues dhe 1 ngrirës;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet certifikata D.D.D;
-Nuk dokumentohet inspektimi i mjeteve të transportit, me të cilat subjekti kryen shërbimin e transportit;
-Inspektimi nuk është kryer on-line.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.N.H, z.M.K dhe z.F.S, ish Kryeinspektori për periudhën në të cilën është kryer inspektimi, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";

32.Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Blloku i magazinave frigoriferike në rrugën dytësore pranë urës së Limuthit, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj
-Grupi i inspektimi: V.S dhe G.H.
-Autorizimi i inspektimit firmosur nga M.M, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë.
-Procesverbali i inspektimit dhe vendimit përfundimtar nr., serial 0041533, datë 17.05.2018, ku pasqyrohet se:
-Ka vendndodhje të përshtatshme;
-Kushtet higjeno-sanitare të përshtatshme;
-Personeli i pajisur me librezë shëndetësore;
-Subjekti përdor uji rrjeti dhe ka kryer analizën bakterologjike;
-Subjekti disponon planin HACCP;
-Sistemi i gjurmueshmërisë funksionon;
-Disponon planin D.D.D.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet plani HACCP
-Nuk dokumentohet temperatura e dhomave frigoriferike për 3 frigorifer, nga të cilët 2 freskues dhe 1 ngrirës;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet inspektimi i mjeteve të transportit, me të cilat subjekti kryen shërbimin e transportit;
-Nuk dokumentohet certifikata D.D.D;
-Inspektimi nuk është kryer on-line.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.V.S dhe z.G.H dhe zj.M.M, ish Kryeinspektori për periudhën në të cilën është kryer inspektimi, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";

33.Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje të njëtë si më sipër, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj
-Grupi i inspektimi: Sh.K dhe E.Sh.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2018-001436-1, datë 16.08.2018, ku nuk pasqyrohet emri dhe mbiemri i Kryeinspektorit, firma e tij dhe vula e institucionit.
-Listë-verifikimi i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002811-1, datë 16.08.2018, ku nuk pasqyrohen shkelje, si dhe nuk janë firmat e inspektorëve që kanë kryer inspektimin.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002811-2, datë 16.08.2018 , ku nuk pasqyrohen shkelje, firmat e inspektorëve dhe përfaqësuesit të subjektit.

-Vendimi përfundimtar i inspektimit, ku lihet detyrë që deri më datën 24.08.2018 subjekti të riparojë një pjesë të dyshemesë në hyrje të dhomës frigoriferike. Në vendimin e inspektimit mungojnë firmat e inspektorëve.
-Theksojmë se në ky inspektim është kryer me qëllim pjesëmarrjen e DRAKU Tiranë, në proçedurën e asgjesimit të disa produkteve dhe kjo proçedurë nuk është kryer, për arsye se subjekti nuk kishte marrë masat. Ky fakt nuk pasqyrohet në asnjë nga dokumentet standard të inspektimit, pra në autorizimin e inspektimit (objekti i tij), procesverbalin dhe vendimin përfundimtar të inspektimit.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet temperatura e dhomave frigoriferike për 3 frigorifer, nga të cilët 2 freskues dhe 1 ngrirës;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet inspektimi i mjeteve të transportit, me të cilat subjekti kryen shërbimin e transportit;
-Nuk dokumentohet certifikata D.D.D;
-Nuk janë firmosur dokumentet standard të procedurës së inspektimit.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.Sh.K dhe z.E.Sh

34.Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje të njëtë si më sipër, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: M.H dhe B.O, inspektor të sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002811-1, datë 06.06.2018, firmosur nga M.M, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë. Autorizimi është iniciuar mbi bazën e një ankese të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU, më datë 04.06.2018, për produktin djath, për praninë e vajit të palmës.
-Listë-verifikimi i inspektimit nuk administrohet në praktikën e inspektimit.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002811-2, datë 06.06.2018, ku pasqyrohet se është marrë mostër për analizë laboratorike nga produkti djah pice "L" në sasinë 2 shufra.
-Gjithashtu pasqyrohet informacioni se u krye inspektimi, ku rezultoi se subjekti importon dhe tregëton produkte të ambalazhuara, të cilat ruhen në kushte të përshtatshme frigoriferike me temperatura të monitoruara. Subjekti disponon dokumentacionin përkatës për produktet si dhe sistemin e gjurmueshmërisë. Gjatë inspektimit nuk u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore.
-Fletë-shoqërimi i mostrës për në laboratorin e ISUV, me nr.2381, ku pasqyrohet sasia prej 2 shufra/3.044 kg secila, ose 6.088 kg në total, për analizë të shtesave bimore të produktit djath. Në fletë shoqërimin e mostrës pasqyrohet refuzimi i pranimit të saj nga laboratori i ISUV, për arsye nuk përputhet me kriteret teknike të pranimit të kampionëve. Firmosur nga A.Ç. Refuzimi i pranimit të mostrës është pasqyruar edhe në procesverbalin e inspektimit.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002811-5, datë 06.06.2018, ku nuk pasqyrohen shkelje dhe masa administrative.
-Bashkangjitur certefikatat e sigurisë së importit dhe shitjet e bëra nga ky subjekt.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Mostra e produktit djath ngeli pa u analizuar dhe indicia e ngritur për këtë produkt nuk u shqyrtua deri në fund, pasi edhe pas refuzimit të analizës laboratorike të mostrës, nga zj.M.M ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për atë periudhë **nuk është marrë asnjë masë tjetër** (fillimisht ngarkimin me përgjegjësi ligjore të inspektorëve, dhe ngritjen e një grupi tjetër inspektimi për marrjen e mostrës sipas kritereve teknike), me qëllim analizimin e saj. Theksojmë këtu se ky subjekt është furnizuar me një sasi të konsiderueshme me djathin L, pra rreth 20 mijë kg, në dy

furnizime në datën 03.02.2018, dhe e ka shitur thuajse të gjithë sasinë në rreth 200 subjekte të tjera (përjashtuar **63 kg**, të cilat i kishte gjendje);
-Gjithashtu konstatohet se ankesa ka ardhur për një produkt me origjinë shtazore, ndërkohë autorizohen të bëjnë inspektimin dy inspektor të sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore;
-Në email-in e përcjellë nga z.K.T, më datë 04.06.2018, është cilësuar që inspektimi të bëhet brenda kësaj date, ndërkohë zj.M.M e ka nxjerrë autorizimin e inspektimit pas dy ditësh;
-Certefikatat e sigurisë së produktit djath L, bashkëlidhur praktikës së importit, janë në gjuhën polake dhe jo në gjuhën shqipe, një detyrim i përcaktuar në nenin 18 të Ligjit të ushqimit, **dhe ky fakt nuk duhet të anashkalohej nga inspektorët që kanë bërë inspektimin pranë këtij subjekti, të cilët duhet të kishin marrë masë administrative (minimalisht në vlerën 1,000,000 lekë, por që nuk e kanë bërë), por edhe nga inspektorët e pikës kufitare, prej nga ka hyrë produkti ushqimor.**
-Sistemi i gjurmueshmërisë nuk është kontrolluar plotësisht, pasi subjekti me produktin djath L 3kg/shufër, është furnizuar edhe më datë 27.11.2018 sipas deklaratës së importit R108687 me datë skadence 01.08.2018, dhe në datën 06.06.2018 që është kryer inspektimi, subjekti ka pasur gjendje nga ky produkt, konfirmuar kjo nga kërkesa e bërë nga subjekti G më datë 24.10.2018 në DRAKU Tiranë për asgjesimin e disa produkteve ushqimore, pjesë e të cilës është edhe produkti L me 3 data skadence: 01.08.2018; 09.10.2018 dhe 13.10.2018, ku vetëm për dy datat 09.10.2018; 13.10.2018, inspektorët kanë pasqyruar sistemin e gjurmueshmërisë.
▪ Sa më sipër grupi i auditimit arrin në konkluzionin se si pasojë e mosvperimeve të titullarëve dhe të inspektorëve të DRAKU Tiranë, **në këtë rast nuk është garantuar siguria dhe cilësia e produktit ushqimor.**
Për këtë mbajnë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektore e DRAKU Tiranë, e cila veç mosmarrjes së masave për analizimin e produktit, gjithashtu ka nxjerrë autorizimin e inspektimit dy ditë me vonesë, ka autorizuar kryerjen e inspektimit nga inspektor të një sektori tjetër dhe jo të atij që mbulon këtë fushë, si dhe inspektorët z.B.O dhe zj.M.H që nuk kanë marrë mostrën në përputhje me kriteret teknike të kampionimit, që nuk kanë kontrolluar plotësisht sistemin e gjurmueshmërisë, që nuk kanë marrë masë administrative ndaj subjektit për mungesën e certifikatave të sigurisë në gjuhën shqipe, përgjegjësi e cila bie edhe mbi inspektorët e pikës kufitare**.**

35. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje të njëtë si më sipër, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: A.N inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore dhe G.H, inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2018-004264-1, datë 09.11.2018, ku nuk pasqyrohet emri dhe mbiemri i Kryeinspektorit, firma e tij dhe vula e institucionit.
-Kërkesa e inspektorëve për shtyrje të afatit autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2018-004264-9, nga data 09.11.2018 në datën 12.11.2018, me arsye se në subjekt mungon personi përgjegjës për dokumentacionin.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2018-004264-1, datë 12.11.2018, ku pasqyrohet se dhomat frigoriferike kanë nevojë për sistemim dhe duhet të përditësohet në mënyrë sistematike rregjistri për monitorimin e temperaturave dhe rregjistri i pastrimit të mjeteve të transportit. Listë-verifikimi i pa firmosur nga inspektorët.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-004264-2, datë 12.11.2018, ku pasqyrohet se se dhomat frigoriferike kanë nevojë për sistemim dhe duhet të përditësohet në mënyrë sistematike rregjistri për monitorimin e temperaturave dhe rregjistri i pastrimit të mjeteve të transportit. Listë-verifikimi i pa firmosur nga inspektorët. Gjithashtu në subjekt u gjendën produkte me afat skadimi të kaluar, në sasinë 9,110 kg, të cilat mbahen në ambjent të veçantë dhe bashkangjitur tyre ishte

lista me të gjithë produktet, me shënimin për tu asgjesuar. Subjekti më datë 24.10.2018 me shkresën nr.3172 prot., ka bërë njoftim në DRAKU për kryerjen e asgjesimit të tyre, por procedura nuk është kryer për arsye të mungesës së inspektorëve të mjedisit. Gjithashtu pasqyrohet masa paralajmërim. Procesverbali i pa firmosur nga inspektorët dhe përfaqësuesi i subjektit.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-004264-5, datë 12.11.2018, ku jepet masa paralajmërim. Vendimi i pa firmosur nga inspektorët.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nga DRAKU Tiranë nuk është marrë asnjë masë për të marrë pjesë në procedurën e asgjesimit të produkteve ushqimore, sipas kërkesës së subjektit më datë 24.10.2018 me nr.3172 prot.,
-Nga inspektorët nuk është dokumentuar asnjë veprim, dokumentacion, mjet, produkt i inspektuar;
-Nuk ka asnjë foto të produkteve të cilat janë për tu asgjesuar apo verifikim të sasisë fizike të tyre në krahasim me listën e produkteve që ka nxjerrë jashtë përdorimit subjekti, me qëllim asgjesimin e tyre;
-Nga inspektorët nuk është dhënë asnjë masë administrative gjobë, për shkeljet të cilat kanë konstatuar, pasi mospërditësimi i temperaturave të mjeteve të transportit, me të cilat kryhet shpërndarja e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, është mosrespektim i kushteve të ruajtjes së zinxhirit ftohës në të gjitha fazat (prodhim, paketim, transportim, vendosje në treg të produkteve ushqimore), dhe për këtë shkelje ligji i ushqimit si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij[18] parashikon dënim admintrativ.
-Gjithashtu nga inspektorët nuk është marrë asnjë masë me qëllim bllokimin e produkteve që do të asgjesohen, me shënja dalluese, dhe vendosjen e afatit konkret për asgjesimin e tyre, pavarsisht se subjekti i ka veçuar ato, inspektorët kanë detyrimin ligjor që produktet të cilat janë dëmtuar ose u ka kaluar afati i skadimit të bëjnë bllokimin e tyre.
-Shtesa e afatit të autorizimit të inspektimit është bërë për një periudhë më tepër se kohëzgjatja fillestare, pra në autorizimin e parë inspektimi fillon dhe përfundon brenda datës 09.11.2018, pra gjysëm ditë, ndërkohë shtyrja e afatit është bërë nga data 09.11.2018 deri më datë 12.11.2018, ose me 3 ditë më tepër.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, si dhe inspektorët z.G.H dhe z.A.N.

36. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Blloku i magazinave frigoriferike në rrugën dytësore pranë urës së Limuthit, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj
-Grupi i inspektimi: Z.C dhe A.N.
-Autorizimi i inspektimit firmosur nga M.M, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, me objekt asgjesimin e produkteve ushqimore me kërkesë të vetë subjektit.
-Procesverbali i inspektimit dhe vendimit përfundimtar nr., serial 0042276, datë 19.11.2018, pra 10 ditë më pas nga inspektimi i mësipërm. Në procesverbalin e inspektimit pasqyrohet se: Asgjesimi i produkteve nuk u krye, për arsye se produktet që do të asgjesoheshin nuk ishin të ndara sipas llojit të tyre, paketimit.

[18] Udhëzim i MBUMK nr. 20, datë 25.11.2010 "Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore". Udhëzim i MBUMK nr. 21, datë 25.11.2010 "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore". Udhëzim i MBUMK nr. 22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor". Udhëzim i MBUMK nr. 23, datë 25.11.2010 "Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike".

Në praktikën e inspektimit konstatohet se:
-Përsëri vazhdon që të lihet në dëshirë të subjektit asgjesimi produkteve dhe jo të vendoset detyrimi për asgjesimin e tyre brenda afatit të caktuar, për më tepër kur një nga inspektorët, konkretisht A.N, ka qenë pjesë edhe e inspektimit të mëparshëm, në të cilin janë shprehur se produktet që do të asgjesohen janë grupuar dhe ndarë veç produkteve të tjera;
-Gjithashtu në këtë inspektim nuk ka asnjë foto për të dokumentuar mënyrën se si ishin grupuar produktet që do të asgjesohen, dhe nëse janë përsëri ato produkte, për të cilat është bërë kërkesa për asgjesimin e tyre, që në datën 24.10.2020;
-Theksojmë se ndarja e tyre bëhet në momentin që ato dërgohen për shkatërrim të tyre, trajtim termik, ose në landfillin përkatës për groposje, dhe kjo nuk është detyrë dhe e drejtë e inspektorëve për të bërë verifikimin dhe më pas të anullojnë asgjesimin, për arsye se produktet nuk janë të ndara sipas llojit të tyre;
▪ Nga sa më sipër, grupi i auditimit arrin në konkluzionin se ky subjekt është favorizuar nga inspektorët dhe kryeinspektorët e DRAKU Tiranë, të cilët kanë lënë në dëshirë të subjektit asgjesimin e produkteve ushqimore, **duke mos garantuar sigurinë e konsumatorit për këto ushqime, pasi në çdo moment subjekti mund t'i ripaketojë ato produkte që janë të dëmtuara dhe mund t'i tregëtojë.**
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, si dhe inspektorët z.Z.C dhe z.A.N.

37. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje të njëtë si më sipër, me aktivitet: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: S.L inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore dhe M.B, inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000862-1, datë 14.02.2019, firmosur nga M.M, me objekt zbatimin e legjislacionit në fuqi.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-000862-2, datë 14.02.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000862-2, datë 14.02.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000862-5, datë 14.02.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në datën 11.01.2019, ose 1 muaj më përpara se data e kryerjes së inspektimit, **subjekti ka bërë një ndryshim në adresën** e aktivitetit të tij (sipas verifikimit në QKB), konkretisht adresa e tij ishte: "Tirane; Kashar; Autostrada Tiranë - Durrës, Km 7, dy dhoma frigoriferike numër 5 dhe 7;
Dhe u bë:
"Tirane; Kashar; Autostrada "Tiranë - Durrës", Km 7, tre dhoma frigoriferike numer **1,** 7 dhe 8";
Pra është shtuar një dhomë tjetër frigoriferike, fakt i cili nuk është përmendur në asnjë rast nga grupi i inspektimit.
-Duke i'u referuar përcaktimeve të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, konkretisht pikës 34 të nenit 3: **"Stabiliment"** është çdo mjedis, ku zhvillohet biznesi ushqimor dhe/ose biznesi ushqimor për kafshë";
Pikave 2 dhe 5 të nenit 19 të Ligjit të mësipërm:
2.**Stabilimentet** për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.
5.**Stabilimentet**, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.
Për të vazhduar më tej:
Me përcaktimet ligjore të bëra në **Fushën II** (Ushqimi dhe shëndeti), **Kategoria II** (Prodhimi dhe/ose tregëtimi i ushqimeve), pikës 1 (kjo veprimtari është kategoria II.1), **shkronjën b të pikës**

2 (Licenca për këtë kategori ndahet në nënkategorinë II.1.b – shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore, për njerëz), **pikës 11 të Kreut III** (licencat për veprimtaritë me kodin II.1.b, jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes), të VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.
-Pra sa më sipër subjekti ka patur detyrimin të pajisej me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në ambjentin e ri që ka marrë në përdorim, veprim i cili nuk ka ndodhur, dhe nga inspektorët nuk është marrë asnjë masë administrative gjobë ndaj subjektit si dhe ndalimin e ushtrimit të aktivitetit deri në pajisjen me licencë, ku një një rast të tillë Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, parashikon gjobë nga vlerat 1,000,000 lekë – 2,000,000 lekë.
▪ **Për më tepër, licencimi i ambjenteve të tilla, që përfshin inspektimin e kushteve higjenike (dhoma frigoriferike, pastërtia, kapaciteti i dhomës), tekniko-teknologjike (temperatura dhe aparati për regjistrimin e saj) bëhet edhe më i domosdoshëm kur në këto ambjente ruhen produkte me origjinë shtazore, me qëllim garantimin që këto produkte të jenë të sigurta.**
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.S.L dhe z.M.B, si dhe zj.M.M për autorizimin e dy inspektorëve të sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, të kryejnë inspektimin e subjektit dhe produkteve me origjinë shtazore.

38. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: R.J inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore dhe E.D, inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, pra grupi i inspektimit ka në përbërje inspektorë të dy sektorëve.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002617-1, datë 09.05.2019, firmosur nga M.M, me objekt verifikimin e kushteve tekniko-teknologjike për licencim.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-002617-1, datë 09.05.2019.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002617-2, datë 09.05.2019, ku pasqyrohet se nga verifikimi i planimetrisë së subjektit të dorëzuar në QKB dhe inspektimi në vend, rezultoi se nuk ka përputhje me vendin e ushtrimit të aktivitetit dhe për këtë arsye subjekti nuk plotëson kushtet për licencim.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002617-5, datë 09.05.2019.
Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-Vendimmarrja e inspektorëve nuk është e plotë, për arsye se veç refuzimit të kërkesës për licencim, ndaj subjektit, duhet të ishte vendosur edhe masa e ndalimit të ushtrimit të aktivitetit deri në plotësimin e kushteve për licencim, me qëllim shmangien e mundësisë, që ky biznes të ushtronte aktivitet i palicencuar.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët zj.R.J dhe zj.E.D, si dhe zj.M.M, ish Kryeinspektore e DRAKU Tiranë.

39. Në inspektimin e subjektit G,vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: R.J inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore dhe E.D, inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, pra grupi i inspektimit ka në përbërje inspektorë të dy sektorëve.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003023-1, datë 27.05.2019, firmosur nga M.M, me objekt verifikimin e kushteve tekniko-teknologjike për licencim, pasi në inspektimin e parë, subjektit i'u refuzua aplikimi.

-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-003023-1, datë 27.05.2019, ku pasqyrohet se subjekti i plotëson kërkesat për licencim.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003023-1, datë 27.05.2019, ku pasqyrohet se subjekti ka dy dhoma frigoriferike, një ngrirës dhe një freskues. Dhomat frigoriferike me kushte të përshtatshme. Disponon librezat shëndetësore të personelit. Ka kryer shërbimin D.D.D. Disponon planin HACCP. Ka ndërtuar sistemin e gjurmueshmërisë. Mjetet e transportit të përshtatshme. Për sa më sipër subjekti i plotëson kushtet për tu licencuar.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003023-1, datë 27.05.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer mbi inspektimin e dokumentacionit, ambjenteve frigoriferike, mjeteve të transportit, ku edhe sipas VKM nr.538, datë 26.05.2009, llojet e dokumenteve provuese në licencimin e për këtë kategori, duhen dokumente pronësie dhe/ose përdorimi (për dhomat frigoriferike), si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre mjedisit, teknologjisë dhe pajisjeve;
-Në këtë rast nuk përmendet fare planimetria, e cila në inspektimin para 18 ditësh, sipas verifikimit të kryer po nga këto dy inspektor, ka rezultuar se nuk përputhej me vendin ku do të ushtrohej aktiviteti, kriter ligjor për të cilin është refuzuar aplikimi i subjektit. Theksojmë këtu se konstatimi i mëparshëm i bërë nga inspektorët për planimetrin nuk mund të jetë objekt ndryshimi, pasi subjekti përsëri për atë vendndodhje ka bërë aplikimin, ç'ka do të thotë se përsëri planimetria nuk përputhet me vendndodhjen;
-Në procesverbalin e inspektimit nuk jepet informacion mbi kohëzgjatjen e inspektimit në subjekt, po ashtu edhe në vendimin përfundimtar të inspektimit, ku ora e fillimit është 00:00 dhe ora e mbarimit është 00:00.
▪ Për sa më sipër grupi i auditimit arrin në konkluzionin se kjo procedurë licencimi nuk është kryer në përputhje me kuadrin rregullator dhe se ajo është një procedurë fiktive, duke mos realizuar qëllimin e inspektimit në rastin e procedurës së licencimit (ku qëllimi është verifikimi i kushteve dhe i dokumenteve provuese të licencimit[19]).
-Gjithashtu theksojmë se shkresa në DPAKU, mbi rezultatet e inspektimit me qëllim licencimin e subjektit, nuk është dërguar në DPAKU, në kundërshtim me përcaktimin ligjor, i cili përcakton afatin 15 ditë[20].
Për këto mbajnë përgjegjësi z.S.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, si dhe inspektorët zj.R.J dhe zj.E.D.

40. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: M.H inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, M.C inspektor i sektorit të produkteve me origjinë jo shtazore, Sh.K inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore, si dhe Xh.P përgjegjëse e sektorit të inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe operatorëve të biznesit, në DPAKU.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003318-1, datë 05.06.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori S.S, sipas urdhrit nr.3352, datë 05.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, ku është urdhëruar kryerja e inspektimit të këtij subjekti.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-003318-1, datë 05.06.2019, ku pasqyrohet se në një dhomë frigoriferike mbajnë produktet dy subjekte; Muri në ambjentin frigoriferik është me qeskë

[19] VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, pika 14, licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.I.B.
[20] VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, pika 15.

plastike; **Nuk është paraqitur termografi për rezultatet e temperaturës;** Sistemi i gjurmueshmërisë për dy produkte nuk është mbajtur; Mangësi në etiketimin e këtyre produkteve; Pikat e kontrollit të sistemit HACCP nuk implementohen;

-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003318-2, datë 06.06.2019, ku pasqyrohen shkeljet e kuadrit ligjor, për mungesën e licencës, sistemin e gjurmueshmërisë, sistemin e vetëkontrollit, etiketimin, si dhe ajo që është e rëndësishme, në ambjentet e subjektit u gjendën produkte të cilave u kishte kaluar afati i përdorimit brenda vitit 2016, 2017, 2018 por edhe brenda vitit 2019. Këto produkte subjekti nuk i kishte përfshirë në listën e produkteve që kishte dërguar në DRAKU më datë 24.10.2018 me shkresën nr.3172 prot., dhe ajo që është më e rëndësishme, ky fakt nuk është përmendur në asnjë rast në dy inspektimet e mëparshme ***(të datave 09.11.2018 dhe 19.11.2018, me grupe inspektimi A.N dhe G.H, si dhe Z.C dhe A.N)***, të kryer në këtë subjekt për procedurën e asgjesimit. Gjithashtu ndaj subjektit për shkeljen e kërkesave ligjore u vendosën 7 gjoba në vlerën 5,200,000 lekë (2,000,000 lekë për licencën + 2,000,000 lekë për importin + 100,000 lekë për etiketimin + 200,000 lekë për gjurmueshmërinë + 200,000 lekë për planin HACCP + 500,000 lekë për nxjerrjen në treg të ushqimeve të pa sigurta + 200,000 lekë për përgjegjësitë e operatorit). Procesverbali i firmosur nga grupi i inspektimit dhe jo edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i DPAKU.

-Vendimi i ndërmjetëm i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003318-4, datë 05.06.2019, ku është bërë ndalimi i ushtrimit të aktivitetit për arsye të mungesës së licencës në këtë vendndodhje; Bllokimi i sasisë ***425 kg*** të produktit friendship butler, si dhe sasia prej ***20,525 kg*** që subjekti ka shitur nga ky produkt të tërhiqet nga tregu brenda datës 07.06.2019

-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003318-5, datë 06.06.2019, ku pasqyrohen masat administrative, ndalimi i ushtrimit të aktivitetit, rietiketimi i produktit friendship butler, inventarizimin e produkteve të skaduara, tërheqjen nga tregu të produktit friendship butler, si dhe përgatitjen e sistemit të gjurmueshmërisë për produktin friendship butler.

Në praktikën e mësipërme konstatohet se:

-Vendimmarrja e grupit të inspektimit nuk është plotë, e saktë dhe brenda të njëtës ditë, për të njëjtat shkelje, ka dy qëndrime, konkretisht: Referenca ligjore shkronja ç e pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", përdorur për bllokimin e produktit friendship butler, nuk është zbatuar siç duhet pasi sipas kësaj reference produkti bllokohet dhe administrohet në ambjentet e institucionit që ka konstatuar kundërvajtjen administrative, veprim i cili nuk është bërë, pasi produkti është bllokuar dhe është lënë në ambjentet e subjektit;

-Nuk janë vendosur shenjat dalluese të bllokimit të produkteve ç'ka e bënë të pa realizuar plotësisht masën administrative të inspektorëve, dhe nuk garantohet, nëse subjekti do të tregëtojë nga ky produkt apo jo;

-Nga masa e marrë në vendimin e ndërmjetëm në krahasim me vendimin përfundimtar të inspektimit, lidhur me produktin friendship butler, ka ndryshim të saj, pasi në vendimin e ndërmjetëm jepet masa e bllokimit dhe tërheqja e këtij produkti, ndërsa në vendimin përfundimtar është lënë detyrimi për tërheqjen nga tregu dhe rietiketimin e tij, dhe në gjykimin e grupit të auditimit është e pabazuar në ligj, pra në asnjë përcaktim në Ligjin e ushqimit si dhe në VKM nr.1344, datë 10.10.2008[21], nuk thuhet se në rastet kur etiketa përmban informacion të gabuar, ajo duhet të rietiketohet. Nëse do të marrim në konsideratë intepretimin e bërë në pikën 1/a dhe b të nenit 11, ku një ushqim është i pasigurt, në rastin kur nuk janë kushtet normale të përdorimit të ushqimit nga konsumatori dhe çdo fazë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes dhe informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë (rasti i mësipërm) ose informacione të tjera, të vlefshme për të, për parandalimin e efekteve të dëmshme specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh, dhe në këtë rast sipas

[21] VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "për etiketimin e produkteve ushqimore".

përcaktimit të bërë në pikën 1 të nenit 24 dhe nenit 69 të Ligjit për ushqimin, ky produkt ushqimor duhet të hiqet nga tregu, të bllokohet dhe të asgjesohet, dhe jo të rietiketohet. Për me tepër kur subjekti nuk ka sistemin e gjurmueshmërisë për këtë produkt, edhe tërheqjen e tij nga tregu s'ka se si bëjë kur ai s'ka informacion se ku e ka shitur këtë produkt.
-Nuk është lënë detyrë për korrigjimin e shkeljeve të konstatuar lidhur me dhomën frigoriferike, regjistrin e temperaturave;
-Gjithashtu konstatohet se gjoba e vendosur nuk është arkëtuar akoma, si dhe ankimi i bërë nga subjekti më datë 25.06.2019, nuk është shqyrtuar nga komisioni i ngritur në Ministrinë e Bujqësisë duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 5,200,000 lekë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.Sh.K, zj.M.H dhe zj.M.C. Z.A.H, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së deri në Tetor të vitit 2019, z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së Tetor 2019-Tetor 2020 për mosshqyrtim të ankesës, si dhe z.B.S, Drejtori i Përgjithshëm në detyrë i cili nuk i ka përcjellë komisionit në Ministri të Bujqësisë, ankesën e bërë nga subjekti.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 07.06.2019, për tërheqjen nga tregu të sasisë së shitur dhe rietiketimin e saj**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, brenda datës 07.06.2019, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", *dhe për këtë mbanë përgjegjësi z.S.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për periudhën Maj-Shtator 2019.*

41. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: N.M inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore dhe A.H inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003763-1, datë 21.06.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori S.S, me qëllim verifikimin e kushteve për licencimin e subjektit.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-003763-1, datë 21.06.2019, ku pasqyrohet se nuk ka asnjë shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003763-2, datë 21.06.2019, ku pasqyrohet se subjekti ka 2 dhoma frigoriferike, një ngrirëse dhe një freskuese. Dhomat frigoriferike kanë kushte të përshtatshme. OBU ka librezat shëndetësore të punonjësve, ka kryer shërbimin D.D.D, ka planin HACCP, mjetet e transportit janë të përshtatshme si dhe bëhet monitorimi i tyre. Sa më sipër subjekti plotëson kushtet për licencim.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003763-5, datë 21.06.2019.
Bashkëlidhur praktikës kontratë nënqeraje me nr.3614 Rep, nr.720 Kol, e datës 24.05.2019, për marrjen me qera të pronës në sipërfaqen 300 m^2, midis shtetasit N.V dhe Shoqërisë Globex;
Prokura nr.1292 Rep, nr.350/2 Kol, e datës 25.03.2019, e administratorit të G, për përfaqësimin e tij nga zj.A.M.
<u>Në praktikën e mësipërme konstatohet se:</u>
-Nuk administrohet pëlqimi i dhënë nga pronari i pronësisë, i cili i ka dhënë me qera objektin shtetasit N.V (sipas kontratës nr.3463 Rep, nr.2283 Kol, datë 07.12.2017), i cili po e jep me nënqera pronën ndaj shoqërisë G;
-Kontrata është bërë me efekt prapaveprues, pra është lidhur më datë 24.05.2019, dhe i fillon efektet që nga data 01.07.2018;
▪ Për sa më sipër, kontrata e nënqerasë ndërmjet G dhe shtetasit N.V është e pavlefshme dhe aplikimi për licencim nuk duhej të miratohej.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët N.M dhe A.H si dhe Kryeinspektori S.S.

42. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: Sh.K inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore, N.M inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore dhe E.Sh inspektor i pikës kufitare.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004012-1, datë 01.07.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori S.S, sipas kërkesës së subjektit, me shkresën nr.2501 prot., datë 27.06.2019, për zhbllokimin e produktit friendship butler, të bllokuar në inspektimin e datës 05.06.2019, pasi subjekti ka plotësuar kërkesat e rietiketimit.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-004012-1, datë 01.07.2019, ku pasqyrohet se nuk ka asnjë shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004012-1, datë 01.07.2019, ku pasqyrohet se subjekti ka bërë rietiketimin e sasisë **425 kg** të produktit friendship butler.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004012-1, datë 01.07.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Është autorizuar të kryejë inspektim për llogari të sektorit të produkteve me origjinë shtazore, inspektori i pikës kufitare, sipas urdhër caktimit nr.432 prot., datë 27.05.2019 të kryeinspektorit S.S, në kundërshtim me shkronjat a, b dhe c të pikës 4 të VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", të ndryshuar, pasi kompetencën ligjore për të kryer lëvizje të stafit, e ka vetëm Drejtori i Përgjithshëm i DPAKU;
-Subjekti nuk i ka korrigjuar detyrat e lëna brenda afatit 07.06.2019 (rietiketimin), por i ka korrigjuar ato brenda datës 27.06.2019, ose 20 ditë me vonesë;
-Subjekti nuk i ka korrigjuar detyrat e lëna brenda datës 07.06.2019, për tërheqjen nga tregu të gjithë sasisë së produktit friendship butler;
-Nga inspektorët në asnjë rast nuk janë pasqyruar shkeljet e mësipërme si dhe nuk është vendosur masa administrative gjobë, për moskorrigjimin e shkeljeve, ku me rëndësi të madhe është tërheqja nga tregu të sasisë së konsiderueshme prej 20,525 kg, të produktit friendship butler;
-Pra siguria e produktit friendship butler nuk është garantuar, për arsye se ai ka qarkulluar në treg me informacion të tjetërsuar, duke i dhënë këtij produkti efekte ose veti të cilat ai nuk i ka, si dhe duke keqinformuar blerësin[22].
▪ Sa më sipër si pasojë e mosveprimeve të inspektorëve si dhe të kryeinspektorit në detyrë për këtë periudhë, **nuk është garantuar siguria e ushqimit si dhe nuk janë mbrojtur interesat e konsumatorit**, për të cilën mbajnë përgjegjësi *z*.S.S, *zj*.Sh.K, *z*.N.M dhe *zj*.E.Sh. *Gjithashtu mbajnë përgjegjësi inspektorët zj.Sh.K, z.N.M dhe zj.E.Sh, për mosvendosjen e gjobës në vlerën 10,000 lekë, për moskorrigjimin e detyrave brenda afatit të përcaktuar dhe sipas mënyrës së përcaktuar.*

43. Në inspektimin e subjektit G, vendndodhje Rruga 3 Deshmorët, Magazina nr.52, kati i parë: "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, eksport-import i mallrave, produkteve dhe materialeve industriale, tekstile, elektrike, bujqesore, paisje, makineri, mjete transporti, etj.
-Grupi i inspektimi: N.H inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore, dhe A.H inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore.
-Autorizimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007275-1, datë 18.11.2019, firmosur nga ish Kryeinspektori A.N, me objekt zbatimin e legjislacionit në fuqi.

[22] VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullave "për etiketimin e produkteve ushqimore", shkronja "a", pika 1, Kreu I.

-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-007275-1, datë 18.11.2019, ku pasqyrohet se nuk ka asnjë shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007275-1, datë 18.11.2019, ku pasqyrohet se subjekti duhet të bëjë veçimin e produkteve me ambalazh të dëmtuar, si dhe në mjediset ku ruhet mielli të monitorohet niveli i lagështisë.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007275-1, datë 18.11.2019, ku jepet masa paralajmërim dhe korrigjimi i detyrave brenda datës 02.12.2019.
Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-Sipas informacionit të pasqyruar në procesverbal, subjekti nuk monitoron lagështinë e ambjentit kur ruhet mielli, pra nuk zbaton përcaktimin ligjor të bërë në shkronjën b të pikës 3 të Udhëzimit nr.207, datë 31.03.2015 "Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për tu shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore", ku më konkretisht përcaktohet se niveli maksimal i përmbajtjes së lagështisë për miellin, pavarsisht species së grurit nga i cili është përgatitur, është 15% /masë, dhe ky udhëzim ka dalë për zbatimin e pikës 2 të nenit 23 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, që përcakton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës së ushqimeve, ç'ka do të thotë se subjekti nuk respekton kushtet e higjienës së ushqimeve, duke ngritur dyshime mbi cilësinë e miellit të tregtuar nga ky subjekt;
-Në një rast të tillë nga inspektorët duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë, duhet të ishte marrë mostër për analizë zyrtare, pasi jemi në kushtet kur nuk respektohen kërkesat e higjienës dhe ruajtjes së produktit, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ushqimit.
-Ky veprim nuk ka ndodhur nga inspektorët, por ata janë mjaftuar duke i lënë detyrë monitorimin e lagështisë dhe i kanë dhënë vetëm masën paralajmërim.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi inspektorët z.N.H dhe z.A.H.

Në përfundim të auditimit të praktikave të inspektimit të kryera pranë subjektit G, gjithashtu konstatohet se:
-Nuk është kryer analiza laboratorike për produktin djath, për të cilin ka patur ankesë se ka në përbërje vaj palme;
-Nuk është kryer verifikimi për detyrat e lëna në inspektimin e datës 18.11.2019;
-Nuk është kryer verifikimi i procedurës së asgjesimit të produkteve në sasinë 9,110 kg;
-Nuk është bërë tërheqja nga tregu të produktit f.b në sasinë 20,525 kg;
-Nuk është arkëtuar gjoba e vendosur nga inspektorët;
-Nuk është shqyrtuar ankesa e bërë nga subjekti;
-Nuk është miratuar në përputhje me kërkesat ligjore aplikimi për licencën e subjektit G;
-Nuk është verifikuar cilësia e miellit që tregëton subjekti G;
-Nuk dokumentohen inspektimet e kryera në mjetet e transportit të subjetit G;
-Faktet e pasqyruara në inspektime të ndryshme të kryera në këtë subjekt, bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, duke krijuar dyshime mbi saktësinë, vërtetësinë dhe plotësinë e veprimeve të kontrolleve të kryera në këtë subjekt.

44. Autorizimi për inspektim nr.131/8, datë 31.01.2018, **në subjektin F.T, Rruga e Kavajës, pranë bllokut të ambasadave, me administrator P.T**, me grup inspektimi:Y.A dhe V.Zh, me qëllim verifikimin e kushteve të subjektit për licencimin.
-Listë-verifikimi me nr.0040931, datë 31.01.2018, ku pasqyrohet se subjekti i plotëson të gjitha kërkesat ligjore, për higjienën, HACCP dhe gjurmueshmërinë.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0040931, datë 31.01.2018. Nga grupi i inspektimit është vendosur miratimi i kërkesës për licencim.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës së inspektimit, konstatohet se:
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;

-Nuk dokumentohet sistemi HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë, megjithëse inspektorët janë shprehur se funksionon;
-Gjithashtu në datën që është kryer inspektimi pranë këtij subjekti me vendndodhjen e mësipërme, rezulton se sipas verifikimit të grupit të auditimit në faqen zyrtare të QKB-së, ky subjekt ka filluar **të ushtrojë aktivitet në këtë adresë, në datë 15.02.2012**, pra rreth 6 vite më përpara, dhe ndodhur në këto kushte ndaj subjektit nuk duhej të kryej inspektim për licencimin e tij, por për zbatimin e kuadrit ligjor në aktivitetin e tregtimit të produkteve me origjinë shtazore për njerëz.
-Sa më sipër nga inspektorët duhet të ishte vendosur masë administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë (vlera minimale e gjobës për ushtrim aktiviteti pa licencë), ndalim ushtrim aktiviteti, lënie e afatit për korrigjimin e shkeljeve (aplikimin për licencë, njoftimin e DRAKU-së), dhe më pas verifikimin e kushteve nëse duhet të pajiset me licencë subjekti apo jo.
-Gjithashtu fakti që subjekti ka ushtruar aktivitet më përpara se të kryhej inspektimi, konfirmohet edhe nga shënimi i inspektorëve në procesverbalin e inspektimit, për funksionimin e sistemit të gjurmueshmërisë **(pra subjekti është furnizuar me produkte dhe ka tregtuar)**.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi Y.A dhe V.Zh.

45. Autorizimi për inspektim nr.AKU-TR-2018-000090-1, datë 06.02.2018, **në subjektin F.T, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, Kashar, me administrator P.T,** me grup inspektimi:S.L dhe G.H, nuk përcaktohet objekti i inspektimit.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-000090-2, datë 07.02.2018, ku pasqyrohet se subjekti ushtron aktivitetin në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore, për higjienën, HACCP dhe gjurmueshmërinë.
-Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-000090-1, datë 07.02.2018, ku pasqyrohet se subjektit i'u gjendën produkte pa etiketën në gjuhën shqipe, dhe për këtë shkelje është vendosur gjobë në vlerën 50,000 lekë.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Inspektimi pranë subjektit është kryer jashtë afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, pra në autorizim përcaktohet se inspektimi fillon më datë 06.02.2018 dhe mbaron po në datën 06.02.2018, ndërkohë që listë-verifikimi i inspektimit është mbajtur më datë 07.02.2018, si dhe në kushtet e mungesës së autorizimit të Drejtorit të DRAKU Tiranë për shtyrje të afatit të inspektimit, **atëherë ky inspektim është i pavlefshëm** dhe bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 29 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi S.L dhe G.H.

46. Autorizimi për inspektim nr.AKU-TR-2018-000466-1, datë 20.03.2018, **në subjektin F.T, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, Kashar, administrator P.T, NIPT K61704029H**, me grup inspektimi:A.B dhe Y.A, verifikim për njoftimin alert të nga Drejtoria e Përgjithshme, mbi një produkt c.p, i cili në brendësi ka paprika dhe mustard, e cila nuk është e deklaruar në listën e përbërsësve, dhe shkakton probleme ndaj njerëzve alergjik nga mustarda.
-Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2018-000466-2, datë 20.03.2018, ku pasqyrohet se subjektit nuk i'u gjendën produktet për të cilat ishte bërë njoftimi alert. Gjithashtu pasqyrohet se subjekti më datë 09.03.2018 ishte njoftuar nga eksportuesi në Itali, për tërheqjen nga tregu të produktit, dhe më datë 10.03.2018 ishte bërë tërheqja e produktit nga tregu (bashkëlidhur praktikës fatura e tërheqjes nga tregu, njoftimi alert, komunikimi ndërmjet subjekteve eksportues-importues).
-Vendimi i inspektimit nr. AKU-TR-2018-000466-5, datë 20.03.2018, ku nuk pasqyrohen shkelje administrative.

47. Autorizimi për inspektim nr.338/11, datë 03.04.2018, **në subjektin supermarket ushqimor,**

A, Rruga 5 Maji, me grup inspektimi:M.K dhe N.H, me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit.
-Listë-verifikimi me nr.41432, datë 03.04.2018, ku pasqyrohet se subjekti i plotëson të gjitha kërkesat ligjore, për higjienën, HACCP dhe gjurmueshmërinë.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0041432, datë 03.04.2018, ku pasqyrohet se subjekti ushtron aktivitet në përputhje me kërkesat ligjore, disponon licencën përkatëse, por i lihet detyrë përsëritjen e librezave shëndetësore të punonjësve, të mos ndahen në pjesë të vogla produktet e bulmetit, të bëhet sistemi i produkteve për fëmijë, dhe të informojë DRAKU për korrigjimin e tyre brenda datës 30.04.2018
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës së inspektimit, konstatohet se:
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet sistemi HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Inspektimi nuk është kryer online, nëpërmjet portalit e-inspektimi;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit, megjithëse inspektorët janë shprehur se ka kryer analizën e ujit të rrjetit;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, inspektorët e këtij inspektimi M.K dhe N.H.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 30.04.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 30.04.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë *përgjegjësi z.F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për periudhën Janar-Maj 2018*.

48. Autorizimi për inspektim nr.346/10, datë 05.04.2018, **në subjektin supermarket ushqimor, C, Rruga Ali Demi,** me grup inspektimi: E.C dhe M.K, me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit.
-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0040537, datë 05.04.2018, ku pasqyrohet se inspektimi nuk u krye, për arsye se subjekti e ka mbullur aktivitetin në këtë adresë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës së inspektimit, konstatohet se:
-Inspektimi nuk pasqyron me vërtetësi veprimet e kryera nga inspektorët, për arsye se në këtë data subjekti, nuk e ka mbyllur aktivitetin këtë adresë. Konkretisht subjekti e ka mbyllur aktivitetin në këtë adresë më datë 26.04.2018, si dhe më datë 24.04.2018, me autorizimin nr.88, drejtuar QKB-së, është autorizuar punonjësja e supermarketit zj.Eralda Metalia, që të kryejë veprimet e nevojshme për mbylljen e aktivitetit në këtë adresë;
-Nuk dokumentohet me foto se subjekti ka qenë mbyllur;
-Inspektimi nuk është kryer online;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi M.K dhe E.C dhe F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU-së për atë periudhë, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line".

49. Autorizimi për inspektim nr.499/12, datë 20.05.2018, **në subjektin supermarket F.T, Casa Italia,** me grup inspektimi: A.B dhe A.N, për gjurmueshmërinë e produktit gjalp L me datë skadence 05.07.2018; 10.07.2018; 25.07.2018; 05.06.2018, të cilit rezultatet e analizave laboratorike i kanë dalë jashtë standardit.

-Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit përfundimtar me nr.,serial 0040633, datë 20.05.2018, ku pasqyrohet se nga inspektimi i kryer, subjekti nuk ka në shitje produkt gjalp L, me datat e skadencës së mësipërme, dhe se përfaqësuesja e subjektit ka deklaruar se nuk furnizohet me produktin gjalp L.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës së inspektimit, konstatohet se:

-Inspektimi nuk është kryer online;

-Inspektimi nuk pasqyron me vërtetësi dhe plotësi veprimet e kryera nga inspektorët, për arsye se si fillim inspektorët për kryerjen e inspektimit në këtë subjekt, janë bazuar mbi sistemin e gjurmueshmërisë (Kompanisë L), në të cilin logjikisht, është pasqyruar se ky subjekt është furnizuar me gjalp L me datat e skadencës si më sipër (sipas librit të shitjeve të kompanisë), sepse ndryshe nuk do të kishte kuptim të kryenin inspektim pranë këtij subjekti, por mund të shkonin në një subjekt tjetër;

-Inspektorët janë shprehur se nuk ka në shitje produkt gjalp L, por subjekti këtë produkt mund ta ketë shitur, ose mund ta mbajë në magazinë, dhe për këtë arsye inspektorët nuk duhet të mjaftoheshin vetëm me vëzhgimin e rafteve të mbajtjes së produkteve, por me inspektimin e të gjitha ambjenteve të subjektit, si dhe inspektimin e sistemit të gjurmueshmërisë, për të parë nëse ky subjekt vërtet nuk është furnizuar me këtë produkt, dhe në këtë rast, identifikohen tre problematika, gjurmueshmëria e Kompanisë L nuk funksionon siç duhet ose gjurmueshmëria e subjektit F.T, ose inspektimi i kryer nga inspektorët është thjesht formal dhe pa asnjë vlerë të shtuar, duke lënë hapsira edhe për abuzim, për arsye se në këtë inspektim, nuk dokumentohet asnjë veprim i inspektorëve;

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi A.B, A.N dhe F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU-së për atë periudhë, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line".

50.Në të njëjtën datë 20.05.2018, dy inspektorë të tjerë M.K dhe E.C, në inspektimin e kryer sipas autorizimit nr.499/6, në subjektin Supermarket C, Unaza e Re, në procesverbalin e inspektimit nr.0042477, datë 20.05.2018, është gjetur sasi gjalpi 6 pako nga 100 gr, e cila është bllokuar dhe i është lënë detyrë subjektit që ta kthejë në origjinë, por pa përcaktuar afatin e realizimit të detyrës.

Në këtë praktikë konstatohet:

-Produkti i bllokuar duhej të asgjesohej dhe jo të kthehej në origjinë;

-Duhej të dokumentohej nëse nga subjekti është shitur tek konsumatori, produkti gjalp lufra, me data skadence si më sipër;

-Duhej të dokumentohej se me sa është furnizuar subjekti nga ky produkt, sa ka shitur prej tij, duke ju referuar sistemit të gjurmueshmërisë;

-Inspektimi nuk është kryer online;

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët e këtij inspektimi M.K dhe E.C dhe F.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU-së për atë periudhë, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line".

51. Në inspektimin **me autorizimin nr.669/4, datë 05.07.2018**, me inspektor Z.C, E.V dhe V.S, pranë subjektit P.T, me ortak edhe subjektin C, me vendndodhje Bulevardi Zhan Dark.

-Listë-verifikimi me nr.0040892, datë 05.07.2018, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit: P.T, **me nr., të licencës: e paplotësuar nga inspektorët.**

Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:

-Kapitulli VI, pika 1 "Shmangia e grumbullimit të mbetjeve në dhomat ku mbahet ushqim", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Mallrat e skaduara apo të dëmtuara të dërgohen në magazinën qendër";**

-Kapitulli IX "Dispozita të zbatueshme për produktet ushqimore", më tej pika 1 "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i

sigurt", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të rinovojë një pjesë të analizave, kryesisht për produktet shtazore";**
-Kapitulli IX "Dispozita të zbatueshme për produktet ushqimore", më tej pika 2 "Ruajtja e lëndëve të para dhe të gjithë përbërësve të tjerë në kushte të përshtatshme", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të sistemojë dhomën frigoriferike";**
▪ Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit nr.0040892 datë 05.07.2018, ku pasqyrohet se:
-Ka vendndodhje të përshtatshme;
-Kushtet dhe gjëndja e ambjentit të përshtatshme;
-Kushtet higjeno-sanitare të përshtatshme;
-Personeli i pajisur me librezë shëndetësore, me uniformë;
-Substancat pastruese ruhen në vend të veçant;
-Subjekti përdor uji rrjeti dhe ka kryer analizën bakterologjike;
-Ushqimet gjysëm të gatshme ruhen në kushte frigoriferike;
-Ushqimet e gatshme ruhen në kushte përshtatshme brenda afatit të skadimit;
-Letra për materialet e paketimit të bulmetit e përshtatshme;
-Dokumentet shoqëruese të ushqimeve kanë dokumentacionin e shoqërimit;
-Personeli ka përvojë;
-Subjekti disponon planin HACCP;
-Sistemi i gjurmueshmërisë funksionon;
Subjektit i lihet detyrë që:
-Të sistemojë produktet në dhomën frigoriferike;
-Të rinovojë një pjesë të analizave, kryesisht për produktet shtazore;
▪ Për sa më sipër subjekti i jepet masa administrative paralajmërim dhe të korrigjojë detyrat e lëna **brenda afatit 18.07.2018,** dhe të njoftojë DRAKU për korrigjimin e tyre**.**
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Inspektimi nuk është kryer online, nëpërmjet portalit e-inspektimi;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet gjendja e ambjenteve;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit që përdoret nga subjekti;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit të bulmetit, që përdor subjekti;
-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Konstatohet se **në këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Bulevardi Zhan Dark, ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët nuk është plotësuar kuadrati përkatës në listë-verifikimin, për numrin e licencës, **si dhe nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë 1,000,000 lekë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në vitin 2013**, pra duket qartë **se subjekti është favorizuar** nga inspektorët, dhe informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit nr.0040892 datë 05.07.2018, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **03.06.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.1928/1 datë 24.05.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi më datë 23.05.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Z.C, E.V dhe V.S për shkeljet e cituara më

sipër dhe zj.M.M, ish Kryeinspektori për periudhën në të cilën është kryer inspektimi, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 30.07.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 30.07.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019*

52. Inspektimi i kryer pranë **subjektit F.T, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, Kashar,** me autorizimin nr.AKU-TR-2018-002964-1, datë 29.08.2018, nga inspektorët M.H dhe M.Z, me objekt zbatimin e legjislacionit në fuqi.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-002964-1, datë 29.08.2018, ku pasqyrohet se subjekti ushtron aktivitet në përputhje me kërkesat ligjore.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002964-2, datë 29.08.2018, ku pasqyrohet që njëra nga magazinat ka nevojë për sistemim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-002964-5, datë 29.08.2018, i është dhënë masa paralajmërim dhe të korrigjohet shkelja **brenda afatit 05.09.2018.**

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 05.09.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 05.09.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

53.Përsëri inspektimi i kryer pranë **subjektit F.T, brenda Qendrës Tregtare R.C,** me autorizimin nr.AKU-TR-2018-003062-1, datë 04.09.2018, nga inspektorët Y.A dhe V.Zh, me objekt zbatimin e legjislacionit në fuqi.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-003062-1, datë 04.09.2018, ku pasqyrohet se subjekti ushtron aktivitet në përputhje me kërkesat ligjore.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-003062-2, datë 04.09.2018, datë 29.08.2018, ku pasqyrohet se magazina ka nevojë për sistemim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-003062-5, datë 04.09.2018, i është dhënë masa paralajmërim dhe të korrigjohet shkelja **brenda afatit 07.09.2018.**

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 07.09.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 07.09.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

54. Në inspektimin **me autorizimin nr.AKU-TR-2018-003443-1, datë 24.09.2018**, me inspektor V.Zh dhe Y.A, pranë subjektit F.T, me vendndodhje Autostrada Tiranë-Durrës, Km 6, në bazë të

indicies së ardhur nga një konsumator në faqet sociale, ku është shprehur se një produkt "D.S" në subjektin C, në Rrugën Andon Zako Çajupi, i fshihet data e skadencës.
-Procesverbali i inspektimit **nr.AKU-TR-2018-003443-2, datë 24.09.2018**, ku pasqyrohet se:
Nga verifikimi u konstatua se produktit nuk i fshihej data e skadencës. Produkti shoqërohej me faturë tatimore nga magazinat e C dhe me etiketë në gjuhën shqipe.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-**003443-5, datë 24.09.2018**, ku pasqyrohet se nuk ka asnjë shkelje dhe asnjë masë.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Ankesa vjen për produktin i cili tregtohet në subjektin C me vendndodhje në rrugën Andon Zako Çajupi, ndërkohë grupi i inspektimit kryen verifikimin në magazinat qendrore, pra ka një mospërputhje midis veprimit që duhet të kryenin inspektorët dhe vendin ku duhet të kryenin inspektimin, me veprimin që kanë bërë konkretisht;
-Inspektorët si fillim duhet të shkonin për inspektim në vendin ku tregtohet produkti për të cilin është bërë ankesa, pra në C, Rruga Andon Zako Çajupi, për të verifikuar nëse subjekti ka gjendje nga ky produkt dhe të kryenin provat nëse fshihet data e skadencës apo jo, dhe më pas të shkonin edhe në magazinën qendrore, për të verifikuar të njëjtin produkt nga i njëjti Lot, për arsye se produkti që kanë verifikuar inspektorët mund të jetë i një Loti tjetër, nga ai produkt për të cilin është bërë ankesa;
-Nuk dokumentohet se me çfarë materiali/send është provuar, nëse fshihet apo jo data e skadimit të produktit;
-Nuk është marrë produkti me qëllim verifikimin/ekzaminimin/ekspertizën, e fshirjes apo jo të datës së skadencës;
-Për sa më sipër inspektimi nuk është i plotë dhe nuk pasqyron saktë situatën.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët V.Zh dhe Y.A për shkeljet e cituara më sipër, si dhe zj.M.M, ish Kryeinspektore e DRAKU Tiranë, për autorizimin e kryerjes së inspektimit në vendndodhjen e subjektit që nuk ka lidhje me objektin e inspektimit.

55. Në inspektimin **me autorizimin nr.AKU-TR-2018-003484-1, datë 26.09.2018**, me inspektor V.Zh dhe Y.A, pranë subjektit R, emir tregtar C, me vendndodhje Rruga Qemal Stafa, Pazari i Ri.
-Listë-verifikimi me **nr.AKU-TR-2018-003484-1, datë 26.09.2018**, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli XII "Hartimi dhe mirëmbajtja e procedurës së bazuar në HACCP", më tej pika 1/b ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Nuk ka të implementuar sistemin e vetkontrollit HACCP";**
-Procesverbali i inspektimit **nr.AKU-TR-2018-003484-2, datë 26.09.2018**, ku pasqyrohet se:
Subjektit i'u gjendën disa produkte pa etiketën në gjuhën shqipe;
Ambjenti i magazinës ku ruhen produktet ushqimore ka nevojë për lyerje dhe sistemim;
Ndaj subjektit është vendosur gjobë në vlerën 100,000 lekë për produktet pa etiketën në gjuhën shqipe, 100,000 lekë për mungesën e sistemit HACCP dhe paralajmërim.
-Të sistemojë produktet në dhomën frigoriferike;
-Të rinovojë një pjesë të analizave, kryesisht për produktet shtazore;
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-003484-5, datë 26.09.2018, ku pasqyrohen gjobat e vendosura, si dhe lihet detyrë për korrigjimin e shkeljes së sistemit HACCP dhe të tërheqë produktet ushqimore të importit të pa etiketuara në gjuhën shqipe dhe të bëj etiketimin e tyre **brenda datës 27.09.2018**, si dhe të lyejë dhe të sistemojë magazinën brenda datës **01.10.2018.**
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;

-Masa e dhënë për tërheqjen e produktit nga tregu dhe etiketimin e tyre **nuk ka bazë ligjore** mbështetëse, pra në asnjë përcaktim në Ligjin e ushqimit si dhe në VKM nr.1344, datë 10.10.2008 [23], nuk thuhet se në rastet kur produkti nuk është i pajisur me kundëretiketën në gjuhën shqipe, ai duhet të tërhiqet dhe të pajiset me këtë etiketë. Nëse do të marrim në konsideratë intepretimin e bërë në pikën 1/b të nenit 11, ku një ushqim është i pasigurt, në rastin kur informacioni që i jepet konsumatorit, përfshirë informacionin e dhënë në etiketë (rasti i mësipërm) ose informacione të tjera, të vlefshme për të, për parandalimin e efekteve të dëmshme specifike për shëndetin nga një ushqim i caktuar ose nga një kategori ushqimesh, dhe në këtë rast sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të nenit 24 dhe nenit 69 të Ligjit për ushqimin, ky produkt ushqimor duhet të hiqet nga tregu, të bllokohet dhe të asgjesohet, dhe jo të rietiketohet, ose inspektorët mund të kishin marrë mostër për analizë laboratorike, për të vlerësuar nga ana shkencore, cilësinë dhe sigurinë e produktit, por as ky veprim nuk është kryer.
-Konstatohet se **në këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Rruga Qemal Stafa, Pazari i Ri, ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Qershor të vitit 2012**, pra informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit nr.0040892 datë 05.07.2018, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **23.07.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2721/1 datë 16.07.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi më datë 11.07.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
-Më datë 11.09.2020 është paguar gjoba në vlerën 200,000 lekë, por rezulton se nuk është paguar kamat-vonesa në masën 2% të vlerës së gjobës për çdo muaj vonesë.
*-Sa më sipër si pasojë e mosarkëtimit të kamat-vonesës, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën (0.02 * 200,000 lekë * 23 muaj) = 92 mijë lekë,* për të cilën mbanë përgjegjësi përmbaruesi gjyqësor privat *z.R.A*, i cila nuk ka marrë masat për ekzekutimin e plotë të detyrimit monetar të debitorit[24]*;*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët V.Zh dhe Y.A për shkeljet e cituara më sipër.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 01.10.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 01.10.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019*

56. Në inspektimin **me autorizimin nr.AKU-TR-2018-003635-1, datë 03.10.2018**, me inspektor V.Zh dhe Y.A, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Bulevardi Zogu i Parë.
-Listë-verifikimi me **nr.AKU-TR-2018-003635-1, datë 03.10.2018**, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**

[23] VKM Nr.1344, datë 10.10.2008 "për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit".
[24] Shkronjat a, b, c dhe g të nenit 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".

Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli IX, pika 1 "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt", më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Një pjesë e raport analizave për produktet ushqimore me afat të shkurtër përdorimi kanë nevojë për rifreskim";**
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2018-003635-2, datë 03.10.2018, ku pasqyrohet se:
-Një pjesë e raport analizave për produktet ushqimore me afat të shkurtër përdorimi kanë nevojë për rifreskim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-003635-5, datë 03.10.2018, ku pasqyrohet masa paralajmërim dhe korrigjimi i detyrave të lëna brenda datës 09.10.2018.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-**Në këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Bulevardi Zogu i Parë, ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Shtator të vitit 2017**, pra informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **25.07.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2836/1 datë 18.07.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi më datë 16.07.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët V.Zh dhe Y.A për shkeljet e cituara më sipër.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 09.10.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 09.10.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019*

57. Në inspektimin **me autorizimin nr.AKU-TR-2018-004830-1, datë 13.12.2018**, me inspektor V.Zh dhe Y.A, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Andon Zako Çajupi, pranë Stadiumit Dinamo.
-Listë-verifikimi me **nr.AKU-TR-2018-004830-1, datë 13.12.2018**, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli I "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Ambjenti i magazinës ka nevojë për sistemim dhe një pjesë e murit po në këtë ambjent ka nevojë për lyerje";**
Kapitulli VIII "Uji i pijshëm për mënjanimin e kontaminimit të produkteve ushqimore" më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Ka bërë kërkesë për kryerjen e analizës mikrobiologjike të ujit të rrjeti";**
-Procesverbali i inspektimit **nr.AKU-TR-2018-004830-2, datë 13.12.2018**, ku pasqyrohet se:
Ambjenti i magazinës ka nevojë për sistemim dhe një pjesë e murit po në këtë ambjent ka nevojë për lyerje.

-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2018-004830-5, datë 13.12.2018, ku pasqyrohet masa paralajmërim dhe korrigjimi i detyrave të lëna **brenda datës 25.12.2018.**
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-**Në këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Rruga Andon Zako Çajupi, pranë Stadiumit Dinamo, ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë 1,000,000 + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Mars të vitit 2011**, pra informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **20.06.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2836/1 datë 07.06.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi i datës 07.06.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët V.Zh dhe Y.A për shkeljet e cituara më sipër.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 25.12.2018**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 25.12.2018, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

58. Përsëri në inspektimin **me autorizimin nr.AKU-TR-2019-000165-1, datë 15.01.2019**, me inspektor Sh.K dhe Y.A, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Bulevardi Zogu i Parë, **subjekt i inspektuar edhe më datë 03.10.2018.**
-Listë-verifikimi me **nr.AKU-TR-2019-000165-1, datë 15.01.2019**, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli I, pika 2/a "Mirëmbajtja, pastrimi/dezinfektimi, kontaminimi nga ajri dhe hapësira e përshtatshme e punës", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-**000165-1, datë 15.01.2019**, ku pasqyrohet se:
-Nuk ka asnjë shkelje, ndërkohë që sipas listë-verifikimit është konstatuar se subjekti nuk plotëson një nga kërkesat e kushteve higjienike: "Mirëmbajtja, pastrimi/dezinfektimi, kontaminimi nga ajri dhe hapësira e përshtatshme e punës".
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-**000165-1, datë 15.01.2019**, në të cilin nuk ka asnjë masë administrative.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk është vendosur masë administrative "gjobë" ndaj subjektit, i cili ushtron aktivitet në kushtet e mosplotësimit të njërës prej kërkesave të kushteve higjienike, ku në këtë rast, në shkronjën "h" të nenit 68 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, përcaktohet masa administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë, veprim i cili nuk ka ndodhur nga inspektorët;
-Gjithashtu në inspektimin e kryer **më datë 03.10.2018**, ndaj këtij subjekti, janë lënë disa detyra për tu korrigjuar **brenda datës 09.10.2018**, dhe nga inspektorët **në inspektimin e rradhës** (pra të datës 15.01.2019) nuk ka asnjë shënim nëse subjekti i ka realizuar detyrat apo jo, për më tepër

kur, **në praktikat e inspektimit të këtij subjekti nuk administrohet asnjë njoftim brenda datës 09.10.2018**, prej tij, i cili duhet të njoftonte DRAKU, për korrigjimin e shkeljeve. Ndodhur në këto kushte dhe në mbështetje të pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", **ndaj subjektit duhet të ishte vendosur gjobë në vlerën 10,000 lekë**, për mospërmbushjen e detyrimit ligjor të njoftimit të DRAKU Tiranë, **veprim i cili nuk ka ndodhur*;***
-Përsëri si edhe në trajtimin e bërë në inspektimin e datës 03.10.2018, edhe në këtë praktikë inspektimi, pra më datë 15.01.2019, pranë subjektit me **vendndodhje Bulevardi Zogu i Parë,** nga verifikimi i grupit të auditimit për licencat që disponon subjekti, konstatohet se ai ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Shtator të vitit 2017**;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **25.07.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2836/1 datë 18.07.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi më datë 16.07.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët edhe pse kanë shkuar për herë të dytë pranë këtij subjekti, brenda harkut kohor rreth 4 muaj, nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, duke mos vendosur asnjë masë administrative për kushtet e higjienës edhe për mungesën e licencës. Pra duket qartë se ky subjekt është favorizuar.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Sh.K dhe Y.A për shkeljet e cituara më sipër.

59. Inspektimi **me autorizimin nr.AKU-TR-2019-000518-1, datë 30.01.2019**, me inspektor E.Sh dhe M.K, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Liqeni i Thatë, Farkë.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-000518-1, datë 30.01.2019, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000518-2, datë 30.01.2019, ku pasqyrohet se:
-Mungon një ambjent i veçantë për amballazhin dhe produktet nuk janë të sistemuara sipas natyrës së tyre.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000518-1, datë 15.01.2019, në të cilin jepet masa paralajmërim dhe korrigjimin e shkeljeve **brenda datës 08.02.2019.**

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 08.02.2019**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 08.02.2019, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019*

60. Inspektimi **me autorizimin nr.AKU-TR-2019-001313-1, datë 05.03.2019**, me inspektor V.Zh, Y.A dhe V.S, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Ibrahim Rrugova.
-Listë-verifikimi me **nr.AKU-TR-2019-001313-1, datë 05.03.2019**, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit, ku pasqyrohet se duhet rinovuar analiza mikrobilogjike e ujit të pijshëm, rifreskimi i analizave për disa produkte dhe ndarjen e produkteve sipas natyres së tyre, në dhomën frigoriferike**.**

-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-**001313-2, datë 05.03.2019**, ku pasqyrohet se: duhet rinovuar analiza mikrobilogjike e ujit të pijshëm, rifreskimi i analizave për disa produkte dhe ndarjen e produkteve sipas natyres së tyre, në dhomën frigoriferike**.**
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-**001313-5, datë 15.01.2019**, në të cilin jepet masa paralajmërim dhe korrigjimin e shkeljeve **brenda datës 20.03.2019.**

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 20.03.2019**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit 20.03.2019, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019*

61. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-001487-1, datë 13.03.2019, me inspektor Sh.K dhe N.M, pranë subjektit P.T, C, me vendndodhje Rruga e Dibres, pranë K.H.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-001487-1, datë 13.03.2019, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit.
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli I "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të sistemohen produktet sipas natyrës së tyre dhe një pjesë e murit ka nevojë për lyerje";**
Kapitulli IX "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt" më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të rinovohen një pjesë e raport analizave të produkteve";**
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001487-1, datë 13.03.2019, ku pasqyrohet se: Të bëhet sistemimi i produkteve në magazinë. Të bëhet lyerja e pjesshme e tavanit të magazinës. Të rinovohen një pjesë e raport analizave të produkteve.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001487-1, datë 13.03.2019, ku pasqyrohet masa paralajmërim dhe korrigjimi i detyrave të lëna brenda datës 22.03.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-**Në këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Rruga e Dibres, pranë K.H, nga verifikimi i grupit të auditimit për licencat që dispononte ky subjekt, në faqen zyrtare të QKB-së, konstatohet se ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë 1,000,000 + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Qershor të vitit 2018**, pra informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **12.07.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2540/1 datë 08.07.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi i datës 03.07.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Sh.K dhe N.M për shkeljet e cituara më sipër.

62. Përsëri në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-001646-1, datë 26.03.2019, me inspektor Y.A dhe V.S, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Andon Zako Çajupi, pranë Stadiumit Dinamo, subjekt i inspektuar **edhe më datë 13.12.2018**, nga inspektorët **Y.A dhe V.Zh**.

-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-001646-1, datë 26.03.2019, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata:
Kapitulli I "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Ambjenti i magazinës ka nevojë për lyerje";**
Kapitulli IX "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt" më tej pika 1 ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Një pjesë e analizave për produktet me afat të shkurtër skadence ka nevojë për rifreskim";**
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001646-1, datë 26.03.2019, ku pasqyrohet se: Ambjenti i magazinës ka nevojë për lyerje, si dhe një pjesë e raport analizave për produktet me afat të shkurtër përdorimi kanë nevojë për rifreskim;
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001646-1, datë 26.03.2019, ku pasqyrohet masa paralajmërim dhe korrigjimi i detyrave të lëna **brenda datës 10.04.2018.**
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në inspektimin e kryer **më datë 13.12.2018**, ndaj këtij subjekti, ku ka qenë një nga inspektorët Y.A, **e cila është përsëri edhe në inspektimin** e datës 26.03.2019, theksojmë se janë lënë disa detyra për tu korrigjuar brenda datës **25.12.2018**, konkretisht:
-Në inspektimin e datës 13.12.2018 është konstatuar se ambjenti i magazinës ka nevojë për lyerje dhe është lënë për tu rregulluar brenda datës 25.12.2018, ndërkohë që edhe në inspektimin e datës 26.03.2019 është konstatuar përsëri se ambjenti i magazinës ka nevojë për lyerje dhe është lënë për tu korrigjuar brenda datës 10.04.2019.
-Pra nga situata e pasqyruar gjatë inspektimit të këtij subjekti, në dy datat e mësipërme, konstatohet se ky subjekt nuk i ka korrigjuar detyrat e lëna, dhe për këtë nga inspektorët, në mbështetje të pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ku thuhet shprehimisht:

Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4[25] të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10,000 deri në 100,000 lekë.

-Inspektorët duhet të kishin vendosur dënim administrativ kryesor si dhe dënim plotësues me gjobë në vlerën 10,000 lekë, **por që nuk ka ndodhur**, sepse inpsektorët jo vetëm që nuk kanë vendosur dënim administrativ kryesor, por as dënim administrative plotësues **nuk kanë vendosur*;***
-Përsëri n**ë këtë datë që është kryer inspektimi** pranë subjektit me vendndodhje Rruga Andon Zako Çajupi, pranë Stadiumit Dinamo, nga verifikimi i grupit të auditimit, mbi licencat që dispononte subjekti, dhe konstatohet se në këtë datë ai ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse (Fusha II, pika 1 dhe më tej nën kategoria II.1.B), dhe nga inspektorët përsëri **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë 1,000,000 lekë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në Mars të vitit 2011**, pra informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-**Theksojmë se** ky subjekt për ushtrimin e aktivitetit në këtë vendondodhje është pajisur me licencë më datë **20.06.2019**, pas konfirmimit të DRAKU Tiranë me shkresën nr.2836/1 datë 07.06.2019 dërguar DPAKU, ku është përcjellë inspektimi i datës 07.06.2019, i kryer pranë këtij subjekti, me qëllim verifikimin e kushteve për licencim;

[25] Neni 48, pika 4 e Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë": Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pa sqyrohet në një fletë shoqëruese.

-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët edhe pse kanë shkuar për herë të dytë pranë këtij subjekti, brenda harkut kohor rreth 3 muaj, nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, duke mos vendosur asnjë masë administrative për kushtet e higjienës edhe për mungesën e licencës.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Y.A dhe V.S për shkeljet e cituara më sipër.

63. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-002208-1, datë 17.04.2019, me inspektor N.H dhe V.S, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Autostrada Tiranë-Durrës Km 6.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-002208-1, datë 17.04.2019, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit**.**
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002208-2, datë 17.04.2019, ku pasqyrohet se: Të ruhen etiketat e produkteve deri në shitjen e fundit të sasisë, si dhe të monitorohet temperatura e produktit për mishrat të cilët janë me gjysëm paketimi;
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002208-5, datë 17.04.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Sipas listë-verifikimit, Kapitulli I, pika 2/d "Regjistrimi, monitorimi dhe kontrolli i temperaturave të ambjenteve", sipas përcaktimit të Udhëzimit nr.22, datë 25.11.2010[26], pasqyrohet shënimi i inspektorëve: Subjekti duhet të monitorojë dhe temperaturën e produkteve (mishrat gjysëm të paketuar) të llojit "sotovuoto", dhe për këtë shkelje është dhënë vetëm masa paralajmërim.
-Shkelja e mësipërme, është një nga kushtet e higjienës të përcaktuar në Udhëzimin e mësipërm, i cili ka dalë për zbatimin e pikës 3 dhe 4 të nenit 23 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, dhe për shkeljen e të cilave ky Ligj, përcakton gjobë në vlerat 300,000 lekë – 500,000 lekë, ndërkohë nga inspektorët është dhënë vetëm masa paralajmërim.
-Theksojmë se kjo masë mund të jepet për një subjekt të ri, ose kur është kontrolluar për herë të parë, por jo për një subjekt, i cili në këtë vendndodhje ka filluar të ushtrojë aktivitet që në Mars të vitit 2013.
-Sa më sipër, në gjykimin e grupit të auditimit, vihet re se ky subjekt është favorizuar në inspektimin e mësipërm.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët N.H dhe V.S.

64.Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003413-1, datë 10.06.2019, me inspektor N.H, E.V dhe A.H, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Abdi T, në Qendrën Tregëtare T. Inspektimi është autorizuar mbi ankesën e ardhur nga një qytetar më datë 07.06.2019, për produktin Kos F me datë skadence 12.06.2019, i cili në brendësinë e tij kishte prezencë myku (bashkëlidhur denoncimit fotot e produktit dhe kuponi tatimor).
-Në procesverbalin e inspektimit mr nr.AKU-TR-2019-003413-2, datë 10.06.2019, nga inspektorët është pasqyruar situata, si vijon: "Nga verifikimi në subjekt konstatohet se nuk ka gjendje nga produkti "Kos total 0% e m 170 gr., F" me datë skadence 12.06.2019. Nga verifikimi i dokumentacionit për gjurmueshmërinë konstatohet se subjekti në datën 11.05.2019 ka marrë nga C Albania SHPK, një koli të përbërë nga 6 cope me datë skadence 01.06.2019 dhe më datën 16.05.2019 ka marrë përsëri një koli me 6 cope me datë skadence 12.06.2019. Ky produkt me datë skadence 12.06.2019 është shitur për herë të fundit më datë 08.06.2019. Në subjekt ka tipe të tjera të produktit Kos F, të cilat ruhen në kushte të përshtatshme frigoriferike dhe ju monitorohet rregullisht temperatura e ruajtjes. Nga këto produkte u verifikuar gjendja e tyre duke hapur 3 cop, për të cilat nuk u konstatua asnjë lloj dëmtimi. Ato janë brenda parametrave visual të pamjes, si dhe nuk u konstatuan të meta apo mangësi në produkt. Bazuar në nenin 47 të Ligjit nr.10433, datë

[26] Udhëzim nr. 22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor".

16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", inspektimi u krye i plotë dhe nuk u konstatuan shkelje të legjislacionit në fuqi, si dhe ky është vendim përfundimtar dhe ju komunikua subjektit".
-Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2019-003413-5, datë 10.06.2019.
Bashkëlidhur praktikës së inspektimit (hyrjet e produkteve të bëra në datën 11.05.2019 dhe në datën 16.05.2019, si dhe shitjet e produktit Kos F në datat 06, 08, dhe 09.06.2019), dhe më të detajuar si vijon:

- Datë 11.05.2019 – Hyrje në magazinën e subjektit produkti "Total 0% E M GR.170 F" një koli me 6 cope, me datë skadence 01.06.2019, me numër artikulli 711478/01, si dhe produkti tjetër "Total 0% M GR.170 F" me datë skadence 01.06.2019, me numër artikulli 711478/06;
- Datë 16.05.2019 - Hyrje në magazinën e subjektit produkti "Total 0% E M GR.170 F" një koli me 6 cope, me datë skadence 12.06.2019, me numër artikulli 711478/01

Pra ky subjekt në datat e mësipërme është furnizuar me 12 cop produkt "Total 0% E M GR.170 F", ku 6 prej tyre me datë skadence 01.06.2019 dhe 6 të tjerë me datë skadence 12.06.2019, si dhe me 6 cop produkt "Total 0% M GR.170 F", me datë skadence 01.06.2019, pra gjithsej 18 cop.

Referuar shitjeve të produktit "Total 0% E M GR.170 F", rezulton se:
-Më datë 06.06.2019 është shitur 1 cop;
-Më datë 08.06.2019 është shitur 1 cop;
-Më datë 09.06.2019 janë shitur 13 cop.
Pra në total, nga ky produkt janë shitur 15 cop, ndërkohë kur ky subjekt është furnizuar me 12 cop.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Referuar informacionit të mësipërm, sipas gjykimit të grupit të auditimit, në 15 cop që janë shitur nga ky produkt sipas datave 06, 08 dhe 09.06.2019, **rezulton se 6 prej tyre janë shitur të skaduara**, pasi u ka kaluar afati i skadencës që në datë 01.06.2019, ndërkohë që janë shitur më datat 06, 08 dhe 09.06.2019.
Pra edhe nëse do e bënim me përjashtim:
-Produkti i shitur më datë 06.06.2019 i përket furnizimit të datës 16.05.2019, me datë skadence 12.06.2019 (pra është shitur brenda afatit të skadencës);
-Produkti i shitur më datë 08.06.2019 i përket furnizimit të datës 16.05.2019, me datë skadence 12.06.2019 (pra është shitur brenda afatit të skadencës), që do të thotë se nga furnizimi i datës 16.05.2019 nga 6 cop të furnizuar, kanë ngelur 4 cop me afat skadence 12.06.2019,
-Ndërkohë që në shitjen e datës 09.06.2019 janë shitur 13 cop nga ky produkt, pra heqim 4 cop që janë brenda afatit të skadencës, duhen edhe 9 cop të tjera për të plotësuar sasinë e shitjes, pjesë e të cilave mund të jenë 6 cop të furnizuara më datë 11.05.2019 me afat skadence 01.06.2019.
-Gjithashtu nga shitja e sasisë së mësipërme prej 15 copesh të produktit "Total 0% E M GR.170 F", nuk justifikohet sasia prej 3 cop, pasi subjekti është furnizuar në total me 12 cop nga ky produkt, çka krijon bindjen e arsyeshme se inspektorët nuk kanë ndjekur plotësisht sistemin e gjurmueshmërisë të këtij produkti, pasi duhet të ishin marrë edhe hyrjet e mëparshme në subjekt për produktin "Total 0% E M GR.170 F";
-Fakt tjetër që, inspektorët nuk kanë ndjekur plotësisht sistemin e gjurmueshmërisë së këtij produkti, është se janë mjaftuar vetëm me inspektimin e këtij subjekti, por jo edhe të subjektit i cili e ka furnizuar atë me produktin "Total 0% E M GR.170 F", furnizim që është kryer nga magazina qendrore e C-it.
-Vlenë për tu theksuar se në raste të tilla, ndaj subjekteve të tjera, gjithmon është bërë një verifikim i tillë, ku inspektorët kanë kryer verifikimin që tek prodhuesi/importuesi/shpërndarësi i parë, me qëllim kontrollin e plotë të sistemit të gjurmueshmërisë.
-Referuar këtyre fakteve, inspektorët duhet të kishin vendosur masë administrative ndaj subjektit si dhe duhet të kishin kontrolluar plotësisht sistemin e gjurmueshmërisë, veprime të cilat nuk janë kryer prej tyre.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët N.H, E.V dhe A.H.

65. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003463-1, datë 11.06.2019**,** nënshkruar nga ish-Kryeinspektori i DRAKU z.S.S, me inspektor E.Sh dhe D.K, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga Ibrahim Rrugova. Inspektimi është autorizuar mbi ankesën e ardhur nga një qytetar, për produkte me origjinë shtazore (mish, djath) të cilat ripaketohen për disa herë në vasketa të vogla ose me qeska.
-Kërkesa për shtyrje të afatit të inspektimit me 1 ditë, kërkuar nga dy inspektorët, nënshkruar nga ish Kryeinspektori i DRAKU z.S.S;
-Në procesverbalin e inspektimit me nr.AKU-TR-2019-003463-2, datë 12.06.2019, është pasqyruar situata, si vijon: "Nga inspektimi i kryer në subjektin C F.T, në Rrugën Ibrahim Rrugova, rezulton se ky subjekt ushtron aktivitet si supermarket ushqimor dhe është i pajisur me licencë të tipit II.1.B. Ky subjekt ambalazhon dhe etiketon produktet në sasi të vogla për shërbim të shpejt tek konsumatori. Produkti shitet tek konsumatori në sasitë 100-500 gr dhe të shoqëruar me informacionin: Emërtimi i produktit, nr., i lotit, origjina e produktit, data e ambalazhimit, afati i përdorimit dhe pesha. U bë verifikimi i sasive të produkteve të ambalazhuara për shitje të menjëhershme tek konsumatori i fundit me produktin primar dhe rezulton se produktet kanë përputhshmëri të emërtimit të produktit, nr., e lotit, origjinën dhe kushtet e ruajtjes. Produktet shoqërohen me fatura tatimore dhe raport analize. Bazuar në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", nenin 47 procesverbali i inspektimit mbyllet kur nuk konstatohen shkelje".
-Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2019-003463-5, datë 12.06.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Për periudhën kur është kryer inspektimi, Inspektori D.K që është autorizuar për kryerjen e këtij inspektimi, nuk është inspektor i sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore, por është inspektor i sektorit të inspektimit të bimëve, dhe përfshirja e tij në këtë inspektimin e këtyre subjekteve apo për llogari të një sektori tjetër brenda DRAKU Tiranë, bëhet me Urdhër caktimi të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, pasi vetëm ai ka kompetencën ligjore, për kryerjen e lëvizjeve, transferimeve, largimeve, caktimeve etj;
-Në autorizimin e inspektimit nuk përcaktohet ora kur fillon dhe kur mbaron inspektimi;
-Nuk administrohet ankesa e qytetarit;
-Nuk dokumentohet me foto asnjë produkt i inspektuar;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë për produktet (mish, djath) të cilat kanë qenë të ambalazhuar në vasketa/qeska, ku në këtë rast duhet të pasqyrohej informacioni kur janë bërë hyrje në subjekt produktet primare (foto, fatura e hyrjes, datë, sasia, origjina, etiketa) dhe deri në cilën datë kanë afatin e përdorimit, më pas për produktet pjesore të tyre, të prera dhe paketuara në sasi të vogla për shitje të shpejt, për të cilat nuk pasqyrohet informacioni me foto, datë përdorimi, skedat e paketimit të produkteve për shitje të shpejtë, etiketat e tyre;
-Nuk dokumentohet me foto temperatura në të cilën ruhen produktet;
-Nuk dokumentohet se sa sasi dhe nga cilat lloje produktesh, kishte në banakun frigoriferik, subjekti në datën e inspektimit;
-Nuk dokumentohen raport analizat e produkteve me origjinë shtazore;
Për sa më sipër ky inspektim nuk është kryer në përputhje me kërkesat ligjore, nuk pasqyrohet dhe dokumentohet situata e subjektit, si dhe informacioni që është pasqyruar është i mangët në plotësinë dhe saktësinë e tij.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët E.Sh dhe D.K, për mosveprimet në praktikën e inspektimit, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019, për autorizimin e inspektorit të sektorit të inspektimit të bimëve që të kryejë inspektim për llogari të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore.

66. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-004266-1, datë 16.07.2019, nënshkruar nga ish-Kryeinspektori i DRAKU z.S.S, me inspektor Sh.K dhe E.Sh, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Rruga e Durrësit, Qendra Tregtare R.C.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-004266-1, datë 16.07.2019, ku nuk janë konstatuar shkelje.
-Në procesverbalin e inspektimit me nr.AKU-TR-2019-004266-2, datë 16.07.2019, nuk janë konstatuar shkelje.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit me **nr.AKU-TR-2019-004266-5, datë 16.07.2019**.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Për periudhën kur është kryer inspektimi, Inspektori E.Sh që është autorizuar për kryerjen e këtij inspektimi, nuk është inspektor i sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore, por është inspektor i pikës kufitare Rinas, dhe përfshirja e tij në këtë inspektimin e këtyre subjekteve apo për llogari të një sektori tjetër brenda DRAKU Tiranë, bëhet me Urdhër caktimi të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, pasi vetëm ai ka kopetencën ligjore, për kryerjen e lëvizjeve, transferimeve, largimeve, caktimeve etj;
-Në autorizimin e inspektimit nuk përcaktohet ora kur mbaron inspektimi;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet gjendja e ambjenteve;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit që përdoret nga subjekti;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit, që përdor subjekti, për produktet për shitje të shpejt (produktet pjesore nga produktet primare);
-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Sh.K dhe E.Sh, për mosveprimet në praktikën e inspektimit, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019, për autorizimin e inspektorit të sektorit të inspektimit të bimëve që të kryejë inspektim për llogari të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore.

67. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-004535-1, datë 16.07.2019, nënshkruar nga ish-Kryeinspektori i DRAKU z.S.S, me inspektor Y.A dhe V.Zh, pranë subjektit F.T, C, me vendndodhje Autostrada Tiranë-Durrës km 6. Inspektimi është autorizuar mbi bazën e kërkesës së subjektit, i cili me shkresën nr.2758 prot., datë 12.07.2019, ka njoftuar DRAKU Tiranë, ku më datë 16.07.2019 në orën 10:00 të jenë të pranishëm në procedurën e asgjesimit të produkteve të skaduara, dëmtuara me peshën 501.26 kg dhe vlerë 237,841 lekë.
-Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-004535-1, datë 16.07.2019.
-Në procesverbalin e inspektimit me nr.AKU-TR-2019-004535-1, datë 16.07.2019, ku pasqyrohet se produktet e mësipërme ishin gjendje në subjekt dhe u krye asgjesimi dhe shkatërrimi i tyre nga mjeti me targë AA332PI, i kontraktuar nga shoqëria "A" Shpk dhe u dërguan për asgjesim në landfillin e Sh, Tiranë.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.AKU-TR-2019-004535-1, datë 16.07.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në njoftimin që ka bërë subjekti, përcaktohet se asgjesimi përfundimtar do të bëhet në orën 10:00, ndërkohë në autorizimin e inspektimit përcaktohet se ky inspektim fillon në orën 15:30 dhe mbaron në orën 00:00 (pra pa afat të përcaktuar), pra duket qartë që inspektimi është autorizuar për tu kryer pas 5 orësh;
-Përsëri kjo mospërputhje orari, konstatohet edhe në procesverbalin e inspektimit, i cili ka filluar në orën 15:10 dhe ka mbaruar në orën 16:10, ku inspektorët janë shprehur se nga verifikimi

produktet ishin gjendje në subjekt dhe u krye asgjesimi dhe shkaterimi i tyre nga mjeti me targën AA332PI dhe u dërguan për asgjesim në landfillin e Sh, pra kur asgjesimi përfundimtar, dhe jo ngarkimi në makinë e transportimi i tyre në landfill, do të kryhet në orën 10:00, si ka mundësi që në orën 15:30 këto produkte ishin ende në magazinën e institucionit, ç'ka do të thotë se autorizimi dhe procesverbali, mbështetur edhe në mospërputhjen e orareve, janë nxjerrë formalisht, por jo se janë kryer veprime nga inspektorët bazuar në këto dy dokumente.
-Gjithashtu theksojmë se konstatimi i mësipërm mbështetet edhe nga fakti se në këtë praktikë nuk administrohet procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sh), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;
-Subjekti "A" ka kryer vetëm procedurën e transportit të mbetjeve dhe jo të asgjesimit të tyre;
-Nuk administrohet kontrata e shërbimit ndërmjet subjektit C (gjeneruesi i mbetjeve) dhe subjektit "A", i cili do të kryejë procedurën e transferimit/transportit të mbetjeve në landfillin e Sh;
-Fatura tatimore që është bashkangjitur praktikës, ku subjekti C ka paguar shërbimin e transportit të kryer nga subjekti "A", nuk ka vulën e shitësit, firmën e blerësit të shërbimit, kuponin tatimor.
Sa më sipër grupi i auditimit arrin në konkluzionin se kjo procedurë nuk është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore, nuk dokumentohet, nuk përputhet në kohë dhe është fiktive.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Y.A dhe V.Zh, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019.

68.Në inspektimin e subjektit G, C, Rruga Ndrek Luca, brenda Qendres "K", Tiranë, sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2019-007580-1, datë 04.11.2019. Grupi i inspektimit: Sh.K dhe N.M.
-Inspektimi është autorizuar mbi bazën e një ankese të ardhur nga një konsumator, për produktin C 250 gr, ankesë e cila është përcjellë nga DPAKU. Konkretisht produkti i mësipërm në brendinë e tij kishte prezencë myku.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-007580-1, datë 04.11.2019, ku nuk është plotësuar numri i licencës.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007580-2, datë 04.11.2019, ku pasqyrohet se në subjekt nuk kishte gjendje nga produkti C. Ky subjekt ishte furnizuar nga magazina qendrore e C, me produktin C, më datë **27.10.2019** në sasinë 1 koli me 12 cope, me datë skadence 06.06.2021, e shoqëruar me faturën e blerjes nr.12416. Konsumatori i cili ka bërë ankesën, e ka kthyer produktin përsëri në subjekt në datën 03.11.2019. Produkti C ishte kthyer në magazinën qendrore të C-it.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007580-5, datë 04.11.2019, ku nuk ka asnjë shkelje dhe nuk ka asnjë masë administrative.
Bashkëlidhur fatura e kthimit të produktit, por në sasinë 10 cop dhe jo 12 cop.
Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-Situata në subjektin e inspektuar nuk është pasqyruar plotësisht, për arsye se ky subjekt është furnizuar me produktin në fjalë në sasinë 12 cop gjithsej, ndërkohë në magazinën qendrore ka kthyer 10 cop, çka do të thotë se ky subjekt ka shitur 2 cop nga produkti C veç 1 cop të shitur klientit që ka bërë ankesën, pra 12 cop furnizim – 1 cop shitje për të cilën është bërë ankesë = 11 cop + 1 cop që është kthyer përsëri nga konsumatori = 12 cop, ndërkohë në magazinën qendrore janë kthyer 10 cop. Pra nga inspektorët nuk është pasqyruar plotësisht situata në subjektin e inspektuar, nuk është kontrolluar plotësisht sistemi i gjurmueshmërisë për produktin në fjalë;

-Në momentin që është kryer inspektimi, ky subjekt ka ushtruar aktivitet pa licencë, dhe nga inspektorët nuk është pasqyruar një fakt i tillë dhe nuk është marrë asnjë masë administrative. Për më tepër, theksojmë se, ky subjekt është inspektuar dy herë brenda vitit 2018 me qëllim licencimin e tij, dhe në të dy rastet nuk i është miratuar aplikimi për licencim, konkretisht në inspektimin e datës 01.02.2018, pas verifikimit të kryer, subjektit nuk i është miratuar aplikimi, si dhe në inspektimin e datës 22.10.2018 (pas 8 muajsh) përsëri nuk i është miratuar aplikimi, që do të thotë se nga inspektimi i parë i datës 01.02.2018 deri më datën 04.11.2019, pra 1 vit e 9 muaj, ky subjekt ka ushtruar aktivitet i pa licencuar, dhe një fakt i till është lejuar nga DRAKU Tiranë, pa marrë asnjë masë ndaj këtij subjekti.
Theksojmë se ky subjekt vazhdon të ushtrojë aktivitet i pa licencuar edhe sot, sipas verifikimit të kryer në faqen zyrtare të QKB-së.
Për sa më sipër, për parregullsitë në praktikën e inspektimit mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët Sh.K dhe N.M, si dhe z.F.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Janar-Maj 2018, znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, si dhe z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – Shtator 2019, z.A.N ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020, z.M.N Kryeinspektor për periudhën Qershor dhe në vijim, për lejimin e ushtrimit të aktivitetit nga ky subjekt, në kushtet e mungesës së licencës.

69.Në vijim të inspektimit të mësipërm, me qëllim ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit C, pranë magazinës qendrore të C, është kryer inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-007617-1, datë 05.11.2019. Grupi i inspektimit: N.M, N.H dhe Sh.K.
-Procesverbali i inspektimit me nr.AKU-TR-2019-007617-2, datë 05.11.2019, ku pasqyrohet informacioni, si vijon: "Nga verifikimi në subjekt për gjurmueshmërinë për produktin C, konstatojmë se në subjekt janë **gjendje 10 pako të kthyera nga subjekti G**. Nga verifikimi i pakove, rezultojnë se **3 prej tyre kanë njolla të mykut** dhe pakot e tjera janë të pastra. Këtë sasi subjekti e ka të veçuar me destinacion për asgjesim ose kthim në origjinë vetëm pas mbërritjes së sasisë tjetër **prej 48 copësh**, që gjenden të bllokuara (me urdhër të vetë subjektit C) në marketet e tjera, të cilat janë furnizuar nga C me këtë produkt. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe deklarimet e subjektit, konstatojmë se janë duke u kthyer 48 pako nga ky produkt. Subjekti na vuri në dispozicion dokumentacionin për hyrjen e këtij produkti, për shitjen si dhe komunikimet për bllokimin dhe kthimin në magazinën qendrore. Nuk konstatojmë mangësi për gjurmueshmëri. Për të gjitha sa më lart, u morrë dokumentacioni përkatës dhe subjektit i lihet detyrë që të kthejë në origjinë produktin në sasinë prej 48 copësh, deri më datë 08.11.2019".
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007617-5, datë 05.11.2019, ku nuk ka asnjë masë.
-Bashkëlidhur praktikës 16 certefikata shëndetësore për eksportimin e produkteve, lëshuar nga furnitori në Itali, si dhe 16 hyrjet e bëra në formë tabelare (të cilat nuk pasqyrohen plotësisht, pasi mungon koka e tabelës, për të vlerësuar informacionin që pasqyrohet, nuk kuptohet se sa sasi ka marrë furnizim C Shqipëri nga furnitori në Itali).
-Përmbledhëse për produktin e mësipërm, ku pasqyrohet, kur janë bërë hyrjet në magazinën qendrore 48 koli nga ky produkt, por nuk përcaktohet se sa cop ka një koli, si dhe shitjet e këtij produkti në 16 pika shitje, ku më e detajuar (pra sasia e shitur) pasqyrohet vetëm në 4 pika, në total 48 cope dhe jo edhe në pikat e tjera, sipas faturave dalëse:
Datë: 28.08.2019 - Subjekti J – Fat., nr.9918
Datë: 29.08.2019 - Subjekti A – Fat., nr.10130
Datë: 02.09.2019 - Subjekti T – Fat., nr.10203 (12 cop)
Datë: 04.09.2019 - Subjekti A 2 – Fat., nr.10298
Datë: 06.09.2019 - Subjekti V – Fat., nr.10346 (7 cop)
Datë: 17.09.2019 - Subjekti P.T – Fat., nr.10687

Datë: 23.09.2019 - Subjekti R – Fat., nr.11076
Datë: 02.10.2019 - Subjekti P.T – Fat., nr.11309
Datë: 07.10.2019 - Subjekti E1 – Fat., nr.11729
Datë: 07.10.2019 - Subjekti S – Fat., nr.11578
Datë: 09.10.2019 - Subjekti J – Fat., nr.11652
Datë: 14.10.2019 - Subjekti J – Fat., nr.11832
Datë: 15.10.2019 - Subjekti P 6 – Fat., nr.11976 (8 cop)
Datë: 19.10.2019 - Subjekti E – Fat., nr.12099 (11 cop)
Datë: 19.10.2019 - Subjekti P 19 – Fat., nr.12101 (10 cop)
Datë: 22.10.2019 - Subjekti T – Fat., nr.12211
Datë: 25.10.2019 - Subjekti G – Fat., nr.12416 (Nuk pasqyrohet sasia e shitur, ku sipas inspektimit të mëparshëm, cituar më sipër, subjekti C ka furnizuar subjektin G me 12 cop)
Datë: 25.10.2019 - Subjekti A – Fat., nr.12419

-Komunikimi në telefon (mesazhe), ku pasqyrohet komunikimi ndërmjet disa personave (që nuk dihet se kush janë), ku thuhet të hiqet nga shitja deri në një komunikim tjetër, për më tepër nuk pasqyrohet as data e komunikimit.
Email-i i Administratores së C, magazinës qendrore, dërguar furnitorit në Itali më datë 04.11.2019, ku i pasqyron ankesën e konsumatorit për produktin C, ku i kërkohen edhe disa analiza që ka bërë prodhuesi i këtij produkti, për të vlerësuar se nga vjen problemi.
-Fatura e shitjes me nr.12416, datë 27.10.2019 së produktit C, midis C – G në sasinë 12 copë.

Në praktikën e mësipërme konstatohet se:

-Nga gjykimi i grupit të auditimit, mbi veprimet e inspektorëve, dokumentacionin e verifikuar dhe bashkangjitur praktikës së inspektimit në subjektin C, **rezulton se në këtë rast ky subjekt është favorizuar prej inspektorëve**, për arsye se:

1.Në momentin që kanë bërë verifikimin e produktit që ka kthyer subjekti G, ku 3 kuti kanë dalë me prezencë myku (pra e papërshtatshme për konsum njerëzor[27]), sipas citimit të tyre, atëherë edhe sasinë tjetër të mbetur duhet ta bllokonin dhe sipas Ligjit të ushqimit[28] pasi kjo sasi merret e mirëqenë se ka prezencë myku, ose në të kundërt krijohet detyrimi i inspektorëve që të marrin një mostër/kampion përfaqësues dhe ta analizojnë në laborator, me qëllim që të arrijnë në përfundimin se e gjithë sasia ka prezencë myku apo jo, çka do të thotë se nuk është e përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor, që prezencën e lëndëve të huaja, ta verifikosh nëpërmjet vëzhgimit okular, siç kanë vepruar në këtë rast inspektorët;

2.Si inspektor i DRAKU Tiranë, i cili nëpërmjet detyrave të tij dhe kompetencës ligjore, ka si qëllim që të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, nuk mund të lëri në dëshirë të subjektit, se kur duhet të tërhiqen nga tregu dhe të kthehen në magazinë sasitë e shitura të produktit C, pasi edhe nga komunikimet me mesazhe, që kanë bashkangjitur inspektorët në këtë praktikë, pasqyrohet informacioni se "Urdhri i C" është dhënë për ti hequr nga shitja deri në një komunikim tjetër, por jo ti kthenin në magazinën qendrore;

3.Informacioni i pasqyruar (njësia matëse) nga inspektorët për furnizimet e C me produktin në fjalë, nuk është i plotë, sepse nuk mund të verifikohet se sa cop C ka një koli, pra C është furnizuar 16 herë dhe në total 48 koli, por se me sa cop nuk pasqyrohet. Kjo vlen edhe për shitjet, pra C ka shitur 48 cop apo 48 koli, ç'ka e bënë të paqartë situatën mbi furnizimin, gjendjen në magazinë dhe shitjen, si dhe duke marrë në konsideratë si referenc nga inspektimi i mëparshëm (ku 1 koli ka 12 cop), atëherë rezulton se në total C është furnizuar me 576 cop, ndërkohë sipas njësisë matëse që është përdorur nga inspektorët dhe nga dokumenti bashkangjitur, rezulton se C ka shitur 60 cop (12 tek subjekti G, T – 12 cop, V – 7 cop, P 6 – 8 cop, E – 11 cop, P 19 – 10 cop) dhe llogjikisht duhet të ketë gjendje në magazinë 516 cop ose 43 koli, ndërkohë inspektorët janë

[27] Pika 3 e nenit 11 dhe shkronja a të pikës 1 të nenit 12 të nr.9863, datë 28.01.2008, i ndryshuar.
[28] Pika 4 e nenit 11 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008, i ndryshuar.

shprehur se ka vetëm 10 cop gjendje, që janë kthyer nga subjekti G;
4.Nuk ka asnjë dokument vërtetues (foto) se 7 cop të tjera të produktit C, që kanë vëzhguar inspektorët, janë pa prezencë myku, arsye për të cilin është bërë ankesa por edhe që është autorizuar inspektimi;
5.Masa administrative e lënë nga inspektorët, që subjekti të kthejë në origjinë 48 cop, është e pa mbështetur në ligj dhe jo e plotë, për arsye se në asnjë akt ligjor apo nën ligjor nuk përcaktohet që produkti, i cili është zhdoganuar dhe futur në treg, për arsye të sigurisë shëndetësore, të tërhiqet nga tregu dhe të kthehet në vendin e origjinës. Detyrimi ligjor në këtë rast është bllokimi i produktit, marrja në administrim e tij/vendosja në një vend ku të ndalohet hyrja e personave të pa autorizuar, dhe detyrimi i subjektit për ta asgjesuar atë me shpenzimet e veta. Gjithashtu nga inspektorët duhet të ishte vendosur afati konkret, se kur duhet ta tërheqi të gjithë produktin subjekti C, nga pikat e shitjes, të cilat i ka furnizuar me C;
-Pra për mos të dëmtuar subjektin, të cilit i shtohen kostot e tërheqjes nga tregu dhe asgjesimit të produktit C, nga inspektorët lihet si detyrë që ai të kthehet në vendin e origjinës brenda datës 08.11.2019 (pra nga nga data 03.11.2019 kur është sinjalizuar C për këtë produkt, si dhe datën 05.11.2019 kur është kryer inspektimi, subjektit i lihen edhe 3 ditë të tjera që ta kthejë produktin në origjinë), për më tepër kur nga Administratorja e C, në email-in e dërguar më datë 04.11.2019, drejtuar furnitorit në Itali, **nuk diskuton në asnjë moment mundësinë e kthimit, por kërkon analizat laboratorike që ka kryer prodhuesi i këtij produkti;**
-Nuk administrohet njoftimi ndaj DRAKU Tiranë, që duhet të bëntë subjekti, në momentin që ka vendosur heqjen nga tregu të produktit C.
▪ Këtë situatë të krijuar referuar si më sipër, e rëndon akoma më tepër, **fakti që nuk është kryer asnjë inspektim më pas me qëllim verifikimin, nëse produkti C u tërhoq nga tregu dhe u kthye në vendin e origjinës, brenda datës 08.11.2019.**
-Në këto kushte, grupi i auditimit gjykon, se inspektorët dhe kryeinspektori për atë periudhë me mosveprimet e tyre **nuk kanë garantuar zbatimin e Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008** "Për ushqimin", i ndryshuar, dhe më tej përcaktimin ligjor të bërë në nenin 9 të tij "**Mbrojtja e interesave të konsumatorit**".
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas trajtimit të bërë, mbajnë përgjegjësi z.A.N ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020, si dhe inspektorët N.M, N.H dhe Sh.K.

70. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-006966-1, datë 23.10.2019, në subjektin C, me vendndodhje Rruga Bajram Curri, Qendra Tregëtare E.
Grupi i inspektimit: E.A, E.D dhe V.S.
Objekti i inspektimit: Plane veprimi, monitorime të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
-Listë-verifikimi nuk administrohet në praktikën përkatëse.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006966-2, datë 23.10.2019, ku pasqyrohet se në subjekt u morrën mostra, fileto pule, prodhuar dhe ambalazhuar në Itali, me datë skadence 25.10.2019, si dhe fileto pule prodhuar dhe ambalazhuar nga C, me datë skadence 28.10.2019. Mostrat u dërguan në laboratorin e DRAKU Tiranë.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006966-5, datë 23.10.2019, ku nuk pasqyrohet asnjë shkelje dhe nuk jepet asnjë masë.
-Bashkëlidhur praktikës dy fletë shoqërimi të mostrave të marra si dhe raporti i provës për dy produktet, ku rezulton se janë brenda normës.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Objekti i inspektimit nuk specifikohet konkretisht, por është në vija të përgjithshme, pra çfarë përcaktohet në planet e monitorimit të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë po në të njëjtën datë që është marrë edhe mostra, pa pritur për rezultatet e analizës laboratorike, të cilat kanë dalë më datë 28.10.2020 (ose pas 5

ditësh nga inspektimi i kryer).
-Është analizuar vetëm bakteri Sallmonella, jo edhe bakteri E Coli.
-Nuk administrohet listë-verifikimi i inspektimit.
-Nuk administrohet Urdhri/plani i monitorimit i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas trajtimit të bërë, mbajnë përgjegjësi inspektorët E.A, E.D dhe V.S.

71. Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-TR-2019-001745-1, datë 01.04.2019, në subjektin C F.T, me vendndodhje Rruga Liqeni i Thatë.
Grupi i inspektimit: E.D, R.J dhe L.A.
Objekti i inspektimit: Ankesë e ardhur nga konsumatori, për produktin kërpudha të skaduara.
Kohëzgjatja e inspektimit nga data 01.04.2019 – 02.04.2019, (pra 1 ditë).
-Listë-verifikimi i inspektimit nuk administrohet në praktikë.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001745-2, datë 03.04.2019, ku pasqyrohet se në raftet e produkteve, u gjetën prej tyre të cilave u ka kaluar afati i përdorimit:
P e tymosur në sasinë 0.6 kg me afat përdorimi 23.03.2019;
S R në sasinë 1.8 kg me afat përdorimi Shkurt 2019;
S b në sasinë 1.8 kg me afat përdorimi 31.03.2019;
F D G në sasinë 10 kg me afat përdorimi 15.03.2019;
K f kultivati m i në sasinë 900 gr me afat përdorimi 05.03.2019;
-Për të gjitha produktet e mësipërme u morrë **masa urgjente e bllokimit në magazinën frigoriferike të subjektit.**
-Gjithashtu për këto produkte u kërkua dokumentacioni shoqërues i tyre, me qëllim vlerësimin e sistemit të gjurmueshmërisë, ku ka rezultuar se ai nuk funksionon plotësisht.
Sa më sipër inspektorët kanë vendosur 2 gjoba në vlerën **400,000 lekë gjithsej**.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-001745-5, datë 03.04.2019, pasqyrohen gjobat e vendosura si dhe asgjesimi i produkteve **brenda afatit 19.04.2019**.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet me foto, vendi i depozitimit të produkteve të cilat u bllokuan, si dhe shenjat dalluese të ndalimit të hyrjes apo përdorimit të tyre nga persona të pa autorizuar;
-Për gjobën e vendosur është bërë kërkesë në GJSHP Tiranë, për lëshimin e urdhrit të ekzektimit, dhe me vendimin nr.1532, datë 04.12.2020 është pranuar kërkesa dhe është bërë lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, por në praktikë nuk administrohet shkresa përcjellëse ndaj zyrës së përmbarimit për ekzekutimin e gjobës, çka do të thotë se kjo gjobë nuk është vënë në ekzekutim, *dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 400,000 lekë.*

▪ Në vijim të praktikës së mësipërme nuk është kryer ri-inspektim me qëllim, verifikimin e korrigjimit të detyrës së lënë nga inspektorët, për asgjesimin e produkteve të bllokuara. Gjithashtu nuk administrohet njoftimi që duhet të bëntë subjekti në DRAKU Tiranë brenda datës 19.04.2019.
-Pra si pasojë e mosveprimeve nga DRAKU Tiranë në vijim të inspektimit të mësipërm, nuk është realizuar plotësisht qëllimi i tij, garantimin e zbatimit të kërkesave ligjore si dhe mbrojta e interesave të konsumatorit.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas trajtimit të bërë, mbanë përgjegjësi znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, si dhe inspektorët E.D, R.J dhe L.A.

72.Në inspektimin me autorizimin nr.AKU-2019-004217-1, datë 30.07.2019, në subjektin P.T, C, NIPT: L11801011M, me vendndodhje Rruga Qemal Stafa.
Grupi i inspektimit: D.K dhe E.Sh.

-Listë-verifikimi me nr.AKU-2019-004217-1, datë 30.07.2019, ku pasqyrohet se ambjenti i magazinës ka nevojë për sistemim.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-2019-004217-2, datë 30.07.2019, ku pasqyrohet se ambjenti i magazinës ka nevojë për sistemim dhe një pjesë e raport-analizave ka nevojë për rifreskim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-2019-004217-5, datë 30.07.2019, ku jepet masa paralajmërim dhe korrigjimi i shkeljeve brenda datës 16.08.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet sistemi HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit të bulmetit, që përdor subjekti;
-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Subjekti i inspektuar është licencuar për shitjen e produkteve me origjinë shtazore, ndërkohë në grupin e inspektimit autorizohet inspektori D.K, i sektorit të inspektimit të bimëve, i cili edhe formimin profesional nuk e ka në përputhje me llojin dhe natyrën e aktivitetit që është inspektuar, pra inspektori në fjalë është i diplomuar për Agrobiznes. Për periudhën kur është kryer inspektimi përfshirja e inspektorit në fjalë, në inspektimin e këtyre subjekteve apo për llogari të një sektori tjetër brenda DRAKU Tiranë, bëhet me Urdhër caktimi të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, pasi vetëm ai ka kompetencën ligjore, për kryerjen e lëvizjeve, transferimeve, largimeve, caktimeve etj;
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas trajtimit të bërë, (për autorizimin e inspektorit të sektorit të bimëve) mbanë përgjegjësi z.S.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2019 – Shtator 2019, si dhe inspektorët D.K dhe E.Sh, për mangësitë në procedurën e inspektimit.

▪ Gjithashtu konstatohet se nga DRAKU Tiranë **nuk është bërë inspektim me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 16.08.2019**, si edhe nuk administrohet njoftimi që duhet të bënte subjekti në DRAKU Tiranë, pas afatit **16.08.2019**, për korrigjimin e shkeljeve. Ky mosveprim bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe për këtë mbanë përgjegjësi *z.S.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë.*

<u>Subjekti S AL</u>
73. Inspektimi me autorizimin nr.525/2, datë 29.05.2018, në subjektin S AL market, me objekt licencimin e ushtrimit të aktivitetit përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje të vajit.
-Grupi i inspektimit: E.M dhe L.Zh.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit dhe vendimit nr.0041672, datë 29.05.2018, ku pasqyrohet informacioni se inspektimi nuk u krye për shkak të mbarimit të orarit zyrtar.
Në praktikën e inspektimit konstatohet:
-Inspektorët nuk kanë vendosur ndalimin e hyrjes në mjediset e inspektimit ose dyllosjen e makinerive, të pajisjeve e të dokumenteve të caktuara, për periudhën e ndërprerjes së veprimeve të inspektimit, deri në rifillimin normal të tyre, në zbatim të pikës 2 të nenit 34 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Për këto mbanë përgjegjësi inspektorët L.Zh dhe E.M.

74. Inspektimi me autorizimin nr.529/11, datë 30.05.2018, në subjektin S AL market, me objekt licencimin e ushtrimit të aktivitetit përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje të vajit.
-Grupi i inspektimit: E.M dhe L.Zh.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit dhe vendimit nr.0041674, datë 30.05.2018, ku pasqyrohet informacioni se subjektit i refuzohet kërkesa për licencim.
Në praktikën e inspektimit konstatohet:
-Në kushtet kur ky subjekt ka qenë edhe më përpara duke ushtruar aktivitetin e përpunimit, ambalazhimit, etiketimit dhe shpërndarjes së vajit, sipas verifikimit në QKB, atëherë inspektorëve i krijohet detyrimi që në përfundim të inspektimit, duhet të kishin vendosur ndalimin e ushtrimit të aktivitetit të biznesit si dhe lënien e detyrimit të tij të plotësojë kushtet dhe të riaplikojë për licencim, në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar dhe nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pasi subjekti nuk plotëson kërkesat ligjore si dhe qëllimin për mbrojtjen e interesave të konsumatorit, por ky veprim nga inspektorët nuk ka ndodhur, si dhe subjekti është lënë të ushtrojë aktivitet.
Për këto mbanë përgjegjësi zj.M.M dhe inspektorët L.Zh dhe E.M.

75. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-002881-1, datë 22.08.2018, në subjektin S AL market, me objekt inspektim në rastin kur analizat laboratorike dalin pozitive, me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H, B.Odhe M.Z, inspektor të sektorit OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002881-2, datë 23.08.2018, ku nuk pasqyrohet ora e fillimit të inspektimit dhe ora e mbarimit. Në procesverbalin e inspektimit pasqyrohet informacioni se në subjekt u morrën 3 mostra, vaj ulliri extra i virgjër dhe vaj ulliri i virgjër, në paketime 0,5 litra dhe 1 litër. Në subjekt u bllokua sasia **171 litër vaji**, e cila do të qendrojë e bllokuar deri në daljen e përgjigjes së analizës. Subjekti duhet të tërheqi sasinë e shitur të vajit të ullirit të virgjër. Për këtë lloj vaji subjekti disponon dokumentin e notifikimit, por etiketa me të cilën del në treg produkti nuk është ajo e notifikuara. Referuar raport-provës së analizës laboratorike nr.4573/2018 datë 17.08.2018 për produktin vaj ulliri i virgjër, parametrat e të cilit kanë dalë jashtë standardit, u ndoq gjurmueshmëria dhe rezultoi se subjekti, ku u morrë mostra e vajit të virgjër, është furnizuar me këtë vaj nga subjekti S AL, më datë 24.07.2018. Sipas deklarimit të subjektit S.AL ambalazhimi i vajit kryhet sipas porosive që i vijnë nga klientët. Pra produkti i mësipërm është ambalazhuar nga subjekti S AL. Lenda e parë është blerë tek fermeri Yzedin Hasanaj në datën 04.07.2017 në sasinë 4570 litra, e cila është përdorur për vaj sallate në sasinë 3176 litra dhe për vaj ulliri të virgjër "P" në porcione 0,5 dhe 1 litër në sasinë 854 litra. Subjekti ka shitur nga ky produkt por nuk bën dot identifikimin e produktit sipas numrit të lotit, pasi në etiketë është stampuar vetëm data e skadencës, pra gjurmueshmëria funksionon pjesërisht.
Ndaj subjektit vendoset masë administrative 100,000 lekë për gjurmueshmërinë dhe 50,000 lekë për etiketimin.
-Procesverbali i inspektimit aty për aty nr.AKU-TR-2019-002881-2/1, datë 23.08.2018, ku pasqyrohet informacioni se në subjekt u bllokua sasia prej 171 litra vaj ulliri extra i virgjër dhe i virgjër, nga të cilat 4 litra u morrën mostër për analiza fiziko-kimike pranë DRAKU Tiranë. Ky produkt do të qendrojë i bllokuar deri në daljen e përgjigjes së analizës.
-Vendim për marrjen e masës urgjente nr.AKU-TR-2019-002881-4, datë 23.08.2018, ku nuk pasqyrohet asnjë masë.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002881-5, datë 23.08.2018, ku pasqyrohen masat administrative dhe bllokimi i produktit.
Bashkëlidhur gjurmueshmëria, fatura furnizimi, certefikata D.D.D, libreza shëndetësore, raport provë.

Në praktikën e mësipërme të inspektimit konstatohet se:
-Gjobat e paguara nga subjekti në datën 27.08.2018;
-Dokumenti standard procesverbali i inspektimit aty për aty me nr.AKU-TR-2019-002881-2/1, datë 23.08.2018, nuk parashikohet në përcaktimet ligjore të bëra në Urdhrin nr.25, datë 10.08.2019, pra është i pavlefshëm;
-Në vendimin për marrjen e masës urgjente nuk pasqyrohet asnjë masë administrative, pra ajo e bllokimit të produktit, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në Kreun VI të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2019[29];
-Vendimi i inspektimit është marrë në të njëjtën ditë që janë marrë dhe mostrat për analizën laboratorike, pra pa pritur përgjigjen e tyre, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Kreun V të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2019[30];
-Sasia e furnizuar nga subjekti nuk është pasqyruar plotësisht, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikës rezulton se subjekti është furnizuar 2 herë, pra në datat 04.07.2017 dhe 09.01.2017 me produktin vaj ushqimor ulliri, në sasinë totale 5240 litra, pra subjekti ka patur 5240 litra dhe jo 4570 litra sipas pasqyrimit të grupit të inspektimit;
-Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet se sa litra vaj janë gjendje nga këto dy furnizime dhe sa janë shitur prej tyre, por pasqyrohet vetëm shitja e vajit të ullirit "P" në sasinë 854 litra, por jo edhe sasia e cila është përdorur për vaj sallate, pra këtë sasi subjekti e ka shitur apo e ka patur gjendje në subjekt, për arsye se është një sasi e konsiderueshme;
-Ndaj subjektit janë vendosur dy gjoba, 1 për sistemin e gjurmueshmërisë, e cila në gjykimin e grupit të auditimit qendron, dhe tjetra në për etiketimin e cila është referuar gabim, pasi për shkeljen e konstatuar në këtë rast është përcaktimi ligjor në ligjin e posacëm, konkretisht në shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 12, Ligji nr.87/2013;
-Grupi i inspektimit veç dy gjobave të vendosura ndaj subjektit, duhet të kishin vendosur edhe masën administrative gjobë në vlerën 100,000 lekë, në mbështetje të përcaktimit ligjor të bërë në shkronjën "ç" të pikës 1 të nenit 12 Ligji nr.87/2013, pasi subjekti ka shitur[31] nga ky vaj dhe jo ambalazhuar;
-Nuk dokumentohet me foto bllokimi i sasisë së vajit, dhe referenca ligjore e përdorur në këtë rast, nuk është zbatuar siç duhet, pasi sipas kësaj reference, malli bllokohet dhe merret në administrim[32], por ky veprim nga inspektorët nuk ka ndodhur, pasi ata e kanë lënë vajin e bllokuar në subjekt, duke mos garantuar plotësisht shitjen e tij nga subjekti.
-Inspektorët nuk kanë marrë mostër për analizë laboratorike edhe nga produkti tjetër, i tregëtuar si vaj sallate, pasi ky vaj është pjesë e sasisë së furnizuar (4570 litra, të cilën subjekti S.AL e ka shitur si vaj sallate dhe si vaj ulliri të virgjër "P") dhe kjo e fundit doli me rezultate jashtë standardit, sipas analizës laboratorike të kryer në ISUV, me raport-provën nr.4573/2018. Pra sasia e furnizuar me vaj është e njëjtë, pavarsisht se subjekti e ka përdorur në dy mënyra atë, dhe inspektorët nuk duhet të kishin marrë mostër vetëm në një prej tyre, por në të dyja produktet.
Për këto mbajnë përgjegjësi inspektorët M.H, B.O dhe M.Z.

76. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-002974-1, datë 29.08.2018, në subjektin S AL market, me objekt inspektim në rastin kur analizat laboratorike kanë dalë jashtë normave, me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H dhe M.Z, inspektor të sektorit OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.

[29] "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"
[30] "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"
[31] Rregjistri analitik i shitjeve të vajit të ullirit "perla" në porcionet 0,5 litra dhe 1 litër.
[32] Shkronja ç, pika 2, neni 43 i Ligjit Nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002974-2, datë 30.08.2018 me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se referuar rezultatit të analizave, të cilat dolën jashtë standardit dhe për këtë ndaj subjektit u vendos gjobë në vlerën 200,000 lekë. Në subjekt rezulton se është e bllokuar sasia 171 litra vaj ulliri, sipas bllokimit të bërë në inspektimin e mëparshëm. Gjithashtu subjektit i lihet detyrë që të tërheqë të gjithë sasinë e vajit të shitur. Në lidhje me produktin e bllokuar dhe atë që do të kthehet nga tregu, subjekti duhet të njoftojë DRAKU Tiranë në lidhje me parametrat fiziko-kimike dhe organo shqisore referuar një analize të kryer në lidhje me karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë. Ky produkt duhet të rietiketohet sipas kategorisë së vajit të ullirit referuar raport analizave përkatëse. Subjekti duhet të njoftojë DRAKU Tiranë për situatën.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002974-5, datë 30.08.2018, ku pasqyrohet gjoba e vendosur në vlerën 200,000 lekë, si dhe tërheqjen nga tregu të sasisë së vajit të shitur.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Gjoba është paguar nga subjekti në 07.02.2019.
-Nuk është **përcaktuar afati konkret** për tërheqjen e vajit të ullirit nga tregu, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 48[33];
-Masa e lënë për kryerjen e analizës laboratorike është e pa mbështetur ligjërisht dhe në kundërshtim me rezultatet e raport-provave nr.389, 390 dhe 391/331, pasi ky produkt është analizuar, dhe parametrat e tij fiziko-kimik dolën jashtë normave, dhe nuk ka arsye të rianalizohet me qëllim që të tregëtohet përsëri. Pra kjo masë e lënë nga inspektorët është në kundërshtim të hapur me ligjin, pasi ky produkt rezultoi i pasigurt.
-Masa e lënë për rietiketimin **është e pambështetur ligjërisht**, pra në asnjë përcaktim në Ligjin nr.87/2013 "për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit", Ligjin e ushqimit si dhe në VKM nr.1344, datë 10.10.2008 [34], nuk përcaktohet rietiketimi i ushqimit, pra nuk thuhet se në rastet kur etiketa përmban informacion të gabuar, ajo duhet të rietiketohet, për më tepër që në këtë rast nuk është vetëm problemi i etiketës, por edhe parametrat fiziko-kimik të produktit të cilat kanë dalë jashtë normave (koeficentët e përthithjes të cilët janë tregues të oksidimit të vajit dhe pastërtisë së tij si dhe të kushteve të ruajtjes së tij, ku në rast se këto dalin jashtë normave, tregon se vaji nuk është ruajtur siç duhet, pra në enë çeliku inoksi ose shishe qelqi të errët, dhe për më tepër kur oksidimi është në vlera më të larta se norma, rritet mundësia që të rritet numri i peroksideve, të cilat ndikojnë negativisht në vlerat ushqyese të vajit. Gjithashtu vlera e Delta k, e cila ka dalë mbi normë tregon praninë e dekoloruesve në trajtimin e vajit[35]), dhe në këtë rast nuk duhet të lihet për rietiketim por asgjesimin e tij.
Për këto mbajnë përgjegjësi M.H dhe M.Z.

77. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003282-1, datë 14.09.2018, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme, me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H dhe M.Z, inspektor të sektorit OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003282-2, datë 14.09.2018 me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se subjekti u gjend i mbyllur dhe u bë afishimi i autorizimit në derën hyrëse të subjektit.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003282-5, datë 14.09.2018.

---

[33] Ligji nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
[34] VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit".
[35] Commission Regulation (EEC) No 2568/91 of 11 July 1991 on the characteristics of olive oil and olive-residue oil and on the relevant methods of analysis, Annex ix "spectrophotometric investigation in the ultraviolet".

Në praktikën e inspektimit konstatohet se:
-Nuk dokumentohet me foto se subjekti në ditën kur është kryer inspektimi, është gjendur mbyllur dhe që është bërë afishimi i autorizimit të inspektimit në derën hyrëse të subjektit, ç'ka do të thotë se nuk vërtetohet informacioni i pasqyruar në procesverbal.
-Gjithashtu ora e fillimit dhe mbarimit të inspektimit është e njëjtë, ç'ka do të thotë se kemi të bëjmë me një inspektim fiktiv.
Për këto mbanë përgjegjësi M.H dhe M.Z.

78. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003327-1, datë 17.09.2018, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme, me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H dhe M.Z, inspektor të sektorit OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003327-2, datë 17.09.2018 me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se në subjekt janë të bllokuara 171 litra vaj dhe 157 litra të tjera të kthyera nga tregu sipas detyrës së lënë në inspektimin e mëparshëm. Gjithashtu subjekti duhet ti drejtohet DRAKU Tiranë me një kërkesë për vijimësinë e procedurave për përpunimin e vajit dhe kthimin në vaj sallate sipas deklarimit të bërë.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003327-5, datë 17.09.2018.
Në praktikën e inspektimit konstatohet se:
-Masa e lënë nga inspektorët nuk ka mbështetje ligjore, si dhe në asnjë akt ligjor/nënligjor (Ligji nr.87/2013 dhe VKM nr.235, datë 21.03.2017, vaji i sallatës nuk përcaktohet si produkt.
-Në këtë rast për këtë produkt i cili ka dalë jashtë normave dhe që është hequr nga tregu, duhet të ishte lënë detyrimi i asgjesimit të tij, por që nuk ka ndodhur[36], dhe jo të kthehet në vaj sallate.
Për këto mbanë përgjegjësi M.H dhe M.Z.

79. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003467-1, datë 25.09.2018, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme, me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H, L.A dhe *M.Z*, inspektor të sektorit OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003467-2, datë 25.09.2018 me kohëzgjatje të pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se në subjekt janë të bllokuara 171 litra vaj dhe 157 litra të tjera të kthyera nga tregu sipas detyrës së lënë në inspektimin e mëparshëm. Subjekti mund të fillojë të përpunojë vajin e bllokuar (vaj ekstra i virgjer dhe vaj i virgjer) me qëllim përpunimin e tij si vaj sallate. Gjithashtu subjekti duhet të analizojë vajin e sallatës në laborator dhe të pajiset me raport analizën përkatëse sipas treguesve të vajit të sallatës. Subjekti mbasi të marrë raport provën e testimit të kryejë etiketimin e produktit si vaj sallate.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003467-5, datë 25.09.2018.
Bashkëlidhur kërkesa e subjektit nr.2437 prot., datë 18.09.2018 ku i drejtohet DRAKU Tiranë për të vazhduar me procedurën e përpunimit të vajit të bllokuar për ta përdorur si vaj sallate.
Në praktikën e inspektimit konstatohet se:
-Lejimi i subjektit që të vazhdojë ti përpunojë dy vajrat e mësipërm dhe ti tregëtojë ato si vaj sallate, është i pa mbeshtetur ligjërisht, sjell keqinformim të konsumatorit si rrjedhojë e etiketimit të produktit si vaj sallate, ndërkohë që nuk mund të cilësohet si vaj sallate, pasi vaji i sallatës, që

[36] Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, neni 69.

të konsiderohet i tillë, duhet të ketë në përbërje të tij vaj luledielli në masën 85% dhe vaj ulliri në masën 15%, referuar standardit shtetëror nr.1414-87, dhe jo vaj ekstra të virgjër dhe vaj të virgjër.
Për këto mbanë përgjegjësi M.H, L.A dhe M.Z.

79.1. Mostra e analizuar nga subjekti: K.K
Data e pranimit të mostrës në laborator: 26.09.2018
Data e fillimit të analizës në laborator: 27.09.2018
Data e mbarimit të provës: 02.10.2018
Produktet: Vaj i përzier.
Treguesit e analizuar: Aciditeti, lagështia, peroksidet.
Tarifa e analizës për këtë tregues: 1,680 lekë gjithsej
Për tu paguar nga subjekti: 1,680 lekë gjithsej
Rezultati: Brenda normës
Analisti: H.H dhe F.V
Përgjegjësi i Laboratorit: F.V
Drejtori i DRAKU: M.M
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në analizën laboratorike ka marrë pjesë edhe përgjegjësja e sektorit të laboratorit;
-Fletë-shoqërimi i mostrës nuk është plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar, vendi i marrjes së mostrës, paketimi, sasia dhe lloji i paketimit të kampionit, temperatura e transportit të mostrës, data e skadencës;
-Raport-prova nuk është sipas formatit të përcaktuar si dhe nuk janë plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar siç duhet vendi i kampionimit të mostrës (loti, prodhimi), origjina e mostrës, kushtet e ruajtjes;
-Standardi shtetëror i referuar për përcaktimin e normave (1414-87) i përket vajit të sallatës, ndërkohë në fletë-shoqërimin e produktit nuk përcaktohet si vaj sallate, por vaj i përzjer, dhe nuk përcaktohet që ky vaj është i përbërë nga 85% vaj luledielli dhe 15% vaj ulliri, që të analizohet si vaj sallate, referuar faktit të cituar edhe më sipër.
-Tarifa e paguar nga subjekti.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi zj. F.V, *përgjegjëse e sektorit të laboratorit në DRAKU Tiranë dhe analisti zj.H.H.*

- Mostra e analizuar nga subjekti: K.K

Data e pranimit të mostrës në laborator: 25.10.2018
Data e fillimit të analizës në laborator: 26.10.2018
Data e mbarimit të provës: 29.10.2018
Produktet: Vaj ulliri.
Treguesit e analizuar: Aciditeti, lagështia, peroksidet.
Tarifa e analizës për këtë tregues: 1,780 lekë gjithsej
Për tu paguar nga subjekti: 1,780 lekë gjithsej
Rezultati: Brenda normës
Analisti: H.H
Përgjegjësi i Laboratorit: F.V
Drejtori i DRAKU: M.M
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Fletë-shoqërimi i mostrës nuk është plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar, vendi i marrjes së

mostrës, paketimi dhe lloji i paketimit të kampionit, temperatura e transportit të mostrës, data e skadencës;
-Raport-prova nuk është sipas formatit të përcaktuar si dhe nuk janë plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar siç duhet vendi i kampionimit të mostrës, origjina e mostrës, kushtet e ruajtjes;
-Tarifa e paguar nga subjekti.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi zj. F.V, *përgjegjëse e sektorit të laboratorit në DRAKU Tiranë.*

▪ Mostra e analizuar nga subjekti: K.K
Data e pranimit të mostrës në laborator: 05.11.2018
Data e fillimit të analizës në laborator: 06.11.2018
Data e mbarimit të provës: 08.11.2018
Produktet: Vaj ulliri extra i virgjër.
Treguesit e analizuar: Aciditeti, lagështia, peroksidet.
Tarifa e analizës për këtë tregues: 1,680 lekë gjithsej
Për tu paguar nga subjekti: 1,680 lekë gjithsej
Rezultati: Brenda normës
Analisti: H.H
Përgjegjësi i Laboratorit: F.V
Drejtori i DRAKU: M.M
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Fletë-shoqërimi i mostrës nuk është plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar, vendi i marrjes së mostrës, paketimi dhe lloji i paketimit të kampionit, temperatura e transportit të mostrës, data e skadencës, prodhuesi;
-Raport-prova nuk është sipas formatit të përcaktuar si dhe nuk janë plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar siç duhet vendi i kampionimit të mostrës, origjina e mostrës, kushtet e ruajtjes;
-Tarifa e paguar nga subjekti.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi zj. F.V, përgjegjëse e sektorit të laboratorit në DRAKU Tiranë.

▪ Mostra e analizuar nga subjekti: K.K
Data e pranimit të mostrës në laborator: 17.12.2018
Data e fillimit të analizës në laborator: 18.12.2018
Data e mbarimit të provës: 20.12.2018
Produktet: Vaj ulliri extra i virgjër dhe vaji i bersise.
Treguesit e analizuar: Aciditeti, lagështia, peroksidet.
Tarifa e analizës për këtë tregues: 1,680 lekë gjithsej
Për tu paguar nga subjekti: 1,680 lekë gjithsej
Rezultati: Brenda normës
Analisti: H.H dhe F.V
Përgjegjësi i Laboratorit: F.V
Drejtori i DRAKU: M.M
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në analizën laboratorike ka marrë pjesë edhe përgjegjësja e laboratorit;
-Fletë-shoqërimi i mostrës nuk është plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar, vendi i marrjes së mostrës, paketimi dhe lloji i paketimit të kampionit, temperatura e transportit të mostrës, data e skadencës;

-Raport-provat nuk janë sipas formatit të përcaktuar si dhe nuk janë plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013, konkretisht nuk është plotësuar siç duhet vendi i kampionimit të mostrës, origjina e mostrës, kushtet e ruajtjes, data e skadencës për vajin e bersise;
-Në fletë-shoqërimin pasqyrohet si sasi e sjellë vetëm 0.5 litra kampion, ndërkohë sipas 2 raport-provave rezulton se janë sjellë 1 litër, pra nuk përputhen të dhënat e fletë-shoqërimit me raport-provën;
-Tarifa e paguar nga subjekti.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi zj. F.V, përgjegjëse e sektorit të laboratorit në DRAKU Tiranë.

80. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-00246-1, datë 17.01.2019, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikim për licencimin e ushtrimit të aktivitetit të ambalazhimit, etiketimit, dhe shpërndarjes me shumicë të produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij, mjaltit, mjaltit industrial, recelit dhe turshive, kohëzgjatja e inspektimit e pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H inspektor i OJSH, M.Z inspektor OJSH, dhe L.A inspektor i OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-00246-1, datë 17.01.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-00246-2, datë 17.01.2019, ora e inspektimit 00:00-00:00, ku pasqyrohet informacioni se subjekti ushtron aktivitetin në planimetri dhe kushte higjeno-sanitare të përshtatshme. Mjetet e transportit, të përshtatshme, frigoriferike të pajisur me leje higjeno-sanitare. Drejtuesja e re teknike për të cilën ka bërë kërkesë subjekti ka njohuritë e duhura në fushën specifike të aktivitetit. Disponon libreza shëndetësore, analizën e ujit të rrjetit, certefikatën e shërbimit D.D.D, sistemin HACCP. Transporti kryhet nga vetë subjekti dhe palë të treta. Sa më sipër subjekti i plotëson kriteret për licencim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-00246-5, datë 17.01.2019.
Bashkëlidhur emaili i DPAKU për kryerjen e inspektimit për licencim.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Si fillim subjekti ushtron aktivitet të tregëtimit të produkteve me origjinë shtazore, dhe në këtë rast është e nevojshme prania e një inspektori të sektorit me origjinë shtazore, ndërkohë në grupin e mësipërm janë vetëm inspektor të sektorit me origjinë joshtazore.
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim;
-Licencimi i subjektit me kodin II.1.A.1 është për subjekte të cilat kanë si aktivitet "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", ndërkohë që në asnjë rast nuk përmendet që subjekti kryen edhe veprimin e prodhimit;
-Nisur nga kërkesa e subjektit për ndryshimin e drejtuesit teknik, ku dokumentet provuese të tij janë certefikatë për arsimin, përvojën, rezulton se në këtë praktikë nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument të till. Gjithashtu nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, dezinfektimi i ambjentit;
-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti për licencim, ku për licencimin e këtij aktiviteti, si dokumente provuese nga subjekti duhet të paraqiten: certifikatë e drejtuesit, dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve (për mjediset, teknologjia, pajisjet standardet tekniko-teknologjike dhe ato higjieno-sanitare).
-Gjithashtu ora e fillimit dhe mbarimit të inspektimit është e njëjtë, ç'ka do të thotë se kemi të bëjmë me një inspektim fiktiv.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore nga subjekti që kërkon licencim.
Për këto mbanë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë dhe inspektorët M.H, M.Z dhe L.A.

81. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-000245-1, datë 17.01.2019, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikim për licencimin e ushtrimit të aktivitetit të përpunim, ambalazhim dhe etiketim, dhe shpërndarjes me shumicë të produkteve të vajit të ullirit, kohëzgjatja e inspektimit e pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: M.H inspektor i OJSH, M.Z inspektor OJSH, dhe L.A inspektor i OJSH.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-000245-1, datë 17.01.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-00246-2, datë 17.01.2019, ora e inspektimit 00:00-00:00, ku pasqyrohet informacioni se drejtuesja e re teknike nuk ka certefikatën e kualifikimit. Sa më sipër subjekti i nuk plotëson kriteret për licencim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-00245-5, datë 17.01.2019.
Bashkëlidhur emaili i DPAKU për kryerjen e inspektimit për licencim.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Në kushtet kur ky subjekt ka qenë edhe më përpara duke ushtruar aktivitetin e përpunimit, ambalazhimit, etiketimit dhe shpërndarjes së vajit, sipas verifikimit në QKB, atëherë inspektorëve i krijohet detyrimi që në përfundim të inspektimit, duhet të kishin vendosur ndalimin e ushtrimit të aktivitetit të biznesit si dhe lënien e detyrimit të tij të plotësojë kushtet dhe të riaplikojë për licencim, pasi subjekti nuk plotëson kërkesat ligjore si dhe qëllimin për mbrojtjen e interesave të konsumatorit, por ky veprim nga inspektorët nuk ka ndodhur.
Për këto mbanë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë dhe inspektorët M.H, M.Z dhe L.A.

82. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-002290-1, datë 24.04.2019, në subjektin S AL market, me objekt inspektim për verifikim për licencimin e ushtrimit të aktivitetit të përpunimit, ambalazhimit dhe etiketimit, dhe shpërndarjes me shumicë të produkteve të vajit të ullirit, kohëzgjatja e inspektimit e pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: L.A dhe A.B.
-Autorizimi firmosur nga zj.M.M.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-002290-1, datë 24.04.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002290-1, datë 24.04.2019, ora e inspektimit 00:00-00:00, ku pasqyrohet informacioni se subjekti ushtron aktivitetin në planimetri dhe kushte higjeno-sanitare të përshtatshme. Mjetet e transportit, të përshtatshme, frigoriferike të pajisur me leje higjeno-sanitare. Drejtuesja e re teknike për të cilën ka bërë kërkesë subjekti ka njohuritë e duhura në fushën specifike të aktivitetit. Disponon libreza shëndetësore, analizën e ujit të rrjetit, certefikatën e shërbimit D.D.D, sistemin HACCP. Transporti kryhet nga vetë subjekti dhe palë të treta. Sa më sipër subjekti i plotëson kriteret për licencim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-002290-1, datë 24.04.2019.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim,
-Nuk administrohen dokumentet provuese të drejtuesit teknik si certefikatë për arsimin, përvojën. Gjithashtu nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, dezinfektimi i ambjentit;
-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti për licencim, ku për licencimin e këtij aktiviteti, si dokumente provuese nga subjekti duhet të paraqiten: certefikatë e drejtuesit, dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve (për mjediset, teknologjia, pajisjet standardet tekniko-teknologjike dhe ato higjieno-sanitare).
-Gjithashtu ora e fillimit dhe mbarimit të inspektimit është e njëjtë, ç'ka do të thotë se kemi të bëjmë me një inspektim fiktiv.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore nga subjekti që kërkon licencim.

Për këto mbanë përgjegjësi zj.M.M ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë dhe inspektorët A.B dhe L.A.

Observacionin: Me shkresën nr.1153/5 datë 12.03.2021 është bërë observacion lidhur me praktikën e mësipërme të inspektimit, ku në mënyrë të përmbledhur parashtrohet: Dokumentet janë dorëzuar në protokollin e DRAKU Tiranë. Marrja e dokumentacionit nuk bëhet në inspektime rutinë por në ato që iniciohen mbi indicie, ankesa.
Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH: Grupi i auditimit për observacionin e mësipërm e ka dhënë qëndrimin e tij edhe në rastet e mësipërme, për këtë subjekt.

- **Gjithashtu konstatohet se nga data 30.05.2018, ku në inspektimin me procesverbalin nr.0041674, subjektit S AL i është refuzuar kërkesa për licencim dhe deri në datën 24.04.2019, pra rreth 1 vit, subjekti ka ushtruar aktivitetin e përpunimit, ambalazhimit dhe etiketimit, dhe shpërndarjes me shumicë të produkteve të vajit të ullirit, pa licencën përkatëse, dhe kjo faktohet nga pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit, publikuar në QKB, si dhe nga regjistri i shitjeve të vajit të ullirit "P", që administrohet në praktikën e inspektimit me autorizimin nr.AKU-TR-2019-002881-1, datë 22.08.2018, dhe për këtë DRAKU Tiranë nuk ka marrë asnjë masë, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë nga ky subjekt, dhe garantimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.**

Për këtë mbanë përgjegjësi zj.M.M, Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Prill 2019, e cila nuk ka marrë asnjë masë, për subjektin e mësipërm.

83. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-006594-1, datë 24.11.2020, në subjektin S AL market, me objekt zbatimi i legjislacionit në fuqi, kohëzgjatja e inspektimit fillon në orën 09:05 dhe mbaron në orën 16:30.
-Grupi i inspektimit: A.B dhe L.B, inspektor të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore.
-Autorizimi firmosur nga z.M.N.
-Vendimi për shtyrjen e afatit të autorizimit nr.AKU-TR-2019-006594-10, datë 24.11.2020, për arsye se në subjekt nuk ishte prezent personi përgjegjës për dokumentacionin. Afati shtyhet nga data 24.11.2020 deri në datën 25.11.2020.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-006594-2/1, datë 25.11.2020, ku nuk pasqyrohen shkelje, veç pasqyrimit të komentit në Kap.X, pika 2, ambienti i ruajtjes së ambalazhit duhet të sistemohet më mirë.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006594-2, datë 25.11.2020, ora e inspektimit 13:00-12:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se subjekti disponon planin HACCP, ushtron aktivitetin në kushte të përshtatshme higjenike. Produktet janë të shoqëruara me dokumentacion. Është kryer shërbimi D.D.D. Përdor ambalazh të përshtatshëm. Subjektit i jepet masa paralajmërim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-006594-5, datë 25.11.2020.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim,
-Nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, temperaturat e rruajtjes së produktit, enët në të cilat mbahet produkti;
-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti.
Për këto mbajnë përgjegjësi inspektorët A.B dhe L.B.

84. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-003148-1, datë 30.05.2019, në subjektin S AL market, me objekt licencimin e ushtrimit të aktivitetit të shitjes me shumicë të produkteve me

origjinë shtazore, kohëzgjatja e inspektimit e pa përcaktuar fillon në orën 00:00 dhe mbaron në orën 00:00.
-Grupi i inspektimit: V.Zh inspektor i OSH dhe Y.A inspektor i OSH.
-Autorizimi firmosur nga z.S.S.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-003148-1, datë 30.05.2019, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003148-2, datë 30.05.2019, ora e inspektimit 15:00-17:00, ku pasqyrohet informacioni se subjekti ushtron aktivitetin në planimetri dhe kushte higjeno-sanitare të përshtatshme. Disponon libreza shëndetësore, analizën e ujit të rrjetit, certefikatën e shërbimit D.D.D, sistemin HACCP. Transporti kryhet nga vetë subjekti dhe palë të treta. Sa më sipër subjekti i plotëson kriteret për licencim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-003148-5, datë 30.05.2019
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim,
-Nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, dezinfektimi i ambjentit;
-Nuk janë kontrolluar mjetet e transportit me të cilat subjekti kryen shërbimin e shpërndarjes së ushqimeve, ku sipas përcaktimeve, licenca për këtë kategori jepet për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes, si dhe referuar ekstraktit të QKB për këtë subjekt, vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit janë edhe dy mjetet e transportit me targa AA 239 LK dhe AA 640 JM;
-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti për licencim, ku për licencimin e këtij aktiviteti, si dokumente provuese nga subjekti duhet të paraqiten: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve (për mjediset, teknologjia, pajisjet standardet tekniko-teknologjike dhe ato higjieno-sanitare).
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore për shitjen e produkteve me origjinë shtazore, për njerëz.
Për këto mbanë përgjegjësi z.S.S ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë dhe inspektorët V.Zh dhe Y.A.

85. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-000778-1, datë 21.02.2020, në subjektin S AL market, me objekt zbatimi i legjislacionit në fuqi, kohëzgjatja e inspektimit fillon në orën 09:43 dhe mbaron në orën 14:00.
-Grupi i inspektimit: Z.C inspektor i OSH dhe E.C inspektor i OSH.
-Autorizimi firmosur nga z.A.N.
-Vendimi për shtyrjen e afatit të autorizimit nr.AKU-TR-2019-000778-10, datë 21.02.2020, për arsye se në subjekt nuk ishte prezent personi përgjegjës për dokumentacionin. Afati shtyhet nga data 21.02.2020 deri në datën 24.02.2020.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-000778-1, datë 24.02.2020, ku nuk pasqyrohen shkelje dhe nga subjekti plotësohen të gjitha kushtet.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000778-2, datë 24.02.2020, ora e inspektimit 10:00-12:00, pra 2 orë kohëzgjatja e inspektimit, nga 4 orë e planifikuar në autorizimin e inspektimit. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se subjekti disponon planin HACCP për të dyja licencat (përpunimin e vajit dhe shitjen e produkteve me origjinë shtazore), por duhet ti ndajë në dosje të veçanta. Subjektit i jepet masa paralajmërim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-000778-5, datë 24.02.2020.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim,
-Nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, temperaturat e dhomës frigoriferike, nuk administrohet listë-verifikimi i posacëm për subjekte që kanë dhomë frigoriferike;

-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti.
-Kohëzgjatja e inspektimit është bërë më tepër se afati fillestar i saj.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, garantimin e sigurisë ushqimore.
Për këto mbanë përgjegjësi Kryeinspektori A.N dhe inspektorët Z.C dhe E.C.

86. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-0003892-1, datë 07.07.2020, në subjektin S AL market, me objekt zbatimi i legjislacionit në fuqi, kohëzgjatja e inspektimit fillon në orën 08:48 dhe mbaron në orën 16:30.
-Grupi i inspektimit: E.C inspektor i OSH dhe D.D inspektor i OJSH.
-Autorizimi firmosur nga z.M.N.
-Kërkesë e inspektorëve për shtyrjen e afatit të autorizimit, për arsye se në subjekt nuk ishte personi përgjegjës për dokumentacionin.
-Vendimi nr.AKU-TR-2019-0003892-10, datë 07.07.2020, i miratimit të shtyrjes së afatit, nga data 07.07.2020 deri në datën 08.07.2020.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-0003892-1, datë 08.07.2020, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-0003892-2, datë 08.07.2020, ora e inspektimit 14:00-11:00. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se në subjekt u morrën mostrat djath kaçkavall i stazhonuar dhe djath feta lope, për analizimin e bakterit e-coli në DRAKU Tiranë.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-0003892-5, datë 08.07.2020, subjekti duhet të rinovojë certifikatën e cilësisë së ambalazhit të produkteve si dhe riparimin e disa pllakave frigoriferike.
Bashkëlidhur praktikës fletë-shoqërimi i mostrave dhe raport provat, ku pasqyrohet informacioni se rezultatet për bakterin e-coli janë brenda standardit.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohen kushtet e subjektit, plani HACCP, temperaturat e dhomës frigoriferike;
-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekt.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, garantimin e sigurisë ushqimore.
Për këto mbanë përgjegjësi E.C dhe D.D.

87. Inspektimi me autorizimin nr.AKU-TR-2019-007123-1, datë 16.12.2020, në subjektin S AL market, me objekt zbatimi i legjislacionit në fuqi, kohëzgjatja e inspektimit fillon në orën 08:18 dhe mbaron në orën 16:30.
-Grupi i inspektimit: Z.C dhe K.J inspektor të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore.
-Autorizimi firmosur nga z.M.N.
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2019-007123-1, datë 16.12.2020, ku nuk pasqyrohen shkelje.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007123-2, datë 16.12.2020, ora e inspektimit 14:00-15:30, pra 1.5 orë kohëzgjatja e inspektimit. Në procesverbal pasqyrohet informacioni se subjekti ka dhoma frigoriferike të përshtatshme, disponon librezat shëndëtetësore, ka kryer shërbimin D.D.D, disponon planin HACCP, por duhet të bëjë sistemimin e produkteve sipas natyrës. Subjektit i jepet masa paralajmërim.
-Vendimi përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-007123-5, datë 16.12.2020, ku jepet masa paralajmërim.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Nuk dokumentohet asnjë veprim i kryer në inspektim,
-Nuk dokumentohet kushtet e subjektit, plani HACCP, temperaturat e dhomës frigoriferike;

-Nuk janë plotësuar rubrikat e procesverbalit të inspektimit, konkretisht pika 6 e tij, mbi dokumentet e paraqitura nga subjekt.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektimi është kryer formalisht dhe jo për të përmbushur qëllimin e tij, garantimin e sigurisë ushqimore.
Për këto mbanë përgjegjësi inspektorët Z.C dhe K.J.

88. Praktika e inspektimit në subjektin O.C, në adresën Rruga Ismail Qemali, me autorizimin e inspektimit nr.809/1, datë 09.08.2018, nga inspektorët Z.C dhe A.B;
▪ Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit nr.0041838 datë 09.08.2018, ku pasqyrohet se:
-Ka vendndodhje të përshtatshme;
-Kushtet dhe gjëndja e ambjentit të gatimit janë të mjaftueshme;
-Një pjesë e mureve të tavanit të guzhinës duhet lyer;
-Kushtet higjeno-sanitare të mjaftueshme;
-Personeli i pajisur me librezë shëndetësore, me uniformë;
-Substancat pastruese ruhen në vend të veçant;
-Subjekti përdor uji rrjeti dhe ka kryer analizën bakterologjike;
-Duhet të pajiset me dhomë ftohëse për produktet;
-Ushqimet gjysëm të gatshme ruhen në kushte frigoriferike;
-Ushqimet e gatshme gatuhen dhe serviren brenda ditës;
-Për materialet e paketimit (letër alumini dhe vasketat) disponon çertefikatën e cilësisë;
-Dokumentet shoqëruese të ushqimeve kanë dokumentacionin e shoqërimit;
-Personeli ka eksperiencë;
-Subjekti disponon planin HACCP;
-Sistemi i gjurmueshmërisë funksionon;
Subjektit i lihet detyrë që:
-Të lyejë një pjesë të tavanit dhe muret anësore;
-Të riparojë një pjesë të dyshemesë, pjesën e tavanit, të pajiset me frigorifer freskues për ushqimet.
▪ Për sa më sipër subjekti i jepet masa administrative paralajmërim dhe të korrigjojë detyrat e lëna **brenda afatit 17.07.2018.**
-Listë-verifikimi me nr.00441838, datë 09.08.2018, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit: O.C, **me nr., të licencës: e paplotësuar nga inspektorët.**
Në listë-verifikimin pasqyrohet situata në subjekt, të cilën e kemi përmendur si më sipër, ku veç të tjerave theksojmë se sipas listë-verifikimit:
Kapitulli IX "Dispozita të zbatueshme për produktet ushqimore", më tej pika 2 "Ruajtja e lëndëve të para dhe të gjithë përbërësve të tjerë në kushte të përshtatshme", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të pajiset me frigorifer freskues për perimet";**
Kapitulli IX "Dispozita të zbatueshme për produktet ushqimore", më tej **pika 5 "Ruajtja e zinxhirit ftohës për lëndët e para, përbërësit, produktet gjysëm të gatshme dhe produktet e gatshme"**, ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Të ndajë produktet sipas natyrës në frigorifer".**
Në inspektimin e mësipërm konstatohet se:
-Inspektimi nuk është kryer online, nëpërmjet portalit e-inspektimi;
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet gjendja e ambjenteve të gatimit;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit që përdoret nga subjekti;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit, që përdor subjekti;

-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Konstatohet se **në këtë datë që është kryer inspektimi** subjekti ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse II.1.A.1, dhe nga inspektorët nuk është plotësuar kuadrati përkatës në listë-verifikimin, për numrin e licencës, **si dhe nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në vitin 2013**, dhe informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit nr.0041838, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-Gjithashtu nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë) ndaj subjektit, **i cili nuk ka frigorifer për ruajtjen e lëndëve të para,** për përbërësit që përdor për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimit të gatshëm, shkelje e cila është pasqyruar vetë prej inspektorëve.
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.Z.C, z.A.B për shkeljet e cituara më sipër dhe z.K.T, ish Kryeinspektori për periudhën në të cilën është kryer inspektimi, i cili ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";

▪ Në vijim të praktikës së mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka njoftuar DRAKU Tiranë për korrigjimin e shkeljeve **brenda afatit ligjor 17.08.2019**, dhe nga DRAKU nuk është masë për kryerjen e inspektimit për verifikim e korrigjimit të shkeljeve të lëna në inspektimin e mëparshëm, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *Për sa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

89. Praktika e inspektimit në subjektin O.C me NIPT: L31806005S, në adresën Qendra Tregtare T, Kati 2, me autorizimin e inspektimit nr.AKU-TR-2018-005318-1, datë 26.12.2018, nga inspektorët M.B dhe S.L;
▪ Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit nr.AKU-TR-2018-005318-2, datë 26.12.2018, ku pasqyrohet se:
-Ambjenti i garderobës ka nevojë për sistemim;
-Ambjenti i gatimit ka nevojë për lyerje;
-Vendi ku mbahet ambalazhi ka nevojë për sistemim;
-Ushqimet kanë dokumentacionin e shoqërimit;
▪ Për sa më sipër subjekti i jepet masa administrative paralajmërim**.**
Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2018-005318-1, datë 26.12.2018, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit: O.C, me NIPT L31806005S, **me nr., të licencës: e paplotësuar nga inspektorët.**
-Në listë-verifikimin pasqyrohet situata në subjekt, të cilën e kemi përmendur si më sipër.
Kapitulli I, pika 5, 6, 7, 8, 9, 10, ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Ambienti i rrobës ka nevojë për sistemim";**
Kapitulli II, **pika 1/c.d,** ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Ambienti i gatimit ka nevojë për lyerje".**
Kapitulli IX, **pika 1** ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Disponon dokumentacionin shoqërues për produktet ushqimore, por disa duhen rinovuar".**
Kapitulli X, **pika 1** ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Vendi ku mbahet ambalazhi duhet sistemuar".**
▪ Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2018-005318-5, datë 26.12.2018, jepet masa paralajmërim, dhe korrigjimin e detyrave brenda afatit 29.01.2019 (pas 34 ditësh).

Në inspektimin e mësipërm konstatohet se:
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet gjendja e ambjenteve të gatimit;
-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet analiza bakterologjike e ujit që përdoret nga subjekti;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit, që përdor subjekti;
-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Konstatohet se **në këtë datë që është kryer inspektimi** subjekti ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse II.1.A.1, dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë + ndalim ushtrim aktiviteti deri në pajisjen me licencë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në vitin 2013**, pra duket qartë **se subjekti përsëri është favorizuar** nga inspektorët, dhe informacioni i pasqyruar në procesverbalin e inspektimit **nr.AKU-TR-2018-005318-2, datë 26.12.2018**, **nuk është i plotë dhe nuk pasqyron me vërtetësi kushtet**, në të cilat subjekti ushtron aktivitet;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët M.B dhe S.L për shkeljet e cituara më sipër;

▪ Në vijim të praktikës së mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka njoftuar DRAKU Tiranë për korrigjimin e shkeljeve **brenda afatit ligjor 26.01.2019**, dhe nga DRAKU nuk është marrë asnjë masë për kryerjen e inspektimit për verifikim e korrigjimit të shkeljeve të lëna në inspektimin e mëparshëm, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *Për sa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019.*

90. Praktika e inspektimit në subjektin O.C, në adresën Rruga Ismail Qemali, me autorizimin e inspektimit nr.AKU-TR-2019-004906-1, datë 01.08.2019, nga inspektorët R.J dhe L.A;
▪ Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-004906-1, datë 01.08.2019, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit: O.C, me NIPT L31806005S**.**
-Në listë-verifikimin bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 nr. 22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor" pasqyrohet situata në subjekt,
Kapitulli I, pika 1 "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli I, pika 2 "Planimetria, projektimi, ndërtimi, vendndodhja", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli I, pika 2/a "Mirëmbajtja, pastrimi, dezifektimi, kontaminimi nga ajri dhe hapsira e përshtatshme e punës", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli I, pika 2/b "Papastërtitë e grumbulluara, kontakti me materialet toksike, ndotja dhe formimi i kondesimit/mykut", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli I, pika 2/c "Mbrojtja, kontaminimi dhe kontrolli nga dëmtuesit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli I, pika 5, 6, 7, 8, 9, 10 "kërkesa për ventilim të përshtatshëm, të ambjenteve sanitare për ndriçimin e duhur për funksionimin e kanaleve të shkarkimit, për ambjente të përshtatshme për

personelin (garderoba), për ruajtjen e agjentëve të pastrimit dhe dezifektantët", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli II, pika 1 "Zbatimi i kërkesave specifike të higjenës në ambjentet e përpunimit dhe të ruajtjes së ushqimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli II, pika 1/a.B "Mirëmbajtja dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të dyshemesë dhe i mureve", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli II, pika 1/c.d "Ndërtimi dhe vendosja e përshtatshme e strukturës së tavaneve ose sipërfaqes së brendshme të çatisë dhe dritareve dhe hapjeve të tjera", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli II, pika 1/e.f "Pastrimi dhe dezinfektimi i dyerve dhe i sipërfaqeve në zonat ku trajtrohen dhe janë në kontakt me ushqimin", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli II, pika 2.3 "Kërkesa për sigurimin e ambjenteve dhe mjeteve të përshtatshme për mirëmbajtjen e veglave të punës si dhe të kushteve të përshtatshme për larjen e ushqimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli IX, pika 1 "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli IX, pika 2 "Ruajtja e lëndëve të para dhe të gjithë përbërësve të tjerë në kushte të përshtatshme", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli IX, pika 3 "Mbrojtja e ushqimit në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes nga kontaminantët", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli IX, pika 6 "Kushtet specifike për shkrirjen e produkteve ushqimore", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**
Kapitulli X, pika 1 "Ruajtja e ambalazhit dhe paketimit nga ekspozimi i kontaminimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo";**

- Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit nr.AKU-TR-2018-004906-2, datë 01.08.2019, ku pasqyrohet se:

-Kushtet higjeno-sanitare janë të papërshtatshme;
-Ambjenti ka nevojë për lyerje;
-Pllakat në një pjesë të ambjentit janë të dëmtuara;
-Papastërti në sipërfaqe të punës;
-Produkti mish, shkrihej në sipërfaqe të ambjentit dhe të tjera shkelje të kushteve higjeniko-sanitare, sipas listë-verifikimit, shkelje të cilat bien në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.
-Gjithashtu inspektorët nga verifikimi i dokumentacionit dhe sistemit online të QKB-së, rezultoi se subjekti ushtron aktivitetin i palicencuar për kategorinë II.1.A.1, në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.
-Subjektit i'u la detyrë që brenda datës 14.08.2019 të paraqesi dokumentat (planin HACCP, kontrata e subjektit për shërbimin catering).
-Ndaj këtij subjekti u vendos gjobë:
500,000 lekë për mosrespektim të kushteve të higjienës;
2,000,000 lekë për ushtrim të aktivitetit pa licencën përkatëse;
Paralajmërim.

- Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente nr.AKU-TR-2019-004906-4, datë 01.08.2019, ku ndaj subjektit është marrë masë urgjente e ndërprerjes së aktivitetit deri në plotësimin e kushteve-higjeno sanitare dhe pajisjes me licencë II.1.A.1;
- Vendim përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004906-5, datë 01.08.2019, ku ndaj subjektit është marrë masë administrative gjobë në vlerën: 500,000 lekë për kushtet e higjienës, 2,000,000 lekë për ushtrim të aktivitetit pa licencë, të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe të njoftojë DRAKU Tiranë për realizimin e detyrave brenda datës 14.08.2019.

Në inspektimin e **mësipërm**, nga inspektorët R.J dhe L.A, është konstatuar se subjekti është gjetur duke ushtruar aktivitet në shkelje të kërkesave ligjore të Ligjit për ushqimin, pra të ushtrimit të aktivitetit pa licencën përkatëse dhe në mungesë të respektimit të kushteve higjienike dhe për pasojë ndaj këtij subjekti me vendimin nr.AKU-TR-2019-004906-5, datë 01.08.2019 janë vendosur dy gjoba në vlerat 2,000,000 lekë për ushtrimin e aktivitetit pa licencë dhe 500,000 lekë për mosrespektimin e kushteve të higjenës, si dhe korrigjimin e shkeljeve brenda **datës 14.08.2019.**

Në këtë praktikë konstatohet se:

-Nuk administrohet foto e shenjave dalluese të ndalimit të ushtrimit të aktivitetit;

-Në vendimin përfundimtar nuk është pasqyruar detyrimi që subjektit i ndalohet ushtrimi i aktivitetit të restorantit (prodhim, përpunim dhe shitje e ushqimit).

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët R.J dhe L.A.

▪ Konstatohet se subjekti nuk i ka korrigjuar shkeljet (pajisjen me licencë dhe rregullimin e kushteve higjienike) dhe nuk ka respektuar detyrimin e DRAKU, por ka vazhduar të ushtrojë aktivitet, konfirmuar nga statusi i subjektit "aktiv", në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe bilancit të subjektit për vitin 2019 (ndryshimi i gjëndjes së inventarit të imët-lëndë të para), dhe për këtë nuk është marrë asnjë masë[37] nga DRAKU Tiranë për të bërë ndalimin përfundimisht të ushtrimit të aktivitetit nga subjekti.

-Konstatohet se edhe pas këtyre veprimeve nga subjekti, ndaj tij nuk është bërë kallëzim penal, në mbështetje të pikës 1 të nenit 68 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, dhe në nenin 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ku në rastet kur shkeljet e kërkesave ligjore nuk përbëjnë vepër penale, **por që në këtë** rast gjen mbështetje sipas përcaktimit ligjor të bërë në nenin 288, shkronja "ç" të Ligjit nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ndryshimet e ligjit nr.44/2019, datë18.7.2019, botuar në fletoren zyrtare më datë 27.09.2019), ku thuhet shprehimisht: "Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikëqyrjeje, kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike, mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, dënohet me burgim deri në tre vjet".

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Kryeinspektori z.S.S, i cili ka qenë në detyrë deri në datën 15.10.2019 (pra rreth 2 muaj nga data e korrigjimit të shkeljeve, ose 15 ditë nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore të Kodit Penal), pezulluar me vendimin nr.7407/7, datë 15.10.2019 të Komisionit Disiplinor në AKU, i cili nuk ka marrë asnjë nga masat e cituara më sipër, ndaj këtij subjekti, ku megjithëse ka patur një proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, për gjobat e vendosura, përsëri masat urgjente nuk pezullohen në zbatimin e tyre.[38]

Pra nëse bëjmë një krahasim të shkeljeve të konstatuara në inspektimin e datës 01.08.2019, në të cilin **janë të dokumentuara me foto** shkeljet, me inspektimin e datës 09.08.2018, në të njëjtën vendndodhje të ushtrimit të aktivitetit, pasqyruar në tabelën nr.20, në Kap. "Anekset", dallohet mjaft qartë se në çfarë kushtesh ka ushtruar aktivitet ky subjekt dhe se çfarë masash janë marrë nga inspektorët e të njëjtit sektor.

---

[37] Shkronja "d", pika 5, të VKM nr.1081, datë 21.10.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e AKU", të ndryshuar;

[38] Ligji nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Neni 133 Efektet e ankimit administrativ ndaj aktit administrative, pika 3. Zbatimi i aktit administrativ ndaj aktit nuk pezullohet kur: shkronja c) organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publikë.

Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 51 Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit pika 4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente të marra sipas nenit 43 të këtij ligji.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në vijim të praktikës së inspektimit (ankimi në DP të AKU-së për gjobën e vendosur, ankimi në GJSHP Tiranë i subjektit, vendimi i GJSHP Tiranë, vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, kërkesë për tërheqjen nga ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit), konstatohet se:

-Ankimi administrativ i bërë nga subjekti privat O.C, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, për kundërshtimin e gjobës së vendosur nga inspektorët në vendimin e inspektimit, nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 2 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 34 të Kreut 3 të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ"; si dhe nga organi përgjegjës, (pra komisioni i shqyrtimit të ankesave) nuk është justifikuar një veprim i tillë para organit epror, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 4 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015[39];

-Më datë 18.10.2019 është bërë nga subjekti privat, kërkes-padi në GJSHP Tiranë, për gjobën e vendosur nga inspektorët, dhe si palë e paditur ka qenë DPAKU dhe DRAKU Tiranë, dhe me shkresën nr.4507 prot., datë 21.11.2019 të Drejtorit të DRAKU Tiranë, të komanduar për atë periudhë A.N, është autorizuar H.P (juriste e DRAKU), J.M (juriste në DRAKU Vlorë) dhe K.G (jurist në DPAKU), për ndjekjen e procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit. Në këtë autorizim konstatohet se Drejtori i komanduar i DRAKU Tiranë, ka autorizuar jashtë kompetencave të tij ligjore, juristët e DPAKU (K.G dhe J.M).

- Më datë 23.06.2020, Gjykata e Shkallës së Parë, ka nxjerrë vendimin nr.1220, protokolluar pranë DRAKU Tiranë me nr. 1220 prot., datë 10.07.2020, i cili ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë së palës paditëse person fizik Le Xu;
- Ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ (Vendim përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004906-5, datë 01.08.2019 të palës së paditur, në lidhje me masën e gjobës nga 2,500,000 lekë në 1,300,000 lekë;
- Lënien në fuqi të aktit administrativ (Vendim përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004906-5, datë 01.08.2019, të palës së paditur për pjesët e tjera;
- Vendimi i gjykatës është titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet menjëherë;
- Shpenzimet gjyqësore mbeten në ngarkim të palës paditëse;
- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë;
- Vendimi shpallet më datë 23.06.2020.

-Po në **këtë datë,** ka dalë vendimi **nr.5511/1, datë 23.06.2020**, **i komisionit të shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së**, i cili është protokolluar pranë DRAKU Tiranë më datë 03.08.2020 me nr.1391 prot., e thënë ndryshe një vendim që ka dalë në 23 Qershor 2020, është përcjellë në DRAKU Tiranë në muajin Gusht të vitit 2020, konkretisht më datë 03.08.2020 (ose 42 ditë kalendarike me vonesë), pra duhen 42 ditë kalendarike që Institucioni epror të njoftojë Institucionin e varësisë, për një vendim të marrë, ku veç dërgimit me postë, është edhe komunikimi me email-in zyrtar.

-Ky vendim **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 2,500,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët në vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-004906-5, datë 01.08.2019.

Vendimi nr.5511/1, datë 23.06.2020 është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, z.R.L.

Sa më sipër, referuar vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave, **konstatohet se:**

Ky vendim është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, pasi është në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikat 1 dhe 2 të nenit 70/1, nenit 73 të Ligjit nr.9863, datë

[39] Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, i cili është shtuar me Ligjin nr.16, datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin".
-Sa më sipër VKM për funksionimin dhe organizimin e Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative në ministri, ka dalë **më datë 27.05.2020** me nr.417 dhe është botuar në fletoren zyrtare më datë **01.06.2020**, pra **22 ditë më përpara** se vendimi nr.5511/1, datë **23.06.2020,** i komisionit të shqyrtimit të gjobave në DPAKU, i cili ka shfuqizuar tërësisht gjobën.
-Gjithashtu në Kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 "Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin", përcaktohet se: "Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kalon në Komisionin e Ministrisë së Bujqësisë, të gjitha ankesat dhe dosjet përkatëse **brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e VKM-së, e cila, e përsërisim edhe njëherë, ka hyrë në fuqi më datë 01.06.2020.**
-Veç referencave ligjore të përmendura më sipër, me të cilat bie në kundërshtim ky vendim, është edhe pika 1 e nenit 133 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ndaj vendimit të inspektimit ka patur një proçes gjyqësor në GJSHP Tiranë, dhe në këto kushte nga komisioni i shqyrtimit të gjobave pranë DPAKU, nuk duhet të kishte një vendimmarrje.

Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000 lekë nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, në kushtet e marrjes së vendimit jashtë afatit, si dhe në kushtet e marrjes së vendimit kur ka një proces gjyqësor që po shqyrton vendimin e inspektimit, konstatohet se Vendimi nr.5511/1, datë 23.06.2020 është absolutisht i pavlefshëm.
Si pasojë e Vendimit nr.5511/1 datë 23.06.2020, DRAKU Tiranë ka tërhequr ankimin e bërë në Gjykatën Administrative të Apelit, për kundërshtimin e vendimit nr.1220 datë 23.06.2020, të marrë nga GJSHP Tiranë, vendim në të cilin është lënë reduktimi i masës së gjobës nga 2,500,000 lekë në 1,300,000 lekë, duke e kthyer vendimin e GJSHP Tiranë, të formës së prerë, si dhe duke hequr dorë edhe nga detyrimi ligjor, për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ (Vendimi i gjobës nga inspektorët e DRAKU-së), **trajtuar edhe në pikën 10 të Raportit të Auditimit "Probleme të ndryshme që dalin gjatë auditimit".**

91. Praktika e inspektimit në subjektin O.C, në adresën Rruga Ismail Qemali, me autorizimin e inspektimit nr.AKU-TR-2019-004170-1, datë 08.07.2020, nga inspektorët N.H dhe A.H;
▪ Listë-verifikimi me nr.AKU-TR-2019-004170-1, datë 08.07.2020, i plotësuar nga inspektorët pranë subjektit: O.C, **me nr., të licencës: e paplotësuar nga inspektorët.**
-Në listë-verifikimin bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 nr. 22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor" pasqyrohet situata në subjekt:
Kapitulli I, pika 1 "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo" Ka prezencë papastërtish në guzhinë, ka prezencë të ndryshkur në pajisje, ka të sistemuar keq produktet ushqimore, nuk ka të ndara produktet e gatshme nga lënda e parë;**
Kapitulli I, pika 2/b "Papastërtitë e grumbulluara, kontakti me materialet toksike, ndotja dhe formimi i kondesimit/mykut", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", Ka njolla ndryshku dhe myku;**
Kapitulli II, pika 1 "Zbatimi i kërkesave specifike të higjenës në ambjentet e përpunimit dhe të ruajtjes së ushqimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", nuk zbatohen kërkesat specifike për ruajtjen dhe përpunimin e produktit;**

Kapitulli II, pika 1/e.f "Pastrimi dhe dezinfektimi i dyerve dhe i sipërfaqeve në zonat ku trajtrohen dhe janë në kontakt me ushqimin", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", dyert duhen pastruar dhe lyer;**
Kapitulli II, pika 2.3 "Kërkesa për sigurimin e ambjenteve dhe mjeteve të përshtatshme për mirëmbajtjen e veglave të punës si dhe të kushteve të përshtatshme për larjen e ushqimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", ambjente te pasistemuara;**
Kapitulli V, pika 1/a.b.c.d "Kërkesa për pastrimin dhe dezifenktimin dhe instalimin e përshtatshëm e të gjitha mjeteve dhe pajisjeve në kontakt me ushqimin për shmangien dhe minimizimin e kontaminimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", duhet të organizohet sistemimi i pajisjeve që të shmanget kontaminimi;**
Kapitulli VI, pika 4 "Trajtimi i mbejteve në mënyrë higjienike", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", nuk largohen periodikisht mbetjet. Në momentin e inspektimit u gjetën shumë mbetje;**
Kapitulli VII, "Furnizimi me ujë", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", ka aplikuar për analizë uji, por nuk e ka dokumentin;**
Kapitulli IX, pika 1 "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", lëndët e para duhen të sistemohen sipasj llojit në frigorifer;**
Kapitulli XII, pika 1/a "Mbikqyrjen, udhëzimin dhe trajtimin e personave përgjegjës në sektorët e ushqimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", Personat kanë njohuri minimale;**
Kapitulli XII, pika 1/c "Respektimi i kërkesave të legjislacionit në fuqi në lidhje me programet e trajnimit", ku pasqyrohet shënimi i inspektorëve: **"Jo", Nuk ka detyra të specifikuara për sigurin ushqimore në subjekt;**

- Procesverbali i inspektimit, konstatimit dhe vendimit nr.AKU-TR-2018-004170-2, datë 08.07.2020, ku pasqyrohet se:

-Kushtet higjeno-sanitare janë të papërshtatshme;
-Ambjenti ka nevojë për lyerje;
-Papastërti në sipërfaqe të punës;
-Nuk dallohen produktet e gatshme nga lënda e parë, shkelje të cilat bien në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.
Ndaj këtij subjekti u vendos gjobë:
-bllokim i aktivitetit deri në korrigjimin e mangësive, brenda datës 16.07.2020 dhe njoftimin zyrtar të DRAKU-së,
-300,000 lekë për mosrespektim të kushteve të higjienës;
-Ditën që do të njoftohet DRAKU Tiranë, subjekti të sjellë dokumentat për procedurat ligjore për gjobën e vendosur nga DRAKU Tiranë më datë 01.08.2019, pra para 1 viti.
-Paralajmërim.

- Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente nr.AKU-TR-2019-004170-4, datë 08.07.2020, ku ndaj subjektit është marrë masë urgjente e ndërprerjes së aktivitetit deri në plotësimin e kushteve-higjeno sanitare;
- Vendim përfundimtar i inspektimit nr.AKU-TR-2019-004170-5, datë 08.07.2020, ku ndaj subjektit është marrë masë administrative gjobë në vlerën: 300,000 lekë për kushtet e higjienës, të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe të njoftojë DRAKU Tiranë për realizimin e detyrave brenda datës 16.07.2020.

Në këtë praktikë konstatohet se:
-Nuk administrohet foto e shenjave dalluese të ndalimit të ushtrimit të aktivitetit;
-Në vendimin përfundimtar nuk është pasqyruar detyrimi që subjektit i ndalohet ushtrimi i aktivitetit të restorantit (prodhim, përpunim dhe shitje e ushqimit);
-Nuk dokumentohet planimetria e subjektit;
-Nuk dokumentohet gjendja e ambjenteve të gatimit;

-Nuk dokumentohen kushtet e higjienës, librezat shëndetësore të punonjësve;
-Nuk dokumentohet temperatura e frigoriferit në të cilin ruhen ushqimet;
-Nuk dokumentohet certefikata e cilësisë për materialet e paketimit, që përdor subjekti;
-Nuk dokumentohet, dokumentacioni shoqërues i ushqimeve dhe i etiketimit;
-Nuk dokumentohet plani HACCP;
-Nuk dokumentohet sistemi i gjurmueshmërisë;
-Konstatohet se **në këtë datë që është kryer inspektimi** subjekti ushtronte **aktivitet pa licencën** përkatëse II.1.A.1, dhe nga inspektorët **nuk është marrë asnjë masë administrative** (gjobë) ndaj subjektit i cili ushtron **aktivitet pa licencë që në vitin 2013, megjithëse është e dyta herë që subjekti konstatohet se ushtron aktivitet pa licencë**;
-Sa më sipër arrihet në konkluzionin se inspektorët nuk e kanë kryer inspektimin në përputhje me kërkesat ligjore, që kanë si qëllim garantimin e një ushqimi të sigurt dhe cilësor, për konsumatorin.
Për pasojë, nga mosveprimet e inspektorëve, **nuk është garantuar siguria dhe cilësia e ushqimit**.
-Konstatohet se subjekti ka paraqitur ankim administrativ në DPAKU me shkresën nr.3056, datë 17.07.2020, ndaj gjobës së vendosur, dhe me Vendimin nr.3056/1, datë 30.07.2020 të Komisionit të Ankimeve në DPAKU, është **shfuqizuar vendimi** përfundimtar i inspektimit;
Theksojmë se në këtë vendim arsyetimi i bërë nga Komisioni përkatës:
"Kushtet higjienike nuk janë fikse, por ndryshojnë përgjatë një periudhe kohore të caktuar. Një fakt i tillë nënkupton se një subjekt i cili në një moment të caktuar mund të konstatohet se nuk përmbush njërën nga kërkesat e higjenës, nuk do të thotë se ai është kurdoherë në paligjshmëri", me qëllim shfuqizimin e vendimit të inspektimit, **nuk qendron**, për arsye se nuk ka bazë ligjore dhe se inspektimi si funksion, ka si qëllim respektimin e kërkesave ligjore nga subjektet private/publike, si dhe inspektorët e kryejën inspektimin në vend duke pasqyruar shkeljet të cilat janë konstatuar gjatë inspektimit në subjekt, dhe nuk mund të hamendësojnë që nëse ky subjekt një ditë më përpara i ka respektuar kërkesat e higjenës. '
-Sa më sipër grupi i auditimit konstaton se vendimi nr.3056/1 datë 30.07.2020 i Komisionit, është i paligjshëm.

92.Në vijim të praktikës së mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka njoftuar DRAKU Tiranë për korrigjimin e shkeljeve **brenda afatit ligjor 16.07.2020**, dhe nga DRAKU nuk është marrë asnjë masë për kryerjen e inspektimit për verifikim e korrigjimit të shkeljeve të lëna në inspektimin e mëparshëm, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 6 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *Për sa më sipër mbanë përgjegjësi ligjore z.M.N, Kryeinspektori i DRAKU Tiranë.*

93.Subjekti i inspektuar A.M në 5 janar 2018, tregëtim mishi, në kushtet e kontrollit është konstatuar se nuk plotëson kushtet higjo–sanitare, nuk kanë librezë shëndetsore, nuk ka analizë bakterologjike të ujit, paisjet janë të papërshtatshme.
Nga konstatimi, subjektit i është vendosur gjobë 100 mijë lekë sipas Ligjit 87/2012, por konstatohet se veprimet e inspektorëve L.Z, A.S, B.O janë të pa mjaftushme dhe në mos përputhje me nenin 10, pika 2 dhe pika 3 (pika b) Ligjin 87/2012, ku shprehimisht thuhet "Nëse subjekti nuk përmbush kërkesat sipas nenit 9 të këtij akti normativ, inspektorët e AKU, plotësojnë procesverbalin e konstatimit dhe marrin masat për ndërprerjen e aktivitetit të tij dhe vendosjen e sanksioneve ..." si dhe (pika b) ku thuhet : Konfiskimin e produkteve, veglave të punës, si dhe të cdo materiali tjetër.
Në ndjekjen e procedurave ligjore, konstatohet se subjekti e ka ankimuar masën e gjobës së vënë dhe në vendimin nr.306/1 datë 25.01.2018 është lënë në fuqi dhe sipas shkresës me nr.2943 prot.

datë 22.10.2018 DRAKU i është drejtuar Shoqërisë Përmbarimore me nr.7449 prot datë 19.10.2018.
Pra konstatohet se ka zgjatje të afateve të ndjekjes se gjobave nga janari i vitit 2018, shkresa për ekzekutim i është nisur në Tetor të vitit 2018, pra mbas 9 muaj, si dhe deri tani kjo gjobë është e pa arkëtuar.
Pra si pasojë e mosveprimeve sipas kuadrit ligjor, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 100 mijë lekë, dhe kamat vonesat "duke mos llogaritur afatet ligjore të ankesës së subjektit" në vlerën **48 mijë lekë** (100,000 x 2 % x 24 muaj), pra 148 **mijë lekë gjithsej,** dhe për këtë mbajnë përgjegjësi z.F.S, zj.M.M, z.S.S, z.A.N.
Gjithashtu konstatojmë se sipas kordinatorit të sektorit me Origjinë Shtazore z.I.F, megjithse janë gjetur një sërë mangësish në subjektin e inspektuar, A.M me aktivitet tregëti mishi, nuk është inspektuar në vazhdimësi, për të evituar shkeljet e konstatuara nga inspektorët si me sipër në inspektimet pasardhëse.
Në dosje nuk ka asnjë të dhënë nga zyrat përmbarimore se çfarë është bërë me subjektin A.M duke e quajtur të përfunduar procedurën në kundërshtim me pikën 14 të urdhërit nr. 4277 datë 01.12.2015 dhe pikën 4 të urdhërit nr. 1586 datë 28.04.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm.

94.Subjekti i inspektuar OBU "M" nga inspektorët E.V, D.D në datën 10 janar 2018, tregëtim mishi, ku është konstatuar se nuk plotëson kushtet higjeno–sanitare, nuk ka analizë bakterologjike të ujit, tregton mish pa vulë, pa certifikatë veterinare.
Subjektit i është vendosur gjobë **120 mijë lekë** sipas Ligjit 87/2012, dhe sekuestrim të 12.8 kg mish qëngji dhe 60.9 kg mish vici, në procesverbalin e inspektimit dhe vendimit përfundimtar është **bllokuar aktiviteti** deri në plotësimin e kushteve të legjislacionit përkatës.
Në dosje nuk ka dokumentacion mbi ç'bllokimin e aktivitetit të këtij subjekti.
Sipas vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë me nr.483 93134-01977-80-2018 datë 10.04.2018 është lënë në fuqi akti administrativ.
Sipas shkresës me nr.318/8 prot. datë 21.11 2018, DRAKU i është drejtuar Shoqërisë Përmbarimore me nr.3731 prot datë 07.12.2018. Pra konstatohet se ka zgjatje të afateve të ndjekjes së gjobës nga janari i vitit 2018, shkresa për ekzekutim i është nisur në Nëntor të vitit 2018, pra mbas 9 muaj, si dhe nuk ka informacion shkresor nëse subjekti vazhdon aktivitet apo është aktualisht i mbyllur dhe deri tani kjo gjobë është e pa arkëtuar.
DRAKU Tiranë nuk administron asnjë informacion nga zyra përmbarimore **se çfarë është bërë me ekzekutimin e gjobës, në kundërshtim me pikën 14 të urdhërit nr.4277 datë 01.12.2015 dhe** pika 4 e urdhërit nr.1586 datë 28.04.2016.
Pra si pasojë e mosveprimeve sipas kuadrit ligjor, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 120 mijë lekë, dhe kamat vonesat "duke mos llogaritur afatet ligjore të ankesës së subjektit" në vlerën 57 mijë lekë (120,000 x 2 % x 24 muaj), pra gjithsej 157 mijë lekë, *dhe për këtë mbajnë përgjegjësi z.F.S, zj.M.M, z.S.S, z.A.N.*
Në dosje nuk ka asnjë të dhënë nga zyrat përmbarimore se çfarë është bërë me subjektin M duke e quajtur të përfunduar procedurën në kundërshtim me pikën 14 të urdhërit nr. 4277 datë 01.12.2015 dhe pikën 4 të urdhërit nr. 1586 datë 28.04.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm.

95.Subjekti i inspektuar B në 10 janar 2018, tregëtim mishi, ku është konstatuar se nuk plotëson kushtet higjeno–sanitare, nuk ka analizë bakterologjike të ujit, tregëton mish pa kushtet e përshtatshme, ambjent i kufizuar pa derë dhe i pa lyer.
Inspektimi i kryer nga E.C dhe S.K.
Në këto kushte subjektit i është vendosur gjobë 30 mijë lekë dhe bllokimi i aktivitetit.

Sipas vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë me nr. 474(33134-01974-80) datë 10.04.2018 është lënë në fuqi akti administrativ.
Sipas shkresës me nr.7212 prot datë 11.10 2018 nga ish/Drejtori i Përgjithshëm A.I, i është kërkuar zyrës përmbarimore për ekzekutim vendimi.
Në shkresën me nr.1356 prot. datë 08.11 2018 të Shoqërisë Përmbarimore, rezulton se janë nisur procedurat për zbatimin e aktit administrativ.
Në këtë praktikë konstatohet se ka **zgjatje të afateve të ndjekjes së gjobave nga janari i vitit 2018, shkresa për ekzekutim i është nisur në Tetor të vitit 2018, pra mbas 8 muaj,** si dhe deri tani kjo gjobë është e pa arkëtuar.
Është ndjekur procedura sipas Ligjit për ç'bllokimin sipas Proces verbal Inspektimit me nr. serial 0043535 datë 19.01.2018.
Në dosje nuk ka asnjë të dhënë nga zyra përmbarimore, se çfarë është bërë me ekzekutimin e gjobës ndaj subjektit B duke e quajtur të përfunduar procedurën, në kundërshtim me "pikën 14 "të urdhërin nr. 4277 datë 01.12.2015 dhe "pika 4 urdhërit" nr. 1586 datë 28.04.2016.
Për mos vazhdimin e procedurave të aktit administrativ mbi 2 vjet dhe bën të pa vlefshëm vendimin dhe të pa arketushem këtë gjobë.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 30 mijë lekë dhe kamat vonësa në vlerën 14 mijë lekë (30,000 x 2 % x 24 muaj) nga ish drejtori F.S, ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S,z A.N.

96.Subjekti i inspektuar M në 12 janar 2018, tregëtim mishi dhe mezeri ku është konstatuar se nuk plotëson kushtet higjo–sanitare, nuk ka analizë bakterologjike të ujit, tregëton mish pa kushtet e përshtatshme, ambjent i kufizuar frigorifer dhe pa librezë shëndetësore.
Në këto kushte subjektit i është vendosur gjobë 50 mijë lekë sipas nenit 10 pika 3 Ligjit 87/2012.
Me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë nr.484 datë 06.04.2018, është lënë në fuqi akti administrativ.
Sipas shkresës me nr.7877 prot datë 30.10. 2018 nga ish/Drejtori i Përgjithshëm A.I i është kërkuar zyrës përmbarimore për ekzekutim vendimi.
Në shkresën me nr.1355 prot. datë 07.11 2018 të Shoqërisë Përmbarimore, rezulton se janë nisur procedurat për zbatimin e aktit administrativ.
Në këtë praktikë konstatohet se ka zgjatje të afateve të ndjekjes se gjobave nga janari i vitit 2018 shkresa për ekzekutim i është nisur në Tetor të vitit 2018, pra mbas 8 muaj, por në dosjen e inspektimit administrohet mandati i arketimit në datën 26.11.2018 me nr. llogarie 0104030780, **ku janë llogaritur dhe kamat-vonesat në vlerën 59,734 lekë.**

97.Subjekti i inspektuar I në 13 janar 2018, tregëtim mishi Kavajë ku është konstatuar se sasia e mishit të gjetur është pa vulë dhe pa certifikatë veterinare. Inspektorët L.Z dhe A.N.
Në këto kushte subjektit i është vendosur gjobë 100 mijë lekë sipas nenit 16 pika 1, Ligjit 87/2012.
Subjekti ka ankimuar vendimin administrativ, dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë është marë vendimi nr. 481 datë 06.04.2018 për lënie në fuqi.
Sipas shkresës me nr.8042 prot datë 06.11. 2018 nga ish/Drejtori i Përgjithshëm A.I i është kërkuar zyrës përmbarimore për ekzekutim vendimi.
Në shkresën me nr.1240 prot. datë 26.11 2018 të Shoqërisë Përmbarimore, rezulton se janë nisur procedurat për zbatimin e aktit administrativ.
Në këtë praktikë konstatohet se ka zgjatje të afateve të ndjekjes se gjobave nga janari i vitit 2018 shkresa për ekzekutim i është nisur në Nëntor të vitit 2018, pra mbas 9 muaj. Gjithashtu konstatohet se gjoba nuk është paguar nga subjekti.

Në dosjen përkatëse nuk administrohet asnjë informacion nga zyra përmbarimore se çfarë është bërë me ekzekutimin e detyrimit të subjektit, duke e quajtur të përfunduar procedurën.
-Konstatojmë se nga inspektorët në mallrat e sekuestruara nuk përpilohet sakt procesverbali ku përshkruhet dhe nuk thuhet se ku ka vajtur kjo sasi mishi. Pra nuk ka dokument bllokimi ose foto etj. faturë të funizimit të sasise se mishit pa vule sanitare, **nuk** dokumentohet transporti i mishit të sekuestruar në qytetin e Kavajes dhe vendin magazinimin e mallit.

98.Subjekti i inspektuar A në 13 janar 2018, tregëtim mishi Rogozhinë, ku është konstatuar se sasia 10 kg mish pa vulë dhe pa certifikatë veterinare. Inspektimi i kryer nga inspektorët N.H, M.K.
Në këto kushte subjektit i është vendosur gjobë 200 mijë lekë sipas nenit 10 të Ligjit 87/2012 dhe sekuestruar 1 peshore, 1 thikë, 3 cengela, 10 (dhjetë) kg mish qengji.
Në këtë praktikë konstatohet se:
Nuk administrohet asnjë dokument mbi vendin e dorëzimit të mishit dhe pajisjeve të punës, të cilat janë sekuestruar nga grupi i inspektimit;
Nga DRAKU nuk janë marrë masat për vënien në ekzekutim të gjobës, brenda afatit dy vjeçar, por GJSHP Tiranë, me shkresën nr.1754, datë 05.05.2020 (pra rreth 2.4 vite vonesë), i është kërkuar lëshimi i urdhërit të ekzekutimit.
Sa më sipër grupi i auditimit konstaton se si pasojë e mosveprimeve nga DRAKU Tiranë, gjoba është parashkruar dhe nuk mund të arkëtohet. Theksojmë se edhe sikur GJSHP Tiranë të nxjerri vendimin për ekzekutimin e kësaj gjobe, subjekti në çdo moment mund ta ankimojë atë në Gjykatën e Apelit dhe ta fitojë me parashkrim.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 290 mijë lekë gjithsej, 200 mijë lekë gjoba dhe kamatvonesa në vlerën 96 mijë lekë (200,000 x 2 % x 24 muaj)
Për këtë mbajnë përgjegjësi F.S, zj.M.M, z.S.S, z A.N dhe juristi i DRAKU Tiranë H.P.

99.Përsëri subjekti A është inspektuar në 15 dhjetor 2018, ku është konstatuar se sasia e mishit është pa vulë veterinare 18.9 kg mish, subjekti ishte i pa rregjistruar në QKB. Inspektimi është kryer nga inspektorët E.V, G.H dhe N.H.
Në këto kushte subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 250 mijë lekë sipas nenit 10 të Ligjit 87/2012.
Nga zyra juridike e AKU-Tiranë nuk na u paraqitën dokumenta mbi ndjekjen e procedurave të ekzekutimit të gjobës për herë të dytë të këtij subjekti, me faturën nr. serie 0054980 dhe vlerë 250 mijë lekë.
Në këtë praktikë konstatohet se:
Nuk administrohet asnjë dokument mbi vendin e dorëzimit të mishit dhe pajisjeve të punës, të cilat janë sekuestruar nga grupi i inspektimit;
Nga DRAKU nuk janë marrë masat për vënien në ekzekutim të gjobës, brenda afatit dy vjeçar.
Sa më sipër grupi i auditimit konstaton se si pasojë e mosveprimeve nga DRAKU Tiranë, gjoba është parashkruar dhe nuk mund të arkëtohet.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 370 mijë lekë gjithsej, 250 mijë lekë gjoba dhe kamat vonesa në vlerën 120 mijë lekë (250,000 x 2 % x 24 muaj).
Për këtë mbajnë përgjegjësi zj.M.M, z.S.S, z.A.N, z.M.N dhe juristi i DRAKU Tiranë H.P.

100.Subjekti i inspektuar G në 14 janar 2018, tregëtim mishi, ku është konstatuar se sasia e mishit të gjetur është pa vulë dhe certifikatë veterinare. Inspektimi është kryer nga inspektorët Z.C, D.D, E.V dhe B.O.

Në këto kushte subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 100 mijë lekë sipas nenit 16, pika (a) të Ligjit 87/2012 dhe konfiskuar 29,6 (njezet e nëntë pikë gjashtë) kg mish vici.
-Në Procesverbal Inspektimi dhe Vendimi Përfundimtar, konstatohet se mishi është dërguar në subjektin privat B, dhe nuk ka asnjë dokument hyrje malli të bashkagjitur dosjes.
Subjekti ka paraqitur kërkesën "e cila **nuk** ndodhet në dosje" dhe nga AKU i është dërguar vendimi nr. 406/1 datë 05.06.2020 ku ka shqyrtuar ankesën dhe e ka lenë në fuqi.
Sipas vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë me nr.481 datë 22.07.2020 ka lënë në fuqi masën administrativ.
Konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dergim të shkreses së zyrave përmbarimore, dhe bën të pa vlefshëm vendimin dhe të pa arketushem këtë gjobë.
Pra konstatojmë se me mosveprime janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 100 mijë lekë, si dhe kamat vonesat në vlerën **48 mijë lekë** (100,000 x 2 % x 24 muaj) nga ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S ish/drejtor, z A.N ish/drejtor**.**

101.Subjekti i inspektuar A në 14 janar 2018, Restorant, ku është konstatuar se nuk ka të përshtatshme kushtet higjeno-sanitare, punonjësit pa rinovuar librezën shëndetësore. Inspektimi është kryer nga inspektorët Z.C, D.K, E.V, B.O, me autorizimin nr.48./1, datë 14.01.2018.
Në këto kushte subjektit i është vendosur gjobë **400 mijë lekë**, si dhe është bërë bllokimi i prodhimeve ushqimore deri në korigjimin e mangësive dhe njoftim në DRAKU –Tiranë.
Subjekti ka paraqitur ankesën "e cila **nuk** ndodhet në dosje" datë 14.01.2018 me nr.48/1.
Nga Drejtoria e AKU i është dërguar vendimi nr. 48/1 datë 17.07.2018 dhe ka shqyrtuar ankesën të cilën e ka lenë në fuqi vendimin administrativ.
Sipas vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë me nr. 31134-04882-80 të aktit datë 07.09.2018 ka lënë në fuqi masën administrativ.
Në shkresën me nr.7211.prot.datë 11.10.2018 Drejtoria e Përgjithshme e AKU i është drejtuar Përmbaruesit Gjyqsor "J" Shpk.
Në dosje nuk ka asnjë të dhënë nga zyrat përmbarimore se çfarë është bërë me subjektin Ardi Hajdini duke e quajtur të përfunduar procedur**.**
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 400 mijë lekë, si dhe kamat vonesat në vlerën 192 mijë lekë (400,000 x 2 % x 24 muaj) nga ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S ish/drejtor, z A.N ish/drejtor**.**

102.Subjekti i inspektuar S në 14 janar 2018, Prodhim tregeti , prodhime gatimi në kushtet e kontrollit është konstatuar se nuk ka të përshtatshme kushtet higjenitare, punonjësit pa rinovuar librezen shendetsore, të inspektuar nga inspektorët Z.C, D.D, E.V, B.O , me autorizimin nr.48./2. Datë 14.01.2018.
Në këto kushte të konstatuara subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 400 mijë lekë, për kushtet higjeno sanitare të pa mjaftushme, nuk ka rinovuar librezat shëndetësore, nuk ka rinovuar analizën bakterologjike të ujit, nuk ka flet analizë të produkteve, është bërë bllokimi i prodhimeve ushqimore deri në korigjimin e mangësive dhe njoftim në DRAKU –Tiranë.
Subjekti të lart përmendur ka paraqitur ankesën "e cila **nuk** ndodhet në dosje " datë 18.01.2018 me nr.463/1.
Nga Drejtoria e AKU i është dërguar vendimi nr 463/1 datë 26.07.2018 ku ka shqyrtuar ankesën dhe e ka lenë në fuqi vendimin administrativ.
Sipas vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë me nr. 4093 të vendimit datë 12.11.2018 kapranuar pjesërisht padinë e paditësit AKU nga paditësi Shaban Aga .
Në shkrësën derguar Aku "kartëla shoqëruse e praktikës" e ardhur në nr.470 prot. Datë 09.03.2020.

Në proceduren e ndjekur konstatojmë se subjekti e ka ndjekur vetë procedurën në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Tiranë dhe në vendimin e marë gjykata ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë.
Vendimi është protokolluar në nr. 470 prot, datë 09.03.2020 ardhur nga në DP-AKU Tiranë, dhe **nuk ka ndjekje të shkallve të tjera në Gjykatën e Apelit**.
Pra në dosje nuk ka asnjë të dhënë, si është vepruar, vazhdimësia e procedurave ligjore me ketë subjekt, kur kanë kaluar periudhën e aktit administrativ mbi 2 vjet, konstatohet se ka zgjatje të afateve, mos ndjekje në shkalle të tjera të gjukatës, si dhe mos dërgim të shkresëes në zyrat përmbarimore në afat, dhe bën të pa vlefshëm vendimin dhe të pa arketushem ketë gjobë.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën 400 mijë lekë, si dhe kamat vonesat në vlerën 192 mijë lekë (400,000 x 2 % x 24 muaj) nga ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S ish/drejtor, z.A.N ish/drejtor me mos veprim i kanë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 592 mijë lekë.

103.Subjekti i inspektuar A në 31 Tetor 2018, Tregeti vezë, i pa rregjistruar në QKR, pa vule nga subjekti, të inspektuar nga inspektorët R.J, A.N, E.C, E.M, me autorizimin nr.4093-1,datë 31.10.2018.
Në këto kushte të konstatuara subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 300 mijë lekë,si dhe është bllokuar 14 400 kokra vezë dhe do të njoftohet DR-AKU për asgjesimin e tyre .
Në datën 01.11.2018 subjekti A ka paraqitur kërkesën pranë DR-Tiranë AKU, për lidhjen e kontratës në kushtet për pamjaftushmeri të ardhurash, me qëllim likujdimin e gjobës.
Në akt marveshjen me nr 3253/1 prot. datë 01.11.2018 nga DRAKU –Tiranë nga ish/Dejtori M.M ku është rënë dakort që likujdimi sipas akt- marveshjes të bëhej me këstë dhe të fillohej në muajin dhjetor 2018 për 6 muaj me nga 50 mijë lekë në muaj.
Në dosje subjekti ka likujduar në datën 19.12.2018 shumen 50 mijë lek, pranë degës së thesarrit Tiranë,"mandati i fotokopjuar në dosje", mbas kesaj për muajt në vazhdim subjekti ka likujduar detyrimin sipas akt marveshjes.
Pra konstatojmë se në autorizimin me nr.1112/1 prot datë. 23.11.2018 ka autorizuar inspektorët N.H, E.V, V.V, është mbajtur Procesverbal, Vendimi Përfundimtar ku cilësohet sasia, por nuk kanë llogaritur cmimin për njësi dhe vlerën totale të asgjesimit në lekë, si dhe proces verbali Vendimi,"Asgjesimi" përshkruhet vetëm sasia sasia e vezve dhe u trasportua me mjetin me targa AA874 PF dhe është derguar në Landfillin e Sh .
Pra nuk ka as nje foto kur trasportua nga magazina, nuk ka asnjë foto kur janë azgjësuar në lanfillin e Sharës.

104.Subjekti i inspektuar L, në 31 Tetor 2018, Restorant–Guzhinë i rregjistruar në QKR, të inspektuar nga inspektorët Sh.K dhe V.V, me autorizimin nr.4087-5,datë 31.10.2018.
Në këto kushte të konstatuara subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 300 mijë lekë, si dhe është bllokuar aktiviteti i guzhinës.
Për mos vazhdimin e procedurave të aktit administrativ mbi 2 vjet, konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dërgim të shkresave në organët gjyqsore dhe zyrës përmbarimore
Në datën 26.05.2020 me nr. 8130/1 prot është marë vendimi për "shqyrtim ankimimi" subjekti L ka bërë kërkesë pranë DR-Tiranë AKU, për lidhjen aktin administrativ, e cila është shqyrtuar mbas 1 vit e 9 muaj vonesë dhe është protokolluar në datën 28.05.2020 me nr. 840. Prot. Në Vendim shprehet se Subjektit L rrëzon kërkesën dhe le në fuqi aktin administrativ për gjobën 300 mijë lekë" por në shkresë nuk i llogarisin kamat vonesën.
Megjithse ankesa është shqyrtuar me vonëse nga **Ish/drejtori R.L** dhe në vendim nuk cilsohen kamat vonesat për mos likujdimit të gjobës në afat, pra **nuk** përshkruhet sakt detyrimi që duhet të likujdoje subjekti i cili është gjobitur 300 mijë lekë dhe kamat vonesa në vlerën dhe mos pagimi

në afat, në vlerën **126 mijë lek**ë, (300,000 x 2 % x 21 muaj), nga ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S,z A.N, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën **426 mijë lekë.**

105.Subjekti i inspektuar F, në 31 Tetor 2018, Banesë private(ushqimore) i rregjistruar në QKB, të inspektuar nga inspektorët V.ZH, Y.A, N.M, me autorizimin nr.4079-1,datë 31.10.2018.
Në këto kushte të konstatuara subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 200 mijë lekë, për mos pasje analiza mikrobiologjike, mos mbajtja pastër e ambjentit higjeno sanitare.
Në dosje ndodhet vendimi me nr. 8530/1 datë 26.05.2020 dhe e protokolluar në AKU me nr .844 datë 26.05.2020 duke kalim të afatet ligjore .
Për mos vazhdimin e procedurave të aktit administrativ mbi 18 muaj, konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dergim të shkreses organëve gjyqsore dhe zyrave përmbarimore,
Në datën 26.05.2020 me nr. 8530/1 prot është marë vendimi për " shqyrtim ankimimi " subjekti F ka bërë ankesë pranë DR-Tiranë AKU, për lidhjen aktin administrativ, e cila është shqyrtuar mbas 1vit e 6 muaj vonesë dhe është protokolluar në datën 26.05.2020 me nr. 844. Prot. Në Vendim shprehet se Subjektit F rrëzon kërkesën ankimore dhe lenë fuqi aktin administrativ për gjobën 200 mijë lekë" por nuk llogarisin kamat vonësen dhe nuk venë në dijeni subjektin ".
Megjithse ankesa është shqyrtuar me vonëse nga **Ish/drejtori R.L** dhe në vendim nuk cilsohen kamat vonesat për mos likujdimit të gjobës në afat, pra **nuk** përshkruhet sakt detyrimi që duhet të likujdoje subjekti i cili është gjobitur 200 mijë lekë dhe kamat vonesa në vlerën dhe mos pagimi në afat, në vlerën 72 mijë lekë, (200,000 x 2 pëqint x 18 muaj), nga ish /Drejtorët, zj.M.M, z.S.S,z A.N, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën **272 mijë lekë.**
Gjithashtu në dosje ndodhet dhe një imel nga juristja H.P ku kërkohet informacion për ekzekutimin në Gjykata administrative e Shkallës parë Tiranë në datën 13.08. 2020 ora 15-06.

106.Subjekti i inspektuar S, në 24.10.2018, Tregëti mishi i rregjistruar në QKR. Inspektimi i kryer nga inspektorët G.H, Z.C, L.B, Y.A, me autorizimin nr.3974-1,datë 24.10.2018.
Në këto kushte subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë 100 mijë lekë, për mungesen e vulës veterinare të mishit dhe i janë konfiskuar 32 kg mish Vici.
Në shkresën me nr.1401 prot., datë 04.08.2020 DRAKU Tiranë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallë se Parë Tiranë për lëshimin e urdhër ekzekutimit të përpiluar nga në mugesë dhe porosi nga specialisti I.F në të cilen **nuk kërkohet për likujdim** dhe kamat vonesa, në kundërshtim me urdhërin nr.4277 datë 01.12.2015 pika 14 nxjerre nga ish/Drejtori i Përgjithshëm i AKU.
Në dosje ndodhet vendimi me nr.8627/1 datë 05.06.2020 dhe e protokolluar në AKU me nr.943 prot. datë 10.06.2020 duke kaluar afatet ligjore .
Në dosje ndodhet pagesa e subjektit në vlerën 100 mijë lekë në datën 10.08.2020, por jo edhe pagesa e kamat-vonesës për 21 muaj.
Pra nuk janë likujduar kamat-vonesat në shumen **42,000 lekë** (100,000 x 21 muaj x 2 %), duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerë **42 mijë lekë**.
107.Në autorizimin me nr.1069/1 prot datë 08.11.2018 janë autorizuar inspektorët Z.C dhe D.K nga ish/drejtori M.M, ku është mbajtur Procesverbal inspektimi, Vendimi Përfundimtar në "B" ku cilësohet sasia 32 kg (pa certifikat veterinare), në vlerën 25,600 lekë për subjektin është firmosur nga përfaqësuesi i frigoriferit "N", si dhe proces verbali Vendimi, "Asgjesimi" të transportuar me mjetin me targa AA 052 KS dhe është derguar në Landfillin e Arbanë .
Pra nuk ka as nje foto kur u muar nga magazina, nuk ka asnjë foto kur janë asgjesuar në lanfillin "Rruga Arbanë nga vetëm prezenca e shoferi R.
Në fletë pranimin e mbetjeve – Vend depozitimi Tiranë dokumenti është firmosur vetëm nga shoferi dhe përfaqësuesi i vend depozitimit Tiranë (firmat e inspektorëve të autorizuar mugojnë firmat e Z.C dhe D.K) dokument i fotokopjuar dhe ka vetëm vulen e B 2014.

108.Subjekti i inspektuar A në 24 Tetor 2018, tregëtim Ushimore, mishi në kushtet e kontrollit është konstatuar se sasia e kërnacka të gjetur është me përberje "Salmonella spp) tej normës së lejuar, të inspektuar nga inspektorët A.N, Z.C, V.V, me autorizim nr.3972-1.
Në këto kushte subjektit të lart përmendur i është vendosur gjobë **300 mijë lekë**.
Sipas shkreses me nr.902 datë 23.10.2018 është informuar AKU nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Vetërinarise "bashkagjitur flet analiza ku produkti i cili është marë kampion analizë në datën 16.10.2018 i është berë analizat del me përmbajtje 25 g (Salmonella spp), pra jashtë e standardit dhe normës së lejuar.
Subjekti ka prodhuar 70 vaska të produktit qofte ose 700 copë dhe janë marë për analizë 5 vasketa nga ky produkt pasi ka informacion nëse produkti Kernacka korce dalë me prezencë " salamonëlla spp" i dëmshem për ushqim për njerzit dhe i është ndërprerë aktiviteti deri në daljen e analizave .
Gjithashtu subjektit të lart përmendur ka shpërndarë ketë produkt në treg " shitur" në Kombinat dhe në fusha e Aviacionit , dhe i është lenë detyrë subjektit të tërheqë mallin e shitur.
Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 24.10.2018 nuk përshkruhet si është bllokuar aktivitet nuk pasqyrohet veprimet e kryera nga inspektorët dyllosja ose bllokimi me shirit etj , si dhe të ketë njoftuar institucionet e tjera ligj zbatuse, si dhe nuk është bërë ndjekja dhe gjurmimi i produktit të shitur në Kombinat dhe në Fusha e Aviacioni.
Megjithse i është lënë detyrë për marjen e mallit të shpërndarë me përbërje "salmonella spp" **nuk është asnjë dokument mbi grumbullimin e kasaj sasie si dhe nuk ka asnjë informacion** nga vetë subjekti i cili ka shpërndarë sasinë e kërnackave me përbërje të rrezikshme, nga ana e inspektorëve nuk është ndjekur procesi gjurshmerisë, nuk ka kryer inspektime në subjektet të cilat janë funizuar me këtë lloj produkti.
Për sa i përket gjobës nuk ka asnjë dokument mbi ndjekjen e procedurave ligjore nga sektori juridik. Sipas vendimit përfundimtar me nr 003972-5 datë 24.10.2018.
Në autorizimin me nr 004241 datë 08.11.2018 nga Z.C dhe D.K, është inspektuar dhe marë përseri mostra për analizë 5 vasketa për analizë (kernacka).
Në Vendimin përfundimtar përshkruhet se objekti qendron i mbyllur dhe u muar kampion për analizat dhe përmendet inspektimi i datës 24.10.2018, për nderprerjen e aktivitetit, si dhe gjobën e vendosur , dhe objekti të qendrojë i mbyllur deri në daljen e analizave.

109.Në autorizimin me nr 004572-1 datë 26.11.2018 nga Z.C dhe A.N, është inspektuar përseri subjekti A.
Në vendimin përfundimtar përshkruhet se objekti ka qëndruar i mbyllur, dhe subjekti ka kryer vetë analizat pranë ISUV dhe analizat kanë dalë brenda normave të lejuara dhe cbllokohet aktiviteti, gjithashtu janë kryer dhe analizat nga vetë isntitucioni labarotorik i AKU.
Pra mos vazhdimin e procedurave të aktit administrativ për gjobën e vendosur datë 24.10.2018 në vlerën totale 305 mijë lekë me faturë arkëtimi me nr. serie 0055482 mbi 2 vjet, konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dërgim të shkreses se zyrave përmbarimore.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit i kanë krijuar të ardhur të munguar në dëm të buxhetin e shtetit në vlerën 305 mijë lekë, dhe kamat vonesat "duke mos llogaritur afatet ligjore të ankesës së subjektit" në vlerën 146 mijë lekë (305,000 x 2 %x 24 muaj) nga ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S, z A.N, janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar në vlerën **305 mijë lekë.**

110.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar M me autorizimin nr.3927 më datën 22.10.2018, Tregeti Peshku, nga inspektorët e autorizuar L.B, Z.C, N.M, në proces verbalin me nr 3927- 2/1 datë 22.10.2018 në fshatin Vardardh Bashkia Sukth.
Subjektit të lart përtmendur i është vendosur gjobë 300 mijë lekë,si dhe është bllokuar sasia e 25 kg peshk me mjetin AA052 KS dhe dërguar në Landfillin e Sharës, është konstatuar se tregtohet në kushte në kushte jo sanitare, pranë rrugës , mugon dokumenti shoqërus .

Në Vendimin Përfundimtar me nr.3927-5 datë 22.10.2018 subjektit i vendoset gjoba 300 mijë lekë, sipas Ligjit 9863 datë 28.01.2008, për ushqimin i ndryshuar 68, germa (d).
Në dosjen ndodhret Vendimi me nr.rregjistri 100 (31134-00403-80-2019) datë 23.01.2019 në vedimin ka lenë në fuqi vendimin e AKU me nr 003927-5 datë 22.10.2018.
Në dosje nuk ka njoftim për subjektin e gjobitur.
Nuk ka dokument nisur zyrës përmbarimore për ekzekutimin e gjobës mos ndjekje të procedurave ligjore.
Në proceduren e ndjekur e ndjekur për bllokimin dhe asgjesimin e sasise 25 kg peshk dërguar në Landfillin Sharre konstatohet se në Proces verbalin me numer 3927-2/1 datë 22/10.2018 shkruhet se "U dërgua në landfillin Sharrë" ndërsa në dosje është vetëm një faturë e datës 22/10/2018 ora 15.52 në B "dokumenti pa firmë nga asnjë përson i autorizuar,pa vulë pa cilësuar pëshkrimin e lloit të mallit" .
Pra konstatojmë se **nuk** ndodhet as flet-hyrje as flet-dalje të mallit, dokumenti pa firmë, nuk ka foto mbi asgjesimin e mallit, përshkrimi ndryshe në proces verbal dhe ndryshe në dokumentin " pa firmë, pa vule, pa përshkrimin e mallit".

112.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar M Resorant, me autorizimin nr.132/1 prot më datën 31.01.2018, nga inspektorët e autorizuar L.Z dhe M.K, në proces verbali inspektimi dhe vendimi përfundimtar me numer serie 0043731 datë 31.01.2018 në Resorantin Gj, prodhim tregëtim prodhime guzhinë Bërzhit Tiranë,
Nga kontrolli i inspektorëve është gjetur 0.6 kg mish rose, dhe është gjobitur 100 mijë lekë, me preteksin e gjurmimit dhe është bërë asgjesimi i sasise se mishit në vend, për mugesë të cërtifikatës veterinare.
Në Proces Verbali Bllokimi me nr. serie 074, ku në vendimin e marë sipas nenit 69 të Ligjit 9863 datë 28.01.2008 "Për ushqimin i ndryshuar " i bllokohet sasia prej 0.6 kg mish dhe është kryer asgjesimi në vend.
Në dosje nuk ka njoftim për subjektin e gjobitur, nuk ndodhet fatura për arketim.
Në shkresën me nr.1454 prot datë 14.08.2020 dhe shkresës me nr 1721/1 prot .datë 30 09 2020 Drejtoria Rajonale e AKU i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë për ekzekutimin e gjobes 100 mijë lekë.
Në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë me numer 780 data e vendimit16.09.2020 ka rezuar kërkesen e AKU për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe **nuk ka ndjekje në shkallet e tjera të gjyqsorit.**
Pra ndjekja e procedurave është berë të aktit administrativ mbas 2 vjet, konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dergim të shkreses organëve gjyqsore dhe zyrave përmbarimore, dhe bën të pa vlefshëm vendimin dhe të pa arkëtushem këtë gjobë.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 48 **mijë lekë**, nga ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S, z.A.N**.**

113.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar S, tregëtim mishi, me autorizimin nr.101/6 prot. më datën 25.01.2018 nga ish/drejtori F.S, si dhe grupi i inspektimit E.C, V.S, A.S.
Nga kontrolli i inspektorëve është konstatuar se paisjet frigoriferike janë të pa përshtatshme dhe i është vendosur gjobë 50 mijë lekë, bashkagjitur dhe faturën me nr.serial l0058152 datë 25.01.2018 dhe i është ndërprerë aktiviteti .
Në kërkesën e bërë nga subjekti me nr. 290 prot. datë 01.02.2018 në autorizimin me nr.161/4 prot datë 06.02.2018 është ç'bllokuar aktiviteti nga inspektorët E.V dhe E.C.
Në vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me në.468 datë 09.06.2020 është lënë në fuqi gjoba e vendosur nga AKU.
Në dosje ndodhet pagesa e subjektit 50 mijë lekë të likujduar nga subjekti në shtator të vitit 2020, por pa likujduar kamat vonësen për 24 muaj.

Në dosje nuk ka asnjë dokument për llogaritjen dhe pagesën e kamat vonesës në vlerën **24 mijë lekë** (50,000 x 2 % x 24 muaj), duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

114.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar S, me autorizimin nr.101/6 prot. më datën 25.01.2018 nga ish/drejtori F.S, si dhe grupi i inspektimit Z.C dhe E.M.
Nga kontrolli i inspektorëve është konstatuar se kushtet higjeno-sanitare të pa mjaftushme, dy punonjes pa rinovuar librezën shëndetësore dhe ambjenti duhet të lyet, si dhe i është vendosur gjobë **300 mijë lekë**, bashkagjitur dhe faturën me nr. seria 0058058 datë 25.01.2018 dhe i është lënë detyrë të njoftoje DR-AKU për korigjimin e mangësive të konstatuara brenda datës 01.02.2018.
Pra konstatojmë se procedurat e ndjekur rezulton subjekti S me shkresën me nr 271 prot. datë 30.01.2018 është njoftuar për njoftuar për pagesen brenda përiudhës kohore , në të kundërt do ti drejtohet organëve gjyqsore. Sipas vendimit nr.72, datë 25.01.2019 Gjykatës Administrative e Shkalles se Pare Tiranë ka lenë në fuqi aktin administrativ.
Në shkresën me nr.1506/7 prot, datë 11.03.2019 Drejtoria Rajonale e AKU- Tiranë i drejtohet Përmbarusit gjyqsor privat, për ekzekutimin e gjobës.
Në dosje ndodhet dokumenti ku subjekti ka likujduar në thesar vlerën 300 mijë lekë datë 30.01.2020, por pa likujduar kamat vonësen 24 muaj në **vlerën 144,000 lekë** (300,000 x 2% x 24 muaj), si dhe nga drejtuesit e DRAKU Tiranë ish /Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S, z.A.N, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e saj, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 144 mijë lekë.

115.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar D, me autorizimin nr.102 prot. më datën 25.01.2018 nga ish/drejtori F.S, si dhe grupi i inspektimit Z.C dhe E.M, në proces verbali inspektimi dhe vendimi përfundimtar me numer serie 0043540 datë 25.01.2018 në vendin e tregëtimit Rruga e vjetër Tiranë –Durres.
Nga kontrolli i inspektorëve është konstatuar se kushtet higjeno sanitare të pa mjaftushme, mishi pa certifikatë veterinare, nuk disponon dokumentin e mallit me flet-analizë bakterologjike dhe i është vendosur gjobë **200 mijë lekë**, bashkagjitur dhe faturën me nr.serial 0058057 datë 25.01.2018 dhe i janë konfiskuar mishi i kafshëve të egra, si dhe u dërgua në frigoriferin e thertores B.
I është lënë detyrë të njoftoje për korigjimin e mangësive të konstatuara brenda datës 10.02,2018.
Pra konstatojmë se procedura e ndjekur në subjektin D, për mallin e sekuestruar nuk është e rregullt, pasi mugon flet hyrja e mallit, sasia e konfiskuar nuk përshkruhet se sa kg kanë konfiskuar, por "me copa".
Në shkresen me nr. 702 prot. datë 26.02.2018 subjekti është venë në dijeni për vendimin e marë dhe likujdimin e gjobës se vendosur dhe sipas kërkesës të bërë nga subjekti për gjobën i është kthyer përgjigje në Vendimin me nr.1171/1 prot, datë 2.09.2018 për lënien në fuqi të gjobës.
Në dosjen e marrë nga juristja rezulton se ndërmjet subjektit D me nr.956/1 datë 20.03.2019 e firmosur akt marveshja nga Ish/drejtore M.M për pagesën për 6 muaj duke filluar nga prilli 2019.
Në akt marveshje nuk përshkruhet kamat vonesa nga momenti i vendosjes së gjobës deri në lidhjen e marveshjes për 13 muaj vonesë në vlerën **52 mijë lekë** (200,000 x 2 % x13**),** duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

116.Nga inspektimi i kryer në Subjektin e inspektuar A tregëti mishi, me autorizimin nr.96/3 prot. më datën 24.01.2018 nga ish /drejtori F.S, nga inspektorët e autorizuar S.K dhe D.K, në proces verbali inspektimi dhe vendimi përfundimtar me numer serie 0040779 datë 24.01.2018 dhe proces verbal përfundimtar me nr 0040780 subjektit i është vendosur gjobe 300 mijë lekë në vendin e tregëtimit Rruga 3 Deshmirët Tiranë.

Nga kontrolli i inspektorëve është konstatuar se tregëtontë mish pa certifikatë veterinare dhe i pa rregjistruar në QKB dhe u bë bllokimi i sasisë së mishit 7 kg mish qëngji, 3 frigoriferë Lunga veglat e punës, thika gur peshore lekure dhe është berë **mbyllja e aktivitetit.**
Në dosje nuk ka foto të mbylljes me shirit dhe të vulosur, nuk ka dokumenta të tjera si hyrje në magazinë, të pa firmosur nga përfaqësuesi i subjektit.
Në proces verbalin e vendim bllokimit me nr. 0904 datë 24.01.2018 shprehimisht thuhet:
Në të dhënat nga zyra juridike nuk ka asnjë dokument të bashkagjitur dosjes, vetëm një shënim dore "ka bërë Ankimim me nr.826, në datën 31.01.2018" në dosje nuk e ka bashkagjitur ankimimin, nuk është vendimi i marë, nuk ka dokument, për ndjekjen e procedurave.
Për mos vazhdimin e procedurave të aktit administrativ mbi 2 vjet, konstatohet se ka zgjatje të afateve mos dergim të shkresës zyrave përmbarimore, dhe ben të pa vlefshëm vendimin dhe të pa arketushëm ketë gjobë.
Pra konstatojmë se me mos veprime sipas Ligjit janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 300 mijë lekë, dhe kamat vonesat në vlerën 144 mijë lekë, nga ish/Drejtori F.S dhe ish /Drejtorin zj.M.M, z.S.S, z.A.N**.**

-Ligjin nr.87/2012 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e Ligjit, nr.4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre";
-Ligjin nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat";
-VKM nr.1081, datë 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", të ndryshuar;
-VKM nr.1344, datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore";
-VKM nr.760, datë 16.9.2015 "Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor";
-VKM nr.235, datë 21.3.2017 "Për miratimin e rregullores për karakteristikat e cilesisë dhe kriteret e natyrshmerise së vajit të ullirit dhe vajit të bersisë së ullirit";
-VKM nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar;
-VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme";
-VKM nr.452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar.
-Urdhrin nr.25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ";
-Urdhrin nr.72, datë 15.03.2011 "Për miratimin e akt-kontrollit mbi inspektimin e produkteve me origjinë jo-shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për çdoganimin e tyre dhe akt-marrje mostre", i ndryshuar;
-Urdhrin nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit";
-Udhëzimin nr.20, datë 25.11.2010 "Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore";
-Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor".

-Rregulloren e Brendshme të AKU-së;
-Urdhrin nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim";
-Urdhrin nr.1586, datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për ndjekjen e procedurave ligjore në gjykatat administrative, për vjeljen e gjobave të vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm gjykatë rrethi".

2.5. Auditim mbi funksionin e inspektimit të sektorit të inspektimit të produkteve me origjinë joshtazore.

Mbi auditimin e ushtruar në **DR AKU** për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020, në baze te programit te auditimit nr. 1153/1, date 05.01.2021, **mbajtur në datë 03.03.2021**.
Në zbatim të pikave të programit të auditimit nr. 1153/1, date 05.01.2021 u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:
1. Organika dhe struktura e DR AKU për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020,
2. Dosjet e OJSH me zgjedhje sipas ndarjes detyrave, për periudhën 2018-2019-2020.
3. Shkresat dhe evidenca te ndryshme lidhur me inspektimet për periudhën 2018-2019-2020.
4. Dokumente tjera,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, sipas pikave të programit të auditimit, konstatohet që:
Nga auditimi i DR AKU Tiranë sektori i OJSH për vitin 2018, 2019, 2020 u konstatua se**:**
Për 26 subjekte me aktivitet të madh nuk janë planifikuar për inspektim dhe nuk është kryer inspektimi i tyre, për një periudhë 2-3 vjeçare, duke i diferencuar me subjektet tjera, pasi këto të fundit i janë nënshtruar inspektimeve për çdo vit, madje deri në 30 inspektime në vit për 1 subjekt, konkretisht:
1. Subjekti *A*, Kavajë, *magazine ushqimore*, L53523802J, nuk është inspektuar për 2 vjet, përkatësisht për vitin 2018 dhe 2019,
2. Subjekti *I*, Rrogozhinë Goce, *magazine ushqimore*, L42507802S, nuk është inspektuar për 2 vjet (viti 2018 dhe 2019),
3. Subjekti *S*, Spille, *mulli bloje*, J93512425Q, nuk është inspektuar për 2 vjet (viti 2018 dhe 2019),
4.Subjekti *F*, Kavajë lagjja nr.4, *Pasta Delicia*, L02616801I, nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019, 2020).
5.Subjekti *M*, Tiranë, *magazine ushqimore*, L52102341S, nuk është inspektuar për 3 vjet *(*2018, 2019, 2020).
6. Subjekti *S*, Tiranë, *magazine ushqimore*, L92217018C, nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
7.Subjekti N, *A*, Rruga M. Gjollesha Tiranë, *magazine ushqimore*, L62107015O, nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
8.Subjekti D shpk, *D*, Njësia nr. 10 Tiranë, *magazine ushqimore*, L61706015C, nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
9.Subjekti *O*, Njësia nr. 9 Tiranë, *Prodhim ujë i pijshëm, lëngje dhe pije alkolike dhe jo alkolike*, L41702005T, nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
10. Subjekti *K***,** K61417005R**,** me aktivitet "*magazine ushqimore"* dhe vendndodhje **"***Autostrada Tirane-Durrës Kashar Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
11. Subjekti **"**M**"** *D***,** me aktivitet *"magazine ushqimore"* dhe vendndodhje **"***Rruga e Rinasit ura Gjoles*" nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
12. Subjekti **E** me aktivitet "*magazine ushqimore"* dhe vendndodhje *Kashar "brenda tregut frutave Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet *(*2018, 2019,2020).

13. Subjekti **S** me aktivitet "*magazine ushqimore"* dhe vendndodhje *Kashar Tiranë* nuk është inspektuar për 3 vjet *(*2018, 2019,2020).
14. Subjekti **R**, K22113003Q, me aktivitet "*magazine ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Kamze rruga Valias"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
15. Subjekti **A** L14708603D, me aktivitet *"import produkte bujqësore***"** dhe vendndodhje **"** *Paskuqan, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
16. Subjekti **K** L41320036L, me aktivitet *"import export produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Paskuqan, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
17. Subjekti M**,** K21428005Ë, me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***",**vendndodhje **"***Paskuqan, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
18. Subjekti A**,** K92305028U, me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Paskuqan, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
19. Subjekti B K31419019R, me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Kamze, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
20. Subjekti K**,** me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Kamze, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
21. Subjekti B**,** me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Kamze, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
22. Subjekti A**,** me aktivitet *"import tregtim produkte ushqimore***"** dhe vendndodhje **"** *Kamze, Tiranë"* nuk është inspektuar për 3 vjet (2018, 2019,2020).
23. Subjekti i huaj L, J61901061H**,** me vendndodhje **"***Autostrada",* me aktivitet **"***Prodhim pije freskuese dhe energjike"* **është inspektuar mbi 10-fish më shumë se subjektet simotra vendase,** konkretisht për vitin **2018** është inspektuar **23 herë,** për vitin **2019** është inspektuar **38 herë** dhe për vitin **2020** është inspektuar **31 herë.**
24. Subjektet **në të njëjtën zonë "***Autostrada Tirane-Durrës Kashar Tiranë"* **dhe me të njëjtin aktivitet** "*magazine frigoriferike fruta e perime***" janë diferencuar në inspektime,** konkretisht: subjekti *F shpk* është inspektuar 7-10 herë për çdo vit 2018, 2019, 2020, ndërsa disa subjekte nuk janë inspektuar për 2 vite, përkatësisht: A (2018, 2020*)*, D(2019, 2020*)* dhe R (2018 dhe 2020).
25. Subjekti *D*, Rruga Hamdi Pepa *(përballë tregut lire)* Tiranë, *magazine ushqimore*, K41308083I, **nuk është inspektuar për 3 vitet** (2018, 2019, 2020), **ndërsa janë inspektuar për çdo vit** subjektet simotra ngjitur tij, përkatësisht: A L41306007U, T 03 shpk K31602086J dhe A K01311046P.

Gjithashtu konstatohet edhe diferencimi i subjekteve në inspektimin e tyre, megjithëse kanë aktivitet dhe vendndodhje të njëjtë, *("magazine ushqimore" adresa "Autostrada Tirane-Durrës, Kashar Tiranë"),* konkretisht, subjekti O nuk është inspektuar për 3 vitet (*2018, 2019, 2020, adresa "Autostrada Tirane-Durrës, Kashar Tiranë", aktiviteti "magazine ushqimore shit-blerje birre dhe produkte tjera me shumice dhe pakicë", L91601003A),* ndërsa subjektet tjera janë inspektuar 1-7 here për çdo vit (2018, 2019, 2020), konkretisht:
-*"A"* është inspektuar 7 here në 2018, nga të cilat 5 herë për asgjesim dhe inspektim i mirëfilltë 2 herë, në 2019 gjithsej 5 here, nga të cilat 4 herë për asgjesim dhe inspektim i mirëfilltë vetëm 1 herë, dhe në 2020 gjithsej 4 herë.
-subjekti C shpk 2018 = 6 herë, nga të cilat 4 herë për asgjesim dhe inspektime të mirëfillta 2 herë, në vitin 2019 = 3 here, nga të cilat 2 herë për asgjesim dhe inspektim i mirëfilltë 1 herë, dhe viti 2020 = 6 herë, nga të cilat 4 herë për asgjesim dhe inspektime të mirëfillta 2 herë.
-E nga 2 deri 5 here përkatësisht sipas viteve (2 inspektime për vitin 2018, 5 inspektime për vitin 2019 (ose rreth 4 herë më tepër se frekuenca) dhe 4 për vitin 2020, nga të cilat 1 inspektim sipas planit dhe 3 inspektime për licencimin e subjektit sipas kërkesës.

Për sa më sipër, për mospërfshirjen në planin e inspektimeve të subjekteve më sipër, ose inspektimin e tyre më tepër se frekuenca e inspektimit, sipas rastit dhe periudhës që korrenspondon me pozicionin e tyre në DRAKU Tiranë, mbajnë përgjegjësi ish Kryeinspektorët F.S (deri maj 2018), M.M (maj 2018 vazhdim), z.S.S (Maj-Shtator 2019), A.N (Shtator-Qershor 2020) dhe M.N (Qershor 2020-Dhjetor 2020).

Praktikat e Inspektimit të Sektorit OJSH-viti 2018

A. Nga auditimi i sektorit OJSH Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë për vitin 2018, rezulton:
Sektori i OJSH ka kryer gjithsej 3149 inspektime**,** *nga këto 1908 inspektime të planifikuara* dhe *1241 inspektime të paplanifikuara*.
Inspektimet e planifikuara janë realizuar 70 % (*2718-1908*) pasi nga 2718 inspektime të planifikuara janë realizuar 1908 dhe **nuk janë realizuar 810 inspektime të planifikuara, çka ka sjellë mos realizim të planifikimit të inspektimeve në masën 30 %**.
Ndikim kanë pasur inspektimet e pa planifikuara prej 1241 ose 45 % ndaj inspektimeve të planifikuara, të cilat nuk janë pjesë e subjekteve të planifikuara dhe nuk duhej të cenonin realizimin e programit miratuar të inspektimit, duke zënë kështu padrejtësisht gjysmën e inspektimeve të programuara.
Ngarkohet me përgjegjësi drejtori F.S (deri maj 2018) dhe M.M (maj 2018 vazhdim).
Inspektimet e kryera sipas planifikimit ose jo, dhe në bazë aktiviteti janë pasqyruar në tabelat nr.21-22, në Kap. "Anekset".

Gjatë vitit 2018 janë marrë gjithsej 2074 masa administrative përkatësisht (*gjoba, ndërprerje aktiviteti, paralajmërime, asgjësime dhe bllokim produkti),* nga këto:
**** 191 masa administrative gjobë*** me vlerë 49,760,000 lekë, përkatësisht:
- 4 masa administrative janë marrë për mungesë të licencës në vlerën 4,000,000 lekë.
-29 masa administrative janë marrë për ushqim të pasigurte, në vlerën 9,200,000 lekë.
-71 masa administrative janë marrë për kushtet hijeno-sanitare, në vlerën 22,300,000 lekë.
-21 masa administrative janë marrë për mos realizim të detyrave të lëna në vlerën 1,160,000 lekë.
-17 masa administrative janë marrë për prishjen e shenjave dalluese të pezullimit të aktivitetit dhe mos lejimi i kryerjes së inspektimit me vlerë 900,000 lekë.
-6 masa administrative janë marrë për kategorizimin e vajit të ullirit,
-7 masa administrative për mungesën e sistemit të gjurmshmërisë, në vlerën 5,600,000 lekë.
-36 masa administrative për etiketimin e produkteve ushqimore, në vlerën 2,700,000 lekë.
**** 82 masa*** *administrative me* ***ndërprerje aktiviteti,***
**** 1560 masa*** *administrative me* ***paralajmërim*** *për mangësi të vogla ligjore****,***
* ***1128 ton produkte bllokuara*** *dhe* ***1684 ton të asgjësuara*** *me vlerë* ***654 milion lekë.***
Për vitin 2018 numri i planifikuar i mostrave është **386**, ku janë realizuar **459** mostra *(DRAKU, ISUV dhe Drejtoria e Higjienës*). **Pasqyruar në tabelat nr.23-24 në Kap., "Anekset".**

Inspektimet me objekt liçensimin e subjekteve për vitin 2018, rezulton se janë bërë miratime të kërkesave për **42** subjekte dhe mosmiratim për **45** subjekte.
6 inspektime të kryera **sipas denoncimeve** të ardhura **nga krimi ekonomik** për vitin 2018**.**

Auditim me zgjedhje i dosjeve për vitin 2018 (35 dosje gjithsej), ku rezultoi:
I. Në mënyrë të përmbledhur:
1. Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë pjesë e së cilës është dhe **sektori i OJSH për vitin 2018 nuk disponon plane vjetore dhe mujore të miratuara nga titullari i institucionit, ndërsa nuk bëhet fjalë për dërgimin e tyre për mendim Inspektoratit Qendror**.

2. Sektori i OJSH për vitin 2018 nuk ka realizuar 810 inspektime të planifikuara, çka ka sjellë mos realizim të inspektimeve në masën 30 %, pasi **ndikim kanë pasur inspektimet e pa planifikuara prej 45 %** ndaj inspektimeve të planifikuara, të cilat nuk janë pjesë e subjekteve të planifikuara.

3. Dosjet e inspektimit në shumicën e rasteve paraqesin mangësi dokumentare, pasi mungojnë njoftimet nga subjektet për korrigjimin e mangësive, mungojnë ri-inspektimet**,** mungojnë *(ose ndodhet diku tjetër zyra juridike)* dokumentet për procedurat e ndjekura për vjeljen e gjobave, mungojnë ankimimet e subjekteve, mungojnë analizat laboratorike, mungojnë procesverbalet e asgjësimit**,** etj.

Në shumicën e rasteve inspektorët nuk kanë kryer fotografime apo filmime te ambienteve ku ruhet ushqimi për kafshë,

4. OJSH e **DR AKU ka përdorur 2 standarde**, pasi:

- në 3 raste nuk ka kryer ri-inspektimin në OBU, për zbatimin e detyrave të lëna për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, ndërsa për rastet tjera ka kryer ri-inspektim ndaj OBU, për të njëjtat shkelje dhe produkte ushqimore.

- në 3 raste në procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar nuk ka përcaktuar afatin kohor për korrigjimin e shkeljeve, ndërsa për disa raste tjera ka përcaktuar afatin kohor.

- në 2 raste ka aplikuar gjobë maksimale, ndërsa për disa raste tjera ka aplikuar gjobë minimale, **për prishje të shenjave dalluese të produktit të bllokuar.**

- në 3 raste nuk ka marrë mostra në OBU, ndërsa në disa tjera ka marrë mostra, në një kohë që janë konstatuar shkelje të njëjta.

- në 2 raste ka aplikuar diferencim të masës vendosjes gjobës, për etiketim parregullt, kur shkelja është e njëjtë.

5. DRAKU Tiranë nuk ka planifikuar për inspektim *C Albania shpk* për vitin 2018, por është mjaftuar me 8 inspektime tematike, mbi bazë ankesave ose indiceve apo me kërkesë subjektit *(OBU),* **ku nuk është pasqyruar asnjë shkelje dhe nuk bëhet fjalë për masa administrative**, ndryshe nga disa subjekte ku ka planifikuar inspektime dhe ka aplikuar masa administrative.

AKU në mënyrë të **paligjshme ka zhbllokuar produkte importi të këtij subjekti, *për mungesë dokumentacioni të origjinës (analiza)***, sipas imeilit e titullarit AKU,

6. nga 35 dosje inspektimi të audituara për vitin 2018**,** rezultojnë **14 gjoba të vendosura** ndaj subjekteve, nga këta **7 gjoba janë arkëtuar** dhe **7 gjoba nuk janë likuiduar,** pavarësisht se janë ndjekur procedurat ligjore **paraqitet tej zgjatje mbi 2 vjet, çka ka krijuar debitor të prapambetur me efekt negative në buxhet të ardhurave nga gjobat.** Kështu,

DR AKU Tiranë nuk ka ekzekutuar 7 gjobat**,** pavarësisht se vendimet e komisionit ankimimeve për 7 subjektet kanë dalë me vonesë mbi 2 vjet nga 30 ditë që duhej nga data e ankesave.

7. në të gjitha rastet për sektorin e OJSH për vitin 2018**, titullari i DRAKU Tiranë nuk ka nënshkruar vendimin përfundimtar të inspektimit,** duke u mjaftuar vetëm me nënshkrimin e inspektorëve, gjë që krijon konflikt interesi, pasi inspektorët kryejnë inspektimin dhe vendosin vetë masat administrative pa miratimin dhe mbikëqyrjen e drejtorit, çka bën të domosdoshme përmirësimi i rregullores brendshme AKU.

II. Në mënyrë analitike.

1. *Dosja e inspektimit* datë 19.01.**2018** të OBU "*Magazina importi D*", ushqim për kafshë, e përbërë nga këto dokumente, përkatësisht:

- Autorizim inspektimi datë 19.01.2018.
- Procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar datë 19.01.2018, Inspektorët E.D, M.H.
- Procesverbal vendim bllokimi datë 19.01.2018 për 28 thasë misër me nga 25 kg/secili, për pa etiketë.

- Listë verifikimi datë 24.01.2018,
- Gjobë 100,000 lekë sipas faturës datë 24.01.2018,

Shkeljet:

AKU, bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar ka konstatuar se janë **pa etiketim 28 thasë misër** me nga 25 kg/secili, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar me ligjin nr. 74/2013, neni 56 dhe 68/b.

Masat e marra:

* masa administrative me gjobë 100,000 lekë, për pa etiketimin e produkteve ushqimore,
në baze të nenit 68, germa k të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar, të parashikuar në nenin 36.
* bllokim i 28 thasë misër me nga 25 kg/secili.
* dënimi paralajmërim dhe korrigjim të mangësive brenda afatit 30 ditor dhe njoftimi i AKU nga subjekti, për eliminimin e shkeljeve të konstatuara.

Konkluzion:

a. Mungon ri-inspektimi dhe njoftimi nga subjekti, për korrigjimin e mangësive dhe për ç,bllokimin apo sekuestrimin e 700 kg misër (*28 thasëve*),

DR AKU ka përdorur 2 standarde, pasi për OBU "*Magazina importi D*" nuk ka kryer ri-inspektimin e shkeljeve të konstatuara, për të cilat kanë lënë detyra për ti realizuar, ndërsa për OBU "*Import ushqim për kafshë A"* ka kryer ri-inspektim, për të njëjtën shkelje dhe produkt ushqimor *(misër për kafshë),* sipas dosjes inspektimit datë 22.01.2018.

b. Mungon procedura për vjeljen e gjobës së vendosur prej 100,000 lekë, e cila nuk është arkëtuar. Kështu ka munguar bashkëpunimi me gjykatën për lëshimin e urdhrit ekzekutiv të vendimit gjobës, me zyrën e përmbarimit, me organet tatimore ku subjekti është i regjistruar.

Dosja paraqet mangësi dokumentare, pasi nuk disponohet dokumenti për arkëtimin e gjobës së vendosur, ankimimi i subjektit, shkresat në adresë të organeve kompetente, ndërsa nuk bëhet fjalë për kamatëvonesa,

2. *<u>Dosja e inspektimit</u>* datë 22.01.**2018** të OBU "***Import ushqim per kafshë A***", e përbërë nga këto dokumente, përkatësisht:

- Autorizim inspektimi datë 22.01.2018, nënshkruar nga drejtori F.S dhe procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar datë 22.01.2018, inspektoret A.Sh, E.C.
- Procesverbal vendim bllokimi datë 22.01.2018 për 12,5 ton misër për kafshë me nga 50 kg/secili thes, për pa etiketim, pa dokumentacion shoqërues dhe mungese kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ruajtjes. Listë verifikimi datë 22.01.2018,
- Gjobë 450,000 lekë (*3 gjoba*) sipas faturës datë 22.01.2018,

Shkeljet: Bazuar në nenin 68/1/k të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar inspektorët e DR AKU Tiranë kanë konstatuar shkeljet sa vijon:

- **12,5 ton misër për kafshë** janë **pa etiketim**, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar me ligjin nr. 74/2013, neni 56 dhe 68/b.
- 12,5 ton misër për kafshë kanë **mungesë të kushteve higjeno-sanitare** të ambienteve ruajtjes.
- 12,5 ton misër për kafshë kanë **mungesë të dokumentacionit shoqërues** 12,5 ton misër.

Masat e marra:

* masa administrative me gjobë 50,000 lekë *(minimale),* për pa etiketimin e produkteve ushqimore,
* masa administrative me gjobë 100,000 lekë *(minimale),* për mungesë dokumentacioni gjurmshmërie
* dënimi administrativ 300,000 lekë *(minimale),* për mungesë të kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ruajtjes.

* bllokim i pjesshëm i aktivitetit deri në krijimin e kushteve higjeno-sanitare të ambienteve dhe 12,5 ton misër pa etiketim dhe dokumentacion,
Ri-inspektim: Autorizim ri- inspektimi datë 16.04.2018, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimi datë 22.01.2018, ku është vendosur përsëri gjobë 50,000 lekë për prishje të shenjave dalluese të bllokimit, pasi nga OBU misri është zhvendosur në ambiente me kushte përshtatshme higjeno-sanitare, por nuk ka etiketim dhe dokumentacion, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 16.04.2018 të inspektorëve D.K dhe D.K.
Marrje mostrash: Autorizim inspektimi datë 24.01.2018 për marrje mostre ushqim për kafshë, në stabilimentin, magazinë, pike tregtimi te subjektit, rezultoi: Mostra është marrë nga sasia 12,5 ton misër,disponohet analiza laboratorike dhe misri është brenda standardeve.
Gjithashtu ky subjekt ka marrë një mostër misri në Lushnje për analiza me qëllim blerje**,** sipas deklaratës subjektit 17.04.2018 dhe procesverbalit "*akt marrje mostre*" nr. 0001672, datë 24.01.2018. Analiza laboratorike datë 30.04.2018 ka rezultuar mbi norme te Alfatoksinës B1, për rrjedhojë subjekti nuk ka lidhur kontratë me prodhuesin në Lushnje dhe DR AKU Tiranë ka verifikuar ne vend subjektin date 02.05.2018 ku nuk ka rezultuar asnjë sasi e këtij misri, ndërsa ka njoftuar drejtorin përgjithshëm, i cili me shkresën 381 datë 30.4.2018 ka njoftuar Ministrinë.

3. *Dosja e inspektimit* datë 18.01.**2018** të OBU ***o*** "*Magazina importi Autostrada Tiranë-Durrës*", ushqim për kafshë, nuk paraqet probleme, përjashtuar etiketimin e pjesshëm të 3,1 ton misër e grurë, ku nga inspektorët është aplikuar gjobë për **100,000 lekë**, sipas faturës nr. 0054753, datë 22.01.2018, e **cila është arkëtuar e plotë** me date 26.02.2018.

4. *Dosja e inspektimit* datë 31.01.**2018** të OBU ***A*** "*fabrike prodhim, përpunim, shpërndarje, Vorë-Rinas"*, ushqim për kafshë, rezulton me probleme, konkretisht: kushte higjeno-sanitare të papërshtatshme, dokumentacion i pjesshëm, mungon raport analiza e produkteve etj. Inspektorët A.Sh, E.C kanë vendosur:
- 5 gjoba për vlerën **900,000 lekë,** sipas faturës nr. 4, datë 31.01.2018, e cila nga verifikimi **rezulton e pa arkëtuar nga subjekti.**
- kanë marrë mostra të ushqimeve të ndryshme për kafshë, ku qumështi për lopë ka rezultuar me **mbi normë të Alfatoksinës B1**, sipas raport analizës 31.01.2018, për pasojë ushqimi në magazinë është bllokuar, ndërsa për atë të tregut është tërhequr nga OBU dhe aktiviteti është ndërprerë, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 31.01.2018 dhe sipas 3 proces-verbaleve bllokimit datë 31.01.2018. Shpenzimet e kryerjes së analizave i janë faturuar subjektit me faturën nr. 5 datë 31.01.2018. Dosja është e plotë, përjashtuar dokumentacionit ankimimit, e cila disponohej ne zyrën juridike, *pavarësisht se komisioni AKU i ka shfuqizuar 3 gjobat e vendosura, sipas vendimit nr. 899/1, datë 14.09.2020, por ky vendim është jashtë afatit ligjor dhe nuk qëndron , trajtuar më hollësisht tek akti nr. 4.*

5. *Dosja e inspektimit* datë 18.01.**2018** të OBU "***Magazina importi J***" Ludovik Hasani, ushqim për kafshë, e përbërë nga këto dokumente, përkatësisht:
- Autorizim inspektimi datë 18.01.2018, nënshkruar nga drejtori F.S.
- Procès-verbal inspektimi dhe vendim përfundimtar datë 18.01.2018, Inspektoret M.D, F.R dhe Valentina Xhilli.
- Procesverbal vendim bllokimi datë 19.01.2018 për 4 ton hime ardhur nga Serbia për pa etiketë.
- Listë verifikimi datë 19.01.2018,
- Gjobë 400,000 lekë sipas faturës datë 19.01.2018, nga kjo: 300,000 leke për mungesë kushteve higjienës dhe 100,000 lekë për etiketimin. DR AKU Tiranë ka ndjekur procedure për vjeljen e gjobës. Kështu subjekti është ankimuar pranë AKU dhe komisioni ankimor ka nxjerre vendimin 1446/1 datë 10.09.2018 duke bërë kërkesën për urdhër ekzekutimi, më tej zyra përmbarimore ka zbatuar ekzekutimin, ku **gjoba 400,000 lekë është arkëtuar** me date 29.08.2019 nga subjekti.

Shkeljet: AKU ka konstatuar mungesë të kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ruajtjes, mungesë etiketimi për 4 ton hime.
Masat e marra:
* masa administrative me gjobë 300,000 lekë, për mungesë të kushteve higjeno-sanitare,
* masa administrative me gjobë 100,000 lekë, për pa etiketimin të 4 ton hime,
* bllokim i 4 ton hime,
* dënimi paralajmërim dhe ndërprerje aktiviteti deri në korrigjim të mangësive dhe njoftimi i AKU nga subjekti, për eliminimin e shkeljeve të konstatuara,

Konkluzion:
a. Grupi i inspektimit në fund të procedurës ka lënë detyra subjektit për korrigjimin e shkeljeve, por nuk ka përcaktuar afatin kohor.
b. Dosja e inspektimit ka mangësi, pasi **nuk disponohet njoftimi i subjektit** *(OBU)* **për korrigjimin e mangësive** dhe **nuk disponohet ri-inspektimi** për ç'bllokimin e 4 ton himeve si dhe nga DR AKU nuk është vendosur gjobë nga 10,000-100,000 lekë, për prishjen e shenjave dalluese të bllokimit.
Inspektoret M.D, F.R dhe V.ZH për mospërcaktimin e afatit të korrigjimit të shkeljeve dhe z.F.S ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për mosnxjerrjen e autorizimit për ri-inspektim.
c. Ndryshe është vepruar me subjektin AKU-TR-2018-000775, Y, Njësia Bashkiake nr. 4, **ku është kryer ri-inspektimi,** duke i shkuar procedurës deri në fund, sipas procès-verbal inspektimi dhe vendim përfundimtar datë 23.04.2018.

6. Inspektorët kanë përdorur 2 standarde *për vendosjen e gjobës për prishje të shenjave dalluese,* pasi ndaj subjektit **"I" ka aplikuar gjobë maksimale prej 100,000 lekë**, ndërsa **për subjektet "A" dhe "L" ka aplikuar gjobë minimale prej 10,000 lekë/secili,** konkretisht:
6/1. *Dosja e inspektimit* datë 17.01.**2018** të OBU ***I*** "*Import magazinim tregtim ushqim për kafshë*" Berxullë, rezulton se: bazuar në nenin 54 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH"* është vendosur përsëri *gjobë maksimale* 100,000 lekë për prishje të shenjave të ndërprerjes veprimtarisë, sipas inspektimit datë 25.10.2017 si dhe i është ri-bllokuar aktiviteti deri në plotësimin e kushteve, me proces-verbalin e inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 17.01.2018 të inspektorëve L.Z dhe E.A. **Gjoba 100,000 lekë është arkëtuar e plotë** me date 03.05.2018 nga subjekti.
6/2. *Dosja e inspektimit* datë 30.01.**2018** të OBU ***A.S*** "*Byrektore*" Njësia Bashkiake nr. 6 Tiranë, rezulton se nga inspektorëve **L.Zh dhe E.A** është vendosur *gjobë minimale* 10,000 lekë për prishje të shenjave të ndërprerjes veprimtarisë, sipas inspektimit datë 27.09.2017 si dhe i është ri-bllokuar aktiviteti deri në plotësimin e kushteve, me proces-verbalin e inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 31.01.2018. **Gjoba 10,000 lekë është arkëtuar** me date 06.04.2018.
6/3. *Dosja e inspektimit* datë 25.01.**2018** të OBU ***L.B*** "*Byrektore*" Njësia Bashkiake nr. 6 Tiranë, rezulton se nga inspektorëve **M.H dhe E.D**, është vendosur *gjobë minimale* 10,000 lekë për prishje të shenjave të ndërprerjes veprimtarisë dhe i është bllokuar aktiviteti deri në plotësimin e kushteve, me proces-verbalin e inspektimit datë 25.01.2018. **Gjoba 10,000 lekë është arkëtuar** me date 07.02.2018 nga subjekti.

7. Inspektorët kanë përdorur 2 standarde *për marrjen e mostrave më OBU me aktivitet furrë buke e pastiçeri,* pasi ***kanë marrë mostra tek OBU Furre buke "K" dhe OBU "Vëllezërit" H"***, ndërsa ***nuk ka marrë mostra tek OBU H***, në një kohë ***që janë konstatuar shkelje të njëjta*** si: mungesë të kushteve higjeno-sanitare, lënda e parë në kushte të papërshtatshme, mungesë e analizave laboratorike e ujit, kjo për subjektin e fundit, të cilit nuk i është marrë mostra, etj, konkretisht:

7/1. *Dosja e inspektimit* datë 25.01.**2018** të OBU Furre buke "*K*" lagjja nr. 3 Kavajë, rezulton se nga inspektorëve G.H dhe L.Zh janë marrë mostra sipas flet shoqërimit të mostrës në laborator date 18.01.2018 (kodi 30).
7/2. *Dosja e inspektimit* datë 18.01.**2018** të OBU Furre buke "*Vëllezërit" H"* Kamëz, rezulton se nga inspektorëve M.D dhe F.R janë marrë mostra sipas flet shoqërimit të mostrës në laborator date 18.01.2018 (kodi 28).
7/3. *Dosja e inspektimit* datë 22.01.**2018** të OBU Furre buke H Instituti Tiranë, rezulton se nga inspektorëve **E.M dhe E.A nuk janë marrë mostra** sipas flet shoqërimit të mostrës në laborator date 18.01.2018 (kodi 28).

8. Në 3 raste janë marrë mostra si ushqim blete, hime, pije alkolike, **por mungojnë përgjigjet e analizave, të cilat** nuk janë bërë pjese e dosjeve te inspektimit, për efekt të ndjekjes dhe mbikëqyrjes subjekteve, përkatësisht: subjekti "*Magazine importi M*", "*A*", "*Drejtoria e shërbimeve qeveritare"*.

9. Në 4 raste inspektimesh *me objekt ankesash* janë marre mostra vaji ulliri, por **inspektimet janë mbyllur pa zbardhur analizat laboratorike**, por thuhet: ***bllokohen deri ne daljen e analizave, dhe nuk disponohen dokumente se çfarë është bere me tej me këtë produkt,*** përkatësisht:
- subjekti AKU-TR-2018-002899 *V*, inspektimi date 24-27.08.2018, inspektorët **E.A, L.Zh dhe A.T**, ***mungon flet shoqërimi i mostrës*** vajit ne laborator.
- subjekti AKU-TR-2018-002901 *V*, inspektimi date 24-27.08.2018, inspektorët M.H dhe M.Z, drejtori M.M, disponohet flet shoqërimi i mostrës vajit ne laborator date 28.08.2018.
- subjekti *vëllezërit K*, AKU-TR-2018-002902 *Dhermiu O*, inspektimi date 24-27.08.2018, inspektorët F.R, G.P dhe N.H, drejtori M.M, bllokuar 528 litra vaj ulliri deri ne daljen e analizave ***(****disponohet flet shoqërimi i mostrës vajit ne laborator date 27.08.2018)* dhe mbyllet inspektimi pa nxjerrë analizat, ndërsa s,ka masa administrative pasi nuk janë konstatuar shkelje..
- subjekti *vëllezërit h*, AKU-TR-2018-002892, inspektimi date 23.08.2018, inspektorët F.R, Gj.P dhe N.H, drejtori M.M, bllokuar 5245 litra vaj ulliri deri ne daljen e analizave ***(****disponohet procesverbal bllokimi dhe flet shoqërimi i mostrës vajit ne laborator)* dhe mbyllet inspektimi pa dalur analizat. Përsëri ne këtë subjekt është kryer inspektimi date 30.8.2018 ku analizat date 29.8.2018 kane rezultuar pozitive dhe produkti është bllokuar si dhe subjekti nuk ka tërhequr vajin e shitur klientëve sipas detyrave te lëna nga inspektimi date 23.08.2018, prandaj është ndëshkuar dhe me gjobe 400,000 leke nga inspektoret M.D, A.Sh dhe D.K.

10. *Dosja e inspektimit* datë 20.08.**2018** AKU-TR-2018-002857 të OBU ***H***, Njësia nr. 9 Tiranë, kryer nga inspektorët **E.A, L.Zh dhe A.T,** sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtare date 20.08.2018, rezulton se: **Inspektorët kanë lënë detyra bllokim dhe kthim ne origjine** *(Sarande)* **vaj ulliri me dokumentacion shoqërues**, *pasi nga analizat ka rezultuar **jashtë standardeve***, por **nuk disponohet dokumentacion justifikues dhe argumentues për marrjen e këtyre masave,** pasi:
- mungon procesverbali i bllokimit,
- mungon dokumentacioni shoqërues për kthimin ne origjinë, megjithëse duhej të ishte objekt i asgjësimit ne vend,
- grupi i inspektimit nuk ka përcaktuar afatin kohor, për korrigjimin e shkeljeve.
- nuk disponohet njoftimi nga OBU *"H"* për korrigjimin e mangësive,
-nuk disponohet ri-inspektimi për ç,bllokimin ose asgjësimin e vajit ullirit jashtë standardit.
Theksojmë se **ky subjekt është furnizuar me vaj ulliri nga furnitori K** me adresë Njësia nr. 8 Tirane sipas dokumentit 24.07.2018**, i cili disponon vaj ulliri jashtë standardit,** sipas analizave kryera në inspektimin date 17.09.2018 (nga **inspektorë**t **M.H , M.Z, drejtori M.M)**, te cilit i janë

bllokuar 171 litra dhe ***tërhequr nga tregu 157 litra,*** por **mungon procesverbali i bllokimit** dhe **nuk disponohet dokument se çfarë është bërë më tej me këtë produkt, pasi ai ndodhet ne ambientet e vete subjektit.**

11. Inspektorët kanë përdorur 2 standarde, lidhur me plotësimin dhe *përcaktimin e afatit kohor për korrigjimin e të metave dhe mangësive,* pasi në proces-verbalet e inspektimeve dhe vendimet përfundimtare në disa raste janë vendosur ndërsa në disa raste nuk janë vendosur këto afate kohore, konkretisht:
11/1. *Dosja e inspektimit* datë 16.01.2018 të OBU **A** "*Import tregtim ushqim për kafshë*" fshati Gjokaj Vorë, rezulton se nuk disponon dokumentacionin gjurmues dhe paraqet kushte higjeno-sanitare të papërshtatshme, për rrjedhojë është vendosur gjobë **300,000 lekë *(pa arkëtuar nga subjekti)*** dhe **bllokim të produkteve** deri në plotësimin e kërkesave ligjore, por **pa përcaktuar afatin kohor**, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 16.01.2018 inspektimit datë 25.10.2017 si dhe 3 procesverbaleve bllokimi datë 17.01.2018 të inspektorëve B.O dhe E.V. ***Procedura për vjeljen e gjobës.***
11/2. *Dosja e inspektimit* datë 12.01.2018 të OBU ***Supermarket D*** shpk, rezulton se **është përcaktuar afati kohor 25.01.2018 për etiketim parregullt** *(50,000 lekë gjobë)*, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.01.2018. **Gjoba 50,000 lekë është arkëtuar e plotë** me date 08.10.2018 nga subjekti.
11/3. *Dosja e inspektimit* datë 12.01.2018 të OBU **E** shpk, rezulton se **është përcaktuar afati kohor 10 ditë për pa etiketim** *(100,000 lekë gjobë)* në gjuhen shqipe, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.01.2018. DRAKU ka njoftuar subjektin për likuidimin e gjobës me shkresën 4716, date 19.02.2019. Gjithashtu ka bere kërkesën nr. 1872 date 14.05.2020 ne gjykate për lëshimin e urdhër ekzekutimit të vlerës 100,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin date 08.06.2020 *(ankimim ska*). Zyra përmbarimit me shkresën nr. 174 datë 19.01.2021 ka njoftuar subjektin për ekzekutim te masës administrative, dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi vlera nuk është arkëtuar nga subjekti. Pra, gjoba është vendosur ne janar 2018, kërkesa në gjykate është kryer maj 2020 ose pas 1 viti dhe me tej kane kaluar mbi 3 vite dhe nuk ka asnjë veprim dhe arkëtim.

12. Inspektorët kanë diferencuar subjektet OBU, *lidhur me masën e vendosjes të gjobës, për shkelje të njëjta, etiketim parregullt,* pasi kanë aplikuar 2 standarde, konkretisht:
12/1. *Dosja e inspektimit* datë 12.01.2018 të OBU *Supermarket D shpk*, rezulton se **për** etiketim parregullt është vendosur gjobë minimale 50,000 lekë, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.01.2018 të inspektorëve A.Sh dhe F.R.
12/2. *Dosja e inspektimit* datë 12.01.2018 të OBU ***E*** *shpk*, rezulton se për etiketim parregullt është vendosur gjobë maksimale 100,000 lekë, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.01.2018 të inspektorëve M.D dhe A.B.

13. *Dosja e inspektimit* datë 15.01.2018 të OBU ***M*** me aktivitet tregtim me pakicë, rezulton me artikuj ushqimor të skaduar (*kaluar afati i s,kadencës*) gjithsej 1,972 kg (salce domate, sallam, kremviçe, esenca supe, etj) me vlerën 220,000 lekë.
Inspektorët **E.M dhe L.Zh** kanë vendosur gjobë 300,000 lekë, paralajmërim dhe bllokim i sasisë me një afat 15 ditor deri në asgjësimin e ushqimit skaduar, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar si dhe bllokimit datë 15.01.2018, **por mungon procesverbali i asgjësimit, ri-verifikimi dhe njoftimi zyrtar i subjektit**.
Gjithashtu **proces-verbali i bllokimit datë 15.01.2018 është i pjesshëm**, pasi nuk ka të plotësuar pjesën e deklarimit se çfarë thotë subjekti.
DR AKU Tiranë ka ndjekur procedure për vjeljen e gjobës. Kështu subjekti është ankimuar pranë AKU dhe komisioni ankimor ka nxjerre vendimin 669/1 datë 26.07.2018 duke bërë kërkesën për

urdhër ekzekutimi, më tej zyra përmbarimore ka zbatuar ekzekutimin, ku **gjoba 300,000 lekë është arkëtuar** me date 27.11.2018 nga subjekti.

***Sa sipër*, për problemet e trajtuara mban përgjegjësi edhe drejtori F.S.**

14. U konstatuan inspektime *(portal)* **rutinë në 5 subjekte,** pasi lihen detyra të pjesshme, sipërfaqësore dhe të njëjta. Kështu sipas proces-verbaleve inspektimit dhe vendimeve përfundimtare nuk përcaktohen sendet e tepërta ndërsa lihet detyrë të largohen nga magazina, nuk përcaktohet aktiviteti, thuhet të rinovohen raport analizat e produkteve dhe nuk citohen këto produktet madje nuk merren mostra për analiza, **lihen detyra dytësore me pak rëndësi si, lyerje e pjesshme e tavanit, rregullim i pjesshëm i banakut, meremetim rrjetit të dritareve** etj, në vend të bllokimit të aktivitetit në rast se këto kushte janë të papërshtatshme për produktet ushqimore. Jepet për subjekte ndryshme e njëjta masë "*paralajmërim".* Fenomene të tilla u konstatuan në këto inspektime: AKU-TR 2018-002220-5 subjekti *"A",* AKU-TR 2018-001992-5 subjekti *"A",* AKU-TR 2018-002263-5 subjekti *"A"*Gose Kavaje, AKU-TR 2018-002367-5 subjekti *"F"*Koder Kamzë, AKU-TR 2018-002516-5 subjekti I dhe AKU-TR 2018-002483-5 subjekti N Golem Kavajë.
Inspektorët **D.K, A.Sh, Gj.P, N.H, D.D, E.M, A.N, S.L, M.K**.

15. *Dosja e inspektimit* datë 27.07.2018. AKU-TR 2018-002610-1, **OBU *A*** Rruga Zogu i pare Tiranë me aktivitet "Pastiqeri", rezulton se **Inspektorët A.N dhe M.K** kanë konstatuar shkelje mbi bazën e të cilave kanë aplikuar gjoba në vlerën **400,000 lekë** dhe paralajmërim. Gjithashtu inspektorët kanë konstatuar produkte me s,kadencë të kaluar bllokuar, sipas procesverbalit inspektimit (aty për aty) dhe vendimit ndërmjetëm për masa urgjente date 27.07.2018, ku citohet: *këto produkte u bllokuan në subjekt deri në marrjen e masave nga subjekti për asgjësimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi*, por:
Nuk thuhet cili ambient, mënyra e bllokimit, me dyllosje, me shirit, me çelës ose dry, mungon procesverbali i asgjësimit me komision posaçëm, produktet e s,kaduara nuk shprehen në vlerë por vetëm në sasi ose copë.
Theksojmë se subjekti mbulon shpenzimet, ndërsa nuk asgjëson produktet e veta të s,kaduara, por komisioni i asgjësimit i cili produktet i largon në vendin ku i asgjëson me procesverbalin përkatës, mbi bazën e këtij të fundit subjekti prêt flet daljen për shkarkimin nga kontabiliteti të produkteve të s,kaduara, çka nuk është bërë.
Mungon fotografimi dhe filmimi si element prove për të justifikuar asgjësimin e produkteve të s,kaduara.
Përfundimisht, procedura e inspektimit nuk ka shkuar deri në fund, duke e bërë atë joefektive, pasi ka mbetur në fazën e konstatimeve dhe vendosjes gjobave, pa justifikuar me dokument asgjësimin e produkteve të s,kaduara dhe vjeljen e gjobave të vendosura.

Subjekti ka animuar gjobën, ndërsa komisioni i AKU ka lënë në fuqi gjobën, gjykata ka nxjerre urdhër ekzekutimi dhe zyra e përmbarimit ka vazhduar proceduren, por **nuk ka arkëtim të gjobës.**

16. *Dosja e inspektimit* datë 18.07.2018. AKU-TR 2018-00230-1, OBU **S**, Rruga Siri Kodra Tiranë me aktivitet "Fast-food", rezulton se **Inspektorët A.H dhe B.O** kanë konstatuar shkelje lidhur me kushtet higjeno sanitare të papërshtatshme si dhe të tjera probleme, mbi bazën e të cilave kanë aplikuar gjobë në vlerën **300,000 lekë** dhe bllokim aktiviteti, por **nuk citohet mënyra e bllokimit** të aktivitetit**.** Gjithashtu inspektorët kanë kryer fotografimin e ambientit po**r nuk disponohen këto foto në dosje.**

Theksojmë se: për të njëjtat shkelje nuk janë aplikuar foto të ambienteve të subjektit *"M Fast Food"* Paskuqan, sipas inspektimit të kryer nga **Inspektorët A.H, M.Z,** pra kemi 2 standarde.
Procedura për vjeljen e gjobës. Subjekti ka ankimuar me date 24.07.2018 dhe komisioni ankimor ka lënë në fuqi gjobën sipas vendimit 5137/1 date 26.05.2020. Komisioni ankimor ka shkelur afatin 2 vjet për shqyrtimin e ankesës**,** DRAKU ka bere kërkesën ne gjykate nr. 1453 date 14.8.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit, të vlerës 300,000leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit 779 date 02.10.2020, dhe me tej asnjë veprim dhe nuk është arkëtuar gjoba nga subjekti.

17. *C Albania shpk.*
17/1. Dosja e inspektimit **datë 20.04.2018**, C Albania Autostrada km 6 Tiranë me aktivitet *import-eksport, magazinim, shitje produkte ushqimore*, rezulton se: Sipas procesverbalit asgjësimit datë 20.04.2018 Inspektorët A.Sh, Gj.P kanë nxjerrë jashtë përdorimit 32 copë patatina me vlerë 4,895 lekë (*ishin të bllokuara më datë 21.03.2018)*, duke i shkatërruar fizikisht, nuk administrohet flet-dalja nga magazina e subjektit të produkteve që do të asgjesohen.
17/2. Dosja e inspektimit **datë 24.05.2018**, C Albania Autostrada km 6 Tiranë me aktivitet *import-eksport, magazinim, shitje produkte ushqimore*, rezulton se: Me kërkesën e subjektit datë 21.05.2018, sipas procesverbalit asgjësimit datë 24.05.2018 Inspektorët N.H dhe Gj.P kanë nxjerrë jashtë përdorimit **1032,7 kg copë** artikuj ndryshëm ushqimor me vlerën 189,626 lekë, duke i dërguar me automjet tek Landfilli i Sh ku disponohet fotografimi i procesit të asgjësimit, por komisioni është i pjesshëm prej 3 vetash *(2 insp + përfaqësuesi i firmës)* nga 5 që duhej, mungon fletëdalja e OBU për shkarkimin nga kontabilitetit.
17/3. Dosja e inspektimit **datë 11.06.2018**. AKU-TR 2018-001513-1, OBU C Albania, inspektorë**t** A.Sh dhe D.K kanë inspektuar subjektin ku nuk kanë rezultuar shkelje me përjashtim të dëmtimeve pjesshme dyshemesë, ku kanë dhënë "*paralajmërim"* dhe kanë lënë detyrë për riparimin e saj, sipas procesverbalit vendimit inspektimit date 11.06.2018.
17/4. Dosja e inspektimit **datë 20.06.2018**. AKU-TR 2018-001739-1, OBU C Albania, inspektorët A.Sh dhe D.K kanë inspektuar subjektin sipas indiceve sistemit RASFF ardhur nga Italia me date 19.06.2018 "***Për praninë e glutenit ne krem patate dhe presh***" ku Shqipëria është etiketuar për ndjekje, u konstatua se: Sipas procesverbalit inspektimit date 21.06.2018, furnizim me këto artikuj ka pasur vetëm në vitin 2017, të cilat janë shpërndarë brenda ditës dhe nga pikat e shitjes janë kthyer vetëm ***7 copë objekt asgjësimi*** me vlerë 634 lekë**,** sipas procesverbalit dhe vendimit asgjësimit 27.06.2018.
17/5. Dosja e inspektimit **datë 01.06.2018**, **C Albania Supermarket** rruga "Ibrahim Rrugova" Tiranë, bazuar në indicie e ankesa konsumatorëve dhe email DP AKU rezulton se Inspektorët S.L dhe A.N kanë kryer inspektim për produktin *"maja*", ku është marrë mostra për analizë dhe nga përgjigjet nuk kanë rezultuar probleme, për rrjedhojë nuk ka masa administrative.
17/6. Dosja e inspektimit **datë 06.12.2018**, **C Albania Supermarket** Tiranë, bazuar në ankesa konsumatorëve ***për sigurinë e vajit ullirit që qarkullon në supermarketet në Tiranë,*** rezulton se Inspektorët **F.R dhe M.D** kanë kryer inspektimin, sipas procesverbalit inspektimit vendimit përfundimtar date 06.12.2018, nuk kanë rezultuar shkelje, për rrjedhojë nuk ka masa administrative. Gjithashtu kan**ë marrë mostra për analizë, përgjigjia e të cilave ka dalë brenda standardit.**
17/7. Dosja e inspektimit **datë 01.11.2018**, C Albania shpk Autostrada km 6 Tiranë, magazine ushqimore, rezulton se: **asgjësimi nuk është kryer pasi OBU nuk kishte marrë masat për asgjësim.** Kështu sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 01.11.2018, inspektorët K.S dhe A.Sh nuk kanë nxjerrë jashtë përdorimit **385 kg artikuj ushqimor s,kaduara me vlerën 100,056 lekë,** pasi OBU nuk kishte marrë masat për asgjësim**,** madje edhe në rastin e dytë nuk është kryer**,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 07.11.2018, megjithëse ka pasur kërkesë nga vetë subjekti.

Konkluzion: OBU "C Albania shpk" nuk ka marrë masa për asgjësim, por edhe **DRAKU nuk ka marrë masa ndaj subjektit për asgjësimin e 385 kg artikuj ushqimor s,kaduara me vlerën 100,056 lekë,** çka ka bërë që 2 herë inspektorët të kthehen pa realizuar inspektimin**.**

17/8. Dosja e inspektimit **datë 02.11.2018**. AKU-TR 2018-004156-1, OBU *C Albania* shpk rezulton se;

a. sipas procesverbalit "vendim bllokimi" nr. 346 datë 31.10.2018 (*insp. R. Mullaraj)* **është bllokuar mjeti DR 6663 në Durrës me "*produkte me origjine jo shtazore*", për mungesë dokumentacioni** *(raport analizë),* ku ngarkesa do të qëndrojë e bllokuar në magazine e subjektit deri në plotësimin e dokumentacionit.

b. Me autorizimin datë 02.11.2018 nënshkruar nga drejtoresha e DR AKU Tiranë zj. M.M autorizohen inspektorët G.H dhe E.M ***të inspektojnë raste bllokimi nga pika e inspektimit kufitar,*** të cilët **nuk kanë konstatuar shkelje dhe kanë zhbllokuar produktet OJSH,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 02.11.2018, me këtë arsyetim:

referuar emailit date 01.11.2018 të drejtorit përgjithshëm AKU z. A.I u krye evidentimi i produkteve të bllokuara OJSH me pr-verb nr. 346 datë 31.10.2018 dhe u konstatua se sasia është gjendje në magazine e subjektit, bazuar ne piken 6/b neni 43 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", si dhe bazuar në emailin date 01.11.2018 të drejtorit përgjithshëm AKU, subjektit i lejohet të shpërndajë produktet e importuara me date 31.10.2018.

Konkluzion: zhbllokimi nga inspektorët i produkteve është i paligjshëm, pasi:
- subjekti nuk ka siguruar dokumentacionin raport analizat e produkte me origjine jo shtazore**.**
-ç,bllokimi është bërë referuar emailit titullarit AKU, në vend të zbatimit urdhrit Ministrit Bujqësisë 374 datë 31.08.2007 ndryshuar me nr. 72 datë 15.03.2011,
- pretendimi i inspektorëve se ky veprim zhbllokimi është bazuar në pikën 6/b, nenit 43 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011*"Për inspektimin në RSH",* nuk ka lidhje me problemin në fjalë.

Ngarkohen me përgjegjësi drejtori përgjithshëm AKU z. A.I, drejtoresha e DR AKU Tiranë zj. M.M, inspektorët z. G.H dhe z. E.M.

18. *Dosja e inspektimit* datë 15.02.2018, OBU 'E" "*prodhim, tregtim pije alkolike"* adresa Njësia Bashkiake 7, me objekt "**indicia krimi ekonomik**, *zbatim legjislacioni* ", rezulton se: Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendim përfundimtar datë 31.10.2018 **është** konstatuar pije 15 litra Vodkë me s,kadencë të kaluar *(sk. 20.10.2017),* ku krahas gjobës 1,350,000 leke dhe marrjes mostrave ne 30 litra është kryer bllokimi**,** sipas proces-verbali i bllokimit datë 15.02.2018 nënshkruar nga inspektorët E.A, L.Zh dhe subjekti.

Sa sipër, **për problemet e trajtuara mban përgjegjësi edhe drejtori zj. M.M.**

VITI 2019

B. Auditimi i sektorit OJSH Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë për vitin 2019, rezulton:

Për vitin 2019, Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor **ka krijuar një raport të zhdrejtë midis numrit të inspektimeve dhe numrit të masave administrative** krahasuar me vitin 2018, pasi inspektimet janë rritur, ndërsa masat janë ulur, konkretisht: Për vitin 2019 OJSH ka kryer gjithsej **3315 inspektime** (*166 inspektime më shumë se 2018 (3149),* ndërsa janë marrë gjithsej **1868 masa administrative** (*206 më pak se viti 2018 (2074-1868).*

Inspektimet e planifikuara për vitin 2019 nuk janë realizuar për 1001 inspektime *(3201-2200),* pasi nga 3201 në plan janë realizuar 2200.

Dinamika e planifikimit dhe realizimit të inspektimit dhe inspektime tjera jashtë planit për vitet 2018 dhe 2019, paraqitet sipas grafikut:

Numri i inspektimeve të kryera për vitin 2019, sipas llojeve të aktivitetit tyre, të planifikuara dhe jashtë planifikimit, janë pasqyruar në tabelat nr.25-26 në Kap. "Anekset".

Gjatë vitin **2019** janë marrë **gjithsej 1868 masa administrative** përkatësisht: gjoba, ndërprerje aktiviteti, paralajmërime, asgjësime dhe bllokim produkti, ose 206 *(2074-1868)* më pak se viti 2018, përkatësisht:
- janë kryer asgjësime të produkteve ushqimore në 94 subjekte në vitin 2019 në sasi 1518 ton, me vlerë 214,515,455 lekë, *ndërsa në vitin 2018 janë kryer 147 asgjësime 1684 ton, me vlerë 654,366,828 lekë.*
- janë kryer bllokime të produkteve ushqimore për vitin 2019 në 46 subjekte në sasi 74 ton.
- janë marrë 139 masa administrative gjobë për 90 subjekte për 2019 me vlerë 69,750,000 lekë,
- janë marrë masa administrative me ndërprerje aktiviteti për 40 subjekte,
- janë marrë masa me paralajmërim për 1594 subjekte për mangësi të një rëndësie të vogël ligjore,

Për vitin **2019** numri i planifikuar i mostrave ka qenë **415** (*DRAKU, ISUV dhe Higjienës*), realizimi për **262** mostra, **nga këto brenda normave janë 253 dhe 9 jashtë normave, pasqyruar në tabelat nr.27, në Kap. "Anekset"**
-Janë bërë miratime të kërkesave për liçensimin për **238 subjekte** në **2019**, mosmiratim të kërkesave për
liçensim për **138 subjekte,**
-nuk ka pasur bashkëpunime me krimin e ekonomik për vitin 2019 nga sektori OJSH**.**

<u>Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve inspektimit pë produktet OJSH të vitit 2019, rezultoi</u>:

***<u>I. Në mënyrë të përmbledhur</u>*:**
I. Ka diferencim midis subjekteve, pasi **inspektimet janë të pakta ndaj disa OBU me aktivitet të madh *"markete"*** dhe nxirren pak problematika e masa administrative, ndërsa në ndaj disa "*marketeve"* **me aktivitet të vogël** kryhen inspektime të shumta, nxirren problematika dhe aplikohen masa administrative ***(trajtuar më hollësisht tek përmbledhja 2018).***
II. Për vitin 2019 dosjet nuk janë mbajtur për çdo subjekt, por për çdo inspektim, konkretisht: një subjekt që është inspektuar 8 herë brenda vitit paraqet 8 dosje të shpërndara sipas muajve, në vend të 1 dosje të vetme ku përfshihen këto 8 inspektime, **çka ka krijuar anomali,** duke **ndikuar negativisht në rritjen artificiale të numrit të inspektimeve** subjekteve të raportuara dhe **mos ndjekjen e aktivitetit vjetor të subjektit.**
III. Nga inspektimet tematike në OBU **"C Albania"** për vitin **2019,** janë konstatuar:
- ***në 2 raste janë falur padrejtësisht 2 gjobat në vlerën 4,200,000 lekë nga komisioni ankimor** AKU Përgjithshme***,*** shkelje që bëjnë fjalë për mungesë dokumentacioni origjinës (certifikata fitosanitare), pa afat s,kadence dhe me substance e paautorizuar si dhe me mospërputhje shifrash me të dhënat e subjektit, **për produktet kërpudhë e freskët dhe oriz**, të cilat janë bllokuar për asgjësim.
- ***nuk është kryer asgjësimi i kërpudhës dhe orizit me substance paautorizuar të bllokuar,*** pasi s,ka dokumentacion,
- **në 1 rast nuk është kryer asgjësimi**, **nën pretekstin se subjekti nuk është gati,** *megjithëse ky i fundit ka bërë vetë kërkesën***,** kështu **pas 1 javë është kryer ky asgjësim por duke ndryshuar grupin e inspektorëve,**
- **në 1 rast nuk është kryer inspektimi për marrjen e mostrave për mbetje pesticidesh në fruta perime, për arsye subjektive, pasi ISUV pranon mostra deri ne orën 13.**

IV. në 2 raste *(N dhe E)* për vitin 2019 j**anë konstatuar shkelje në dokumentacion dhe sigurinë në kripën jodizuar importit, rezulton se nuk disponohet procesverbal bllokimi,** *krahas gjobave të vendosura.*
Tek inspektimi datë 02.05.2019 "***E***" AKU-TR-2019-002473 **nuk janë marrë masat për kontrollin e të gjithë zinxhirit të shkelësve, por lihet detyrë që kripa të kthehet tek furnitori,** ndërsa për pjesën e shitur të kthehet në market nga klientët.

V. në 1 rast për *OBU "M*" Tiranë **janë konstatuar produkte skaduar** të vitit 2018, të cilat nuk janë trajtuar nga inspektimet në 2018**,** pasi ato janë gjendje deri maj 2019. **Procedura e inspektimit në 2019 nuk ka shkuar deri në fund,** pasi ka mbetur në fazën e konstatimeve dhe vendosjes gjobave, **pa justifikuar me procesverbal asgjësimi dhe fletëdalje zhdukjen e produkteve s,kaduara, të cilat nuk shprehen në vlerë por vetëm në sasi**,
VI. Në DR AKU Tiranë për vitin 2019, u konstatuan:
- **në 5 raste u vërejtën çështje inspektimi të anuluara brenda ditës** për subjektin nën inspektim, megjithëse inspektimi ka filluar me kërkesën subjektit si: AKU-TR-2019-002706, AKU-TR-2019-002705,AKU-TR-2019-003059,AKU-TR-2019-003102;AKU-TR-2019-003101.
- **në 3 raste subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura, por nuk justifikohen me foto** të subjektit mbyllur, kërkesë kjo e rregullores së procedurës inspektimit**,** si: AKU-TR-2019-003182; AKU-TR-2019-000492; AKU-TR-2019-003151.
- **në 15 raste mungojnë foto dhe video në subjektin e inspektimit, për argumentimin e shkeljeve** si; AKU-TR-2019-000485;AKU-TR-2019-003141; AKU-TR-2019-002812; AKU-TR-2019-003211; AKU-TR-2019-002705; AKU-TR-2019-002706; AKU-TR-2019-002671; AKU-TR-2019-002752; AKU-TR-2019-003193; AKU-TR-2019-003166; AKU-TR-2019-001215; AKU-TR-2019-002629; AKU-TR-2019-000492; AKU-TR-2019-003101; AKU-TR-2019-003102.

VII. Nga 27 dosje inspektimi të audituara për vitin 2019, rezultojnë 10 gjoba të vendosura ndaj subjekteve, nga këta 2 gjoba janë arkëtuar dhe 8 gjoba nuk janë likuiduar, procedurat ligjore paraqesin tejzgjatje mbi 2 vjet, çka ka krijuar debitor të prapambetur me efekt negative në buxhet të të ardhurave nga gjoba, *më hollësisht trajtuar sipas subjekteve si më poshtë:*

VIII. Në 1 rast inspektimi tematik me objekt: "*për zbatim urdhri eproreve*" u konstatua se inspektimi nuk është argumentues dhe nuk shoqërohet me dokumente, me informacion dhe me foto, e domosdoshme kjo për raste të veçanta, madje nuk sqarohet pse lihet detyrë kur nuk pasqyrohet shkelja.

II. Në mënyrë analitike (28 dosje 2019 audituar).

1. C Albania shpk.

1/1. Dosja e inspektimit **datë 09.04.2019**, C Albania Autostrada km 6 Tiranë me aktivitet *import-eksport, magazinim, shitje produkte ushqimore*, rezulton se: Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 08.04.2019 Inspektorët **M.C, A.Sh, A.B** kanë vendosur **bllokimin e asgjësimin e kërpudhës freskët**, pasi mungon dokumentacioni i origjinës *(certifikata fitosanitare*) si dhe kanë vendosur **gjobë 2,000,000 lekë dhe paralajmërim** (*drejtoresha e DR AKU Tiranë zj. M.M*), madje edhe kjo gjobë është ***falur 50 % nga komisioni ankimor*** AKU Qendër sipas vendimit nr. 2642/1 datë 08.05.2019 *ndërsa gjykata e shkallës pare ka rrëzuar këtë vendim dhe aktin e inspektimit duke ja hequr subjektit 100 % gjobën*, sipas vendimit nr. 3579 datë 29.10.2019. Çështja është apeluar me 26.12.2019 nga DR AKU Tiranë, ku nga andej s,ka përgjigje. **Kërpudha freskët nuk është asgjësuar, pasi s'ka dokument asgjësimi.**

1/2. Dosja e inspektimit **datë 08.07.2019**, C Albania shpk: Sipas autorizimit date 08.07.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU S.S, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 09.07.2019, **sipas informacionit te një autoriteti publik ose RASFF është e nevojshme një inspektim për një sasi *orizi me substance e paautorizuar.*** Inspektorët M.H, F.R dhe M.D, K.J ka kryer inspektimin dhe kane ***lënë detyre OBU te tërheq nga tregu produktin për asgjësim*** *(pasi përfaqësuesi i Cit ishte me pushime, kështu duke e shtyre inspektimin*)**, në fakt nuk është asgjësuar, pasi s'ka dokument asgjësimi.**

1/3. Dosja e inspektimit **datë 10.07.2019**, C Albania shpk: Sipas autorizimit date 10.07.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU **S.S**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 10.07.2019, *sipas RASFF* **u disponua dokumentacioni për një sasi orizi (***360*

kg) **pa afat s,kadence dhe me mospërputhje shifrash me te dhënat e subjektit, ku është vendosur gjobë 2,200,000 lekë** *(2,000,000+200,000)* nga Inspektorët M.H, F.R dhe M.D, K.J, e cila është falur 100 % nga komisioni ankimor AKU Qendër, sipas vendimit nr. 16 datë 05.03.2020.

1/4. Dosja e inspektimit **datë 30.08.2019**, C Albania shpk rezulton se: Sipas autorizimit date 30.08.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU S.S dhe procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 30.08.2019, *bazuar në planifikimin*, inspektorët **K.S, K.J dhe Dallëndyshe Kajmaku *duhej të merrnin mostra për fruta perime për mbetje pesticidesh*, në fakt nuk kanë marrë për arsye subjektive** *(ISUV pranon mostra deri ne orën 13).*

1/5. Dosja e inspektimit **datë 23.10.2019**, C Albania shpk rezulton se: Sipas autorizimit date 23.10.2019 nënshkruar nga drejtori i DRAKU A.N, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 23.10.2019 inspektorët **M.C dhe J.K nuk kanë asgjësuar produktet ushqimore skaduara për 891 kg me vlere 487,911 leke, nën pretekstin se subjekti nuk është gati,** megjithëse ky i fundit ka bere vete kërkesën date 18.10.2019. Në fakt pas 1 jave është kryer asgjësimi i 891 kg produkteve s,kaduara me vlere 487,911 leke por nga inspektorë tjerë E.V dhe N.M**,** sipas autorizimit date 29.10.2019 dhe aktinspektimit vendimit përfundimtar datë 29.10.2019, ku procedura asgjësimit është e pjesshme**,** pasi mungon procesverbali asgjësimit, mungojnë nënshkrimet e komisionarëve në listën e produkteve të asgjësuara, mungon flet dalja e subjektit për produktet e asgjësuara për efekt të shkarkimit tyre nga kontabiliteti. **Disa nga produktet e s,kaduara i përkasin vitit 2018** sipas listës subjektit**, por nuk janë kapur nga inspektimet e vitit 2018,** fakt është se ato janë gjendje deri në tetor 2019, për pasojë **nuk janë aplikuar gjoba, siç janë aplikuar tek OBU** Market "G" Laknas.

2. *Dosja e inspektimit* **datë 02.05.2019**, ***E shpk*** rezulton se: Sipas autorizimit date 02.05.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU **M.M**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 03.05.2019, inspektorët **K.S dhe A.Sh kanë konstatuar shkelje në dokumentacionin dhe sigurinë në kripën ushqimore jodizuar importit** *(disponohet përgjigjja e analizave 26.04.2019 dhe pastaj kanë mbyllur me të drejtë inspektimin)* **dhe kanë aplikuar 4 gjoba për 1,500,000 lekë, paralajmërim si dhe kanë bllokuar 16,236 kg kripe jodizuar,** por **nuk administrohet informacion çfarë është bërë më tej për kontrollin e zinxhirit shkelësve.**
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 1,500,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti është ankimuar me date 10.06.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën**.** Subjekti ka bërë ankimimin në gjykatë datë 26.06.2020. DRAKU ka bere kërkesën ne gjykatën administrative shkalles parë Tiranë nr. 1605 date 10.09.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit për masën administrative, të vlerës 1,500,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit nr. 1021 date 18.08.2020. **Mungon kërkesa e AKU për zyrën e përmbarimit për ekzekutim te masës administrative. Po kështu nga e DRAKU Tiranë dhe zyra juridike ka munguar bashkëpunimi me AKU Qendër. Mungon bashkëpunimi me zyrën e përmbarimit, dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi vlera nuk është arkëtuar nga subjekti.**

3. Dosja e inspektimit datë 10.05.2019, N Kashar Tirane, rezulton se: Sipas autorizimit date 10.05.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU S.S, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 13.05.2019, inspektorët M.H dhe M.C kanë konstatuar shkelje në dokumentacionin dhe sigurinë në kripën *Himalaja* ushqimore jodizuar importit, ku kanë aplikuar 2 gjoba në vlerën 1,100,000 lekë dhe paralajmërim. Theksojmë se më parë me date 30.04.2019 nuk është lejuar inspektimi i DRAKU dhe me praninë e policisë, ku nga inspektorët K.S, L.A dhe D.K ndaj OBU N i është aplikuar gjobë 100,000 lekë.

3/1. Po kështu është vepruar me "T" shpk Kashar Tirane, ku janë aplikuar 2 gjoba në vlerën 1,100,000 lekë dhe është bllokuar një sasi kripë jashtë afatit s,kadencës dhe me përmbajtje te jodit 3 mlg/100 gram ku duhej 40-60 miligram/100 gram, **pa mbajtur procesverbal bllokimi dhe pa**

ditur destinacionin e kësaj kripe, madje është lënë detyrë subjektit të tërheq kripen nga klientët me dokument duke njoftuar DAKU, në vend që të ndiqte vete klientët, pasi është detyre pa shprese realizimi. DAKU me shkresën 1608 datë 25.04.2019 **ka njoftuar subjektin për** 2 gjobat dhe **bllokimin e kripës deri ne daljen e analizave**, por **nuk disponohet dokument për marrjen e shoqërimin e mostrës kripës.** Sipas autorizimit date 23.04.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU M.M, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 24.04.2019, inspektorët **L.B dhe E.M.**

4. *Dosja e inspektimit* datë 02.05.2019, "***E***" Tirane, *për zbatim detyrash të lëna*, rezulton se: Sipas autorizimit date 02.05.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU M.M, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 02.05.2019, inspektorët K.S dhe A.Sh kanë konstatuar se 13 kg kripe e jodizuar e bllokuar "*për jod nen norme*" dhe me procesverbalin 18.04.2019 është zhbllokuar për tu kthyer tek furnitori *E shpk* sipas faturës tatimore date 02.05.2019, i cili rezulton me probleme te tilla sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 03.05.2019.

5. *Dosja e inspektimit* datë 22.05.2019, "**Q**" Tirane, sipas autorizimit date 22.05.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU **S.S**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 22.05.2019, inspektorët **L.A dhe L.B,** rezulton:
- është kryer një **inspektim formal dhe sipërfaqësor si dhe pa asnjë rezultat dhe peshë.**
- **nuk është konstatuar asnjë shkelje, për pasojë nuk ka masa administrative**,
- **kanë mbyllur inspektimin pa përgjigjen e analizave *salcë fresh,***
- **kanë bllokuar 3 kg salcë fresh 2 lloje**, megjithëse janë brenda afatit s,kadencës datë 15 dhe 16.07.2019, deri në zbardhjen e analizave.
- **nuk është plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit date 22.05.2019**, ku thuhet:"***ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit***", pasi mbyllet pa gjetur shkelje, **nuk argumentohet se çfarë u kontrollua dhe u gjet në rregull.**
- **dosja e inspektimit paraqet mangësi,** pasi mungojnë dokumentet shoqëruese te kontrollit zyrtar si kontrolli i etiketës, gjurshmërisë dhe sistemit vet kontrollit, fotot ose filmime, paketimi.
- objekti i inspektimit në autorizim lenë për tu dëshiruar, ku thuhet: " *inspektime ne rast kur nga vet kontrolli analizat laboratorike rezultojnë pozitive",* ça tregon mungesë në metodologjinë e vlerësimit riskut dhe inspektim jo efiçent, .

6. *Dosja e inspektimit* datë 17.05.2019. AKU-TR 2019-002815-1, ***OBU M*** Njësia bashkiake nr. 3 Tiranë me aktivitet "*tregtim buke e artikuj ushqimore etj*", rezulton se **Inspektorët D.K, E.M dhe P.D** kanë konstatuar shkelje mbi bazën e të cilave kanë aplikuar gjoba në vlerën **500,000 lekë** dhe paralajmërim. Gjithashtu inspektorët kanë konstatuar produkte me s,kadencë të kaluar, sipas procesverbalit inspektimit (aty për aty) dhe vendimit ndërmjetëm për masa urgjente date 17.05.2019, ku citohet: *këto produkte u bllokuan në subjekt deri në marrjen e masave nga subjekti për asgjësimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi*, por:
a. Nuk thuhet vendi dhe mënyra e bllokimit, për efekt të sigurisë të produkteve të bllokuara.
b. Produktet e s,kaduara nuk shprehen në vlerë por vetëm në sasi ose cope *(sallam 7 pako me afat s,kadence 14.05.2019, fruta thata palme 7 pako me afat s,kadence 28.03.2019, birre B 8 shishe me afat ..9.2018, birre T 4 shishe me afat 09.10 2018, birre K 10 shishe me afat 20.12.2018, birre S 2 shishe 21.12.2018, I 29 cope 14.5.2019, lëngje frutash 8 cope 26.01.2019, etj),*
c. Ushqimet e s,kaduara nuk janë kapur nga inspektimet e vitit 2018, pasi disa i përkasin këtij viti dhe janë gjendje deri maj 2019.
d. Procedura e inspektimit nuk ka shkuar deri në fund, pasi ka mbetur në fazën e konstatimeve dhe vendosjes gjobave, pa justifikuar me dokument asgjësimin e produkteve

të s, kaduara (*të cilat nuk do të qëndrojnë pa afat të bllokuara në ambientet e subjektit).* Kështu mungon procesverbali i asgjësimit me komision posaçëm dhe flet dalja për shkarkimin nga kontabiliteti e produkteve të s,kaduara,
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 500,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti është ankimuar me date 28.05.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën**, d**isponohet kërkesa e DRAKU dhe urdhri ekzekutimit dhjetor 2020.
7. *Dosja e inspektimit* datë 22.05.2019 *market G*, Laknas, AKU-TR-2019-002927-1, me objekt ***indicie nga ankimimet*** ku janë konstatuar shkeljet: **ushqime s,kaduara të cilat i kanë shoqëruar me foto për çdo artikull**, mungese dokumentacioni gjurshmerise dhe sende tepërta ne magazine etj, inspektoret **D.K, E.M** kane vendosur 3 gjoba për **800,000 leke**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit ndërmjetëm për masa urgjente date 22.05.2019. Inspektorët kanë bllokuar produktet që kanë kaluar s,kadencën, por nuk kanë mbajtur akt-bllokimin, ndërsa mungon procesverbali i asgjësimit për produktet e s,kaduara i shoqëruar me flet daljen e subjektit.
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 800,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti është ankimuar me date 29.05.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën**.** Subjekti nuk ka likuiduar vullnetarisht gjobën, por ka ngritur padi ne gjykate kundër vendimit komisionit ankimor. DRAKU ka bere kërkesën ne gjykatën administrative shkallës parë Tiranë nr. 2435, date 16.12.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit të masës administrative 800,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin e saj me vendimin nr. 1648, date 23.12.2020 dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi vlera nuk është arkëtuar nga subjekti.

8. *Dosja e inspektimit* datë 29.05.2019 G "*tregti me shumice e pakice***" Kashar,** AKU-TR-2019-003059, inspektim ne zbatim urdhrit ministrit e drejtorit, ku janë konstatuar shkeljet: **-mungese e gjurmshmërisë për 2016- 2017** s,ka asnjë dokument për **vajin e palmës** dhe ne rastet qe ka shitur mungon emri, mbiemri identiteti i blerësit, ku nga inspektoret **M.H, M.C, M.Z** janë vendosur **2 gjoba me nga 200,000 leke/***secila* **dhe paralajmërim,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtarë date 30.05.2019, ku ***subjekti refuzon firmën pasi thotë se edhe kompani te mëdha tjera kanë probleme të tilla dhe shesin vaj palme me kase por nuk citon identitetin e kompanive.***
Procedura për vjeljen e gjobës.
Gjoba 400,000 lekë nuk është likuiduar, Subjekti me datë 30.05.2019 ka marrë gjobë 400,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 03.06.2019 dhe **komisioni ankimor shqyrtimin e ankesës e ka kryer *me vonesë mbi 1 vit nga 30 ditë që duhej,*** sipas vendimit nr. 3338/1 datë 01.10.2020**, ku ka lënë në fuqi gjobën e vendosur** nga inspektorët, por **më tej deri 31.12.2020 DR AKU nuk ka bërë kërkese ndaj gjykatës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv për masën administrative,** për rrjedhojë vazhdon tejzgjatja e procedurës për likuidimin e gjobës vendosur, çka **ngarkon me përgjegjësi juristen H.P dhe drejtorin M.N.**
Theksojmë se disponohet shkresa "*kërkim dokumentacioni*" ne adrese postes nr. 120 date 20.01.2021, lidhur me njoftimin e subjektit, por ajo i përket vitit pasardhës 2021, ndërsa çështja i përket vitit 2020, *ky fenomen edhe për disa subjekte tjera*.

9. *Dosja e inspektimit* datë 02.05.2019 *S* "*tregti me shumice e pakice***"** Njësia Bashkiake 5**,** AKU-TR-2019-002470, ***ri-inspektim zbatim detyrash sipas procesverbalit date 18.04.2019***, për ***bllokimin e 16 kg kripe jodizuar***, inspektorët K.S dhe A.Sh, **kanë zhbllokuar kripën, pasi analizat janë normale**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 02.05.2019.
9/1. *Dosja e inspektimit* datë 21.10.2019 *S* "*tregti me shumice e pakice***" Farke,** AKU-TR-2019-006939, objekti: ***plane monitorimi,*** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 21.10.2019, rezulton se: Inspektimi **nuk ka konstatuar asnjë shkelje, është mjaftuar me marrjen e disa mostrave** si **spec**, molle, domate, patate, **për të cilat nuk ka përgjigje dhe nga**

inspektorët është mbyllur inspektimi. Produktet spec (45 kg), molle, domate, patate **nuk janë bllokuar** të cilave ju morën mostrat**,** ndryshe nga inspektimi datë 11.11.2019 ku produkti 155 kg miell është bllokuar deri ne daljen e përgjigjeve analizave. **Mungon fotografimi i produkteve dhe ambientit ku janë të vendosura**, për pasojë nuk është realizuar qëllimi i inspektimit.
Gjurmimi: Nga gjurmimi i inspektimit bazuar në procesverbalin inspektimit dhe vendimin përfundimtar date 18.11.2019 ne subjektin ***"G"*** **shpk i cili ka furnizuar** ***"S"*** me faturën 12014 datë 21.10.2019, **rezulton se speci ka rezultuar mbi normën e lejuar** te pesticideve (*imidacloprid*), sipas analizave date 14.11.2019. **Subjekti "G" është furnizuar nga prodhuesi fermer "*M*" Elbasan**.
Përfundimisht, inspektimi është mbyllur pa masa administrative, pa bllokim produkti *(45 kg spec)* të pa sigurte dhe pa asgjësim të tij, me pretekstin se analizat janë vonuar 24 ditë *(21.10 deri 14.11.2019)* dhe produkti është shitur konsumatorëve nga *S*, ndërsa nuk ka gjendje ne magazine *(mungon fotografimi)* duke mbetur përgjegjës fermeri në Elbasan. **Inspektorët M.H, M.C, J.K dhe kryeinspektori A.N.**
9/2. *Dosja e inspektimit* datë 11.11.2019 ***S*** **"***tregti me shumice e pakice***" Farke,** AKU-TR-2019-006939, objekti: ***Indice nga ankimimet,*** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 11 dhe 12.11.2019, rezulton se **inspektimi është mbyllur pa dalë rezultati i analizave miell granoro semola**, por është bllokuar 155 kg miell (*ska procesverbal bllokimi*) deri ne daljen e analizave (*mungojnë*), **mungon fotografimi, mungon listverifikimi** *(i paplotësuar).* **Masa administrative nuk janë aplikuar,** *ndryshe nga subjekti AKU-TR-2019-003483, "Furre buke" S si dhe subjekti B AKU-TR-2019-008616 "buke e pastiqeri", ku është aplikuar 300 mije leke gjobe/secilin (inspektimi date 19-20 nëntor 2019)..*
Inspektorët K.J, S.L dhe kryeinspektori A.N.

10. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2019, Q, AKU-TR-2019-003178, **market ushqimor** pranë Profarmës Tirane, ***inspektim nga indicet ankimimet..***sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 30.05.2019 është konstatuar shkelje **mungese gjurmimi, mangësi në etiketim dhe ambienti ka nevoje për sistemim**, ku janë aplikuar **2 gjoba për 150,000 leke** dhe **paralajmërim** nga inspektoret **A.N dhe I.O.**
Theksojmë se **I.O njëkohësisht është edhe inspektor pranë sektorit PIK (**pik kufitare), çka krijon **dublim detyrash**, sipas urdhrit nr. 429, datë 27.05.2019 të drejtorit DR AKU Tiranë S.S, në vend të Drejtorit Përgjithshëm.
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 150,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 08.04.2019 ka marrë gjobë 150,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 12.06.2019 dhe komisioni ankimor nuk ka vendim.

11. Inspektoret L.B dhe M.B kanë paraqitur inspektime të pjesshme, pasi fusha e inspektimit ka qenë e gjerë për të gjitha problemet në zbatim të legjislacionit si dhe janë përdorur 2 standarde në dhënien e masave administrative në subjektet e inspektuara me shkelje te njëjta, konkretisht:
11/1- Dosja e inspektimit* datë 14.05.2019, S grup,** AKU-TR-2019-002731, **market ushqimor** pranë spitalit ushtarak Tirane, ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 14.05.2019 është konstatuar shkelje e nenit 48 , pika 1,4,5 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH", gardëroba ne ambient papërshtatshëm, një pjese e tavanit ka nevoje për lyerje, disa prej analizave te produkteve ushqimore duhet rinovohen (nuk citohen cilat produkte)* **dhe nga inspektoret nuk janë dhënë asnjë mase administrative.**
11/2- Dosja e inspektimit* datë 13.05.2019, D,** AKU-TR-2019-002688, **market ushqimor**, ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 14.05.2019 është konstatuar shkelje e nenit 48 , pika 1,4,5 të ligjit nr. 10433

datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH", ambienti ka nevoje për sistemim, një pjese e sendeve tepërta duhet te largohen, disa prej analizave te produkteve ushqimore duhet rinovohen pasi u ka kaluar afati (nuk citohen cilat produkte)* **dhe nga inspektoret është dhënë paralajmërim dhe janë lënë detyra.**

***Sa sipër,* 2 inspektimet janë formale,** pasi nuk kanë plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit date 22.05.2019, ku thuhet:"*ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit*", pasi mbyllet pa gjetur shkelje, nuk argumentohet se c,fare u kontrollua dhe u gjet në rregull. Njëkohësisht dosjet e inspektimit paraqesin mangësi**,** pasi mungojnë dokumentet shoqëruese te kontrollit zyrtar si kontrolli i etiketës, gjurshmerise dhe sistemit vet kontrollit, fotot ose filmime, paketimi etj. Gjithashtu 2 inspektimet janë firmosur nga subjektet, ndryshe nga rastet tjera ku janë refuzuar.

11/3. Dosja e inspektimit* AKU-TR-2019-0033158*, inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 30.05.2019 të inspektoreve **A.N dhe I.O** është konstatuar shkelje si:

- *ambienti ka nevoje për sistemim,*
- *disa prej analizave te produkteve ushqimore duhet rinovohen por* ***nuk citohen cilat produkte****,*
- ***nuk kanë plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit date 30.05.2019****, ku thuhet*:"*ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit*", *pasi mbyllet pa gjetur shkelje, nuk argumentohet se c,fare u kontrollua dhe u gjet në rregull.* ***Mungojnë dokumentet shoqëruese*** *si kontrolli i etiketës, gjurmshmerise, fotot, paketimi etj. Përfundimisht inspektimi është firmosur nga subjekti pa vërejtje.*

Përfundimisht, inspektimi është i cekët dhe sipërfaqësor, pasi fusha e inspektimit ka qenë e gjerë për të gjitha problemet në zbatim të legjislacionit, por është mjaftuar me paralajmërim dhe kanë lënë detyra.

11/4. Po kështu ***me të njëjtat probleme*** konstatohet dhe inspektimi ***AKU-TR-2019-002835***, **i** kryer nga inspektoret A.N dhe Ardian Troci.

11/5. Dosja e inspektimit AKU-TR-2019-002912*, "Pastiçeri, akullore, prodhim e tregtim*", H, rruga Tufine, me objekt: ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...*** rezulton se **inspektimi i kryer nga inspektorët L.A dhe L.B është formal**, pasi fusha e inspektimit ka qenë e gjerë në zbatim të legjislacionit, ndërsa fenomenet e trajtuara janë të mangëta dhe të pa shoqëruara me dokumentacionin përkatës, për të argumentuar ato që thuhen në procesverbal, më konkretisht**:**

a. nuk është kryer inspektimi në datën e përcaktuar në autorizimin e titullarit datë 21.05.2019 "*nën pretekstin se nuk patëm kohë të kryenim inspektimin nga kompleksiteti i veprimeve",* **duke e shtyrë afatin për datën 22.05.2019 pa miratim titullarit (***nuk ka firme kryeinspektori S.S)*, **b. nuk është konstatuar asnjë shkelje**, *përjashtuar nevojën për sistemimin e ambientit dhe rinovimin e analizave ujit*, sipas procesverbalit dhe vendimit përfundimtar date 22.05.2019.

c nuk është plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit datë 22.05.2019*, ku thuhet*:"*ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit*", *pasi mbyllet pa gjetur shkelje, nuk argumentohet se c,fare u kontrollua dhe u gjet në rregull.*

d. mungojnë kontrollet tjera shoqëruar me dokumente provë, *si kontrolli i etiketës, ambalazhit, gjurmshmerise, fotot ambientit, paketimi, marrja e mostrave qumështit dhe tortave për sigurinë e tyre, dokumentet e lëvizjes lendeve para si faturat tatimore blerje dhe shitjes etj, s,kadenca e produkteve dhe sendet e tepërta etj. Përfundimisht inspektimi është firmosur nga subjekti pa vërejtje.*

11/6. Me të njëjtat probleme konstatohet dhe inspektimi ***AKU-TR-2019-002826***, i kryer me datë 17.05.2019 në subjektin L "*prodhim brumi buke e byrek*" nga inspektoret **inspektorët L.A dhe L.B,** të cilët në fund kanë lënë detyre pa vend "*paralajmërim"* pasi s,ka arsye *për lyerje tavani të ambientit*.

Për 6 dosjet e më sipërta nënshkrimi i drejtorit DR AKU Tiranë **S.S.**

12- *Dosja e inspektimit* datë 14.05.2019, B përballë Pediatrisë **Tiranë,** AKU-TR-2019-002734, ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...***sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 14.05.2019 është konstatuar shkelje e nenit 48 , pika 1,4,5 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH", sende tepërta dhe dokumentacioni shoqërues duhet rinovohet certifikata e ambalazheve* dhe nga inspektoret është lënë kjo detyrë dhe paralajmërim. **Inspektimi** i kryer nga **F.R dhe M.D paraqitet formal, me mangësi në trajtimin e çështjeve, me mungesë dokumentacioni shoqërues** etj. Kështu nuk janë konstatuar shkelje thelbësore, por nuk jepen arsyet e përfundimit te procedimit, pasi mbyllet pa gjetur shkelje, nuk argumentohet se c,fare u kontrollua dhe u gjet në rregull shoqëruar kjo edhe me foto e dokumentacion shoqërues prove, kërkesë kjo e pikës 9 të procesverbalit inspektimit. Mungojnë kontrolli i etiketës, ambalazhit, gjurmshmerise, fotot ambientit, paketimi, marrja e mostrave për sigurinë e tyre, faturat tatimore blerje dhe shitjes etj, s,kadenca e produkteve, madje **nuk përmendet askund në asnjë dokument të dosjes aktiviteti i subjektit dhe nuk bëhet fjalë për produktet, çka e bën jo efiçent inspektimin.**

13- *Dosja e inspektimit* datë 02.04.2019, *M,* Njësia Bashkiake 11, rruga "Elez Isufi" **Tiranë,** AKU-TR-2019-002734, ***inspektim nga ankesat e konsumatorëve për mungese licence dhe tregtim produktesh te s,kaduara***... i kryer nga **E.V dhe M.D** rezulton se: **Inspektimi paraqitet i pjesshëm,** pasi:
a. nuk ka trajtuar produktet që tregtohen me afat s,kadencë të kaluar, objekt i inspektimit dhe i ankesës datë 28.03.2019, ndryshe nga inspektimi AKU-TR-2019-001779 date 01.04.2019, ne subjektin "*Market D*" ku është trajtuar se nuk disponohen produkte jashtë s,kadence.
b. procesverbali i inspektimit datë 02.04.2019 nuk pasqyron dokumentet e paraqitura, faturat e blerjes dhe shitjes, bazë për të verifikuar afatin e s,kadencës të pijeve freskuese.
Theksojmë se janë konstatuar këto shkelje tjera si: -mos implementim regjistrat HACCP, -nevojë për lyerje muresh ku mbahen pijet ambalazhuara -vendosja e lavamanit në ambientin e tregtimit. Nga inspektoret është aplikuar gjobë **100,000 lekë** dhe paralajmërim si dhe është lënë detyrë për përmirësim kushtesh në të ardhmen. Nga auditimi i procedurave për ndjekjen dhe vjeljen e gjobës së vendosur rezulton se subjekti ka likuiduar gjobën 100,000 lekë në datën 20.05.2019.

14- *Dosja e inspektimit* datë 08.04.2019, market ushqimor, *L* Tiranë, AKU-TR-2019-001962, ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi...***sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 08.04.2019 është konstatuar shkelje e nenit 68/1/d të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *"Për Ushqimin"* i ndryshuar, pasi **9.58 kg produkte janë me afat s,kadence te tejkaluar** dhe nga inspektoret është vendosur gjobe **300,000 leke**, paralajmërim dhe **bllokim produkteve jashtë s,kadencës,** por:
- nuk ka procesverbal bllokimi dhe nuk behet fjale për asgjësimin e tyre sepse nuk ka procesverbal asgjësimi me komision.
- mungon dokumentacioni shoqërues me foto ambientit sepse thuhet muri ka lagështire dhe janë pranishme sende tepërta të cilat nuk citohen,
- **nuk është plotësuar dokumentacioni faturat tatimore blerje-shitje**, kërkesë e pikës 6 procesverbalit inspektimit, **për efekt gjurmimit produkteve s,kaduara në origjinë.**
- nuk është kontrolluar i gjithë zinxhiri i shkelësve pra furnitorin.
- nuk argumentohet sasia e produkteve s,kaduara sipas gjetjeve inspektoreve, me të dhënat sipas faturave hyrje-dalje,
Përfundimisht, **inspektimi i kryer** nga **L.A dhe P.D nuk ka shkuar deri në fund të procedurës, çka e bën jo efiçent** inspektimin.
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 300,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 08.04.2019 ka marrë gjobë 300,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 19.04.2019 dhe komisioni ankimor nuk ka vendim.

15. ***Dosja e inspektimit*** **AKU-TR-2019-001948**, ***Furre buke e pastiqeri*** **P.S**, Njësia nr. 5 Tiranë me objekt: ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi dhe marrje mostre...***sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 08.04.2019, u konstatua se: **Inspektimi i kryer nga E.A dhe L.Zh nuk ka qenë i plotë,** pasi është **mbyllur procedura e inspektimit pa marrë rezultatin e analizave bukës,** *në dosje mungon përgjigjja e analizave laboratorike.* Inspektorët kanë marre mostrën 400 gram buke, kanë aplikuar gjobe **100,000 lekë** për mos korrigjim te shkeljeve të mëparshme. Nga auditimi i procedurave për ndjekjen dhe vjeljen e gjobës së vendosur rezulton se subjekti ka likuiduar gjobën 100,000 lekë me këste nga 20,000 leke/ maj, qershor, korrik, gusht, shtator 2019.
Ndryshe ka ndodhur në inspektimin sipas ankesave datë 16.04.2019 të AKU-TR-2019-002165, Pastiçeri *"Z",* rruga "*Myslim Shyri*", ***ku disponohet rezultati i analizave " normale", fotot e produkteve dhe ambientit si dhe është aplikuar gjobe 10,000 lekë për mos korrigjim te shkeljeve të mëparshme.***

16. ***Dosja e inspektimit*** **datë 26.04.2019**, market **I Synej** Kavaje, me objekt: ***inspektim zbatim i legjislacionit ne fuqi,*** rezulton se: Sipas autorizimit date 26.04.2019 nënshkruar nga drejtori i DR AKU **M.M**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 26.04.2019, inspektorët inspektorët **L.B dhe E.M** kanë konstatuar **produkte me afat s,kadence te tejkaluar** *(gjalpë, qumësht, kikirik etj)* dhe nga inspektoret është vendosur gjobe **400,000 leke**, paralajmërim dhe **bllokim, asgjësim ose kthim tek furnitori,** por:
- nuk ka procesverbal bllokimi dhe nuk behet fjale për asgjësimin e tyre sepse nuk ka procesverbal asgjësimi me komision të shoqëruar me flet daljen përkatëse.
- **nuk është plotësuar dokumentacioni faturat tatimore blerje-shitje**, kërkesë e pikës 6 procesverbalit inspektimit, **për efekt gjurmimit produkteve s,kaduara në origjinë.**
- **nuk është kontrolluar i gjithë zinxhiri i shkelësve** pra furnitorin, madje lihet detyre kthim tek furnitori, pa zgjidhur asgjë, sikur është pik kufitare.
- **nuk argumentohet sasia e produkteve s,kaduara sipas gjetjeve inspektoreve, me të dhënat sipas faturave hyrje-dalje,** *të cilat nuk janë pasqyruar tek procesverbali inspektimit 26.04.2019.*
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 400,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 26.04.2019 ka marrë gjobë 400,000 lekë, DRAKU ka njoftuar subjektin me datë 30.04.2019, subjekti është ankimuar me date 21.05.2019 dhe **komisioni ankimor nuk ka vendim për shqyrtimin e ankesës.**

17. ***Dosja e inspektimit*** datë 16.07.2019, AKU-TR-2020-004517, subjekti ***"A***" adresa: Q.Stafa Tiranë, e kryer nga **K.S, K.Jj, D.K**, sipas autorizimit datë 16.07.2019 të drejtorit S.S me objekt "*zbatim urdhrave drejtorisë dhe Ministrisë*", sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 16.07.2019 thuhet: *OBU"A" ka licence për prodhim e shpërndarje ushqimore me shumice, ne momentin e inspektimit OBU ai është ne fazën eksperimentale me bimët medicionale pra nuk ka filluar punën ne treg, ju la detyre te mos dale pa etikete te miratuar....rezulton se:* **Praktika e inspektimit nuk është argumentuese dhe paraqet mungesa të dokumenteve shoqëruese,** pasi nuk disponohet dokumenti për qëllimin e inspektimit, mungon informacioni për sqarimin e urdhrit të drejtorit përgjithshëm, mungon nënshkrimi i subjektit dhe arsyet që ngrenë ai. Inspektorët janë në kontradiktë me atë që kanë shkruajtur në procesverbal, pasi thuhet *OBU është ne fazën eksperimentale me bimët medicionale, nuk ka filluar punën ne treg, ju la detyre te mos dale pa etikete te miratuar,* pra nuk sqarohet pse lihet detyrë kur nuk pasqyrohet shkelja. Gjithashtu faza eksperimentale me bimët medicionale nuk serviset me foto, e domosdoshme kjo kur ka urdhra të veçantë.

C. Inspektime të sektorit OJSH për vitin 2020, rezulton:

Gjatë periudhës **01.01.2020 deri më 31.12.2020,** Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor ka kryer gjithsej **2518 inspektime**. Për vitin **2020** numri i inspektimeve të **planifikuara është 2522 inspektime** dhe janë realizuar **1431 inspektime (pasqyruar në tabelat nr.28-29 në Kap. "Anekset"). Për vitin 2020 ka pasur një ulje të numrit të inspektimeve për diferencën 797 inspektime.** Grafiku ka qenë në zbritje si në planifikimin dhe realizimin e inspektimeve, ku ndikim negativ ka pasur dhe pandemia, pasi inspektorët janë angazhuar në zbatimin e masave anti-covid 19.

Për vitin **2020 nuk janë realizuar 1091 inspektime të planifikuar**:
Gjatë vitin **2020** janë marrë gjithsej **1240 masa administrative** përkatësisht: gjoba, ndërprerje aktiviteti, paralajmërime, asgjësime dhe bllokim produkti, përkatësisht:
- **asgjësime** të produkteve ushqimore në **85 subjekte** në sasi **2011 ton**, me vlerë **329,506,860** lekë.
- **bllokime** të produkteve ushqimore në **28** subjekte në sasi **45 ton,**

Grafiku ***një rënie të numrit dhe sasisë në ton të produkteve ushqimore të bllokuara për vitin 2020*** krahasuar me vitin 2019
- **54 masa administrative gjobë** për **46 subjekte** për vitin 2020, me vlerë 8 510 000 lekë, *ndërsa në vitin 2019 janë marrë 139 masa administrative gjobë për 90 subjekte vlerë 69 750 000 lekë.*

Gjatë vitit 2020 janë marrë masa administrative me **ndërprerje aktiviteti për 10 subjekte**, *ndërsa në vitin 2019 janë marrë 40 masa me ndërprerje aktiviteti.*
Gjatë vitit 2020 janë marrë masa administrative me **paralajmërim për 1071 subjekte** për mangësi të një rëndësie të vogël ligjore, *ndërsa për vitin 2019 numri i masave me paralajmërim është 1594.*
Për vitin **2020 numri i planifikuar i mostrave** ka qenë **368** (*DRAKU, ISUV dhe Higjienës*), **jashtë parametrave të lejuara 6 mostra.**
Janë bërë miratime të kërkesave për licencim për **56** subjekte në **2020**, *ndërsa në 2019 janë miratuar 238 kërkesa për licencim.* Janë bërë mosmiratime të kërkesave për licencim për **21** subjekte në **2020**, *ndërsa në 2019 nuk janë miratuar 138 kërkesa për licencim.*

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve inspektimit pë produktet OJSH të vitit 2020, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi:
1. Në 5 raste inspektimet janë mjaftuar me paraqitjen e disa mangësive të godinës së subjekteve si: mure, tavane, dysheme ose pjesë të tyre të dëmtuara dhe të pa lyera, *sikur janë mbikëqyrës ose kolaudator ndërtimi,* **në vend që të trajtonin produktet ushqimore, sigurinë, gjurmimin, mostrat, analizat laboratorike, zbatimin e detyrave të lëna, arkëtimin e gjobave**, **dokumentacionin shoqërues etj.**
2. Në 10 raste përgjigjet e analizave laboratorike për perime e fruta, *për praninë e pesticideve pranë ISUV*, kanë dalë me vonesë prej 3 muaj, çka ka humbur qëllimin e kryerjes të këtyre analizave, sepse perimet e frutat janë shitur plotësisht pasi nuk kanë qenë të bllokuara dhe nuk ka dale përgjegjësia. **3. Në 5 raste inspektimet nuk janë kryer për arsye se u gjenden të mbyllura, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti**, kërkesë kjo e procedurës së inspektimit.
4. Në 6 raste DR AKU **ka vepruar me 2 standarde,** lidhur me inspektimet me objekt të njëjtë ***"indice nga konsumatorët, rrjetet sociale dhe mediat etj"***, **për mos etiketim ne gjuhen shqipe të produkteve, pasi disa kanë sjellë prova me foto të qarta, ndërsa disa nuk kanë ilustruar faktet me foto**, e domosdoshme për sqarimin sa më mire të ankesave.
5. Në 1 rast (*subjekti Kavajë)* **nuk plotësonte kushtet për licencim, por ka ushtruar aktivitet pa licence 9 muaj më parë se kryerja e inspektimit** dhe nuk është vendosur masë administrative gjobë 1,000,000 lekë, nuk është ndaluar ushtrimi i aktivitetit deri në plotësimin e kushteve dhe pajisjen me licence, .

Më analitikisht *(42 dosje audituar 2020):*

1. Në 3 raste nga auditimi u konstatuan inspektime *(maj 2020)* **me shkelje, për mos zbatim të masave anti-covit, ku janë vendosur gjoba 50,000 lekë/secila, në subjektet "*furre buke*" ,** konkretisht:

- *Dosja e inspektimit datë 05.05.2020 "T*" Tirane, AKU-TR-2020-002717.
- *Dosja e inspektimit datë 06.05.2020 "R*" Tirane, AKU-TR-2020-002723.
- *Dosja e inspektimit datë 06.05.2020 "O*" Tirane, AKU-TR-2020-002720.

2. Nga auditimi u konstatuan **në 8 raste inspektime** *(maj 2020)* **për marrje mostra në perime** e fruta, **për analiza laboratorike, për praninë e pesticideve pranë ISUV,** ku rezultoi se: ***mostrat janë marrë në muajin Maj të vitit 2020 dhe përgjigjet kanë dale me vonesë prej 3 muaj ose në gusht 2020,*** ***çka ka humbur qëllimin e kryerjes të këtyre analizave*****, sepse perimet e frutat janë shitur plotësisht pasi nuk kanë qenë të bllokuara.**

Theksojmë se pesticidet janë brenda normave sipas analizave laboratorike të ISUV, më konkretisht inspektimet:

- *inspektimi datë 13.05.2020 "N*" NJ. 1, Tirane, AKU-TR-2020-002754.
- *inspektimi datë 12.05.2020 "F*" Tirane, AKU-TR-2020-002745.
- *inspektimi datë 12.05.2020 "A*" Tirane, AKU-TR-2020-002744.
- *inspektimi datë 11.05.2020 "A*" Tirane, AKU-TR-2020-002738.
- *inspektimi datë 11.05.2020 "F*" Njësia nr.2, Tirane, AKU-TR-2020-002738.
- *inspektimi datë 13.05.2020 "E*" Njesia nr. 1, Tirane, AKU-TR-2020-002756.
- *inspektimi datë 11.05.2020 "B*" Kashar, Tirane, AKU-TR-2020-002736.
- *inspektimi datë 19.05.2020 "S*" Tirane, AKU-TR-2020-002818.

3. *Dosja e inspektimit* datë 14.05.2020, ***S Albania*** TEG (Farkë) Tiranë me aktivitet *import-eksport, magazinim, shitje produkte ushqimore*, rezulton se: Inspektorët **M.C, J.K dhe M.H** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 14.05.2020 me objekt: "***inspektim ku nga kontrolli analizat laboratorike rezultojnë negative ose pozitive***" kanë konstatuar **praninë mbi normat e lejuara të pesticideve në spinaq**, sipas raport analizave date 13.05.2020 te ISUV, marrë mostra më 22.04.2020. Inspektorët nuk kanë vendosur masa administrative dhe nuk **kanë bllokuar dhe asgjësuar spinaqin, pasi spinaqi është shitur plotësisht konsumatorëve,** kjo për arsye se kanë kaluar 24 dite nga data e furnizimit dhe përgjigjes marrjes mostrës.

- *Gjurmimi:* Inspektorët kanë gjurmuar produktin tek furnitori, sipas procesverbaleve inspektimit dhe vendimeve përfundimtare date 15.05.2020 , ku ***blerësi*** "***S Albania"*** *shpk* produktet ushqimore ndër këto dhe 65 kg spinaq i ka marrë nga ***shitësi "F CO"*** shpk (*sipas 4 faturave nr. 88806668, nr. 88806656, nr. 88806655 dhe nr. 88806666, date 21- 22.04.2020),* i cili e ka blere tek ***shitësi T person fizik*** (*sipas faturës nr. 13485761, date 21.04.2020),* ndërsa ky i fundit e ka blere 90 kg spinaq nga ***fermeri*** XH **Ndroq.**

Inspektorët **nuk kanë gjetur gjendje spinaq ne 3 subjektet tregtuese**, por **nuk e kanë argumentuar me foto dhe me dokumente hyrje dhe dalje,** për periudhën pas marrjes mostrave 21.04.2020 deri në momentin e inspektimit 15.05.2020, për efekt të saktësimit te furnizimit me ketë subjekt kontraktor me probleme në pesticide.

Theksojmë se ne dosje disponohen 2 fatura (Taulant Dedës dhe "Spar Albania").

Konkluzion: **Inspektimi nuk është efiçent, pasi ka humbur qëllimin e kryerjes të tij,** sepse:

- nuk ka bllokuar spinaqin me mbi normativë pesticidesh që me marrjen e mostrave deri në daljen e përgjigjeve analizave,

- mungesa e spinaqit me pesticide gjendje në 3 subjektet tregtuese nuk është justifikuar me dokumente e foto.

- nuk ka masa administrative dhe asgjesime,

Për pasojë faji dhe përgjegjësia kanë mbetur pa autor.

Po kështu,
Me të njëjtat probleme paraqitet:
3/1. subjekti shites Z Njësia nr. 8 Tiranë ***AKU-TR-2020-002749*** (***inspektorët E.A dhe Y.A***) dhe nga gjurmimi ***subjekti furnizues G Kashar,*** AKU-TR-2020-002760, i cili është furnizuar nga Greqia me **1013 kg spec me mbi normativë pesticidesh, (*inspektorët A.B dhe L.B).***
3/2. subjekti shitës K lagjja ***Qesarake Dajt*** Tiranë AKU-TR-2020-002834 (***inspektorët M.C, J.K dhe M.H***) dhe nga gjurmimi rezulton se ky subjekt e ka blere tek ***furnizues*** I fshati Shesh Tirane, **spinaq me mbi normativë pesticidesh, ku në vend nuk u gjet gjendje spinaq, pasi është shitur konsumatorëve.**

4. Në 15 raste u konstatua se inspektorët kanë cituar se **inspektimi nuk u krye për arsye se subjekti u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti,** kërkesë kjo e procedurës së inspektimit. Gjithashtu **në 1 rast** thuhet inspektimi nuk u krye për arsye se **për 1 vit është mbyllur aktiviteti, por subjekti (OBU) në QKR rezulton aktiv,**, konkretisht:
4/1. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2020, ***B***, adresa *rruga Barrikadave* Tiranë, rezulton se: **Inspektorët E.A dhe Y.A** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se për 1 vit është mbyllur aktiviteti, por në QKR rezulton aktiv.
4/2. *Dosja e inspektimit* datë 26.05.2020, ***L***, adresa *Kamzë Tiranë*, rezulton se: **Inspektorët E.M dhe E.V** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 26.05.2020 kanë cituar se: inspektimi nuk u krye për arsye se është mbyllur aktiviteti, por në QKR rezulton aktiv, *madje për çudi thuhet se sipas bisedës telefonike subjekti ndodhej ne zyrat e QKB për të mbyllur aktivitetin, pra justifikohet pa argument dhe dokumente.* Njëkohësisht nuk disponohen foto për mbylljen e aktivitetit.
4/3. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2020, AKU-TR-2020-002327, *S*, adresa Kashar *tregu agro ushqimor*, rezulton se: **Inspektorët L.B dhe A.B** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto.
4/4. *Dosja e inspektimit* datë 29.05.2020, AKU-TR-2020-002463, *I*, adresa Njësia nr. 9 Tiran *tregu agro ushqimor*, rezulton se: **Inspektorët L.B dhe A.B** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto për justifikimin e këtij fakti.
4/5. *Dosja e inspektimit* datë 22.05.2020, AKU-TR-2020-002262, *S*, adresa Kamez Tiranë, rezulton se: **Inspektorët G dhe S.L** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 22.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti.
4/6. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2020, AKU-TR-2020-002416, *P*, adresa Njesia nr.6 Tiranë, rezulton se: **Inspektorët G.H dhe S.L** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto të ambientit të mbyllur.
4/7. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2020, AKU-TR-2020-002483, L, adresa Tiranë, rezulton se: **Inspektorët K.S dhe M.A** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto të ambientit të mbyllur.
4/8. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2020, AKU-TR-2020-002480, F, adresa Kamzë, rezulton se: **Inspektorët E.M, D.K dhe E.V** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se fabrika u gjend i mbyllur, por nuk disponohen foto.
4/9. *Dosja e inspektimit* datë 02.12.2020, AKU-TR-2020-007223, S, adresa Vaqarr, rezulton se: **Inspektorët A.N dhe A.K,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë

02.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se subjekti u gjend i mbyllur dhe ne subjekt u afishua autorizimi.

4/10. ***Dosja e inspektimit*** datë 07.12.2020, AKU-TR-2020-007218, D, adresa Peze, rezulton se: **Inspektorët A.B dhe L.B,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 07.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se subjekti u gjend i mbyllur dhe ne subjekt u afishua autorizimi, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti. Me të njëjtat problem paraqitet dhe inspektimi date 9.12.2020 subjekti *H.*

4/11. ***Dosja e inspektimit*** datë 09.12.2020, AKU-TR-2020-007222, A, adresa Vaqarr, rezulton se: **Inspektorët M.B dhe H.K,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 09.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se subjekti ndodhej jashtë Tiranës dhe ne subjekt u afishua autorizimi, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti.

4/12. ***Dosja e inspektimit*** datë 10.12.2020, AKU-TR-2020-007497, K, *adresa tregu i uzinës Dinamo*, me objekt: ***inspektim nga indiciet ankimimet***, rezulton se: **Inspektorët D.K dhe E.C,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 10.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se subjekti nuk ndodhet në objekt, ndërsa subjekti ka firmosur procesverbalin e inspektimit. Gjithashtu thuhet ne subjekt u afishua autorizimi, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti.

4/13. ***Dosja e inspektimit*** datë 11.12.2020, AKU-TR-2020-007243, V, *adresa Izberish Kashar*, me objekt: ***zbatimi i legjislacionit ne fuqi***, rezulton se: **Inspektorët E.Sh dhe E.C,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 11.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se OBU u gjet i mbyllur dhe thuhet se në subjekt u afishua autorizimi, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti.

4/14. ***Dosja e inspektimit*** datë 14.12.2020, AKU-TR-2020-007298, H *adresa Paskuqan*, me objekt: ***zbatimi i legjislacionit ne fuqi***, rezulton se: **Inspektorët M.H dhe J.K,** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 14.12.2020 kanë cituar se inspektimi nuk u krye për arsye se OBU u gjet i mbyllur dhe thuhet se në subjekt u afishua autorizimi, por nuk disponohen foto për ilustrimin e këtij fakti.

4/15. ***Dosja e inspektimit*** **datë 27.05.2020**, **AKU-TR-2020-002201**, ***F***, adresa lanabregas Tiranë, me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi",*** rezulton se: Inspektorët **S.L dhe G.H** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 27.05.2020 **nuk kanë kryer inspektimin**, **pasi OBU u gjend i mbyllur, por nuk kanë bërë fotografimin e ambientit mbyllur si prove për atë që thuhet.**

5. DR AKU ka vepruar me 2 standarde lidhur me inspektimet në periudhë dhe me objekt të njëjtë ***"me indice te veçanta nga konsumatorët, rrjetet sociale dhe mediat etj"***, bazuar në imeil date 26.05.2020 të Drejtorit Përgjithshëm AKU ***"për mos etiketim ne gjuhen shqipe produkteve nga subjektet e poshtëshënuara"***, pasi disa kanë sjellë prova me foto të qarta, ndërsa disa nuk kanë ilustruar faktet me foto, që ishte e domosdoshme për sqarimin sa më mire të ankesave, konkretisht:

Dosje rregullta.

5/1- Dosja e inspektimit datë 26.05.2020, **AKU-TR-2020-003312**, ***Market ushqimor***, A, adresa Kamzë, ***indice për mos etiketim,*** rezulton se: Inspektorët M.H dhe J.K kanë kryer inspektimin sipas procedurave duke e kompletuar dosjen edhe me dokumente prove si foto te qarta të ambienteve dhe produkteve subjektit madje dhe s,kadenca e lexueshme, ku nuk janë konstatuar shkelje, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 26.05.2020.

5/2- Po kështu është vepruar tek ***AKU-TR-2020-003313,*** ku nuk janë konstatuar shkelje dhe dosja disponon dokumente prove me fakte të ilustruara me foto.

Dosje pa rregullta.

5/3- Dosja e inspektimit datë 26.05.2020, **AKU-TR-2020-003304**, ***Market ushqimor***, ***indice për mos etiketim ne gjuhen shqipe,*** rezulton se: Inspektorët ***D.K dhe E.C*** kanë kryer inspektimin

sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 26.05.2020, ku nuk kanë konstatuar shkeljen e ankimuar, por **nuk disponojnë dokumente shoqëruese me fakte të ilustruara me foto,** siç është vepruar me subjektet AKU-TR-2020-003312 dhe AKU-TR-2020-003313.

5/4- Po kështu është vepruar tek ***AKU-TR-2020-003301,*** *tek* ***AKU-TR-2020-003299*** ku nuk janë konstatuar shkelje dhe dosja nuk disponon dokumente prove me fakte të ilustruara me foto. subjektet AKU-TR-2020-003312 dhe AKU-TR-2020-003313.

5/5- Gjithashtu kështu është vepruar tek ***AKU-TR-2020-003317*** ku nuk janë konstatuar shkelje pasi ka kundër etiketa në gjuhën shqipe për artikullin Redbull, por **dosja nuk disponon dokumente prove me fakte të ilustruara me foto.**

5/6- Kështu është vepruar tek ***AKU-TR-2020-007500*** ku nuk është kryer inspektimi për mos etiketim të produkteve, pasi subjekti u gjend i mbyllur, e cila nuk vërtetohet me **dokumente prove ose foto** *(Z.C dhe K.J*).

5/7- Dosja e inspektimit datë 17.12.2020, **AKU-TR-2020-007562**, P rruga Siri Kodra "tregtim produkte ushqimore", rezulton se: Inspektorët ***M.H, J.K dhe M.C*** kanë kryer inspektimin sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 17.12.2020, ku nuk kanë konstatuar ***mos etiketim ne gjuhen shqipe të artikujve pije jo alkolike***, por **nuk e kanë justifikuar me foto, ndërsa subjekti e ka shoqëruar me foto ankesën për ketë subjekt.**

6. ***Dosja e inspektimit*** datë 26.05.2020, **AKU-TR-2020-003305**, R, adresa Paskuqan, me object ***"me indicie te veçanta nga konsumatorët, rrjetet sociale dhe mediat etj"*** **,** rezulton se: Inspektorët **E.M dhe E.V** kanë kryer inspektimin sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 26.05.2020, por **nuk kanë trajtuar shkeljen e ankimuar *indice për mos etiketim ne gjuhen shqipe* dhe ndërsa nuk bëhet fjalë për foto,** por **ndryshe kanë vepruar në inspektimin** datë 22.05.2019 *market "G" M, Laknas, AKU-TR-2019-002927-1* dhe në inspektimin datë 11.12.2020, *AKU-TR-2020-007501, B,* ku kane trajtuar shkeljen, kanë bërë foto të qarta e të lexueshme për çdo **ushqim s,kaduar *(pasigurt)*** si dhe kane bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues**,** pra **kemi aplikim me 2 standarde.**

6/1. Në inspektimin datë 11.12.2020, AKU-TR-2020-007501, ***B,*** adresa Farke, me objekt *"me indice te veçanta nga konsumatorët, rrjetet, autoritet publik etj"* inspektorët E.M dhe E.V kanë kryer inspektimin, kanë trajtuar shkeljen e ankimuar, kane bllokuar produktin me stampen e DR AKU ***50 kg fara zeza susan me oksid etileni mbi norme me rrisk te larte ne shendetin e njeriut,*** *ardhur nga India nëpërmjet pikës kufitare greke,* kane bërë foto të qarta e të lexueshme si dhe kane bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues**,** madje dhe deklaratën doganore, aktkontrollin e PIK, faturat, dokumentin e origjinës Greqi, etj.

6/2. Në inspektimin datë 14.12.2020, AKU-TR-2020-007509, ***A***, adresa Njësia 2 rruga Elbasanit, me objekt *"me indicie te veçanta nga konsumatorët, rrjetet, autoritet publik etj"* inspektorët E.M dhe E.V kanë bllokuar produktin ***4,8 kg fara zeza susan me oksid etileni mbi norme me rrisk te larte ne shendetin e njeriut,*** *ardhur nga India nëpërmjet pikës kufitare greke,* kane bërë foto dhe kane bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues**, si dhe lënë detyre pa afat subjektit për asgjësim ose kthimin ne origjine, por nuk disponohen dokumente për asgjësimin e tyre.**

6/3. Në inspektimin datë 11.12.2020, AKU-TR-2020-007505, **A**, adresa Kashar, me objekt *"me indice te veçanta nga konsumatorët, rrjetet, autoritet publik etj"* inspektorë **M.B dhe H.K** kanë kryer inspektim te plote, ku **kanë trajtuar shkeljen e ankimuar, kane bllokuar produktin *50 kg fara zeza susan me oksid etileni mbi norme me rrisk te larte ne shendetin e njeriut, ardhur nga India nëpërmjet pikës kufitare greke***, si dhe kane **bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues,** madje dhe deklaratën doganore, aktkontrollin e PIK, faturat, dokumentin e origjinës Greqi, etj, **kanë lënë detyrë për asgjësimin e produktit, me risk te larte ne shëndetin e njeriut,** me një firme fituese duke lajmëruar AKU për asgjësimin, **gjë që nuk është kryer pasi ska dokument asgjësimi.**

6/4. Në inspektimin datë 11.12.2020**,** AKU-TR-2020-007504, **F**, adresa njësia 6 , me objekt *"me indice te veçanta nga konsumatorët, rrjetet, autoritet publik etj"* inspektorët **A.N dhe Ardit Kanaci** kanë gjetur gjendje ne subjekt **4,1 ton *fara zeza susam* *me oksid etileni mbi norme me rrisk te larte ne shendetin e njeriut,*** *ardhur nga India nëpërmjet pikës kufitare greke***.** Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimin përfundimtarë 11.12.2020 thuhet se bllokohet në subjekt sasia 4,1 ton duke i bere foto dhe lihet subjektit detyre 2 javore për asgjësim**.**

7. *Dosja e inspektimit* datë 22.12.2020, AKU-TR-2020-007574***, S ALBANIA, TEG*** , me aktivitet **"***tregti me shumice e pakice***"**, me objekt: ***Indicie nga ankimimi me eimeil për produkte ushqimore pasigurta*** *(çokollata M&M 90 gr skaduara)* ***e shoqëruar me foto dhe kupon tatimor date 16.12.2020),*** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 22.12.2020 të inspektorëve **N.H dhe A.H,** rezulton se:
a. inspektimi është mbyllur pa rezultat, pasi pretendohet se nuk ka gjendje asnjë *çokollatë M&M 90 gr*, objekt indicie.
b. dokumentacioni i dosjes paraqet kontradikta, lidhur me inventarin e çokollatave, pasi nuk dokumentohen hyrje-daljet për periudhën nga data 17 deri 22.12.2020, konkretisht:
-thuhet janë gjendje deri sot me date 22.12.2020 gjithsej 45 cope çokollata të njëjta me atë të ankimuarën (*M&M PEANUT 90GR dhe M&M CHOCO 90GR)* dhe janë brenda afat skadencës *(shkurt-korrik 2021),* sipas procesverbalit inspektimit datë 22.12.2020.
- thuhet se janë gjendje deri me datë 17.12.2020 gjithsej 45 cope çokollata të njëjta me atë të ankimuarën (*M&M PEANUT 90GR dhe M&M CHOCO 90GR),* sipas dokumentacionit shoqërues të subjektit, përmbledhëses hyrje-daljeve nga data 29.10.2020 deri 17.12.2020.
c. Nuk disponohen dokumente prove ose foto për 45 çokollatat gjendje, të cilat janë të domosdoshme në raste ankimimesh, për sqarimin sa më mire të ankimuesve, ku të vërtetohej numri dhe lloji si dhe afat skadenca e tyre, çka ka bërë të mos realizohet qëllimi i inspektimit për verifikimin e afat skadencave të çokollatave,
8. *Dosja e inspektimit* datë 22.12.2020, **AKU-TR-2020-007578, *Byrektore M,*** adresa Komuna Parisit, me objekt: "***Indicie nga ankimimi",*** rezulton se: Inspektorët **A.K, E.A dhe A.N** kanë kryer inspektimin sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 22.12.2020, ku **nuk kanë konstatuar shkelje*, lidhur me ankimimin për tregtimin e produkteve ushqimore në kushte jo të mira higjeno-sanitare.*** Inspektorët janë mjaftuar me lyerjen e tavanit dhe nuk kanë argumentuar konstatimet e tyre me dokumentacion shoqërues dhe fotografim të produkteve dhe ambientit, për efekt të sqarimit korrekt të ankimuesit.

9. *Dosja e inspektimit* datë 29.05.2020, **AKU-TR-2020-002192**, S, adresa bulevardi *ZHAN DARK* Tiranë, me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi",*** rezulton se: Inspektorët A.Sh dhe K.J sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020 **nuk kanë kryer inspektimin**, **pasi OBU nuk u gjend dhe telefonimi i bllokuar, për rrjedhojë inspektimi ka dështuar**.

10. *Dosja e inspektimit* datë 28.05.2020 të OBU "*Magazina importi D*", ***ushqim për kafshë***, me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi",*** sipas procesverbal inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020, Inspektorët **E.M dhe E.V** *(drejtor A.N)* nuk kanë konstatuar shkelje në etiketim, ambalazhim, por ***janë mjaftuar me disa mangësi në lyerjen e mureve, fenomen ky në shumicën rasteve, sikur janë mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit***, **në vend që të trajtojnë produktet, gjurmimin, mostrat dhe analizat e misrit për kafshë, sigurinë ushqimore, zbatimin e detyrave të lëna dhe arkëtimin e gjobës 100,000 lekë të vitit 2018**, **dokumentacioni shoqërues etj.**

11. ***Dosja e inspektimit*** datë 29.05.2020, AKU-TR-2020-00332, OBU *L "furre buke"* bulevardi "Josiv Budo: Kavajë, me objekt: "*verifikimi i kushteve për licencimin*", sipas procesverbal inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020, inspektorët S.L dhe G.H *(A.N)* kanë konstatuar se subjekti nuk plotëson kushtet për licencim.
Sa sipër, konstatohet se ky subjekt ka hapur aktivitetin e tij në ketë vendndodhje me datë 27.01.2020, pra subjekti **ka ushtruar aktivitet pa licence 4 muaj** me parë se kryerja e inspektimit. Në këto kushte **inspektorët** kanë **patur detyrimin ligjor** për marrjen e masës administrative gjobë 1,000,000 lekë, **ndalimin e ushtrimit aktivitetit** duke vendosur një datë të caktuar për korrigjimin e shkeljeve, për plotësimin e kushteve dhe pajisjen me licence me kodin 2,1,A,1. **Theksojmë** se ky subjekt është pajisur me licence me datë **07.10.2020** pra edhe **5 muaj** te tjerë **pa licence, gjithsej 9 muaj.**

12. ***Dosja e inspektimit*** **datë 29.05.2020** të OBU Tirana C" rruga Vaqarr, me kërkesë te subjektit me objekt: "***asgjësim produktesh ushqimore skaduar*** *për vlerën 2,3 milion leke***",** sipas procesverbal inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020, Inspektorët **E.M dhe E.V** *(drejtor A.N)* nuk kanë asgjësuar produktesh ushqimore skaduar, nën pretekstin se mungojnë përfaqësuesit e mjedisit, duke e lënë ne një moment të dytë, rezulton se:
-nuk disponohet ne dosje lista e produkteve skaduar që do të asgjësohen,
-paraqiten vonesa ne evidentimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të produkteve skaduar, pasi komisioni është ngritur me date 10.02.2020 dhe njoftimi i AKU, Mjedisit dhe Degës Tatimeve është bërë me date 25.05.2020 pra pas 4 muajsh, ku përsëri produktet nuk janë asgjësuar, çka ka bërë që ata të jenë jashtë mbikëqyrjes së DR AKU Tiranë.
- mungon fotografimi i produkteve s,kaduara, **siç është vepruar tek AKU-TR-2020-003312** dhe AKU-TR-2020-003313, ku disponohen dokumente prove me fakte të ilustruara me foto të qarta të produkteve subjektit madje dhe skadenca është e lexueshme, pra **kemi 2 standarde.**

13. ***Dosja e inspektimit*** **datë 29.05.2020** të OBU R, ***piceri*** me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi***", rezulton se: Inspektorët **K.S, R.B dhe M.A** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020 **nuk kanë marrë masa administrative me gjobe, pasi kanë konstatuar mungese sistemimi dhe pastrim frigoriferi, mungesë dosje dokumentacioni** *(pjesërisht)* **për AKU, mungese rinovimi për një pjesë të raport analizave me afat të shkurtër s,kadence, pra pa cituar emrat e produkteve, raport analizat, datat e s,kadencave afatshkurtra si dhe pa përcaktuar afatin kohor për korrigjimin e parregullsive.** Përfundimisht inspektimi nuk ka qenë korrekt dhe është mjaftuar vetëm me një paralajmërim ndaj subjektit, ku subjekti ka nënshkruar vendimin përfundimtar.

14. ***Dosja e inspektimit*** **datë 29.05.2020**, AKU-TR-2020-002377, të OBU K, adresa Fushe Mezes "***pike shitje dhe shërbim ushqimi, piceri***" me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi***", rezulton se:
- inspektorët sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.05.2020 nuk kanë aplikuar masa administrative me gjobë, por janë mjaftuar me paralajmërim, pasi nuk kanë konstatuar shkelje, përjashtuar disa raport analiza për rinovim.
- nuk përmenden cilat janë këto raport analiza dhe emrat e produkteve, pasi thuhet rinovimi për një pjesë të raport analizave,
- nuk përcaktohet afati kohor për korrigjimin e parregullsive tek lënia e detyrave, madje ndryshe nga procesverbali i inspektimit shtohet rinovimi i disa raport analizave për produktet ndihmese, sipas vendimit përfundimtar,
- dosja e inspektimit paraqet mangësi në dokumentacion, pasi mungon gjurmimi, mostrat, analizat për sigurinë ushqimore, zbatimi i detyrave të lëna, foto të ambienteve dhe produkteve si prove për atë që thuhet.

- janë anashkaluar pa trajtuar disa çështje përfshirë dhe masat anti covid -19 etj, pasi fusha e inspektimit ka qenë e gjerë, me objekt"*zbatim i legjislacionit në fuqi".*

15. ***Dosja e inspektimit*** **datë 30.05.2020**, AKU-TR-2020-002210, të OBU L, adresa rruga ***Budi*** Tirane "***njesi prodhimi e tregtimi buke dhe ëmbëlsira"*** me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi",*** rezulton se: inspektorët ***M.H, J.K dhe M.C,*** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.05.2020 nuk kanë aplikuar masa administrative me gjobë, por janë mjaftuar me paralajmërim**,** pasi nuk kanë konstatuar shkelje, përjashtuar te sistemohet me mire ambienti i përpunimit. Subjekti prodhon dhe tregton përveç bukës dhe **ëmbëlsira për të cilat inspektorët duhej të merrnin mostra për analiza, pasi koha e qëndrimit tyre pas prodhimit në periudhë pandemie nuk dihet as nuk dokumentohet, për efekt të sigurisë ushqimore.**
Ndryshe kanë vepruar tek subjekti M, Farke**,** ***AKU-TR-2020-007194,*** me të njëjtin aktivitet**,** ku këta inspektorë kanë marrë mostra, madje kane siguruar përgjigjet e analizave laboratorike dhe pastaj kanë mbyllur inspektimin date 07.12.2020.

16. ***Dosja e inspektimit*** **datë 09.12.2020**, AKU-TR-2020-007221, të OBU ***L***, adresa Njësia nr.6 Tirane " ***prodhime pastiqerie"*** me objekt: "***zbatim i legjislacionit në fuqi",*** rezulton: **a.** inspektorët ***M.A dhe D.K,*** sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 09.12.2020 nuk kanë aplikuar masa administrative me gjobë, por janë mjaftuar me paralajmërim**,** pasi nuk kanë konstatuar shkelje, përjashtuar sistemimit më mire të ambientit përpunimit.
b. subjekti prodhon dhe tregton pastiqerie *ëmbëlsira* për të cilat inspektorët duhej të merrnin mostra për analiza, pasi koha e qëndrimit tyre në periudhë pandemie nuk dihet as nuk dokumentohet, për efekt të sigurisë ushqimore.
c. gjithashtu nuk është plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit date 09.12.2020, ku thuhet: *ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit.*
d. inspektimi nuk ka përmbushur objektin e tij "*Zbatim i legjislacionit ne fuqi",*i cili ka fushë të gjerë verifikimi e kontrolli, pasi inspektimi është sipërfaqësor dhe pa dokumente shoqëruese për lendet e para, pavarësisht se thuhet *disponohen dhe janë brenda afatit të përdorimit.* Mungon pasqyrimi dhe dokumentet për kontrollin e gjurshmerise, sistemit vet kontrollit, fotot, filmime, paketimi, zbatimi i detyrave të lëna, etj.

17. ***Dosja e inspektimit*** **datë 01.12.2020**, ***I***, **magazine ushqimore**, Njësia 11, Tirane, sipas autorizimit date 01.12.2020 me objekt: ***Zbatim i legjislacionit ne fuqi***, nënshkruar nga drejtori i DR AKU z. **M.N**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 01.12.2020, inspektorët **B.O, Gj.P dhe E.M,** rezulton se: **inspektimi është sipërfaqësor dhe pa asnjë rezultat,** nuk është konstatuar asnjë shkelje dhe nuk ka masa administrative**,** pasi:
a. dosja e inspektimit paraqet mangësi, pasi mungojnë dokumentet shoqëruese te kontrollit zyrtar si kontrolli i etiketës, s,kadences, gjurshmerise, sistemit vet kontrollit, fotot, filmime, paketimi etj.
b. nuk është plotësuar pika 9 e procesverbalit inspektimit date 01.12.2020, ku thuhet: *ne rast se nuk konstatohen shkelje te jepen arsyet e përfundimit te procedimit*,
c. nuk pasqyrohet se çfarë u kontrollua dhe u gjet në rregull.
d. nuk është përmbushur objekti i inspektimit "*Zbatim i legjislacionit ne fuqi",* pasi inspektimi ka pasur fushë të gjerë verifikimi e kontrolli, ka qenë i planifikuar dhe jo tematik.
Po kështu, ***me problem të njëjta pa asnjë rezultat dhe me mungesë të dokumentacionit shoqëruese, paraqiten edhe inspektimet***, sa vijon:
17/1. **inspektimi datë 18.12.2020**, subjekti "B***"***, Tirane, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 18.12.2020, inspektorët **S.L dhe G.H.**
17/2. **inspektimi datë 17.12.2020**, subjekti "J***"***, Vacarr, Tirane, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 18.12.2020, inspektorët **E.Sh dhe Elion Cuci**.

17/3. **inspektimi datë 21.12.2020**, subjekti "M",Helmes Kavaje, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 18.12.2020, inspektorët **D.K dhe E.C**.

18. ***Dosja e inspektimit*** **datë 11.01.2020**. AKU-TR-2020-000435, subjekti OBU **S ALBANIA** TEG Tiranë me aktivitet **"*Supermarket*** *e magazina ushqimore*", rezulton se:
Asgjësimi i **5 copë "Molto" me 80 gr/secila me date skadence 30.11.2019** (të fotografuara) është kryer në subjekt, duke i thyer dhe hedhur ne ambientet e depozitimit të mbeturinave, nga trupa e inspektimit M.H, J.K dhe M.C, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 11.01.2020. Shkeljet e konstatuara nga auditimi: mungon procesverbali i rregullt i asgjësimit, mungon fletëdalja e subjektit, për efekt të shkarkimit nga kontabiliteti të produkteve të asgjësuara, mungon nënshkrimi i subjektit.

Nxjerrjet jashtë përdorimit, asgjësimet e produkteve ushqimore të sektorit OJSH, janë pasqyruar në formë tabelare në tabelën **nr.30, në Kap. "Anekset"**.
- Për vitin **2018** janë kryer **asgjësime** të produkteve ushqimore **1684 ton** për 654 milion lekë.
- Për vitin **2019** janë kryer **asgjësime** të produkteve ushqimore **1518 ton** për 214 milion lekë, në 94 subjekte.
- Për vitin **2020** janë kryer **asgjësime** të produkteve ushqimore **2012 ton** për 329 milion lekë, në 85 subjekte.

Shkelje në mënyrë të përmbledhur:
Nga auditimi i **43 praktikave dokumentare të procedurave të asgjësimit të produkteve OJSH për vitin 2019 dhe 2020,** u konstatuan këto shkelje në mënyrë të përmbledhur, sa vijon:
1. në shumicën e rasteve **mungon procesverbali i rregullt i asgjësimit** me komision të veçantë, **me nënshkrimin e përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor, tatimeve dhe DR AKU** Tiranë, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit, i cili është i pjesshëm, pasi është firmosur vetëm nga inspektoret e DR AKU.
2. në shumicën e rasteve **mungon fletëdalja e subjekteve**, për efekt të shkarkimit nga magazina të produkteve të asgjësuara, dokument vërtetues dhe bazë që fakton daljen nga magazina të tyre.
3. në disa raste **mungon dokumenti i shoqërimit *(fletëngarkesa*) për transportin** e produkteve për në vendin ku do të kryhet asgjësimi i tyre,
4. në disa raste **mungon fotot e artikujve skaduar, ambientit subjektit dhe vendit** të asgjësimit tyre**.**
5. janë aplikuar 2 standarde në zbatimin e procedurave të asgjësimit të produkteve, pasi në disa raste disponohet dokumentacioni shoqërues i produkteve te asgjësuara, ndërsa në disa raste nuk disponohet.
6. në të gjitha rastet **mungon nënshkrimi i drejtorit DR AKU Tiranë në vendimin përfundimtar për asgjësimin e produkteve të s,kaduara,** por është mjaftuar vetëm me nënshkrimin e inspektorëve dhe subjektit, çka e bën të paligjshme vendimmarrjen, pasi **nuk ka vendimmarrje pa firmën dhe vulën e titullarit institucionit.**
7. mungon inventari i inspektoreve DRAKU për produktet e s,kaduara, për efekt të krahasimit dhe verifikimit tyre me inventarin e subjektit, ndërsa thuhet u bë verifikimi i tyre sipas kërkesës subjektit dhe nuk pasqyrohet në dokumente *(inventarë).*
8. peshën më të madhe në asgjësimet e kryera e zënë OBU ***"C SHQIPERIA"***, ku nuk pasqyrohen fazat e procedurës asgjësimit dhe nuk shoqërohen me dokumente justifikuese, pra paraqiten sipërfaqësore nga forma dhe përmbajtja.
9. DRAKU në disa raste nuk ka menaxhuar pasigurinë ushqimore, pasi nuk asgjësohen në moment produktet e s,kaduara, por qëndrojnë nga 5-6 muaj deri 2-3 vite në subjekt, në vend që të grumbulloheshin në një ambient tjetër magazinimi nën menaxhimin e AKU për asgjësimin e menjëhershëm të tyre**.**

10. Nuk është përcaktuar saktë afati gjysmë dite në disa autorizime asgjësimi, pasi është e pamjaftueshme koha për inspektorët, për evidentimin, inventarizimin, asgjësimin, transportin, depozitimin, fotografimin dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës, për sasi të mëdha produkteve të s,kaduara si: OBU *"C, "F", "A" G" ejt,* ndërsa nga inspektorët nuk është kërkuar kohë shtese, çka ka ndikuar në cilësinë, sigurinë dhe mangësinë e inspektimit**.**

<u>Më konkretisht:</u>
<u>Viti 2018</u> ***(1 dosje asgjësimi e audituar)****.*
1. *<u>Dosja e inspektimit</u>* datë 12.07.2018. AKU-TR 2018-002269-1, subjekti OBU ***A*** Rruga Don Bosto Tiranë me aktivitet "Pastiqeri", rezulton se **Inspektorët A.N dhe S.L** kanë konstatuar shkelje: mbi normën enterobakterike në 7 torta nga analizat e mostrave të marra, ku kanë vendosur gjobë 300,000 lekë, paralajmërim, bllokim i sasisë 7 torta dhe asgjësimin në vend të tyre me detergjent, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.07.2018, **por mungon procedura e asgjësimit, procesverbali i rregullt i asgjësimit (***me komision të veçantë)* **mungon nënshkrimi i subjektit, mungon fotografimi dhe filmimi si element prove për të justifikuar asgjësimin tyre,**

Theksojmë se subjekti *A* është inspektuar më pare 02.07.2018 dhe ka marrë paralajmërim. Gjithashtu gjoba është likuiduar pjesërisht për 50,000 leke me date 30.09.2019 dhe ka një marrëveshje me subjektin për likuidim me këste.
Sa sipër, **Ndryshe është vepruar në asgjësimin e pijeve alkolike pranë subjektit DSHQ** ("*Drejtoria e shërbimeve qeveritare"),* **ku disponohet procesverbali i asgjësimit me nënshkrimin e komisionit (**2 veta) **dhe subjektit.** Megjithëse edhe kjo procedurë asgjësimi paraqet mangësi, pasi mungon flet dalja e subjektit, mungon komisioni prej 5 vetash, mungon fotografimi dhe filmimi si element prove për të justifikuar asgjësimin tyre,
Inspektorët A.B dhe E.D dhe drejtori M.M, sipas autorizimit dhe procesverbalit e vendim asgjësimit datë 26.07.2018

<u>Viti 2019</u> ***(11 dosje asgjësimi të audituara)****.*
1. U konstatuan **33 inspektime** për vitin **2019** tek subjekti ***"C SHQIPERIA",*** për **asgjësimin e pijeve skaduara** në sasinë **733,966 litra** me vlerë **54,103,107 lekë,** më hollësisht:
1/1. ***Maj 2019,*** janë kryer ***14 inspektime*** nga inspektorë K.S, A.Sh dhe A.T, për ***asgjësimin e 208,164 litra*** me vlerë ***18,945,441 lekë pije skaduar,*** në bazë të kërkesës datë 24.04.2019 të subjektit ***"C",*** sipas autorizimit drejtorit z. S.S, ku rezultoi: Inspektimet nuk janë të plota**,** pasi fazat e zhvillimit procedurës asgjësimit nuk shoqërohen me dokumente justifikuese. Mungojnë procesverbalet e asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalet e inspektimit, të cilat nuk janë firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. Mungon fletëdalja e subjektit, për efekt të shkarkimit nga magazina të produkteve të asgjësuara. Mungojnë fotot e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet.

1/2. ***Korrik 2019,*** janë kryer ***2 inspektime*** nga inspektorë K.S, K.J dhe D.K, për ***asgjësimin*** e 46,034 arka ose ***119,295 litra*** me vlerë ***1,693,279 leke pije skaduar,*** në bazë të kërkesës datë 05.07.2019 të subjektit *"C",* sipas autorizimit drejtorit z. S.S, ku rezultoi: Inspektimet nuk janë të plota**,** pasi fazat e zhvillimit procedurës asgjësimit nuk shoqërohen me dokumente justifikuese, përjashtuar fotografimet të cilat janë të plota, të qarta në gjitha fazat e asgjësimit. Kështu mungojnë procesverbalet e asgjësimit, duke u mjaftuar me procesverbalet e inspektimit, të cilat nuk janë firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. Mungon fletëdalja e subjektit, për efekt të shkarkimit nga magazina të produkteve të asgjësuara.
1/3. ***Shtator 2019,*** janë kryer ***10 inspektime*** nga inspektorë K.S, M.A, K.J, P.D, I.O, për ***asgjësimin e 238,698 litra*** me vlerë ***21,363,855 lekë pije skaduar,*** në bazë të kërkesës datë

30.08.2019 të subjektit *"C"***,** sipas autorizimit drejtorit z. S.S, ku rezultoi: Inspektimet nuk janë të plota**,** pasi fazat e zhvillimit procedurës asgjësimit nuk shoqërohen me dokumente justifikuese, përjashtuar fotografimet të cilat janë të qarta. Mungojnë procesverbalet e asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalet e inspektimit, të cilat nuk janë firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. Mungon fletëdalja e subjektit, për efekt të shkarkimit nga magazina të produkteve të asgjësuara. Gjithashtu **u konstatua se 11880 litra coca-cola zero** cherry 33x24 *(36,000 cope)* **u ka mbaruar s,kadenca më datë 04.01.2019, në një kohë që janë kryer asgjësime në majin Maj dhe korrik 2019 dhe nga grupi inspektimit nuk janë verifikuar dhe asgjësuar** në kohën e duhur.

1/4. ***Dhjetor 2019,*** janë kryer ***7 inspektime*** nga inspektorë F.R dhe M.D, për ***asgjësimin e 167,154 litra*** me vlerë ***12,100,532 lekë pije skaduar,*** në bazë të kërkesës datë 25.11.2019 të subjektit *"C SHQIPERIA",* sipas autorizimit drejtorit z. A.N, ku rezultoi: Inspektimet nuk janë të plota**,** pasi fazat e zhvillimit procedurës asgjësimit nuk shoqërohen me dokumente justifikuese, përjashtuar fotografimet të cilat janë bërë. Mungojnë procesverbalet e asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalet e inspektimit, të cilat nuk janë firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. Mungon fletëdalja e subjektit, për efekt të shkarkimit nga magazina të produkteve të asgjësuara.

2. ***Dosja e inspektimit*** datë 21.05.2019, AKU-TR-2020-002918, subjekti ***"F"*** Tiranë, me kërkese te subjektit date 15.05.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **4,645 kg "fruta-perime te dëmtuara" vlerë 538,791 lekë**. Drejtori i DR AKU Tiranë z. S.S ka lëshuar autorizimin datë 21.05.2019. Inspektorët DR AKU L.ZH dhe D.K kane kryer asgjësimin në prani të subjektit (*B)* sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 21.05.2019, duke i shoqëruar të gjitha fazat e asgjësimit me foto të qarta ku pasqyrohen ambientet, produktet, ngarkesa, transporti dhe vendi i depozitimit, por u vërejtën këto mangësi:
-mungon procesverbali i asgjësimit dhe përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.
-mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara.
-mungojnë fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese të produktet asgjësuara.
-mungon inventari i produkteve të dëmtuara nga inspektorët, për efekt të verifikimit dhe krahasimit me listën e subjektit.

3. ***Dosja e inspektimit*** datë 23.01.2019, AKU-TR-2020-000351, subjekti ***"F Tirana"*** Njësia nr. 2, Tiranë, e kryer nga S.L dhe M.B sipas autorizimit datë 23.01.2019 të drejtorit M.M. Inspektorët kane kryer bllokimin dhe asgjësimin e produktit "***F"*** 20 copë = 8000 lekë me datë s,kadence maj 2022 në prani të subjektit dhe përfaqësuesit mjedisit, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 23.01.2019. **Praktika e asgjësimit paraqet mangësi dokumentare dhe nuk është argumentuese**, pasi:
- nuk argumentohet pse asgjësohet produkti brenda afatit të s,kadencës ne vitin 2022.
- mungon procesverbali i asgjësimit dhe përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.
- mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara.
- mungojnë fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese të produktet asgjësuara.
- mungon fotografimi e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet, për rrjedhojë nuk ka dokumente provë, **ndryshe është vepruar tek subjekti *"G"* ku asgjësimi i produkteve date 16.08.2018 shoqërohet me foto te qarta ne gjitha fazat.**
- mungon nënshkrimi i drejtorit në vendimin përfundimtar të asgjësimit datë 23.01.2019, pasi nuk ka vendimmarrje pa firmën e titullarit. Vendimi përfundimtar i asgjësimit datë 23.01.2019 është mjaftuar me firmën e grupit inspektimi DRAKU, madje dhe të subjektit, çka ka krijuar konflikt interesi, pasi inspektorët kanë asgjësuar dhe kanë marrë vendim.

4. *Dosja e inspektimit* datë 11.03.2019, AKU-TR-2019-001423, subjekti***"F"***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, tregu agro-ushqimor, rezulton : Me kërkese te subjektit nr. 850, datë 08.03.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **18,275 kg "produkte dëmtuara" me vlerë 1,843,255 lekë**, dhe në bazë të saj drejtori M.M ka lëshuar autorizimin datë 11.03.2019 për asgjësimin e produkteve të dëmtuara. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 11.03.2019 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe A.T dhe nga OBU *(B)*, thuhet se asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë AA781VE, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit, **rezulton se këto që thuhen në procesverbal nuk justifikohen me asnjë dokument,** konkretisht: mungon kërkesa dhe lista e subjektit, mungon verifikimi i produkteve të dëmtuara të pasqyruara ne një liste ose inventar, i cili nuk disponohet, mungon procesverbali i asgjësimit dhe nënshkrimi i përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve, mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara, mungojnë fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese të produktet asgjësuara, mungon fotografimi e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar, për rrjedhojë nuk ka dokumente provë.

5. *Dosja e inspektimit* datë 07.05.2019, AKU-TR-2019-002535, subjekti***"F"***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, tregu agro-ushqimor, rezulton: Me kërkese te subjektit nr. 1725, datë 03.05.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **14,5 ton "Perime+Fruta të dëmtuara" me vlerë 1,455,400 lekë**, dhe në bazë të saj drejtori M.M ka lëshuar autorizimin datë 07.05.2019 për asgjësimin e produkteve të dëmtuara. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 07.05.2019 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe A.T dhe nga OBU *(B)*, thuhet se asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë AA851TI, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit, **rezulton se këto që thuhen në procesverbal nuk justifikohen me asnjë dokument,** konkretisht: mungon kërkesa dhe lista e subjektit, mungon nga inspektorët verifikimi i produkteve të dëmtuara të pasqyruara ne një liste ose inventar, , mungon procesverbali i asgjësimit dhe nënshkrimi i përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve, mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara, mungojnë fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese të produktet asgjësuara, mungon fotografimi e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar, **mungon dokumenti për llogaritjen sipas normativave ligjore të 1 ton firo nga kalbëzimi i fruta perimeve, të miratuara nga inspektorët për asgjësim. *Përfundimisht* praktika e asgjësimit nuk ka asnjë dokument shoqërues, madje ka njohur dhe firot pa bazë ligjore.**

6. *Dosja e inspektimit* datë 02.08.2019, AKU-TR-2020-004914, OBU subjekti***"F"***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, Tregu agro-ushqimor, rezulton se: Me kërkese te subjektit datë 26.07.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **22,449 kg "Perime+Fruta të skaduar" me vlerë 2,227,123 lekë**, *sipas listës të fruta+perimeve*, ku drejtori S.S ka lëshuar autorizimin datë 02.08.2019 për asgjësimin e produkteve skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 17.01.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B, A.T dhe J.K si dhe nga subjekti, asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë AA631PB, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit.
Shkeljet e konstatuara nga auditimi, sa vijon:
a. mungon procesverbali asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit 02.08.2019, i cili është i pjesshëm, pasi nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.
b. mungon verifikimi i produkteve të dëmtuara nga inspektorët, duke i pasqyruar ne një liste ose inventar i cili nuk disponohet, për efekt krahasimi me listën e paraqitur nga subjekti.
c. mungon fletëdalja e subjektit *"F"*, për efekt të shkarkimit të produkteve të asgjësuara nga magazina,

d. mungon fletëngarkesa për transportin e produkteve të skaduar dhe nuk disponohen fotot megjithëse thuhet se u kryen fotot.

7. ***Dosja e inspektimit*** datë 25.01.2019, AKU-TR-2020-000431, subjekti ***"R"*** Tiranë, me kërkese te subjektit date 24.01.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **5,6 ton "produkte te dëmtuara" vlerë 10,117,,835 lekë**. Drejtori i DR AKU Tiranë z. D.K ka lëshuar autorizimin datë 25.01.2019. Inspektorët A.N, E.M dhe G.H kane kryer asgjësimin në prani të subjektit sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 25.01.2019, ku rezultoi, sa vijon:

-mungon inventari i produkteve të dëmtuara nga inspektorët, për efekt të verifikimit dhe krahasimit me listën e subjektit.

-mungon procesverbali i asgjësimit dhe nënshkrimi i përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.

-mungon dokumenti vërtetues ose fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara.

-mungon fotografimi e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet, pra ska dokumente provë.

8. ***Dosja e inspektimit*** datë 21.01.2019, AKU-TR-2020-000285, subjekti ***"A"*** Kashar, Tiranë, me kërkese te subjektit date 14.01.2019 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **10,6 ton "produkte te skaduar" vlerë 2,775,575 lekë**. Drejtori i DR AKU Tiranë z. D.K ka lëshuar autorizimin datë 21.01.2019. Inspektorët A.N, E.M dhe G.H kane kryer asgjësimin në prani të subjektit sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 21.01.2019, ku rezultoi se:

a. DRAKU nuk ka menaxhuar pasigurinë ushqimore, pasi ka lejuar produktet e s,kaduara të qëndrojnë në subjekt për 2-3 vite, *duke mos garantuar shëndetin e konsumatorëve* si dhe nuk ka nxjerrë përgjegjësinë ndaj inspektorëve për inspektimet e kryera në vitin 2016-2017. Ndërsa ne fund te vitit 2018 ka evidentuar produktet e s,kaduara, duke i veçuar ne ambientet e subjektit ne vend qe te merrte masat menjëherë për largimin dhe asgjësimin e tyre, çka e bën jo efektiv dhe të vonuar asgjësimin e datës 21.01.2019.

b. Nuk është përcaktuar saktë afati gjysmë dite në autorizimin datë 21.01.2019, pasi është e pamjaftueshme koha për inspektorët, për evidentimin, inventarizimin, asgjësimin, transportin, depozitimin, fotografimin dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës, për 10 ton produkte te s,kaduara me vlerë 2,775,575 lekë, ndërsa nga inspektorët nuk është kërkuar kohë shtese, çka ka ndikuar në cilësinë, sigurinë dhe mangësinë e inspektimit**,** konkretisht: mungon inventari i produkteve të s,kaduara si bazë krahasimi me listën e subjektit, mungojnë fletëngarkesa për kompaninë transportuese, mungon procesverbali i asgjësimit dhe nënshkrimi i përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve, mungon dokumenti vërtetues ose fletëdalja e subjektit për produktet e s,kaduara, mungon fotografimi e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet.

<u>Viti 2020 (31 dosje asgjësimi të audituara).</u>

1. ***Dosja e inspektimit*** **datë 16.01.2020**, AKU-TR-2020-000457, OBU ***F***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, tregu Agro-ushqimor, Kashar, rezulton se: Me kërkese te subjektit *FRUIT CO* datë 10.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **14,**7 **ton "Perime +Fruta të kalbëzuara" me vlerë 1,582,405 lekë**, sipas listës të fruta + perimeve të dëmtuara. FRUIT CO shpenzimet e asgjësimit dhe transportit do ta mbulojë vetë. Asgjësimi është kryer nëpërmjet një mjeti transporti, ku janë hedhur fruta-perimet e dëmtuara dhe më tej thuhet se janë groposur në vendin Landfili Bushat Shkodër, nga trupa e inspektimit M.H, J.K dhe M.C (*autorizimi datë 16.01.2020 i drejtorit A.N)*, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 16.01.2020, duke pasur në prani përfaqësuesin e subjektit *F* si dhe përfaqësues të inspektoratit mjedisor. Disponohen foto ne ambientet e *F* të produkteve dëmtuara duke u hedhur në automjet.

Shkeljet e konstatuara:

a. mungon procesverbali asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit, i cili është i pjesshëm, pasi nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor.

b. mungon fletëdalja e subjektit *F*, për efekt të shkarkimit nga kontabiliteti të produkteve të asgjësuara, ndryshe nga subjekti ***"O"*** ku disponohet fatura tatimore nr. 85802925 date 28.01.2020.
c. mungon dokumenti i shoqërimit për kompaninë *E*, për transportin në linjën Tiranë-Bushat Shkodër, ndryshe nga subjekti ***"O"*** ku disponohet fatura shoqëruese nr. 85802925 date 28.01.2020 për transport mbeturina produktesh asgjësuara nga *"E",*
d. mungojnë fotot në vendin e asgjësimit të produkteve të dëmtuara në vendin e asgjësimit Bushat Vau i Dejës,
n. nuk justifikohet transporti me subjektin*"E"* të pa licencuar (*subjekti është pajisur pas 10 muajsh me licencë kategorisë III.2.B sipas shkresës nr. 362 datë 22.10.2019, lëshuar nga Axhensia Kombëtare Mjedisit Tiranë)* si dhe dalja nga juridiksioni i Qarkut Tiranë, për transportin e produkteve të kalbëzuara në Landfillin e Qarkut Shkodër, i cili është i destinuar për mbeturinat brenda juridiksionit tij.
m. Dokumentacioni nuk është i rregullt, për transportin e produkteve të dëmtuara, pasi:
- Subjekti F ka siguruar mjetin e transportit me kompaninë e pa licencuar E me vend ndodhje në Maminas Durrës sipas kontratës datë 20.07.2019 me afat 6-mujor, *e cila është e parregullt, pasi nuk është origjinale dhe as e noterizuar por fotokopje.*
-*E* ka lidhur kontratën me *sha "Bushat"* me aktivitet vend depozitim i mbetjeve urbane me datë 20.06.2019 me afat 6-mujor ose deri më 31.12.2019, neni 7/1, kap VII "*Kohëzgjatja", e cila nuk është e rregullt, pasi nuk është origjinale dhe as e noterizuar (fotokopje),* madje pa fuqi ligjore sepse i ka mbaruar afati ligjor.

1/1. *Dosja e inspektimit* datë 14.04.2020, AKU-TR-2020-001897, OBU ***F***, rezulton: **Asgjësimi.** Me kërkese te subjektit datë 08.04.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **24,121 kg "Perime +Fruta të kalbëzuara" me vlerë 2,220,129 lekë**, sipas listës përkatëse. Asgjësimi është kryer nëpërmjet një mjeti transporti, ku janë hedhur fruta-perimet e dëmtuara dhe më tej thuhet se janë groposur në vendin Landfili Bushat Shkodër, nga trupa e inspektimit M.H, J.K dhe M.C (*autorizimi i drejtorit A.N)*, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 14.04.2020, duke pasur në prani përfaqësuesin e subjektit Bardhyl Muça. **Shkeljet e konstatuara nga auditimi**, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve, mungon fletëdalja e subjektit *F*, mungon dokumenti i shoqërimit për kompaninë *E*, për transportin në linjën Tiranë-Bushat Shkodër, mungojnë fotot në ambientin e subjektit dhe ne vendin e asgjësimit të produkteve të dëmtuara Bushat.
1/2. *Dosja e inspektimit* datë 12.08.2020, AKU-TR-2020-004898, ***F***, rezulton se: **ndryshe nga rastet tjera është mbajtur procesverbali asgjësimit datë 12.08.2020 me nënshkrimin e 2 përfaqësuesve Mjedisit, e 1 përfaqësuesi Tatimeve dhe 2 inspektorëve të DR AKU** Tiranë si dhe subjektit G.
Kështu me kërkese te subjektit datë 10.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **10,268 kg "Perime +Fruta të kalbëzuara" me vlerë 1,408,050 lekë**, sipas listës përkatëse. Asgjësimi është kryer nëpërmjet një mjeti transporti, ku janë hedhur fruta-perimet e dëmtuara dhe më tej thuhet se janë groposur në vendin Landfili Bushat Shkodër, nga trupa e inspektimit **E.Sh dhe E.C (*autorizimi i drejtorit M.N)***, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 12.08.2020, duke pasur në prani përfaqësuesin e subjektit.
Shkeljet e konstatuara nga auditimi, mungon fletëdalja e subjektit *F* për fruta-perimet e dëmtuara si dhe mungon dokumenti i shoqërimit për kompaninë *E*, për transportin në linjën Tiranë-Bushat Shkodër.

2. *Dosja e inspektimit* datë 28.01.2020, AKU-TR-2020-000543, subjekti ***"O"***, adresa: Njësia nr. 2 Sauk Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit ***"O"*** datë 23.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **6,244 kg "artikuj ushqimor me afat kadence të kaluar" me vlerë 2,089,329 lekë**.

Në bazë të kërkesës subjektit drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 28.01.2020 për asgjësimin e artikujve të skaduar, sipas listës përkatëse. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 28.01.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.D dhe F.R dhe nga subjekti Gentian Bineri, thuhet se: asgjësimi është kryer me copëtim duke u transportuar me makinën me targë AA725YY të kompanisë licencuar *"E"*. Disponohet fatura shoqëruese nr. 85802925 date 28.01.2020 per transportin e 5,6 ton mbeturina produktesh, nënshkruar nga subjekti ***"O"*** dhe *"E"*. Disponohet (fotokopje) leja Mjedisore e tipit C e subjektit*"Eco Empirë"* me nr. 105 datë 08.07.2019, lëshuar nga DR E Mjedisit Tiranë. Disponohet (fotokopje) licenca e kategorisë III.2.B e subjektit*"E"* me nr. 362 datë 22.10.2019, lëshuar nga Axhensia Kombëtare Mjedisit Tiranë. ***Shkeljet e konstatuara nga auditimi***,

-Mungon procesverbali asgjësimit,

-Mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 28.01.2020, por është mjaftuar me nënshkrimin e 2 inspektorëve dhe subjektit.

-Nuk përputhet sasia e asgjësuar 6,244 ton sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 28.01.2020 me faturën tatimore të subjektit ***"O"*** nr. 85802925 date 28.01.2020 prej 5,6 ton mbeturina produktesh nënshkruar nga subjekti transportues *"E*", pra diferenca 0,6 ton për vlerën 175,000 leke.

3. *Dosja e inspektimit* datë 17.01.2020, AKU-TR-2020-000465, OBU ***G***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"G"* datë 13.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **39,840 kg "Perime+Fruta të skaduar" me vlerë 3,054,852 lekë**, *sipas listës të fruta+perimeve,* ku drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 17.01.2020 për asgjësimin e produkteve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 17.01.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B, A.B dhe E.D si dhe nga subjekti, asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë AA725YY, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit. **Shkeljet e konstatuara**, sa vijon:

a.mungon procesverbali asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit 17.01.2020, i cili është i pjesshëm, pasi nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.

b.mungon fletëdalja e subjektit *G*, për efekt të shkarkimit nga magazina, dokument bazë që fakton daljen nga magazina të produkteve të asgjësuara.

c.mungon dokumenti i shoqërimit për transportin e produkteve të skaduar,

d.mungon përcaktimi i vendit se ku janë asgjësuar produktet e dëmtuara,

e.nuk disponohen fotot e produkteve, ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet.

3/1. *Dosja e inspektimit* datë 17.04.2020, AKU-TR-2020-0002006, OBU ***G***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"G"* datë 14.04.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **47,731 kg "Perime+Fruta të skaduar" me vlerë 3,763,393 lekë**, *sipas listës të fruta+perimeve,* ku drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 17.04.2020 për asgjësimin e produkteve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 17.04.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B, A.B si dhe nga subjekti, asgjësimi është kryer nëpërmjet makinës vetshkatërruese me targë AA725YY dhe TR5734R në prezencë të inspektorëve tatimeve dhe mjedisit. **Shkeljet e konstatuara nga auditimi**, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi i përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.

3/2. *Dosja e inspektimit* datë 21.08.2020, AKU-TR-2020-004975, ***G***, rezulton se: Me kërkese te subjektit datë 17.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **47,281 kg "Perime+Fruta të skaduar" me vlerë 5,331,789 lekë**, *sipas listës të fruta+perimeve,* ku drejtori M.N ka lëshuar autorizimin datë 17.04.2020 për asgjësimin e produkteve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 21.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët E.Sh dhe

D.K si dhe nga subjekti S, asgjësimi është kryer nëpërmjet makinës vet shkatërruese me targë AA725YY në prezencë të inspektorëve tatimeve dhe mjedisit.
Shkeljet e konstatuara nga auditimi, mungon procesverbali asgjësimit ndërsa tek inspektimi datë 30.10.2020 i këtij subjekti është mbajtur procesverbali asgjësimit datë 30.10.2020 me nënshkrimin e 2 përfaqësuesve Mjedisit, të përfaqësuesit Tatimeve dhe inspektorëve të DR AKU Tiranë si dhe subjektit G. Mungon fletëdalja e subjektit *G*.

3/3. *Dosja e inspektimit* datë 30.10.2020, AKU-TR-2020-006828, ***G***, rezulton se: **ndryshe nga rastet tjera është mbajtur procesverbali asgjësimit datë 30.10.2020 me nënshkrimin e 2 përfaqësuesve Mjedisit (ARM) Tirane, e 1 përfaqësuesi Tatim Paguesve Mëdhenj (DTM) dhe 2 inspektorëve të DR AKU** Tiranë si dhe subjektit G. Me kërkese te subjektit datë 26.10.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **42,857 kg "Perime+Fruta të skaduar" me vlerë 4,331,013 lekë**, *sipas listës të fruta+perimeve*, ku drejtori M.N ka lëshuar autorizimin datë 17.04.2020 për asgjësimin e produkteve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.10.2020 të nënshkruar nga inspektorët E.Sh dhe E.C si dhe nga subjekti S, asgjësimi është kryer nëpërmjet makinës vet shkatërruese me targë AA725YY në Bushat.

4. *Dosja e inspektimit* datë 21.01.2020, AKU-TR-2020-000489,subjekti***"C"***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, km 11 pranë karburant E, rezulton :
Me kërkese te subjektit *"C"* nr. 136, datë 17.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **2,232 kg "Artikuj të ndryshëm skaduar" me vlerë 2,658,835 lekë**, *sipas listës bashkëngjitur* dhe në bazë të saj drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 21.01.2020 për asgjësimin e artikujve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 21.01.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga OBU *(M)*, thuhet se asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë TR5734R, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 21.01.2020, , mungon dokumenti i shoqërimit për transportin e produkteve të skaduar, mungon përcaktimi i vendit se ku janë asgjësuar produktet e dëmtuara, nuk disponohen fotot e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet, mungon fletëdalja e subjektit *"C"* për efekt të shkarkimit magazinës dhe justifikimit detyrimeve fiskale.

4/1. *Dosja e inspektimit* datë 24.04.2020, AKU-TR-2020-002156, subjekti ***"CS"***, adresa Autostrada Tiranë-Durrës, km 11 pranë karburant E, rezulton: Me kërkese te subjektit datë 21.04.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **4,469 kg "produkte ushqimore të skaduar" me vlerë 1,840,369 lekë**, *sipas listës bashkëngjitur* dhe në bazë të saj drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 22.04.2020 për asgjësimin e artikujve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 24.04.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga OBU *(M)*, thuhet se asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë targë AA725YY, ku thuhet morën pjesë inspektorët e mjedisit.
Shkeljet e konstatuara, Praktikës i mungon procesverbali asgjësimit, dokument bazë ligjor që justifikon asgjësimin e produkteve, mungon nënshkrimi i përfaqësuesit inspektoratit mjedisor dhe tatimeve, për efekt të mbrojtjes mjedisit dhe shmangies detyrimeve fiskale.

5. *Dosja e inspektimit* datë 23.01.2020, AKU-TR-2020-000510,subjekti***"D"***, adresa Njësia 5, rruga I. Rugova Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"D"* nr. 164, datë 22.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **744,632 kg "Produkte ushqimore skaduar" me vlerë 1,931,064 lekë**, dhe në bazë të saj drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 23.01.2020 për asgjësimin e artikujve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 23.01.2020

të nënshkruar nga inspektorët D.D dhe E.M dhe nga OBU *(D)*, thuhet se asgjësimi është kryer nëpërmjet një makine vet shkatërruese me targë AA725YY në vendin e quajtur Bushat, Vau Dejës, ku thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon dokumenti i shoqërimit për transportin e produkteve të skaduar, mungon lista e produkteve të skaduar, mungon fletëdalja e subjektit për efekt të shkarkimit magazinës dhe justifikimit detyrimeve fiskale. Mungon nënshkrimi i inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 23.01.2020 dhe nuk disponohen fotot e ambientit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet. Nuk disponohen dokumente si kontrata, aktmarrëveshje për transportin dhe lejimin e depozitimit të produkteve skaduar në Bushat, ndryshe nga subjekti *F* ku disponoheshin, *pavarësisht parregullsive të konstatuara.*

6. *Dosja e inspektimit* datë 23.01.2020, AKU-TR-2020-000508,subjekti***"A"***, adresa: Autostrada Tiranë-Durrës KM 6, Fshati Katund i ri, Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"A"* nr. 64, datë 19.01.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **540 kg "Barna e artikuj me afat kadence të kaluar" me vlerë 1,151,303 lekë**, dhe në bazë të saj drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 23.01.2020 për asgjësimin e barnave dhe artikujve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 23.01.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga OBU *(B)*, thuhet se asgjësimi është kryer dhe janë transportuar me makinat me targë AA879NH dhe AA473ZP dhe thuhet morën pjesë inspektorët e tatimeve dhe mjedisit.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 23.01.2020, mungojnë fotot e ambientit dhe nuk është përcaktuar vendi ku janë asgjësuar produktet, mungon lista e barnave dhe artikujve të skaduar, mungon fletëdalja e subjektit. ***Mungon dokumenti i shoqërimit për transportin e produkteve të skaduar***, ***ndërsa inspektorët e kanë disponuar dokumentin shoqërues tek subjekti "A****", fatura tatimore shitjes nr. 85802929 date 25.02.2020 për transportin e 5,9 ton mbeturina produktesh, nënshkruar dhe "E",* **pra me 2 standarde**.

7. *Dosja e inspektimit* datë 25.02.2020, AKU-TR-2020-001112, subjekti ***"A"***, adresa: Kashar Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit datë 19.02.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **8,548 kg "artikuj ushqimor skaduar" me vlerë 425,429 lekë**. Në bazë të kërkesës subjektit është lëshuar autorizimin datë 25.02.2020 për asgjësimin e artikujve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 25.02.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga subjekti F, thuhet se: asgjësimi është kryer me makinën vet shkatërruese me targë AA725YY të kompanisë licencuar *"E"* ne prani te përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor. Disponohet dokumenti shoqërues, fatura tatimore shitjes nr. 85802929 date 25.02.2020 për transportin e 5,9 ton mbeturina produktesh, nënshkruar nga subjekti *"A"* dhe *"E"*.
Shkeljet: -mungon procesverbali asgjësimit dhe mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 25.02.2020, por është mjaftuar me nënshkrimin e 2 inspektorëve dhe subjektit.
-nuk përputhet sasia e asgjësuar 8,548 kg sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 25.02.2020 me faturën tatimore të subjektit ***"****O"* nr. 85802929 date 25.02.2020 prej 5,9 ton, pra diferenca 2,6 ton.
-nuk disponohen fotot e produkteve dhe ambientit subjektit.

8. *Dosja e inspektimit* datë 20.02.2020, AKU-TR-2020-001096, subjekti***"Z"*** adresa: Vaqarri, Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"Z sha"* nr. 09/20, datë 17.02.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **14,600 kg "Banane dëmtuara" vlerë 2,7641,365 lekë**, dhe drejtori A.N ka lëshuar autorizimin datë 20.02.2020 për asgjësimin e 2000 kuti (*14600 kg*) bananeve të skaduar. Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 20.02.2020 të nënshkruar nga

inspektorët E.Sh dhe D.K dhe nga OBU *D)*, thuhet se asgjësimi i bananeve është kryer dhe transportuar me makinën SH4502E në landfillin Bushat. Disponohet (fotokopje) dokumenti peshimit 0046337 i mjetit plote dhe bosh me diferencën neto mbeturina banane 14600 kg, i cili përcakton datën 19.02.2020 të hyrjes dhe daljes në Landfillin Bushat. Disponohet fotot e bananeve të dëmtuara.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon pjesëmarrja dhe nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 20.02.2020, mungon fletëdalja e subjektit.

9. *Dosja e inspektimit* datë 27.02.2020, AKU-TR-2020-001096, subjekti***"E shpk"*** adresa: RRuga Kavajës, Tiranë, rezulton se: Me kërkese te subjektit *"ZIKO sha"* nr. 09/20, datë 24.02.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **7,088 kg "produkte ushqimore dëmtuara" vlerë 2,163,085 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 27.02.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga OBU *(I)*, thuhet se asgjësimi u kryer me makinën vet shkatërruese me targë AA725YY dhe TR5734R, ne prani te përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor. Disponohet (fotokopje) fatura tatimore shitjes 85802930 date 27.02.2020 për transportin 8 ton mbeturina produktesh, nënshkruar nga subjekti dhe transportuesi.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor tek procesverbali i inspektimit 27.02.2020, mungon fotot e produkteve dëmtuara.

10. *Dosja e inspektimit* datë 04.03.2020, AKU-TR-2020-001563, subjekti***"A"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 28.02.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **12,1 ton "produkte ushqimore skaduar" vlerë 5,534,597 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 04.03.2020 të nënshkruar nga inspektorët L.B dhe A.B dhe nga OBU *(D)*, thuhet se asgjësimi u kryer me makinën vet shkatërruese me targë AA725YY dhe TR5734R, ne prani te përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.
Shkeljet e konstatuara, mungon procesverbali asgjësimit, mungon nënshkrimi i përfaqësuesve të inspektoratit mjedisor dhe tatimeve tek procesverbali i inspektimit 04.03.2020, mungon fotot e produkteve dëmtuara, madje mungon lista produkteve dhe dokumentacioni i gjurmshmërisë, për efekt te argumentimit s kadencës. Mungon fletëdalja e subjektit për efekt të shkarkimit nga magazina, mungon dokumenti i shoqërimit për transportin e produkteve. ***Përfundimisht***, praktika e asgjësimit nuk ka asnjë dokument shoqërues dhe argumentues për të justifikuar asgjesimin12,1 ton produkte ushqimore skaduar .

11. *Dosja e inspektimit* datë 28.12.2020, AKU-TR-2020-007599, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **49,565 litra "produkte pije skaduar" vlerë 4,532,320 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 28.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.
11/1. *Dosja e inspektimit* datë 29.12.2020, AKU-TR-2020-007599, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **15,683 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 2,353,043 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 29.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.
11/2. *Dosja e inspektimit* datë 30.12.2020, AKU-TR-2020-007599, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **22,967 litra "produkte skaduar" vlerë 1,832,952 lekë**, Sipas procesverbalit

inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 30.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/3. *Dosja e inspektimit* datë 24.12.2020, AKU-TR-2020-007599, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **26,572 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 1,182,164 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 24.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/4. *Dosja e inspektimit* datë 23.12.2020, AKU-TR-2020-007585, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **49,842 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 2,321,060 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 23.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**,** Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/5. *Dosja e inspektimit* datë 22.12.2020, AKU-TR-2020-007599, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 21.12.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **20,398 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 980,966 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 22.12.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**, por mungon fletëdalja e subjektit,** ndërsa disponohet procesverbali asgjësimit date 22.12.2020 me nënshkrimin e inspektoratit mjedisor, tatimeve dhe AKU e shoqëruar me foto.

11/6. *Dosja e inspektimit* datë 27.08.2020, AKU-TR-2020-005458, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 11.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **5,594 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 684,297 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 27.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. **U konstatua se mungon fletëdalja e subjektit,** ndërsa disponohet procesverbali asgjësimit date 18.08.2020 me nënshkrimin e inspektoratit mjedisor, tatimeve dhe AKU e shoqëruar me foto**.**

11/7. *Dosja e inspektimit* datë 21.08.2020, AKU-TR-2020-004978, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 11.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **30,650 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 2, 135,869 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 21.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B, Ermal Matuka dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. Praktika ska dokumente shoqëruese.

11/8. *Dosja e inspektimit* datë 20.08.2020, AKU-TR-2020-004969, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 11.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **13,789 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 2, 563,844 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 20.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/9. *Dosja e inspektimit* datë 19.08.2020, AKU-TR-2020-004963, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 11.08.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **30,396 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 1, 084,612 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 19.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin e brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/10. *Dosja e inspektimit* datë 18.08.2020, AKU-TR-2020-004961, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 11.08.2020 i kërkohet DRAKU

asgjësimi i **9,668 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 337,722 lekë**, Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 19.08.2020 të nënshkruar nga inspektorët M.B dhe H.K dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. Praktika s,ka dokumente shoqëruese.

11/11. ***Dosja e inspektimit*** datë 04, 05, 06, 07, 08, 11, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22, 29 **gjithsej 16 inspektime asgjësimi të kryera në muajin maj 2020**, subjekti ***"C SHQIPERIA"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 27.04.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **432,813 litra "produkte, pije skaduar" vlerë 31,644,067 lekë.** Mbi bazën e kërkesës subjektit drejtori z. A.N ka lëshuar **16 autorizime e mësipërme.**

Sipas 16 procesverbaleve inspektimit dhe vendimeve përfundimtare të nënshkruara nga inspektorët M.B dhe L.A dhe nga OBU *(Z)*, thuhet se asgjësimi u kryer me derdhje në ambientin brendshme te kompanisë**,** ndërsa ambalazhi për riciklim. Nga auditimi konstatohet se**:**

- 16 inspektimet kanë qene sipërfaqësore nga forma dhe përmbajtja, pasi nuk pasqyrohen fazat e zhvillimit procedurës asgjësimit dhe nuk shoqërohet me dokumente justifikuese.

- **mungon procesverbali asgjësimit**, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit 17.01.2020, i cili është i pjesshëm, pasi nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.

- **mungon fletëdalja e subjektit**, për efekt të shkarkimit nga magazina, dokument bazë që fakton daljen nga magazina të produkteve të asgjësuara.

- **mungojnë në disa raste fotot** e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar **produktet.**

12. ***Dosja e inspektimit*** datë 07.05.2020, AKU-TR-2020-002727, subjekti ***"A"*** adresa: Kashar, Tiranë, rezulton se: me kërkese te subjektit datë 28.04.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **40,000 kg "artikuj skaduar" vlerë 17,846,4937 lekë.** Mbi bazën e kërkesës subjektit drejtori A.N ka lëshuar autorizimin date 07.05.2020**.** Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 07.05.2020 të nënshkruara nga inspektorët E.V dhe Z.C dhe nga OBU *(B)*, thuhet se; asgjësimi u krye me makinat vet,shkaterruese me targë AA725YY dhe TR5734R, duke i dërguar ne landfillin e B, ku te pranishëm ishin përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor, ujërave, pyjeve, turizmit dhe tatimeve, ku u kryen foto. Nga auditimi konstatohet se**:**

- mungon procesverbali asgjësimit, por është mjaftuar me procesverbalin e inspektimit 17.01.2020, i cili është i pjesshëm, pasi nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. **Ndryshe është vepruar tek subjekti *G,*** *pasi është mbajtur procesverbali asgjësimit datë 30.10.2020 me nënshkrimin e përfaqësuesve të Mjedisit, të tatimeve dhe inspektorëve të DR AKU, pra kemi* **2 standarde.**

- **mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara**, për efekt të shkarkimit nga magazina, dokument bazë që fakton daljen nga magazina të tyre.

- **mungon lista e komisionit të asgjësimit për produktet e asgjësuara,** por është mjaftuar me një liste te subjektit, e cila është e parregullt pasi nuk ka asnjë firme.

- **mungon fletëshoqërimi për kompaninë transportuese për produktet e asgjësuara si dhe mungon flet peshimi, ndryshe është vepruar tek subjekti** "*Z sha" ku disponohet dokumenti peshimit 0046337 i mjetit plote dhe bosh me diferencën neto mbeturina 14600 kg, i cili përcakton datën 19.02.2020 të hyrjes dhe daljes në Landfillin Bushat.*

- **fotot e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet nuk japin pamje,** madje janë të paqarta, për rrjedhojë nuk janë dokumente provë. **Ndryshe është vepruar tek subjekti T** date 10.08.2020 ku ne foto duken qarte produktet e skaduara, kadenca, ambienti i subjektit dhe i asgjësimit, makinat vet shkatërruese dhe personat pjesëmarrës.

12/1. ***Dosja e inspektimit*** datë 29.07.2020, AKU-TR-2020-004811, subjekti ***"A"*** me kërkese te subjektit i kërkohet DRAKU asgjësimi i **24,000 kg "artikuj skaduar" vlerë 9,429,753 lekë.** Mbi bazën e kërkesës subjektit drejtori M.N ka lëshuar autorizimin date 29.07.2020**.** Sipas

procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 29.07.2020 të nënshkruara nga inspektorët E.Sh dhe E.C dhe nga OBU *(B)*, thuhet se; asgjësimi u krye me makinat vet shkaterruese me targë AA752HD dhe TR3971R, duke i dërguar ne landfillin e Sh Tirane, ku te pranishëm ishin përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve. Nga auditimi konstatohet se**:**
- mungon procesverbali asgjësimit, **duke vepruar me 2 standarde,** *pasi po këta inspektorë tek subjekti G kanë mbajtur procesverbal asgjësimi datë 30.10.2020 me nënshkrimin e përfaqësuesve të mjedisit, të tatimeve dhe inspektorëve të DR AKU***.** Inspektorët janë mjaftuar me procesverbalin e inspektimit 29.07.2020, i cili nuk është firmosur nga përfaqësuesit e inspektoratit mjedisor dhe tatimeve.
- **mungon fletëdalja e subjektit për produktet e asgjësuara**, për efekt të shkarkimit nga magazina, dokument bazë që fakton daljen nga magazina të tyre.
- **mungon lista e komisionit të asgjësimit për produktet e asgjësuara,** por është mjaftuar me një liste te subjektit.
- **mungon fletëshoqërimi për kompaninë transportuese për produktet e asgjësuara si dhe mungon flet peshimi, ndryshe është vepruar tek subjekti** "*Z sha" ku disponohet dokumenti peshimit i mjetit plote dhe bosh me diferencën neto të mbeturina, i cili përcakton datën e hyrjes dhe daljes në Landfillin.*
- **mungojnë** fotot e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet, për rrjedhojë nuk ka dokumente provë.

13. ***<u>Dosja e inspektimit</u>*** datë 28.08.2020, AKU-TR-2020-005459, subjekti ***"E"*** Tiranë, me kërkese te subjektit i kërkohet DRAKU asgjësimi i **4,875 kg "artikuj skaduar" vlerë 2,955,561 lekë**. Inspektorët DR AKU E.Sh dhe E.C si dhe 2 përfaqësuesit e mjedisit dhe përfaqësuesi i firmës **kane mbajtur procesverbalin e asgjësimit datë 28.08.2020, i cili nuk pasqyron asgjë** *(shih foton),* përveç prezencës tyre, madje dhe kjo e pjesshme, pasi mungon nënshkrimi i përfaqësuesit tatimeve dhe 1 inspektori te DR AKU, më konkretisht:
-mungon fletëdalja e subjektit dhe lista e komisionit për produktet e asgjësuara, për efekt të shkarkimit nga magazina *(është mjaftuar me një liste te subjektit).*
-mungon fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese për produktet e asgjësuara, ndryshe nga subjekti "Z" ku disponohen, pra me 2 standarde.
-mungojnë fotot e ambientit subjektit dhe vendit ku janë asgjësuar produktet, ndërsa në procesverbal thuhet u kryen fotot.
Përfundimisht, Dosja për procedurën e asgjësimit paraqitet e parregullt, jo e plote dhe me mangësi të dokumentacionit shoqërues, provues dhe argumentues, në kundërshtim me kërkesat ligjore të cituara më sipër.

14. ***<u>Dosja e inspektimit</u>*** datë 28.10.2020, AKU-TR-2020-006799, subjekti ***"T"*** Kashar, Tiranë, me kërkese te subjektit datë 20.10.2020 i kërkohet DRAKU asgjësimi i **1,393 kg "artikuj skaduar" vlerë 337,167 lekë**. Mbi bazën e kërkesës subjektit drejtori M.N ka lëshuar autorizimin date 28.10.2020**.** Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 28.10.2020 të nënshkruara nga inspektorët G.H dhe S.L dhe nga OBU *(J),* rezulton se:
- **thuhet se u krye inventarizimi i sasisë gjendje ne magazine dhe përputhej me sasinë e produkteve të skaduar sipas kërkesës subjektit,** por **mungon inventari i inspektoreve** DR AKU, për rrjedhojë nuk ka kuptim përputhja dhe krahasimi midis 2 inventarëve kur njëri prej tyre mungon *(lista e subjektit është e pa rregullt pasi s,ka asnjë nënshkrim dhe vule).*
- **thuhet se u krye asgjësimi fizik i produkteve të skaduar** me makinën vet shkatërruese me targë AA725YY, duke i dërguar ne landfillin e B, por:
* mungojnë dokumentet prove, fotot e ambientit subjektit, vendit ku janë asgjësuar produktet, makina vet shkatërruese e transportit dhe përfaqësuesve të institucioneve, ndërsa në procesverbal

citohet u kryen fotot. ***Ndryshe është vepruar tek asgjësimi datë 22.12.2020 në subjektin " K"*** ku disponohen fotot e qarta për çdo faze te procedurës asgjësimit.
* mungojnë fletëshoqërimi dhe flet peshimi për kompaninë transportuese të produktet asgjësuara.
- thuhet se pas asgjësimit u larguan nga subjekti produktet e skaduar prej **1,393 kg** me **vlerë 337,167 lekë,** por **nuk argumentohet me dokument, pasi mungon** fletëdalja e magazinës subjektit.
- thuhet se te pranishëm ishin 2 përfaqësuesit e mjedisit dhe përfaqësuesit e tatimeve, por mungojnë firmat e tyre, ndërsa disponohen tek procesverbali i ARM Tiranë, por këtu mungojnë firmat e 2 inspektorëve të DR AKU. Pra, **disponohen 2 procesverbale me komisione të ndara për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtin qëllim,** në vend të një procesverbali asgjësimi me nënshkrimin e komisionit përbashkët të 3 institucioneve**.**
Përfundimisht, Dosja për procedurën e asgjësimit paraqitet e parregullt, jo e plote dhe me mangësi të dokumentacionit shoqërues, provues dhe argumentues, në kundërshtim me kërkesat ligjore të cituara më sipër në akt-konstatim.
14/1. Me fenomene të njëjta paraqitet *dhe dosja e subjektit* "*U" Tiranë,* për **asgjësimin e 6,710 litra** me vlerë **591,409 lekë,** kryer nga inspektorët G.H dhe S.L, ku përveç procesverbalit dhe autorizimit datë 30.12.2020 nuk disponon asnjë dokument tjetër.

<u>Praktikat e ankimimeve dhe vendimet e komisionit të shqyrtimit ankesave të subjekteve pranë AKU Përgjithshme Tiranë, për periudhën 2018-2019-2020.</u>
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, sipas pikave të programit të auditimit, konstatohet që:
I. DRAKU Tirane dhe zyra juridike paraqet në disa raste vonesa te kerkesave në adresë të gjykatës shkallës parë Tiranë, për lëshimin e urdhër ekzekutimit për masën administrative të gjobave ndaj subjekteve.
II. Dosjet për procedurat e ndjekjes dhe vjeljes gjobave paraqesin mangësi dokumentare dhe nuk janë pjesë e dosjeve të inspektimit**,** madje në disa raste ato mungojnë, për pasojë jemi adresuar DPAKU me shkresën nr. 87, datë 15.01.2021, për disponimin e tyre për efekt auditimi *(vendimet e komisionit AKU për shqyrtimin e ankesave të subjekteve*).
Zyra juridike e DRAKU Tirane në 1 rast paraqet 2 standarde, pasi mungojnë procedurat e ndjekjes për arkëtimin e gjobave, ndryshe nga praktika e subjektit "*Shkëlqim Allgjata*" e cila është e kompletuar.
III. DRAKU për vitin 2020 në 12 raste nuk ka bërë kërkese ndaj gjykatës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv për masën administrative gjobë ndaj subjekteve, *por është mjaftuar me një shkresë (2021) në adresë të Postës Shqiptare lidhur me njoftimin e subjektit, në vend që ta verifikonte brenda institucionit saj AKU brenda vitit 2020.*
IV. Komisioni ankimor i AKU Tiranë ka nxjerrë vendime me 2 standarde në 1 rast**,** pasi me vendimin nr. 899/1 datë 14.09.2020 ka falur në mënyrë të pa argumentuar 3 gjoba për 450, 000 lekë si të pa bazuara plotësisht në ligj**,** , ndërsa disa tjera janë lënë në fuqi**,** megjithëse paraqesin të njëjtat probleme,

Sa sipër , **konkretisht:**
<u>1. Dosja e inspektimit</u> **datë 09.04.2019**, *"C Albania*", Tiranë, rezulton se:
-Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 08.04.2019 Inspektorët e DRAKU Tiranë kanë vendosur bllokimin e asgjësimin e kërpudhës freskët, pasi mungon dokumentacioni i origjinës *(certifikata fitosanitare*) si dhe kanë vendosur **gjobë 2,000,000 lekë** dhe paralajmërim.
- Komisioni i shqyrtimit ankesave i AKU sipas vendimit nr. 2642/1 datë 08.05.2019, nënshkruar nga titullari i AKU dhe kryetar komisionit shqyrtimit ankimimeve z.A.H, A.D, A.K dhe I.A komisioner të ankimimeve kanë **falur 50% gjobën prej 1,000,000 lekë**.

- Gjykata e shkallës parë Tiranë sipas vendimit saj nr. 3579 datë 29.10.2019 ka rrëzuar vendimin e komisionit shqyrtimit ankimimeve nr. 2642/1 datë 08.05.2019 dhe aktin e inspektimit duke hequr subjektit 100 % gjobën, pra vlerën 2,000,000 lekë.
- DR AKU Tiranë çështjen e ka apeluar me datë 26.12.2019 ku nga andej s,ka përgjigje**.**

2. Dosja e inspektimit **datë 10.07.2019**, "*C Albania*" Tiranë, rezulton se:
-Sipas sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 10.07.2019, *sipas RASFF* u disponua dokumentacioni për një sasi orizi (*360 kg*) pa afat s,kadence dhe me mospërputhje shifrash me te dhënat e subjektit, ku nga Inspektorët është vendosur **gjobë 2,200,000 lekë** *(2,000,000+200,000)* e cila është **falur 100 % nga komisionit shqyrtimit** ankimimeve të AKU, sipas vendimit nr.16 datë 05.03.2020, nënshkruar nga titullari i AKU dhe kryetar komisionit shqyrtimit ankimimeve z. R.L, A.H, I.A, A.K dhe L.I komisioner**.**

3. *Dosja e inspektimit* datë 02.05.2019, "*E" shpk* rezulton se: Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 03.05.2019, inspektorët e DRAKU Tiranë kanë konstatuar shkelje në dokumentacionin dhe sigurinë në kripën ushqimore jodizuar importit *(disponohet përgjigjja e analizave 26.04.2019)* dhe kanë aplikuar 4 gjoba për **1,500,000 lekë,** paralajmërim si dhe kanë bllokuar 16,236 kg kripe.
***Procedura për vjeljen e gjobës*.** Subjekti është ankimuar me date 10.06.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën me **vendimin nr**. **3492/1 datë 04.05.2020, i cili është në shkelje afatit ligjor 10 muaj** nga 1 muaj që duhej për shqyrtimin e ankesës, çka bën përgjegjës komisionin ankimor dhe drejtorin AKU z. R.L.
Subjekti ka bërë ankimimin në gjykatën e shkallës parë Tiranë datë 26.06.2020.
DRAKU ka bere kërkesën ne gjykatën administrative shkalles parë Tiranë nr. 1605 date 10.09.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit për masën administrative të vlerës 1,500,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit nr. 1021 date 18.08.2020. **Mungon kërkesa e DR dhe AKU për zyrën e përmbarimit për ekzekutim te masës administrative.**
DRAKU Tiranë dhe zyra juridike paraqet mungesë bashkëpunimi me AKU Qendër.
Mungon bashkëpunimi me zyrën e përmbarimit dhe me tej asnjë zgjidhje, **pasi gjoba 1,500,000 lekë nuk është likuiduar nga subjekti, duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.**

4. *Dosja e inspektimit* datë 17.05.2019, *OBU "M"* Tiranë, rezulton: Inspektorët e DR AKU Tiranë kanë konstatuar shkelje mbi bazën e të cilave kanë aplikuar gjoba në vlerën **500,000 lekë** dhe paralajmërim. Gjithashtu inspektorët kanë konstatuar produkte me s,kadencë të kaluar, sipas procesverbalit inspektimit (aty për aty) dhe vendimit ndërmjetëm për masa urgjente date 17.05.2019.
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 500,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti është ankimuar me date 28.05.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën**,** por ka nxjerrë **vendimin 3131/1 datë 01.10.2020 në shkelje afatit ligjor mbi 1 vit për shqyrtimin** e ankesës, çka bën përgjegjës komisionin ankimor dhe drejtorin AKU z. R.L.
Disponohet kërkesa e DRAKU dhe urdhri ekzekutimit dhjetor 2020.

5. *Dosja e inspektimit* datë 22.05.2019, *market "G*" M, Laknas**,** me objekt *indicie nga ankimimet* ku janë konstatuar shkeljet: **ushqime s,kaduara,** mungese dokumentacioni gjurshmerise dhe sende tepërta ne magazine etj, inspektoret e DR AKU Tiranë kane vendosur 3 gjoba për **800,000 lekë**, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit ndërmjetëm për masa urgjente date 22.05.2019..
***Procedura për vjeljen e gjobës*.,** Subjekti është ankimuar me date 29.05.2019 dhe komisioni ankimor ka lënë fuqi gjobën, por **ka nxjerrë vendimin 3163/1 datë 01.10.2020 në shkelje afatit**

ligjor mbi 1 vit për shqyrtimin e ankesës, çka bën përgjegjës komisionin ankimor dhe drejtorin AKU z. R.L.
Subjekti nuk ka likuiduar vullnetarisht gjobën, por ka ngritur padi ne gjykate kundër vendimit komisionit ankimor.
DRAKU ka bere kërkesën ne gjykatën administrative shkallës parë Tiranë nr. 2435, date 16.12.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit të masës administrative, e cila ka lëshuar urdhrin e saj me vendimin nr. 1648, date 23.12.2020 dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi **gjoba 800,000 lekë nuk është likuiduar** nga subjekti **duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.**

6. *Dosja e inspektimit* datë 30.05.2019, *Q, market ushqimor*,Tirane, *inspektim nga indicet ankimimet*..sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 30.05.2019 është konstatuar shkelje **mungese gjurmimi, mangësi në etiketim dhe ambienti ka nevoje për sistemim**, ku janë aplikuar 2 gjoba për **150,000 leke** dhe paralajmërim nga inspektoret e DR AKU Tiranë**.**
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 150,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 08.04.2019 ka marrë gjobën 150,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 12.06.2019 dhe **komisioni ankimor nuk ka vendim** duke shkelur afatin për 1,5 vjet për shqyrtimin e ankesës**, duke rritur mundësitë për parashkrimin e saj.**

***7. Dosja e inspektimit* datë 08.04.2019,** *market ushqimor, L* Tiranë**,** rezulton: Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 08.04.2019 është konstatuar shkelje e nenit 68/1/d të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *"Për Ushqimin"* i ndryshuar, pasi 9.58 kg **produkte janë me afat s,kadence te tejkaluar** dhe nga inspektoret është vendosur gjobe **300,000 leke**, paralajmërim dhe bllokim produkteve jashtë s,kadencës.
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 300,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 08.04.2019 ka marrë gjobë 300,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 19.04.2019 dhe **komisioni ankimor nuk ka vendim** duke shkelur afatin mbi 1,5 vjet për shqyrtimin e ankesës, **duke rritur mundësitë për parashkrimin e saj.**

8. *Dosja e inspektimit* datë 26.04.2019, *market I Synej* Kavaje, rezulton se: Sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar date 26.04.2019, inspektorët inspektorët e DRAKU Tiranë kanë konstatuar **produkte me afat s,kadence te tejkaluar** *(gjalpë, qumësht, kikirik etj)* dhe është vendosur gjobe **400,000 leke**, paralajmërim dhe bllokim, asgjësim ose kthim tek furnitori**.**
Procedura për vjeljen e gjobës. **Gjoba 400,000 lekë nuk është likuiduar,** Subjekti me datë 26.04.2019 ka marrë gjobë 400,000 lekë, DRAKU ka njoftuar subjektin me datë 30.04.2019, subjekti është ankimuar me date 21.05.2019 dhe **komisioni ankimor nuk ka vendim duke shkelur afatin mbi 1,5 vjet për shqyrtimin e ankesës, duke rritur mundësitë për parashkrimin e saj.**

9. *Dosja e inspektimit* datë 22.01.2018 të OBU "*Import ushqim per kafshë A*", e përbërë nga këto dokumente, përkatësisht:
- Autorizim inspektimi datë 22.01.2018, nënshkruar nga drejtori F.S dhe Procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar datë 22.01.2018,
- Procesverbal vendim bllokimi datë 22.01.2018 për 12,5 ton misër për kafshë me nga 50 kg/secili thes, për pa etiketim, pa dokumentacion shoqërues dhe mungese kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ruajtjes. - Listë verifikimi datë 22.01.2018,
- Gjobë 450,000 lekë (*3 gjoba*) sipas faturës datë 22.01.2018,
Shkeljet: Bazuar në nenin 68/1/k të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* i ndryshuar inspektorët e DR AKU Tiranë kanë konstatuar shkeljet sa vijon:

- 12,5 ton misër për kafshë janë **pa etiketim**, në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *" Për Ushqimin "* ndryshuar me ligjin 74/2013, neni 56 dhe 68/b.
- 12,5 ton misër për kafshë kanë **mungesë të kushteve higjeno-sanitare** të ambienteve.
- 12,5 ton misër për kafshë kanë **mungesë të dokumentacionit shoqërues** 12,5 ton.

Masat e marra:
*masa administrative me gjobë 50,000 lekë *(minimale)*, për pa etiketimin e produkteve,
*masa administrative me gjobë 100,000 lekë *(minimale)*, për mungesë dokumentacioni gjurmshmërie.
*dënimi administrativ 300,000 lekë *(minimale)*, për mungesë të kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ruajtjes.
* bllokim i pjesshëm i aktivitetit deri në krijimin e kushteve higjeno-sanitare të ambienteve dhe 12,5 ton misër pa etiketim dhe dokumentacion,

Ri-inspektim: Autorizim ri- inspektimi datë 16.04.2018, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimi datë 22.01.2018, ku është vendosur përsëri gjobë 50,000 lekë për prishje të shenjave dalluese të bllokimit,

Konkluzion:

a. Komisioni i ankimimeve AKU Qendër me vendimin nr. 899/1, datë 14.09.2020 ka shfuqizuar padrejtësisht 3 gjobat e vendosura nga inspektorët për 450,000 lekë, si të pa bazuara plotësisht në ligj pavarësisht se mangësitë qëndrojnë dhe duheshin më të lehta dhe minimale, pasi:
- 3 gjobat kanë qenë minimale dhe shkeljet qëndrojnë dhe janë pranuar nga komisioni ankimimeve.
- vendimi nr. 899/1 datë 14.09.2020 ka dalë me vonesë prej 2,7 vitesh, pasi ankimimi është kryer me datë 05.02.2018, nga 30 ditë që duhej,

***Për pasojë,* vonesa mbi 2 vjet e zbardhjes të këtij vendimi ka sjellë shuarjen e këtyre gjobave "*parashkruhen*", sipas nenit 46 ligjit 10279 datë 20.5.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*".**
Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i ankimimeve dhe drejtori i përgjithshëm AKU dhe kryetar komisionit shqyrtimit ankimimeve z. R.L, A.H, I.A, A.K dhe L.I komisioner.

b. DR AKU Tiranë nuk ka ekzekutuar 3 gjobat për vlerën 450,000 lekë, çka ngarkon me përgjegjësi juristen H.P, drejtori F.S dhe M.M.

10. *Dosja e inspektimit* datë 16.01.2018 të OBU *A* "*Import tregtim ushqim për kafshë*" fshati Gjokaj Vorë, rezulton se nuk disponon dokumentacionin gjurmues dhe paraqet kushte higjeno-sanitare të papërshtatshme, për rrjedhojë është vendosur gjobë **300,000 lekë** dhe bllokim të produkteve deri në plotësimin e kërkesave ligjore, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 16.01.2018.

Procedura për vjeljen e gjobës.
Subjekti ka ankimuar me date 19.01.2018 dhe komisioni ankimor ka lënë në fuqi gjobën sipas vendimit nr. 1919 date 18.05.2020. Komisioni ankimor ka shkelur afatin mbi 2 vjet për shqyrtimin e ankesës, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin dhe drejtorin e AKU z.R.L.
DRAKU ka bere kërkesën ne gjykate nr. 2166 date 04.06.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit të vlerës 300,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit nr.526 date 15.06.2020.
Zyra përmbarimit me shkresën nr. 805/2 datë 26.09.2020 ka njoftuar subjektin për ekzekutim vullnetar te masës administrative, dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi **vlera nuk është arkëtuar nga subjekti.**

11. *Dosja e inspektimit* datë 31.01.**2018** të OBU *A* "*fabrike prodhim, përpunim, shpërndarje,* Vorë-Rinas", ushqim për kafshë, rezulton me probleme, konkretisht: kushte higjeno-sanitare të papërshtatshme, dokumentacion i pjesshëm, mungon raport analiza e produkteve etj.

Inspektorët kanë marrë mostra të ushqimeve të ndryshme për kafshë, ku qumështi për lopë ka rezultuar me **mbi normë të Alfatoksinës B1**, sipas raport analizës 31.01.2018, për pasojë ushqimi në magazinë është bllokuar, ndërsa për atë të tregut është tërhequr nga OBU dhe aktiviteti është ndërprerë, sipas proces-verbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtar datë 31.01.2018 dhe sipas 3 proces-verbaleve vendimit bllokimit datë 31.01.2018. Inspektorët kanë vendosur subjektit 5 gjoba për vlerën **900,000 lekë** sipas faturës nr. 4, datë 31.01.2018.

Procedura për vjeljen e gjobës.

Subjekti ka ankimuar me date 13.2.2018 dhe komisioni ankimor ka lënë në fuqi gjobën sipas vendimit nr. 1224/1 date 26.05.2020.

Komisioni ankimor ka shkelur afatin mbi 2 vjet për shqyrtimin e ankesës, për pasojë vonesa mbi 2 vjet e zbardhjes të këtij vendimi ka sjellë shuarjen e këtyre gjobave "parashkruhen", sipas nenit 46 ligjit 10279 datë 20.5.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*".

Subjekti nuk ka likuiduar vullnetarisht gjobën, por ka ngritur padi ne gjykate gjykata, e cila me vendimin 3131 date 13.07.2020 ka shfuqizuar pjesërisht gjobën nga 900,000 leke ne 400,000 leke.

DRAKU ka bere kërkesën ne gjykate nr. 1520 date 26.8.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit, të vlerës 900,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit nr.852 date 28.08.2020.

DRAKU apelimin e ka kryer me shkresën 1968/1 date 05.11.2020 kundër vendimit gjykatës shkalles pare nr. 3131 date 13.07.2020 (*përgjigjja nga apelimi mungon).*

AKU Qendër ka bere kërkese zyrës përmbarimit, për ekzekutim te masës administrative, dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi **vlera 900,000 lekë nuk është arkëtuar nga subjekti.**

12. ***Dosja e inspektimit*** **datë 18.07.2018**, OBU "*S",* Rruga Siri Kodra Tiranë me aktivitet "Fast-food", rezulton se Inspektorët e DR AKU Tiranë kanë konstatuar shkelje lidhur me kushtet higjeno sanitare të papërshtatshme si dhe të tjera probleme, mbi bazën e të cilave kanë aplikuar gjobë **300,000 lekë** dhe bllokim aktiviteti.

Procedura për vjeljen e gjobës.

Subjekti ka ankimuar me date 24.07.2018 dhe komisioni ankimor ka lënë në fuqi gjobën sipas vendimit 5137/1 date 26.05.2020. **Komisioni ankimor ka shkelur afatin 2 vjet për shqyrtimin e ankesës**.

DRAKU ka bere kërkesën ne gjykate nr. 1453 date 14.8.2020 për lëshimin e urdhër ekzekutimit të vlerës 300,000 leke, e cila ka lëshuar urdhrin sipas vendimit 779 date 02.10.2020 dhe me tej asnjë zgjidhje, pasi **subjekti nuk ka arkëtuar gjobën**.

13. Vendimi komisionit shqyrtimit ankimimeve nr. 4950/1, datë 13.06.2018 nënshkruar nga titullari i AKU dhe kryetar z. A.I, A.D, I.A, A.K, E.C, X.P dhe E.H komisioner ka **shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ**, procesverbalin inspektimit dhe vendimin përfundimtar datë 30.10.2017, gjobën 1,000,000 lekë duke **ngelur 700,000 lekë** *(1,000,000 gjoba-300,000 hequr)* e vendosur ndaj subjektit "*S*" me aktivitet *"prodhim,tregtim vaj ulliri, sallate, luledielli, lëng limonade"* nga inspektorët për shkeljet: ***kushte higjeno-sanitare të papërshtatshme***, ***ambient i pa sistemuar, sistemi i gjurmëshmërisë nuk funksionon, nxjerr në treg produkte me etikete të pa miratuar.***

AKU me shkresën nr. 4950/2, date 26.06.2018 ka njoftuar subjektin ankimues "S" për vendimin nr. 4950/1, datë 13.06.2018, ku i kërkon arkëtimin e gjobës mbetur 700,000 leke, brenda afatit 10 ditë, në të kundërt do vendoset kamatëvonesa, në fakt deri në periudhën e auditimit nuk është arkëtuar gjoba dhe kamatëvonesa,

DR AKU *(A.N)* me vonesë prej 1 vit e gjysmë ka njoftuar subjektin sipas shkresës 4683 datë 16.12.2019, lidhur me mos pagesën brenda 10 ditëve, duke i sqaruar se do i kërkoj lëshimin e urdhër ekzekutimit Gjykatës administrative shkallës pare në rrugë përmbarimore.

Gjykata administrative shkallës pare Tirane ka nxjerre vendimin për lëshimin e urdhrit ekzekutimit, sipas shkresës 459 datë 08.06.2020. Nuk disponohet MA për gjobën e vendosur.

Përfundimisht, Gjoba është vendosur tetor 2017, është shqyrtuar në komisionin ankimues në qershor 2018, urdhri i ekzekutimit është nxjerrë qershor 2020 dhe pas gjithë këtyre procedurave të tej zgjatura prej mbi 3 vjet nuk është arkëtuar gjoba dhe kamatëvonesa dhe subjekti zhvillon aktivitetin i qetë**,** fenomen ky edhe për rastet tjera**,** çka i bën inspektimet të pa vlera dhe ***ngarkon me përgjegjësi juristen H.P, përgjegjësen e financës N.Ç, drejtorin F.S, M.M, A.N dhe M.N.***

14. Vendimi nr. 6462/1, datë 26.12.2018, nënshkruar nga titullari i AKU dhe kryetar komisionit shqyrtimit ankimimeve z.A.I, A.D, I.A, A.K komisioner ka **shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ**, procesverbalin inspektimit dhe vendimin përfundimtar datë 04.09.2017, **gjobën 400,000 lekë** duke **ngelur 100,000 lekë** *(400,000 gjoba-300,000 hequr)* e vendosur ndaj subjektit "*S*" me aktivitet *"tregtim import-export produkte ushqimore dhe jo ushqimore, TEG"* nga inspektorët e DR AKU Tiranë për shkeljet: ***produkte skaduara dhe te dëmtuara, të cilat qëndrojnë brenda marketit,*** duke ndikuar në sigurinë ushqimore.
Praktika dokumentare ka mangësi, pasi **mungon procedura e ndjekjes për arkëtimin e gjobës, ndryshe nga praktika e subjektit "*S*" e cila është e kompletuar.**

15. Vendimi nr. 2531/1, datë 11.04.2019 i nënshkruar nga z. A.H ka **shfuqizuar aktin administrativ**, procesverbalin inspektimit dhe vendimin përfundimtar datë 08.05.2017, **gjobën 200,000 lekë** e vendosur ndaj subjektit "*R*" me aktivitet "*kopsht për fëmijë*" nga inspektorët e drejtorise rajonale Tiranë per shkeljet: ***mungesë analizash bakteriologjike të ujit rrjetit, mungesë e dokumentacionit shoqërues, mungesë e planit HACCP dhe tejkalim afati të librezës shëndetësore***. Theksojmë se **këto shkelje qëndrojnë**, pavarësisht se subjekti disa raport analiza i ka siguruar pas periudhës se inspektimit dhe nga komisioni janë marrë parasysh, por inspektorët kanë gjykuar drejt ne momentin e inspektimit.
Praktika dokumentare ka mangësi, pasi **mungon procedura e ndjekjes për arkëtimin e gjobës** ndryshe nga praktika e subjektit "*S*" e cila është e kompletuar.

16. Vendimi AKU nr. 1930, datë 18.05.2020 i nënshkruar nga R.L **ka shfuqizuar aktin administrativ**, procesverbalin inspektimit dhe vendimin përfundimtar datë 12 dhe 13.09.2018, **gjobën 800,000 lekë** ndaj subjektit **"***B Group***"** me aktivitet *"tregtim import- export Vore"* nga inspektorët e DR AKU Tiranë për shkeljet: ***pa siguri ushqimore, etiketë jo e plotë, pa datë prodhimi dhe skadimi 8000 kg tërshëre e trashë, e imët*"**, rezulton se:
AKU ka hedhur poshtë vendimin e tij nr. 1930, datë 18.05.2020, pasi me shkresën nr. 2717, date 01.07.2020 ka bërë kërkesë Gjykatës administrative shkallës parë për lëshimin e urdhër ekzekutimit dhe përllogaritjen e 2 % kamatëvonesave, ku gjykata ka miratuar kërkesën me vendimin nr. 592 datë 08.07.2020.
Me shkresën nr. 3497/1, date 18.08.2020 AKU ka bërë kërkesë zyrës përmbarimit, për fillimin e ekzekutimit të gjobës, *ku më tej nuk ka dokumente për ecurinë dhe vjeljen e gjobës.*
Përfundimisht, **AKU me vendimin 1930, datë 18.05.2020 ka pranuar kërkesën ankimore subjektit *"B Group"* dhe ka shfuqizuar gjobën 800,000 lekë, ndërsa pa objekt ka kërkuar gjykatës lëshimin e urdhrit ekzekutiv dhe kamatëvonesat, duke cituar të kundërtat e vendimit 1930*, rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien ne fuqi akteve.***

17. ***<u>Dosja e inspektimit</u>*** **datë 29.05.2019** *G* **"***tregti me shumice e pakice***"** *Kashar,* AKU-TR-2019-003059, inspektim ne zbatim urdhrit ministrit e drejtorit, ku janë konstatuar shkeljet: **mungese e gjurmshmërisë për 2016- 2017** s,ka asnjë dokument për **vajin e palmës** dhe ne rastet qe ka shitur mungon emri, mbiemri identiteti i blerësit, ku nga inspektoret e DR AKU Tiranë janë vendosur **2 gjoba me nga 200,000 leke/***secila*, sipas procesverbalit inspektimit dhe vendimit përfundimtarë date 30.05.2019.
Procedura për vjeljen e gjobës.

Gjoba 400,000 lekë nuk është likuiduar. Subjekti me datë 30.05.2019 ka marrë gjobë 400,000 lekë, subjekti është ankimuar me date 03.06.2019 dhe **komisioni ankimor shqyrtimin e ankesës e ka kryer me vonesë mbi 1 vit nga 30 ditë që duhej,** sipas vendimit nr. 3338/1 datë 01.10.2020**,** ku ka **lënë në fuqi gjobën e vendosur**.
DR AKU deri 31.12.2020 nuk ka bërë kërkese ndaj gjykatës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv për masën administrative, për rrjedhojë vazhdon tejzgjatja e procedurës për likuidimin e gjobës vendosur, ***çka ngarkon me përgjegjësi juristen H.P dhe drejtorin M.N, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.***
Theksojmë se disponohet shkresa "*kërkim dokumentacioni*" ne adrese të Postes Shqipëtare nr. 120 date 20.01.2021, lidhur me njoftimin e subjektit, por ajo i përket vitit pasardhës 2021, ndërsa çështja i përket vitit 2020, *ky fenomen edhe për disa subjekte tjera*. Njëkohësisht njoftimi i subjektit duhet kërkuar brenda institucionit dhe jo nga Posta.

Veprimet dhe mosveprimet në praktikat e mësipërme të inspektimit, rast pas rasti, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Ligjin nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
-Ligjin nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
-Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
-Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat";
-Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
-Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar;
-VKM nr. 696 datë 16.08.2013;
-VKM nr.1081, datë 21.10.2009 "Mbi organizimin dhe funksionimin e AKU", i ndryshuar;
-VKM nr.760, date 19.09.2015 "Për kërkesat e gjurmimit ushqimit dhe ushqimit për kafshe përgjatë zinxhirit ushqimor";
-Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
-Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH";
-Rregulloren e brendshme të AKU-së.

2.6. Auditim mbi funksionin e inspektimit të sektorit të inspektimit të mbrojtjes së bimëve.
Mbi auditimin e ushtruar në **DR AKU** për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020, në baze te programit te auditimit nr. 1153/1, date 05.01.2021, i ndryshuar me 1153/2, datë 06.01.2021, i ndryshuar me 1153/3, datë 03.02.2021 **mbajtur në datë 05.03.2021**.
Në zbatim të pikave të programit të auditimit nr. 1153/1, date 05.01.2021 u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:
1. Dosjet e MBIB për asgjësimet e produkteve asgjësuara, me zgjedhje sipas ndarjes detyrave, për periudhën 2018-2019-2020.
2.Shkresat dhe evidenca te ndryshme lidhur me asgjësimet e produkteve asgjësuara për periudhën 2018-2019-2020.
3. Dosjet e MBIB me zgjedhje sipas ndarjes detyrave, për periudhën 2018-2019-2020.
4. Dokumente tjera.

PMB
Nga auditimi i praktikave të inspektimet për subjektet qe ushtrojnë veprimtarinë e importit dhe tregëtimit të PMB, konstatohet se në mungon lista e produkteve që tregtohen duke mos vërtetuar n.q.s. këto produkte janë brenda listës së miratuar nga SPMB në Ministrinë e Bujqësisë të përcaktuar në Ligjin 105/2016, kreu V, neni 19, pika 1, 2 dhe 3.

Për sa i përket PIK, DRAKU nuk ka kryer asnjë inspektim për importin e PMB pasi nuk ka pasur hyrje në PIK e Qarkut Tiranë.

Analizimi i PMB-ve.

Nuk është kryer analizimin i PMB për vitin 2018 në asnjë nga subjektet e inspektuar, nga laboratori i akredituar siç parashikohet në ligjin 105/2016 kreu II, pika 1.2, germa a, b dhe c.

Moskryerja e analizimit ka bërë të mundur hedhjen që PMB-t për përdorim në vendin tonë nuk i nënshtrohen asnjë analizë laboratorike të formulimit për të parë vetitë e tyre fiziko – kimike, përbërjen e lëndës vepruese dhe përmbajtjen e saj në % apo g/L, përbërjen dhe përmbajtjen e lëndëve mbushëse (inerte) si dhe përbërjen e aditivëve që ju shtohen formulimeve, rrjedhimisht këto PMB nuk kalojnë paraprakisht në testet laboratorike dhe në terren për të parë veprimin e tyre në kushtet aktuale të vendit tonë.

1. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 211/5 prot, datë 20.02.2018, për subjektin m me veprimtari "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve", konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Proces-verbalit të Inspektimit dhe Vendimit përfundimtar nr. serial 0007222, nuk ka shkelje të kërkesave ligjore nga ana e subjektit. Autorizim Inspektimi është i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët A.Sh dhe D.K.
2. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 579/4 prot, datë 12.06.2018, me objekt inspektimi marrjen e mostrave bazuar në planin vjetor për marrjen e mostrave, konstatohet se janë marrë mostra për dy produkte, përkatësisht PYRINEX 48 EC dhe PISION për analizimin e lëndës aktive dhe janë dërguar për analizim tëk ISUV. Produktet e mostrave të marra janë të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar ne RSH. Gjatë shqyrtimit të praktikave të tjera nuk rezultojnë përgjigjet për analizën e këtyre produkteve.
3. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 691/4 prot., datë 12.07.2018 për subjektin K me nr. NIPT L01327039U për veprimtarinë "tregëtimi me pakicë i PMB-ve", është konstatuar se veprimtaria kryhet me persona të cilët nuk janë ta pajisur me licencë, . Për shkak të shkeljes së konstatuar DRAKU Tiranë ka vendosur masën administrative gjobë me vlerën 200.000 Lek sipas nenit 28, pika1, germa ç në proces-verbalin dhe vendimin që mbajnë nr. serial 0007073. DRAKU ka bërë kërkesën për lëshim të urdhër ekzekutimit me dokumentin nr. prot. 4031, datë 06.08.2019 por në këtë praktik nuk administrohet fatura e lëshuar nga DRAKU Tiranë për kamat vonesat ne masën 2 % te vlerës se gjobës për çdo muaj vonese(13 muaj, 52,000lek) **.** Gjykata Administrative e shkallës së parë, me vendimin nr. regj. 1538(31134-05261-80), datë 19.09.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për proces-verbalin dhe vendimin përfundimtar Nr. 0007073, datë 12.07.2018 të DRAKU Tiranë dhe ka urdhëruar Zyrat e Përmbarimit për ekzekutimin e këtij vendimi. ***Në praktikën e inspektimit mungon ndjekja nga zyra e përmbarimit bazuar në pikën 4 të urdhrit nr. 1586, datë 28.04.2016.***
4. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2018-002380-1, datë 18.07.2018 me nr. Prot. 725/4 për subjektin R me nr. NIPT K82618801C për veprimtarinë "tregëtimi me pakicë i PMB-ve", është konstatuar se veprimtaria kryhet me persona të cilët nuk janë ta pajisur me licencë, në kundërshtim me nenin 20, pika 3 të ligjit 105/2016 datë 27.10.2016 "për Mbrojtjen e Bimëve". Për shkak të shkeljes së konstatuar DRAKU Tiranë ka vendosur masën administrative me gjobë në vlerën 200.000 Lek sipas nenit 28, pika 1 germa ç në ligjin 105/2016, datë 27.10.201 me proces-verbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar Nr. 002380-2-5, datë 18.07.2018 . DRAKU Tiranë ka bërë kërkesën për lëshim urdhër-ekzekutim për masën administrative me dokumentin nr. Prot. 4574, datë 02.02.2019 por në këtë praktik nuk administrohet fatura e lëshuar nga DRAKU Tiranë për kamat vonesat ne masën 2 % te vlerës se gjobës për çdo muaj vonese (13 muaj/52,000 lekë) **.** Gjykata Administrative e shkallës së parë, me vendimin nr. regj. 2025(7222), datë 12.12.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar Nr. 002380-2-5, datë 18.07.2018 të DRAKU Tiranë dhe ka urdhëruar Zyrat e Përmbarimit për ekzekutimin e këtij vendimi. Subjekti ka bërë padi duke kërkuar konstatimin e

pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, por gjykata ja ka rrëzuar kërkesën e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5. Nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit me nr. 53/1 prot., datë 15.01.2018 për subjektin H me nr. NIPT K51607002R për veprimtarinë "tregëtimi me pakicë i PMB-ve" është konstatuar se gjatë inspektimit subjekti ka qenë i mbyllur por nuk është dokumentuar në praktikat e inspektimit. L.B/T.K

6. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr.119/1 prot, datë 29.01.2018 për subjektin A me nr. NIPT J61918010D për veprimtarinë "importi dhe tregëtimi me shumicë i PMB-ve", konstatohet se në subjekt ka pasur gjendje PMB (Arvak) të cilat nuk janë të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë në periudhën kur është bërë inspektimi. DRAKU Tiranë ka vepruar . Praktika është kryer nga inspektorët: S.Rr, T.K dhe A.Sh.

7. Nga shqyrtimi i praktikës së inpektimit me nr. 186/1 prot., datë 13.02.2018 për subjektin L SHPK me nr. NIPT J64103632Ë për veprimtarinë "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve", konstatohet se listë-verifikimi nuk është i plotësuar në të gjitha pikat e tij për kërkesat e ligjit 105/2016, neni 20, pika 6, germa a dhe b.

8. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr.599/1 prot., datë 18.06.2018, për subjektin S me nr. NIPT K31506063L për veprimtarinë "tregëtimi me pakicë i PMB-ve" konstatohet se në inspektimin e bërë nga indiciet e veçanta me autorizim inspektimi nr. AKU-TR-2018-001637-1, miratuar nga kryeinspektori rajonal **M.M, përpunuar nga inspektorët L.B dhe S.Rr** është vendosur dënim administrativ me gjobë në vlerën 100.000 Lek për shkeljen e nenit 20.2 të ligjit 105/2016 "Tregëtimi me shumicë dhe pakicë i PMB-ve bëhet nga persona fizikë, të diplomuar në fushën e agronomisë, ose nga persona juridikë, të cilët duhet të punësojnë një ose disa persona, teknikë përgjegjës, të cilët janë diplomuar në këtë fushë". Gjobë 100 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 2, të nenit 14; nenin 15; pikat 2 e 6, të nenit 20; nenin 21; pikat 2 e 3, të nenit 23;dhe pikën 4, të nenit 24, **të ligjit 105/2016 "për Mbrojtjen e Bimëve".** Subjekti ka bërë ankimin në DPAKU në datën 21.06.2018 ku pas shqyrtimit nga komisioni është vendosur: rrëzimi i kërkesës ankimore dhe lënia në fuqi e aktit administrativ. Subjekti ka bërë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ e cila është rrëzuar nga gjykata si e pabazuar në ligj dhe në prova me Vendimin nr. 4424, datë 05.12.2018, nr. regj. Them 4265(31154-05257-80). DRAKU Tiranë ka bërë kërkesën për lëshim të urdhër ekzekutimit datën 27.05.2019 në kundërshtim me pikën 1 dhe 14 të urdhrit nr. 69, datë 04.02.2016 "për vënien në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit sipas vendimeve të gjykatave përkatëse", 1.*"Brenda 5(pesë) ditëve që Vendimin gjyqësor i cili ka lënë në fuqi masën administrative ka marrë formë të prerë, drejtoritë rajonale do të paraqesin pranë gjykatave Administrative të Shkallës së parë përkatëse për lëshim urdhri ekzekutiv" dhe në kundërshtim të pikës* 14. Nëse subjekti nuk i drejtohet gjykatës dhe njëkohësisht mbarojnë afatet ligjore të animimeve, atëherë fillimisht DR fillojnë përpjekjet për arkëtimin e gjobës në mënyrë vullnetare dhe ky proces është i vazhdueshëm. ***Në kërkesën për lëshim të urdhrit të ekzekutimit duhet detyrimisht që të kërkohen edhe kamat-vonesat dhe për këtë kërkesë, ti kërkohet gjykatës që të shprehet.*** Pas kërkesës së barë nga DRAKU për lëshim të urdhrit ekzekutiv, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. regj. Them. 1123, datë 03.06.2019 ka vendosur: pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhër ekzekutimit për masën administrative dhe urdhërimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi. DPAKU ka bërë kërkesën për vënien në ekzekutim të masës administrative, drejtuar zyrës përmbarimore private R.B.S më shkresën nr. prot. 3521, datë 18.08.2020. DRAKU Tiranë nuk ka bërë kërkesën për përfshirje të kamat-vonesave (16 muaj/48,000 lekë),

9. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-007144-1, datë 08.11.2019, për subjektin E me nr. NIPT L62804803A për veprimtarinë "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve", konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit Përfundimtar, subjekti nuk ka

shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal A.N dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K dhe D.K.
10. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-002221-1, datë 18.04.2019, konstatohet se nuk është bërë i plotë plotësimi i Listë-verifikimit nga ana e inspektorëve. Referuar vendimit përfundimtar subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektoret T.K, E.Gj dhe D.K.
11. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-001199-1, datë 28.02.2019 për subjektin M me nr. NIPT K26625601E për veprimtarinë "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve", konstatohet se subjekti ka është furnizuar me 3 produkte PMB përkatësisht Merpan 80ËG(5000kg), Shavit F(2000kg) dhe Mavrik 2F(600Litër), të importuara nga Izraeli në PIK Port-Durrës në datën 14.02.2019, bazuar në proces verbalin me nr. serial 0000596, 1 produkt PMB përkatësisht Carakol(20000kg) të importuar nga Italia në PIK Port-Durrës në datën 15.02.2019, bazuar në proces verbalin me nr. serial 0001741 dhe 2 produkte PMB përkatësisht Ecoram 20ËP dhe Nitropol S të importuara nga Greqia në datën 20.02.2019, bazuar në proces-verbalin me nr. serial 0000316. Për produktet PMB të importuara në RSH bazuar në pikën 1.a, kreu 10 të VKM-së Nr.1188, datë 20.8.2008 "për miratimin e rregullave për importimin, tregëtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve", duhet të ishte bërë marrja e mostrave për produktet në fjalë. ***10. kontrolli cilësor i produkteve për mbrojtjen e bimëve***
1. Kontrolli cilësor i PMB-ve bëhet:
a) për PMB-të, që importohen, mostrat e të cilave merren nga inspektorët e karantinës, në pikat e kalimit kufitar, për çdo parti të PMB-së; Autorizim Inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe D.K.
12. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-001553-1, datë 19.03.2019, konstatohet se është bërë marrje mostre për 2 produkte PMB, përkatësisht Merpan 80 ËG dhe Aviator. Produktet janë dërguat për analizim tek ISUV por nuk ka përgjigje për rezultatet e analizave. ***DRAKU ka vepruar në kundërshtim me pikën 4, kreu V të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë": pasi nuk ka njoftuar subjektin për rezultatet e analizës.*** Autorizim Inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe D.K.
13. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-002291-1, datë 24.04.2019, konstatohet se është bërë marrje mostre për produkt PMB, përkatësisht Pyrinex 48EC. Produktet janë dërguat për analizim tek ISUV por nuk ka përgjigje për rezultatet e analizave. ***DRAKU ka vepruar në kundërshtim me pikën 4, kreu V të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë": pasi nuk ka njoftuar subjektin për rezultatet e analizës.*** Autorizim Inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K, E.GJ dhe D.K.
14. Nga shqyrtimi i praktikës së inpsektimit me nr. AKU-TR-2019-002718-1, datë 14.05.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit Përfundimtar, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.
15. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-008041-1, datë 03.12.2019 me objekt inspektimi verifikimin e kërkesave ligjore të PMB-ve, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe bazuar Vendimit Përfundimitar subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim Inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal A.N dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr, E.GJ dhe D.K.
16. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektnmit me nr. AKU-TR-2019-005786-1, datë 22.01.2019 për subjektin E me nr. NIPT L52101213C me veprimtarin "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve" konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar me nr. AKU-TR-

2019-005786-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal D.D dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K dhe S.Rr.
17. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-000324-1, datë 11.09.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar me nr. AKU-TR-2019-005786-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët B.Q dhe S.Rr.
18. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-000459-1, datë 28.01.2019 për subjektin L me nr. NIPT J64103632Ë për veprimtarinë "Tregëtimi me pakicë i PMB-ve", konstatohet se inspektimi është bëre i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar nr. AKU-TR-2019-000459-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.
Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-0003293-1, datë 05.06.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.
19. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-001388, datë 07.03.2019, për subjektin A me nr. NIPT K01508002O me veprimtarinë "prodhimi dhe tregëtimi i MMSHB dhe bimëve zbukuruese", konstatohet se inspektimi është bërë i rregullt dhe referuar Vendimit përfundimtar subjekti nuk ka shkelje të kërkesve ligjore. Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe D.K.
20.Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-003177-1, datë 30.05.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.
21.Nga shqyrtimi praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-000156-1, datë 15.01.2019, për subjektin E me nr. NIPT L32327004K me veprimtari "Tregëtimin me pakicë të PMB-ve", konstatohet se inspektimi eshtë bërë i rregullt dhe referuar Vendimit Përfundimtar me nr. AKU-TR-2019-000156-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K dhe S.Rr.
22. Nga shqyrtimi praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-002654-1, datë 10.05.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i rregullt dhe referuar Vendimit Përfundimtar me nr. AKU-TR-2019-002654-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është i miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K, E.GJ dhe D.K

MMSHB

Për inspektimin e MMSHB (materiali mbjellës dhe shumëzues bimor) janë kryer 274 inspektime nga të cilat janë asgjësuar 11.229 ton dhe janë marrë masa administrative me vlerë 120.000 lekë. Nga 36 mostra të marra për MMSHB nuk kanë rezultuar me tregues cilësor brenda normës së lejuar 4 mostra për të cilat është marrë masa administrative me gjobë dhe 2 të tjera janë pa përgjigje.
23. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 1 prot., datë 03.01.2018 për subjektin A me nr. NIPT L07003004D për veprimtarinë "importi dhe tregëtimi me shumicë i MMSHB-ve", konstatohet se nga përgjigja e analiza e fuqisë mbirëse të farës së spinaqit e cila ka dalë jashtë standardit. DRAKU ka marrë masën me gjobë në vlerën 40.000 për shkeljen e konstatuar , e cila është likuiduar dhe është bërë akt-bllokimi i 20(kuti) x 1(kg)=(20kg) me nr. 0000004, datë 03.01.2018. Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe D.K.
24. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 99/5, datë 25.01.2018 për të njëjtin subjekt është konstatuar një sasi prej 7 ton farë misri hibrid për të cilin subjektit i është lënë detyrë të ri analizoj treguesit e fuqisë mbirëse por nuk ka bërë akt-bllokimin për farën deri në momentin e daljes së analizës. DRAKU Tiranë nuk ka kryer me asnjë inspektim për këtë çështje. Autorizim-

inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët A.Sh dhe D.K.

25. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 129/1, datë 31.01.2018 konstatohet se në subjekt nuk është nuk është gjetur administratori. është bërë afishimi i autorizimit ambientet e subjektit, i cili është pasqyruar në proces verbalin dhe vendimin përfundimtar me nr. serial 0007334, datë 31.01.2018. Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe D.K.

26. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. 240/1, datë 28.02.2018 për ri-inspektimin e detyrave të lëna nga inspektimi i datës 25.01.2018 për ri-analizimin e farës së misrit hibrid, konstatohet se ende nuk janë marrë përgjigjet e analizës. Në proces-verbalin dhe vendimin përfundimtar me nr. serial 0007446 DRAKU Tiranë ka vendosur që subjekti të mos e tregtoj farën deri në daljen e analizës por përsëri nuk ka bërë akt-bllokimin e farës. Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe D.K.

27. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr.421/1, datë 26.04.2018 për ndjekjen e gjurmueshmërisë, referuar rezultatit të analizave të fuqisë mbirëse, nga mostrat e marra në një subjekt tjetër i cili ishte furnizuar në subjektin A, është konstatuar se nga sasia e farës së misrit LG 30600 me nr. loti: F0964B021584SM prej 5632.3 kg e ardhur në janar 2018 është shitur e gjitha. **DRAKU nuk ka bërë marrjen e mostrës, kjo në kundërshtim me pikën 4, neni 24 të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 "për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".** Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

28. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 424, datë 27.04.2018 në vijimësi të inspektimit 424, datë 27.04.2018, është bërë marrja e mostrës për farën e misrit VAR. LG 30600(LANDERO) LOT F0964B0215855SM(120kg) dhe VAR LG 30600 LOT F0964B021583SM(5000KG). DRAKU ka bërë bllokimin e të dy LOT me akt-bllokimin nr. 0000009, datë 27.04.2018. Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe F.F.

29. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 460/1, datë 08.05.2018, për inspektimin referuar analizave të ardhura nga ESHFF për mostrat e marra në datën 27.04.2018, konstatohet se pas rezultatit të ardhur nga ESHFF me fletë analizën nr. 277 dhe 276 datë 07.05.2018 dhe 276 mostrat e marra kanë dalë brenda normës së lejuar. DRAKU ka bërë zhbllokimin e sasisë që ndodhet në magazinën e subjektit. Autorizim-inspektimi i miratuar nga drejtori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe F.F.

30. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2018-001255-1, datë 25.05.2018 për inspektimin për zbatimin e kritereve ligjore për prodhimin dhe tregëtimin e MMSHB-ve, konstatohet se **inspektorët L.B dhe D.K** nuk kanë bërë plotësimin e listë-verifikimit. Në proces verbalin e inspektimit në rubrikën Vendimin Përfundimtar i veçantë shkruhet se në momentin e inspektimit subjekti nuk po prodhon dhe tregëton MMSHB(fidan perimor). Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe D.K.

31. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 739/3, datë 20.07.2018 për inspektimin për verifikimin e kërkesave ligjore për aktivitetin e MMSHB-ve, konstatohet se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore, listë-verifikimi dhe proces verbali i inspektimit janë të plotësuar. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr.

32. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 1052/2, datë 01.11.2018 për inspektimin për verifikimin e kërkesave ligjore në importimin dhe tregëtimin me shumicë të MMSHB-ve, konstatohet se nuk është bërë plotësimi i Listë-verifikimit. Nga vendimi përfundimtar nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

33. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimi me nr. AKU-TR-2019-001200-1, datë 28.02.2019, për subjektin M me nr. NIPT K26625601E për veprimtarinë "Tregëtimi i MMSHB-ve dhe bimëve zbukuruese", konstatohet se inspektorët kanë bërë marrje mostre, farë jonxhe për analizimin e fuqisë mbirëse e cila është dërguar tek ESHFF në datën 28.02.2019. Nga përgjigja e analizës me nr. 63, datë 12.03.2019, rezulton se fuqia mbirëse e produktit është nën normë(77.25%), ku fuqia mbirëse minimale e produktit (jonxhe) duhet të jetë 80%.
34. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-002721-1, datë 14.05.2019 për inspektimin e kërkesave ligjore konstatohet, referuar Listë-verifikimit me nr. AKU-TR-2019-002721-2 se subjekti në momentin e inspektimit nuk ka gjendje të MMSHB-ve, e cila nuk është e pasqyruar në praktikën e inspektimit . Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët E.GJ, D.K dhe T.K.
35. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe T.K. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-005078-1, datë 09.08.2019 për inspektimin e kërkesave ligjore konstatohet, referuar Listë-verifikimit me nr. AKU-TR-2019-002721-2 se subjekti në momentin e inspektimit nuk ka gjendje të MMSHB-ve. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe T.K.
36. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 211/3, datë 20.02.2018 me subjekt "M" me nr. NIPT K26625601E për veprimtarinë "Importi dhe tregëtimi me shumicë të mmshb-ve" rezulton se në subjektin e sipërpërmendur gjatë inspektimit nuk janë gjetur MMSHB në ambientet e subjektit. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.
37. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 434/2, datë 30.04.2018 me objekt inspektimi ndjekjen e gjurmëshmërisë referuar evidencës së marrë nga subjekti A mbi shpëërndarjen e farës së misrit në datë 27.04.2018. Subjekti M është furnizuar me farë misri nga subjekti A, LG 30600 me nr. loti: F0964B021584SM prej 5632.3 kg e ardhur në janar 2018, në sasinë 1000 kg prej dhe nga e cila në momentin e inspektimit kanë ngelur 30 kg për të cilat është bërë bllokimi me Akt-bllokim nr. 0000012, datë 30.04.2018. Pjesa tjetër është shitur fermerëve të zonës së Kavajës, ku bashkëlidhur me praktikën e inspektimit është lista e blerësve. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe F.F.
38. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 467/2, datë 10.05.2018 me objekt inspektimi, zhbllokimin e farës së misrit referuar përgjigjes së analizave, konstatohet se inspektorët kanë bërë zhbllokimin e sasisë prej 30 kg të bllokuar në subjektin M pas përgjigjes së analizës të ESHFF nr. 277, datë 07.05.2018 për VAR. LG 30600(LANDERO) LOT F0964B0215855SM(120kg) dhe VAR LG 30600 LOT F0964B021583SM(5000KG). Sasia e cila është zhbllokuar në subjektin M nuk është e të njëjtit LOT nga e cila ka dal analiza, pasi në subjektin A nuk është bërë marrja e mostrës për këtë LOT por për një tjetër LOT me të njëjtin varietet. **DRAKU Tiranë nuk duhet të kishte bërë zhbllokimin e sasisë së farës së misrit pasi *"Kur nga inspektimi i kryer ose nga analizat e mostrave të marra rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor nuk plotëson kërkesat e përcaktuara, furnizuesit i ndalohet nxjerrja në treg e këtij materiali mbjellës dhe shumëzues bimor".*** Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.
39. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit nr. 843/2, datë 22.08.2018 me objekt inspektimi, verifikimin e kërkesave ligjore për tregëtimin me shumicë të MMSHB-ve, konstatohet se nuk është bërë plotësimi i Listë-verifikimit. Në vendimin përfundimtar konstatohet se subjektit nuk janë gjetur shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.
40. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 1159/2, datë 14.12.2018 për verifikimin e kërkesave ligjore për tregëtimin e MMSHB-ve, konstatohet se nuk është bërë plotësimi i Listë-

verifikimit. Në vendimin përfundimtar konstatohet se subjektit nuk janë gjetur shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

41. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit Nr. AKU-TR-2018-000173-1, datë 22.02.2018 subjekti M me nr. NIPT K838074201L për veprimtarinë "Importimi dhe Tregëtimi me shumicë i MMSHB-ve" është konstatuar se në momentin e inspektimit nuk janë gjetur MMSHB në ambientet e subjektit, sipas proces-verbalit të inspektimit me nr. serial 0007389, datë 22.02.2018 të mbajtur nga inspektoret T.K dhe D.K. , konstatohet se nuk është bërë plotësimi i Listë-verifikimit. Në vendimin përfundimtar konstatohet se subjektit nuk janë gjetur shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët D.K dhe T.K.

42. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 434, datë 30.04.2018 me objekt inspektimi ndjekjen e gjurmëshmërisë referuar evidencës së marrë nga subjekti A mbi shpërndarjen e farës së misrit në datë 27.04.2018. Subjekti M është furnizuar me farë misri nga subjekti A, LG 30600 me nr. loti: F0964B021584SM prej 5632.3 kg e ardhur në janar 2018, në sasinë 1000 kg prej dhe nga e cila në momentin e inspektimit kanë ngelur 304 kg për të cilat është bërë bllokimi me Akt-bllokim nr. 0000011, datë 30.04.2018. Pjesa tjetër është shitur fermerëve të zonës së Kavajës, ku bashkëlidhur me praktikën e inspektimit është lista e blerësve. Autorizim-inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët F.F dhe L.B.

43. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 467/1, datë 10.05.2018 me objekt inspektimi zhbllokimin e farës së misrit referuar përgjigjes së analizave, konstatohet se inspektorët kanë bërë zhbllokimin e sasisë prej 30 kg të bllokuar në subjektin MBM pas përgjigjes së analizës të ESHFF nr. 277, datë 07.05.2018 për VAR. LG 30600(LANDERO) LOT F0964B0215855SM(120kg) dhe VAR LG 30600 LOT F0964B021583SM(5000KG). Sasia e cila është zhbllokuar në subjektin M nuk është e të njëjtit LOT nga e cila ka dal analiza, pasi në subjektin A nuk është bërë marrja e mostrës për këtë LOT por për një tjetër LOT me të njëjtin varietet. **DRAKU Tiranë nuk duhet të kishte bërë zhbllokimin e sasisë së farës së misrit pasi *"Kur nga inspektimi i kryer ose nga analizat e mostrave të marra rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor nuk plotëson kërkesat e përcaktuara, furnizuesit i ndalohet nxjerrja në treg e këtij materiali mbjellës dhe shumëzues bimor".*** Autorizim-inspektimi i miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

44. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 632/1, datë 26.06.2018 me objekt inspektimi verifikimin e kërkesave ligjore në importin dhe tregëtimin me shumicë të MMSHB-ve, konstatohet se nuk është bërë plotësimi i plotë i Listë-verifikimit

45. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit Nr. Prot. 329/1, datë 29.03.2018 për subjektin A me nr. NIPT J61918010D për veprimtarinë "importi dhe tregëtimi me shumicë i MMSHB, konstatohet se gjatë inspektimit të kryer referuar e-mail-t të ardhur nga sektori fitosanitar i PIK-ut Qafë-Thanë, në magazinën e subjektit gjendet sasia prej 4456.95 kg farë misri e bllokuar nga PIK-Qafë-Thanë me Proces-verbal Bllokimi dhe Vendimi nr. 000357, datë 27.03.2018 deri në daljen e përgjigjes së analizave. Gjithashtu është bërë bllokimi me nr. serial 0000005, datë 29.03.2018 i sasisë prej 19.853 kg e ardhur në datën 11.03.2018 me lotët 716-15 dhe 715-15 të cilat kanë rezultuar nën normë referuar përgjigjes së analizave të ardhura nga ESHFF.

46. Nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit me nr. prot. 10/4 dhe 10/3 datë 05.01.2018 për subjektin A me nr. NIPT L01719012O për veprimtarinë "importi dhe tregëtimi i MMSHB-ve" dhe "importi dhe tregëtimi me shumicë i PMB-ve" është konstatuar se gjatë inspektimit subjekti ka qenë i mbyllur por nuk është dokumentuar në praktikat e inspektimit. L.B/T.K.

47. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 145/1, datë 02.02.2018 për subjektin A me nr. NIPT L13329801V për veprimtarinë "Prodhimi dhe Tregëtimi i MMSHB", konstatohet se

inspektorët nuk kanë plotësuar listë verifikimin me nr. AKU-TR-2018-000062, datë 02.02.2018 për kërkesat e;
Praktika e inspektimit është bërë nga inspektorët L.B dhe T.K.
48. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 286/2, datë 15.03.2018 për subjektin A me nr. NIPT K01508002O për veprimtarinë "prodhimi dhe tregëtimi me shumicë të MMSHB-ve", konstatohet se grupi i inspektimit i përbërë nga: L.B dhe T.K bie ne kontradiktë me deklarimin e bërë në procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar me nr. serial 0007159, kur deklarojnë se MMSHB janë të regjistruara dhe plotësojnë kriteret ligjore për vendosjen e tyre në treg dhe më pas se subjekti tregëton dhe prodhon vetëm bimë dekorative të ndryshme. Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B, T.K).
49. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 508/4, datë 23.05.2018 konstatohet se inspektorët nuk kanë bërë plotësimin e kritereve të listë-verifikimit për kërkesat e:
Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika e inspektimit është përpunuar nga inspektorët F.F dhe T.K.
50. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 1169/1, datë 19.12.2018, konstatohet se inspektimi është kryer i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar nr. AKU-TR-2018-005008-5, datë 19.12.2018 nuk ka shkelje të kërkesave ligjore nga ana e subjektit. Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.
51. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 333/1, datë 30.03.2018 për subjektin F me nr. NIPT J72902836N për veprimtarinë "Prodhimi dhe Tregëtimi i MMSHB", konstatohet se inspektorët nuk kanë plotësuar listë verifikimin me nr. AKU-TR-2018-000574, datë 30.03.2018 prë kërkesat e;
- Praktika e inspektimit është bërë nga inspektorët D.K dhe T.K.

52. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 137/4, datë 01.02.2018, për subjektin A me nr. NIPT J97326615B për veprimtarinë "Import dhe tregëtimi me shumicë i MMSHB-ve", konstatohet se autorizim inspektimi është i pa miratuar nga kryeinspektori rajonal. Nuk është bërë plotësimi i listë verifikimit. Referuar vendimit përfundimtar nuk ka shkelje të kërkesave ligjore nga ana e subjektit. Autorizimi inspektimi është i pa firmosur nga kryeinspektori rajonal dhe praktika është përpunuar nga inspektorët T.K dhe L.B.
53. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 199/4, datë 16.02.2018 me objekt inspektimi marrje mostre, konstatohet se është bërë marrja e mostrës për farën e misrit (var-morava) nga LG-30325-LOT-599SM(3013KG) e ndarë në 251 thasë x 12.004 kg. Mostrat janë dërguar për analizim në datën 19.02.2018 ***<u>në kundërshtim me pikën 6, neni 40 të udhëzimit nr. 107, datë 2.12.2002</u>*** "për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor". Nga përgjigja e ardhur në datën 26.02.2018, konstatohet se fuqia mbirëse e farës së misrit është në normë.
54. Nga shqyrtimi i praktikës së inspëkrimit me nr. prot. 391, datë 18.04.2018, konstatohet se është bërë marrja e mostrës së misrit për 3 lote;
LG 3350 lot-H-17-094/0549 me sasinë 861.8kg/;
LG 3395 lot-H-18-094/0166 me sasinë 7893.6kg/;
ANTIS lot-H-17-094-0541 me sasinë 12123.3kg.
Nga analiza, mostrat e marra rezultuan me fuqi mbirëse nën normë. Nga verifikimi i bërë nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është konstatuar se në magazinën e subjektit nga 3 lotet e mësipërme ndodheshin:
LG 3350 lot-H-17-094/0549 me sasinë 55.6kg;
LG 3395 lot-H-18-094/0166 me sasinë 66kg;
ANTIS lot-H-17-094-0541 me sasinë 69kg,

Pjesa tjetër është shitur nga ana e subjektit tek tregtarët e tjerë. Në proces-verbal inspektimi dhe vendimin përfundimtar DRAKU ka lënë detyrë të bëhet njoftimi i te tretëve për rreziqet e mundshme dhe tërheqjen e menjëhershme nga tregu të sasisë së shitur. ***DRAKU Tiranë nuk kanë marrë masë administrative për shkeljen e pikës 3, neni 13 dhe pikës 2, neni 23 të ligjit 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor"***

Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

55. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 417/3, datë 25.04.2018 me objekt inspektimi rinspektim detyrash të lëna nga inspektimi i datës 18.04.2018 me proces-verbal inspektimi dhe vendim përfundimtar nr. serial 0007184, konstatohet se në magazinën e subjektit është rikthyer sasia prej 6059.8 kg fare misri VAR ANTIS dhe 719.2 kg kg farë misri VAR DIBRA LG 3350. Nga sasia e VAR ANTIS e kthyer mungojnë 5995.3 kg dhe nga sasia e VAR DIBRA LOT 3350 mungojnë edhe 87 kg të cilat duhet të riktheheshin në magazinën e subjektit. Për LOT-in LG 3395 lot-H-18-094/0166 me sasinë 7893.6kg nga e cila në magazinën e subjektit ishin gjetur vetëm 66 kg nuk është bërë tërheqja e sasisë. Bashkëlidhur praktikës janë foto tek të cilat janë të paqarta për të dalluar sasinë. Pavarësisht se farës i ishte bërë njeher analizimi DRAKU Tiranë ka marrë përsëri mostër për analizim dhe ka bërë bllokimin e farës me Akt-Bllokim nr. 0000008 deri në daljen e rezultatit të laboratorit. Autorizimi inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët F.F dhe T.K.

56. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 451/1, datë 04.05.2018 me objekt inspektimi referuar analizave të ardhura nga ESHFF nga praktika e datës 417/6, datë 25.04.2018, konstatohet se pas daljes së analizave DRAKU Tiranë ka bërë zhbllokimin e sasisë së bllokuar pasi rezultatet e ardhura në datën 02.05.2018 me fletë-analizat nr. 272 dhe nr. 274 rezulton se fuqia mbirëse e farës së misrit është në normë. Autorizimi i inspektimit është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët F.F dhe L.B.

57. Nga shqyrtimi i praktikës së inpsektimit me nr. AKU-TR-2018-003570-1, datë 01.10.2018, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit përfundimitar nr. AKU-TR-2018-003570-5, subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

58. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 145/1, datë 02.02.2018 për subjektin A me nr. NIPT L13329801V për veprimtarinë "tregëtimi i MMSHB dhe Bimëve zbukuruese", konstatohet se inspektorët nuk kanë plotësimin e kritereve të listë-verifikimit.

Praktika e inspektimit është bërë nga inspektorët L.B dhe T.K.

59. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 1133/1 datë 05.12.2018 për subjektin A me nr. NIPT K71723017L për veprimtarinë "prodhimi dhe tregëtimin e MMSHB dhe bimëve zbukuruese konstatohet se inspektorët nuk kanë bërë plotësimin e listë-verifikimit. Praktika është bërë nga inspektorët S.Rr dhe L.B.

60. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 170/2, datë 08.02.2018 subjekti "Koja" me nr. NIPT K31505125A për veprimtarinë "Importi dhe tregëtimi me shumicë të MMSHB-ve, rezulton se në subjekt nuk janë gjetur shkelje të kërkesave ligjore. Inspektorët kanë marrë nga subjekti, mostra për dy produkte, spinaqi dhe bizele. DRAKU Tiranë ka dërguar për analizim produktet në datën 09.02.2018.

61. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 279/1, datë 13.03.2018. me objekt inspektimi, referuar rezultateve të analizës së ardhur nga ESHFF-ja, me Fletë-Analizën me nr. 0023101, datë 19.02.2018 rezultojë se fara e bizeles kishte fuqi mbirëse nën normë. Në Proces-verbal inspektimi dhe Vendim përfundimtar me nr. 0007157, datë 12.03.2018, subjektit i është dhënë dënim administrativ me gjobë në vlerën 40.000, **DRAKU Tiranë nuk ka vepruar në përputhje me ligjin pasi duhet të bënte sekuestrimin, asgjësimin ose kthimin në vendin e origjinës të produktit që ka dalë me fuqi mbirëse jashtë normës.** Gjithashtu, DRAKU Tiranë ka vonuar njoftimin për dhënien e rezultatit Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 362/2, datë 12.04.2018 për subjektin L me nr. NIPT J64103632Ë, konstatohet se është bërë marrja

e mostrës për 3 variatete të misrit nga **inspektorët T.K dhe F.F** dhe u dërguan tek ESHFF për analizimin e fuqisë mbirëse por në praktikën e inspektimit mungon shkresa bashkëlidhur dhe etiketat e mostrave të farave.

62. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit nr. 417/1, datë 25.04.2018 me objekt inspektimi në rast kur nga kontrolli zyrtar analizat laboratorike rezultojnë pozitive, pas përgjigjes së ardhur me shkresën nr. 215, datë 23.04.2018 nga ESHFF, rezulton se fuqia mbirëse e mostrës është nën normë. DRAKU ka marrë masën dënim administrativ me gjobë me vlerën 40.000 lek për shkeljen e konstatuar dhe ka bërë bllokimin e farës prej 30.6 kg e ndarë në dy thasë me shkresën nr. 0000007, datë 25.04.2018, në praktikën e inspektimit me nr. prot.417/1, datë 25.04.2018, punuar nga **inspektorët S.Rr dhe L.B.** "**DRAKU Tiranë nuk ka vepruar në përputhje me ligjin pasi duhet të bënte sekuestrimin, asgjësimin ose kthimin në vendin e origjinës të produktit që ka dalë me fuqi mbirëse jashtë normës.** Autorizim-inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe L.B.

63. Në praktikën e inspektimit nr. prot. 508/5, datë 23.05.2018, pas kërkesës së subjektit me nr. prot 1141, datë 18.05.2018 për asgjësimin e dy produkteve(fara qepujka dhe patate), në proces-verbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar me nr. serial 0007011, datë 23.05.2018, thuhet se asgjësimi është bërë komfort kërkesave ligjore por mungojnë evidencat nga momenti i asgjësimit. Autorizim-inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët D.K dhe L.B.

64. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-000461-1, datë 28.01.2019 me subjekt L me nr. NIPT J64103632Ë për veprimtarinë "Tregëtimi me pakicë i MMSHB", konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit përfundimtar me nr. AKU-TR-2019-000461-5 subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

65. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-003393-1, datë 07.06.2019, për inspektimin e kërkesave ligjore konstatohet, referuar Listë-verifikimit me nr. AKU-TR-2019-002721-2 se subjekti në momentin e inspektimit nuk ka gjendje të MMSHB-ve, ***e cila nuk është e pasqyruar në praktikën e inspektimit.*** Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal S.S dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr dhe T.K.

66. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2019-008035-1, datë 04.12.2019, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit Përfundimtar AKU-TR-2019-008035-5 subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga kryeinspektori rajonal A.N dhe praktika është përpunuar nga inspektorët S.Rr, E.GJ dhe D.K.

Plehrat e Përdorimit Për Bimësi

67. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 388/4 datë 17.04.2018 për subjektin A me nr. NIPT L01719012O për veprimtarinë "Importi dhe tregëtimi i plehrave për bimësi", konstatohet se është bërë marrja e tre mostrave dhe dërgimi i tyre për analizim në laboratori i QTTB Fushë Krujë në datën 17..04.2018 me shkresat proces-verbal inspektimi me nr. 03, 04 dhe 05. **Përgjigjja e analizës ka ardhur në datën 02.05.2018 . DRAKU Tiranë dhe laboratori duhet të kishin mbajtur një lidhje të vazhdueshme me drejtorinë e standardizimit për njohjen e metodave të adaptuara prej saj, .**

68. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot. 68/2, datë 18.01.2018 subjektin A me nr. NIPT J611918010D për veprimtarinë "Importi, ambalazhimin dhe tregëtimin e plehrave të përdorimit për bimësinë", konstatohet se gjatë inspektimit të kryer për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për tregëtim, subjekti rezulton brenda standardeve referuar Proces-verbalit të Inspektimit dhe Vendimit Përfundimtar me nr. serial 0007360. Autorizimi i inspektimit miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika e përpunuar nga inspektorët D.K dhe T.K.

69. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 119/2, datë 29.01.2018 konstatohet se gjatë inspektimit të kryer për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për tregëtim, subjekti rezulton brenda standardeve referuar Proces-verbalit të Inspektimit dhe Vendimit

Përfundimtar me nr. serial 0007367. Gjithashtu ne praktikën e inspektimit janë të bashkëngjitur disa certifikata pa shpjegim. Autorizimi i inspektimit miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika e përpunuar nga inspektorët A.Sh, S.Rr dhe T.K.

70. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 350/1 datë 05.04.2018, konstatohet se gjatë inspektimit të kryer për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për tregëtim, subjekti rezulton brenda standardeve referuar Vendimit Përfundimtar me nr. AKU-TR-2018-000624-5, datë 05.05.2018. Autorizimi i inspektimit miratuar nga kryeinspektori rajonal F.S dhe praktika e përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

71. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. AKU-TR-2018-001981-1, datë 02.07.2018 me nr. Prot. 653/1 për konstatohet se, është bërë marrja e mostrave(2) për kontroll zyrtar dhe janë dërguar për analizim në Q.T.T.B Fushë-Krujë në datën 02.07.2018. Marrja e mostrave është bërë në përputhje me VKM 260, datë 27.03.2013 "Rregullat për kontrollin, marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënien e rezultatit të tyre si dhe vlerësimin e analizave të plehrave" **por rezultati përfundimtar ka dalë në datë 17.07.2018, Rezultati përfundimtar i analizave i dorëzohet inspektorit brenda një periudhe kohe prej 10 ditësh nga çasti i dorëzimit të mostrës për analizim.** Autorizimi i inspektimit miratuar nga kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika e përpunuar nga inspektorët F.F, L.B dhe T.K.

72. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 685/1 datë 10.07.2018, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar Vendimit Përfundimtar nr. AKU-TR-2018-002167-5, datë 10.07.2018 nuk rezultojnë shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga Kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

73. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 1129/1, datë 04.12.2018, konstatohet se inspektimi është bërë i plotë dhe referuar vendimit përfundimtar nr. AKU-TR-2018-004645-5, datë 04.12.2018 nuk rezultojnë shkelje të kërkesave ligjore. Autorizim inspektimi është miratuar nga Kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

74. Nga shqyrtimi i praktikës së inspektimit me nr. prot 1167/1, datë 18.12.2018, konstatohet se inspektorët e DRAKU Tiranë nuk kanë bërë plotësimin e Listë-verifikimit nr. AKU-TR-2018-005017, datë 18.12.2018. Procesverbali i inspektimit është i firmosur vetëm nga inspektorët e DRAKU dhe jo ka personi i autorizuar i subjektit. Referuar Vendimit -përfundimtar nr. AKU-TR-2018-005017-5, datë 18.12.2018 rezulton se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore nga ana e subjektit. Autorizim inspektimi është miratuar nga Kryeinspektori rajonal M.M dhe praktika është përpunuar nga inspektorët L.B dhe T.K.

Veprimet dhe mosveprimet në praktikat e mësipërme të inspektimit, rast pas rasti, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

-Ligjin nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
-Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
-Ligjin nr.105/2016, datë 27.10.2016 "Për Mbrojtjen e Bimëve";
-Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor";
-Ligjin nr.10390, datë 03.03.2011 "Për Plehrat e Përdorimit për Bimësinë";
-Ligjin nr.9870, datë 04.02.2008 "për standardizimin";
-VKM nr.532, datë 11.09.2018 "për miratimin e rregullave për tregëtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve"
-VKM nr.87, datë 30.1.2013 "për përcaktimin e kritereve të tregëtimit, certifikimit dhe testimit të farave foragjere",
-VKM nr.86, datë 30.01.2013 "për përcaktimin e kritereve të tregëtimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve për farat e drithërave";
-VKM nr.332, datë 18.04.2013 "për përcaktimin e kritereve të tregëtimit e të certifikimit të farave të perimeve";

-VKM nr.530, datë 13.06.2013 "për përcaktimin e kritereve të tregëtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës";
-VKM nr.409, datë 08.05.2013 "për përcaktimin e kritereve të tregëtimit dhe certifikimit të shumëzimit vegjetativ të hardhisë".
-VKM nr.260, datë 27.03.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave"
-Urdhrit 4277, datë 01.12.2015 "Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim".

2.7.Auditim mbi funksionin e inspektimit jashtë planit vjetor të miratuar, të iniciuara nga ankesat, indiciet, rastet urgjente, apo edhe me urdhëra të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së.

Mbi auditimin e Urdhrit nr.4549, datë 27.10.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së dhe zbatimin e tij nga DRAKU Tiranë.

▪ Me Urdhrin nr.4549, datë 27.10.2020, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, ka urdhëruar Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ku një ndër ato është edhe DRAKU Tiranë, për:

1. Marrjen e mostrave të farave dhe produkteve plehëruese për analizim të treguesve cilësor të farës dhe elementëve përbërës të plehut, në laboratorët e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanave, si dhe Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë.
2. Për secilën mostër përveç numrit të kampionëve që merren në zbatim të kërkesave ligjore në të njëjtën ditë, do të merret edhe një kampion shtesë, i cili do të dorëzohet në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.
3. Mostrat do të merren në të gjithë operatorët të cilët ushtrojnë këto aktivitete dhe do të jenë të koduara.
4. Periudha për marrjen e mostrave do të jetë në datat 28-29.10.2020.
5. Për zbatimin e këtij Urdhëri, ngarkohen DRAKU, DMRKI (Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Kordinimit të Inspektimit) në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.

▪ Në zbatim të këtij Urdhri janë kryer **21** inspektime për mostërmarrje, për analizë laboratorike, nga të cilat vetëm **1** prej tyre nuk rezultoi me norma brenda standardit, përsa i përket fuqisë mbirëse, dhe ndaj subjektit është vendosur gjobë në vlerën 200,000 lekë.

Grupi i auditimit shqyrtoi ligjshmërinë e Urdhrit, dhe për këtë bëri parashtrimin, si më poshtë vijon:

▪ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është institucion në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i krijuar në zbatim të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", më konkretisht në zbatim të nenit 61 të këtij Ligji.

▪ Në zbatim të nenit 39 të Ligjit të mësipërm, AKU është organi përgjegjës **për kryerjen e kontrollit zyrtar** për ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

▪ Në zbatim të nenit 38, **kontrolli zyrtar përfshin**:

a) inspektimin;
b) marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave;
c) kontrollin e etiketës dhe të dokumentacionit zyrtar;
ç) shqyrtimin e dokumentacionit për gjurmueshmërinë;
d) shqyrtimin e sistemit të vetëkontrollit.

Si dhe kontrolli zyrtar kryhet në përputhje me **rregullat e parashikuara** në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj.

▪ Duke vijuar në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në përcaktimet e tij ligjore, parashikohen dy forma inspektimi/kontrolli **ai i programuar**[40] dhe **ai jashtë programit**[41]**,** dhe për këto dy forma përcakton rregullat për programimin dhe autorizimin.

▪ Pra duke i'u referuar përcaktimit të Ligjit të ushqimit, se çfarë përfaqëson kontrolli zyrtar dhe se si kryhet ai, cituar më sipër, për të vijuar më pas me përcaktimin e Ligjit të inspektimit për format dhe mënyrat e kryerjes së inspektimit, si dhe **referencës** së bërë në Urdhrin nr.4549, datë 27.10.2020, në pikën 1 të tij, pra marrjen e mostrave (**përveç sa është planifikuar në planin me bazë risku të marrjes së mostrave për vitin 2020, plan i cili miratohet me Urdhër të Ministrit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural**), arrijmë në konkluzionin se në këtë rast **jemi përpara kryerjes së inspektimit/kontrollit jashtë programit të miratuar.**

▪ Në këto kushte, për kryerjen e inspektimit/kontrollit jashtë planit/programit të miratuar, sipas përcaktimit të bërë në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 1 dhe në pikën 2 të nenit 25, të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, duhet të plotësohen disa kushte (jo kumulative, pra mjafton një prej tyre), të cilat po i renditim si më poshtë:
a) subjekti i inspektimit, që detyrohet të paraqesë një informacion periodik, sipas ligjit të posaçëm, nuk e ka përmbushur këtë detyrim brenda afatit të caktuar, nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë, apo ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e informacionit të paraqitur – **Nuk jemi përpara këtij rasti;**
b) nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektoratet, nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore dhe arrihet në përfundimin se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi – **Nuk jemi përpara këtij rasti;**
c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a një organizatë ndërkombëtare, konsiderohet se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi – **Nuk jemi përpara këtij rasti;**
ç) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin – **Nuk jemi përpara këtij rasti;**
d) parashikohet në pikën 5 të nenit 18 (neni 18/5 Ministri mund të urdhërojë, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt, **por në këtë rast, urdhërimin e ka bërë Drejtori i Përgjithshëm**) dhe në pikën 5 të nenit 19 (neni 19/5 Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mund të urdhërojë, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt, **por që në këtë rast nuk lidhet me situatën, pasi jemi në një institucion qendror**) të këtij ligji;
dh) parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm (**në Ligjin e posaçëm, pra atë të ushqimit, por edhe në Ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor**[42]**, Ligjin për produktet plehëruese**[43]**, nuk ka asnjë përcaktim të tillë**).
Konstatimi: Pra referuar sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, **nuk plotësohet asnjë nga kushtet** dhe se Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së nuk ka **kompetencën ligjore** për të nxjerrë një urdhër të tillë.

▪ Ky konstatim mbështetet edhe nga përcaktimi ligjor i bërë në pikën 2 të nenit 24 të Ligjit nr.17/2020 "Për produktet plehëruese", ku përcaktohet shprehimisht se:

---

[40] Neni 24 Inspektimi i programuar, Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
[41] Neni 25 Inspektimi jashtë programit, Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
[42] Ligji nr.10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".
[43] Ligji nr.17/2020 "Për produktet plehëruese".

2. Kontrolli për cilësinë e produkteve plehëruese të vendosura në treg kryhet **në bazë të planit vjetor të marrjes dhe të analizimit të mostrave, miratuar me urdhër të ministrit dhe për mostërmarrjen plani vjetor i vitit 2020 është miratuar me Udhëzimin nr.2, datë 24.02.2020, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.**

- Gjithashtu theksojmë se baza ligjore e përmendur në Urdhrin nr.4549, datë 27.10.2020, **është e përgjithshme dhe jo specifike, si dhe jo e plotë**, për arsye se nuk është përmendur edhe Ligji nr.17/2020 "Për produktet plehëruese", meqënëse është urdhëruar marrja e mostrave për produktet plehëruese, veprim i cili rregullohet sipas përcaktimeve të këtij Ligji.

- Për të vijuar më tej me analizën e ligjshmërisë së **pikave të këtij Urdhri**, konkretisht të **pikës 1 të tij**, e cila bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 42 të Ligjit nr.10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar.
- Pra sipas këtij përcaktimi, AKU i kërkon subjekteve që të kryejnë rianalizimin për treguesit e fuqisë mbirëse për çdo specie, varietet dhe lot të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të importuar apo të prodhuar në vendin tonë, dhe jo **të shkojë të zgjedhi dhe të marri vetë kampionin për analizë laboratorike**.

- Të **pikës 2** të Urdhrit, ku kërkohet që veç kampionit të marrë për analizë, **të merret edhe një kampion shtesë, i cili do të dorëzohet në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së**, e cila bie në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të shkronjës B, të Kreut II, si dhe shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 4 të shkronjës B të Kreut II të VKM-së nr. 260, datë 27.03.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave".
-Pra sa më sipër, kuptohet qartë se, **në asnjë rast nuk parashikohet** që të merret një kampion shtesë dhe të dërgohet në DPAKU.

- Në përfundim të shqyrtimit të ligjshmërisë së Urdhrit nr.4549, datë 27.10.2020 (aktit administrativ të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së), grupi i auditimit konstaton se ai është marrë në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore që përcaktojnë veprimet e këtij Urdhri, si dhe në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", **ai vlerësohet akt administrativ i paligjshëm, dhe për këtë mbanë përgjegjësi z.B.S, Drejtori i Përgjithshëm në detyrë i AKU-së.**

- Gjithashtu nga DPAKU nuk ka patur një bashkëpunim gjatë fazës së hartimit të këtij Urdhri, me qëllim përcaktimin sa më të saktë të fushës së zbatimit, objektivave dhe kohëzgjatjes, pasi në 2 ditë që është përcaktuar afati për realizimin e mostërmarrjes në rreth 200 subjekte që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Tiranës, është e pamundur fizikisht, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3.4 të Urdhërit nr.108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", si dhe pikën 2.3 të Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

<u>Mbi zbatimin e Urdhrit nr.4549, datë 27.10.2020, nga DRAKU Tiranë, Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve.</u>

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DRAKU Tiranë, mbi zbatimin e Urdhrit të mësipërm, rezulton se janë kryer 20 mostëmarrje në 16 subjekte, pasi 14 subjekte ushtrojnë 2 lloje

aktivitetesh, konkretisht në materialin mbjellës dhe shumëzues bimor si dhe në plehërat për përdorim në bimësi, pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr.1 Mostërmarrja sipas subjekteve

Nr.	Subjekti	Numri i llojeve të aktiviteteve që kryen	lloji i aktivitetit 1 MMSHB	Risku sipas llojit të aktivitetit 1	Mostërma rrje sipas urdhërit	lloji i aktivitetit 2 Plehëra	Risku sipas llojit të aktivitetit 2	Mostërma rrje sipas urdhërit
1	J	2	Import dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	M	PO	Import tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	M	
2	S	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
3	K	2	Import dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	M	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
4	A	1	Import dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	M	PO			
5	H	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
6	A	2	Import dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	M	PO	Import tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	M	PO
7	H	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
8	M	2	Import dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	M	PO	Import, ambalazhim dhe tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	L	PO
9	E	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
10	M	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
11	I	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
12	D	2	Prodhim dhe Tregëtim të MMSHB-ve	L	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	PO
13	P	2	Tregëtim me pakicë të MMSHB-ve	U	PO	Tregëtim me pakicë të plehrave të përdorimit për bimësi	U	
14	C	1				Import, ambalazhim dhe tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	L	PO
15	A	2	Import, Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	L	JO	Import, ambalazhim dhe tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	L	PO
16	A	2	Import, prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve me shumicë	L	JO	Import tregëtim me shumicë të Plehrave të Përdorimit për Bimësi	M	PO

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

- Nga shqyrtimi i mostërmarrjes, pasqyruar në tabelen e mësipërme, arrihet në konkluzionin se, mostërmarrja është përqendruar më tepër në subjekte me aktivitet me risk të ulët dhe jo me risk të lartë, konkretisht, 8 mostra nga 20 gjithsej, janë marrë në subjekte me aktivititet me risk të ulët, ose 40% e tyre, 7 mostra ose 35 % e tyre janë marrë në subjekte me aktivitet me risk të mesëm, si dhe 3 mostra ose 15 % e tyre janë marrë në subjekte me risk të lartë, pra duket qartë se mostërmarrja nuk është përqendruar tek ato aktivitete të cilat kanë risk të lartë, ku edhe mundësia për të zbuluar shkelje është më e lartë.

▪ Gjithashtu ky konkluzion mbështetet edhe në numrin e subjekteve me risk të lartë që kanë lënë inspektorët pa i përfshirë në mostërmarrje, konkretisht në llojin e aktivitetit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, ku gjithsej janë 17 subjekte të cilat janë klasifikuar me risk të lartë sipas llojit të aktivitetit për MMSHB, dhe 15 prej tyre ose 88% nuk janë përfshirë në mostërmarrje, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2 Subjektet me risk të lartë në aktivitetin e MMSHB-ve dhe mostërmarrja

Nr	Risku	Lloji i aktivitetit	Subjekti	Mostërmarrje
1	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
2	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	PO
3	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
4	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	D	PO
5	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	N	JO
6	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	M	JO
7	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	S	JO
8	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	V	JO
9	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
10	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
11	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
12	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	A	JO
13	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	M	JO
14	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	R	JO
15	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	S	JO
16	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	X	JO
17	L	Prodhim dhe tregëtim të MMSHB-ve	Y	JO

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

1.Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006814-1, datë 28.10.2020 në subjektin a ALBANIA, NIPT L071719012O. Grupi i inspektimit: E.Gj (inspektore e sektorit të bimëve), A.B (inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore), D.K (inspektor i sektorit të bimëve) dhe R.J (inspektore e produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006814-2, datë 28.10.2020 ku është marrë farë shalqi në sasinë 3x1000=3000. Procesverbali nënshkruar nga inspektorët dhe subjekti.
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra, si dhe ai është nënshkruar vetëm nga inspektori E.Gj dhe jo edhe nga anëtarët e grupit të inspektimit si dhe nga përfaqësuesi i subjektit, ;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 ;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektori E.Gj.
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në shkronjën G, të tabelës A, të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 .
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emir, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit, ;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar në modelin 3/1 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 , konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori E.Gj, A.B, D.K dhe R.J.

2. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006820-1, datë 29.10.2020 në subjektin i, NIPT K31505068A. Grupi i inspektimit: E.Gj (inspektore e sektorit të bimëve), A.B

(inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore), D.K (inspektor i sektorit të bimëve) dhe L.B (inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006820-2, datë 29.10.2020 ku është marrë farë gruri në sasinë 4x1=4 kg. Procesverbali nënshkruar vetëm nga inspektori E.Gj dhe jo nga anëtarët e tjerë të grupit të inspektimit si dhe nga përfaqësuesi i subjektit, ;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra, ;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Të dhënat e peshës së lotit në fletë-etiketë për sasinë e tij nuk përputhen me të dhënat e sasisë së lotit në procesverbalin e inspektimit;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektorët E.Gj dhe D.K.
-Data e mostrimit 02.11.2020 sipas fletë-analizën me nr.424, datë 06.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 29.10.2020.
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në shkronjën A, të tabelës A, të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emir, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në Urdhërin nr.4635, datë 16.10.2006;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar në modelin 3/1 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori E.Gj, A.B, D.K dhe L.B.

3. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006816-1, datë 28.10.2020 në subjektin A, NIPT J97326615B. Grupi i inspektimit: E.Gj (inspektore e sektorit të bimëve), A.B (inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore), D.K (inspektor i sektorit të bimëve) dhe R.J (inspektore e produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006816-2, datë 28.10.2020 ku është marrë farë gruri në sasinë 4x1=4 kg;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra, në kundërshtim me pikën 21 të Kreut V të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektorët E.Gj dhe A.B.
-Data e mostrimit 29.10.2020 sipas fletë-analizën me nr.380, datë 03.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 28.10.2020.
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në shkronjën A, të tabelës A, të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emir, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit, ;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar në modelin 3/1 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori E.Gj, A.B, D.K dhe R.J.

4. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006825-1, datë 29.10.2020 në subjektin P, NIPT L52103216N. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006825-2, datë 29.10.2020 ku është marrë farë shalqi në sasinë 1 farë. Procesverbali nënshkruar nga inspektorët dhe subjekti.
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Nuk është plotësuar Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës;
Data e mostrimit 02.11.2020 sipas fletë-analizën me nr.426, datë 09.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 29.10.2020.
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në shkronjën G, të tabelës A, të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

5. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006824-1, datë 29.10.2020 në subjektin D, NIPT L21407026j. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006824-2, datë 29.10.2020 ku është marrë farë gruri në sasinë 1 kg. Procesverbali nënshkruar nga inspektorët dhe subjekti.
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Nuk është plotësuar Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Data e mostrimit 02.11.2020 sipas fletë-analizën me nr.423, datë 06.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 29.10.2020.
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në shkronjën A, të tabelës A, të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

6. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006812-1, datë 28.10.2020 në subjektin M, NIPT K83807201L. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006812-2, datë 28.10.2020, ku nuk pasqyrohet se është marrë mostër për analizë, pra nuk vërtetohet marrja e mostrës në këtë subjekt;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektori T.K;

-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emir, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

7. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006821-1, datë 29.10.2020 në subjektin M, NIPT K31714042M. Grupi i inspektimit: S.Rr (Inspektore e sektorit të mbrotjes së bimëve) dhe E.M (Inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006821-2, datë 29.10.2020;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektori S.Rr;
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori S.Rr dhe E.M.

8. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006806-1, datë 28.10.2020 në subjektin A, NIPT K411720010G. Grupi i inspektimit: S.Rr (Inspektore e sektorit të mbrotjes së bimëve) dhe E.M (Inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006806-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër farë pjepri në sasinë 500 fara për analizë;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa nuk është nënshkruar nga inspektorët;
-Data e mostrimit 30.10.2020 sipas fletë-analizës me nr.377, datë 06.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 28.10.2020.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori S.Rr dhe E.M.

9. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006810-1, datë 28.10.2020 në subjektin S, NIPT K31603121H. Grupi i inspektimit: S.Rr (Inspektore e sektorit të mbrotjes së bimëve) dhe E.M (Inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006810-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër farë spinaqi në sasinë 0.9 kg fara për analizë;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;

-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektori S.Rr;
-Data e mostrimit 29.10.2020 sipas fletë-analizës me nr.381, datë 13.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 28.10.2020.
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
-Sasia e kampionit të marrë nuk është në përputhje me sasinë e përcaktuar në Aneksin III të VKM nr.332, datë 18.04.2013, konkretisht pesha e një mostre për spinaqin duhet të jetë 75 gr, ndërkohë nga inspektorët është marrë 225 gr për mostër.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori S.Rr dhe E.M.

10. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006813-1, datë 28.10.2020 në subjektin H, NIPT K51607002R. Grupi i inspektimit: S.Rr (Inspektore e sektorit të mbrotjes së bimëve) dhe E.M (Inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-006813-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër farë spinaqi në sasinë 0.3 kg fara për analizë;
-Vendimi është marrë në të njëjtën datë kur është marrë dhe mostra;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës nuk është në përputhje me formatin e përcaktuar në modelin 3/2 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
-Fletë-etiketa është nënshkruar vetëm nga inspektori S.Rr;
-Data e mostrimit 29.10.2020 sipas fletë-analizës me nr.379, datë 13.11.2020 nuk përputhet me datën e mostrimit sipas procesverbalit të inspektimit datë 28.10.2020.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emir, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar, konkretisht ajo nuk ka vulën e lotit prej nga është marrë mostra për analizë, është vetëm në gjuhën shqipe dhe jo edhe në atë anglisht;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori S.Rr dhe E.M.

11. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006809-1, datë 28.10.2020 në subjektin K, NIPT K31505125A. Grupi i inspektimit: S.Rr (Inspektore e sektorit të mbrotjes së bimëve) dhe E.M (Inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore).
-Listë-verifikimi nr.AKU-TR-2020-6307, datë 14.10.2020, i pa nënshkruar nga inspektorët.
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6307-2, datë 14.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër farë gruri varieteti bisano në sasinë 3 kg dhe farë gruri në sasinë 3 kg varieteti pobeda; Procesverbali i pa nënshkruar nga inspektorët.
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6307-5, datë 14.10.2020 i pa nënshkruar nga inspektorët;
-Fletë-etiketa e shoqërimit të mostrës, në të cilën pasqyrohet informacioni për mostrën bizele të marrë për analizë laboratorike, e nënshkruar vetëm nga inspektori S.Rr.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
-Fletë-etiketa e marrjes së mostrës është bashkangjitur formalisht, pasi në atë pasqyrohet se është marrë mostër bizele, ndërkohë në procesverbal pasqyrohet se është marrë mostër farë gruri.

-Sa më sipër dokumentet e pasqyruara janë fiktive dhe nuk vërtetojnë kryerjen e veprimeve nga inspektorët.
-Dokumentet e inspektimit (listë-verifikimi, procesverbali dhe vendimi i inspektimit) nuk janë të nënshkruar nga inspektorët;
-Fletë-etiketimi i bashkangjitur në praktikë është nënshkruar vetëm nga inspektori S.Rr.
-Nuk administrohet në praktikë fletë-shoqërimi i mostrës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, në të cilin vihet emri, mbiemri i inspektorit/ët që kanë marrë mostrën, vula e institucionit;
-Fletë-analiza është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe nuk është sipas formatit të përcaktuar në modelin 3/1 të Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori S.Rr dhe E.M.

12. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006804-1, datë 28.10.2020 në subjektin A, NIPT L07003004D. Grupi i inspektimit: E.Gj (inspektore e sektorit të bimëve), A.B (inspektor i produkteve me origjinë jo shtazore), D.K (inspektor i sektorit të bimëve) dhe R.J (inspektore e produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6804-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër sulfat kaliumi 50 në sasinë 4 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6804-5, datë 28.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM Nr. 260, datë 27.3.2013, konkretisht mungojnë emrat dhe mbiemrat e inspektorëve si dhe firma e tyre;
-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij. Gjithashtu theksojmë se ai është fotokopje dhe jo dokument original.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori E.Gj, A.B, D.K dhe R.J.

13. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006802-1, datë 28.10.2020 në subjektin A, NIPT L01719012O. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6802-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër produkt plehërues (NPK 20-20-20) në sasinë 1 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6802-5, datë 28.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM Nr.260, datë 27.3.2013, konkretisht mungon emri dhe mbiemri i inspektorit tjetër që ka qënë në inspektim, E.V, numri i standardit të përdorur për marrjen e mostrës nuk është plotësuar saktë si dhe etiketa është fotokopje dhe jo dokument origjinal;
-Në etiketën e cila është dorëzuar në laborator janë shënuar edhe të dhënat e subjektit, ku është marrë mostra, duke cenuar anonimatin e mostrës.

-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij, por numrin e kodit të prodhuesit. Gjithashtu theksojmë se ai është fotokopje dhe jo dokument original.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

14. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006822-1, datë 29.10.2020 në subjektin D, NIPT L21407026J. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6822-2, datë 29.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër produkt plehërues (extra elea) në sasinë 1 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6822-5, datë 29.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM Nr. 260, datë 27.3.2013, konkretisht mungon emri dhe mbiemri i inspektorit tjetër që ka qënë në inspektim, E.V, numri i standardit të përdorur për marrjen e mostrës nuk është plotësuar saktë;
-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij, por numrin e kodit të prodhuesit. Gjithashtu në këtë procesverbal ka firmosur vetëm inspektori T.K.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

15. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006805-1, datë 28.10.2020 në subjektin A NIPT J61918010D. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6805-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër produkt plehërues (NPK 16-16-16) në sasinë 1 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6805-5, datë 28.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM Nr. 260, datë 27.3.2013, numri i standardit të përdorur për marrjen e mostrës nuk është plotësuar saktë si dhe etiketa është fotokopje dhe jo dokument origjinal;

-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij, por numrin e kodit të prodhuesit. Gjithashtu në këtë procesverbal ka firmosur vetëm inspektori T.K.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

16. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006808-1, datë 28.10.2020 në subjektin M NIPT K83807201L. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6808-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër produkt plehërues (nitrat amoni) në sasinë 1 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6808-5, datë 28.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM nr.260, datë 27.3.2013, numri i standardit të përdorur për marrjen e mostrës nuk është plotësuar saktë si dhe etiketa është fotokopje dhe jo dokument origjinal;
-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij, por numrin e kodit të prodhuesit. Gjithashtu procesverbali është fotokopje dhe jo dokument origjinal, si dhe në këtë procesverbal ka firmosur vetëm inspektori T.K.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

17. Mostërmarrja sipas autorizimit të inspektimit nr.AKU-TR-2020-006815-1, datë 28.10.2020 në subjektin C NIPT j62903815s. Grupi i inspektimit: T.K (Inspektor i sektorit të mbrojtjes së bimëve) dhe E.V (inspektor i sektorit të produkteve me origjinë shtazore).
-Procesverbali i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6815-2, datë 28.10.2020, ku pasqyrohet se është marrë mostër produkt plehërues (ure) në sasinë 1 kg, e cila do të analizohet në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë;
-Vendimi i inspektimit nr.AKU-TR-2020-6815-5, datë 28.10.2020 është marrë në të njëjtën ditë që është marrë edhe mostra;
-Etiketa e mostrës së plehrave, nuk është plotësuar sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2 të VKM Nr. 260, datë 27.3.2013, numri i standardit të përdorur për marrjen e mostrës nuk është plotësuar saktë si dhe etiketa është fotokopje dhe jo dokument origjinal;

-Procesverbali i mbajtur nga inspektorët sipas shtojcës 1 të VKM së mësipërme, nuk ka numrin e referencës së tij, por numrin e kodit të prodhuesit. Gjithashtu procesverbali është fotokopje dhe jo dokument origjinal, si dhe në këtë procesverbal ka firmosur vetëm inspektori T.K.
-Në praktikë nuk administrohet dokumenti i protokollit të marrjes në dorëzim të mostrave, sipas formatit të shtojcës 3 të VKM së mësipërme, në të cilën firmosin marrësi në dorëzim i mostrës dhe dorëzuesi i mostrës;
-Fletë-analiza e mostrës është fotokopje dhe jo dokument original, si dhe ajo nuk ka firmën e analizuesit dhe përgjegjësit të laboratorit;
-Nuk dokumentohet se me çfarë pajisje janë marrë mostrat, ku sipas VKM nr.260, datë 27.3.2013, ato merren në enë plastike dhe plumbosen.
-Nuk administrohet fletë-analiza e dorëzuar nga inspektori tek subjekti;
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektori T.K dhe E.V.

- Grupi i auditimit bëri edhe verifikimin fizik të mostrave, ku nga grupi i auditimit të pranishëm ishin audituesit K.K dhe B.B, si dhe nga DRAKU Tiranë S.Rr, ish Kordinatore e Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve, aktualisht inspektore.

-Nga verifikimi fizik rezultoi se në DRAKU administrohen vetëm 7 mostra nga 19 që duhet të ishin sipas numrit të mostërmarrjes, konkretisht mostrat e marra në subjektet E, H, D, I, M, M (2 mostra), si dhe 1 mostër për produktin farë shalqi, e cila i përket vitit 2018 dhe jo vitit 2020, kjo sipas shënimit të bërë në zarfin, në të cilin është futur mostra.
-Gjithashtu edhe nga verifikimi fizik, rezultoi se këto mostra mbaheshin në zarf letër dhe jo në enët mbajtëse sipas përcaktimit ligjor të bërë në VKM nr.260, datë 27.3.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave" dhe Udhëzimin nr.107, datë 02.12.2002 "Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor".
-Theksojmë se marrja e mostrës në këtë mënyrë nuk ruan gjurmët e kryerjes së veprimit dhe mund të hapet dhe mbyllet pa asnjë problem dhe nuk lë gjurmë të hapjes ose të mbylljes, ndërkohë që sipas VKM nr.260, datë 27.03.2013, ato duhet të futen në mbajtëse plastike, e cila plumboset në mënyrë që nëse do të hapet, të ruhet gjurma që mostra është hapur;
-Gjithashtu theksojmë se vula e njomë që është vendosur në fletë-etiketat e mostrave që na u paraqitën ditën e kryerjes së verifikimit, është bërë ditën që u krye verifikimi, dhe kjo faktohet nga fletë-etiketat në praktikat e inspektimit, vula në të cilat ishte fotokopje dhe jo e njomë.
-Mostrat e paraqitura nga DRAKU Tiranë, i kemi pasqyruar si më poshtë:






Etikete
Per marrjen e mostres Farave
34/27


Etikete
Per marrjen e mostres Farave
34/25


Etikete
Per marrjen e mostres Farave
34/26


ETIKETA E MOSTRES SË PLEHRAVE (per mostren e imposhtme)
EMRI I PLEHUT
Data e marjes se mostres
adresa dhe Nr. i telefonit te Prodhuesit
adresa dhe Nr. i telefonit te inspektorit
Qeliu
Numri i shenjuesit qe eshte perdorur per marrjen e mostres
Emri Mbiemri i inspektorit
Firma Vula


Etikete
Per marrjen e mostres Farave

Shuspi
MACSON FA
V. 2018



▪ Gjithashtu theksojmë se në asnjë nga praktikat e mësipërme të marrjes së mostrave, nuk administrohet dokumentacioni (procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë-hyrja në magazinë) i dorëzimit të mostrave në DPAKU.

Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
-Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
-VKM nr.260, datë 27.3.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave";
-Urdhrin nr.25, datë 10.8.2018 "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ";
-Urdhërin nr.4635, datë 16.10.2006 "Për inspektimin fitosanitar në PIK";
-Urdhërin nr.58, datë 21.08.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në RSH", i ndryshuar;
-Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 "Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor".

2.8. Auditim mbi veprimtarinë e sektorit të laboratorit.

Mbi auditimin e veprimtarisë së sektorit të laboratorit, aparaturat laboratorike, rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit të analizave laboratorike, të ardhurat e gjeneruara nga analizat e autokontrollit.

-Sektori i laboratorit për Qarkun Tiranë, deri në muajin Shtator të vitit 2020, ka qenë në varësi direkte të Drejtorisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, dhe më pas me hyrjen në fuqi të VKM nr.708, datë 09.09.2020[44], kaloi në varësi të Drejtorisë së Përgjithme të AKU. Sektori i laboratorit ndahet në dy nënsektor të tjerë, në atë fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. Në këto dy laborator kryhen shërbimet e analizimit për treguesit cilësorë të produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, tregues të etiketimit, tregues analitik të sigurisë ushqimore, proçeseve të higjenës. Theksojmë se ky laborator, ka mbuluar shërbimet laboratorike të DRAKU Qarku Kukës dhe DRAKU Qarku Dibër.

Në vija të përgjithshme nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i laboratorit, konstatohet se:

[44] Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

-Laboratori ende nuk është i akredituar për kryerjen e analizave të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore.
-Për 3 vitet 2018, 2019 dhe 2020, laboratori e ka ushtruar aktivitetin e vet, në mungesë të autorizimit që miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për bujqësinë.
Për gjobën në vlerën 300,000 lekë, të vendosur nga inspektorët, është bërë kërkesa për lëshimin e Urdhërit për ekzekutim nr.984 prot datë 21.02.2020, por ende gjoba nuk është arkëtuar.

2.Inspektimi i kryer në subjektin "A", me autorizimin me nr.003880-1 datë 18.10.2018 nënshkruar nga ish Kryeinspektori zj.M.M, me grup inspektimi E.V dhe N.H.

Në procesverbalin e inspektimit dhe vendimit përfundimtar me nr., serie 003880-5 datë 19.10.2018 "një ditë me von nga autorizimi i inspektimit të subjektit", pasqyrohet informacioni se në subjekt janë gjendur 2530 kg produkte deti (peshk, karkaleca), në gjëndje të ngrirë, por që u ka ikur ngjyra, pasi nuk ka pasur drita elektrike dhe difekt në frigorifer, difekt në amballazhim, dhe për këto produkti është i pakonsumueshëm.
Sa më sipër është bërë bllokimi i produkteve dhe vendosur gjobë në vlerën 500,000 lekë.
Në praktikën e mësipërme konstatohet se:
Nuk administrohet shkresa drejtuar subjektit për likujdim vullnetar të gjobës;
Megjithëse GJSHP Tiranë në vendimin nr.1979 datë 19.11.2019 ka lenë në fuqi aktin administrativ dhe lëshimin e urdhërit për ekzekutimin e masave administrative, në vijimësi nuk administrohet asnjë dokumentacion mbi ndjekjen e arkëtimit të gjobës së vendosur.
Nuk dokumentohet me shenja dalluese bllokimi i produkteve të mësipërme;
Nuk është përcaktuar afati për asgjesimin e produkteve;
Në inspektimin e rradhës të kryer në këtë subjekt me grup inspektimi G.H dhe M.B, është pasqyruar informacioni se është i mbyllur, por që nuk dokumentohet nëse realisht ka qenë i mbyllur;
Në këto kushte nga DRAKU Tiranë, i është dërguar shkresë për vlerësim të rastit, organeve të tjera Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentit të Policisë Kriminale, Operacioni Forca e Ligjit, por që nuk administrohet asnjë informacion për ecurinë e veprimeve.

3.Për vitin 2020 nga sektori OJSH janë kryer 2 inspektime me Krimin Ekonomik, ku është vendosur gjobë subjekteve me vlerën 150,000 lekë dhe marrë masa "paralajmërim" për 2 subjektet si dhe është bërë bllokim produkti, ku nga shqyrtimi i këtyre dy praktikave nuk rezultuan probleme.

2.10. Auditim mbi probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit, të cilat mund të kërkojnë auditim edhe jashtë periudhës së auditimit.

-Praktikat e shqyrtimit të ankimeve administrative nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për periudhën 01.06.2020-31.12.2020, ndaj masave administrative të vendosura nga DRAKU Tiranë, kërkuar nga grupi i auditimit me shkresën nr.87 prot., datë 15.01.2021 drejtuar DRAKU Tiranë dhe DPAKU, si dhe vendosur në dispozicion të grupit të auditimit nga DPAKU, me shkresën nr.182/1 prot., datë 04.02.2021.

1.Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-006039-5, datë 23.09.2019, ndaj subjektit S, NIPT L81702016P, me aktivitet përpunim dhe tregëtim me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore, janë vendosur **4 gjoba** me vlerën **2,900,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për mungesën e licencës; 500,000 lekë për nxjerrjen në treg të ushqimeve të pasigurta; 200,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë dhe 200,000 lekë për veprimet në kundërshtim me përgjegjësit e operatorit);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.8315 prot., datë **07.11.2019**, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.8315/1 prot., datë 27.07.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 2,900,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, Kryetar i Komisionit, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:

-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 2,900,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
-Ankimi administrativ i bërë nga subjekti, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, për kundërshtimin e gjobës së vendosur nga inspektorët në vendimin e inspektimit, **nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor**;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së dhe në kushtet e marrjes së vendimit jashtë afatit, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.8315/1, datë **27.07.2020** është **absolutisht i pavlefshëm[52].**

2. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2018-004906-1, datë 01.08.2019, ndaj subjektit L, NIPT L31806005S, me aktivitet restorant, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **2,500,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për mungesën e licencës; 500,000 lekë për mosrespektim të kushteve të higjienës);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.5511 prot., datë **10.08.2019**, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.5511/1 prot., datë 23.06.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 2,500,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti privat L, veç ankesës së drejtuar DPAKU, ka bërë edhe kërkes-padi në GJSHP Tiranë, e cila me Vendimin nr.1220, datë 23.06.2020, **ka pranuar pjesërisht** kërkes padinë e subjektit privat dhe ka lënë në **fuqi** gjobën në vlerën **1,300,000 lekë** nga 2,500,000 lekë; Në vijim DRAKU ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, me objekt ndryshimin e vendimit të GJSHP Tiranë dhe rrëzimin e kërkes-padisë së subjektit privat; Pra ndaj gjobës së vendosur nga inspektorët, është hapur një çështje gjyqësore, e cila në kohën kur është marrë Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve në DPAKU, ka qenë në shkallën e dytë të gjykimit, pra atë të apelit;
-Pavarsisht këtij fakti (që ka patur një proces gjyqësor të pa përfunduar), ku të dyja Drejtoritë, DPAKU dhe DRAKU, kanë qenë palë e paditur, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve në DPAKU, ka dalë me vendim, duke shfuqizuar gjobën në vlerën 2,500,000 lekë, ç'ka ka sjellë që DRAKU Tiranë të tërhiqet nga ankimi i bërë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke bërë përfundimin e proçesit, por njëkohësisht duke i dhënë formë të prerë Vendimit të GJSHP Tiranë;
-Gjithashtu Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 2,500,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së dhe në kushtet e marrjes së vendimit jashtë afatit, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr. 5511/1, datë **23.06.2020** është **absolutisht i pavlefshëm**, **dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,300,000 lekë (Gjoba e lënë në fuqi me Vendimin** nr.1220, datë 23.06.2020 të GJSHP Tiranë**).**

[52] Neni 110 i Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"

3. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-002772-5, datë 17.05.2019, ndaj subjektit A, NIPT L42419006N, me aktivitet magazinim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore, është vendosur **1 gjobë** me vlerën **2,000,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për mungesën e licencës);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3534 prot., datë **11.06.2019**, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobës së vendosur nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3534/1 prot., datë 11.09.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobës në vlerën 2,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 2,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3534/1, datë **11.09.2020** është **absolutisht i pavlefshëm**.

4. Me procesverbalin e vendimit të inspektimit me nr., serial 0040656, datë 22.01.2019, ndaj subjektit A, NIPT L42419006N, me aktivitet magazinim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore, janë vendosur **3 gjoba** me vlerën **450,000 lekë** gjithsej (300,000 lekë për kushtet e higjienës, 100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë dhe 50,000 lekë për etiketimin);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.899 prot., datë 05.02.2018, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobës së vendosur nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.899/1 prot., datë 11.09.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 450,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobat prej 450,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.899/1, datë **11.09.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**
Pra në të njëjtën ditë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve në DPAKU, me dy vendime, ka shfuqizuar 4 gjoba ndaj të njëjtit subjekt, në vlerën 2,450,000 lekë gjithsej.

5. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-003598-5, datë 16.06.2019, ndaj subjektit F, NIPT L82419011H, me aktivitet prodhim dhe tregëtim të akullores (produkte me origjinë shtazore), është vendosur **1 gjobë** me vlerën **2,000,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për mungesën e licencës);

-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3758 prot., datë 20.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobës së vendosur nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3758/1 prot., datë 17.09.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobës në vlerën 2,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 2,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3758/1, datë **17.09.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**

6. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-002671-5, datë 13.05.2019, ndaj subjektit N, NIPT K41822008H, me aktivitet magazinë importi të produkteve ushqimore, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **1,100,000 lekë** gjithsej (1,000,000 lekë për importin e produkteve në kundërshtim me ligjin dhe 100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3522 prot., datë 11.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3522/1 prot., datë 01.10.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 1,000,000 lekë, dhe ka lënë në fuqi vetëm gjobën 100,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.L.I, zj.A.K dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti privat N, veç ankesës së drejtuar DPAKU, ka bërë edhe kërkes-padi në **GJSHP Tiranë**, e cila me *Vendimin **nr.3926**, datë 13.11.2019*, ka pranuar pjesërisht kërkes padinë e subjektit privat (shfuqizimin e gjobës në vlerën 1,000,000 lekë); Në vijim DRAKU ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, me objekt ndryshimin e vendimit të GJSHP Tiranë dhe rrëzimin e kërkes-padisë së subjektit privat; Pra ndaj gjobës së vendosur nga inspektorët, është hapur një çështje gjyqësore, e cila në kohën kur është marrë Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve në DPAKU, *ka qenë në shkallën e dytë të gjykimit, pra atë të apelit;*
-Pavarsisht këtij fakti (që ka patur një proces gjyqësor të pa përfunduar), ku të dyja Drejtoritë, DPAKU dhe DRAKU, kanë qenë palë e paditur, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve në DPAKU, ka dalë me vendim, duke shfuqizuar gjobën në vlerën 1,000,000 lekë;
-Gjithashtu Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 1,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së kur çështja është duke u gjykuar në apel, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3522/1, datë **01.10.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**

7. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-002428-5, datë 02.05.2019, ndaj subjektit T, NIPT L61719025E, me aktivitet import-eksport, shpërndarje e produkteve ushqimore, është vendosur **1 gjobë** me vlerën **1,000,000 lekë** gjithsej (1,000,000 lekë për importimin e ushqimit në kundërshtim me kërkesat ligjore);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3494 prot., datë 10.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobës së vendosur nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3494/1 prot., datë 28.08.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobës në vlerën 1,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A..
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar tërësisht gjobën prej 1,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3494/1, datë **28.08.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**

8. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-001696-5, datë 29.03.2019, ndaj subjektit B, NIPT K51713036L, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **400,000 lekë** gjithsej (300,000 lekë për kushtet higjieno-sanitare dhe 100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.2347 prot., datë 18.04.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.2347/1 prot., datë 29.9.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobës në vlerën 100,000 lekë, dhe ka lënë në fuqi vetëm gjobën 300,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.R.L, ish Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, për periudhën Tetor 2019-Tetor 2020, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, zj.A.K dhe zj.I.A..
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 100,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.2347/1 prot., datë 29.9.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

9.Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-005152-5, datë 16.08.2019, ndaj subjektit T, NIPT L31506004B, me aktivitet tregëtim me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore, janë vendosur **3 gjoba** me vlerën **2,400,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për mungesën e licencës; 200,000 lekë për planin e vetëkontrollit HACCP dhe 200,000 lekë për veprimet në kundërshtim me përgjegjësit e operatorit);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.5816 prot., datë 21.10.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;

-Me vendimin **nr.5816/1 prot., datë 21.10.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur ndryshimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 2,400,000 lekë, duke shfuqizuar plotësisht dy gjoba në vlerën 2,200,000 lekë gjithsej, dhe shfuqizuar pjesërisht një gjobë nga 200,000 lekë në 100,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar pjesërisht gjobën prej 2,400,000 lekë, duke lënë në fuqi vetëm 100,000 lekë, pra ka shfuqizuar 2,300,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
-Ankimi administrativ i bërë nga subjekti, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, për kundërshtimin e gjobës së vendosur nga inspektorët në vendimin e inspektimit, **nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor, për të cilën mbanë përgjegjësi z.R.L, i cili ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së, në kohën kur është bërë ankesa nga subjekti**;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.5816/1, datë **21.10.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**

10. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-005932-5, datë 17.09.2019, ndaj subjektit R, NIPT L91405033M, me aktivitet Bar&Snack, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **700,000 lekë** gjithsej (500,000 lekë për kushtet e higjienës dhe 200,000 lekë për planin e vetëkontrollit HACCP);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.7698 prot., datë **25.10.2019**, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.7698/1 prot., datë 04.11.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 700,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-AKU me shkresën nr.1211 prot., datë 06.03.2020 ka bërë kërkesën në **GJSHP Tiranë**, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe me ***Vendimin nr.400****, datë 08.06.2020 ka vendosur* ***pranimin e kërkesës*** dhe ***lëshimin e urdhrit të ekzuktimit*** të titullit ekzekutiv nr.AKU-TR-2019-005932-5, datë 17.09.2019, si dhe urdhërimin e zyrës së përmbarimit të bëjë ekzekutimin, **ndërkohë** që gjoba **më pas**, është **shfuqizuar** nga Komisioni. Për këtë vendim të GJSHP, nuk ka patur ankesë nga subjekti privat në Gjykatën Administrative të Apelit, duke e kthyer në vendim të formës së prerë.
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 700,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
-Ankimi administrativ i bërë nga subjekti, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, për kundërshtimin e gjobës së vendosur nga inspektorët në vendimin e inspektimit, **nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor**, **për të cilën mbanë përgjegjësi z.R.L, i cili ka qenë Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së, në kohën kur është bërë ankesa nga subjekti**;
-Vendimi nr.7698/1 prot., datë 04.11.2020, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve, është në **kundërshtim me Vendimin nr.400, datë 08.06.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë**, i cili ka lëshuar urdhër ekzekutimi për gjobën e vendosur;

▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së dhe në kundërshtim me Vendimin e GJSHP Tiranë, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.7698/1, datë 04.11.2020 është **absolutisht i pavlefshëm**, **dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 700,000 lekë.**

11. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-002283-5, datë 24.04.2019, ndaj subjektit T Shpk, NIPT L52602402T, me aktivitet Magazinë Ushqimore, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **1,100,000 lekë** gjithsej (1,000,000 lekë për mosrespektimin e rregullave të importit dhe 100,000 lekë për sistemin e gjurmueshmërisë);
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3006 prot., datë 21.05.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3006/1 prot., datë 10.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 1,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 1,100,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-s, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3006/1, datë 10.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

12. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-003140-5, datë 29.05.2019, ndaj subjektit L, NIPT L62211039O, me aktivitet Bar-Kafe dhe Akullore, janë vendosur **3 gjoba** me vlerën **900,000 lekë** gjithsej (500,000 lekë për mosrespektimin e kushteve higjenike, 200,000 lekë për sistemin e gjurmueshmërisë, 100,000 lekë për sistemin HACCP dhe 100,000 lekë për etiketimin e produktit të akullores). Ky inspektim është iniciuar mbi bazën e ankesave të ardhura nga konsumatorët.
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3540 prot., datë 12.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3540/1 prot., datë 9.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur ndryshimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave nga vlera 900,000 lekë, bëhet në 500,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka ndryshuar gjobën prej 900,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3540/1, datë 09.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

13. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-002774-5, datë 17.05.2019, ndaj subjektit K, , me aktivitet shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore, janë vendosur **3 gjoba** me vlerën **2,300,000 lekë** gjithsej (100,000 lekë për etiketimin, 200,000 lekë për mosrespektimin e përgjegjësive të operatorit, dhe 2,000,000 lekë për mosrespektimin e rregullave të importit).
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3863 prot., datë 25.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3863/1 prot., datë 14.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 2,300,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 2,300,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi **nr.3863/1 prot., datë 14.12.2020** është **absolutisht i pavlefshëm.**

14. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-001779-5, datë 02.04.2019, ndaj subjektit N, NIPT L91311036R, me aktivitet market ushqimor, është vendosur **1 gjobë** me vlerën **1,000,000 lekë** gjithsej (1,000,000 lekë për ushtrimin e aktivitetit pa licencë). Ky inspektim është autorizuar mbi bazën e indicieve të ardhura në DRAKU Tiranë.
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.2069 prot., datë 08.04.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.2069/1 prot., datë 10.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 1,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka ndryshuar gjobën prej 1,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.2069/1, datë 10.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

15. Me vendimin përfundimtar të inspektimit me nr., serial 0015249-17, datë 25.10.2017, ndaj subjektit I shpk, NIPT K62414003L, me aktivitet tregëtim i produkteve ushqimore, janë vendosur **5 gjoba** me vlerën **1,150,000 lekë** gjithsej (500,000 lekë për mosrespektimin e kushteve higjienike, 300,000 lekë për nxjerrjen në treg të ushqimeve të pasigurta, 200,000 lekë për mungesën e sistemit HACCP, 100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë dhe 50,000 lekë për mosrealizimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm).

-Me shkresën *nr.1268 prot., datë 10.03.2020, **DPAKU** ka bërë kërkesë në **GJSHP Tiranë** për lëshim urdhri ekzekutimi të gjobës së vendosur;*
-Me **Vendimin nr.339, datë 10.03.2020 të GJSHP Tiranë, është pranuar kërkesa e DPAKU** dhe lëshimi i urdhrit të ekzekutimit të gjobave të vendosura. Nga subjekti privat nuk është bërë ankesë në Gjykatën Administrative të Apelit, për vendimin e GJSHP Tiranë, duke e kthyer atë në vendim të formës së prerë.
-Ndërkohë pas vendimit të GJSHP Tiranë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve pranë DPAKU-së, me vendimin **nr.5657 prot., datë 28.12.2020**, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 1,150,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobat prej 1,150,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së dhe **në kundërshtim me Vendimin nr.339, datë 10.03.2020, të GJSHP Tiranë**[53], gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.5657, datë 28.12.2020 i Komisionit është **absolutisht i pavlefshëm**, **dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,150,000 lekë.**

16. Me vendimin përfundimtar të inspektimit me nr., serial A000004502-15-T, datë 03.05.2016, ndaj subjektit I shpk, NIPT K62414003L, me aktivitet tregëtim i produkteve ushqimore, janë vendosur **4 gjoba** me vlerën **550,000 lekë** gjithsej (100,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë, 100,000 lekë për mungesën e sistemit HACCP, 300,000 lekë për mosrespektimin e kushteve higjienike dhe 50,000 lekë për etiketimin).
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.1880 prot., datë 18.05.2016, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.1880/1 prot., datë 24.04.2019 (pra rreth 3 vite më vonë)**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur lënien në fuqi të gjobave** dhe rrëzimin e ankimit të subjektit, vendim i cili është protokolluar në DRAKU Tiranë me shkresën nr.1635, datë 30.04.2019. Vendimi i nënshkruar nga **z.A.H**, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së;
-Subjekti ndaj këtij vendimi ka bërë kërkes-padi në GJSHP Tiranë, e cila me **Vendimin *nr.3337***, *datë 10.10.2019 **e ka rrëzuar**, dhe në vijim subjekti e ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, referuar nr., të çështjes 31154-04034-86-2019, e cila është regjistruar në Gjykatën e Apelit më datë 11.11.2019, dhe nga ky moment nuk ka patur një vendim përfundimtar;*
-Me vendimin **nr.5656 prot., datë 28.11.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, nënshkruar **nga z.B.S, Kryetar**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 550,000 lekë, **megjithëse çështja është në shqyrtim në apel**,
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobat prej 550,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
-Vendimi i dytë i Komisionit i DPAKU-së, në gjykimin e grupit të auditimit është i pavlefshëm për arsye se, ndaj kësaj ankese ka një Vendim të mëparshëm nga po ky Komision (i cili e ka lënë

[53] Pikën 2 të nenit 65 të Ligjit Nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

në fuqi), dhe në këtë rast ky vendim mund të shfuqizohej vetëm nga Gjykata e Shkallës së Parë, por jo nga e njëjta strukturë e cila, nuk ka kompetencë ligjore që të shfuqizojë një vendim që e ka nxjerrë vetë më përpara;
-*Gjithashtu theksojmë se ndaj kësaj ankese, nuk duhet të kishte një vendim nga Komisioni, për arsye se ka një çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila nuk ka dalë akoma me një vendim të formës së prerë.*
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së dhe në kundërshtim me Vendimin e parë të nxjerrë nga ky Komision, si dhe në kushtet kur ka një proces gjyqësor[54], gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.5656, datë 28.11.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

17. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-003597-5, datë 17.06.2019, ndaj subjektit M, NIPT L52010028K, me aktivitet furrë buke dhe pastiçeri, janë vendosur **2 gjoba** me vlerën **2,000,000 lekë** gjithsej (1,500,000 lekë për ushtrimin e aktivitetit pa licencë dhe 500,000 për nxjerrjen në treg të ushqimeve të pasigurta, për arsye se gjatë inspektimit, subjektit iu gjendën produkte jashtë afatit të skadencës).
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3787 prot., datë 21.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3787/1 prot., datë 10.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 2,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
<u>Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:</u>
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobat prej 2,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;
▪ Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3787/1, datë 10.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**
18. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-003400-5, datë 11.06.2019, ndaj subjektit Y, NIPT K81504040O, me aktivitet përpunim dhe tregëtim të bimëve medicinale, janë vendosur **5 gjoba** me vlerën **1,800,000 lekë** gjithsej (1,000,000 lekë për ushtrimin e aktivitetit pa licencë, 300,000 lekë për kushtet higjenike, 200,000 lekë për mungesën e sistemit HACCP, 200,000 lekë për mungesën e sistemit të gjurmueshmërisë dhe 100,000 për etiketimin).
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.3766 prot., datë 20.06.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.3766/1 prot., datë 10.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobave në vlerën 1,800,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
<u>Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:</u>

[54] nenin 36 dhe 449 të "Kodit të Procedurës Civile në RSH", i ndryshuar;

-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobat prej 1,800,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;

- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.3766/1, datë 10.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

19. Me vendimin përfundimtar të inspektimit nr.AKU-TR-2019-003716-5, datë 21.07.2019, ndaj subjektit L, NIPT K41405003J, me aktivitet prodhim, përpunim dhe tregëtim të produkteve ushqimore, brumi, akullore, embelsira), është vendosur **1 gjobë** me vlerën **2,000,000 lekë** gjithsej (2,000,000 lekë për ushtrimin e aktivitetit pa licencë).
-Ndaj këtij vendimi, subjekti me shkresën nr.5162 prot., datë 31.07.2019, ka bërë ankim, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për shqyrtimin e gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë;
-Me vendimin **nr.5162/1 prot., datë 10.12.2020**, Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve të AKU-së, **ka vendosur shfuqizimin e vendimit përfundimtar** të inspektimit dhe gjobës në vlerën 2,000,000 lekë;
-Vendimi i nënshkruar **nga z.B.S, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**, si dhe anëtarët e Komisionit zj.A.H, z.B.K, z.L.I dhe zj.I.A.
Nga shqyrtimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:
-Vendimi i Komisionit, i cili **ka shfuqizuar gjobën prej 2,000,000 lekë**, të vendosur nga inspektorët e DRAKU Tiranë, është marrë në shkelje të hapur të kuadrit ligjor, dhe në mungesë të kompetencës ligjore;

- Sa më sipër në kushtet e mungesës së kompetencës ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të gjobave me vlerë mbi 300,000, nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve pranë DPAKU-së, gjykojmë dhe vlerësojmë se Vendimi nr.5162/1, datë 10.12.2020 është **absolutisht i pavlefshëm.**

Këto veprime dhe mosveprime në praktikat e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:
-Pikën 2 dhe 5 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", për arsye se në pikën 2 të nenit të mësipërm përcaktohet që:

Neni 91 **Afati për përfundimin e procedurës administrative** 2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

- Për të vijuar tek Ligji i posaçëm nr.9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar, ku në pikën 3 të nenit 70 përcaktohet që:

Neni 70 **Procedura e kundërvajtjes administrative** (ndryshuar me ligjin nr. 74/2013, datë 14.2.2013 dhe me ligjin nr. 16/2020, datë 12.2.2020) 3. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative bëhet në përputhje me këtë ligj dhe **legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin**.

- Për të vijuar me Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ku në pikën 1 të nenit 17 përcaktohet që:

Neni 17

Afatet e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Për të vijuar në pikën 2, shkronja "c", të këtij Ligji, ku përcaktohet që:
2. Nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni përjashtohen ato raste, për të cilat:
a) kompetente për shqyrtimin e kundërvajtjes është gjykata;
b) ligji i veçantë ka parashikuar afate të ndryshme;
c) **konstatimi i shkeljeve bëhet nga struktura auditimi apo inspektimi.**
Gjatë kryerjes së auditimeve apo inspektimeve, **afatet dhe procedurat rregullohen nga ligji i posaçëm.**

- Në vijim, ligji i posaçëm që rregullon veprimtarinë e inspektimit, Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ku në pikën 1 të nenit 51 përcaktohet që:

Neni 51
Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit
1. Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të **Kodit të Procedurave Administrative.**

- Sa më sipër arrijmë në referencën ligjore të bërë në pikën 2 të nenit 91 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

-Pikën 2 të nenit 65 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, për praktikat nr.2; 10; 15;
-Nenin 36 dhe nenin 449 të "Kodit të Procedurës Civile në RSH", i ndryshuar, nr.2; 6; dhe 16;
-Pikat 1 dhe 2 të nenit 70/1 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht:

Neni 70/1 Shqyrtimi i ankimit të masave administrative
1.Për **shqyrtimin e ankesave** ndaj masave administrative të marra nga inspektorët e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, gjatë kryerjes së një inspektimi, me vlerë të përgjithshme **mbi 300,000 lekë**, **në ministri ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Masave Administrative**, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë, tre përfaqësues të ministrisë dhe dy përfaqësues nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.
2.Procedurat e organizimit dhe të funksionimit të komisioneve të shqyrtimit të masave administrative, përfshirë kryesimin, sekretariatin, ndryshimin e anëtarëve dhe masën e shpërblimit të Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative përcaktohen me **Vendim të Këshillit të Ministrave".**

-Në dispozitën kalimtare të nenit 73 të po këtij Ligji, ku thuhet shprehimisht:

Ankesat për gjobat **mbi 300,000 lekë**, deri në ditën që hyn në fuqi **Vendimi i Këshillit të Ministrave** për funksionimin dhe organizimin e Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative në ministri, bëhen pranë komisionit të ankesave në institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe përfundojnë shqyrtimin në këtë komision.

-Sa më sipër VKM për funksionimin dhe organizimin e Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative në ministri, ka dalë **më datë 27.05.2020** me nr.417 dhe është botuar në fletoren zyrtare më datë **01.06.2020**.
-Gjithashtu në vijim, në Kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 "Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin", përcaktohet se: "Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kalon në Komisionin e Ministrisë së Bujqësisë, të gjitha ankesat dhe dosjet përkatëse **brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e VKM-së, e cila, e përsërisim edhe njëherë, ka hyrë në fuqi më datë 01.06.2020.**

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, *rekomandojmë*:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në **21 raste** në vlerën **31,550,000 lekë**, nga ky Komision janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, nga të cilat në:
-**14 raste** për subjektet (S.D.T, A.F, F.B, T.C.C, T.A, T.P, L.H, K.F.T, M.N, M.S.D, Y.M, L.S), në vlerën **21,350,000 lekë** gjithsej, janë shfuqizuar gjobat në mungesë të kompetencës ligjore dhe jashtë afatit, 2 raste prej tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*
-**5 raste** për subjektet (A.B, B.N, O.C, C.A), në vlerën **8,650,000 lekë** në mungesë të arsyetimit ligjor nga Komisioni përkatës pranë DPAKU. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*
-**2 raste** për subjektet (I dhe N), në vlerën **1,550,000 lekë**, janë shfuqizuar gjobat, ndërkohë që ato kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, pra Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat nuk ka patur ende vendim përfundimtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*
Këto veprime nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 dhe 5 të nenit 91, nenin 99 dhe 100, të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Nenin 36 dhe nenin 449 të "Kodit të Procedurës Civile në RSH", i ndryshuar, shkronjat "d", "e", "f", "g", "h", "i", "k", të pikës 1 të nenit 68, pikat 1 dhe 2 të nenit 70/1 dhe nenin 73 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, si dhe Kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 "Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4, 2.5 dhe 2.10) faqe (27-140; 140-191 dhe 256-266) të Raportit të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë dhe DPAKU në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjobat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përjashtuar 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjykimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme.
1.2.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, **për 2 gjobat,** të cilat kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e ecurisë së procesit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.557/10, datë 22.09.2015, nuk janë zbatuar rekomandimet si më poshtë vijon:
Rekomandimi 1: "MBZHRAU dhe DPAKU të marrin masa për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti dhe tarifave të tyre, referuar Udhëzimit nr.8, datë 08.05.2007 "Për përcaktimin e tarifave të të ardhurave dytësore".
Rekomandimi nr.2:DPAKU të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos apelimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, në dy raste të pagesave të punonjësve të larguar nga puna.
Rekomandimi nr.3:DRAKU Tiranë të marri masat për certefikimin e laboratorit.
Rekomandimi nr.5:DRAKU Tiranë të përgatitë dokumentacionin ligjor të pronësisë për objektin që i është vënë në dispozicion nga MBZHRAU, si dhe të bëjë kontabilizimin e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-20) të Raportit të Auditimit)*
2.1.Rekomandimi: Titullari i DRAKU Tiranë për rekomandimet nr.1, 2, 3 dhe 5 të lëna në auditimin e mëparshëm, të marrë masat e nevojshme për analizimin dhe vlerësimin e mundësisë së zbatimit të tyre.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin", i ndryshuar dhe me urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm nr. 2363 datë 30.03.2018, DRAKU Tiranë **nuk ka dorëzuar pranë rezervave shtetërore për ankand, pajisjet dhe sendet sekuestruara/konfiskuara**, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, por ato qëndrojnë prej 3 vitesh në magazinën e AKU, në dëm të biznesit dhe administrimit tyre. DRAKU Tiranë pajisjet e konfiskuara ndaj 18 subjekteve në vitin 2018 i ka dorëzuar pa vlerë duke i pasqyruar vetëm në sasi. Padrejtësisht në flet hyrjen nr. 2 datë 07.05.2018 të AKU thuhet se: 5 frigoriferët janë jashtë përdorimit, sepse nuk argumentohet me dokumente, pasi mungon procesverbali i specialistit fushës dhe pasqyra e amortizimit si dhe viti blerjes. Gjithashtu pajisjet jo në gjendje pune nuk konfiskohen sepse janë objekt nxjerrjes jashtë përdorimit. Për rrjedhojë frigoriferët që pretendohen se janë jashtë përdorimit nuk mund të kalojnë në rezervat shtetërore, pasi bie ndesh me pikën 4/c te UKM nr. 1 datë 18.02.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*
3.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marrë masa për kalimin në pranë rezervave shtetërore të pajisjeve dhe sendeve sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, sipas flet hyrjes nr.2 datë 07.05.2018 të AKU.

Menjëherë

4.Gjetje: Plani vjetor i inspektimit, nuk është hartuar sipas standardeve të kërkuara nga Inspektorati Qendror me tematikë inspektimi dhe parashikimin e numrit të përgjithshëm të inspektimeve që do të kryhen, si dhe programet mujore për periudhën 2018-2020 nuk janë hartuar, miratuar si dhe nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.696, datë 16.08.2013 dhe Urdhrit nr.6, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm;

-Në metodikën për përcaktimin e riskut të subjektit, frekuencën e inspektimeve dhe marrjen e mostrave për analizë laboratorike, nuk merret në konsideratë, si faktor vlerësues, historiku i subjektit[55], ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit, marrja e tij në konsideratë, është e rëndësishme, pasi në subjektet, të cilat në rreth 3 vitet e fundit nuk kanë patur shkelje ligjore përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, mund të reduktohet numri i inspektimeve vjetore, duke siguruar në këtë mënyrë përdorimin eficient të burimeve njerëzore.
-Për 26 subjekte me aktivitet të madh nuk janë planifikuar për inspektim dhe nuk është kryer inspektimi i tyre për një periudhë 2-3 vjeçare, duke diferencuar subjektet, pasi disa subjekte janë inspektuar deri në 30 herë në vit. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*
4.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, për subjektet e inspektuara në 3 vitet e fundit, të bëjë një vlerësim të sjelljes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, si dhe në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët) e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre.
4.2.Rekomandimi: Gjithashtu në planin vjetor të planifikohen të gjitha subjektet për inspektim pa diferencime, si dhe ai dhe planet mujore ti përcillen për mendim Inspektoratit Qendror dhe më pas të miratohen nga titullari i institucionit.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

5.Gjetje: Laboratori i DRAKU Tiranë, tashmë në varësi direkte të DPAKU-së, ende nuk është i akredituar[56] për kryerjen e analizave të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore[57].*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*
5.1. Rekomandimi: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë të marrin masat e nevojshme që të fillojnë procesin e akreditimit të laboratorit.
5.2. Rekomandimi: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë të marrin masat për kryerjen e investimeve të nevojshme në përmirësimin e kushteve të laboratorit (dhoma e pranimit dhe e qëndrimit të mostrave, sistemin e kondicionimit, aspirimit), si dhe kalibrimin dhe vënien në funksion të plotë aparaturave laboratorike, me qëllim rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të analizave laboratorike.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

6.Gjetje: Ndërmjet sektorit të laboratorit dhe atij të inspektimit në DRAKU Tiranë ka munguar koordinimi në përcaktimin e treguesve mikrobiologjik që duhet të analizohen për një mostër të kontrollit zyrtar, ku theksojmë se treguesi që do të analizohet përcaktohet nga inspektori dhe jo nga specialisti i laboratorit, referuar këtu edhe përcaktimit të bërë në Urdhrin nr.261, datë 10.09.2009 "Për miratimin e rregullores mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*
6.1.Rekomandimi: DPAKU të marri masat e nevojshme që për çdo mostër të sjellë nga kontrolli zyrtar, treguesit që do të analizohen të përcaktohen nga specialistët e laboratorit, si dhe nga inspektorët në fletë-shoqërimin e mostrës të përcaktohet qartë se në çfarë kushtesh është ruajtur produkti prej nga është marrë mostra, duke shërbyer si tregues për laboratorin në përcaktimin e treguesit që do të analizohet.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

7.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore, në **12 raste** është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat

[55] Pika 2.6, kapitulli II programimi i veprimtarive të inspektimit, Urdhëri nr.13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë".
[56] Shkronja g, pika 3 të Udhëzimit nr.14, datë 13.12.2012 "Mbi kriteret që duhet të plotësojë një laborator veterinar i autorizuar".
[57] Rregullore e Komisionit dhe Parlamentit të BE-së -765-2008 – Akreditimi, Mbikqyrja e Tregut; Strategjia per mbrojtjen e konsumatoreve dhe mbikqyrjen e tregut, plani i veprimit, fusha-1.1.1-Siguria e produkteve Ushqimore.

kanë qenë në shkelje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambjentet e subjekteve private, si B.Z.F sh.p.k., dhe K sh.p.k., në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën ç të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 43, të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", si dhe përcaktimit të bërë në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Theksojmë se ky veprim është kryer në tejkalim të kompetencave ligjore, pasi për kryerjen e tij, (pra mishin e konfiskuar ta dërgosh në ambjentet e një tjetër subjekti privat), nuk ka patur minimalisht as edhe një kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike, ndërmjet AKU dhe këtyre subjekteve, që të lejonte kryerjen e këtij veprimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: DRAKU dhe DPAKU të marrin masat e nevojshme, duke analizuar dhe vlerësuar mundësitë e investimit në blerjen e dhomave frigoriferike ose marrjes me qira të tyre, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjesohen, të ruhen në këto ambjente. Nëse ky proces finalizohet, të sigurohen mimalisht 4 dhoma frigoriferike, pra 1 dhomë në dispozicion të 3 Qarqeve, më konkretisht dhoma frigoriferike për DRAKU Tiranë, të shërbejë edhe për DRAKU Elbasan dhe DRAKU Durrës, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në subjektet e inspektuara, t'u tarifohet atyre, deri në momentin e asgjesimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet sipas përcaktimeve të Ligjit të ushqimit, nuk do t'i lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit ta futet përsëri në treg.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

8.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të asgjesimit të produkteve, të cilave u ka kaluar afati i përdorimit ose kanë qenë të dëmtuara dhe nuk mund të konsumohen, është konstatuar se në **59 raste,** procedura e asgjesimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 69 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, pasi në këto praktika nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjesimit, si procesverbali i asgjesimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjesimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sh), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë, të marri masat e nevojshme, që çdo proçedurë asgjesimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe: Procesverbali i asgjesimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

Në vijimësi

9.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit (kryesisht atyre me ankesë/indicie), në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve

ushqimore të ndryshme dhe linjës së prodhimit, është konstatuar se **në 35 raste** nuk dokumentohet me shenjat dalluese dhe më pas administrimi i tyre për produktet, konkretisht për:
-27,890 kg mish, i ndryshëm;
-20,000 kg djath për praninë e vajit të palmës, për të cilin ka patur ankesë nga konsumator;
-20,525 kg yndyrë vegjetale, e shitur në treg si gjalp, për të cilën është lënë detyrë e tërheqjes nga tregu, por që nuk administrohet informacion se çfarë është bërë me këtë sasi;
-9,132 kg produkte të ndryshme (mocarela, briosh, djathra, etj);
-4,242 litra vaj të cilat janë shitur, ndërkohë që analizat laboratorike të këtij vaji, të kryera më pas, kanë dalë jashtë standardit, dhe ky vaj nuk u tërhoq nga tregu;
-587 kg yndyrë vegjetale e cila ishte shitur në treg si gjalp;
-516 cop pasta C;
-3 raste të bllokimit të aktivitetit/linjës së prodhimit.
Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 të nenit 40 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, shkronjën a të nenit 41, shkronjën ç të pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*
9.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat e nevojshme, që të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjitës për bllokimin e produkteve, plumbçe për bllokimin e aktivitetit/linjës së prodhimit, këtu mund t'i referoheni praktikës që ndjekin autoritetet doganore/Inspektorati Shtetor Teknik Industrial), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shënjat dalluese dhe përdorimi i tyre të përcaktohet si detyrim ligjor në rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit me qëllim licencimin e aktivitetit, në **11 raste** janë konstatuar mangësi dhe moszbatim i kuadrit ligjor përkatës, si vijon:
-Në 4 raste është bërë refuzimi i aplikimit të subjektit për licencim, për mosplotësim të kushteve teknike, por nuk është bërë edhe ndalimi i ushtrimit të aktivitetit, si dhe përcaktimi i afatit konkret për rregullimin dhe plotësimin e kushteve për licencim;
-Në 6 raste nuk dokumentohen veprimet e inspektorëve përgjatë verifikimit të kushteve teknologjike, higjenike si dhe të dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
-Në 1 rast është miratuar aplikimi për licencim, ndërkohë që dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, ka patur mangësi në formë dhe përmbajtje, dhe për rrjedhojë aplikimi nuk duhej miratuar. Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën "a" të nenit 92, nenin 680 dhe nenin 818 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil", i ndryshuar; pikën 3 të nenit 3 dhe nenin 19 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar; shkronjat ç dhe d të pikës 2 të nenit 4, pikat 2 dhe 3 të nenit 6 dhe pikën 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; pikën 2 të nenit 3, pikën 1 të nenit 5, si dhe shkronjat "a" dhe "b" të nenit 6 të Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; pikat 14 dhe 15, (licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.I.B), të VKM nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar; shtojcën II të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", si dhe shkronjën b të nenit 49 të Rregullores së brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që në çdo rast të refuzimit të aplikimit për licencim, të bëjë ndalimin e ushtrimit të aktivitetit si dhe përcaktimin e afatit konkret për rregullimin e mangësive.
10.2.Rekomandimi: Gjithashtu në çdo praktikë licencimi të administrohet aplikimi i subjektit, dokumentacioni i dorëzuar nga ai (cerifikata kualifikimi, certifikata cilësie, të higjenës, të pajisjeve etj), si dhe të dokumentohet me foto çdo verifikim i kryer në subjekt, për vlerësimin e plotësimit të kushteve për licencim.

Në vijimësi

11.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, ku theksojmë se në këto praktika janë konstatuar edhe raste të trajtimit me dy standard (inspektimi për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në subjektin "Y.M", "A.F", ose për subjekte të tjera është përcaktuar afati kohor i korrigjimit të shkeljeve (D, E.M, C, G), veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe pikën 16 të Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*
11.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre, si dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi

12.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të mostërmarrjes për analizë laboratorike, në **20 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është dokumentuar plotësisht dhe saktësisht procedura e marrjes së mostrës në subjekt, ose nuk është nuk është marrë mostër me pretendimin se ISUV pranon mostra për analizë deri në orën 13:00, si dhe vendimi i inspektimit është marrë në të njëjtën ditë kur është marrë edhe mostra, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën B (1, 2, 3, 4) të Kreut II, pikën 3 të Kreut III dhe pikat 1 dhe 2 të shkronjës A, si dhe shkronjën "c" të pikës 1 të shkronjës B të Kreut IV të VKM nr.260, datë 27.3.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave", pikën 21 dhe pikën 30 të Kreut V të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018 "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit", Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 "Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.7) faqe (27-140 dhe 203-218) të Raportit të Auditimit)*
12.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë, të marri masat e nevojshme, që çdo proçedurë mostërmarrje, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë: Autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit, fletë-shoqërimi i mostrës në laborator, raport-prova, vendimi përfundimtar i inspektimit, i cili të merret në momentin e përgjigjes së rezultatit të analizës laboratorike.
12.2.Rekomandimi: Gjithashtu DRAKU në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme për pajisjen e inspektorëve me mjetet e nevojshme për marrjen e mostrës dhe transportimin e tyre në laborator.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi

13.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **22 raste** është konstatuar se nga kryeinspektorët e DRAKU Tiranë, janë autorizuar inspektorë të sektorit të inspektimit të bimëve të kryejnë inspektime në subjekte, të cilat tregëtojnë produkte me origjinë shtazore, ose e anasjellta, pra jo sipas formimit profesional të tyre, dhe përfshirja e tyre në inspektime për llogari të një sektori tjetër brenda DRAKU Tiranë, bëhet me urdhër caktimi të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, pasi vetëm ai ka kompetencën ligjore, për kryerjen e lëvizjeve, transferimeve, largimeve, caktimeve, etj, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjat a, b dhe c të pikës 4 të VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", (në fuqi deri në 14.09.2020) si dhe shkronjën "g" të pikës 7 të Kreut III, të VKM nr.708, datë 09.09.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e AKU-së". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.7) faqe (27-140 dhe 203-218) të Raportit të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë, për çdo rast kur është e nevojshme përfshirja e një inspektori të një sektori të caktuar pranë drejtorisë (pra inspektori i sektorit të bimëve të kryejë inspektime në subjekte që tregëtojnë produkte me origjinë shtazore ose e anasjellta), në kryerjen e inspektimeve për llogari të sektorit tjetër, t'i bëjë propozim Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, me qëllim miratimin nga ky i fundit, me urdhër caktimi të lëvizjes/transferimit paralel të inspektorit.

Në vijimësi

14.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **3 raste** është konstatuar se nga inspektorët e pikës kufitare Qafë Thanë dhe Durrës, është lejuar hyrja e produkteve ushqimore në Shqipëri (42 ton yndyrë vegjetale dhe 20 ton djath), ku dokumentet e praktikës së importit kanë patur mangësi në formë dhe përmbajtje, kryesisht (invoice, packing-list, certifikata veterinare, certifikata e analizave laboratorike), janë fotokopje, pa vulën e laboratorit përkatës dhe jo në gjuhën shqipe, mungesa e akt-kontrollit të inspektorëve, si dhe **në 1 rast,** në mënyrë të paligjshme janë zhbllokuar produkte importi të subjektit C, në mungesë të dokumentacioni të origjinës (analiza e cilësisë), sipas urdhrit të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, përcjellë me email-it, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 14, nenin 16, nenin 17 dhe 18, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar; në Urdhrin nr.72, datë 15.03.2011 "Për miratimin e akt-kontrollit mbi inspektimin e produkteve me origjinë jo-shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për çdoganimin e tyre dhe akt-marrje mostre", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: DPAKU, Sektori i Auditit të Brendshëm, ta marri masat e nevojshme duke analizuar mundësitë për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve në 12 Drejtoritë Rajonale të AKU-së, me fokus shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së inspektimit të produkteve të importit, ndjekur nga inspektorët e pikave kufitare, me qëllim identifikimin e mangësive, rregullimin e tyre dhe ngarkimin me përgjegjësi ligjore të personave përkatës, duke rritur në këtë mënyrë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e punonjësve në institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në 1 rast është konstatuar se nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, është nxjerrë urdhër i brendshëm për marrjen e mostrave në subjekte të cilat tregëtojnë fara dhe plehëra për përdorim për bimësi, në mungesë të kompetencës ligjore, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 109 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 1 dhe në pikën 2 të nenit 25, të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në RSH", pikën 2 të nenit 24 të Ligjit nr.17/2020 "Për produktet plehëruese", pikën 3 të shkronjës B të Kreut II, si

dhe shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 4 të shkronjës B të Kreut II të VKM-së nr. 260, datë 27.03.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.7) faqe (203-218) të Raportit të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: DPAKU në çdo rast kur e vlerëson të nevojshëm kryerjen e inspektimeve (përjashtuar ato të iniciuara nga ankesat/indiciet), jashtë planit vjetor të kontrollit zyrtar të miratuar nga Ministri përgjegjës për bujqësinë, të bëjë propozimin shoqëruar me relacionin shpjegues pranë MBZHR-së, dhe pritjen nga kjo e fundit të miratimit/refuzimit të propozimit, me qëllim shmangien e efekteve ligjore dhe financiare që mund të krijohen nga zbatimi i urdhrave të paligjshëm, si dhe duke forcuar në këtë mënyrë edhe elementët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e AKU-së.

Në vijimësi

16.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të autokontrollit laboratorik, në 75 raste janë konstatuar mangësi, si më poshtë vijon:

-51 raste dokumentet standard nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve ligjore, kryesisht fletë-shoqërimi i mostrës nuk pasqyron informacionin për temperaturën e transportit të mostrës, paketimin e kampionit, orën e dorëzimit të mostrës, vendin e marrjes së mostrës, afatin e skadencës së produktit, raport-provat japin informacion për vendin e kampionimit të mostrës (Lot-in), origjinën e mostrës (import apo prodhim i brendshëm), kushtet e ruajtjes, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 3 dhe 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit";

-19 raste në analizat laboratorike ka marrë pjesë edhe përgjegjësja e laboratorit ku në të njëjtën kohë ka bërë edhe pritjen e mostrës në laborator, duke u bërë burim për konflikt interesi në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën "b" (konflikt në dukje i interesit) të pikës 4 të nenit 3 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;

-5 raste sasia e kampionit të sjellë për analizë nuk ka qenë në përputhje me përcaktimin ligjor të bërë në Urdhrin nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit", dhe në këto kushte mostrat nuk duhet të ishin pranuar nga laboratori[58].*(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: DPAKU të marri masat e nevojshme që për çdo rast, dokumentet standarde të laboratorit (autokontroll dhe kontroll zyrtar) të plotësohen saktë në formë dhe përmbajtje. Gjithashtu të mos lejohet marrja pjesë e përgjegjësit të laboratorit në analizat laboratorike me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, si dhe në rastet kur sasia e kampionit të sjellë (autokontroll dhe kontroll zyrtar) nuk është sipas kërkesave teknike, mostra të refuzohet.

Në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: DRAKU Tiranë nuk ka kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2019, Godinën-3-kat të AKU Tiranë në vlerën 520,000 euro, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin*", me ligjin ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të kontabilizojë dhe të pasqyrojë në bilancin financiar Godinën-3-kat të AKU Tiranë, bazuar në situacionin dhe akt kolaudimin përfundimtar të objektit.

---

[58] Pika 4 e Kreut I të Urdhrin nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit".

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

18.Gjetje nga auditimi: Sektori i OJSH-së së DRAKU Tiranë ka përdorur **2 standarde**, pasi:
-për vitin 2018, në 2 raste, për prishje të shenjave dalluese të produktit të bllokuar, ka aplikuar gjobë maksimale 100,000 lekë (I shpk), ndërsa për raste tjera ka aplikuar gjobë minimale 10,000 lekë (A.S dhe L.B),
-për vitin 2018, në 3 raste, nuk ka marrë mostra në OBU (H.Sh), ndërsa në disa tjera ka marrë mostra (K), në një kohë që janë konstatuar shkelje të njëjta.
-për vitin 2018, në 2 raste ka aplikuar diferencim të masës vendosjes gjobës, për etiketim parregullt, pasi ka vendosur gjobë minimale 50,000 lekë ndaj OBU "D", ndërsa ka vendosur gjobë maksimale 100,000 lekë për OBU "E.M", për shkelje njëjta.
-për vitin 2019, në 6 raste, ka vepruar me 2 standarde, lidhur me inspektimet me objekt të njëjtë "indice nga konsumatorët, rrjetet sociale dhe mediat etj", pasi për disa subjekte kanë sjellë prova me foto të qarta (OBU "G"), ndërsa për disa raste tjera nuk kanë ilustruar faktet me foto, e domosdoshme për sqarimin sa më mirë të ankesave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)*
18.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në të ardhmen të eliminojë inspektimet me 2 standarde, duke përdorur një standard inspektimi për gjitha subjektet, në zbatim të kërkesave ligjore, në mënyrë që të mos diskriminojë dhe diferencojë subjektet, të cilat shpesh janë bërë objekt ankesash dhe pakënaqësish ndaj inspektimeve të kryera.

Në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Në DRAKU Tiranë për vitin 2019, u konstatuan:
- në **5 raste** çështje inspektimi të anuluara brenda ditës, megjithëse inspektimi ka filluar me kërkesën subjektit si: AKU-TR-2019-002706; AKU-TR-2019-002705; AKU-TR-2019-003059; AKU-TR-2019-003102; AKU-TR-2019-003101.
- në **3 raste** subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura, por nuk dokumentohet me foto, kërkesë kjo e rregullores së procedurës inspektimit, si: AKU-TR-2019-003182; AKU-TR-2019-000492; AKU-TR-2019-003151.
- në **1 rast** inspektimi tematik me objekt: "*për zbatim urdhri eproreve*" u konstatua se inspektimi nuk është argumentues dhe nuk shoqërohet me dokumente, informacion dhe foto, e domosdoshme kjo për raste të veçanta, madje nuk sqarohet pse lihet detyrë kur nuk pasqyrohet shkelja. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)*
19.1. Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marrë masa që inspektimet e filluara me kërkesën e subjekteve të mos anulohen pa arsye brenda ditës, në rast se subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura të justifikohen me foto, sipas rregullores së procedurës inspektimit, si dhe shkeljet e konstatuara në inspektimet e kryera të shoqërohen me dokumente provuese, kryesisht në inspektimet tematike.

Në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Në DRAKU Tiranë *(sektori OJSH)* për vitin 2020, u konstatuan:
-Në **5 raste**, inspektimet janë mjaftuar me paraqitjen e disa mangësive në godinën e subjekteve, si: mure, tavane, dysheme ose pjesë të tyre të dëmtuara dhe të pa lyera, sikur janë mbikëqyrës ose kolaudator ndërtimi, në vend që të trajtonin edhe sigurinë e produkteve ushqimore, gjurmimin, mostrat, analizat laboratorike, zbatimin e detyrave të lëna, arkëtimin e gjobave, dokumentacionin shoqërues etj.
- Në **10 raste**, përgjigjet e analizave laboratorike për perime e fruta, *për praninë e pesticideve pranë ISUV*, kanë dalë me vonesë prej 3 muaj, çka ka humbur qëllimin e kryerjes të këtyre analizave, sepse perimet e frutat janë shitur plotësisht pasi nuk kanë qenë të bllokuara dhe nuk ka dalë përgjegjësia. Veprim ne kundërshtim me nenin 46/b të rregullores së brendshme AKU

miratuar me urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 377 datë 05.09.2017 dhe me nenin 38/4 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH". (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)*

20.1. Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marrë masa që inspektimet të jenë të plota, të trajtojnë të gjitha problemet e legjislacionit dhe jo duke u mjaftuar vetëm me kushtet higjeno-sanitare, gjendjen e godinave dhe ambjenteve tyre, të cilat përfaqësojnë një pjesë të inspektimit.

20.2. Rekomandimi: Gjithashtu të merren masat e nevojshme që përgjigjet e analizave laboratorike për perime e fruta, *për praninë e pesticideve pranë ISUV*, të sigurohen brenda afatit ligjor dhe pa vonesa me qëllim që të garantohet siguria ushqimore e produkteve të bllokuara, sipas kërkesave të nenit 46/b te rregullores brendshme AKU miratuar me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr.377 datë 05.09.2017 dhe me nenin 38/4 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në RSH".*

Në vijimësi

21.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të marrjes së mostrave për produktet PMB rezulton se nuk është kryer analizimi në vitet 2018-2019, nga laboratori i akredituar siç parashikohet në ligjin 105/2016 kreu II, pika 1.2, germa a,b dhe c. Moskryerja e analizimit ka bërë të mundur që PMB-t për përdorim në vendin tonë nuk i nënshtrohen asnjë analize laboratorike të formulimit për të parë vetitë e tyre fiziko – kimike, përbërjen e lëndës vepruese dhe përmbajtjen e saj në % apo g/L, përbërjen dhe përmbajtjen e lëndëve mbushëse (inerte) si dhe përbërjen e aditivëve që ju shtohen formulimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit)*

21.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, për analizimin e produkteve PMB, duke përgatitur Planin Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK, para hartimit të buxhetit të ISUV për të parashikuar nevojën për reagent dhe standartet e nevojshme për hartimin e tyre.

Menjëherë

22.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit në **15 raste** inspektorët nuk kanë bërë plotësimin e listë-verifikimit në mospërputhje me pikën 3 neni 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe me urdhërin nr.13, datë 23.04.2015 "Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit)*

22.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të bëj plotësimin e listë-verifikimit për të gjithë inspektimet, si dhe në rastet kur subjektet kanë mungesë të produkteve, të bëhën komentet në kategorinë përkatëse.

Menjëherë

23.Gjetje: Nga DPAKU nuk është respektuar përcaktimi ligjor në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës, si dhe nuk është hartuar manuali i posaçëm i inspektimit, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

23.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së përcaktimit të vlerës së gjobës, ku gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës për llojin e shkeljes, të merret në konsideratë historiku dhe frekuenca e shkeljeve të subjektit në vitin paraardhës, me qëllim shmangien e qëndrimit subjektiv të inspektorit në përcaktimin e masës së gjobës përballë shkeljeve të subjektit.

23.2.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e munualit posaçëm të inspektimit, referuar këtu edhe përcaktimeve të bëra në manualin e përgjithshëm të inspektimit në RSH[59].

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

24.Gjetje: Rregullorja e brendshme e DRAKU Tiranë nuk përputhet me ndryshimet strukturore të AKU-së, sipas VKM nr.708, datë 09.09.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit", ku ndër të tjera është parashikuar edhe pozicioni i përgjegjësit të sektorit të inspektimit pranë DRAKU, pozicion i cili më përpara nuk ka qenë i parashikuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

24.1.Rekomandimi: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të AKU-së, ku veç të tjerave të përcaktohet afati konkret për shqyrtimin e ankesave/indicieve që vijnë nga konsumatorët, grupe interesi. Gjithashtu në Kreu-n përkatës të kësaj rregullore, të përcaktohen rregulla të qarta për sektorin e laboratorit, mbi administrimin e mostrave (për të shmangur edhe konfliktin e interesit), dokumentet standard që duhet të përdoren, etj.

24.2.Rekomandim: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU si edhe me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi të përbashkët pune, për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurës së arkëtimit të gjobës nga momenti i vënies së gjobës nga inspektorët, ankimi, shqyrtimi i ankimit nga komisioni përkatës, përcjellja e vendimit nga DPAKU-DRAKU ose MBZHR-DPAKU-DRAKU, masat që duhet të merren nga DRAKU për vënien në ekzekutim si dhe monitorimin periodik të veprimeve të ndërmarra nga përmbaruesit për ezkekutimin e detyrimit.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

25.Gjetje: Në Urdhërin nr.24 datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve", nuk ka afate të përcaktuara për nxjerrjen e rezultatit të analizave laboratorike, duke sjellë vonesa në përgjigjen e tyre nga 5-15 ditë për të nxjerrë rezultatin, ç'ka në gjykimin e grupit të auditimit mund të ndikojë negativisht në aktivitetin e subjektit privat, pasi ky i fundit do të jetë i detyruar të mos tregëtojë produktin, deri në pritjen e rezultatit të analizës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

25.1.Rekomandimi: DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat e nevojshme, që në Urdhërin e mësipërm, të përcaktohet afati minimal dhe maksimal i nxjerrjes së rezultatit laboratorik, të përcaktohen kushtet teknike për pranimin e mostrave për analizat fiziko-kimike.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kthimin e ligjshmërisë dhe kërkimin për shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën *4,146,175 lekë*, si më poshtë:

[59] Urdhri nr.13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë".

1.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në 3 raste për subjektet (L – 1,300,000 lekë, R – 700,000 lekë, I – 1,150,000 lekë) janë shfuqizuar gjobat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përkatësisht nr.1220, datë 23.06.2020, nr.400, datë 08.06.2020 dhe nr.339, datë 10.03.2020**,** i kanë lënë në fuqi, *duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë*. Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 të nenit 65 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të përcjellin pranë zyrave të përmbarimit, vendimet e mësipërme të Gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim dhe arkëtimin e gjobave në vlerën *3,150,000 lekë*.

Menjëherë

2.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të ekzekutimit të gjobave, është konstatuar se në 2 raste për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare, nga momenti i vendosjes së gjobave, nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin dhe arkëtimin, **duke sjellë parashkrimin e tyre**, sipas nenit 46 të Ligjit nr.10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", dhe heqjen e të drejtës për arkëtimin nga AKU, *me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë.* Këto mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 9, pikën 1 të nenit 30, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30, pikën 1 të nenit 41 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative"; nenin 91 pika 1**,** nenin 97 pikat 1, 2, 3, nenin 128 pika 1 dhe pika 3, nenin 133 pika 3 shkronja a, nenin 138 pika 1, nenin 140 pika 1 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, nenet 510 dhe 511 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikën 4 të nenit 9, pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, pikën f të nenit 42 të Rregullores së Brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë, pikat 11, 14 dhe 16 të Urdhrit nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim" dhe pikat 1, 2, 3 dhe 5 të Urdhrit nr.1586, datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për ndjekjen e procedurave ligjore në gjykatat administrative, për vjeljen e gjobave të vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm gjykatë rrethi". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën *350,000 lekë*, përkatësisht nga personat përgjegjës, pasqyruar në tabelën nr.31, në Kap., Anekse, aneksi nr.7.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me UMF nr.5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, DR AKU Tiranë nuk ka përllogaritur dhe ndalur tatimin mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë *(1,842,171 x 15 %)* ndaj E, pagë e përfituar sipas urdhër shpenzimit nr.82 datë 13.05.2020 mbi bazën e Vendimit Gjykatës së Apelit nr.3320 datë 20.12.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-22) të Raportit të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marrë masa për arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë ndaj E, pasi nuk është ndalur nga paga e përfituar, sipas urdhër shpenzimit nr.82, datë 13.05.2020 dhe Vendimit Gjykatës Apelit nr. 3320 datë 20.12.2019.

Menjëherë

4.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të likujdimit të gjobave, është konstatuar se në **2 raste** nga përmbaruesit gjyqësor nuk është ekzekutuar plotësisht detyrimi monetar i subjektit të gjobitur,

pasi është paguar vetëm vlera e gjobës dhe jo edhe kamat-vonesa (2% e vlerës së gjobës), *me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën 266,000 lekë,* në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën 266,000 lekë*, përkatësisht nga përmbaruesi gjyqësor privat z.R.A.

Menjëherë

5.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të likujdimit të gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë, në **1 rast,** është konstatuar, se nuk është arkëtuar vlera e kamat-vonesës, për arsye se, nga DRAKU Tiranë, në kërkesën e bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nuk është kërkuar edhe arkëtimi i kamat vonesës, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të nenit 30 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", pikën 4 të nenit 9, pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Kreun IV, nenin 65 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodit të Procedurës Civile në RSH", i ndryshuar, shkronjën "f" të nenit 42 të Rregullores së Brendshme miratuar me Urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr. 377 datë 05.09.2017, dhe si pasojë e mosvprimeve janë krijuar të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 48,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën 48,000 lekë*, nga zyra përmbarimore e ngarkuar me ekzekutimin e detyrimit.

Menjëherë

6.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të likujdimit të analizave laboratorike të kryera në laboratorin e DRAKU Tiranë, është konstatuar se, në 9 raste, si pasojë e mangësive (tarifim më pak se vlera e përcaktuar) *janë krijuar të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën* 23,750 *lekë*, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr.8, datë 8.05.2007 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë", pikën 61 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Udhëzimin nr.1 prot., datë 09.01.1996 "Per procedurat e punes se sistemit te thesarit dhe marredheniet me institucionet buxhetore", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi:DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën* 23,750 *lekë*, përkatësisht nga 9 subjektet që kanë përfituar shërbimin e analizës laboratorike, pasqyruar në tabelën nr.32, Kap., Anekse, aneksi nr.7.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin",* DR AKU Tiranë nuk ka administruar në magazinë, nuk ka prerë fletë-hyrje për 23 kg mish të bllokuar/sekuestruar me vlerën 16,100 lekë, për pasiguri ushqimore, pa vulë veterinerit, pa certifikate, pa kushte përshtatshme si dhe mjete prerëse, ku nuk përcaktohet numri dhe vlera e tyre, për të cilat nuk administrohet asnjë dokument, konkretisht:

a.sipas inspektimit datë 23.10.2019 në subjektin *(S)*, Kavajë, DRAKU Tiranë nuk ka bërë hyrje *23 kg produkte mishi* për vlerën *16,100 lekë (çmimet minimale tregut)* për pasiguri ushqimore, pa vulë veterinerit dhe pa certifikate, si dhe mjete prerëse të pa përcaktuara numri i tyre, ku sipas procesverbalit të inspektimit, janë ngarkuar në automjetin e institucionit me targa AA691XI dhe janë dërguar në ambientet e DRAKU Tiranë, por mungon fletë-hyrja në magazinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar Ushqimit Tiranë, sektori i financës të arkëtojë vlerën *16,100 lekë* për 23 kg mish të pa administruar në magazinën e institucionit, bllokuar/sekuestruar për pasiguri ushqimore, në ngarkim të *Z.C, E.C dhe A.N me nga 5,366 lekë/secili.*

Menjëherë

8.Gjetje: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në **2 raste** nga inspektorët në vendimin përfundimtar, nuk është vendosur detyrimi për likujdimin e shpenzimeve të analizës laboratorike (në vlerën 4,500 lekë), mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 38, të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke hequr mundësinë e arkëtimit të tyre, *me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën 9,000 lekë* (vlera e analizës). *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën 9,000 lekë*, përkatësisht nga z.N.H dhe z.A.N, inspektor, 4,500 lekë secili.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve bankës në DR AKU Tiranë u konstatua:
Sipas urdhër shpenzimeve nr.29, 30, 31, 32, 33, 34 datë 70.02.2020 dhe nr.76 datë 13.05.2020 DRAKU Tiranë ka likuiduar ndaj DRSHTRR Tiranë vlerën 7,000 lekë gjoba, për tejkalim afati për kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë të arkëtojë vlerën 7,000 lekë gjoba**,** për tejkalim afati për kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve, përkatësisht A.N dhe N.C me nga 3,500 lekë/ secili.

Menjëherë

B.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Gjetje: Nga auditimi i pasqyrave financiare të DRAKU Tiranë, në vija të përgjithshme është konstatuar se ky institucion paraqet problem në ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave të akumuluara nga viti 2014 deri në vitin 2019 për vlerën 290,232,981 lekë, sipas bilancit 2019, ç'ka e ka bërë jo efektive punën e këtij institucioni. Më konkretisht nga auditimi i praktikave të arkëtimit të gjobave të vendosura nga inspektorët është konstatuar se:

-Në **56 raste** nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbaruesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likujdim vullnetar, kërkimi nga përmbaruesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve të paluajtshme/të luajtshme) dhe për pasojë deri në momentin e auditimit nuk janë arkëtuar në buxhetin e shtetit gjobat në vlerën 29,958,000 lekë, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë 23 gjoba, përkatësisht në vlerën 18,334,000 lekë gjithsej, për të cilat

është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.
-Në **2 raste** për gjobat që **nuk janë arkëtuar akoma**, dhe që **janë në proces**, në kërkesën e drejtuar GJSHP Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nuk janë kërkuar për arkëtim edhe kamat-vonesat në vlerën **86,000 lekë**. Këto mosveprime bien në kundërshtim me nenin 140 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; nenin 9, pikën 3 të nenit 30, nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", nenin 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", shkronjën e të pikës 4 të Kreut III të VKM nr.1081, datë 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", të ndryshuar, kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 "Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin", nenin 34 të Kreut 3 të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", pikën f të nenit 42 të Rregullores së Brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë, si dhe pikat 11, 14 dhe 16 të Urdhrit nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim". *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4, 2.5 dhe 2.6) faqe (27-140; 140-191 dhe 191-203) të Raportit të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proçes shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor privat, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme), për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa). Për çdo rast, kur nga përmbaruesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, DPAKU t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbaruesve. Në këtë mënyrë, kjo praktikë do të shërbejë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit të AKU me zyrat e përmbarimit.
-Për dy rastet, në të cilat nuk është kërkuar për arkëtim kamat-vonesa, të njoftohet shërbimi i përmbarimit për arkëtimin e tyre, duke shmangur dëmin ekonomik që mund të shkaktohet ndaj buxhetit të shtetit, në të ardhmen.
-Gjithashtu 23 gjobat në vlerën 18,334,000 lekë, t'i përcillen për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit të DPAKU-së ose Komisionit të posaçëm në MBZHR, sipas kompetencës ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: DRAKU Tiranë për vitet 2018-2019-2020 ka likuiduar 3 vendime gjyqësore për largime nga puna, sipas urdhër shpenzimeve nr.46 datë 13.03.2018, nr.82 datë 13.05.2020, nr.177 datë 03.10.2018, nr.215 datë 21.11.2018, nr.186 datë 11.11.2020, ku është konstatuar: se nuk janë nxjerrë përgjegjësitë dhe nuk janë marrë masa administrative ndaj ish-Kryeninspektorit të DRAKU Tiranë z.F.S dhe ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së z.A.I, pasi me veprimet e tyre ndaj buxhetit të shtetit është shkaktuar efekt negativ financiar në vlerën 3,531,426 lekë (pagesë e dubluar për të njëjtën vend pune dhe periudhë, për inspektorin zëvendësues dhe për inspektorin e larguar i cili e ka fituar me vendim gjykatës Apelit). Veprime në kundërshtim me pikën 62 e UMF nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr.442, datë 04.03.2020 dhe nr.995, datë 15.06.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-22) të Raportit të Auditimit)*
2.1.Rekomandimi: DPAKU të marrë masa për shqyrtimin e përgjegjësive dhe vendosjen e masave administrative ndaj personave ish-drejtues të AKU, pavarësisht se ata janë larguar në vende pune tjera, *pasi kanë shkaktuar efekte negative financiare në buxhetin e shtetit për vlerën*

3,531,426 lekë, si rezultat i largimeve të punonjësve nga puna pa u bazuar në legjislacionin në fuqi, sipas Vendimeve Gjykatës Apelit

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

C.1.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, 141, dhe 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në kontratën individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, vlerësimin dhe marrjen masave të nevojshme rast pas rasti, sipas shkeljeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me paralajmërim" deri në "Ndërprjerje të kontratës së punës", për:

▪ z.A.N, me detyrë Inspektor, (ish Kryeinspektor i komanduar i DRAKU Tiranë, për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020), për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, (administrimi i sendeve të sekuestruara, fq.,24-25; për mosrealizim të planit të inspektimeve për muajt Tetor-Dhjetor 2019 dhe Janar-Shkurt 2020, fq.,29; 2 raste të gjobave që janë parashkruar, fq.,32-33; si dhe 13 praktika inspektimesh, fq., 30, 33, 35, 63, 72, 87, 91, 116, 136, 138.

▪ z.G.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 33, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 48, 50, 51, 57, 59, 117, 120, 134.

▪ z.Z.C, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 14 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 30, 33, 35, 63, 72, 87, 91, 116, 136, 138.

▪ z.N.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 15 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 35, 36, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 59, 70, 72, 83, 85, 137.

▪ z.E.V, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 23 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 36, 37, 38, 39, 43, 44, 56, 57, 73, 84, 117, 125, 127, 136, 138, 159, 163, 165, 167, 181, 208, 254.

▪ z.E.M, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 46, 57, 93, 124, 125, 127, 128, 134, 151, 156, 160, 163, 167, 209.

▪ z.D.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 15 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 37, 39, 41, 42, 43, 44, 58, 86, 92, 121, 171, 176, 178, 194, 207.

▪ zj.F.V, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Laboratorit në DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në dokumentacionin e administruar në praktikat e analizave të autolaboratorit, si raport-provat, fletë-shoqërimi i mostrave, sasia e kampionit të mostrës-jo në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë nr.24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit", Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë nr.8, datë 8.05.2007 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë", trajtuar në pikën 2.8, fq., nr.218-255 të Raportit të Auditimit;

"Vërejtje" deri "Vërejtje me paralajmërim", për:

▪ z.A.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 73, 101, 103, 106, 163, 170, 173, 176, 178, 207.

▪ zj.E.Sh, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 58, 60, 72, 73, 86, 93, 164, 176, 178.

▪ z.E.C, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 58, 60, 72, 73, 86, 93, 164, 176, 178.

▪ z.T.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 191, 191, 196, 198, 199, 200, 208.
▪ z.L.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 33, 56, 103, 131, 154, 155, 158, 163, 173, 176, 178, 206.
▪ zj.Sh.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 36, 54, 60, 67, 69, 80, 88, 91, 134.
▪ D.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 48, 51, 52, 57, 104, 117, 125, 155, 164, 173, 254.

Vërejtje, <u>për:</u>
▪ z.M.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 59, 72, 73, 116, 125, 148.
▪ zj.S.L, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 64, 71, 107, 157, 163, 167, 182.
▪ zj.L.A, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 92, 97, 109, 155, 158.
▪ zj.M.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 50, 54, 61, 67, 96, 97.
▪ zj.M.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 48, 64, 107, 157, 172, 254.

➢ Për punonjësit, të cilët janë konstatuar në më pak se 5 raste, nuk propozojmë masë displinore, **por tërheqje vëmendje**, për kryerjen e funksioneve në vijimësi, si më poshtë vijon:
▪ z.M.N, me detyrë Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Korrik-Dhjetor 2020, periudhë brenda vitit 2020, të cilën lidhur me inspektimet e kemi marrë me rezervë, për shkak të pandemisë Covid-19, si dhe angazhimit të inspektorëve të DRAKU, me grupe inspektimi të përbashkëta për monitorimin e zbatimit të masave anti Covid-19, pasqyruar në fq., nr.15 dhe 29;
▪ zj.N.C, me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës;
▪ zj.Herla Praka, me detyrë jurist;
▪ zj.S.Rr, me detyrë inspektor;
▪ z.V.S, me detyrë inspektor;
▪ zj.K.S, me detyrë inspektor;
▪ zj.M.C, me detyrë inspektor;
▪ z.A.H , me detyrë inspektor;
▪ zj.A.Sh, me detyrë inspektor;
▪ zj.E.D, me detyrë inspektor;
▪ zj.E.Gj, me detyrë inspektor;
▪ z.Lulzim Zajmi, me detyrë inspektor;
▪ zj.H.K, me detyrë inspektor;
▪ zj.F.F, me detyrë inspektor;
▪ z.Gjon Peci, me detyrë inspektor;
▪ z.Elion Cuci, me detyrë inspektor;
▪ zj.F.R, me detyrë inspektor;
▪ zj.Migena Alliaj, me detyrë inspektor;
▪ z.Vate Vukaj, me detyrë inspektor;
▪ zj.Dallëndyshe Kajmaku, me detyrë inspektor;
▪ z.Ermal Matuka, me detyrë inspektor;
▪ zj.H.H, me detyrë specialiste laboratori;
▪ z.N.H, me detyrë inspektor;
▪ z.Poliksen Drazho, me detyrë inspektor;

- z.Ardit Kanaci, me detyrë inspektor;
- zj.E.Sh, me detyrë inspektor;
- z.I.O, me detyrë inspektor;
- zj.M.K, me detyrë inspektor;
- z.F.M, me detyrë inspektor;
- zj.P.R, me detyrë specialiste e magazinës;
- z.R.M, me detyrë inspektor;

C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore **"Vërejtje me paralajmërim" deri në "Ndërprjerje të kontratës së punës"** për:

- zj.M.M, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 60 raste;
- z.S.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 48 raste;
- z.F.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 33 raste;

"Vërejtje" deri "Vërejtje me paralajmërim":

- z.L.B, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 11 praktika inspektimesh;
- zj.M.B, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 11 praktika inspektimesh;
- zj.V.Zh, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 praktika inspektimesh;
- zj.Y.A, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 praktika inspektimesh;

Vërejtje:

- zj.L.Zh, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 praktika inspektimesh;
- z.B.O, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 praktika inspektimesh;
- zj.N.M, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 praktika inspektimesh;
- zj.M.D, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 praktika inspektimesh;

V.ANEKSE

Aneksi nr.1 "Për kategorizimin e riskut, llohgaritjen e materialitetit dhe përzgjdhjen e kampionit të auditimit".

Tabela nr.1 Kategorizimi i riskut

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Riskut	Burimi
1	Inspektimi i produkteve me origjinë shtazore (periudha e audituar 2018-2020)	I Lartë	DRAKU Tiranë + DPAKU
2	Inspektimi i produkteve me origjinë joshtazore (periudha e audituar 2018-2020)	I Mesëm - I Lartë	DRAKU Tiranë + DPAKU
3	Inspektimi i produkteve bimore (periudha e audituar 2018-2020)	I Mesëm	DRAKU Tiranë + DPAKU
4	Veprimtaria e laboratorit (periudha e audituar 2018-2020)	I Mesëm	DRAKU Tiranë
5	Shërbimet mbështetëse (periudha e audituar 2018-2020)	I Ulët – I Mesëm	DRAKU Tiranë

Burimi:Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.2 Shpenzimet e institucionit

Pershkrimi	Plani vjetor	Realizimi Thesar	Fatura te pa likujduara me banke per vitin 2019	Fatura te vitit 2018 likujduar ne vitin 2019	Realizimi ne Banke	Në %
SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	**58,440,000**	**57,585,742**	**0**	**6,360**	**57,592,102**	**98.5**
PAGA, SHPERBLIME DHE TE TJERA SHPENZIME PERSONELI	**43,000,000**	**42,507,295**	**0**	**0**	**42,507,295**	**98.9**
KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	**7,150,000**	**7,110,550**	**0**	**0**	**7,110,550**	**99.4**
MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	**8,100,000**	**7,777,897**	**0**	**6,360**	**7,784,257**	**96.1**
Shpenzime per qiramarrje	72,000	72,000	0	0	72,000	
Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale	840,300	840,300	0	0	840,300	
Shpenzime te tjera operative	40,000	39,095	0	0	39,095	
Shpenzime udhetimi (dieta)	910,280	910,280	0	0	910,280	910,280
Shpenzime tatime & taksa te paguara nga institucioni.	35,000	34,095			34,095	

Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	5,000	5,000			5,000	
TRANSFERTE NE BUXHETET FAMILJARE	**190,000**	**190,000**	**0**	**0**	**190,000**	**100**
Trasnsferte ne buxhetet familjare	190,000	190,000			190,000	

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.3 Kategorizimi i riskut dhe përzgjedhja e numrit të kampionit për t'u audituar

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Riskut	Kampioni i përzgjedhur
1	Inspektimi i produkteve me origjinë shtazore (planifikim, zbatim, masa administrative, ndjekja dhe vjelja e gjobave, mostërmarrja)	I Lartë	250 praktika
2	Inspektimi i produkteve me origjinë joshtazore (planifikim, zbatim, masa administrative, ndjekja dhe vjelja e gjobave, mostërmarrja)	I Mesëm - I Lartë	200 praktika
3	Inspektimi i produkteve bimore (planifikim, zbatim, masa administrative, ndjekja dhe vjelja e gjobave, mostërmarrja)	I Mesëm	200 praktika
4	Sektori i laboratorit	I Mesëm	200 praktika
5	Shërbimet mbështetëse (shpenzimet financiare, inventarizimi, kontabiliteti)	I Ulët – I Mesëm	Sipas materialitetit

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.4 Inspektimet e kryera nga DRAKU, muaji Janar 2018

Nr.	Risku (U,M,L)	Aktiviteti Specifik	Adresa aktivitetit	Inspektime te planifikuar sipas planit vjetor 2018	Inspektime te kryera sipas planifikimit mujor te programuar	Inspektime jashte planifikimit mujor	inspektimet per verifikimin e detyrave te lena (riinspektim)	Data e inspektimit	Masa administrative					Detyrat e lena si dhe afatet e realizimev e te tyre
									gjoba		bllokim produkti/asgjesim			
									nr	vlera ne leke	bllokim produkti (emertimi i produktit)	asgjesim produktit (emertimi i produktit)	nderprerje veprimtarie	
1	M	TREGETIM MISHI	RR.PANDI DARDHA			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		05.01.2018	1	100,000			NDERPRERJE	
2	M	TREGETIM MISHI	RR ALI DEMI	PLANI	PLANI			08.01.2018	1	150,000	1.3.KG SALLAM			BAZUAR NE GERMEN I
3	M	TREGETIM MISHI	RR.METUSH LULI			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		10.01.2018	1	120,000	Mish vici pa vule e pa		BAZUAR NE NENIN 43	
4	M	TREGETIM MISHI	RR.FERIT XHAJKO,PRANE			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		10.01.2018	1	30,000			BAZUAR NE NENIN 43	NE ZBATIM TE LIGJIT
5	M	TREGETIM MISHI	PASKUQAN-1			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		12.01.2018	1	50,000				REFERUAR NENIT
6	M	TREGETIM MISHI	RROGOZHINE,RR.TREG UT			Urdhëri nr. 275, datë 12.01.2018 i DP të AKU-së		13.01.2018	1	200,000	MISH QENGJI 10-		Nderprerje veprimtarie	REFERUAR NENIT
7	M	TREGETIM MISHI	RR.JOSIF BUDA NDERTESA 2 KATESHE			Urdhëri nr. 274, datë 12.01.2018 i DP të AKU-së		13.01.2018	1	100,000	36 KG MISH VICI			NE ZBATIM TE LIGJIT
8	M	TREGETIM MISHI	RR. PAZARI I RI			Urdhëri nr. 276, datë 12.01.2018 i DP të AKU-së		14.01.2018	1	100,000		SASIA PREJ 29.6 KG MISH VICI U		BAZUAR NE AKTIN
9	M	Restorant(prod. mixe)	RR. PRISK DAJT.			ZBATIM I LEGJISLACIONIT NE FUQI.		14.01.2018	1	400,000			NE ZBATIM TE NENIT 43	BAZUAR NE LIGJIN 9863
10	M	Restorant(prod. mixe)	RR. VISHNJE TIRAN			ZBATIM I LEGJISLACIONIT NE FUQI.		14.01.2018	1	400,000			NE ZBATIM TE NENIT 43	BAZUAR NE LIGJIN 9863
11	M	TREGETIM MISHI	RR FERIT XHAJKO				RIINSPEKTIM	15.01.2018	1	30,000				BAZUAR NE NENIN 54 TE
12	M	SUPERMARKET	RR FORTUZI			ZBATIM I LEGJISLACIONIT NE FUQI.		15.01.2018	1	100,000				BAZUAR NE GERMEN K
13	M	SUPERMARKET	RR.PROKOP MIMA			ZBATIM I LEGJISLACIONIT NE FUQI.		15.01.2018	1	300,000				REFERUAR NENIT 68.
14	M	TREGETIM MISHI	RR.SKENDERBEG, KAMEZ	PLANI	PLANI			17.01.2018	1	50,000	4.8 KG QOFTE.			REFERUAR NENIT 47 TE
15	M	TREGETIM MISHI	RR. URA E INSTITUTIT MAJTAS.			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		**17.01.2018**	1	50,000				BAZUAR NE NENIN 48
16	M	TREGETIM MISHI	RR. URA E INSTITUTIT-PASKUQAN NGJITR ME			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		**17.01.2018**	1	200,000	BAZUAR NE NENIN 19			BAZUAR NE AKTIN
17	L	PERPUNIM MISH	RR.SABAUDIN GABRANI,GODINE			INDICIO		18.01.2018	1	400,000	QOFTE-38 KG,SALCICE-		NDERPRERJE VEPRIMTARI	REFERUAR NENIT 43
18	M	SUPERMARKET	RR. ARTAN LENJA PERBALL KONVIKTEVE			INDICIO.ZBATIM I LEGJISLACIONIT NE FUQI		**18.01.2018**	1	100,000				BAZUAR NE PIKEN 1
19	M	TREGETIM MISHI	SAUK I VJETER RR SELIM BRAHJA			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		18.01.2018.	1	100,000	30 KG MISH VICI			NE MOMENTIN
20	M	TREGETIM MISHI	Rr. Ura e Institutit-Paskuqan, 100 metra			Urdhëri nr. 469, datë 19.01.2018 i DP të AKU-së		20.01.2018.	1	300,000	U BLLOKUA 198.4 KG		Nderprerje veprimtarie	BAZUAR NE AKTIN
21	M	TRANSPORT TE	Rr. Marije Kraja, Kodra e Priftit, Tirane			DENONCIM / KOMISARIATI NR. 1		20.01.2018.	1	300,000	U BLLOKUA N65.4 KG			BAZUAR NE AKTIN
22	M	Restorant(prod. mixe)	Rr. Dajtit, Surrel			Urdhëri nr. 470, datë 19.01.2018 i DP të AKU-së		20.01.2018.	1	200,000	MISH KECI PA			Në mbështeti
23	M	TREGETIM MISHI	RR.PETRAQ LEKA			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		23.01.2018	1	50,000			NDERPRERJE E	O.B.U.TE KORIGJOJE
24	M	TREGETIM MISHI	VILE–BOSHTOVE			INDICIO		23.01.2018	1	300,000	Mish vici 67.5 kg pa		Nderprerje e	BAZUAR NE AKTIN
25	M	TREGETIM MISHI	RR ARKITEKT KASEMI			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		23.01.2018	1	20,000				NE ZBATIM TE PIKES 6
26	M	TREGETIM MISHI	RR 3 DESHMORET			INDICIO. URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		24.01.2018	1	300,000	Mish vici			BAZUAR NE AKTIN
27	M	TREGETIM MISHI	URA INSTITUTIT			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		25.01.2018.	1	50,000			REFERUAR GERMES a T	SUBJEKTI NE KUNDERSHTI
28	M	TREGETIM MISHI	Rr. Xhanfize Keko			DENONCIM,KUSHTET ERUAJTJES MISHIT.		25.01.2018.	1	100,000				**NE BAZE TE AKTIT**
29	M	TREGETIM MISHI	RR.NDRE MJADA AFER ME MARKET			URDHERI NR 6 DT 21 .12.2017 I DP TE AKU PER		25.01.2018.	1	50,000				Në mbështetje
30	M	Restorant(prod. mixe)	RR TIRANA DURRES. PEZE			URDHERI NR. 575 DT 25.01.2018 I DP TE AKU.		25.01.2018.	1	200,000		MISH DERRRI I EGER 5.9 k dhe		BAZUAR NE LIGJIN 9863
31	M	Restorant(prod. mixe)	RR.FARKES FSHATI VISHAJ TIRANE.			URDHERI NR. 575 DT 25.01.2018 I DP TE AKU.		25.01.2018	1	300,000			NE ZBATIM TE NENIT 43	NE ZBATIM TE LIGJIT NR
32	M	TREGETIM MISHI	Rr. Robert Shvarc				Kerkese per cbllokim aktiviteti	26.01.2018	1	50,000			Nderprerje veprimtarie	NE ZBATIM TE AKTIT
33	L	PERPUNIM QUMESHTI	RR.KONFERENCA E PEZES. TIRANE	Plani	Plani			26.01.2018	1	100,000	598.8 kg diath			te korrigjoj mangesite
34	M	SUPERMARKET	Rrogozhine Lagjia nr. 2			URDHERI DP. AKU NR. 699 DATE 26.01.2018		27.01.2018	1	150,000				Në mbështetje
35	M	TREGETIM MISHI	KAVAJE			URDHERI DP. AKU NR. 699 DATE 26.01.2018		28.01.2018.	1	400,000	20 KG MISH QINGJI		BLLOKIM AKTIVITETI	REFERUAR GERMES c
36	M	MAGAZINE FRIGORIFERI	RR SIRI KODRA TEK BLLOKU I			NE VIJIM TE INSPEKTIMIT TE DATES 26.01.2018.		**29.01.2018**	1	200,000				BAZUAR NE LIGJIN 9863
37	M	Restorant(prod. mixe)	BERZHIT TIRANE			URDHERI DREJTORIT PERGJITHSHEM.		31.01.2018	1	100,000	Rose e eger			REFERUAR LIGJIT
38	M	Restorant(prod. mixe)	PETRELE MULLET GODINA NJEKATESHE			URDHERI DREJTORIT PERGJITHSHEM.		31.01.2018	1	400,000	Recel thane			PER VEPRIME NE

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.2 "Për verifikimin e auditimit të zbatimit të rekomandimeve".

Pasqyra nr.1 e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	E m ë r t i m i	Rekomandimet ne numër :		Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike	
		Rekomandim	Nga rekomandimet janë:	Rekomanduar Gjithsej	Nga rekomandimet janë:

		gjithsej	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr. per	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	5	-	2	3		-	-	-	-	-	-	-
2	Masa për përmirësim ligjor	6	4	-	2	-	-	-		-	-	-	-
3	Masa efekt financiar	-	-	-	-	-	-	-		-	-	-	-
4	Masa disiplinore	6	-	-	-	-	-	-		-	-	-	-
	Totali	**17**	**6**	**2**	**5**	**-**	**-**	**-**		**-**	**-**	**-**	**-**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.3 "Për auditimin e zbatimit të buxhetit të shtetit".

Tabela nr.4 Buxheti-viti 2018

Nr.	Art.	Emertimi	Plan 2018	Fakt 2018	% e realizimit
1	600	Paga, shperb tjera	37,980,000	37,964,352	99,96%
2	601	Kontrib. Sig. shoqerore.	6,420,000	6,354,896	98,99%
3	602	Mallra dhe sherbime.	7,150,000	7,066,750	98,84%
4	231	Investime	0	0	0
5	466	tjera	95,000	95,000	
		Shuma totale	**51,645,000**	**51,480,998**	

Tabela nr.5 Buxheti-viti 2019

Nr.	Art.	Emertimi	Plan 2019	Fakt 2019	% e realizimit
1	600	Paga, shperb tjera	43,000,000	42,507,295	98,85%
2	601	Kontrib. Sig. shoqerore.	7,150,000	7,110,550	99,45%
3	602	Mallra dhe sherbime.	810,0000	7,777,897	96,02%
4	231	Investime	0	0	
5	606, tjeraj	transferta	190,000	190,000	
		Shuma totale	**58,440,000**	**57,585,742**	

Tabela nr.6 Buxheti-viti 2020

Nr.	Art.	Emertimi	Plan 2020	Fakt 2020	% e realizimit
1	600	Paga, shperb tjera	44,000,000	43,412,387	98,66%
2	601	Kontrib. Sig. shoqerore.	7,300,000	7,250,228	99,32%
3	602	Mallra dhe sherbime.	9,620,354	9,068,882	94,27%
4	231	Investime	0	0	
5	606, tjeraj	Transferta	30,000	30,000	
		Shuma totale	**60,950,354**	**59,761,497**	

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.7 shpenzimet operative viti 2018

Art.	**Pershkrimi**	**Plani 2018**	**Fakti 2018**
	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	**7 150 000**	**7 066 750**
6020	***Materiale zyre dhe te pergjithshme***	***1 602 240***	***1 601 568***
6020	Kancelari	426 000	426 000
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	144 000	144 000
6020	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres, toner	559 200	559 200
6020	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	96 000	95 328
6020	Blerje dokumentacioni	377 040	377 040
6021	***Materiale dhe sherbime speciale***	***1 633 540***	***1 566 740***
6021	Materiale dhe pajisje laboratorik e te sherbimit publik	350 000	333 600
6021	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	1 283 540	1 233 140
6022	***Sherbime nga te trete***	***2 866 426***	***2 850 648***
6022	Elektricitet	1 460 815	1 450 155
6022	Uje	652 233	650 480
6022	Sherbime telefonike	24 000	23 040
6022	Posta dhe sherbimi korier	160 000	157 595
6022	Sherbime te sigurimit dhe te ruajtjes	428 522	428 522
6022	Sherbim interneti	140 856	140 856
6024	***Shpenzime udhetimi***	***123 950***	***123 950***
6024	Udhetim i brendshem.	123 950	123 950
6027	***Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale***	***923 844***	***923 844***
6027	Shpenzime per vendimeve gjyqesore largim nga puna	890 544	890 544
6027	Shpenzime per detyrimeve kontraktuale te papaguara	33 300	33 300

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.8 shpenzimet operative viti 2019

Art.	Pershkrimi	Plani 2019	Realiz. 2019
	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	**8 100 000**	**7 777 897**
	Materiale zyre dhe te pergjithshme	***2 012 640***	***1 742 748***
602 0100	Kancelari	498 000	453 600
602 0200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	144 000	112 800
602 0300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres toner	960 000	765 708
602 0500	Blerje dokumentacioni	410 640	410 640
	Materiale dhe sherbime speciale	***952 794***	***943 686***
602 1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	952 794	943 686
	Sherbime nga te trete	***3 271 986***	***3 229 788***
602 2001	Elektricitet	1 601 128	1 570 386
602 2002	Uje	652 910	652 420
602 2003	Sherbime telefonike	25 000	23 146
602 2004	Posta dhe sherbimi korrier	184 485	184 470
602 2007	Sherbimet bankare	5 000	3 138
602 2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	573 463	573 463
602 2099	Sherbime (Internet)	230 000	222 765
	Shpenzime transporti	**0**	**0**
	Shpenzime udhetimi	***910 280***	***910 280***
602 4100	Udhetim i brendshem.	910 280	910 280
	Shpenzime per qiramarrje	***72 000***	***72 000***
602 6400	Shpenzime qeramarrje mjetesh transporti	72 000	72 000
	Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale	***840 300***	***840 300***
602 7500	Shpenzim per detyrimeve kontraktuale te pa paguara	840 300	840 300
	Shpenzime te tjera operative	***40 000***	***39 095***
602 9008	Shpenzime tatime & taksa te paguara nga institucioni.	35 000	34 095
602 9099	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	5 000	5 000
606	***TRANSFERTE NE BUXHETET FAMILJARE***	***190 000***	***190 000***

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.9 shpenzimet operative viti 2020

Art.	Pershkrimi	Plani 2020	Realiz. 2020
602	**MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA**	**9 620 354**	**9,068, 882**
	Materiale zyre dhe te pergjithshme	***1 425 632***	***1,394,700***
602 0100	Kancelari	410 112	410 112
602 0200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	122 160	122 160
602 0300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres toner	320 000	293 868
602 0400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	240 000	235 200
602 0900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	333 360	333 360
	Materiale dhe sherbime speciale	***1 824 589***	***1,573, 320***
602 1009	Materiale dhe pajisje labratorik e te sherbimit publik	720 354	480 000
602 1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	1 104 235	1,093,320
	Sherbime nga te trete	***2 603 360***	***2,424,746***
602 2001	Elektricitet	1 087 717	1,025,170
602 2002	Uje	688 300	654 250
602 2003	Sherbime telefonike	32 000	23 040
602 2004	Posta dhe sherbimi korrier	108 578	68 065
602 2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	436 925	436 925
602 2099	Sherbime (Internet)	240 000	217 296
602 2099	Sherbime te tjera	9 840	
	Shpenzime transporti	***436 220***	***413, 942***
602 3300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	366 220	366,220
602 3900	Shpenzime te tjera transporti	70 000	47,722
	Shpenzime udhetimi	***390 980***	***390,980***
602 4100	Udhetim i brendshem.	390 980	390, 980
	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	***213 000***	***213,000***
602 5500	Shpenzime per mirembajtjen aparateve, paisjeve teknike,	75 000	75,000
602 5600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	138 000	138, 000
	Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale	***2 686 573***	***2,640,882***
602 7400	Shpenzim per vendimeve gjyqesore largim nga puna	2 646 573	2 640 882
602 7500	Shpenzim per detyrimeve kontraktuale te pa paguara	40 000	
	Shpenzime te tjera operative	***40 000***	***17, 312***
602 9008	Shpenzime tatime & taksa te paguara nga institucioni.	20 000	17, 312
602 9099	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	20 000	

606	***TRANSFERTE NE BUXHETET FAMILJARE***	***30 000***	***30, 000***

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.4 "Për auditimin e administrimit të vlerave monetare dhe materiale".

Tabela nr.10 Shpenzime për vendimet gjyqësore për vitin 2018

Nr.	Institucioni	Nr. autorizimit	Nr. Vendimit	Detyrimi
1	DRAKU, A.B	3542/2 dt 10.4.2018	Vendim Apelit 3873/4053 date 21.09.2017	885,696
2	DRAKU, E.Y	4547/2 dt.23/06/2017	Vendim Apelit 1781 date 27.04.2017	4,848
	Shuma Totale			**890,544**

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.11 Shpenzime për vendimet gjyqësore për vitin 2020

Nr.	Institucioni	Nr. autoriz.	Nr. Vendimit	Detyrimi
1	E.S	Nr.1581/2 dt 28/02/2020	V. Apelit Tiran 3320 dt 20/12/2019	1,842,171
2	M.F	Nr. 3728/2 dt 11/6/2020	V. Apelit Tiran. 4705 dt. 22/12/2016	704,402
3	E.S	Nr. 1581/2 dt 28/2/2020	V. Apelit Tiran. 3320 dt 20/12/2019	94,309
	Shuma Totale			**2,640,882**

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.5 "për auditimin e funksionit të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore".

Aktiviteti i inspektimit:

Tabela nr.12 inspektimet e kryera nga 3 sektorët e DRAKU Tiranë 2018-2020

SEKTORI OSH	Numri i inspektimeve të kryera	Numri i inspektimeve të kryera brenda planit	Numri i inspektimeve të kryera jashte planit planit	Gjoba	Në leke
VITI 2018	**2862**	**1771**	**1091**	**178**	**40,780,000**
VITI 2019	**3587**	**2107**	**1479**	**167**	**66,960,000**
VITI 2020	**3003**	**1716**	**1287**	**27**	**4,350,000**

SEKTORI OJSH	Numri i inspektimeve të kryera	Numri i inspektimeve të kryera brenda planit	Numri i inspektimeve të kryera jashte planit planit	Gjoba	Në lekë
VITI 2018	**3149**	**1908**	**1241**	**191**	**49,760,000**
VITI 2019	**3315**	**2200**	**1115**	**90**	**69,750,000**
VITI 2020	**2518**	**1431**	**1087**	**46**	**8,510,000**

SEKTORI I BIMËVE	Numri i inspektimeve të kryera	Inspektime në pikën kufitare Rinas (import)	Numri i inspektimeve brenda planit	Numri i inspektimeve jashte planit planit	Gjoba - lekë
VITI 2018	**966**	**231**	**610**	**125**	**11 - 1,160,000**
VITI 2019	**924**	**288**	**533**	**103**	**3 - 600,000**
VITI 2020	**911**	**275**	**554**	**82**	**3 – 420,000**

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.13:Planifikimi i inspektimit të subjekteve

Risku	Kodi i veprimtarisë specifike	AKTIVITETI	Emri i Subjektit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
L	A.3.1.2	Ruajtje,Të ngrira/freskëta, paketuar	F				1								1
L	A.2.1.4	Stabilimente perpunim produkte mishi	L	1					1					1	
L	A.2.3.5	Stabilimente të standartizimit dhe paketimit të peshk	S	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
M	A.3.6.2	Restorant (produkte mikse)	I		1			1			1			1	

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.14 Realizimi i inspektimeve të planifikuar sipas muajve të vitit 2018 (OSH):

Muaji	**Inspektime të realizuara sipas planit**	**Inspektime të planifikuara**	**Realizimi**
Janar	49	277	18%
Shkurt	124	277	45%
Mars	125	287	44%
Prill	157	282	56%

Maj	174	285	61%
Qershor	167	282	59%
Korrik	190	282	67%
Gusht	107	269	40%
Shtator	152	276	55%
Tetor	193	287	67%
Nentor	159	285	56%
Dhjetor	130	288	45%

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.15 Realizimi i mostërmarrjeve të planifikuar sipas muajve të vitit 2018

Muaji	Kampionime për tu kryer	Kampionime të kryera	Realizimi
Janar	31	18	58%
Shkurt	40	38	95%
Mars	60	16	27%
Prill	66	61	92%
Maj	67	62	93%
Qershor	72	10	14%
Korrik	65	8	12%
Gusht	61	14	23%
Shtator	67	5	7%
Tetor	66	49	74%
Nentor	62	28	45%
Dhjetor	58	38	66%

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.16 Planifikimi i inspektimit të subjekteve

Nr.	Risku	Veprimtaria Specifike	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	L	Ruajtje,Të ngrira/freskëta, paketuar					1							
2	L	Ruajtje,Të ngrira/freskëta, paketuar					1							1
3	L	Stabilimente perpunim produkte mishi	1					1					1	
4	L	Grupe të veçanta (fëmijë, pacientë, të moshuar, etj)				1			1			1		
5	L	Stabilimente përpunim peshku	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
6	L	Grupe të veçanta (fëmijë, pacientë, të moshuar, etj)			1									1
7	L	Stabilimente perpunim produkte mishi			1									1
8	L	Grupe të veçanta (fëmijë, pacientë, të moshuar, etj)		1									1	
9	L	Grupe të veçanta (fëmijë, pacientë, të moshuar, etj)									1			
10	L	Stabilimente përpunim peshku	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
11	L	Restorant (produkte mikse)			1									
12	L	Stabilimente përpunim peshku	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
13	M	Restorant (produkte mikse)		1			1			1			1	
14	M	Restorant (produkte mikse)												
15	M	Restorant (produkte mikse)												
16	M	Restorant (produkte mikse)		1			1			1			1	
17	U	Ruajtje, Temperature ambienti, paketuar	1			1			1			1		
18	U	Ruajtje, Temperature ambienti, paketuar		1			1			1			1	
19	U	Ruajtje, Temperature ambienti, paketuar		1			1			1			1	

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.17 Realizimi i inspektimeve të planifikuar sipas muajve të vitit 2019 (OSH):

Muaji	Inspektime të realizuara sipas planit	Inspektime të planifikuara	Realizimi
Janar	157	283	55%
Shkurt	231	261	89%
Mars	169	276	61%
Prill	231	279	83%
Maj	181	273	66%
Qershor	173	282	61%
Korrik	149	259	58%
Gusht	125	244	51%
Shtator	165	267	62%
Tetor	189	275	69%
Nentor	160	271	59%
Dhjetor	171	279	61%

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.18 Realizimi i mostërmarrjeve të planifikuar sipas muajve të vitit 2019

Muaji	Kampionime për tu kryer	Kampionime të kryera	Realizimi

Janar	58	40	69%
Shkurt	57	41	72%
Mars	72	14	19%
Prill	74	34	46%
Maj	74	44	59%
Qershor	72	14	19%
Korrik	72	25	35%
Gusht	64	38	59%
Shtator	62	19	31%
Tetor	64	66	103%
Nentor	64	63	98%
Dhjetor	59	13	22%

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.19 Realizimi i inspektimeve të planifikuar sipas muajve të vitit 2020

Muaji	Numri i inspektimeve të planifikuara	Numri i inspektimeve brenda planit	Realizimi
Janar	174	156	90%
Shkurt	174	166	95%
Mars	178	89	50%
Prill	193	0	0%
Maj	199	65	33%
Qershor	199	201	101%
Korrik	254	228	90%
Gusht	206	202	98%
Shtator	199	197	99%
Tetor	189	125	66%
Nentor	193	142	74%
Dhjetor	**185**	**145**	78%

Burimi:DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.20 Shkeljet e pasqyruara në dy inspektimet e ndryshme pranë subjektit L

Nr	Shkeljet dt. 9.08.2018	Masat e dhëna	Shkeljet dt. 1.08.2019	Diferenca	Masat e dhëna
1	Licenca: Nuk pasqyrohet asgjë	**Paralajmërim dhe korrigjim të shkeljeve brenda datës 17.08.2018**	Licenca: Subjekti ushtron aktivitet pa licencë		**Ndalim ushtrim aktiviteti; Gjobë në vlerën 2,000,000 dhe në vlerën 500,000; Korrigjim të shkeljeve brenda afatit 14.08.2019**
2	Ka vendndodhje të përshtatshme;		-Kapitulli I, pika 2 "Planimetria, projektimi, ndërtimi, vendndodhja", **"Jo";**		
3	Kushtet dhe gjëndja e ambjentit të gatimit janë të mjaftueshme;		-Kapitulli I, pika 2/a "Mirëmbajtja, pastrimi, dezifektimi, kontaminimi nga ajri dhe hapsira e përshtatshme e punës", **"Jo";**		
4	Një pjesë e mureve të tavanit të guzhinës duhet lyer;		-Kapitulli I, pika 1 "Mirëmbajtja e stabilimenteve ushqimore", **"Jo";**		
5	Kushtet higjeno-sanitare të mjaftueshme;		-Kapitulli II, pika 1 "Zbatimi i kërkesave specifike të higjenës në ambjentet e përpunimit dhe të ruajtjes së ushqimit", **"Jo";**		
6	Personeli i pajisur me librezë shëndetësore, me uniformë;		-Kapitulli I, pika 5, 6, 7, 8, 9, 10 "kërkesa për ventilim të përshtatshëm, të ambjenteve sanitare për ndriçimin e duhur për funksionimin e kanaleve të shkarkimit, **<u>për ambjente të përshtatshme për personelin (garderoba)</u>**, për ruajtjen e agjentëve të pastrimit dhe dezifektantët", **"Jo";**		
7	Substancat pastruese ruhen në vend të veçant;		-Kapitulli I, pika 5, 6, 7, 8, 9, 10 "kërkesa për ventilim të përshtatshëm, të ambjenteve sanitare për ndriçimin e duhur për funksionimin e kanaleve të shkarkimit, për ambjente të përshtatshme për personelin (garderoba), **<u>për ruajtjen e agjentëve të pastrimit dhe dezifektantët"</u>**, **"Jo";**		
8	Subjekti përdor uji rrjeti dhe ka kryer analizën bakterologjike;		-Kapitulli I, pika 2/b "Papastërtitë e grumbulluara, kontakti me materialet toksike, ndotja dhe formimi i kondesimit/mykut", **"Jo";**		
9	Duhet të pajiset me dhomë ftohëse për produktet;		-Kapitulli IX, pika 2 "Ruajtja e lëndëve të para dhe të gjithë përbërësve të tjerë në kushte të përshtatshme", **"Jo";**		
10	Ushqimet gjysëm të gatshme ruhen në kushte frigoriferike;		-Kapitulli IX, pika 3 "Mbrojtja e ushqimit në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes nga kontaminantët", **"Jo";**		
11	Ushqimet e gatshme gatuhen dhe serviren brenda ditës;		-Kapitulli II, pika 1/e.f "Pastrimi dhe dezinfektimi i dyerve dhe i sipërfaqeve në zonat ku trajtrohen dhe janë në kontakt me ushqimin", **"Jo";**		
12	Për materialet e paketimit (letër alumini dhe vasketat) disponon çertefikatën e cilësisë;		-Kapitulli X, pika 1 "Ruajtja e ambalazhit dhe paketimit nga ekspozimi i kontaminimit", **"Jo";**		
13	Dokumentet shoqëruese të ushqimeve kanë dokumentacionin e shoqërimit;		-Kapitulli IX, pika 1 "Mënjanimi i pranimit të lëndëve të para të kontaminuar, për të siguruar që produkti përfundimtar është i sigurt", **"Jo";**		
14	Personeli ka eksperiencë;		-Kapitulli II, pika 1/a.B "Mirëmbajtja dhe dezinfektimi i		

			sipërfaqeve të dyshemesë dhe i mureve", **"Jo";**		
15	Subjekti disponon planin HACCP;		-Kapitulli II, pika 1/c.d "Ndërtimi dhe vendosja e përshtatshme e strukturës së tavaneve ose sipërfaqes së brendshme të çatisë dhe dritareve dhe hapjeve të tjera", **"Jo";**		
16	Sistemi i gjurmueshmërisë funksionon;		-Kapitulli IX, pika 6 "Kushtet specifike për shkrirjen e produkteve ushqimore", **"Jo";**		
17			-Kapitulli II, pika 2.3 "Kërkesa për sigurimin e ambjenteve dhe mjeteve të përshtatshme për mirëmbajtjen e veglave të punës si dhe të kushteve të përshtatshme për larjen e ushqimit", **"Jo";**		
18			-Kapitulli I, pika 2/c "Mbrojtja, kontaminimi dhe kontrolli nga dëmtuesit", **"Jo";**		

Burimi: DRAKU, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.6 "për auditimin e funksionit të inspektimit të produkteve me origjinë joshtazore".

Tabela nr.21 Inspektimet e kryera sipas planifikimit dhe në bazë të aktiviteti

Nr	Aktiviteti	Numri i inspektimeve
1	Furre buke	395
2	Furre buke & pasticeri	97
3	Pasticeri	150
4	Bar snack	12
5	Bar kafe	246
6	Bar club	29
7	Byrektore & fast food	370
8	Bar & creperi & pasticeri	9
9	Piceri	100
10	Pjekje, ambalazhim kafeje	37
11	Prodhime brumi/ jufkash/ kausha	8
12	Perpunim, ambalazhim fruta te thata	8
13	Prodhim pije freskuese	25
14	Prodhim . Ambalazhim mielli	46
15	Magazine ushqmore/fruta perime	391
16	Magazine frigoriferike	37
17	Ambalazhim produkte ushqimore	28
18	Market, minimarkete, pika tregtimi	826
19	Trajtim uji dhe prodhim pije freskuese	33
20	Stabilimet perimesh	5
21	Prodhim, ambalazhim vaj dhe vaj ulliri	52
22	Prodhim, ambalazhim ushqimesh	14
23	Bulmetore	1
24	Prodhim biskotash	3
25	Prodhim karamelesh	7
26	Prodhim, ambalazhim patatinash	8
27	Prodhim, ambalazhim pije alkolike	22
28	Prodhim, tregtim vere/uthull	5
29	Prodhim birre	4
30	Perpunim kripe	1
31	Prodhim, ambalazhim bime medicinale dhe cajra	4
32	Prodhime brumi / makarona/ petesh	22
33	Prodhim gliko dhe recel	3
34	Import ushqim per kafshe ushqim per kafshe	46
35	Prodhim majoneze	5
36	Prodhim suplemente ushqimore/ depo farmaceotike	7
37	Supermarkete	53
38	Prodhim boze	8
39	Ferme lopesh	2
40	Drejtoria e sherbimeve qeveritare	1
41	Pike grumbullimi ullinje	5
42	Mjet transporti shperndarje/ bot uji	4
43	Perpunim amabalzhim mjalti	1
44	Prodhim kerpudha	1
45	Restorant	13
46	Treg ushqimor	4
47	Fraksionim i barerave mjeksore	1
TOTALI		**3149**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.22 Inspektimet e kryera me dhe pa planifikim sipas drejtimeve, urdhrave.

Nr.	Inspektimi referuar planit, ose urdher, indicio, licensime, gjurmueshmeria etj.	Totali I Inspektimeve 2018
1	Indicio adhur me email nga dp	204
2	Ndjekja e gjurmueshmerise	21
3	Verifikimi i ngarkesave te importit	47
4	Asgjesim me kerkese te subjektit	158
5	Licensime	92
6	Me urdher te drejtorit te pergjithshem/ emailit	149
7	Realizim detyrash	103

8	Kerkese per zhbllokim aktiviteti	26
9	Ne ndjekje te problematikes	5
10	Njoftim nga sistemi raffs	22
11	Verifikimi i produkteve te bllokuara	8
12	Rivleresim ne baze te rezulltatit te analizave	32
13	Kerkimi i grandeve	10
14	Monitorimi i kripes	14
15	Ne kuader te zesonit turistik	153
16	Marrje mostre kontroll zyrtar	40
17	Referuar planit te fundvitit	149
18	Vleresimi i kartes teknologjike	2
19	Insp.Te.parealizuara nga plani vjetor i inspektimeve	810
20	Plani i inspektimeve (planifikimet)	2718
21	Inspektime jashte planit totali	1241
22	Insp. Brenda planit ne baze te muajve	1908
23	NR.TOTAL I INSPEKTIMEVE NE BAZE TE MUAJVE	3149

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.23 Realizimi i mostrave për vitin 2018

Laboratori		**OJSH**							
		Nr. mostrave					**Nr. Analizave**	**Brenda norme**	**Jashte norme**
		PIK	**K-Z**	**K-Z mostr pas autok**	**AK**	**Tot**			
Laboratori i DRAKU	Kimiko-fizik		320			320	320	302	**17**
	Mikrobiologjik		12			12	12	10	**2**
	Totali		***332***			***332***	***332***	***312***	***19***
ISUV	Kimiko-fizik		18			18	18	11	**7**
	Mikrobiologjik		19			19	19	13	**6**
	Toksikologjike		78	1		79	79	67	**2**
	Totali		***115***	***1***		***116***	***116***	***91***	***15***
ISHP	**Mikrobiologjik**		11			11	11	8	**3**
TOTALI AKTIVITETIT			458	1		459	459	411	**37**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.25 Inspektimet e kryera për vitin 2019

Nr	**Aktiviteti**	**Numri i inspektimeve**
1	Furre buke	**608**
2	Furre buke & pasticeri	**174**
3	Pasticeri	**158**
4	Bar snack	**31**
5	Bar kafe	**211**
6	Prodhim akulli	**1**
7	Fast food	**238**
8	Byrektore	**136**
9	Bar & creperi & pasticeri	**36**
10	Piceri	**108**
11	Pjekje, ambalazhim kafeje	**52**
12	Prodhime brumi / jufkash / kausha	**7**
13	Perpunim, ambalazhim fruta te thata	**10**
14	Prodhim pije freskuese	**23**
15	Prodhim, ambalazhim mielli	**12**
16	Magazine ushqmore /fruta perime	**316**
17	Magazine frigoriferike	**31**
18	Ambalazhim produkte ushqimore	**13**
19	Market, minimarkete, pika tregtimi	**840**
20	Trajtim uji dhe prodhim pije freskuese	**39**
21	Stabilimet perimesh	**12**
22	Prodhim, ambalazhim vaj dhe vaj ulliri	**35**
23	Prodhim, ambalazhim ushqimesh	**11**
24	Prodhim karamelesh	**5**
25	Prodhim, ambalazhim patatinash	**3**
26	Prodhim, ambalazhim pije alkolike	**12**
27	Prodhim, tregtim vere/uthull	**14**
28	Prodhim birre	**3**
29	Perpunim kripe	**8**
30	Prodhim, ambalazhim bime medicinale dhe cajra	**26**
31	Prodhime brumi / makarona / petesh	**48**
32	Prodhim gliko dhe recel	**3**
33	Import ushqim per kafshe ushqim per kafshe	**12**
34	Prodhim majoneze	**5**
35	Prodhim suplemente ushqimore / depo farmaceotike	**8**
36	Supermarkete	**38**
37	Prodhim boze	**4**
38	Ambalazhim ullinje	**5**
39	Pike grumbullimi	**2**
40	Prodhim i gazit ushqimor	**4**
41	Restorant megjezore	**13**
	Totali	**3315**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.26 Inspektime te kryera në total për vitin 2019, përfshirë dhe urdhrat e veçantë, licencimet, etj.

Nr.	Inspektimi referuar planit, urdher, indicio, licensime, gjurmueshmeria etj.	Totali i Inspektimeve 2019
1	Indicio adhur me email nga dp	108
2	Ndjekja e gjurmueshmerise	8
3	Asgjesim me kerkese te subjektit	121
4	Licensime	400
5	Me urdher te drejtorit te pergjithshem/ emailit	127
6	Realizim detyrash	54
7	Me kerkese te subjektit	22
8	Ne ndjekje te problematikes	1
9	Njoftim nga sistemi raffs	7
10	Rivleresim ne baze te rezulltatit te analizave	22
11	Kerkimi i grandeve	3
12	Plane monitorimi	31
13	Ne kuader te zesonit turistik	44
14	Marrje mostre kontroll zyrtar	28
15	Referuar planit te fundvitit	137
16	Vleresimi i kartes teknologjike	2
17	Insp. te parealizuara nga plani vjetor i inspektimeve	1001
18	Diferenca e inspektimeve te planifikuara me inspektimet e realizuara	114
19	Plani i inspektimeve ne baze te muajve (planifikimet)	3201
20	Insp. Brenda planit ne baze te muajve te realizuara	2200
	Nr. total i inspektimeve ne baze te muajve	**3315**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.27 Lloji i mostrave të analizuara në laboratorë për vitin 2019

Lloji i mostrave te analizuara	DRAKU			ISUV			ISHP	
	PIK	K-Z	AK	PIK	K-Z	AK		
Miell gruri, misri, orizi,thekre		10			13			
Bukë gruri, misri gluten, hime(gruri, misri, thekre)		43						
Grurë, misër.theker,kafe, erëza,çaj		3			2			
Produkte pastiçerie		37			1			
Produkte brumi		17						
Mish e produkte (sallam,proshutë, hamburger, qofte etj)		5						
Qumësht e produkte qumeshti (gjalp, djath, gjizë, kos, qumësht pluhur, ushqim për fëmijë etj)					1			
Pije alkoolike (vere, birre, brendi, ëisky, ferrnet, ponc		6						
Pije joalkoolike, lëngje frutash dhe ujërat		7						2
Fruta dhe perime, komposto frutash, recel, salca etj		3						
Vajra,margarinë,majonezë		12			2			
Kripë		12						
Bimë e produkte bimore dhe blegtorale		1			82			
Gjak dhe organe te brendshme viçi, dhije, dele; qumësht lope, dele, dhije; mizë blete;		2			1			
Totali		**158**			**102**			**2**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.28 Numri i inspektimeve në bazë të aktivitetit

Nr	Aktiviteti	Numri i inspektimeve
1	Furre buke	737
2	Furre buke & pasticeri	85
3	Pasticeri/ peodhim boze	75
4	Bar kafe	73
5	Prodhim akulli	3
6	Fast food	186
7	Byrektore	53
8	Bar & creperi & pasticeri	21
9	Piceri	75
10	Pjekje, ambalazhim kafeje	34
11	Prodhime brumi/ jufkash/ kausha	11
12	Perpunim, ambalazhim fruta te thata	8
13	Prodhim pije freskuese	36
14	Prodhim. Ambalazhim mielli	10
15	Magazine ushqmore/fruta perime	252
16	Magazine frigoriferike	22
17	Prodhim ambalazhim produkte ushqimore	10
18	Market, minimarkete, pika tregtimi	656
19	Trajtim uji dhe prodhim pije freskuese	11
20	Stabilimet perimesh	10
21	Prodhim, ambalazhim vaj dhe vaj ulliri	17
22	Prodhim karamelesh	2
23	Prodhim, ambalazhim patatinash	1
24	Prodhim, ambalazhim pije alkolike	5
25	Prodhim, tregtim vere/uthull	9
26	Prodhim birre	4

27	Perpunim kripe	1
28	Prodhim, ambalazhim bime medicinale dhe cajra	12
29	Prodhime brumi / makarona/ petesh	23
30	Prodhim gliko dhe recel	2
31	Import ushqim per kafshe ushqim per kafshe	3
32	Prodhim majoneze	7
33	Supermarkete	45
34	Ambalazhim ullinje	1
35	Farmaci bujqesore	3
36	Prodhim i gazit ushqimor	2
37	Restorant/megjezore	12
38	Farmaci bujqesore	1
39	Totali	2518

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.29 Inspektimet e kryera në total për këtë periudhë *(përfshirë dhe urdhrat e veçantë, licencimet, etj)*

Nr.	**Inspektimi referuar planit, ose urdher, indicio, licensime, gjurmueshmeria etj.**	**Totali i Inspektimeve 2020**
1	Indicio adhur me email nga dp	**190**
2	Covid 19	**442**
3	Asgjesim me kerkese te subjektit	**97**
4	Licensime	**91**
5	Me urdher te drejtorit te pergjithshem/ emailit	**75**
6	Realizim detyrash	**4**
7	Me kerkese te subjektit	**17**
8	Kerkese per leje Higjeno sanitare	**1**
9	Njoftim nga sistemi raffs	**13**
10	Rivleresim ne baze te rezulltatit te analizave	**17**
11	Kerkimi i grandeve	**4**
12	Plane monitorimi	**122**
13	Ne kuader te zesonit turistik	**2**
14	Marrje mostre kontroll zyrtar	**7**
15	Vleresimi i kartes teknologjike	**3**
16	Insp. te parealizuara nga plani vjetor i inspektimeve	**1091**
17	Diferenca e inspektimeve te planifikuara me inspektimet e realizuara	**4**
18	Plani i inspektimeve ne baze te muajve (planifikimet)	**2522**
19	Insp. Brenda planit ne baze te muajve te realizuara	**1431**
	Nr. total i inspektimeve ne baze te muajve	**2518**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.30 Produktet OJSH e asgjësuara nga DR AKU Tiranë për periudhën 2018, 2019, 2020,

Viti	Sasia e produkte të bllokuara (ton)	**Sasia e produkte asgjësuara (ton)**	**Vlera e produkteve asgjësuara (lekë)**
2018	1128	1684	654,366,828
2019	74	1518	214,515,455
2020	45	2012	329,506,861
Totali	1,247	**5,214**	**1,198,389,144**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.7

Tabela nr.31 Personat për dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e parashkrimit të gjobave

1	z.A.I, ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU	*38,890 lekë/secili*
2	z.A.H ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU	
3	z.R.L ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU	
4	z.F.S, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Janar-Maj 2018	
5	znj.M.M, ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj 2018 – Maj 2019	
6	z.S.S ish Kryeinspektori i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – 15 Tetor 2019	
7	z.A.N ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Tetor 2019 – Shkurt 2020	
8	zj.N.C, përgjegjëse e sektorit të shërbimeve të brendshme në DRAKU Tiranë	
9	zj.H.P Juristi i DRAKU Tiranë	

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.32 Subjektet debitore për shërbimin laboratorik, sipas trajtimit dhe renditjes së bërë në pikën 5 të Projekt-raportit

Nr	Subjekti	Vlera në lek
1	G	2,050
2	M	1,800
3	M	600
4	M	2,000

5	S	6,500
6	F	4,500
7	N	1,100
8	N	4,000
9	M	1,200

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.32 Subjektet debitore nga gjobat e vendosura

Nr.	Emer Mbiemer	Vlera në lekë
1	A	148,000
2	M	177,000
3	B	44,000
4	A	296,000
5	A	370,000
6	G	148,000
7	A	592,000
8	S	592,000
9	L	444,000
10	F	296,000
11	S	148,000
12	A	451,000
13	K	444,000
14	M	148,000
15	S	74,000
16	S	444,000
17	D	296,000
18	A	444,000
19	K	444,000
20	A	444,000
21	L	148,000
22	S	592,000
23	E	592,000
24	F	296,000
25	E	296,000
26	G	444,000
27	M	444,000
28	N	74,000
29	R	444,000
30	D	740,000
31	M	444,000
32	G	222,000
33	J	444,000
34	H	624,000
35	V	156,000
36	I	312,000
37	V	624,000
38	A	312,000
39	A	156,000
40	K	3,200,000
41	G	5,200,000
42	C	400,000
43	E	1,500,000
44	Q	150,000
45	G	800,000
46	L	300,000
47	I	400,000
48	M	500,000
49	A	300,000
50	A	900,000
51	S	300,000
52	S	700,000
53	S	100,000
54	R	200,000
55	B	800,000
56	G	400,000
	SHUMA	**29,958,000**

Burimi: DRAKU Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

V.1 Observacione

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion, ku në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet:

Mbështetur në Urdhërin e Brendshëm nr.643 prot datë 29.01.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorisë Rajonale i kanë kaluar në përdorim 7 automjete në Janar të 2019. Meqenëse këto automjete i kanë kaluar vetëm në përdorim DRAKU Tiranë, gjatë vitit 2019 në asnjë rast kjo drejtori rajonale nuk ka pasuar të

parashikuar dhe të realizuar asnjë shpenzim për automjetet (mirëmbajtje, siguracion apo taksa) pasi gjatë vitit 2019 këto shërbime nuk kryheshin nga Drejtoria Rajonale AKU Tiranë (bashkëlidhur kopje të situacionit të shpenzimeve janar dhe dhjetor 2019); gjithashtu gjatë këtij viti kalendarik edhe policat e sigurimit për të gjitha automjetet janë tërhequr pranë Drejtorisë së Përgjithshme (kopje të disa policave të sigurimit për vitin 2019 bashkëlidhur).

Vetëm në Janar të vitit 2020 me e-mail nga Drejtoria e Përgjithshme na është kërkuar që për vitin buxhetor 2020 të parashikohen zërat që mbulojnë shpenzimet që lidhen me këto automjete. Për rrjedhojë gjatë vitit 2020 është filluar të kryhen këto shpenzime konkretisht siguracionet, taksat, kualidimet dhe mirëmbajtje) ku në cdo rast janë respektuar afatet e kryerjes së pagesave. Në momentin që janë kryer likujdimet e taksave dhe kualidimeve për vitin 2020, nga zyra e D.R.SH.T.RR Tirane na janë bërë me dije edhe detyrimet për vitin 2019 të cilat rrjedhimisht për tejkalim të afatit janë shoqëruar me gjobë.

Meqenëse shërbimi i realizuar në këtë procedurë prokurimi është specifik nga natyra e tij (transport reagente dhe mbetje laboratorike etj), OE këtë faturë e ka shoqëruar me listë shoqëruese ku janë përshkruar qartazi zërat si përshkrimin e mallit , sasia, vlera pa dhe me Tvsh etj;

Nënshkrimi i transportuesit është vendosur pranë vulës së OE (fotokopje bashkëlidhur); Numrat serial të faturës tatimore të kopjes së parë të faturës janë të kuqe dhe jo blu vërtetuar kjo me kopje me ngjyra bashkëlidhur.

Në vitin 2016 nga Drejtori Rajonal i DRAKU Tiranë është lidhur me kompaninë A marrëveshja me nr. 117 prot date 02/02/2016 mbi dhënie në përdorim të numrave të celularit punonjësve të institucionit kundrejt lëshimit të një fature përmbledhëse me emrat dhe shumat e detyrimit për cdo punonjës. (bashkëlidhur kopje e kontratës me kompaninë A dhe fatura e muajit dhjetor 2017). Për të kryer likujdimin e faturës përmbledhëse të këtij shërbimi, meqenëse në kontratë ishte parashikuar likujdimi i faturës totale nga institucioni, në borderotë e cdo muaji mbahej detyrimi përkatës te cdo punonjësi dhe më pas kryhej likujdimi total i faturës mujore. Për këtë qëllim nga punonjësit e DRAKU Tiranë është marrë edhe autorizimi përkatës (një model bashkëlidhur 491/35 datë 31/05/2016).

Konkretisht shuma 12,465 lekë likujduar me urdhër shpenzimin nr 21 datë 05/02/2018 kompanisë A, i është mbajtur paraprakisht punonjësve në pagën e muajit janar 2018 (basgkëlidhur borderoja janar 2018) e më pas likujduar më datë 05/02/2021 kësaj kompanie.

Pra në asnjë rast nuk ka pasur mbulim të mbulim të shpenzimeve për telefoninë celulare nga fondet e DRAKU Tiranë dhe në asnjë rast nuk gjen zbatim VKM nr.864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë".

Mbështetur në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" neni 11 "tarifë shërbimi" pika b ka të parashikuar "Tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelezizionit Publik Shqiptar" Ndërkohë në neni 11/1janë të parashikuara rastet e përjashtimeve nga pagesa e tarifave të shërbimit konkretisht:

Përjashtimet nga pagesa e tarifave të shërbimit

"1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar",statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të ndryshuar, apo statusin e të verbrit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", përjashtohen nga:

a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë se Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;

c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;

ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës së Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë;

Gjithashtu mbështetur në Udhëzimin Nr. 29 datë 27/12/2011 (bashkëlidhur) janë të përcaktuar qartë rastet kur një konsumator i energjisë elektrike nuk është subjekt i pagimit të kësaj tarife shërbimi. Pra mbështetur në bazën ligjore të sipër cituar në asnjë rast institucionet buxhetore nuk janë të prejashtuar nga pagesa e kësaj tarife konkretisht 100 lekë cdo muaj dhe jo 1000 lekë cituar në projekt raporti. Megjithatë lidhur me këtë gjetje i jemi drejtuar me shkresë edhe institucionit përkatës, përgjigjen e te cilën e gjeni bashkelidhur (kopje e shkreses 5552/1 prot date 16/06/2021).

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Për observacionin e bërë më sipër, trajtimi gjendet në shkronjën b të pikës 4, pikën 7, pikën 23 dhe 34 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.
Për numrat serial të faturës tatimore, observacioni merret në konsideratë.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur (listë-pagesa muaji Janar 2018), merret në konsideratë observacioni i bërë më sipër.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur, merret në konsideratë observacioni i bërë më sipër.
Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale dhe monetare, si vijon:
Shpërndarja e materialeve të ndryshme, kancelari, etj, është bërë sipas kërkesës së çdo sektori në fillim të vitit.
Fletë-daljet e karburantit.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Observacioni për daljen e materialeve të ndryshme, kancelari nga magazina, merret në konsideratë, si dhe për fletë-daljet nr.163 datë 13.08.2019 dhe fletë-daljen nr.112, datë 30.06.2019.

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion për inspektimin në subjektet S dhe B, ku janë bashkëlidhur foto e inspektimit.
Për inspektimin datë 11.12.2020 nr.AKU-TR-2020-007504, bashkëlidhur foto dhe kërkesa e subjektit për asgjesimin e produktit.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Fotot nuk janë të qarta dhe nuk arrihet të lexohen. Lidhur me referimin e shkronjës a të nenit 41 të Ligjit të inspektimit, sqarojmë se neni 41 është pjesë e seksionit 3 të Ligjit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e inspektorit, pra inspektori ka të drejtë përball subjektit të kryejë veprimet e nevojshme, sic ka edhe detyrimin që ti kryejë këto veprime, në raport me institucionin ku kryen funksionin publik. Pra ligji sic ka germe ka edhe frymë, dhe në këtë rast është e përcaktuar qartë se çfarë veprimesh ka të drejtë dhe detyrë njëkohësisht inspektori gjatë inspektimit në subjekt.
Për inspektimin datë 11.12.2020 nr.AKU-TR-2020-007504 merret në konsideratë pjesërisht.

Observacion: Me shkresën nr.1153/17, datë 18.06.2021, është bërë observacion, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur:
Për inspektimin në subjektin A, datë 22.01.2018, bashkëlidhur observacionit fotot e bërë gjatë inspektimit.
Për çështjet 12, 12/1, 12/2, datë 12.01.2018**.**
Për inspektimin e datës 20.04.2018, asgjesim produktesh tek C Albania.
Për inspektimin e datës 20.06.2018, asgjesim produktesh tek C Albania.
Për inspektimin e datës 01.11.2018, asgjesim produktesh tek C Albania.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Observacioni merret në konsideratë. Në rastin e inspektimeve për çështjet 12, 12/1, 12/2, datë 12.01.2018, nga ana juaj duhet të ishte bashkëlidhur historiku i shkeljeve për subjektin që ka marrë masën administrative më të lartë, me qëllim vlerësimin nga ana jonë të qëndrimit tuaj në këto dy inspektime. Për inspektimet e kryera tek C Albania, observacionet merren në konsideratë pjesërisht. Për inspektimin e datës 01.11.2018, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacion:Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion lidhur me procedurën e ekzekutimit të gjobës për subjektet H, Vath Xhani, V, A, A, ku në mënyrë të përmbledhur parashtrohet:
Për subjektin "H" janë ndjekur të gjitha procedurat hap pas hapi për vënien në ekzekutim të masës administrative detyrim me gjobë në zbatim <u>të Urdhërit nr. 69, datë 04.02.2016</u> "*Për Vënien në Ekzekutim sipas Vendimeve të Gjykatave Përkatëse*" dhe Urdhërit nr.1586, datë 28.04.2016 "*Për ndjekjen e procedurave Ligjore në Gjykatat Administrative për Vjeljen e Gjobave vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm Gjykatë Rrethi*" konkretisht:
Pasi kam administruar konfirmimin për marrjen dijeni nga ana e subjektit "H" për vendimin e Komisionit nr. 5975/1, datë 10.09.2018, kam vijuar procedurat për celje urdhëri në gjykatë. Me vendim nr. 21, datë 21.01.2019 gjykata ka nxjerr urdhër ekzekutimi i cili është përcjell origjinal në Drejtorinë e Përgjithshme mbështetur në:

Pika 3, Urdhër nr.1586, datë 28.04.2016, citohet: "*Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë përgjegjëse për ndjekjen e procesit* ***deri në marrjen e vendimit i cili origjinal do të dërgohet*** *pranë Sektorit Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme".*

Bazuar në:

Pikën 4, Urdhër nr.1586, datë 28.04.2016, citohet: "***Sektori Juridik është përgjegjës për ndjekjen e procesit në zyrat e përmbarimit****.....*"

Pikën 2, Urdhër nr.69, datë 04.02.2016, citohet: "*Urdhërat e ekzekutimit, Vendimet e Gjykatave* ***origjinale do ti përcillen në Sektorin Juridik*** *në Drejtorinë e Përgjithshme AKU i cili është* ***përgjegjës për shpërndarjen e tyre në shërbimet përmbarimore me anë të kërkesave për vënie në ekzekutim të këtyre urdhërave".***

Sektori Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme ka vënë në ekzekutim urdhërin nr. 21, datë 21.01.2019 pranë shërbimit përmbarimor R.B.S dhe është përgjegjës për si më sipër cituar për ndjekjen e procesit në zyrat përmbarimore. Në lidhje me konstatimin tuaj **pika 17** faqe 47, subjekti "**A**" mbaj të njëjtin qëndrim si në subjektin H. Sekuestrot konservative dhe ekzekutive nga përmbaruesit gjyqësor mbajnë të bllokuara dhe nën sekuestro për një afat 6 mujor llogaritë bankare dhe cdo sekuestro tjetër vendosur mbi pasuritë dhe të drejtat reale të debitorëve. Rezulton data 16.06.2021 ridërgimi i sekuestrove të fundit dërguar nga përmbaruesi komunikuar në Drejtorinë Rajonale.

1. Në lidhje me konstatimin tuaj **pika 14** faqe 40, subjekti "**V**" , mbaj të njëjtin qëndrim si në subjektin H. Rezulton data 02.02.2021 ridërgimi i sekuestrove të fundit komunikuar në Drejtorinë Rajonale.
2. Në lidhje me konstatimin tuaj **pika 16** faqe 45, subjekti "**V**" , mbaj të njëjtin qëndrim si në subjektin H. Rezulton data 16.06.2021 ridërgimi i sekuestrove të fundit komunikuar në Drejtorinë Rajonale.
3. Në lidhje me konstatimin tuaj **pika 19** faqe 45, subjekti "**A**" , mbaj të njëjtin qëndrim si në subjektin H. Rezulton data 16.06.2021 ridërgimi i sekuestrove të fundit komunikuar në Drejtorinë Rajonale
4. Në lidhje me konstatimin tuaj **pika 99** faqe 149 **"A"** është inspektuar në 15 dhjetor 2018, mbaj të njëjtin qëndrim si në subjektin H. Rezulton se është vënë në ekzekutim me shkresën Nr. 2850 prot.,në datë 14.05.2019, Sekuestrot janë riderguar në mënyrë periodike, më datë 21.12.2020, 16.06. komunikuar në Drejtorinë Rajonale.

Lidhur me qëndrimin për mos arkëtimin e gjobës nga përmbaruesi, vihet re se debitorët nuk ka likuiditet, pasi sekuestrot janë ridërguar dhe janë të rifreskuara. Ecja e afateve për përllogaritjen parashkrimit të gjobave ndërpritet në momentin që gjoba vihet në ekzekutim. Pasi gjobat për subjektet e sipër cituar janë vënë në ekzekutim afati për parashkirimin e tyre ndëpritet. Mos arkëtimi i gjobave dhe përllogaritja e kamatvonesave cituar si dëm ekonomik nuk qëndrojnë në kuptim të ligjit, për sa kohë këto gjoba janë vënë ne ekzekutim në momentin që janë kthyer në tituj ekzekutiv. Zgjatja në kohë e arkëtimit të gjobës është një marrdhënië midis Përmbaruesi dhe vet debitorit e cila normohet nga Kodi Civil dhe K.Pr.A nëpërmjet vendosjes së sekuestrove konservative dhe ekzekutive për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit dhe kamatvonesat.

Referuar Neni 30 ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për Kundravajtjet Administrative*", nenit 510 paragrafi I, gërma "e" të K.Pr.C, Nenit 22 i po të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative*",*

*G*jobat dhe kamatëvonesat paguhen nga kundërvajtësi nga momenti kur vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe akti është bërë i ekzekutueshëm.

Neni 510, e) *"...aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre"*

Nenit 22 *"Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv, parashikon se: Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobe përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji".*

Duke u parë ky nen ngusht në frymën dhe qëndrimin që mban gjykata, kamatëvonesat përllogariten në momentin që akti administrativ bëhet i ekzekutueshëm. Pala kreditor në momentin që dërgon kërkesë për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv pranë zyrave përmbarimore përcakton dhe detyrimin. Kamatëvonesa mbi një detyrim përllogaritet nga Përmbaruesi dhe derdhet në Thesar në llogarinë e DR AKU Tiranë nga Përmbaruesi në momentin që bëhet likuidimi në total i detyrimit.

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Grupi i auditimit për observacionin e mësipërm argumenton e ka dhënë sqarimin në observacionet e trajtuara në Projekt Raport, rast pas rasti për subjektet e mësipërme, si dhe ka saktësuar përgjegjësinë për 4 rastet**.**

Observacion: Me shkresën nr.1153/16 prot., datë 18.06.2021, është bërë observacion për inspektimet e kryera në subjektet (B, K, G) si dhe praktikat 1/1, 1/5, 9/1, 3-2020, 3/2, 5/7, 15, 18, 1.1-2020.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Lidhur me observacionin e bërë për praktikat e mësipërme të inspektimit, kemi të njëjtin qëndrim me atë që kemi mbajtur në observacionin për akt-konstatimin, për të tjerat merret në konsideratë pjesërisht.
Procedura e asgjesimit vazhdon edhe pa pjesëmarrjen e inspektorëve të tatimeve (Udhëzimi nr.6, datë 30.01.2015 për tatimin mbi vlerën e shtuar, neni 58, kreu v.

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021, është bërë observacion për analizën laboratorike të vajit të ullirit.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Observacioni merret në konsideratë pjesërisht, për citimin në raport-provë të stashit të përdorur.

Observacion: Me shkresën nr.1153/17, datë 18.06.2021 është bërë observacion për inspektimin nr.AKU-TR-2020-002483, për 2 inspektimet në Korrik 2019.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Në procesverbal thuhet u gjend i mbyllur, pra janë dy elementë të ndryshëm (mbyllur/nuk u gjend në adresën e dhënë), kjo i jep përgjigje pyetjes tuaj.
Për sa i përket 2 inspektimeve në Korrik 2019 dhe atyre në Shtator, mbi mangësi në dokumentacionin e mbajtur, i referohemi dokumentit të transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sh), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar; Për nënshkrimin e titullarit, merret në konsideratë.

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion për 7 inspektime asgjesimi në Dhjetor 2019, për inspektimin nr. AKU-TR-2020-000543, inspektimin në subjektin "*Magazina importi J*", administrimin e fletë-analizave për 4 subjekte, mostërmarrja në subjektin C, për produktin vaj ulliri.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Për sa i përket 7 inspektimeve në Dhjetor 2019 mbi mangësi në dokumentacionin e mbajtur, i referohemi dokumentit të transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sh), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar; Për nënshkrimin e titullarit, merret në konsideratë.
Observacioni për inspektimin me nr. AKU-TR-2020-000543 nuk merret në konsideratë, dhe shpjegimet i kemi dhënë edhe gjatë përgatitjes së Projekt Raportit.
Për inspektimin e kryer në subjektin Magazina importi J, është saktësuar përgjegjësia e personave për veprime dhe mosveprime.
Për administrimin e fletë-analizës në 4 subjekte, merret në konsideratë për subjektin "M" me përfaqësues E.
Për mostërmarrjen në subjektin C, merret në konsideratë observacioni.

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion nga z.F.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për likujdimin e vendimeve jyqësore, për sendet e sekuestruara, inspektimet online, procedurën e ekzekutimit të gjobës në 1 rast, kohëzgjatja e autorizimit.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Për sa i përket likujdimeve gjyqësore, nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi, por thjesht është cituar urdhër-shpenzimi dhe ju si autorizues i tij. Lidhur me ekzekutimin e gjobës, e kemi sqaruar qëndrimin tonë. Për pikën inspektimin nr.35, merret në konsideratë. Për inspektimin

nr.47 dhe 48, ju jeni cituar si përgjegjës vetëm për moskryerjen e inspektimit on-line. Për rastet e kryerjes së ri-inspektimit, e kemi sqaruar në praktikat konkrete të inspektimit, mbështetjen ligjore.

Observacion: Me shkresën nr.1153/16, datë 18.06.2021 është bërë observacion për mostërmarrjen për plehëra për përdorim në bimësi.
Ne process verbalin Nr. AKU-TR-2020-006821–date 28.10.2020 ne subjektin **M**. Ju citoni qe nuk vertetohet marrja mostrës. Në procesverbalin e inspektimit i cili është online, është pasqyruar shume qartë që është marrë një moster fare Gruri var. "Nogal" në subjekt.
Por kjo nuk ka dalë në formë tabelare ne process verbal (kjo ka ardhur si rezultat i një gabimi të momentit pasi inspektimi online i ka këto probleme gje që e kemi ngritur here pas here në Inspektoriatin qendror) Po të ishte ndryshe subjekti nuk do të firmoste proces verbalin e inspektimit (sqarojme që ne subjekt është lënë mostër së bashku me etiketen e mostrës, kjo mund të vërtetohet nëse ju dyshoni vertet). Më poshte po paraqesim konfiguracionin e marrë nga sistemi online i process verbalit të inspektimit si dhe firmat e inspektoreve dhe subjektit.
Përsa i përket fletë etiketës së marrjes së mostrës ajo është në perputhje me VKM Nr.86, datë 30.1.2013 për përcaktimin e kritereve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve për farat e drithërave. (jo te vkm 107)
Theksojmë që ajo etiketë nuk shkon në laborator pasi ruhet anonimati i mostrës. Kjo etiketë bashkangjitet praktikës ndërsa në laborator shkon një etiketë tjeter bashkangjitur mostres e kodifikuar pa të dhënat e subjektit por vetëm lloji i farës.
Etiketa vuloset dhe vendoset mbi mostër. Farat futen në qese letre për të ruajtur kushtet e farës dhe jo ne qese plastike. Pastaj zarfi mbyllet vuloset mbi mbylljen e saj dhe vendoset nr i kodit sic ju e pate konkretisht ne ambjentet e AKU-se.
Mostrat dërgohen në ESHFF me shkrese përcjellëse dhe jo me fletë shoqëruese. (bashkengjitur shkresat e derguara ne laboratoret e ESHFF dhe QTTB-se) ndërsa flete shoqeruesja qe ju citoni sipas Urdheri 4635 dt 16.10.2006 per Inspektimin Fitosantar është për mostrat fitosanitare të fidanëve për diagnostikimin e paraziteve dhe jo per fuqi mbirëse të farave.
Mostra e dyte me të njejtat te dhëna etikete por pa numër kodi lihet në subjekt deri në marrjen e përgjigjes së analizës.
Mostra e trete ruhet ne ambjentet e AKU-se deri ne marrjen e rezultatit ashtu sic ju e patë edhe pse mund te mos ishin ruajtur pas marrjes së përgjigjeve. Në këtë rast na është dashur të marrim edhe një moster te katert sipas urdherit dhe jane dërguar në ambjentet e DP AKU-së. (bashkëngjitur proces verbali i dorzimit në DP edhe pse e konsideroni të jashtligjshëm përsëri citoni që).
Për sa i përket Fletë analizës së ardhur nga ESHFF me shkresë zyrtare ato janë fotokopje pasi origjinalet janë në protokoll dhe ne na dorëzohen pasi janë cikluar nga Drejtori dhe protokolluar (shkresa percjellese). Kjo është lehtësisht e verifikueshme si te protokolli i AKU-se Tiranë po ashtu edhe në ESHFF. Fletë formati është sipas VKM Nr. 86, datë 30.1.2013. dhe për të njëjtën arsye të anonimatit nuk vendoset nr i lotit në të.
Duhet të keni parasysh që mënyra e marrjes së mostres eshte pershtatur për te permiresuar procedurën e mostermarrjes pasi Udhezimi nr 107 është shumë i vjeter dhe i përket kohës kur nuk ka qenë krijuar AKU-ja për pasojë ajo është përshtatur në kushtet aktuale në mungesë të një VKM-je të re. Të njëjtat argumente kemi për të gjitha mostrat sa i përket procedures së marrjes dhe dërgimit në laborator.
Për process verbalin Nr.AKU-TR-2020-006806 datë 28.10.2020 ne subjektin Alban Velo sqarojme: Mostra është marrë sipas VKM nr 332 dt 18.4.3013 për perimet. Sasia e farës së mostrës marrë përcaktohet sipas kësaj vkm-je për farat e perimeve aneksi III pesha e lotit për farat Hibride (F1)me poshtë nje fragment i vkm-së.
Data e mostrimit sigurisht nuk lidhje me datën e flete analizës së ESHFF. Ne i dergojmë një dite me vone mostrat në ESHFF plotësojme formularin e dorëzimit tek ESHFF dhe marrim faturen për arkëtim që menaxhohet nga financa per procedurën e pagesës së mostrës.
Në procesverbalin Nr.AKU-TR-2020-006810 date 28.10.2020 në subjektin Sherif Subashi. Sqarojmë: Sasia e mostres është marre sipas VKm nr.86, datë 30.1.2013 për farat e perimeve aneksi III pasha e lotit sasia minimale 75 gr (me poshte fragmenti i VKM-se per spinaqin)
Gjithashtu edhe per process verbalin Nr. AKU-TR-2020-006813 date 28.10.2020 ne subjektin H per mostren spinaq.

Per praktiken Nr. AKU-TR-2020-006809 ne subjektin Koja date 28.10.2020 sqarojme: Sa i përket praktikës së këtij subjekti bashkëngjitur ju dërgojmë të gjithë praktikën e nxjerre nga sistemi on line. Gabimisht është printuar nga sistemi praktika e datës 14.10.2020 të po këtij subjekti.
Duhet të ishit më bashkëpunues dhe të na kërkonit sqarim mbi këtë lapsus kur ishin në ambjentet e AKU-së Tirane.
Megjithatë faktet janë në sistemin online dhe nuk mund ti ndryshoje askush. Më poshtë ju paraqesim konfiguracionin e marrë nga sistemi on line për konkretizimin e saj.
Pra është e qartë që gabimisht është printuar nga sistemi inspektimi i mëparshem i subjektit ai i dt 14.10.2020.
(Bashkengjitur praktika e plote e inspektimit te date 28.10.2020 e subjektit K)
udhezimi nr.107 , dt.02.12.2002 ku ju i referoheni per proceduren e plotesimit te etiketes se mostres eshte ndryshuar .
Sa më siper përcaktimet e bëra nga ju nuk qendrojne.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Për observacionet që janë trajtuar edhe gjatë fazës së Projekt Raportit, mbajmë të njëjtin qëndrim.
Sasia e farës në rastin e subjektit S nuk merret në konsideratë;
Sasia e farës në rastin e subjektit H merret në konsideratë.
Për rastin e subjektit K, merret në konsideratë pjesërisht.

Observacion: DPAKU me shkresën nr.1153/15 datë 16.06.2021 ka bërë observacion për trajtimin e bërë nga grupi i auditimit, të praktikave të shqyrtimit të ankesave, përgjatë periudhës 01.06.2020-31.12.2020, si dhe të praktikës së mostërmarrjes së plehërave për përdorim për bimësi.
Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së: Për këtë çështje kemi të njëjtin qëndrim, me atë të mbajtur në Projekt Raportin e Auditimit**.** Kryetari i Komisionit si dhe Anëtarët e Komisionit, nuk janë ngarkuar me përgjegjësi për moshqyrtimin brenda afatit ligjor të ankesave, pasi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm i AKU (Kryetar Komisioni), për një ankesë të administruar në AKU në vitin 2018, ndërkohë që ai është emëruar në vitin 2019/2020 (në rastin e z.B.S), dhe logjikisht do të jetë jashtë afatit, por këtë nuk mund ta themi për rastet e z.R.L (Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së, për periudhën Tetor 2019 –Tetor 2020), ku ankesat e bëra nga subjektet si: S, L, T, R, L, etj, janë bërë gjatë kohës që duheshin marrë në shqyrtim nga Drejtori i mësipërm. Anëtarët e Komisionit janë cituar përgjegjës vetëm për vendimmarrjen ndaj ankesave. Lidhur me Urdhrin për mostëmarrje merret në konsideratë pjesërisht, dhe është pasqyruar në gjetjen dhe rekomandimin përkatës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT